

## Përmbajtja

TITULLI I .....	5
LIGJI PENAL DHE ZBATIMI I TIJ .....	5
KREU I .....	5
PARIME TË PËRGJITHSHME .....	5
KREU II .....	7
ZBATIMI I LIGJIT PENAL NË KOHË .....	7
KREU III .....	8
ZBATIMI I LIGJIT PENAL NË HAPËSIRË .....	8
TITULLI II .....	11
VEPRA PENALE DHE PËRGJEGJËSIA PENALE .....	11
KREU I .....	11
VEPRA PENALE .....	11
KREU II .....	16
PËRGJEGJËSIA PENALE .....	16
KREU III .....	21
BASHKËPUNIMI DHE PERSONAT JURIDIKË .....	21
SEKSIONI I .....	21
BASHKËPUNIMI .....	21
SEKSIONI II .....	27
PËRGJEGJËSIA PENALE E PERSONAVE JURIDIKË .....	27
TITULLI III .....	29
DËNIMET .....	29
KREU I .....	29
DËNIMET NDAJ PERSONAVE FIZIKË .....	29
KREU II .....	42
MASAT EDUKUESE DHE MJEKËSORE .....	42
SEKSIONI I .....	42
MASAT EDUKUESE NDAJ TE MITURIT .....	42
SEKSIONI II .....	47
MASAT MJEKSORE .....	47
KREU III .....	50
DËNIMET PENALE NDAJ PERSONAVE JURIDIKË .....	50
KREU V .....	55
CAKTIMI I DËNIMIT .....	55
SEKSIONI I .....	56
INDIVIDUALIZIMI I DENIMIT PENAL .....	56
SEKSIONI II .....	62
DENIMI PER DISA VEPRA PENALE .....	62
KREU VI .....	65
SEKSIONI I .....	65
ALTERNATIVAT E DËNIMIT DHE ZËVENDËSIMI I TIJ .....	65

SEKSIONI II .....	74
LIRMI ME KUSHT .....	74
TITULLI IV .....	78
SHUARJA E VEPRËS PENALE DHE E DËNIMEVE .....	78
KREU I.....	78
SHUARJA E VEPRËS PENALE.....	78
KREU II .....	80
SHUARJA E DËNIMIT.....	80
PJESA E POSAÇME .....	82
TITULLI I.....	82
KRIME KUNDËR LIGJIT NDERKOMBETAR .....	82
TITULLI II.....	89
VEPRAT PENALE KUNDËR PAVARËSISË DHE RENDIT KUSHTETUES .....	89
KREU I.....	89
VEPRA PENALE KUNDËR PAVARËSISË DHE TËRËSISË TERRITORIALE .....	89
KREU II .....	94
VEPRAT PENALE KUNDËR RENDIT KUSHTETUES .....	94
KREU III .....	96
VEPRAT PENALE TË TERRORIZMIT .....	96
KREU IV .....	106
VEPRAT PENALE KIBERNETIKE .....	106
KREU V .....	112
VEPRAT PENALE QË CENOJNË MARRËDHËNIET ME SHTETET E TJERA .....	112
TITULLI III .....	113
VEPRAT PENALE KUNDËR AUTORITETIT TË SHTETIT .....	113
KREU I.....	113
VEPRAT PENALE QË CENOJNË VEPRIMTARINË POLITIKE DHE SISTEMIN E ZGJEDHJEVE .....	113
KREU II .....	119
VEPRAT PENALE KUNDËR VEPRIMTARISË SHTETËRORE TË KRYERA NGA ZYRTARËT PUBLIKË OSE NË SHËRBIM PUBLIK .....	119
KREU III .....	131
VEPRAT PENALE KUNDËR VEPRIMTARISË SHTETËRORE TË KRYERA NGA SHTETASIT .....	131
KREU IV .....	136
VEPRAT PENALE KUNDËR RENDIT, SIGURISË DHE SHËNDETIT PUBLIK.....	136
KREU V .....	174
FALSIFIKIMET .....	174
KREU VI.....	179
VEPRAT PENALE TË KRYERA NGA BANDA E ARMATOSUR DHE ORGANIZATA KRIMINALE.....	179
TITULLI IV .....	182
VEPRAT PENALE KUNDËR SISTEMIT TË DREJTËSISË.....	182
KREU I.....	182
VEPRAT PENALE KUNDËR VEPRIMTARISË GJYQËSORE.....	182

KREU II .....	195
VEPRAT PENALE KUNDËR AUTORITETIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE .....	195
TITULLI V .....	200
VEPRAT PENALE KUNDËR MJEDISIT DHE REGJIMIT TË TOKËS .....	200
KREU I.....	200
VEPRAT PENALE KUNDËR MJEDISIT.....	200
KREU II .....	208
VEPRAT PENALE KUNDËR REGJIMIT JURIDIK TË TOKËS DHE TË NDËRTIMEVE .....	208
TITULLI VI.....	212
VEPRAT PENALE KUNDËR EKONOMISË.....	212
KREU I.....	212
VEPRAT PENALE NË FUSHËN E TATIMEVE.....	212
KREU II .....	219
VEPRAT PENALE NË FUSHËN E DOGANAVE.....	219
KREU III .....	224
VEPRAT PENALE TË KRYERA NË SHOQËRITË TREGTARE DHE KUNDËR PUNONJËSVE .....	224
KREU IV.....	236
VEPRAT NË LIDHJE ME USHTRIMIN E VEPRIMTARISE BANKARE DHE FINANCIARE .....	236
KREU V .....	238
VEPRAT PENALE NË FUSHËN E LOJËRAVE TË FATIT DHE GARAVE SPORTIVE .....	238
KREU VI.....	242
VEPRAT PENALE NË FUSHËN E FALIMENTIMIT.....	242
KREU VII.....	244
VEPRAT PENALE NË FUSHËN E PASTRIMIT TË PARAVE .....	244
TITULLI VII.....	247
VEPRAT PENALE KUNDËR FËMIJËVE, FAMILJES DHE MARTESËS .....	247
KREU I.....	247
VEPRAT PENALE KUNDËR FËMIJËVE.....	247
KREU II .....	256
VEPRAT PENALE KUNDËR FAMILJES.....	256
KREU III .....	261
VEPRAT PENALE KUNDËR MARTESËS.....	261
TITULLI VIII.....	262
VEPRAT PENALE KUNDËR PERSONIT .....	262
KREU I.....	262
VEPRAT PENALE KUNDËR JETËS .....	262
KREU II .....	266
VEPRAT PENALE KUNDËR INTEGRITETIT FIZIK OSE PSIKIK TË PERSONIT ....	266
KREU III .....	275
VEPRAT PENALE KUNDËR INTEGRITETIT SEKSUAL .....	275
KREU IV.....	287

VEPRAT PENALE KUNDËR LIRIVE VETJAKE .....	287
KREU V .....	299
VEPRAT PENALE KUNDËR MORALIT DHE NDERIT VETJAK .....	299
TITULLI IX .....	305
VEPRAT PENALE KUNDËR PASURISË .....	305
KREU I .....	305
VJEDHJA E PASURISË .....	305
KREU II .....	310
MASHTRIMET .....	310
KREU III .....	317
SHKATËRRIMI DHE DËMTIMI I PRONËS .....	317
KREU IV .....	319
VEPRAT PENALE KUNDËR ARTIT, KULTURES, PRONESISE INTELEKTUALE DHE INDUSTRIALE.....	319
TITULLI X.....	328
VEPRAT PENALE KUNDËR KAFSHËVE.....	328
DISPOZITA KALIMTARE .....	330



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PROJEKTLIGJ

Nr. , datë . .2025

KODI PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 81, pika 2, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozim të Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I  
PJESA E PËRGJITHSHME

TITULLI I  
LIGJI PENAL DHE ZBATIMI I TIJ

KREU I  
PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 1  
**Parimi i ligjshmërisë**

Ligji penal përcakton veprat penale, dënimet dhe masat e tjera që merren ndaj autorëve të tyre.

Neni 2  
**Mosdënimi pa ligj**

1. Askush nuk mund të dënohet penalisht për një fakt që nuk është parashikuar më parë shprehimisht në ligj si vepër penale.
2. Askush nuk mund të dënohet me një lloj dhe masë dënimi të paparashikuar në ligj.

Neni 3  
**Ndarja e veprave penale**

1. Veprat penale ndahen në krime dhe në kundërvajtje penale. Dallimi i tyre bëhet në çdo rast në dispozitat e pjesës së posaçme të këtij Kodi.

2. Kur dispozita penale nuk bën dallimin sipas paragrafit të parë të këtij neni, vepra penale do të konsiderohet kundërvajtje nëse lloji i dënimit të parashikuar është dënim jo me burgim ose, masa e dënimit me burgim të parashikuar është jo më e lartë në maksimum se dy vjet.

3. Dënimi me gjobë për kundërvajtjet penale nuk mund të kalojë kufirin maksimal të shumës së gjobës të parashikuar në këtë Kod.

4. Për efekt të dënueshmërisë së bashkëpunimit të veçantë në kryerjen e krimeve, individualizimit të qartë të dënimit, për zbatimin e rrethanave që lehtësojnë apo rëndojnë dënimin, për zbatimin e alternativave të dënimit me burgim dhe për çdo element tjetër të përmendur në këtë Kod që lidhet me veprën dhe politikën penale, do të vlerësohen si krime të rënda kur dispozita penale parashikon mundësinë e dënimit me burgim jo më pak se sa katër vjet dhe, si krime të lehta kur parashikohet dënim me burgim me pak se sa katër vjet apo çdo dënim tjetër më të butë.

5. Në lidhje me mënyrën e vuajtjes së dënimit apo caktimin e dënimeve plotësuese, do të vlerësohet si krim shumë i rëndë çdo krim që përmban mundësinë e dënimit të tij mbi dhjetë vjet burgim si dhe, ai që kryhet nga organizata kriminale pavarësisht masës së dënimit që ka parashikuar dispozita e shkelur.

#### Neni 4

### **Interpretimi i ligjit penal**

1. Zbatimi i ligjit penal me analogji nuk lejohet. Nëse norma penale është e paqartë, ajo interpretohet në kuptimin më të favorshëm për të pandehurin.

2. Gjykata interpreton ligjin duke i dhënë kuptim normës penale dhe përmbajtjes së saj brenda qëllimeve dhe parimeve të Kodit Penal.

#### Neni 5

### **Parimet e legjislacionit penal**

1. Kodi Penal ndërtohet mbi parimet e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, mbi parimet e përgjithshme të së drejtës penale ndërkombëtare, mbi marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar dhe legjislacionin e Bashkimit Evropian.

2. Kodi Penal bazohet në barazinë e shtetasve përpara ligjit, drejtësinë në përcaktimin e fajësisë, mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijëve dhe viktimave të veprës penale, humanizmin dhe proporcionalitetin e dënimit penal.

#### Neni 6

### **Qëllimi i legjislacionit penal**

Legjislacioni penal i Republikës së Shqipërisë ka për qëllim të parandalojë kryerjen e veprave penale dhe, të mbrojë pavarësinë e shtetit shqiptar, tërësinë e territorit të tij, rendin kushtetues, dinjitetin e njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, pronën, mjedisin, bashkëjetesën dhe mirëkuptimin e shqiptarëve me pakicat kombëtare dhe bashkëjetesën fetare nga kryerja e tyre.

#### Neni 7

## **Ligji penal dhe zbatimi i tij**

1. Legjislacioni penal material përbëhet nga ky Kod dhe nga ligje të tjera me fuqi të njëjtë që parashikojnë vepra penale.
2. Dispozitat e pjesës së përgjithshme të këtij Kodi zbatohen edhe për veprat e tjera penale të parashikuara si të tilla nga ligje të veçanta.

### **KREU II ZBATIMI I LIGJIT PENAL NË KOHË**

#### **Neni 8**

#### **Koha e kryerjes së veprës penale**

1. Vepra penale vlerësohet e kryer në kohën kur autori ka vepruar ose mbaruar së vepruari dhe, në rastin e mosveprimit, kur duhej të kishte vepruar.
2. Kur vepra penale është e qëndrueshme apo ndikimi i veprimeve të autorit sjell në kohë të mëvonshme pasojën e veprës, vlerësohet si kohë e kryerjes së veprës penale ajo në të cilën janë shfaqur apo vazhdojnë të kenë ndikim pasojat e veprës penale.
3. Në kuptim të ligjit penal vlerësohet si vepër penale e qëndrueshme atëherë kur shkelja e ligjit është e zgjatur në kohë, nuk përfundon në një çast të vetëm si dhe, kur autori kufizon të drejtën e viktimës në mënyrë të pandërprerë duke bërë që pasoja të shfaqet përgjatë gjithë kohës së kryerjes së veprimeve prej tij.

#### **Neni 9**

#### **Veprimi në kohë i ligjit penal**

1. Askush nuk mund të dënohet për një fakt që, sipas ligjit të kohës kur është kryer, nuk përbënte vepër penale, me përjashtim të krimeve që sipas të drejtës ndërkombëtare në kohën e kryerjes së tyre përbënin krime lufte ose krime kundër njerëzimit.
2. Ligji i ri që nuk dënon veprën penale ka fuqi prapavepruese. Procedimi penal i filluar pushon ndërsa, në rast se personi është dënuar, ekzekutimi i dënimit nuk mund të fillojë dhe, në qoftë se ka filluar, pushon.
3. Kur ligji i kohës kur është kryer vepra penale dhe ligji i mëvonshëm janë të ndryshëm, zbatohet ai ligj dispozitat e të cilit janë më të favorshme për personin që ka kryer veprën penale, përveç rasteve kur duhet shmangur gjëja e gjykuar. Çdo kërkesë që referon në përmbajtjen e ndryshme të dispozitave penale apo në masën e llojin e ndryshëm të dënimit penal që ato parashikojnë, kur e drejta lind në fazën e vuajtjes së dënimit, zgjidhet nga gjykata penale e fazës përgjatë ekzekutimit të dënimeve.
4. Fuqia prapavepruese e ligjit penal zbatohet edhe për institute të tjera penale, materiale apo procedurale, përmbajtja dhe natyra e të cilave referojnë drejtpërdrejt në dënimin penal apo lidhen me fillimin e ndjekjes penale, ekzekutimin e dënimit penal, alternativat e dënimit me burgim, si dhe llojin e gjykimit kur kjo ndikon në masën e dënimit penal.
5. Një ligj, i cili ka qenë në fuqi përkohësisht, do të zbatohet për ato vepra penale, të cilat janë kryer gjatë kohës që ai ka qenë në fuqi, përveç rasteve kur vetë ligji parashikon ndryshe.

KREU III  
ZBATIMI I LIGJIT PENAL NË HAPËSIRË

Neni 10

**Zbatimi i ligjit penal në territorin e Republikës së Shqipërisë**

1. Për çdo vepër penale, të kryer pjesërisht ose tërësisht brenda territorit të Republikës së Shqipërisë zbatohet ligji penal i Republikës së Shqipërisë.

2. Ligji Penal i Republikës së Shqipërisë zbatohet në hapësirën tokësore, në gjerësinë e ujërave territoriale dhe të brendshme detare, në hapësirën ajrore që shtrihet mbi hapësirën tokësore dhe të ujërave territoriale dhe të brendshme detare, si dhe në çdo vend tjetër ku shtrihet sovraniteti i shtetit shqiptar, si selitë e përfaqësive diplomatike dhe konsullore shqiptare, anijet që mbajnë flamurin e Republikës së Shqipërisë, anijet e marinës luftarake, të aviacionit ushtarak ose civil kudo që ndodhen.

Neni 11

**Veprat penale të kryera nga shtetasit shqiptarë jashtë territorit**

1. Ligji penal i Republikës së Shqipërisë është i zbatueshëm edhe për shtetasin shqiptar që kryen, sipas ligjit penal shqiptar, një vepër të rëndë penale në territorin e një shteti tjetër, që është njëkohësisht e dënueshme nga legjislacionet e dy vendeve dhe, kur shtetasi shqiptar në kohën e procedimit ndodhet me qëndrim në Republikën e Shqipërisë, qoftë edhe për kohësisht dhe, derisa nuk është dhënë për të një vendim përfundimtar i formës së prerë sipas ligjit të shtetit ku gjendet gjykata e huaj, përveçse kur marrëveshja mes shteteve ka parashikuar ndryshe.

2. Kushti për dënueshmërinë e njëkohshme në territorin e shtetit tjetër nuk zbatohet në rastet e krimeve të korrupsionit në sektorin publik ose privat, ushtrimit të ndikimit të paligjshëm, trafikimit apo shfrytëzimit seksual të çdo lloji të të miturve, dhunës në familje si dhe, pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, piraterisë apo, kryerjes së krimeve shumë të rënda.

3. Në kuptim të këtij neni shtetas shqiptarë janë edhe ata persona që përveç shtetësisë shqiptare gëzojnë edhe shtetësi tjetër.

Neni 12

**Veprat penale të kryera nga shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi jashtë territorit**

1. Ligji penal i Republikës së Shqipërisë është i zbatueshëm edhe për shtetasin e huaj apo pa shtetësi që jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë kryen në dëm të interesave të shtetit ose të shtetasit shqiptar një nga krimet e mëposhtme:

- a) gjenocid ose krime kundër njerëzimit;
- b) krime kundër pavarësisë dhe rendit kushtetues;
- c) vepra me qëllime terroriste;

ç) organizimi i prostitucionit, trafikimi i jashtëligjshëm i njerëzve, fëmijëve dhe grave, prodhimi dhe trafikimi i jashtëligjshëm i armëve, drogës, substancave të tjera narkotike e psikotrope, i substancave bërthamore, i materialeve pornografike, si dhe trafikimi i jashtëligjshëm i veprave të artit dhe i objekteve me vlerë historike, kulturore dhe arkeologjike;

- d) falsifikimi i vulës së shtetit shqiptar, monedhës dhe letrave me vlerë shqiptare;
- dh) krime që cenojnë jetën dhe shëndetin e shtetasit shqiptar, për të cilat ligji parashikon dënim mbi pesë vjet burgim ose çdo lloj dënimi më të rëndë;
- e) pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale;
- ë) krimet e korrupsionit në sektorin publik ose privat, si dhe të ushtrimit të ndikimit të paligjshëm;
- f) vepra penale në fushën e teknologjisë së informacionit apo kibernetikes;
- g) veprat penale kundër mjedisit.

## Neni 13

### **Juridiksioni universal**

1. Ligji penal i Republikës së Shqipërisë është i zbatueshëm edhe për shtetasin e huaj, apo pa shtetësi që ndodhet në territorin e Republikës së Shqipërisë i paekstraduar, apo nuk mund të ekstradohet, i cili jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë ka kryer njërin nga krimet e mëposhtme:

- a) krime kundër njerëzimit;
- b) krime lufte;
- c) gjenocid;
- ç) vepra me qëllime terroriste;
- d) torturë;
- dh) financim terrorizmi;
- e) pastrim të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale;
- ë) krime me natyrë ndërkombëtare, të cilat:
  - i. kryhen në më shumë se një Shtet;
  - ii. kryhen në një Shtet, por pjesa thelbësore e përgatitjes, planit, drejtimit ose kontrollit kryhet në një Shtet tjetër;
  - iii. kryhen në një Shtet, por në të është përfshirë një grup kriminal i organizuar, i cili angazhohet në veprimtari kriminale në më shumë se një Shtet; ose
  - iv. kryhen në një Shtet, por efektet thelbësore i ka në një Shtet tjetër.

2. Ligji penal i Republikës së Shqipërisë është i zbatueshëm edhe për shtetasin e huaj, apo pa shtetësi që jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë kryen ndonjërin nga veprat penale, për të cilat ligje të veçanta ose marrëveshje ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë, përcaktojnë zbatueshmërinë e legjislacionit penal shqiptar.

## Neni 14

### **Veprat penale ndaj personave të mbrojtur ndërkombëtarisht**

1. Dispozitat e këtij Kodi zbatohen edhe për veprat penale të kryera ndaj personave të mbrojtur ndërkombëtarisht.

2. Person i mbrojtur ndërkombëtarisht, përveçse kur marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar parashikojnë ndryshe, është:

- a) kryetari i një shteti, përfshirë edhe anëtarin e organit kolegjial që kryen funksionet e kryetarit të shtetit, sipas kushtetutës së atij shteti, kryetari i qeverisë ose ministri i Punëve të Jashtme, kur këta ndodhen në një shtet tjetër, si dhe anëtarët e familjes që i shoqërojnë;

b) çdo përfaqësues a zyrtar i një shteti ose çdo zyrtar apo agent i një organizate ndërkombëtare me karakter ndërqeveritar, i cili, në kohën dhe vendin e kryerjes së veprës penale kundër tij, zyrës, banesës private ose mjeteve të tij të transportit, gëzon, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, mbrojtje të posaçme nga çdo sulm mbi personin, lirinë dhe dinjitetin e tij, si dhe anëtarët e familjes së tij.

#### Neni 15

### **Veprat penale të kryera nga personat që gëzojnë imunitet**

Përgjegjësia penale për shtetasit e huaj që kryejnë një veprë penale në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe që gëzojnë imunitet në bazë të së drejtës ndërkombëtare, zgjidhet me rrugë diplomatike.

#### Neni 16

### **Fuqia e vendimeve penale të gjykatave të huaja**

1. Vendimet penale të dhëna nga gjykatat e huaja që vërtetojnë kryerjen e një veprë penale në territorin e tyre dhe, të dënueshme edhe sipas legjislacionit penal shqiptar, kur nuk është parashikuar ndryshe nga marrëveshjet dy ose shumëpalëshe, vlejnë në Shqipëri ndaj personave, edhe për:

- a) efekt të cilësimit përsëritës të personit që ka kryer veprën penale;
- b) zbatimin e vendimeve që përmbajnë dënime plotësuese, alternative dhe masave të tjera penale;
- c) zbatimin e masave të sigurimit;
- ç) shlyerjen e dëmit ose efekteve të tjera civile që rrjedhin nga vendimi penal i huaj.

2. Rregullat e përcaktuara në paragrafin e parë të këtij neni, për aq sa janë të zbatueshme, vlejnë edhe për personat juridikë.

#### Neni 17

### **Ekstradimi**

1. Ekstradimi mund të lejohet vetëm kur është parashikuar shprehimisht në marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë.

2. Ekstradimi lejohet kur vepra penale që përbën objektin e kërkesës për ekstradim është parashikuar si e tillë njëkohësisht si nga ligji shqiptar ashtu edhe nga ai i huaj.

3. Ekstradimi nuk lejohet:

a) në qoftë se personi që do të ekstradohet është shtetas shqiptar, veç rasteve kur në marrëveshje është parashikuar ndryshe;

b) në qoftë se vepra penale që përbën objektin e kërkesës për ekstradim ka karakter politik ose ushtarak;

c) kur ka arsye për të dyshuar që personi i kërkuar për t'u ekstraduar do të persekutohet, kërkohet ose dënohet për arsye të bindjeve të tija politike, fetare, kombëtare, gjinore, orientimit seksual, racore ose etnike.

ç) në qoftë se personi që kërkohet të ekstradohet është gjykuar nga një gjykatë kompetente shqiptare për kryerjen e veprës penale për të cilën kërkohet ekstradimi.

TITULLI II  
VEPRA PENALE DHE PËRGJEGJËSIA PENALE

KREU I  
VEPRA PENALE

Neni 18  
**Vepra penale**

1. Vepër penale është çdo veprim apo mosveprim shoqërisht i rrezikshëm i parashikuar nga ligji penal, i kryer me faj dhe që cenon Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të drejtat dhe liritë e shtetasve dhe, objekte të tjera të mbrojtura nga ligji penal ndaj të cilave parashikohen të jepen dënime apo masa të tjera penale të përcaktuara në ligjin penal.

2. Kur vlerësohet se veprimi apo mosveprimi, ndonëse parashikohet si i tillë në ligjin penal, përmban rrezikshmëri të ulët, gjyqtari i seancës paraprake vendos pushimin e procedimit. Marrja e opinionit të viktimës, për vazhdimin ose jo të procedimit, është e detyrueshme.

3. Vlerësohet rrezikshmëri e ulët kur vepra është e parëndësishme për shkak të natyrës ose peshës së saj, mungesës së pasojave ose pranisë minimale të tyre, rrethanave rastësore në të cilat është kryer, rrethanave personale të autorit që e kanë çuar në kryerjen e veprës që shprehin shkallë të ulët të rrezikshmërisë tij ose, kur shpenzimet e procedimit penal kalojnë vlerën e objektit material të dëmtuar.

4. Paragrafi i dytë i këtij neni, nuk zbatohet në rastin e veprave penale të korrupsionit të çfarëdolloji, ndaj përsëritësve në kryerjen e krimeve ose, personave që kanë përfituar më parë nga parashikimet e paragrafëve dy dhe tre të këtij neni.

5. Për qëllim të ligjit penal me termin “viktimë të veprës penale” kuptohet çdo person fizik apo grup i tillë personash të formuar për mbrojtjen e të drejtave themelore, që kanë pësuar lëndime fizike apo shpirtërore, vuajtje emocionale, humbje ekonomike apo çdo cenim thelbësor të të drejtave të tyre, nga kryerja e një vepre penale.

6. Kur është shkaktuar vdekja e një personi nga një vepër penale, viktimë është:

- a) bashkëshorti ose personi që bashkëjeton me viktimën në një shtëpi të përbashkët në mënyrë të vazhdueshme;
- b) i paralinduri apo i paslinduri;
- c) vëllezërit dhe motrat e viktimës;
- ç) i paralinduri apo i paslinduri në vijë të tërthortë;
- d) personi në ngarkim të viktimës nga pikëpamja financiare.

Neni 19  
**Vendi i kryerjes së veprës penale**

1. Vepra penale vlerësohet e kryer në çdo vend ku autori i saj ka vepruar, ose në rastin e mosveprimit, ku duhej të vepronte, ose në atë vend ku pasoja që është element i veprës penale, është shfaqur ose duhej të shfaqej.

2. Krimet në fushën kibernetike apo nëpërmjet çdo komunikimi elektronik, parashikuar në pjesën e posaçme të këtij Kodi, apo në ligje të tjera penale, vlerësohen të kryera në territorin e Republikës

së Shqipërisë nëse janë tentuar apo kryer në dëm të interesave të Shtetit Shqiptar, të një personi fizik me banim apo personi juridik me seli të regjistruar në Republikën e Shqipërisë.

3. Veprimet e bashkëpunëtorëve, pavarësisht prej cilësisë së tyre, realizohen jo vetëm në vendin ku vepra penale është kryer, por në çdo vend ku bashkëpunëtori vepron ose, në rastin e mosveprimit, duhej të vepronte ose atje ku, në përputhje me dashjen e tij, vepra penale duhej të kryhej.

4. Nëse bashkëpunëtori i një vepre të kryer jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë vepron në territorin e brendshëm të saj, ndaj tij zbatohet ligji shqiptar edhe nëse vepra e kryer jashtë parashikohet si vepër penale vetëm nga ligji shqiptar.

#### Neni 20

### **Lidhja shkakësore**

1. Askush nuk mund të dënohet për një vepër penale nëse, ndërmjet veprimit dhe pasojës së dëmshme a të rrezikshme të ardhur ose, kur është shtuar rreziku i ardhjes së tyre, nuk ka lidhje shkakësore, të natyrës së drejtpërdrejtë, të domosdoshme apo të mjaftueshme për të sjellë pasojën.

2. Kushtet shkakësore të drejtperdrejta, të domosdoshme apo të mjaftueshme, vlerësohen nga gjykata për praninë dhe ndikimin e tyre në një vepër penale të kryer edhe kur pasoja vjen për shkaqe të tjera ndërhyrëse, rrethanave ndihmëse rastësore ose, për shkaqe të tjera të pavarura nga veprimi i personit.

#### Neni 21

### **Lidhja shkakësore në mosveprim**

1. Askush nuk mund të mbajë përgjegjësi penale nëse midis mosveprimit dhe pasojës apo mundësisë për ardhjen e saj nuk ka lidhje shkakësore, si kusht i drejtpërdrejtë, i domosdoshëm apo i mjaftueshëm për të sjellë pasojën.

2. Barazohet me kryerjen e veprës penale çdo mospengim i një pasoje, për të cilën subjekti ka përgjegjësinë për të moslejuar ardhjen e saj nëse, përmbushja e veprimit të munguar do të ndalonte ardhjen e pasojës me probabilitet të lartë.

#### Neni 22

### **Burimet e përgjegjësisë për veprim**

1. Vlerësohet vepër penale e kryer me mosveprim kur personi me dashje nuk kryen detyrën e tij për të parandaluar dëmtimin e një interesi të ligjshëm të mbrojtur nga ligji penal, kur ai ka përgjegjësinë të veprojë për shkak të:

- a) përgjegjësisë që rrjedh nga ligji;
- b) përgjegjësisë që rrjedh nga kontrata sipas nenit 25 të këtij Kodi;
- c) përgjegjësive të marra përsipër vullnetarisht apo për shkak të natyrës së veprimtarisë së kryer;
- ç) përgjegjësive prindërore ose të kujdestarisë ndaj fëmijëve të mitur apo të paaftë kur përmbushja e tyre është rezultat i kujdesit të zakonshëm prindëror.

#### Neni 23

### **Përgjegjësitë që rrjedhin nga ligji**

1. Subjektet që i përkasin forcave të policisë, në ushtrimin e detyrave të tyre kanë përgjegjësinë për të penguar vepra penale, përveç rasteve kur pamundësia për të vepruar është objektive.

2. Subjektet që ushtrojnë funksione publike kontrolli mbi sende, veprimtari që lidhen me mbrojtjen e jetës, shëndetit publik, sigurisë publike dhe mbrojtjen e mjedisit, kanë përgjegjësinë për të penguar pasoja vdekjesh, plagosjesh, vepra kundër sigurisë publike apo mjedisit, përveç rasteve kur pamundësia për të vepruar është objektive.

3. Subjektet që, gjatë ushtrimit të profesionit të mjekut apo të një tjetër veprimtarie në fushën e shëndetësisë, kanë marrë përsipër kurimin e dikujt kanë përgjegjësinë për të respektuar veprimet e përcaktuara qartë në protokollet përkatëse të mjekimit të miratuara nga organet kompetente, me qëllim pengimin e pasojave në jetën e shëndetin e pacientit që, me probabilitet shumë të lartë do të shmangeshin nëse detyrimi do të ishte përmbushur, përveç rasteve të pashpresa kur pamundësia e shmangies është objektive.

## Neni 24

### **Baza e përgjegjësisë penale te personit juridik**

1. Personat juridikë kanë përgjegjësinë për të ndërmarrë mënyra organizimi të afta për të penguar kryerjen e veprave penale që lidhen me mosrespektimin e dispozitave në fushën e ushtrimit të veprimtarive të tyre në përputhje me ligjin, për të zbatuar masat apo vendimet e nevojshme për të shmangur ardhjen e pasojave.

2. Organet e personit juridik dhe individët drejtues të saj, në përputhje me kompetencat e tyre, kanë përgjegjësinë e organizimit dhe administrimit të veprimtarisë së shoqërisë në mënyrë të përshtatshme për të siguruar shëndetin dhe jetën e të punësuarve dhe, gjithë të tjerëve të cilët ndikohen nga/apo marrin shërbimet e personit juridik.

3. Këtë përgjegjësi e kanë edhe individët, të cilët edhe pse nuk kanë të drejtën formale për të udhëhequr, drejtojnë de facto personin juridik në mënyrë të vazhdueshme dhe mbizotëruese.

4. Organet drejtuese të personit juridik kanë përgjegjësinë të ndërmarrin të gjitha masat materiale, organizative dhe protokollet e sjelljes që kanë për qëllim ushtrimin e veprimtarisë së tyre në respektim të ligjit, si dhe për të zbuluar dhe shmangur çdo situatë të parregullt apo që mbart rrezik.

5. Me qëllim parandalimin e kryerjes së veprave penale, në përpjesëtim me natyrën dhe madhësinë e personit juridik, llojin e veprimtarisë së zhvilluar, modelet e organizimit duhet të përmbajnë:

a) një ndarje sa më të detajuar të funksioneve dhe kompetencave të organeve të personit juridik, të cilat mundësojnë pasjen e kompetencave teknike dhe të drejta për kontrollin, vlerësimin apo administrimin e situatave të rrezikut;

b) formimin dhe informimin sa më të përshtatshëm të personelit mbi çështjet më të rëndësishme të zbatimit të ligjit gjatë ushtrimit të veprimtarisë së personit juridik;

c) pasjen e një sistemi delegimi të punëve apo kontrolli për zbatimin e modelit të organizimit që garanton vijueshmërinë në kohë të aftësisë të masave të ndërmarra;

ç) rishqyrtimin dhe rishikimin e modelit të organizimit, kur zbulohen shkelje të ligjit penal, ose kur ka pasur ndryshime të natyrës, formës së personit juridik apo të veprimtarisë ekonomike, ose kur ka pasur risi për shkak të arritjeve të shkencës dhe teknikës;

d) pasjen e një sistemi të përshtatshëm disiplinor.

6. Mosmarrja e masave të përmendura në këtë nen përbën bazën e përgjegjësisë penale të personit juridik.

#### Neni 25

### **Përgjegjësitë që rrjedhin nga kontrata**

1. Subjektet që kanë marrë përsipër sipas kontratës detyra specifike për ruajtjen a mbrojtjen e personave të caktuar, apo të sendeve të caktuara, në kuadër të ushtrimit të detyrës së tyre, kanë përgjegjësinë për të penguar vepra penale të kryera nga të tretë në dëm të personit apo të sendit për ruajtjen apo mbrojtjen e të cilit janë të ngarkuar.

2. Subjektet që kanë marrë përsipër sipas kontratës detyra specifike, me çfarëdo lloj titulli, mbi kontrollin e sendeve të rrezikshme, ose burimeve të rrezikshme, kanë përgjegjësinë për të penguar ardhjen e pasojave të dëmshme apo të rrezikshme për jetën apo tërësinë e shëndetit, apo të ngjarjeve që përbëjnë vepra penale kundër sigurisë publike apo kundër mjedisit.

#### Neni 26

### **Përgjegjësitë për shkak të natyrës së veprimtarisë apo vullnetarizmit**

1. Subjektet që, në veprimtari sportive, edukative, shkollore kanë marrë përsipër në kuadër të ushtrimit të detyrës apo, sipas natyrës së aktivitetit, detyrën e udhërrëfyesit, apo të mbikëqyrësit, kanë përgjegjësinë për të penguar veprime që cenojnë jetën, shëndetin apo integritetin psikik të personit të cilin kanë marrë në ngarkim, apo pasoja që këta persona mund t'u sjellin të tretëve.

2. Ky detyrim rëndon mbi personat përgjegjës pavarësisht nëse detyra është marrë përsipër vullnetarisht apo kryhet prej tyre në mënyrë të përhershme.

#### Neni 27

### **Përgjegjësitë prindërore apo të kujdestarisë**

1. Prindërit që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore për të miturit kanë përgjegjësinë ligjore për të penguar çdo veprim që cenon jetën, integritetin fizik dhe psikik, lirinë personale, si dhe paprekshmërinë seksuale të të miturit.

2. Personat që kanë marrë përsipër sipas ligjit ose kontratës rolin e kujdestarit të të miturit, të një personi të paaftë, apo të një personi të moshuar, qoftë edhe përkohësisht, kanë përgjegjësinë për të penguar çdo veprim të përmendur në paragrafin e parë të këtij neni.

#### Neni 28

### **Tentativa**

1. Personi tenton të kryejë krim kur ai me dashje ndërmerr hapa të drejtpërdrejtë, të mjaftueshëm apo të domosdoshëm, të aftë të çojnë me siguri në kryerjen e krimit të synuar, por që nuk kryhet për rrethana të pavarura nga vullneti i tij.

2. Kur autori kërkon të kryejë krimin me mosveprim, tentativa do të qëndrojë, me cilësitë e përmendura në paragrafin e parë të këtij neni, vetëm kur mosveprimi është rezultat i paramendimit për të arritur pasojën e veprës penale.

3. Vlerësohen, jo në mënyrë shteruese, veprime të drejtpërdrejta, të mjaftueshme apo të domosdoshme, që çojnë drejt përfundimit të kryerjes së krimit:

- a) ato që përbëjnë elemente thelbësore të llojit të krimit që do të kryhet;
- b) ato që janë të përshtatshme për të prodhuar një rezultat të qartë të dëshiruar;
- c) ato veprime thelbësore të shfaqura pa asnjë dyshim që synojnë cenimin e shpejtë të objektit të dëshiruar.

#### Neni 29

### **Tentativa e pamundur**

1. Tentativa është e padënueshme penalisht nëse personi kërkon të kryejë krimin duke përdorur mjete shkencërisht të papërshtatshme për të sjellë pasojë kriminale ndaj objektit konkret, apo i drejtohet një objekti material të munguar, apo të pamundur për t'u cenuar për shkak të veprimit të tij, veçse kur, sipas rrethanave të rastit, ekziston edhe një probabilitet minimal për ardhjen e pasojës.

2. Në rastin kur vëren probabilitetin edhe minimal për ardhjen e pasojës, gjykata, në varësi të seriozitetit të faktit, mund të japë një nga masat alternative të dënimit deri te zbatimi i rregullave të nenit 30 të këtij Kodi.

#### Neni 30

### **Përgjegjësia për tentativën**

1. Personi që tenton të kryejë një krim, përgjigjet për të sikur pasoja e veprës të ketë ardhur nëse tentativa është e plotë dhe autori i saj ka përdorur çdo mundësi për të realizuar krimin duke shfaqur rrezikshmëri të plotë të tij.

2. Gjkata, në varësi të shkallës së afërsisë së pasojës, shkaqeve për të cilat krimi mbeti në tentativë, kur vëren se nuk jemi përpara kushteve të përcaktuara në paragrafin e parë të këtij neni, zbut dënimin në interpretim të rregullave të caktuara në paragrafët më poshtë të këtij neni, përveç rasteve kur pjesa e posaçme e këtij Kodi parashikon ndryshe.

3. Në rastet kur krimi i mbetur në tentativë, për të cilin dispozita përkatëse e pjesës së posaçme të Kodit Penal parashikon dënim jo më të lartë se dhjetë vjet burgim, në analizë të kushteve të shënuara në paragrafin dy të këtij neni, gjykata cakton jo më shumë se sa një të tretën e dënimit maksimal të parashikuar në dispozitë.

4. Në rastet kur krimi dënohet nga dhjetë vjet deri në tridhjetë vjet në maksimumin e tij në analizë të kushteve të shënuara në paragrafin e dytë të këtij neni, gjykata cakton nga një e treta deri në një të dytën e dënimit maksimal të parashikuar në dispozitë.

5. Në rastet kur krimi dënohet edhe me burgim të përjetshëm, në analizë të kushteve të shënuara në paragrafin e dytë të këtij neni, gjykata cakton jo më pak se njëzet vjet burgim.

6. Gjkata, në varësi të shkallës së afërsisë së pasojës dhe shkaqeve për të cilat krimi mbeti në tentativë, mund të ulë dënimin nën minimumin e parashikuar nga ligji, por jo në rastet kur krimi i tentuar të kryhet është krim i shumë i rëndë.

7. Dhënia e dënimeve plotësuese nga gjykata, nuk ndikohet nga mbetja në tentativë e veprës penale.

#### Neni 31

## **Heqja dorë nga kryerja e veprës penale**

1. Personi që me vullnetin e tij heq dorë në mënyrë përfundimtare nga kryerja e veprës penale, megjithë mundësitë që ka për kryerjen e saj, nuk ka përgjegjësi penale.
2. Kur veprimet e gjeratëhershme përmbajnë elementet e ndonjë vepre tjetër penale, personi përgjigjet për të.
3. Vlerësohet heqje dorë në kuptim të paragrafit të parë të këtij neni edhe rasti kur personi ka kryer veprimet e plota për kryerjen e një vepre të lehtë penale që ka filluar të sjellë pasojën e saj, por ai me vullnet të qartë shmang menjëherë apo nuk lejon ardhjen e plotë të pasojës që do të rrezikonte të sillte veprimi i tij, si dhe kallëzon pa vonesë veprën e kryer në organet e rendit publik.

## **KREU II PËRGJEGJËSIA PENALE**

### **Neni 32**

#### **Mosha për përgjegjësi penale**

1. Ka përgjegjësi penale personi që ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç në kohën e kryerjes së një krimi apo ka mbushur moshën gjashtëmëdhjetë vjeç në kohën e kryerjes së një kundërvajtje penale.
2. Për personat e moshës 14-16 vjeç që kryejnë krim, gjykata duhet të vlerësojë nivelin e dashjes së të miturit bazuar në aftësinë e tij për të kuptuar rëndësinë e faktit dhe pasojën e veprës, në mënyrë që të arrijë bindjen jashtë çdo dyshimi rreth pjekurisë përkundër faktit të kryer dhe fajësisë së tij. Në rast dyshimi, krimi vlerësohet i kryer me pakujdesi ose, kur i mituri përbën rrezik për veten gjykata mund të zbatojë urdhërimet e paragrafit të katërt të këtij neni.
3. Personi madhor i ri i grupmoshës nga 18 deri në 21 vjeç, nëse ka kryer vepër penale përgjatë periudhës kohore nga 18 deri në 21 vjeç, trajtohet si i mitur kur parashikohet në dispozitat e këtij Kodi, pavarësisht nga koha e fillimit të procedimit penal ndaj tij.
4. I mituri i grupmoshës 12 deri në 14 vjeç që kryen një krim nuk ka përgjegjësi penale, por nëse përbën rrezik për veten apo për shoqërinë, i nënshtrohet zbatimit të masave edukuese, dhe nëse rezulton i paaftë mendërisht për të kuptuar veprimet e tij, i nënshtrohet masave mjekësore të përcaktuara në dispozitat e këtij Kodi.

### **Neni 33**

#### **Faji**

1. Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose mosveprim të parashikuar nga ligji si vepër penale, në qoftë se nuk është kryer me faj.
2. Askush nuk mund të dënohet për kryerjen e një krimi nëse nuk është kryer me dashje apo me pakujdesi.
3. Askush nuk mund të dënohet për kryerjen e një kundërvajtje penale nëse nuk është kryer me dashje.
4. Gjukata në çdo rast përcakton llojin dhe shkallën e fajit të shfaqur në kryerjen e një vepre penale pas shqyrtimit të rrethanave të faktit, provave dhe sjelljes së autorit të saj. Në rastin e

pakujdesisë, gjykata merr parasysh edhe natyrën e detyrave ose funksioneve të autorit, aftësitë e tij si dhe kompetencat dhe mjetet që ka në dispozicion për të kryer detyrën.

#### Neni 34

##### **Dashja**

1. Vepra penale kryhet me dashje, kur personi e parashikon pasojën e veprës, synon me vullnet ardhjen e saj ose, megjithëse e parashikon, nuk e synon atë, por e lejon ardhjen e saj.
2. Vepra penale mund të kryhet me dashje direkte ose indirekte.

#### Neni 35

##### **Dashja direkte**

Vepra penale kryhet me dashje direkte, si rrjedhojë e veprimit ose e mosveprimit, kur autori i saj, parashikon pasojën e faktit konkret që përbën vepër penale, vendos të sjellë pasojën e saj, ose synon me vullnet të kryeje atë, apo, kur është rasti, ndikohet edhe nga motive si shtysa të brendshme për kryerjen e saj.

#### Neni 36

##### **Dashja indirekte**

Vepra penale kryhet me dashje indirekte kur personi ka parashikuar ardhjen e pasojës si rrjedhojë e veprimit apo mosveprimit të tij dhe, pavarësisht se nuk e synon atë, me vullnet të ndërgjegjshëm e lejon ardhjen e saj.

#### Neni 37

##### **Pakujdesia**

1. Vepra penale mund të kryhet me pakujdesi të vetëdijshme ose të pavetëdijshme.
2. Vepra penale kryhet me pakujdesi të vetëdijshme kur personi megjithëse nuk i dëshiron pasojat që mund të vijnë si rezultat i veprimeve ose mosveprimeve të tij, është i vetëdijshëm për mundësinë e ardhjes së tyre dhe, me mendjelehtësi mendon se ajo nuk do të vijë apo se ai do të mund të parandalojë ardhjen e saj. Fakti që përbën vepër penale në këtë rast ndodh për shkak të vetëbesimit të tepruar, mungesës së aftësive profesionale apo për shkak të mosrespektimit të rregullave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.
3. Personi vepron me pakujdesi të pavetëdijshme kur nuk është i vetëdijshëm për mundësinë e ardhjes së pasojave që mund të vijnë si rezultat i veprimit ose mosveprimit të tij edhe pse në rrethanat dhe sipas cilësive apo aftësive të tij personale mund apo duhej të ishte i vetëdijshëm për mundësinë e ardhjes së tyre.

#### Neni 38

##### **Gabimi në fakt**

1. Personi që, në mënyrë pashmangshmërisht të ndershme e të arsyeshme gabon në ligjshmërinë e veprimit të kryer, nuk mban përgjegjësi penale.

2. Cilido që kryen një vepër penale duke menduar gabimisht se është duke kryer një vepër penale më të lehtë, do të mbajë përgjegjësi për veprën që ka kryer dhe, kur ka kryer një vepër penale më të lehtë se ajo që ka menduar të kryejë, do të përgjigjet për veprën që ka kryer.

Neni 39

### **Mosnjohja e ligjit**

Mosnjohja e ligjit që dënon veprën penale, nuk përbën shkak për përjashtim nga përgjegjësia penale, veç rasteve kur mosnjohja e ndershme dhe e arsyeshme, është objektivisht e pashmangshme.

Neni 40

### **Papërgjegjshmëria për shkak të gjendjes mendore**

1. Personi i paaftë mendërisht, i cili në momentin e kryerjes së veprës penale vuante nga një sëmundje mendore e përhershme ose e përkohshme apo, nëse vuante nga një çrregullim apo, nivel i ulët në zhvillimin mendor, nuk është i përgjegjshëm penalisht nëse kjo gjendje ka prishur tërësisht ekuilibrin dhe funksionimin e rregullt mendor të tij dhe, si pasojë e këtij ndikimi, ai nuk ka qenë i aftë të kuptojë natyrën, rëndësinë apo pasojën e veprimeve ose mosveprimeve dhe, nuk ka qenë në gjendje t'i kontrollojë veprimet ose mosveprimet e tij, apo të kuptojë se po kryen vepër penale.

2. Do të vlerësohet i paaftë mendërisht çdo person që në kohën e kryerjes së veprës penale vuan nga një sëmundje mendore, çrregullim mendor i përkohshëm, paaftësi intelektive ose çdo turbullimi tjetër mendor i një shkalle të rëndë.

3. Personi me aftësi të ulët mendore që, në kohën e kryerjes së veprës penale vuante nga një çrregullim mendor apo psikik që ka ulur ekuilibrin dhe funksionimin e rregullt mendor të tij për të kuptuar dhe kontrolluar plotësisht veprimet apo mosveprimet e tij, dhe si pasojë e këtij ndikimi, ka pasur aftësi të pjesshme për të qenë në gjendje të kuptojë natyrën, rëndësinë apo pasojën e veprimeve ose mosveprimeve të tij, është i përgjegjshëm penalisht.

4. Gjykata, në rastet e papërgjegjshmërisë së personit, zbaton masat mjekësore të përshtatshme për rastin, parashikuar në nenin 114 të këtij Kodi.

5. Gjykata, në rastet e përgjegjshmërisë së përmendur në paragrafin e tretë të këtij neni, mund të ulë masën e dënimit të caktuar nga një e treta deri në një të dytën e tij. Në varësi të shkallës dhe llojit të sëmundjes, çrregullimit, paaftësisë intelektive ose çdo turbullimi tjetër, gjykata vendos që personi të marrë trajtimin terapeutik të nevojshëm për shërimin e tij, sipas natyrës së dënimit plotësues të parashikuar në nenin 92 të këtij Kodi.

Neni 41

### **Kryerja e veprës penale në gjendje të dehur dhe intoksikimi**

1. Nuk përjashtohet nga përgjegjësia personi që ka kryer veprën në gjendje të dehur për shkak të konsumimit të pijeve alkoolike, veç rasti kur ajo ka shkaktuar gjendjen e parashikuar në paragrafin e parë të nenit 40 të këtij Kodi.

2. Kur dehja është shkaktuar në rrethana të rasti dhe ka sjellë uljen e ekuilibrit mendor, kjo rrethanë mbahet parasysh për zbutjen e dënimit.

3. Kur dehja është bërë me paramendim për të kryer veprën penale, kjo rrethanë mbahet parasysht për rëndimin e dënimit.

4. Parashikimet e mësipërme zbatohen edhe kur vepra penale kryhet në gjendje intoksikimi për shkak të konsumimit të drogave toksike, narkotikëve, substancave psikotrope ose të tjera që shkaktojnë efekte të ngjashme ose nën ndikimin e një sindromi të abstinencës për shkak të varësisë nga substanca të tilla, e cila e pengon personin të kuptojë natyrën, rëndësinë e veprimeve apo mosveprimeve të tij dhe të pasojave përkatëse si dhe të kontrollojë veprimet apo mosveprimet e tij.

5. Në çdo rast, kur vepra penale është kryer nën gjendjen e dehjes ose intoksikimit me lëndë narkotike e psikotrope, gjykata vendos masën e dënimit plotësues të detyrimit për të marrë pjesë në seanca terapeutike sipas nenit 92 të këtij Kodi.

6. Kur gjendja e dehjes ose e intoksimit është provokuar nga një i tretë, pa vullnetin dhe vetëdijen e autorit, me qëllim që autori të kryejë veprën penale dhe, ka prishur tërësisht ekuilibrin dhe funksionet e rregullta mendore, për veprën penale të kryer do të përgjigjet penalisht personi që e ka provokuar dehjen apo intoksikimin.

#### Neni 42

#### **Shtrëngimi fizik**

1. Nuk ka përgjegjësi penale personi që ka kryer veprën duke qenë i shtrënguar, drejtpërdrejtë apo në mënyrë rrethore, nga një person tjetër nëpërmjet dhunës fizike ose kanosjes serioze, natyra, shkalla e brutalitetit dhe intensitetit të së cilës nuk ka qenë e mundur të përballohet apo, në çdo rast nuk ka mundur t'i shmangej apo, të referohej për shmangie dhe mbrojtje në organet e rendit, përveç rastit kur personi shtrëngohet të kryejë një vrasje.

2. Nuk do të ketë përgjegjësi penale personi edhe kur shtrëngimi në cilësinë e përcaktuar në paragrafin e parë të këtij neni ka qenë i drejtuar ndaj anëtarëve të familjes së tij.

3. Në rastet e përmendura më lart, për veprën e kryer përgjigjet penalisht personi që ka përdorur dhunën.

4. Nuk do të vlerësohet si shtrëngim në kuptim të këtij neni, nëse personi detyrohet të kryejë një vepër penale ngaqë i janë krijuar rrethana frikësuese për të sepse shfrytëzojnë dobësinë për shkak të materialit të përdorur nën kërcënimin se ato do të bëhen publike dhe dëmtojnë rëndë interesat, nderin dhe reputacionin tij apo të një të afërmi të familjes.

#### Neni 43

#### **Dhënia e pëlqimit nga titullari i së drejtës**

1. Nuk ka përgjegjësi penale personi i cili me sjelljen e tij cenon apo vendos në rrezik jetën, shëndetin apo një të drejtë të disponueshme të viktimës, me pëlqimin e këtij të fundit, dhënë me vullnetin e tij të lirë dhe me aftësinë e plotë për të kuptuar e vlerësuar pasojat e pëlqimit.

2. Rregullat që lidhen me cenimin e jetës së viktimës me pëlqimin e tij, rregullohen me ligj të veçantë. Deri në miratimin e ligjit të veçantë, por jo më vonë se sa një vit nga miratimi i Kodit Penal, paragrafi i parë i këtij neni nuk ka efekt në rastin e cenimit të jetës së viktimës.

#### Neni 44

## **Ushtrimi i një të drejte ose përmbushja e një detyre**

1. Nuk ka përgjegjësi penale personi që ka kryer një veprim të parashikuar ose të lejuar nga një normë ligjore.
2. Nuk ka përgjegjësi penale personi që ka kryer një veprim në bazë të një urdhri të ligjshëm të dhënë nga autoriteti kompetent pranë të cilit ai shërben.
3. Nëse fakti që përbën vepër penale është kryer në bazë të një urdhri, përgjegjës për veprën penale është gjithnjë zyrtari publik që ka dhënë urdhrin.
4. Personi që ka zbatuar urdhrin është gjithashtu përgjegjës për veprën penale, me përjashtim të rastit kur për shkak të lajthitjes në fakt, ka vlerësuar ndershmërisht arsyeshëm se po i bindet një urdhri të ligjshëm.
5. Kushdo që zbaton një urdhër të paligjshëm, nuk dënohet kur vetë ligji nuk i lejon asnjë mundësi kontrolli apo shfuqizimi mbi ligjshmërinë e urdhrin.

### Neni 45

#### **Mbrojtja e nevojshme**

1. Nuk ka përgjegjësi penale personi që kryen faktin që përbën vepër penale, duke qenë i detyruar të veprojë për të mbrojtur jetën, shëndetin, të drejtat e tij ose të një tjetri, nga rrezik aktual i një sulmi të padrejtë, të vërtetë, të çastit dhe të pandërprerë, me kusht që, mbrojtja të jetë në përpjesëtim me rrezikshmërinë e sulmit.
2. Reagimi proporcional mbrojtës ndaj hyrjes së paligjshme natën në shtëpinë e personit me dhunë, thyerje apo mashtrim, vlerësohet si mbrojtje e nevojshme.
3. Nëse personi i sulmuar ka mundësi konkrete, lehtësisht të përdorshme, për t'iu shmangur rrezikut duke u tërhequr pa pësuar ndonjë pasojë, ai duhet të shmangë reagimin mbrojtës.
4. Për vlerësimin e përpjesëtueshmërisë së mbrojtjes me sulmin duhet të mbahen parasysh të drejtat që ndodhen në konflikt, mjetet që ka në dispozicion personi që mbrohet, kushtet dhe mënyrën konkrete të sulmit.
5. Nuk është në kushtet e mbrojtjes së nevojshme personi që ka provokuar gjendjen e sulmit.  
Në kuptim të ligjit penal me provokim do të kuptohet kryerja e një apo disa veprimeve apo sjelljeve nga ana e viktimës të afta për të shkaktuar reagim të menjëhershëm, të pamenduar më parë dhe të kuptueshëm prej personit.
6. Mospërputhja haptazi e mbrojtjes me shkallën e rrezikshmërisë së sulmit, pasojave të tij, apo mjeteve të përdorura, përbën kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme.

### Neni 46

#### **Nevoja ekstreme**

1. Nuk ka përgjegjësi penale personi që ka kryer veprën nga nevoja për të përballuar një rrezik real dhe të çastit që e kërcënon atë, jetën apo shëndetin e një personi tjetër apo, pasurinë e tij apo të një tjetri nga një dëmtim i rëndë, i pashmangshëm me mënyra të tjera apo që mund të shmanget kohë më pas, me kusht që të mos jetë i provokuar prej tij dhe, dëmi i shkaktuar të mos jetë më i madh së dëmi i zmbrazur.

2. Për dëmin e shkaktuar përtej dëmit të zbrapsur, personi do të përgjigjet për veprën penale të kryer nga pakujdesia.

3. Paragrafi i parë i këtij neni, nuk zbatohet ndaj personave në detyrë të ngarkuar të kryejnë veprimtari për shmangien apo përballimin e rrezikut.

4. Vlerësohet se është në kushtet e paragrafit të parë të këtij neni edhe personeli shëndetësor kur, sipas ligjit duhet t'i japë trajtim mjekësor një personi që nuk është i vetëdijshëm për të dhënë pëlqimin për trajtim, ose nuk është i aftë për të arsyetuar, ose kur një anëtar i ngushtë i familjes ose përfaqësuesi i tij ligjor nuk gjendet për të dhënë pëlqimin dhe, kur shtyrja e trajtimit ose ndërhyrjes me probabilitet të lartë do të rrezikonte jetën e personit ose do të shkaktonte një përkeqësim të rëndë të shëndetit të tij.

#### Neni 47

### **Përdorimi i ligjshëm i armëve të zjarrit**

1. Personi që përdor ose urdhëron përdorimin e armëve ose të mjeteve të tjera të përdorimit të forcës, duke qenë i detyruar nga nevoja për të përmbushur detyrën sipas ligjit, nuk ka përgjegjësi penale. Rastet dhe mënyra e përdorimit të armëve të zjarrit dhe mjeteve të tjera të përdorimit të forcës miratohen me ligj të veçantë me fuqi të njëjtë.

2. Ky parashikim zbatohet edhe për çdo person i cili ndihmon zyrtarin publik, pas kërkesës së ligjshme që i ka bërë ky i fundit.

#### Neni 48

### **Raportimi i sinjalizuesit**

Nuk ka përgjegjësi penale personi, që në përputhje me parashikimet e bëra në ligjin “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” plotëson kriteret për të qenë sinjalizues, kur cenon një sekret të mbrojtur me ligj me kusht që, ky zbulim të jetë i nevojshëm, në përpjesëtim me mbrojtjen e interesave që përfshihen në qëllimin e ligjit dhe, i kryer në përputhje me format dhe përmbajtjen e ligjit të sinjalizimit. Nëse për të siguruar informacionin në funksion të shërbimit të sinjalizuesit, personi kryen një vepër penale, ai mban përgjegjësi për të.

## KREU III

### BASHKËPUNIMI DHE PERSONAT JURIDIKË

#### SEKSIONI I

### BASHKËPUNIMI

#### Neni 49

### **Bashkëpunimi**

1. Bashkëpunim quhet kryerja e veprës penale nga dy ose më shumë persona me marrëveshje ndërmjet tyre.

2. Në kuptim të ligjit penal, me marrëveshje do të kuptohet çfarëdolloj bashkimi forcash për të arritur apo tentuar një rezultat kriminal, pavarësisht rolit apo mënyrës së kryerjes së detyrave të bashkëpunëtorëve apo, aftësive të përgjithshme të tyre për të kontribuar në kryerjen e veprës penale. Bashkëpunim kemi edhe për personin kur ai i vetëm ka dijeni për përputhjen e qëllimeve të tij me ekzekutorin që kryen veprën dhe, kontribuon fshehtas duke shfrytëzuar veprimet e ekzekutorit për të realizuar qëllimin e tij.

3. Personi, që është përdorur pa dijeninë e tij se po kryhen një veprë penale, pavarësisht kontributit që ka dhënë në kryerjen e saj, vlerësohet si ndërmjetës i pafajshëm. Personi që e ka përdorur atë do të përgjigjet për kryerjen në bashkëpunim të veprës penale apo tentativën e kryerjes së saj.

4. Të gjithë bashkëpunëtorët do të kenë përgjegjësi për të njëjtën veprë edhe në rastin kur ajo është tentuar të kryhet apo, kur marrëveshja parashikohet më vete si veprë penale nga pjesa e posaçme e Kodit Penal.

## Neni 50

### **Llojet e bashkëpunëtorëve**

1. Bashkëpunëtorë për kryerjen e veprës penale quhen: organizatorët, nxitësit, ekzekutorët, përkrahësit, inkurajuesit, provokuesit dhe bashkëpunëtorët e jashtëm.

2. Organizator është personi që ideon, organizon dhe drejton veprimtarinë për kryerjen e veprës penale, në mënyrë tipike në krimet që ky Kod parashikon format e veçanta të bashkëpunimit, por pa u kufizuar në to.

3. Nxitës është personi që shtyn, tërheq, jep ide, provokon qëllimisht motiv apo rrethana për kryerjen e veprës penale nëpërmjet pagesës, dhuratave, premtimeve, shpërdorimit të autoritetit, dhunës, kërcënimeve, mashtrimit, gënjeshtërisë apo dizinformimit.

4. Ekzekutor është personi që kryen veprime të drejtpërdrejta për realizimin e veprës penale.

5. Përkrahësi, ose ndihmësi, quhet personi që me këshilla, udhëzime, dhënie mjatesh, largim të pengesave, dhënie të premtimit për fshehjen e bashkëpunëtorëve, të gjurmëve apo të sendeve që rrjedhin nga vepra penale, ndihmon për kryerjen e veprës penale. Barazohet me të edhe personi që nuk vepron me dashje kur ligji ua kërkon të ushtrojë autoritetin e tij për të ndaluar kryerjen e veprës penale, ose ai që me dashje jep informacion të vlefshëm dhe që shërben për kryerjen e veprës penale. Përkrahësi është inkurajues i kryerjes së veprës penale kur u jep mbështetje, siguri dhe besim veprimeve të bashkëpunëtorëve të tjerë që të vazhdojnë të kryejnë veprën penale të nisur, e ndihmon apo stimulon me të gjitha mënyrat përfundimin e saj.

6. Provokatori është personi që, nëpërmjet gënjeshtërisë apo dezinformimit të çdo lloji, përmes nxitjes së drejtpërdrejtë, çdolloj kontakti, të hapur ose të tërthortë, afrohet edhe publikisht të krijojë motivin apo rrethana të atilla që qartazi nxisin kryerjen e një krimi.

7. Bashkëpunëtor i jashtëm do të quhet personi që në mënyrë të pjesshme merr pjesë në kryerjen e veprës penale, në njërin prej roleve anësore të bashkëpunëtorëve më lart, për shkak të cilësive të veçanta që ka, profesionit apo njohurisë rreth mekanizmit të kryerjes së veprës. Përkohshmëria në ushtrimin e rolit e përjashton atë nga formimi apo pjesëmarrja në bashkëpunimin e veçantë, njohjes së qëllimeve të përgjithshme të bashkëpunëtorëve, njohjes së anëtarësisë apo vazhdimësinë në veprimtarinë e bashkëpunimit të veçantë, përndryshe vlerësohet si bashkëpunëtor i zakonshëm i strukturës së posaçme të bashkëpunimit. Në mënyrë tipike ai bashkëpunon në rastin e kryerjes së krimeve nga format e posaçme të bashkëpunimit.

## Neni 51

### **Përgjegjësia e bashkëpunëtorëve**

1. Të gjithë bashkëpunëtorët kanë përgjegjësi si edhe ekzekutorët për veprën penale të kryer prej tyre, përveçse kur ekzekutori i saj është në gjendjen e eksedit.

2. Për qëllim të këtij ligji do të kemi akses të ekzekutorit kur autori i kryerjes së veprës penale e ka kryer atë duke dalë qartazi përtej sa ka detajuar të kryejë së bashku në marrëveshjen me bashkëpunëtorët dhe, kur parashikueshmëria e kryerjes së veprës akses ka qenë krejtësisht e pamundur prej bashkëpunëtorëve të tjerë.

3. Në caktimin e dënimit për bashkëpunëtorët, gjykata duhet të mbajë parasysh rolin parësor ose dytësor të tyre në kryerjen e veprës penale, shkallën e pjesëmarrjes së secilit, aftësitë e bashkëpunëtorëve për të kontribuar në kryerjen e një vepre të veçantë, mënyrën dhe shkallën e organizimit, lidhjen e tyre, strukturën e bashkimit, qëndrimin ndaj pasojave të veprës, vazhdimësinë dhe rolin e luajtur në kryerjen e veprës penale.

## Neni 52

### **Përgjegjësia e organizatorit**

1. Për shkak të kontributit të organizatorit të kryerjes së veprës penale, prej lindjes së idesë për kryerjen e saj, përpunimit të planit, tërheqjes së bashkëpunëtorëve të tjerë, bindjes së tyre për nevojën dhe të mirat që priten nga kryerja e veprës, ndarjes së roleve për secilin prej tyre në përputhje me nevojën e kryerjes së veprës penale, planifikimit të ndarjes së fitimeve dhe, kur është rasti, mënyra e investimit të të ardhurave në veprimtarinë e mëpastajme, gjykata përcakton rolin parësor të tij ndër bashkëpunëtorët e tjerë.

2. Për qëllim të kësaj dispozite, vlerësohet organizator me të gjitha cilësitë edhe personi që vetëm financon kryerjen e veprës duke ditur qartësisht kompleksitetin e saj, nevojën e tërheqjes së shumë personave në kryerjen e veprës, ndarjen e nevojshme të roleve të tyre dhe që, qoftë edhe nëse vetëm sa përfiton të ardhura nga kryerja e veprës penale.

3. Vlerësohet organizator edhe nxitësi kur shfrytëzon fshehtëzi qëllimet e ekzekutorit, pa dijeninë e këtij të fundit, i jep ndihmë të çfarëdoshme atij, pa të cilën vepra penale nuk do të mund të realizohej.

4. Gjikata, pas identifikimit të rolit të organizatorit si parësor, cakton për të një masë dënimi më të lartë sesa për bashkëpunëtorët e tjerë.

## Neni 53

### **Përgjegjësia e nxitësit**

1. Për shkak të kontributit të nxitësit të kryerjes së veprës penale, prej dhënies së idesë për kryerjen e saj, motivit, interesit, tërheqjes së bashkëpunëtorëve të tjerë gjykata përcakton rolin e nxitësit si parësor në kryerjen e veprës penale, përgjithësisht nëse vepra është kryer, por jo domosdoshmërisht e kufizuar atje, nga autorë në bashkëpunim të thjeshtë.

2. Për qëllim të kësaj dispozite, nxitësi, jo anëtar i strukturës së bashkëpunimit të posaçëm, që për interes apo çdo përfitim tjetër, vë në lëvizje të veprojë për të kryer një krim, një strukturë që përkufizohet nga ky Kod si strukturë e bashkëpunimit të veçantë, vlerësohet organizator në

kryerjen e krimit që ka nxitur edhe pse vetëm sa ka financuar kryerjen e tij, me kushtin që të dijë kompleksitetin e krimit të nxitur si dhe, aftësinë e subjektit që i është drejtuar për të realizuar porosinë e tij.

3. Nxitësi që përdor si mjet, ose shtyn për të kryer një veprë penale një person tjetër që nuk mund të merret i pandehur ose nuk mund të dënohet për çfarëdolloj shkak ligjor, ose për shkak të varësisë dhe kontrollit që ka mbi të, vlerësohet në rolin e organizatorit të kryerjes së veprës penale në bashkëpunim dhe, do të individualizohet i tillë nga gjykata në caktimin e dënimit duke dhënë jo më pak se sa  $\frac{3}{4}$  e dënimit të parashikuar nga dispozita për veprën e kryer.

4. Në rast se nxitësi që sipas paragrafit të tretë të këtij neni, ka përdorur një person tjetër të papërgjegjshëm penalisht, për kryerjen e veprës penale, është prindi ose kujdestari i tij, dënimi i caktuar në atë paragraf shtohet deri në gjysmën e tij ose, nëse janë kryer krime për të cilët parashikohet ne minimum pesë vjet burgim, dënimit të caktuar për prindin i shtohet nga një e treta deri në dy të tretat, pavarësisht maksimumit të dënimit të parashikuar nga dispozita përkatëse, por gjithmonë jo më shumë se sa mbledhja aritmetike e maksimumit të dënimit të parashikuar për krimin e kryer dhe gjysmës së shtuar të atij dënimi.

5. Gjykata, pas identifikimit të rolit të nxitësit si parësor, në varësi të natyrës së nxitjes, llojit të bashkëpunimit dhe varësisë së kryerjes së krimit prej ndikimit të nxitësit, cakton për të një masë dënimi të lartë si për bashkëpunëtorët e tjerë parësorë.

#### Neni 54

### **Përgjegjësia e ekzekutorit**

1. Për shkak të kryerjes së veprës penale, aftësive të kërkuara për kryerjen e saj, në varësi të llojit të bashkëpunimit, numrit të personave që marrin pjesë në të, nivelit të organizimit të tyre, vështirësisë së kryerjes së veprës, për rrjedhojë edhe rrezikshmërisë së grupit të formuar të bashkëpunëtorëve, kur të gjitha elementet së bashku, nuk nxjerrin epërsinë e organizatorit apo nxitësit në kryerjen e veprës, atëherë gjykata përcakton rolin e ekzekutorit si parësor.

2. Në rastet kur, kryerja e veprës penale është pjese e veprimtarisë së grupeve të strukturuar kriminale, gjykata përcakton rolin e ekzekutorit në të njëjtën shkallë rrezikshmërie siç edhe atë të organizatorit të kryerjes së veprës penale.

3. Në individualizimin e dënimit për ekzekutorin gjykata merr parasysh edhe mënyrën e kryerjes së veprës penale prej tij, aftësinë për arritjen e qëllimit apo vazhdimësinë në kryerjen e veprave penale në këtë rol.

4. Në rastin kur bashkohen në të njëjtin person të paktën dy prej cilësive të bashkëpunëtorit parësor, gjykata e vlerëson si rrethanë rënduese dhe, në vlerësim të neneve 140 e 141 të këtij Kodi, jep dënim jo më të vogël se  $\frac{3}{4}$  e dënimit maksimal që parashikon dispozita për veprën e kryer.

#### Neni 55

### **Ndihmësi, përkrahësi dhe inkurajuesi**

1. Ndihmësi, përkrahësi dhe inkurajuesi janë bashkëpunëtorë në kryerjen e veprës penale dhe, do të përgjigjen për veprën e kryer në përputhje me rolin e caktuar dhe kontributin në njërin prej mënyrave të përcaktuara në nenin 50 të këtij Kodi.

2. Gjykata pasi përcakton qartazi kontributin konkret të secilit prej tyre, afërsinë me bashkëpunëtorin parësor gjatë kryerjes së veprës, rëndësinë që ka roli i secilit në përmbushjen e veprës penale, jep dënim më të butë krahasuar me bashkëpunëtorët parësorë.

3. Në rastin se një person përmbledh disa prej cilësive të bashkëpunëtorit dytësor, atëherë dënimi për të do të jetë më i lartë se sa gjykata do të caktonte ndaj atij që realizon një rol të vetëm.

#### Neni 56

### **Përgjegjësia e provokuesit**

Nisur nga roli në kryerjen e veprës penale, provokuesit do të dënohen sipas parashikimeve në dispozitat e pjesës së posaçme të këtij Kodi për një vepër të veçantë, nëse mungon dijenia e tyre për personat ekzekutorë apo mënyrën se si do të kryhet vepra penale. Nëse krimi ndodh, provokatori do të vlerësohet si nxitës në bashkëpunim.

#### Neni 57

### **Përgjegjësia e bashkëpunëtorit të jashtëm**

1. Bashkëpunëtori i jashtëm është subjekt vetëm i bashkëpunimit të veçantë dhe do të ketë përgjegjësi penale për veprën e kryer për të cilën është thirrur në ndihmë nga kontakti i tij, me kushtin që ndihma e dhënë të ketë ndikuar në realizimin e veprës penale nga bashkëpunëtorët e tjerë. Ai ndihmon në kryerjen e veprës penale për aftësitë që rrjedhin nga profesioni, kompetencat që ushtron në detyrë apo njohurisë rreth mekanizmit të kryerjes së veprës.

2. Në varësi të pasojave të ardhura nga vepra penale e kryer nga ky bashkëpunëtor, gjykata cakton dënimin individual sipas kritereve të përgjithshme për kryerjen e një vepre penale të kryer nga bashkëpunëtorët dytësorë.

3. Nëse pjesëmarrja e bashkëpunëtorit të jashtëm në kryerjen e veprave penale bëhet e vazhdueshme, nën porosinë dhe kontaktin e të njëjtit person apo personave që, për shkak të detyrës janë të njohur prej tij edhe për veprimtarinë ndërmjet tyre, ndihmohen në mënyrë thelbësore për kryerjen e krimeve dhe, jo rastësore, vlerësohet nga gjykata si bashkëpunëtor i zakonshëm i strukturës së posaçme të bashkëpunimit.

#### Neni 58

### **Forma të veçanta të bashkëpunimit**

1. Organizata kriminale është forma më e lartë e bashkëpunimit, në të cilën bëjnë pjesë tre ose më shumë persona dhe që dallohet nga shkalla e veçantë e organizimit, strukturimit, qëndrueshmërisë, kohëzgjatjes, si dhe nga qëllimi për kryerjen e një a më shumë veprave penale, për të realizuar dhe rritur përfitimet materiale dhe jomateriale, kryesisht, por jo domosdoshmërisht, në fushën e trafikëve, krimeve me rrezik të lartë, kundër të miturve, pastrimit të produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale, përvetësimit të fondeve publike nëpërmjet veprimeve të korrupsionit, shtrëngimeve, pengimit të drejtësisë apo vepra të tjera të lidhura me to. Organizata kriminale është e strukturuar, e shtrirë në kohë dhe, veprimtaria e saj mund të shtrihet edhe në rrafshin ndërkombëtar.

Anëtarët e organizatës kriminale bashkohen ndërmjet tyre nën qëllimin e përbashkët, në dijeni të plotë për llojin e veprave penale që do të kryejnë, gatishmërinë për kryerjen e tyre sipas kontributit

që do të japin në përputhje me natyrën e veprës apo aftësitë individuale, krijimit të përfitimeve materiale apo të çfarëdollojshme. Ata mbështesin njëri-tjetrin për efekt të përmbushjes së qëllimeve apo fshehjes së veprimtarisë kriminale nëpërmjet kalimit në tregun ligjor të ekonomisë apo tregtinë e lirë.

2. Organizata terroriste është strukturë e organizuar kriminale, e përbërë nga dy ose më shumë persona, që kanë një bashkëpunim të qëndrueshëm në kohë, me synim kryerjen e veprave me qëllime terroriste.

Anëtarët e kësaj strukture të organizuar planifikojnë apo marrin përsipër të kryejnë veprimtari të vlerësuar nga ligji si terrorizëm, përfshirë planifikimin, realizimin, ose promovimin e akteve të dhunës, sulmet kundër individëve, pronave, apo institucioneve, me qëllim të frikësimit, thyerjes së vetëveprimit, pavarësisht ose detyrimit të qeverive për marrjen e vendimeve sovrane, shoqërive, apo organizatave ndërkombëtare.

Anëtarët e organizatës terroriste bashkohen ndërmjet tyre nën qëllimin e përbashkët, në dijeni të plotë për llojin e veprave penale që do të kryejnë, gatishmërinë për kryerjen e tyre sipas kontributit që do të japin në përputhje me natyrën e veprës apo aftësitë individuale, krijimit të përfitimeve të çfarëdollojshme që rrjedhin prej qëllimit të formimit të organizatës terroriste.

3. Banda e armatosur është një formë e veçantë bashkëpunimi që, duke zotëruar armë, municione luftarake dhe mjete të tjera të nevojshme, synon kryerjen e veprave penale të dhunshme kundër personave apo pronave që përfshijnë përdorimin e armëve, detyrimin, ose frikësimin për të arritur objektivat e tyre. Anëtarët e bandës së armatosur veprojnë në koordinim për të kryer krime të rënda si vjedhje, shantazh, rrëmbim, ose sulme kundër individëve apo institucioneve, por pa u kufizuar domosdoshmërisht në to. Ata synojnë të krijojnë frikë që nënshtron apo shkatërron reagimin ndaj akteve të dhunës pavarësisht motiveve që i shtyjnë për të realizuar qëllimet e tyre.

Anëtarët e bandës së armatosur bashkohen ndërmjet tyre nën qëllimin e përbashkët, në dijeni të plotë për llojin e veprave penale që do të kryejnë, gatishmërinë për kryerjen e tyre sipas kontributit që do të japin në përputhje me natyrën e veprës apo aftësitë individuale, krijimit të përfitimeve të çfarëdollojshme që rrjedhin prej qëllimit të formimit të bandës së armatosur.

4. Grupi i strukturuar kriminal është formë e veçantë bashkëpunimi, në të cilin bëjnë pjesë tre ose më shumë persona, për kryerjen e një a më shumë veprave penale, për të realizuar përfitime materiale dhe jomateriale, kryesisht, por jo domosdoshmërisht, në fushën e trafikeve dhe krimeve me rrezik të lartë. Grupi i strukturuar kriminal nuk formohet në mënyrë të rastësishme. Ai mund të bashkohet përkohësisht për kryerjen e një vepre penale apo të rimblidhet më pas për të kryer të tjera vepra.

Grupi i strukturuar kriminal për kryerjen e një vepre penale formohet me dijeni të plotë të anëtarëve të tyre rreth llojit të veprimtarisë apo qëllimeve të grupit. Kjo formë bashkëpunimi nuk dallohet për anëtarësi të qëndrueshme, hierarki në ndarjen e detyrave, organizim dhe strukturim të zhvilluar. Anëtarët e grupit të strukturuar kriminal bashkohen ndërmjet tyre nën qëllimin e përbashkët, në dijeni të plotë për llojin e veprave penale që do të kryejnë, gatishmërinë për kryerjen e tyre sipas kontributit që do të japin në përputhje me natyrën e veprës apo aftësitë individuale, krijimit të përfitimeve të çfarëdollojshme që rrjedhin prej qëllimit të formimit të grupit të strukturuar.

5. Krijimi dhe pjesëmarrja në një organizatë kriminale, organizatë terroriste, bandë të armatosur ose grup të strukturuar kriminal cilësohen si vepra penale dhe dënohen sipas parashikimeve të pjesës së posaçme të këtij Kodi ose të dispozitave të tjera penale të veçanta, vetëm kur organizimi përkatës është arritur për kryerjen e një vepre penale të rëndë, në të kundërt organizimi do të përbëjë rrethanë rënduese.

## Neni 59

### **Përgjegjësia e bashkëpunëtorëve për veprat e kryera**

1. Anëtarët e organizatës kriminale, të organizatës terroriste, bandës së armatosur ose grupit të strukturuar kriminal janë përgjegjës për të gjitha veprat penale të kryera në përmbushjen e qëllimeve të veprimtarisë kriminale të grupimeve të posaçme në përputhje me rolin e tyre në secilën vepër të kryer.

2. Anëtarët e organizatës kriminale dhe organizatës terroriste mbajnë përgjegjësi penale për çdo vepër penale të kryer nga organizatat pavarësisht nëse kanë dhënë më parë miratimin apo mbështetjen e tyre.

3. Anëtarët e bandës së armatosur dhe grupit të strukturuar kriminal, mbajnë përgjegjësi penale për veprat penale të kryera kur ata kanë marrë pjesë në kryerjen e tyre, ose kanë dhënë më parë miratimin apo mbështetjen për kryerjen e tyre.

## Neni 60

### **Heqja dorë nga kryerja e veprës penale dhe përjashtimi nga dënimi**

1. Vlerësohet si heqje dorë nga kryerja e veprës, edhe rasti kur jemi përpara krijimit të bashkimit për të kryer një vepër penale, parashikuar si e dënueshme nga dispozitat e pjesës së posaçme të këtij Kodi, nëse personi vepron me vullnet të plotë për të kallëzuar bashkëpunëtorët dhe planet e tyre, rolin e tij dhe veprat penale të parashikuara të kryheshin.

2. Pjesëtari i organizatës kriminale, organizatës terroriste, bandës së armatosur ose i grupit të strukturuar kriminal, përfiton përjashtimin nga dënimi ose uljen e tij, kur jep ndihmesë, që gjykohet vendimtare për njohjen e veprimtarisë së tyre, të bashkëpunëtorëve të tjerë, pasurive të zotëruara drejtpërdrejt ose jo prej tyre, si dhe për veprimtaritë hetimore, që zhvillohen ndaj organizatave kriminale, organizatave terroriste, bandave të armatosura dhe grupeve të strukturuar kriminale.

3. Përjashtimi nga dënimi i pjesëtarit të organizatës kriminale, organizatës terroriste, bandës së armatosur ose i grupit të strukturuar kriminal, është rast përjashtimor dhe realizohet veçse kur anëtari kontribuon përpara se ndaj tij të ketë filluar procedimi penal. Nuk vlerësohet ndihmesë vendimtare informacioni i dhënë, por që dihej më parë dhe qëndronte në të dhënat e organeve proceduese, përveç rastit kur këto të dhëna nuk përbënin provë të fortë për të provuar fajësinë e autorëve dhe, ndihmesa shërben dukshëm në suksesin e procedimit.

## SEKSIONI II

### **PËRGJEGJËSIA PENALE E PERSONAVE JURIDIKË**

## Neni 61

### **Përgjegjësia penale e personave juridikë**

1. Personat juridikë përgjigjen penalisht për krime të kryera për përfitim të tyre nga organet dhe përfaqësuesit e tyre, ligjor apo faktik, pavarësisht nëse përmbushin apo jo kushtet apo cilësitë për të kryer detyrën e ngarkuar, edhe në rastet kur ndaj autorëve të veçantë është e pamundur të fillojë apo përfundojë një procedim penal.

2. Përgjegjësia penale e personave juridikë nuk përjashton atë të autoreve, të cilët kanë kryer ose janë bashkëpunëtorë në kryerjen e të njëjtave krime me autorë të tjerë. Ajo do të gjejë zbatim edhe atëherë kur autori përgjegjës nuk është individualizuar.
3. Në kuptim të ligjit penal, person juridik do të vlerësohet të jetë jo subjekti fizik i njohur për të ushtruar aktivitetin tregtar në përputhje me ligjin për shoqëritë tregtare, por ai që në strukturën e tij organizative përmban organizim të gjerë, ndarje të punëve sipas politikave apo modeleve të organizimit bazuar në ligjin përkatës dhe këtë Kod.
4. Organet e personit juridik dhe individët drejtues të saj, në përputhje me kompetencat e tyre, kanë përgjegjësinë e organizimit dhe administrimit të veprimtarisë së shoqërisë në mënyrë të përshtatshme për të siguruar shëndetin dhe jetën e të punësuarve dhe, gjithë të tjerëve të cilët ndikohen apo marrin shërbimet e personit juridik.
5. Te personat juridikë me përmasa të vogla, funksionet mbikëqyrëse të përmendura në këtë Kod dhe ligjin e posaçëm, mund të merren përsipër drejtpërdrejt nga organi i administrimit. Në kuptim të kësaj dispozite, do të konsiderohen persona juridikë me përmasa të vogla ata që, sipas legjislacionit në fuqi kane përgjegjësi tatimore te thjeshtuar.
6. Personi juridik përgjigjet penalisht për të gjitha veprat penale që citohen shprehimisht në pjesën e posaçme të këtij Kodi dhe, dënohen me llojet e dënimeve të parashikuara në dispozitat përkatëse apo, ndaj tyre mund të urdhërohen masa penale që gjendet të dobishme nga gjykata. Ata mund të gjenden në rolin e bashkëpunëtorit dytësor në kryerjen e çdo vepre penale.
7. Rrethanat e karakterit të veçantë që lehtësojnë apo rendojnë dënimin penal që i atribuohen një autori fizik nuk vlerësohen përkundrajt përgjegjësisë së personit juridik apo të anashkalojnë përgjegjësinë e tij.

## Neni 62

### **Delegimi i përgjegjësive**

Personi juridik është përgjegjës penalisht për veprat penale që lidhen me shërbimin ndaj publikut të kryera nëpërmjet punonjësve të tyre edhe kur përgjegjësia e shërbimit u është deleguar atyre sipas ligjit apo akteve të shoqërisë.

## Neni 63

### **Personat juridikë që nuk i nënshtrohen përgjegjësisë penale**

1. Përjashtohen nga zbatimi i përgjegjësisë penale të personave juridikë:
  - a) njësitet e qeverisjes së përgjithshme, institucioneve publike të pavarura;
  - b) entet rregullatore;
  - c) agjencitë, entitetet publike të biznesit apo shoqëritë tregtare shtetërore që zbatojnë apo ofrojnë shërbime në interes të përgjithshëm ekonomik;
  - ç) organizmat e të drejtës publike ndërkombëtare apo të ngjashme që ushtrojnë fuqitë e sovranitetit apo qeverisjes.
2. Njësitë e vetëqeverisjes vendore përgjigjen penalisht vetëm për veprime të kryera gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre nëpërmjet delegimit të shërbimeve publike.
3. Ligji i posaçëm nr. 9754, datë 14.6.2007, “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë”, zbatohet për atë që nuk bie ndesh me parashikimet e këtij Kodi.

## TITULLI III DËNIMET

Neni 64

### **Qëllimi i dënimit**

1. Dënimi penal ka për qëllim të ndëshkojë veprën penale të kryer, të izolojë fajtorin për kohën që nevojitet për arritjen e sigurisë publike, të ndikojë në riintegrimin e tij në shoqëri përmes mënyrës së vuajtjes së dënimit, të synojë parandalimin e kryerjes së veprave penale në shoqëri, kompensimin e mbrojtjen e viktimave, të miturve dhe subjekteve të tjera nga shfrytëzimi.
2. Prokurori i Shtetit ka përgjegjësinë që, mbështetur në kriteret e vendosura në këtë ligj, nisur nga përgjegjësia e tij për ndjekjen penale, përfaqësimin e interesave të Shtetit në seancën gjyqësore dhe, veçanërisht kontrollin ndaj kriminalitetit, të kërkojë në mënyrë të argumentuar përpara gjykatës dënim të përshtatshëm e proporcional për autorët që kanë kryer vepra penale me synimin për të arritur qëllimet e dënimit të përcaktuara në paragrafin e parë të këtij neni.

Neni 65

### **Dhënia e dënimeve për krime e kundërvajtje penale**

Në përmbushjen e qëllimeve të dënimit penal, gjykata vendos dënimet kryesore, plotësuese ose ndërmerr masa penale ndaj personave që kryejnë krime apo kundërvajtje penale. Në përzgjedhjen e tyre ajo i përmbahet nevojës së kontrollit të kriminalitetit, bazohet në rëndësinë e veprës penale, në parimet e individualizimit si mënyrë e caktimit të dënimit penal dhe parimeve të përgjithshme të këtij Kodi.

## KREU I

### DËNIMET NDAJ PERSONAVE FIZIKË

Neni 66

### **Dënimet kryesore**

1. Për personat që kanë kryer krime, nga gjykata jepen këto dënime kryesore:
  - a) me burgim të përjetshëm;
  - b) me burgim;
  - c) me gjobë.
2. Për personat që kanë kryer kundërvajtje penale jepen këto dënime kryesore:
  - a) me burgim;
  - b) me gjobë;
  - c) heqje e së drejtës për të kryer funksione publike.
3. Për personat që kanë kryer krime apo kundërvajtje penale gjykata mund të caktojë edhe dënime plotësuese apo masa penale, në varësi me natyrën e veprës penale të kryer në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

4. Llojet e dënimeve penale për të miturit të parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Miturit, janë të zbatueshme pavarësisht nga parashikimet në këtë Kod.

#### Neni 67

### **Dënimet plotësuese për krimet**

1. Dënimet plotësuese që jepen për kryerjen e krimeve janë, si më poshtë:
- a) ndalimi i të drejtës për të ushtruar funksione publike;
  - b) konfiskimi i mjeteve të kryerjes së veprës penale dhe produkteve të veprës penale;
  - c) ndalimi për të drejtuar automjete;
  - ç) ndalimi për të mbajtur armë me leje;
  - d) heqja e dekoratave dhe titujve të nderit;
  - dh) heqja e së drejtës për të ushtruar një veprimtari ose mjeshtëri ;
  - e) moslejimi për të marrë pjesë në gara për vende pune publike apo për të përfituar fonde publike;
  - ë) heqja e së drejtës për të ushtruar detyra drejtuese pranë personave juridikë, edhe privatë;
  - f) ndalimi për të qëndruar, ose detyrimi për të qëndruar në një ose disa njësi administrative;
  - g) ndalimi për të banuar në vende të caktuara;
  - gj) dëbimi jashtë territorit;
  - h) detyrimi për publikimin e vendimit gjyqësor në media dhe komunitet;
  - i) humbja e përgjegjësisë prindërore;
  - j) ndalimi për t'iu afruar viktimës, të afërmeve të saj apo komunikuar me ta;
  - k) detyrimi për të marrë pjesë në seanca terapeutike sociale, desintoksitimi apo kurse edukimi;
  - l) detyrimi për të mos frekuentuar vende dhe persona të caktuar;
  - ll) përjashtimin e autorit të veprës penale nga e drejta e trashëgimisë që i rrjedh atij prej viktimës dhe humbjen e të drejtave për të përfituar kujdesin prej saj, në rastet kur ky detyrim ekziston për shkak të ligjit apo marrëdhënies gjinore;
  - m) ndalimi i të drejtës për t'u zgjedhur.

#### Neni 68

### **Caktimi i dënimeve plotësuese**

1. Për personat që kanë kryer vepra penale të lehta për të cilat ligji parashikon dënim me burgim ose dënim më të butë, gjykata, në raste të veçanta, kur dhënia e dënimeve kryesore çmohet e papërshtatshme mund të mjaftohet vetëm me caktimin e jo më pak se dy dënimeve plotësuese që përputhen me natyrën e veprës së kryer.

2. Për personat që kanë kryer krime të rënda apo shumë të rënda, gjykata, bashkë me dënimin kryesor jep edhe një apo më shumë dënime plotësuese në përputhje me natyrën e veprës së kryer.

3. Kur gjykata vlerëson të nevojshme, për shkak të natyrës së krimit, të efekteve që kanë dënimet plotësuese, nevojës për përputhjen sa më të mirë të dënimit penal me qëllimet e synuara prej tij dhe kur, krijon bindjen rreth efektivitetit të dënimit plotësues, e cakton atë edhe për krimet kur dispozitat e pjesës së posaçme të këtij Kodi nuk e kanë parashikuar shprehimisht atë.

#### Neni 69

### **Dënimet plotësuese për kundërvajtje penale**

1. Dënimet plotësuese që jepen për personat që kryejnë kundërvajtje penale janë si më poshtë:
  - a) konfiskimi i mjeteve të kryerjes së veprës penale dhe produkteve të veprës penale;
  - b) ndalimi për të drejtuar automjete;
  - c) heqja e së drejtës së ushtrimit të një veprimtarie ose mjeshtërie;
  - ç) heqja e së drejtës për të ushtruar detyra drejtuese pranë personave juridikë, edhe privatë;
  - d) detyrimi për publikimin e vendimit gjyqësor në media dhe komunitet;
  - dh) detyrimi për të marrë pjesë në seanca terapeutike sociale, desintoksitimi apo kurse edukimi.
2. Në raste të veçanta kur gjykata vlerëson se dënimi kryesor është i papërshtatshëm mjaftohet me caktimin e një dënimi plotësues që përputhet me natyrën e kundërvajtjes së kryer.
3. Kur gjykata vlerëson të nevojshme, për shkak të natyrës së kundërvajtjes penale, të efekteve që kanë dënimet plotësuese, nevojës për përputhjen sa më të mirë të dënimit penal me qëllimet e synuara prej tij dhe kur, krijon bindjen rreth efektivitetit të dënimit plotësues, e cakton atë edhe për kundërvajtjet kur dispozitat e pjesës së posaçme të këtij Kodi nuk e kanë parashikuar shprehimisht atë.

#### Neni 70

##### **Masat plotësuese**

1. Masat plotësuese që jepen për personat që kryejnë vepër penale janë si më poshtë:
  - a) pagimi i dëmit të shkaktuar;
  - b) pagimi i kostove të procedimit;
  - c) regjistrimi, shkëmbimi dhe ruajtja e të dhënave;
  - ç) kufizimi i lëvizjeve;
  - d) kthimi në gjendjen e mëparshme;
  - dh) kompensimin e viktimës.
2. Dispozitat e pjesës së posaçme të këtij Kodi parashikojnë edhe masa plotësuese të tjera, të cilat vlerësohen të domosdoshme të jepen nga gjykata kur ajo synon të zbusë ndikimin e pasojës penale, të shmangë a pakësojë dëmtimin e pasurisë publike apo, cenimin e interesave themelore të shtetasve, të ndikojë thelbësisht në parandalimin e kryerjes së veprave penale të ngjashme me atë që ka për gjykim dhe, të përfshijë në procesin e parandalimit të përgjithshëm organet publike për të ndjekur zbatimin e masave penale.
3. Në raste të veçanta, kur gjykata vlerëson se dënimi kryesor apo plotësues për kryerjen e një kundërvajtje penale është i papërshtatshëm mjaftohet me caktimin e disa masave plotësuese penale në përputhje me natyrën e kundërvajtjes së kryer dhe, sigurojnë arritjen e qëllimeve të dënimit penal.

#### Neni 71

##### **Dënimi me burgim të përjetshëm**

1. Dënimi me burgim të përjetshëm jepet me vendim të gjykatës për kryerjen e një krimi të rëndë që ka shkaktuar pasoja veçanërisht të rënda.
2. Dënimi me burgim të përjetshëm nuk jepet ndaj personave që në kohën e kryerjes së krimit nuk kanë mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, apo kur janë rastet e parashikuara në këtë Kod, edhe për personat që nuk kanë mbushur moshën 21 vjeç si dhe ndaj grave.

#### Neni 72

## **Dënimi me burgim**

1. Dënimi me burgim për krimet jepet për një kohë nga 10 ditë deri në tridhjetë vjet, përveç rasteve kur bëhet bashkimi i dënimeve sipas këtij Kodi.
2. Për kundërvajtje penale dënimi me burgim jepet për një kohë nga 5 ditë deri në dy vjet, përveç rasteve kur bëhet bashkimi i dënimeve sipas këtij Kodi.

### Neni 73

#### **Ekzekutimi i dënimit me burgim të përjetshëm dhe me burgim**

1. Dënimi me burgim të përjetshëm dhe dënimi me burgim shlyhen në institucione të caktuara posaçërisht për këtë qëllim.
2. Rregullat mbi mënyrën e shlyerjes së dënimeve, të drejtat dhe detyrat e të dënuarve caktohen me ligj të veçantë.
3. Të miturit e kryejnë dënimin me burgim në vende të veçanta nga të rriturit.
4. Gratë e kryejnë dënimin me burgim në institucione të veçanta nga burrat.

### Neni 74

#### **Dënimi me gjobë**

1. Dënimi me gjobë konsiston në pagimin në favor të shtetit të një shume të hollash brenda kufijve të parashikuar në ligj.
2. Dënimi me gjobë jepet për personat që kryejnë krim ose kundërvajtje penale dhe përmban:
  - a) për personat që kryejnë krim gjoba jepet nga 100 mijë deri në 10 milionë lekë;
  - b) për personat që kryejnë kundërvajtje penale, gjoba jepet nga 50 mijë deri në 3 milionë lekë.
3. Për personat që kryejnë krime për motive fitimi të pasurive ose të sigurimit të çdo lloj përfitimi tjetër material, gjykata vendos detyrimisht konfiskimin e mjeteve të kryerjes së veprës penale dhe produkteve të veprës penale ose, në pamundësi apo mungesë të tyre, një shtesë të dënimit me burgim deri në 1/3 e atij të dhënë, konvertuar në gjobë sipas rregullave të nenit 148 të këtij Kodi.
4. Gjkata jep dënimin me gjobë vetëm pasi ka hetuar rreth aftësisë paguese të personit. Aftësia paguese përcaktohet nga gjendja personale dhe pasurore e personit. Dënimi me gjobë paguhet në afatin e caktuar në vendimin e gjykatës.
5. Gjkata, duke marrë parasysh gjendjen ekonomike të të dënuarit, mund të lejojë që gjoba të paguhet me këste, duke caktuar këstet dhe afatin e pagimit të tyre.

### Neni 75

#### **Mospagimi dhe zëvendësimi i gjobës**

1. Kur i dënuari nuk e paguan gjobën dhe ajo nuk mund të vilet nëpërmjet ekzekutimit të detyrueshëm, gjykata vendos zëvendësimin e gjobës me burgim, duke llogaritur sipas rregullave të nenit 148 të këtij Kodi.
2. Kur i dënuari nuk mund të paguajë gjobën në afat pa fajin e tij dhe nëse kriteret, mbi të cilat është caktuar gjoba, kanë ndryshuar pas dhënies së vendimit dhe nuk e justifikojnë haptazi pagimin e gjobës, atëherë i dënuari mund të kërkojë:
  - a) shtyrje të afatit të pagesës së gjobës deri në gjashtë muaj;

b) kryerjen e një pune me interes publik.

3. Nëse gjykata urdhëron kryerjen e një pune në interes publik zbatohen rregullat përkatëse që ky ligj përmban lidhur me punën në interes publik.

4. Nëse gjyba nuk paguhet edhe pas shtyrjes së afatit ose nëse i dënuari nuk e kryen punën në interes publik, gjykata vendos zëvendësimin e gjobës me burgim. Nuk lejohet revokimi i dënimit me burgim pasi ai ka zëvendësuar dënimin me gjobë apo alternativën e punës në interes publik.

5. Kur gjyba është dhënë për kryerjen e një krimi, zëvendësimi i saj me burgim nuk mund të kalojë tre vjet, ndërsa kur ajo është dhënë për kryerjen e një kundërvajtjeje penale, zëvendësimi nuk mund të kalojë një vit burgim, por gjithmonë pa kaluar maksimumin e dënimit me burgim që parashikon dispozita përkatëse. Nëse dispozita penale nuk parashikon dënim me burgim, maksimumi i dënimit me burgim vlerësohet të jetë gjashtë muaj.

#### Neni 76

### **Heqja e së drejtës për të ushtruar funksione publike**

1. Heqja e së drejtës për të ushtruar funksione publike, për një kohë jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet deri në 25 vjet, jepet ndaj personit që ka kryer një krim që lidhet me detyrën duke shpërdoruar funksionin publik ose, ka kryer një krim për të cilin gjykata ka caktuar një dënim me burgim jo më pak se dhjetë vjet. Kur për krimin e kryer dispozita parashikon dënim me burgim të përjetshëm, ose kundër integritetit seksual të të miturve, heqja e së drejtës për të ushtruar funksione publike është e përhershme.

2. Heqja e së drejtës për të ushtruar funksione publike mund të jepet për një kohë nga 10 deri në 20 vjet, kur gjykata ka caktuar një dënim nga pesë deri në dhjetë vjet burgim, dhe nga 5 deri në 10 vjet, kur është caktuar dënimi deri në tre vjet burgim.

3. Heqja e së drejtës për të ushtruar funksione publike është dënim kryesor në rastin kur kryhet një kundërvajtje penale të parashikuara në pjesën e posaçme të këtij Kodi. Ajo jepet ndaj të dënuarit që kryen kundërvajtjen e lidhur me natyrën e funksionit që ushtron dhe nuk mund të jetë më tepër se sa dy vjet.

4. Në çdo rast kryerja e dënimit plotësues fillon pas kryerjes së dënimit kryesor.

#### Neni 77

### **Konfiskimi i mjeteve të kryerjes së veprës penale dhe produkteve të veprës penale**

1. Konfiskimi jepet detyrimisht nga gjykata dhe ka të bëjë me marrjen dhe kalimin në favor të shtetit:

a) të sendeve që kanë shërbyer ose janë caktuar si mjete për kryerjen e veprës penale;

b) të produkteve të veprës penale, ku përfshihet çdo lloj pasurie, si dhe dokumentet ose instrumentet ligjore që vërtetojnë tituj ose interesa të tjerë në pasurinë që rrjedh ose fitohet drejtpërdrejt ose tërthorazi nga kryerja e veprës penale;

c) të shpërblimeve, të dhëna ose të premtuara, për kryerjen e veprës penale;

ç) të çdo pasurie tjetër, vlera e së cilës i korrespondon asaj të produkteve të veprës penale;

d) të sendeve, prodhimi, përdorimi, mbajtja ose tjetërsimi i të cilave përbëjnë vepër penale, edhe kur nuk është dhënë vendim dënimi.

2. Nëse produktet e veprës penale janë transformuar ose shndërruar pjesërisht ose plotësisht në pasuri të tjera, këto të fundit i nënshtrohen konfiskimit.

3. Nëse produktet e veprës penale janë bashkuar me pasuri të fituara në rrugë të ligjshme, këto të fundit konfiskohen deri në vlerën e produkteve të veprës penale.

4. Konfiskimit i nënshtrohen edhe të ardhurat ose përfitimet e tjera nga produktet e veprës penale, nga pasuritë në të cilat janë transformuar ose shndërruar produktet e veprës penale ose nga pasuritë me të cilat janë përzier këto produkte, në të njëjtën masë dhe mënyrë sikurse produktet e veprës penale.

5. Pjesa e Posaçme e këtij Kodi përmban përcaktime të rasteve kur konfiskimi jepet nga gjykata ndaj mjediseve që kanë shërbyer për kryerjen e veprave penale të rënda.

6. Për qëllim të këtij dënimi plotësues personi fizik barazohet me atë juridik.

#### Neni 78

### **Konfiskimi te të tretët**

1. Konfiskimit i nënshtrohen edhe produktet ose pasuritë e tjera, vlera e të cilave u korrespondon këtyre produkteve, të cilat janë transferuar te persona të tretë nga autori i veprës penale, ose që personat e tretë kanë blerë drejtpërdrejt ose tërthorazi nga autori, me kushtin që personat e tretë të kenë ditur ose duhej të kishin ditur që qëllimi i tjetërsimit të pronësisë ose i blerjes ka qenë shmangia e konfiskimit, duke u bazuar në fakte dhe rrethana konkrete, si dhe kur transferimi ose blerja është bërë falas apo kundrejt një vlere shumë herë më të vogël se sa vlera e tregut.

2. E njëjta masë vendoset edhe ndaj sendeve apo pasurisë që rrjedh nga kryerja e veprës penale, është produkt apo mjet i kryerjes së saj, kur ato gjenden te persona të tretë për çfarëdolloj arsye.

3. Konfiskimi sipas paragrafit të parë të këtij neni nuk cenon të drejtat e palëve të treta që janë në mirëbesim.

#### Neni 79

### **Ndalimi për të drejtuar automjete**

1. Ndalimi për të drejtuar automjete jepet nga gjykata, për një kohë nga një deri në pesë vjet, kundër personave që kanë kryer vepër të rëndë penale, kur çmohet se do të ketë efekt parandalues apo pajtohet me natyrën e veprës së kryer.

2. Ky dënim është i detyrueshëm të jepet nga gjykata edhe në rastin e kryerjes së një vepre të lehtë penale kur autori është ndihmuar nga përdorimi i automjetit për kryerjen e saj ose, ka kryer një vepër penale të lidhur me qarkullimin rrugor.

3. Koha e fillimit të zbatimit të dënimit caktohet nga gjykata me shpalljen e vendimit përfundimtar.

#### Neni 80

### **Ndalimi për të mbajtur armë zjarri**

1. Gjkata jep dënimin plotësues të ndalimit për të mbajtur armë zjarri ndaj personave që kanë shpërdoruar lejen e mbajtjes së saj duke kryer vepër të rëndë penale me përdorimin e armës.

2. Afati i heqjes së të drejtës për të mbajtur armë është nga pesë deri në dhjetë vjet, ose i përhershëm.

3. Personat të cilët kanë kryer një krim nëpërmjet përdorimit të armës së zjarrit të mbajtur pa lejen e organeve shtetërore, asnjëherë nuk mund të pajisen me leje përkatëse për mbajtjen e tyre.

## Neni 81

### **Heqja e dekoratave dhe e titujve**

1. Heqja e dekoratave dhe e titujve të nderit apo titujve akademikë vendoset për personat që kanë kryer një krim të rëndë që dënohet me burgim dhe çmohet se mbajtja e tyre nuk pajtohet me natyrën e veprës së kryer.

2. Heqja e dekoratave dhe titujve të nderit apo akademik është e përhershme kur personi dënohet për një krim mbi dhjetë vjet burgim dhe, nga një deri në pesë vjet kur dënohet deri në dhjetë vjet burgim.

## Neni 82

### **Heqja e së drejtës së ushtrimit të një profesioni ose të një veprimtarie**

1. Heqja e së drejtës së ushtrimit të një profesioni ose të një veprimtarie e ndalon të dënuarin të ushtrojë profesionin ose veprimtarinë, për të cilën është dhënë leje e veçantë, dëshmi, autorizim apo licencë nga organi kompetent.

2. Heqja e së drejtës së ushtrimit të një veprimtarie ose të një profesioni jepet detyrimisht për një kohë nga dy deri në pesë vjet, ose e përhershme dhe, është rrjedhojë e çdo dënimi për vepra të rënda apo shumë të rënda penale që kryhen duke shpërdoruar detyrën që kërkon leje të veçantë, ose, kur vlerësohet se ushtrimi i mëtijshëm i veprimtarisë apo profesionit bie ndesh me marrëdhënien juridike që synon të mbrojë vepra penale konkrete.

3. Leja e veçantë, dëshmia, autorizimi apo licenca e organit kompetent që kushtëzon kryerjen e një veprimtarie profesionale nuk mund të lëshohet në favor të personave të dënuar më parë për veprat e rënda ose shumë të rënda penale që lidhen me përmbajtjen e atyre të shënuara në paragrafin e dytë të këtij neni, pavarësisht nëse ata janë ose jo të rehabilituar sipas parashikimeve të këtij Kodi.

4. Për efekt të këtij dënimi plotësues do të barazohen sektori publik dhe ai privat si dhe personi fizik me atë juridik.

## Neni 83

### **Ndalimi për të marrë pjesë në gara për vende pune apo për të përfituar fonde publike**

1. Ndalimi për të marrë pjesë në gara për vende pune publike apo për të përfituar fonde publike, jepet detyrimisht nga gjykata ndaj personave, edhe juridikë, që kanë kryer një vepër të rëndë ose shumë të rëndë penale që lidhet me detyrën, objektin e veprimtarisë, ose është drejtuar kundër autoritetit të shtetit, rendit kushtetues, veprimtarisë shtetërore, rendit e sigurisë juridike, kundër drejtësisë, në fushën e korrupsionit ose kryer nga persona në bashkëpunim të posaçëm me njëritjetrin.

2. Afati i zbatimit të këtij dënimi plotësues është nga pesë deri në dhjetë vjet, ose deri në afatin kohor që përcaktohet nga koha e rehabilitimit të dënimit kryesor.

3. Për efekt të këtij dënimi plotësues do të barazohen sektori publik dhe ai privat si dhe personi fizik me atë juridik.

## Neni 84

## **Heqja e së drejtës së ushtrimit të detyrave drejtuese**

1. Heqja e së drejtës së ushtrimit të detyrave drejtuese pranë personave juridikë, i heq mundësinë të dënuarit të ushtrojë detyrat e drejtorit, të administratorit, likuidatorit, si dhe çdo detyrë tjetër që ka të bëjë me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik.

2. Heqja e së drejtës së ushtrimit të detyrave drejtuese pranë personave juridikë është rrjedhojë e çdo dënimi për vepra të rënda penale kur i dënuari ka shpërdoruar funksionet apo ka vepruar në kundërshtim me rregullat që lidhen me detyrën. Afati i heqjes të së drejtës është për një kohë nga një deri në pesë vjet nëse dënimi me burgim i dhënë nga gjykata është deri në pesë vjet.

3. Kur dënimi i dhënë nga gjykata është jo më pak se pesë vjet burgim, kjo e drejtë hiqet për një kohë nga pesë deri në dhjetë vjet.

4. Për efekt të këtij dënimi plotësues do të barazohen sektori publik dhe ai privat si dhe, personi fizik me atë juridik.

### Neni 85

#### **Ndalimi për të qëndruar ose qëndrimi në një apo disa njësi administrative**

1. Ndalimi për të qëndruar në një apo disa njësi administrative jepet nga gjykata për një kohë nga një deri në pesë vjet, kur çmohet se qëndrimi i të dënuarit në këto vende përbën rrezik për sigurimin publik.

2. Qëndrimi i të dënuarit në një apo disa njësi administrative jepet nga gjykata për një kohë nga një deri në pesë vjet, kur çmohet se qëndrimi në këto vende i shërben sigurisë publike.

3. Në rastet e krimeve të rënda me pasoja në komunitetin ku ka ndodhur, apo të dhunës së përsëritur në familje, zbatimi i këtij dënimi plotësues është i detyruar, përveç rastit kur marrëdhëniet ndërmjet palëve në konflikt duket qartazi, përtej çdo dyshimi, që janë normalizuar.

4. Në krimet që lidhen me cenim të rendit publik, krimet seksuale të kryera ndaj të miturve apo sjellje të padenja, kur janë shkaktuar pasoja të rënda për jetën publike, zbatimi i këtij dënimi është i detyrueshëm.

### Neni 86

#### **Ndalimi për të banuar në vende të caktuara**

1. Ndalimi për të banuar në vende të caktuara vendoset ndaj të dënuarit dhe lidhet me vendin ku është kryer vepra penale ose në vendin ku banon viktima ose familja e tij. Në rastet kur tek i dënuari është vërtetuar ekzistenca e një paaftësie intelektuale ose e një paaftësie që e ka origjinën në një çrregullim mendor, në caktimin e këtij dënimi, gjykata duhet të mbajë parasysh të drejtat ligjore që duhen mbrojtur dhe interesin më të lartë të personit me aftësi të kufizuara, i cili duhet të disponojë mjetet e nevojshme të shoqërimit dhe mbështetjes për të shlyer këtë dënim.

2. Kriteret e përcaktuara në nenin 85 të këtij Kodi janë të zbatueshme edhe për paragrafin e parë të këtij neni.

### Neni 87

#### **Dëbimi jashtë territorit**

1. Dëbimi jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë jepet nga gjykata ndaj shtetasit të huaj dhe atij pa shtetësi që kryen një krim dhe çmohet se qëndrimi i mëtejshëm i tij në territorin e Republikës së Shqipërisë nuk duhet të vazhdojë më në të ardhmen.

2. Vendimi revokohet nga gjykata, me kërkesën e të dënuarit, kur shtetasi i huaj apo pa shtetësi fiton shtetësinë shqiptare. Në këtë rast, nëse janë kushtet e zbatimit të nenit 85 të këtij Kodi, gjykata revokon vendimin e parë dhe, në varësi të krimit të kryer, zbaton urdhërimet e kësaj dispozite, nëse kriteret e parashikuara në të, janë në përputhje me natyrën e veprës së kryer.

#### Neni 88

### **Publikimi i vendimit gjyqësor në media dhe komunitet**

1. Publikimi i vendimit gjyqësor jepet nga gjykata kur çmon se njohja e përmbajtjes së vendimit ka interes publik, përveçse kur viktima kërkon ndryshe.

2. Publikimi i vendimit gjyqësor, tërësisht apo pjesërisht, të urdhëruar nga gjykata, realizohet me shpenzimet e të dënuarit, në një apo disa mjete komunikimi masiv ose stacione radiotelevizive apo/edhe vende të posaçme në komunitet.

3. Data e publikimit dhe kohëzgjatja e tij caktohen nga gjykata.

4. Mjetet e komunikimit dhe të radiotelevizionit, organet e pushtetit lokal janë të detyruara të publikojnë vendimin gjyqësor të dërguar nga gjykata. Pas përfundimit të afatit të caktuar nga gjykata lidhur me publikimin e vendimit gjyqësor, organet e çdolloj mjeti që e publikuan atë, janë të detyruara ta heqin, fshijnë apo shmangin në mënyrë që vendimi gjyqësor të mos jetë i arritshëm nga të tretët.

5. Publikimi i vendimit gjyqësor nuk jepet kur rrezikohet përhapja e sekretit shtetëror, cenohet jeta personale e personave, të miturve ose preket morali shoqëror.

6. Publikimi i vendimit gjyqësor është i detyrueshëm kur vepra e rëndë penale lidhet me raste për të cilat është shfaqur interes i lartë publik, për raste që çmohen se përbëjnë demonstrim të qëllimit parandalues të dënimit, për rastet kur vlerësohet se publikimi i vendimit do të ndikojë pozitivisht në sjelljet e të dënuarit apo do të ndikojë që publiku të tregojë kujdesin e duhur ndaj personave mbartës të sjelljeve kriminale. Në çdo rast, gjykata mban parasysh detyrimet e dhëna në paragrafët e parë dhe të pestë të kësaj dispozite.

7. Për efekt të këtij dënimi plotësues do të barazohen sektori publik dhe ai privat si dhe, personi fizik me atë juridik.

#### Neni 89

### **Publikimi i vendimit lidhur me viktimën e mitur**

1. Përtej sa është parashikuar në nenin 88 të këtij Kodi, për të ekspozuar autorin që ka kryer krime që drejtohen ndaj integritetit seksual të të miturve, për të garantuar sigurinë e tyre dhe atë publike, gjykata është e detyruar të publikojë vendimin gjyqësor me gjeneralitetet e plota të autorit, përfshirë këtu edhe fotografinë e tij, të veprës penale të kryer dhe dënimit të dhënë, por me arsyetim të përmbledhur të faktit penal, me qëllim mbrojtjen nga ekspozimi të të dhënave personale të viktimës së mitur.

2. Në rastin kur autori i krimit të përcaktuar në paragrafin e parë është një i mitur, zbatohen kufizimet e publikimit të gjeneraliteteve të të miturit që ka kryer një krim.

## Neni 90

### **Humbja e përgjegjesisë prindërore**

1. Humbja e përgjegjesisë prindërore jepet nga gjykata ndaj personit që e ushtron përgjegjësinë prindërore, kur ai dënohet si autor ose bashkëpunëtor në një vepër penale ndaj viktimës së mitur ose si bashkëpunëtor me të miturin në kryerjen e një krimi.

2. Të njëjtat parashikime vlejnë edhe kur kujdestari i të miturit është subjekt sipas paragrafit të parë të këtij neni.

## Neni 91

### **Ndalimi për t'iu afruar viktimës, të afërmeve të saj apo komunikuar me ta**

1. Ndalimi për t'iu afruar viktimës, të afërmeve të saj apo për të komunikuar me çfarëdo lloji mënyre me ta, mund të jepet nga gjykata në rastet kur i dënuari ka kryer një krim që lidhet me ushtrimin e dhunës në familje, komunitet, mjedise sociale, arsimore, pune, përndjekjes apo, pavarësisht llojit të krimit, rezulton në gjykim se është ushtruar presion prej tij për të arritur në favore lehtësuese përgjatë kohës nga kryerja e veprës deri në dhënien e vendimit nga ana e gjykatës.

2. Kur gjykata vlerëson që presioni i ushtruar ndaj viktimës është bërë për të arritur favore lehtësuese procedurale të cilat shkaktojnë heqjen dorë nga ankimi apo edhe pushimin e çështjes, përpos mospranimit të tërheqjes nga ankimi dhe urdhërimit të ndjekjes penale, zbaton në mënyrë të detyrueshme këtë dënim plotësues.

3. Ndalimi për t'iu afruar viktimës ose të afërmeve të tij ose personave të tjerë të përcaktuar nga gjykata, e pengon të dënuarin t'iu afrohet atyre, në çdo vend ku ndodhen, si dhe t'iu afrohet vendbanimit të tyre, vendit të punës dhe çdo vendi tjetër që frekuentohet prej tyre, përveç rasteve kur ushtron të drejtën e vizitave, komunikimit dhe qëndrimit me fëmijët e tij.

4. Ndalimi për të komunikuar me viktimën, ose me të afërmit e saj ose me persona të tjerë të përcaktuar nga gjykata, e pengon të dënuarin të komunikojë me ta, me çdo mjet komunikimi ose mjet kompjuterik ose telematik, kontakt me shkrim, verbal ose pamor.

Gjykata mund të disponojë që kontrolli i këtyre masave të kryhet nëpërmjet mjeteve elektronike që e mundësojnë një gjë të tillë.

5. Gjykata duhet të vendosë edhe për afatin e arsyeshëm të këtij ndalimi. Çdo vit, gjykata kryesisht rivlerëson dobishmërinë e dënimit plotësues dhe, në varësi të efektit të saj, marrëdhënive të reja ndërmjet palëve, vendos për zgjatjen apo heqjen e këtij dënimi plotësues.

## Neni 92

### **Detyrimi për të marrë pjesë në programe terapeutike sociale, desintoksitimi apo kurse edukimi**

1. Detyrimi për të marrë pjesë në programe terapeutike sociale, desintoksitimi apo kurse edukimi jepet ndaj të dënuarve të cilët kanë kryer veprën penale edhe si pasojë e ndikimit të dukshëm të prirjeve të dhunës, çrregullimeve të personalitetit deri në kufirin e pranuar të përgjegjshmërisë për veprën penale, mospërmbytjes së zemërimit, përdorimit të alkoolit apo lëndëve narkotike, nivelit të ulët arsimor, kulturor apo rasteve të mungesës së një familje të aftë për edukimin e personit.

2. Gjykata duhet të vendosë edhe për afatin e arsyeshëm të këtij detyrimi bazuar në rastin konkret dhe mendimin e specialistëve që sigurojnë zbatimin e dënimit plotësues.

Neni 93

### **Detyrimi për të mos frekuentuar vende dhe persona të caktuar**

Detyrimi për të mos frekuentuar vende ose persona të caktuar, jepet nga gjykata ndaj të dënuarit kur çmohet e drejtë që, shoqërimi i tij me persona të caktuar apo frekuentimi i vendeve të caktuara, ndikojnë negativisht në sjelljen që ai shfaq. Kryesisht gjykata detyron të dënuarin të mos shoqërohet me persona të dënuar, bashkëpunëtorët e veprës penale, të mos frekuentojë vendet ku ai ka kryer veprën apo edhe, çdo vend tjetër kur vlerësohet që prania e tij do të ndikojë në sigurinë e rendit publik.

Neni 94

### **Përjashtimi nga e drejta e trashëgimisë**

Përjashtimin nga e drejta e trashëgimisë së viktimës dhe humbjen e së drejtave për të përfituar kujdesin prej saj, në rastet kur ky detyrim ekziston për shkak të ligjit apo marrëdhënies gjinore, vendoset nga gjykata ndaj autorit të veprës penale kur ai, e ka kryer atë me qëllimin e përvetësimit të saj. Në çdo rast për të vendosur këtë dënim plotësues, gjykata, kur është e mundur, merr pëlqimin e viktimës.

Neni 95

### **Ndalimi i së drejtës për t'u zgjedhur**

Ndalimi i së drejtës për t'u zgjedhur në organet legislative kombëtare apo vendore, për një kohë jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet deri në njëzet e pesë vjet, jepet ndaj personit që ka kryer një krim që lidhet me krimet zgjedhore, ushtrimin e detyrës duke shpërdoruar funksionin publik ose, kur ka kryer një krim për të cilin gjykata ka caktuar një dënim me burgim jo më pak se pesë vjet.

Neni 96

### **Detyrimi për pagimin e dëmit të shkaktuar**

1. Masa plotësuese e detyrimit për pagimin e dëmit të shkaktuar jepet nga gjykata ndaj të dënuarit, kur rasti paraqitet i qartë, pavarësisht nëse ka apo jo kërkesë të veçantë nga viktimia apo paditësi civil në procesin penal, kur nga vepra penale është shkaktuar një dëm pasuror dhe synon të arrijë kompensimin e drejtë të viktimës nga vepra penale.

2. Nëse i dënuari është i mitur deri në 18 vjeç, ose është deri në 21 vjeç pa mjete jetese dhe jeton me prindërit apo kujdestarin, nuk ka pasuri për të zëvendësuar dëmin e shkaktuar, apo është i papërgjegjshëm penalisht dhe ndaj tij janë urdhëruar masa mjekësore, atëherë gjykata mund të urdhërojë që dëmi të paguhet nga:

a) prindërit apo kujdestari për dëmet dhe humbjet e shkaktuara viktimës nëse pakujdesia e tyre në përmbushjen e detyrimeve të edukimit apo kontrollit të sjelljes të të miturit apo të riut deri në 21 vjeç, është e qartë dhe përbën shkak për dëmin e shkaktuar.

3. Nëse i dënuari ka kryer veprën penale në ushtrim të detyrës së tij, atëherë gjykata mund të urdhërojë që dëmi të paguhet nga :

a) personat fizikë apo juridikë të çdolloj industrie apo tregtie, kur vepra penale është kryer, nga punonjësit e tyre, përfaqësuesit apo administratorët në përmbushje të detyrimeve apo shërbimeve;

b) personat fizikë apo juridikë që zotërojnë makineri të afta për të krijuar rrezik për të tretët për veprat penale që kanë kryer me përdorimin e tyre asistentët, përfaqësuesit ose persona të tjerë të autorizuar;

c) institucionet publike të vendit, sipas përkatësisë, do të jenë përgjegjës subsidarë (shpeshmbështetës) për dëmet e shkaktuara nga ata që kanë kryer veprën penale, kur të dënuarit janë autoritete, agjentë dhe punonjës të institucioneve publike ose nëpunës civil që po kryejnë detyrat e tyre apo funksionet e zyrës dhe, dëmet janë shkaktuar drejtpërdrejtë nga veprimet e shërbimeve publike të ngarkuar atyre. Nëse në procesin penal kërkohet përgjegjësia civile, ajo u drejtohet bashkërisht administratës publike dhe subjektit të procedimit penal.

4. Nëse i dënuari ka kryer veprën penale duke përdorur komunikimin publik nepermjet medias, atëherë gjykata mund të urdhërojë që dëmi të paguhet nga :

a) personat fizikë ose juridikë që zotërojnë shtëpi botuese, gazeta, revista, çdo lloj mjeti komunikimi, stacione radio apo kanale televizive, ose çdo mjet tjetër të përhapjes me shkrim, të folur ose vizuale, për veprat penale të kryera duke përdorur median e tyre. Në këtë rast përgjegjësia civile e tyre trajtohet solidarisht me personin e dënuar;

5. Masa plotësuese e detyrimit për të paguar dëmin e shkaktuar përmban edhe pagimin e shpenzimeve për trajtimin mjekësor të viktimës të bëra si pasojë e nevojës për rikuperimin e shëndetit të tij mendor e fizik apo psikologjik për shkak të dëmtimit të pësuar prej veprimeve të autorit të veprës penale si dhe, çdo shpenzim tjetër të kryer po për të njëjtin shkak.

#### Neni 97

### **Regjistrimi i të dhënave**

1. Regjistrimi apo shkëmbimi i të dhënave që lidhen me gjeneralitetet e autorit që ka kryer krime drejtuar ndaj integritetit seksual të të miturve, është masë penale që synon të kontrollojë e parandalojë veprimtarinë e mundshme të ardhshme të tij në këtë fushë të kriminalitetit.

2. Në këtë rast, gjykata urdhëron prokurorin që menjëherë të njoftojë organet e zbatimit të ligjit për dhënien e masës.

3. Regjistrimi apo shkëmbimi i të dhënave që lidhen me vendimet gjyqësore që administrojnë sendet, mjetet e posaçme të kryerjes së veprës penale apo lidhur me veprat penale në fushën e sigurisë rrugore apo publike, kufitare, atyre me ndikim apo përhapje edhe nderkombetare, ushqimore apo kundër mjedisit për efekt të parandalimit të kryerjes së veprave të ngjashme në të ardhmen, kontrollin e kriminalitetit apo mundësisë që autori t'i shmanget kryerjes së dënimeve kryesore apo plotësuese të marra ndaj tij, gjykata, urdhëron prokurorin të njoftojë organet përkatëse për marrjen e kësaj mase me qëllim që ajo të ruhet për sa kohë rregullat e veçanta administrative e kërkojnë atë, të shkëmbehet me të interesuarit me qëllim bërjen efektive të dënimit të dhënë ose të pengojnë autorin të kryejë vepra të tilla në të ardhmen.

#### Neni 98

### **Kufizimi i lëvizjeve**

Kufizimi i lëvizjeve jepet nga gjykata ndaj autorëve të veprave penale kundër të miturve, për një periudhë nga dy deri në pesë vjet, dhe konsiston në ndalimin e tyre të afrohen në vende që frekuentohen zakonisht nga të miturit.

Neni 99

### **Kthimi në gjendjen e mëparshme**

Kthimi në gjendjen e mëparshme është masë penale që jepet nga gjykata ndaj personit fizik apo juridik që ka dëmtuar mjedisin, peizazhin mjedisor, kulturor apo çdo veprë penale kur është e mundur rikthimi në gjendjen e mëparshme të dëmit fizik të shkaktuar.

Neni 100

### **Kompensimi i viktimës**

1. Masa penale e kompensimit të viktimës jepet nga gjykata ndaj të gjithë autorëve të veprave penale kur ka rezultuar dëm material apo jo material dhe, përfshin krahas kompensimit pasuror edhe çdolloj tjetër kompensimi që vlerësohet i përshtatshëm për rikuperimin emocional, psikik, social apo shëndetësor të viktimës.

2. Në çdo rast, prokurori paraqet përpara gjykatës raport të qartë për nevojat e kompensimit të viktimës, mënyrat dhe mjediset e nevojshme për trajtim rikuperues të saj, vlerat e duhura monetare dhe çdo gjë tjetër që shërben për përmbushjen e këtij qëllimi.

Neni 101

### **Pezullimi i veprimtarisë**

Pezullimi i veprimtarisë që përbën vepër penale është masë që jepet nga gjykata ndaj një personi juridik, apo kur është rasti, edhe fizik, kur dëmi apo pasoja nga vepra është e rëndësishme, me kushtin që të mos jetë e njëjtë me dënimin kryesor ndaj personit juridik të parashikuar në nenin 121, paragrafi 3, shkronja “a” të këtij Kodi.

Neni 102

### **Detyrimi për të paguar shpenzimet procedurale**

Detyrimi për të paguar shpenzimet e gjithë procedimit penal jepet në çdo rast nga gjykata me paraqitjen e kërkesave prej palëve, apo edhe kryesisht kur rasti paraqitet i qartë.

Neni 103

### **Koha e fillimit të shlyerjes së dënimeve plotësuese dhe masave penale**

Kur gjykata, së bashku me një dënim me burgim, jep edhe një ose disa nga dënimet plotësuese apo masave penale të përmendura në këtë Kod, urdhëron njëkohësisht kohën dhe mënyrën e fillimit të shlyerjes, në përputhje me natyrën e përmbajtjes, zbatimit dhe efektit të tyre.

## Neni 104

### **Moszbatimi i dënimeve plotësuese**

Moszbatimi nga i dënuari i vendimit të gjykatës mbi dënimet plotësuese apo masave penale për shkak të mungesës së kontrollit apo kryerjes së rregullt së detyrës nga ana e personelit të shërbimit të provës, përbën veprën penale për subjektet e fundit, sipas parashikimeve në pjesën e posaçme të këtij Kodi.

## KREU II

### MASAT EDUKUESE DHE MJEKËSORE

#### SEKSIONI I

### MASAT EDUKUESE NDAJ TË MITURIT

## Neni 105

### **Masat edukuese dhe qëllimi i tyre**

1. Masat edukuese synojnë që të sigurojnë/garantojnë zhvillimin fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror të të miturit të grupmoshës 12-14 vjeç nën moshën për përgjegjësi penale, që ka kryer krim, të të miturit që ka përgjegjësi penale dhe përjashtohet nga dënimi, apo të të miturit që përbën rrezik për veten dhe të tjerët. Ato synojnë të trajtojnë dhe përfshijnë këto kategori të miturish në programe konkrete për korrigjimin, risocializimin, rehabilitimin dhe parandalimin e veprimtarisë së mëtejshme kriminale, duke i ofruar të miturit vëmendje, kujdes, ndihmë dhe mbikëqyrje si dhe, duke siguruar edukim, aftësim profesional, zhvilluar ndjenjën e përgjegjësisë së tij personale dhe përfshirjen e ardhshme të tij në një rol sa më të dobishëm në shoqëri.

2. Gjykata gjatë shqyrtimit të kërkesës për caktim mase edukuese ndaj të miturit vlerëson raportet e strukturave të posaçme të njohura me ligj apo rekomandon për ndërhyrjet që shërbimet e tyre duhet të kryejnë për riintegrimin e miturit, duke vlerësuar:

- a) kushtet, të cilat lehtësuan përfshirjen e fëmijës në krim;
- b) nivelin e rrezikshmërisë shoqërore dhe veprën e kryer;
- c) mjedisin, në të cilin është rritur dhe ka jetuar fëmija;
- ç) rrezikun apo mundësinë që fëmija të kryejë një veprën tjetër penale;
- d) çdo faktor tjetër, i cili mund të ndihmojë për të kuptuar dhe vlerësuar situatën e fëmijës.

## Neni 106

### **Llojet e masave edukuese**

1. Llojet e masave edukuese që mund të caktohen nga gjykata ndaj të miturve janë:

- a) këshillimi i të miturit;
- b) mbikëqyrja e veçantë e të miturit nga ana e prindit, prindit birësues ose kujdestarit;
- c) mbikëqyrja e të miturit në përkujdesje alternative;
- ç) vendosja e të miturit në një institucion të përkujdesjes edukativo–korrigjuese.

2. Vendimi gjyqësor për masat edukuese është i revokueshëm në çdo kohë kur ndryshojnë apo zhduken rrethanat për të cilat ai është dhënë. Në çdo rast, gjykata është e detyruar që pas kalimit

të gjashtë muajve nga dita e dhënies së vendimit ndaj të miturit të marrë në shqyrtim vendimin e parë të saj.

3. Rregullat për revokimin e vendimit gjyqësor që përmban masë edukuese, parashikohen në dispozitat vijuese të këtij Kodi dhe në Kodin e Procedurës Penale.

#### Neni 107

### **Caktimi i masave edukuese**

1. Në caktimin e masës edukuese ndaj të miturit gjykata mban parasysh rrethanat e kryerjes së krimit, personalitetin e të miturit, nevojat që lidhen me moshën, edukimin, arsimimin, kushtet personale, familjare, sociale dhe mjedisore, nevojat zhvillimore, si dhe nevoja të tjera të të miturit përfshirë, nëse është rasti, edhe nevojat e veçanta.

2. Gjkata respekton për sa është e arsyeshme radhën e masave edukuese, duke mbështetur parimin që, nuk mund të caktohet masa më e rëndë edukuese, nëse qëllimi mund të realizohet përmes një mase më të butë edukuese ndaj të miturit.

3. Në çdo lëndë dhe procedurë që ndiqet ndaj të miturit për caktimin e masave edukuese zbatohen për sa nuk bien në kundërshtim dhe, është e mundur parimet, garancitë dhe parashikimet e Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturin, si dhe të ligjit në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.

#### Neni 108

### **Këshillimi i të miturit**

1. Këshillimi gjyqësor caktohet ndaj të miturit kur nevojat edukativo-korrigjuese të tij përmbushen përmes zbatimit të një mase edukuese të tillë afatshkurtër edhe ngaqë, krimi është kryer nga pamaturia apo pakujdesia.

2. Këshillimi konsiston në informimin dhe shpjegimin që i bëhet të miturit në seancë gjyqësore për rrezikshmërinë e veprimeve të tij, të pasojave negative që shkaktojnë për viktimën dhe komunitetin, rëndësinë e respektimit të rregullave shkelja e të cilave përbën krim dhe, informimin rreth pasojave të shkeljes së tyre për të ardhmen e tij, të drejtave të viktimës dhe interesit publik të cenuar.

3. Gjkata cakton masën edukuese të këshillimit gjyqësor kur kjo masë konsiderohet e mjaftueshme dhe në interesin më të lartë të të miturit për të ndikuar pozitivisht dhe korrigjuar sjelljen e tij. Ai informohet se ka kryer një vepër të dëmshme dhe të rrezikshme e cila përbën krim, i bëhet me dije se nëse kryen përsëri të njëjtën vepër, apo tjetër, Gjkata do të caktojë ndaj tij një masë edukuese më të rëndë.

4. Këshillimi shoqërohet me detyrimin e të miturit për të vijuar rregullisht procesin edukativ-arsimor në institucionin përkatës arsimor.

5. Gjkata ngarkon Njësinë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës ose shërbimet sociale dhe/ose psikologjike të hartojnë një plan lidhur me mënyrën e zbatimit dhe monitorimit të këshillimit të të miturit, si dhe matjen e efekteve të tij hap pas hapi.

#### Neni 109

### **Mbikëqyrja e veçantë e të miturit nga ana e prindit, prindit birësues ose kujdestarit**

1. Masat edukuese të mbikëqyrjes së veçantë të të miturit nga ana e prindit, prindit birësues ose kujdestarit dhe të mbikëqyrjes së të miturit në përkujdesje alternative, caktohen ndaj të miturit kur nevojat edukativo/korrigjuese të tij përmbushen përmes zbatimit të tyre, për një periudhë nga tre muaj deri në dy vjet, nuk kërkojnë izolimin nga mjedisi i tij i mëparshëm familjar-social dhe, i garantojnë të miturit trajtimin shoqëror të nevojshëm.

2. Mbikëqyrja e veçantë e të miturit konsiston në lejimin e qëndrimit të të miturit pranë familjes, me kusht që të mbikëqyret nga afër në një apo më shumë nga veprimtaritë e mëposhtme:

- a) vijimi i procesit edukativo-arsimor në institucionin përkatës arsimor në mënyrë të rregullt;
- b) pjesëmarrja në veprimtari të shërbimeve parashoqërore;
- c) ndjekja e një trajtimi mjekësor apo këshillimi psikologjik;
- ç) ndalimi për të shkuar apo frekuentuar vende dhe persona të caktuar.

3. Gjykata cakton këtë lloj mase edukuese ndaj të miturit edhe kur prindi, prindi birësues apo kujdestari, që janë treguar të pakujdesshëm në ushtrimin e mbikëqyrjes prindërore, janë plotësisht të aftë dhe të gatshëm për të realizuar mbikëqyrjen e të miturit dhe, kur ajo është masa më e përshtatshme në interesin më të lartë të të miturit për të siguruar korrigjimin dhe edukimin e tij.

4. I mituri informohet se ai ka kryer një vepër të dëmshme dhe të rrezikshme e cila përbën krim, i bëhet me dije se nëse kryen përsëri vepër penale, gjykata do të caktojë ndaj tij një masë edukuese më të rëndë.

5. Masa edukuese monitorohet dhe përmban udhëzimet e nevojshme për të miturin dhe prindin si dhe urdhërimet për përmbushjen e detyrave të caktuara që janë pjesë e masës edukuese me qëllim garantimin e përkujdesjes, edukimit dhe mbikëqyrjes së të miturit në vijimësi.

6. Gjykata ngarkon Njësinë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës ose shërbimet sociale dhe/ose psikologjike që të hartojnë një plan lidhur me mënyrën e zbatimit dhe monitorimit të mbikëqyrjes së veçantë të të miturit, t'i ofrojnë ndihmën e nevojshme prindit, prindit birësues ose kujdestarit si dhe për matjen e efekteve të tij hap pas hapi.

## Neni 110

### **Mbikëqyrja e të miturit në përkujdesje alternative**

1. Mbikëqyrja e të miturit në përkujdesje alternative konsiston në zhvendosjen/transferimin e të miturit nga familja e tij tek i afërmi, pranë një familje tjetër e afërt kujdestare që përkujdeset për të apo edhe një institucioni të përkujdesjes sipas dispozitave të zbatueshme të Kodit të Familjes, nëse prindi, prindi birësues ose kujdestari është i paaftë për kryerjen e mbikëqyrjes së veçantë ndaj të miturit dhe shprehet se, është në pamundësi të ushtrimit të përgjegjësisë prindërore apo mbikëqyrur e korrigjuar sjelljen dhe edukimin e tij dhe, kur masa e tillë është në interesin më të lartë të të miturit. Masat e shënura në paragrafin e dytë të nenit 109, vlejnë edhe për këtë mbikëqyrje.

2. Gjykata e cakton masën edukuese ndaj të miturit vetëm me propozim të strukturave të mbrojtjes së fëmijës ose propozim të prindit, prindit birësues apo kujdestarit, në rast se është e pamundur që fëmija të lihet pranë familjes së tij ose kur fëmija përbën rrezik për veten dhe pas dëgjimit të prindit, prindit birësues ose kujdestarit për paaftësinë e pamundësinë e tij në ushtrimin e mbikëqyrjes së veçantë për edukimin e të miturit. Në këtë rast merret detyrimisht vlerësimi paraprak i sektorit të ndihmës dhe shërbimeve sociale, sipas dispozitave për kujdestarinë.

3. Masa edukuese monitorohet dhe përmban udhëzimet e nevojshme për të miturin, të afërmin/familjen kujdestare dhe urdhërimet për përmbushjen e detyrave të caktuara që janë pjesë e masës edukuese me qëllim garantimin e përkujdesjes, edukimit dhe mbikëqyrjes së të miturit në vijimësi.

4. Kohëzgjatja e masës edukuese përcaktohet nga nevojat e të miturit dhe, efektet e saj përfundojnë edhe para përfundimit të afatit të zbatimit të saj, kur prindi, prindi birësues apo kujdestari i të miturit shpreh gatishmërinë dhe është i aftë e në gjendje të ushtrojë mbikëqyrjen e veçantë ndaj të miturit apo kur, sipas rezultateve të monitoruara nga ekzekutimi i kësaj mase, del qartë se nuk ekziston më nevoja për mbikëqyrje të veçantë të të miturit ngaqë ai është korrigjuar.

5. Gjykata për zbatimin e masës edukuese, ngarkon Njësinë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës që të hartojë një plan lidhur me mënyrën e zbatimit dhe monitorimit të mbikëqyrjes së veçantë të të miturit nga i afërmi, familja tjetër e afërt, apo institucioni i përkujdesjes, t'i ofrojë ndihmën e nevojshme si dhe për matjen e efekteve të tij hap pas hapi.

Neni 111

### **Vendosja e të miturit në një institucion të veçantë të përkujdesjes edukativo–korrigjuese**

1. Masa edukuese e vendosjes së të miturit në një institucion të përkujdesjes edukativo-korrigjuese, caktohet kur nevojat edukativo-korrigjuese të tij përmbushen, si alternativë e fundit, vetëm përmes zbatimit të veçimit nga mjedisi i mëparshëm dhe, për një periudhë afatgjatë, që të miturit i ofron mundësinë e edukimit, riintegritit dhe rehabilitimit përmes trajtimit të nevojshëm institucional të organizuar.

2. Masa edukuese e dërgimit të të miturit në një institucion të veçantë të përkujdesjes caktohet nga gjykata në rastet kur:

a) i mituri ka kryer një krim të rëndë, i mituri ka nevojë për edukim të specializuar për korrigjimin e sjelljes dhe rishoqërimin e tij si dhe, kur një masë e tillë është në interesin më të lartë të të miturit;

b) i mituri që ka kryer një krim të lehtë, nevojat e të miturit nuk sigurohen nga asnjë prej alternativave të masave edukuese të mësipërme të zbatuara më parë ndaj tij, dhe kur një masë e tillë është në interesin më të lartë të të miturit;

c) i mituri me sjelljen dhe veprimet e tij përbën rrezik për të dëmtuar veten, vë në rrezik shëndetin, jetën, zhvillimin normal fizik, psikik, emocional e social të tij dhe, nevojat e të miturit nuk sigurohen nga asnjë prej alternativave të masave edukuese të mësipërme të zbatuara më parë ndaj tij dhe, kur një masë e tillë kërkohet nga strukturat e mbrojtjes së fëmijës apo vetë prindi, prindi birësues, kujdestari duke deklaruar shprehimisht paaftësinë për të mbikëqyrur e korrigjuar sjelljen dhe edukimin e të miturit dhe kur, një masë e tillë është në interesin më të lartë të të miturit.

2. Gjykata në caktimin e kësaj lloji mase edukuese merr parasysh rëndësinë dhe natyrën e veprës penale dhe faktin nëse ndaj të miturit më parë është caktuar masë edukuese.

3. Kjo masë edukuese jepet për një periudhë deri në dy vjet.

4. Institucionet e edukimit janë të detyruara t'i dërgojnë gjykatës çdo tre muaj një raport me informacion të hollësishëm që përmban përshkrimin e ecurisë së zbatimit të masës edukuese të caktuar ndaj të miturit dhe efektet e saj korrigjuese të arritura. Në rastet kur gjykata bindet që procesi i edukimit të të miturit ka rezultate pozitive dhe ai ka ndryshuar mënyrën e sjelljes, është ndërgjegjësuar për të kuptuar rëndësinë e respektimit të ligjit e të rregullave, urdhëron thirrjen e të

miturit në seancë dhe në prani të prindërve/kujdestarit vendos revokimin e masës edukuese duke i caktuar, sipas rastit, detyrime të veçanta për edukimin e tij.

#### Neni 112

### **Parashikime të veçanta lidhur me zbatimin e masave edukuese**

1. Në funksion të ekzekutimit të masave edukuese ndaj të miturve, gjykata cakton detyra për strukturën përkatëse të mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor apo çdo organi tjetër kompetent në monitorimin e masës edukuese, duke përfshirë:

- a) trajtimin e gjendjes psiko-emocionale të të miturit dhe mbikëqyrjen e edukimit të tij;
- b) ndihmën dhe krijimin e mundësive për prindërit për të mbajtur kontakte e marrëdhënie personale me fëmijët e tyre;
- c) sigurimin e largimit të të miturit nga çfarëdo ndikimi negativ;
- ç) lehtësimin e qasjes në kujdes të nevojshëm mjekësor;
- d) ofrimin e zgjidhjeve të mundshme për ndonjë problem që mund të shfaqet në jetën e të miturit;
- dh) çdo detyrë tjetër që çmohet se do të ishte në interesin e të miturit.

2. Struktura përkatëse e mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor apo çdo organ tjetër kompetent i raporton çdo dy muaj gjykatës që ka caktuar masën edukuese, mbi efektet që kanë rezultuar nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor në zbatimin e masës edukuese.

3. Marrja e masës edukuese për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative merr parasysh, për sa është e mundur, edhe ruajtjen e kontakteve mes motrave dhe vëllezërve.

4. Personat apo institucioni, pranë të cilit vendoset fëmija në përkujdesje alternative, kanë të njëjtat detyra, përgjegjësi dhe të drejta si ato të kujdestarit, të parashikuara në Kodin e Familjes, ndërsa prindërit e fëmijës, gjatë kohës së vlefshmërisë së masës edukuese sipas neneve 110 dhe 111 të këtij Kodi, nuk mund të ushtrojnë përgjegjësinë e tyre prindërore.

#### Neni 113

### **Detyrimet e veçanta ndaj të miturit**

1. Gjkata, kur cakton një nga masat edukuese të parashikuara në nenet 110 dhe 111 të këtij Kodi, në varësi të natyrës së veprës penale të kryer, cakton një ose më shumë detyrime të veçanta ndaj të miturit, nëse vlerëson se është e domosdoshme për arritjen e qëllimit të masës, me kusht që detyrimet e veçanta të përmbushen brenda afatit të masës edukuese të dhënë.

2. Detyrimet e veçanta janë:

- a) i mituri t'i kërkojë personalisht falje viktimës;
- b) t'i kompensojë dëmin viktimës në varësi të aftësisë paguese, gjendjes financiare të të miturit. Në pamundësinë personale të tij për zhdëmtim, zbatohen rregullat e nenit 96, paragrafi 2 të këtij Kodi;
- c) të vijojë rregullisht ndjekjen e procesit arsimor;
- ç) të kryejë një program edukativ, korrigjues dhe/ose mjekësor;
- d) të përmbushë detyrime të tjera që do të përforcojnë rishoqërimin e tij dhe parandalimin e rikryerjes së veprës penale;
- dh) të pranojë këshillim psikologjik;
- e) të mos frekuentojë vende ose mjedise të caktuara që kanë ndikim negativ tek i mituri;
- ë) të mos kontaktojë/takojë persona të caktuar;

- f) të mos largohet pa leje nga një vend ose nga një rajon administrativ i përcaktuar;
- g) të mos ndryshojë vendin e banimit;
- gj) të mos largohet nga shtëpia gjatë një periudhe/orari të caktuar;
- h) të ndalojë përdorimin e substancave narkotike, stimulantëve të tjerë apo alkoolit dhe, nëse është rasti, t'i nënshtrohet një programi trajtues mjekësor.

3. Gjykata në çdo kohë mund t'ia ndërpresë ose ndryshojë detyrimet e veçanta që i janë caktuar të miturit, kur rrethanat për të cilat ato janë dhënë nuk qëndrojnë më.

4. Nëse i mituri nuk përmbush detyrimet e veçanta të parashikuara në paragrafin dy të këtij neni, gjykata mund ta zëvendësojë masën edukuese me një masë tjetër edukuese më të rëndë.

5. Për detyrimet e caktuara sipas pikës “c”, “ç”, “d”, “dh”, “h” të këtij neni, njoftimi për masën detyruese, i përcillet edhe autoritetit përgjegjës në fushën e arsimit dhe/ose të programit edukativ, të shëndetësisë, çdo shërbimi tjetër të përfshirë dhe Njesisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës.

6. Kur urdhëron detyrimet e veçanta të parashikuara në paragrafin dy të këtij neni, gjykata e informon të miturin se mospërmbushja e tyre mund të passjellë zëvendësimin e masës edukuese të caktuar me një masë tjetër edukuese më të rëndë.

## SEKSIONI II MASAT MJEKËSORE

Neni 114

### **Masat mjekësore**

1. Masat mjekësore caktohen nga gjykata ndaj personave madhorë të papërgjegjshëm që në kohën kur kanë kryer veprën penale dhe për shkak të papërgjegjshmërisë përjashtohen nga vazhdimi i mëtejshëm i ndjekjes penale apo nga dënimi e vuajtja e tij.

2. Masë mjekësore jepet edhe ndaj të miturve të papërgjegjshëm që kanë mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe kanë kryer veprën penale, si dhe ndaj të miturve të papërgjegjshëm nën moshën për përgjegjësi penale të grupmohës 12-14 vjeç, që kanë kryer veprën penale dhe, për këtë shkak përbëjnë rrezik për veten apo për të tjerët.

3. Masat mjekësore që jepen ndaj personave madhorë, janë:

a) mjekimi i detyruar ambulator nën kujdesin e një familjari dhe ndjekjen e detyruar nga mjeku specialist;

b) mjekimi i detyruar në një institucion mjekësor të posaçëm.

4. Masat mjekësore që jepen ndaj të miturit janë:

a) mjekimi i detyruar ambulator, nën kujdesin e prindit, prindit adoptues apo kujdestarit dhe ndjekjen detyrimisht nga mjeku specialist;

b) vendosje për mjekim të detyruar në një institucion mjekësor të posaçëm, të përshtatshëm për të miturit.

5. Ndaj personave të çdo grup moshe që kanë kryer një krim për shkak të papërgjegjshmërisë si rrjedhojë e intoksikimit të plotë, gjykata cakton masën mjekësore të trajtimit të detyruar për disintoksikimin e tyre për një periudhë të domosdoshme për rehabilitimin nga varësia prej substancave që kanë sjellë intoksikimin. Kjo masë zbatohet në institucione të posaçme të njohura për shërbimin e ofruar dhe nën kujdesin e specialistëve të fushës.

6. Personeli i ngarkuar me ndjekjen dhe kurimin e personave të vendosur në mjekim apo trajtim të detyruar, çdo tre muaj duhet të njoftojë gjykatën për ecurinë e trajtimit të çdo personi. Raporti përmban elementet e domosdoshme të metodologjisë, kurimit dhe ndryshimit që subjekti ka shfaqur për shkak të trajtimit.

#### Neni 115

### **Revokimi i masave**

1. Vendimi gjyqësor për masat edukuese dhe mjekësore të çdo lloji është i revokueshëm në çdo kohë kur ndryshojnë apo zhduken rrethanat për të cilat ai është dhënë. Në çdo rast, bazuar në paragrafin e gjashtë të nenit 114, por edhe kryesisht, gjykata është e detyruar që pas kalimit të gjashtë muajve nga dita e dhënies së vendimit ndaj të miturit dhe pas kalimit të një viti nga dita e dhënies së vendimit ndaj madhorit, të marrë në shqyrtim vendimin e parë të saj.

2. Rregullat për revokimin e vendimit gjyqësor që përmban masën mjekësore dhe edukuese, parashikohen në dispozitat vijuese të këtij Kodi dhe në Kodin e Procedurës Penale.

#### Neni 116

### **Subjektet dhe procedura e caktimit të masave mjekësore**

1. Kur arrihet në përfundimin se janë kushtet për marrjen e masës mjekësore ndaj personit që ka kryer veprë penale, prokurori paraqet në gjykatë kërkesën për të gjykuar faktin penal. Pas vërtetimit të kryerjes së veprës prej personit, rrezikshmërisë dhe faktit të papërgjegjshmërisë së tij, gjykata e themelit urdhëron caktimin e masës mjekësore në përputhje me nevojat e rehabilitimit. Fajësia e personit për veprën e kryer nuk deklarohet.

2. Nën të njëjtën procedurë, për aq sa është e zbatueshme, prokurori kërkon vendosjen e masës së përshtatshme mjekësore edhe ndaj personit që bie në gjendje papërgjegjshmërie përgjatë kohës së vuajtjes së dënimit penal.

3. Procedura e caktimit të masës mjekësore parashikuar në këtë dispozite, për shkak të natyrës së rastit, rasti gjykohet drejtpërdrejtë nga gjykata e themelit.

4. Rregullat e parashikuara në nenin 46 të Kodit të Procedurës Penale janë të zbatueshme për aq sa nuk bien ndesh me parashikimet e kësaj dispozite.

#### Neni 117

### **Masa mjekësore e mjekimit të detyruar ambulator për të miturin**

1. Gjukata për të miturit cakton masën e mjekimit të detyruar ambulator nën kujdesin e prindit, prindit birësues apo kujdestarit dhe ndjekjen detyrimisht nga mjeku specialist të të miturit që shfaq apo vuan nga çrregullime të shëndetit mendor, kur i sigurohet asistenca e specializuar mjekësore dhe trajtimi i posaçëm mjekësor në gjendje të lirë për rikuperimin e shëndetit mendor dhe, kur kjo është në interesin më të lartë të tij. Ato synojnë të sigurojnë trajtimin e specializuar dhe kujdesin e duhur mjekësor të të miturit.

2. Gjukata që ka caktuar masën mjekësore ndaj të miturit është e detyruar që edhe kryesisht, çdo gjashtë muaj të rishikojë nevojën për vijueshmërinë ose jo të saj. Mjeku përgjegjës për shëndetin

mendor të të miturit është i detyruar të referojë në gjykatë në afatet dhe rregullat e përcaktuara në nenin 114, paragrafi 6 të këtij Kodi.

#### Neni 118

### **Masa mjekësore e vendosjes së të miturit në një institucionin mjekësor të posaçëm**

1. Gjykata cakton masën e vendosjes për mjekim të detyruar në një institucion mjekësor të posaçëm të të miturit që shfaq apo vuan nga çrregullime të shëndetit mendor kur nevojat e tij për asistencë të specializuar mjekësore nuk mund të përmbushen nëpërmjet masës së mjekimit të detyruar ambulator, kur të miturit i nevojitet trajtim i specializuar mjekësor institucional për rikuperimin e shëndetit mendor dhe, kur kjo është në interesin më të lartë të tij. Ato synojnë të sigurojnë trajtimin e specializuar dhe kujdesin e duhur mjekësor të të miturit.

2. Gjykata që ka caktuar masën mjekësore ndaj të miturit është e detyruar që edhe kryesisht, çdo gjashtë muaj të rishikojë nevojën për vijueshmërinë ose jo të saj. Mjeku përgjegjës për shëndetin mendor të të miturit është i detyruar të referojë në gjykatë në afatet dhe rregullat e përcaktuara në nenin 114, paragrafi 6 të këtij Kodi.

#### Neni 119

### **Subjektet dhe procedura e caktimit të masave edukuese dhe mjekësore ndaj të miturit**

1. Në çdo situatë që dikton marrjen e masës edukuese apo mjekësore ndaj të miturit nën moshën e përgjegjësisë penale, sipas rastit, prokurori apo policia gjyqësore njoftojnë Njësinë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, si dhe kanë detyrimin ligjor të bashkërendojnë veprimtarinë e tyre për të siguruar efektivitetin dhe minimizimin e kohëzgjatjes së procedurës për kërkimin dhe caktimin e masës edukuese apo mjekësore ndaj të miturit.

2. Në shqyrtimin e rasteve me të miturit, për mbrojtjen e interesit më të lartë të tyre dhe të drejtësisë, gjykata kujdeset maksimalisht të nxjerrë të vërtetën, përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, rreth kryerjes apo jo të veprës penale nga ai, me qëllim për të shmangur çdo atribuum, vetinkriminim apo përdorim që mund t'i jetë bërë të miturit nga persona të tretë.

3. Kur konkludohet se janë kushtet për marrjen e masave ndaj të miturit që ka kryer vepër penale, prokurori paraqet në gjykatë kërkesën për të gjykuar faktin penal. Pas vërtetimit të kryerjes së veprës prej të miturit dhe faktit të papërgjegjshmërisë së tij, gjykata e themelit urdhëron caktimin e masës mjekësore apo edukuese në përputhje me nevojat e rehabilitimit të të miturit. Fajësia e tij për kryerjen e veprës penale nuk deklarohet.

4. Prokurori përkatës pranë Gjykatës së të Miturve ka detyrimin e paraqitjes në gjykatë të kërkesës për caktim mase mjekësore për të miturit që kanë mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe diktohet nevoja e caktimit të masës mjekësore ndaj tij, bazuar në përcaktimet edhe të nenit 46 të Kodit të Procedurës Penale.

5. Prokurori përkatës pranë Gjykatës së të Miturve ka detyrimin e paraqitjes në Gjykatë të kërkesës për caktim mase edukuese apo mjekësore për të miturit nën moshën e përgjegjësisë penale. Oficeri

i policisë gjyqësore i specializuar në çështjet e të miturve dhe/apo Njësia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, kur gjatë veprimtarisë së tyre konstatojnë raste për zbatimin e masave të tilla, i drejtohen me kërkesë prokurorit për vendosjen e tyre, duke përfshirë dhe detyrimet vijuese:

a) të shoqërojë kërkesën me gjithë dokumentacionin e nevojshëm;

b) të marrë pjesë në gjykimin e shqyrtimit të kërkesës;  
c) të marrë masat mbrojtëse për të miturin nëse këto janë të nevojshme sipas legjislacionit për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës dhe Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit si dhe, në bashkëpunim me mbrojtësin ose në mungesë të tij në bashkëpunim me të miturin dhe përfaqësuesin ligjor, të garantojë shërbimet juridike, psikologjike, sociale, mjekësore e çdo shërbim tjetër të nevojshëm sipas rastit dhe nevojave të të miturit përgjatë gjithë procesit.

6. Specialisti/Përfaqësuesi i Njësisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve është personi mbështetës i të miturit dhe ndër të tjera, ka për detyrë:

a) të mbështesë të miturin emocionalisht;  
b) të japë mbështetje gjatë gjithë procesit gjyqësor. Kjo ndihmë mund të përfshijë masa për minimizimin e pasojave negative të veprës penale, masa për të ndihmuar të miturin në veprimtarinë e përditshme dhe masa në raport me çështjet administrative që lidhen me rrethanat e rastit konkret;  
c) të këshillojë nëse ndjekja e një terapie ose këshillimi profesional është i nevojshëm;  
ç) të ruajë komunikimin me të afërmit, shokët dhe mbrojtësin e të miturit;  
d) të informojë/aksesojë të miturin në shërbimet juridike, shëndetësore, psikologjike ose sociale;  
dh) të informojë të miturin për pozitën e tij procedurale, rëndësinë e masës edukuese, kohëzgjatjen, formën, si dhe për rregullat procedurale të caktimit të saj;  
e) të informojë të miturin për të drejtën për ankim ndaj vendimit gjyqësor.

7. Prindi, prindi birësues, kujdestari kanë të drejtën e paraqitjes së kërkesës në gjykatë për caktim apo zëvendësim mase edukuese apo mjekësore ndaj të miturit nën moshën e përgjegjësisë penale.

8. Në procedurën e caktimit apo zëvendësimit dhe shqyrtimit të kërkesës për masë edukuese apo mjekësore ndaj të miturit, pjesëmarrja dhe mbikëqyrja e prokurorit dhe Njësisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve është e detyrueshme dhe po ashtu është i detyrueshëm edhe bashkërendimi i veprimtarisë mes tyre.

Neni 120

### **Mosekzekutimi i vendimeve për masë edukuese apo mjekësore**

Moszbatimi i detyrimeve të veçanta të caktuara nga gjykata në funksion të ekzekutimit të vendimeve për caktim mase edukuese apo mjekësore, nga ana e subjekteve të ngarkuara nga vendimi gjyqësor për ndjekjen e tyre, përbën vepër penale sipas parashikimit në pjesën e posaçme të këtij Kodi.

## **KREU III**

### **DËNIMET PENALE NDAJ PERSONAVE JURIDIKË**

Neni 121

#### **Dënimet për personat juridikë**

1. Në zbatimin e dënimeve të caktuara ndaj personave juridikë, mbahen parasysh, për aq sa janë të zbatueshme, të gjitha rregullat mbi caktimin e dënimeve të parashikuara në këtë Kod.

2. Gjykata mund të zbatojë dënimet kryesore të mëposhtme:

a) gjoba të përshtatshme me pasojën e ardhur;  
b) mbarimin e personit juridik.

3. Kur shihet e arsyeshme dhe e dobishme për qëllim të efekteve të dënimit penal, gjykata cakton edhe një apo disa dënime plotësuese:

- a) pezullimin e veprimtarisë për një periudhë tërësore jo më shumë se pesë vjet;
- b) mbylljen e mjediseve të punës së kompanisë;
- c) ndalimin për të kryer në të ardhmen veprimtarinë nëpërmjet të cilës është kryer vepra penale;
- ç) ndalimin për të përfituar ndihmë nga shteti;
- d) ndalimin për të hyrë në marrëdhënie kontraktore me sektorin publik ose të përfitojë lehtësira fiskale;
- dh) kthimin e përfitimeve dhe ndihmave të marra nga shteti për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike, për një periudhë prej dhjetë vjetësh;
- e) caktimin e një mbikëqyrësi ligjor;
- ë) detyrimin e personit juridik që brenda tre muajve të marrë të gjitha masat organizative të kërkuara nga paragrafi i pestë i nenit 24 të këtij Kodi;
- f) detyrimin për publikimin e vendimit gjyqësor, si dënim plotësues.

4. Gjkata, në rastet që vlerëson me vend, mund të japë edhe një apo disa nga masat penale të parashikuara në nenin 70 të këtij Kodi, për aq sa ato përputhen me natyrën dhe veprën penale të kryer nga personi juridik.

5. Gjatë hetimeve paraprake, mbyllja e mjediseve të punës së kompanisë, bllokimi i aseteve materiale dhe financiare, pezullimi i veprimtarisë që përbën vepër penale, caktimi i një mbikëqyrësi ligjor, ndalimi i zhvillimit të promocionit apo publicitetit ose reklamimit të shërbimeve të kompanisë për një periudhë të caktuar, marrjen e masave të domosdoshme sipas paragrafit pesë të nenit 24 të këtij Kodi, mund të vendosen si masa të sigurimit nga ana e gjyqtarit të hetimeve paraprake.

6. Konfiskimi, si dënim plotësues i përcaktuar në nenin 77, paragrafi 6 të këtij Kodi, është i zbatueshëm nga gjykata për çdo rast që përmban kriteret e shënuara në atë dispozitë.

## Neni 122

### **Bazat e caktimit të dënimit ndaj personit juridik**

1. Për dënimet penale ndaj personit juridik, të ndryshme nga gjobat, gjykata përkrah rregullave të përgjithshme për mënyrën e caktimit të dënimit dhe bazat ku mbështetet ai të parashikuara në këtë Kod, ka parasysh edhe:

- a) nevojën për të parandaluar vazhdimin e veprimtarisë kriminale ose pasojat e saj;
- b) pasojat ekonomike dhe shoqërore;
- c) pasojat për punëtorët;
- ç) pozicionin në strukturën e personit juridik dhe organin përkatës që ka kryer shkeljen.

2. Gjkata, me qëllim që të përcaktojë llojin proporcional të dënimit penal të parashikuar në nenin 121 të këtij Kodi, ndaj personit juridik që ka kryer një vepër penale, vlerëson edhe:

- a) faktin nëse ka qenë ose jo përsëritës në kryerjen e veprave penale;
- b) nëse është përdorur si mjet nga autorët për të fshehur përgjegjësinë e tyre penale apo zhvendosur qëllimin e ligjshëm të formimit të personit juridik drejt veprimtarisë së paligjshme.

## Neni 123

### **Dënimi me gjobë**

1. Dënimi me gjobë konsiston në pagimin, në favor të shtetit, të një shume të hollash të përshtatshme me pasojën e ardhur, brenda kufijve të parashikuar në këtë Kod.

2. Personi juridik përgjegjës për kryerjen e një veprë penale mund të dënohet me gjobë sa pesëfishi i masës së gjobës së parashikuar në nenin 74 të këtij Kodi, me përjashtim të rasteve kur pjesa e posaçme e këtij Kodi parashikon ndryshe.

3. Shlyerja e dënimit me gjobë bëhet nga pasuritë e personit juridik të dënuar, sipas mënyrës dhe afateve që caktohen nga gjykata.

4. Gjukata në përcaktimin e vlerës së gjobës ndaj personit juridik, përtej konfiskimit të produkteve të veprës penale, merr parasysh përfitimin e marrë prej tij, dëmin e shkaktuar, vlerën e sendit apo shumën e përfituar në mënyrë të paligjshme. Këto kritere nuk përjashtojnë rregullat e përgjithshme të shënuara në këtë Kod për mënyrën e caktimit të dënimit penal.

5. Gjyba mund të paguhet me këste në një afat deri në pesë vjet nga dita kur vendimi penal bëhet i ekzekutueshëm, në rastet e mëposhtme:

- a) kur personi juridik rrezikon mbijetesën;
- b) për ruajtjen e vendeve ekzistuese të punës; ose,
- c) kur i shërben interesit të përgjithshëm.

6. Në rast pamundësie apo pengese në shlyerjen e dënimit me gjobë, gjykata, me kërkesë të prokurorit, vendos ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit të dënimit. Nëse personi juridik nuk disponon fonde dhe pasuri për shlyerjen e dënimit me gjobë, gjykata mund ta zëvendësojë atë me dënimin e mbarimit të personit juridik.

#### Neni 124

### **Mbarimi i personit juridik**

1. Mbarimi i personit juridik, për shkak të përgjegjësisë për kryerjen e veprës penale, jepet kur ekziston njëra nga shkaqet e mëposhtme:

- a) është themeluar me qëllim kryerjen e veprës penale;
- b) ka përdorur në një masë të rëndësishme fushën e veprimtarisë së tij për t'i shërbyer kryerjes së veprës penale;
- c) kanë ardhur pasoja të rënda nga kryerja e veprës penale.

2. Mbarimi i personit juridik, për shkak të përgjegjësisë për kryerjen e veprës penale, mund të jepet edhe në rastet e kryerjes së veprës penale më shumë se një herë dhe për rrethana të tjera rënduese sipas këtij Kodi.

3. Vendimi për mbarimin e personit juridik realizohet nëpërmjet procedurave për likuidimin e detyruar të tij nga organet kompetente, sipas ligjit. Pjesa e të ardhurave dhe e pasurive që, në përfundim të procedurës së likuidimit të detyruar të personit juridik, rezultojnë të jenë mjete apo produkte të veprës penale konfiskohen.

4. Mbarimi i personit juridik, shkakton humbjen e personalitetit juridik, mundësisë për të marrë pjesë në transaksione ligjore, ose të ndërmarrjes së ndonjë veprimtarie, qoftë edhe të ligjshme.

#### Neni 125

### **Pezullimi i veprimtarisë**

1. Pezullimi i veprimtarisë së personit juridik, për shkak të përgjegjësisë për kryerjen e veprës penale, jepet nga gjykata për një kohë deri në pesë vjet, kur ajo është vendosur si masë sigurimi gjatë hetimeve paraprake.

2. Pezullimi i veprimtarisë së personit juridik jepet nga gjykata kur gjatë ushtrimit apo për shkak të këtyre veprimtarive është kryer vepra penale, ose kur çmohet se personi juridik i ka shpërdoruar ato.

#### Neni 126

### **Mbyllja e mjediseve të punës**

Mbyllja e mjediseve të punës jepet nga gjykata, kur mjediset e punës së personit juridik janë të papërshtatshme dhe në shkelje të standardeve të parashikuara nga legjislacioni i posaçëm për ushtrimin e kësaj veprimtarie.

#### Neni 127

### **Ndalimi i ushtrimit të një apo më shumë veprimtarive**

1. Ndalimi i ushtrimit, drejtpërdrejt ose jo, të një ose më shumë veprimtarive të personit juridik, mund të jepet nga gjykata për një kohë nga një deri në dhjetë vjet, kur gjatë ushtrimit apo për shkak të këtyre veprimtarive është kryer vepra penale, ose kur çmohet se personi juridik i ka shpërdoruar ato.

2. Ndalimi i përhershëm i ushtrimit drejtpërdrejt ose jo të një ose më shumë veprimtarive të personit juridik, jepet nga gjykata kur ato janë përdorur në kryerjen e një krimi, që ka sjellë pasoja të rënda dhe çmohet se mbajtja e tyre nuk pajtohet me natyrën e veprës penale të kryer.

#### Neni 128

### **Ndalimi për të përfituar ndihmë nga shteti**

1. Ndalimi për të përfituar ndihmë nga shteti ose për të marrë pjesë drejtpërdrejt ose jo në transaksione dhe shpërndarje të fondeve publike, për të hyrë në marrëdhënie kontraktore dhe procedura të prokurimit të fondeve publike me institucione shtetërore, qendrore apo vendore, persona të tjerë juridikë publikë ose të kontrolluar nga ata ose për të përfituar lehtësira fiskale, jepet për një kohë prej dhjetë vjetësh, kur çmohet se ka efekt parandalues ose pajtohet me natyrën e veprës së kryer.

2. Detyrimi për kthimin e përfitimeve dhe ndihmave të marra nga shteti për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike jepet nga gjykata kur vlerëson që subjekti ka shpërdoruar ndihmat e marra, nuk është sjellë në mënyrë të arsyeshme me administrimin e tyre apo ka devijuar destinacionin e përdorimit të tyre.

#### Neni 129

### **Caktimi i një mbikëqyrësi ligjor**

1. Caktimi i një mbikëqyrësi ligjor jepet nga gjykata për një kohë nga një deri në pesë vjet, kur çmohet se një masë e tillë ka efekt parandalues ose pajtohet me natyrën e veprës së kryer.

2. Përveç sa parashikohet në paragrafin e parë të këtij neni, caktimi i një mbikëqyrësi ligjor mund të jepet nëse:

- a) personi juridik ofron shërbime dhe kryen veprimtari në interes publik;
- b) për shkak të rrethanave ekonomike dhe shoqërore, që lidhen me llojin, përmasat dhe vendin ku zhvillohet veprimtaria e personit juridik, çmohet se zbatimi i dënimeve më të rënda të parashikuara të jepen ndaj personit juridik të parashikuara në nenin 121 të këtij Kodi sjell pasoja të rënda në punësim, në zhvillimin ekonomik e shoqëror dhe në mbrojtjen e mjedisit.

3. Gjykata përcakton mbikëqyrësin apo mbikëqyrësit ligjorë për t'u kujdesur për ruajtjen e të drejtave të punonjësve apo kreditorëve deri në afatin që çmohet e nevojshme prej saj.

4. Brenda kompetencave të përcaktuara nga gjykata, mbikëqyrësi kujdeset edhe për zbatimin dhe përmbushjen me sukses të modeleve të organizimit dhe kontrollit efektiv për parandalimin e veprës penale.

5. Mbikëqyrësi ligjor, të paktën një herë në katër muaj, i paraqet gjykatës një informacion të hollësishëm, me shkrim, për mënyrën e përmbushjes së detyrave dhe të kompetencave të tyre. Një kopje e informacionit i dërgohet edhe prokurorit.

6. Gjykata, me kërkesën e personave të interesuar apo të prokurorit, pas shqyrtimit të informacionit dhe shpjegimeve të mbikëqyrësit ligjor, mund të vendosë heqjen e masës së caktimit të një mbikëqyrësi ligjor ose zëvendësimin e tij me një dënim të ri.

#### Neni 130

### **Ndalimi për të kërkuar publikisht fonde dhe për të reklamuar veprimtarinë**

1. Ndalimi i personit juridik për të kërkuar publikisht fonde, burime financiare dhe garanci, për t'iu drejtuar për këtë qëllim bankave, institucioneve financiare dhe tregut të kapitaleve, ose për të reklamuar veprimtarinë e tij, jepet nga gjykata për një kohë nga një deri në tre vjet, kur çmohet se ka efekt parandalues ose pajtohet me natyrën e veprës së kryer.

2. Në rastin e përgjegjësisë për kryerjen e një krimi që sipas këtij Kodi parashikohet një dënim me burgim mbi shtatë vjet ose burgim i përjetshëm, dënimi jepet për një afat jo më pak se dy vjet.

#### Neni 131

### **Detyrimi për publikimin e vendimit gjyqësor**

1. Publikimi i vendimit gjyqësor ose i njoftimit rreth përmbajtjes së tij, nëpërmjet shtypit të shkruar, llojeve të tjera të organeve të informimit publik, shpalljeve në vende të caktuara dhe mënyrave të tjera të informimit urdhërohet nga gjykata, kur çmohet se njohja e tij publikisht ka interes për personat fizikë dhe juridikë.

2. Publikimi i pjesshëm ose tërësor i vendimit gjyqësor, mënyrat, organet e shtypit, ditët dhe kohëzgjatja e publikimit caktohen nga gjykata. Shpenzimet e publikimit të vendimit gjyqësor janë në ngarkim të personit juridik të dënuar.

3. Organet e shtypit dhe të radiotelevizionit janë të detyruara të bëjnë publikimin e vendimit gjyqësor të dërguar nga gjykata.

4. Publikimi i vendimit gjyqësor nuk bëhet kur cenohet jeta private e viktimave të veprës penale dhe e personave të tjerë, përveç rasteve kur ata japin pëlqimin, kur preket morali shoqëror ose kur rrezikohet përhapja e sekretit shtetëror.

## Neni 132

### **Kriteret e caktimit dhe pagimit të gjobës**

1. Gjykata në përcaktimin e vlerës së gjobës ndaj personit juridik, përtej konfiskimit të të ardhurave nga vepra penale, vlerëson përfitimin e marrë prej saj, dëmin e shkaktuar, vlerën e sendit apo shumën e përfituar në mënyrë të paligjshme. Këto kritere nuk përjashtojnë rregullat e përgjithshme të shënuara në këtë Kod për mënyrën e caktimit të dënimit penal.

2. Për personat juridikë, masa e gjobës që mund të caktohet ndaj tyre është sa pesëfishi i parashikuar në nenin 74 të këtij Kodi, përveç kur pjesa e posaçme e Kodit Penal ka parashikuar dënime të ndryshme me gjobë.

3. Mënyra e pagimit të gjobës me këste ndaj personit juridik në një afat deri në pesë vjet nga dita kur vendimi penal bëhet i ekzekutueshëm, është e lejuar kur:

- a) rrezikon mbijetesën e personit juridik;
- b) ruajtjen e vendeve ekzistuese të punës;
- c) kur i shërben interesit të përgjithshëm.

## Neni 133

### **Përjashtimi i personave juridikë nga përgjegjësia penale**

1. Personat juridikë, të padënuar më parë, në rastet kur vepra penale është kryer nga përfaqësuesit e tyre, shkarkohen nga përgjegjësia nëse plotësojnë bashkërisht kushtet e mëposhtme:

- a) kallëzimin e veprës penale tek autoritetet përpara se sa këto të marrin dijëni për të;
- b) bashkëpunojnë në çdo fazë të hetimit paraprak të çështjes duke paraqitur prova të cilat janë të reja dhe vendimtare për të qartësuar përgjegjësinë penale që rrjedh prej fakteve;
- c) zëvendësojnë apo pakësojnë dëmin e shkaktuar nga vepra penale në çdo fazë të procedimit, por përpara se sa të fillojë shqyrtimi gjyqësor i provave;
- ç) të vendosë, përpara se sa të fillojë shqyrtimi gjyqësor i provave, masa efektive për të parandaluar dhe zbuluar vepra penale që mund të kryen në të ardhmen me mjetet apo nën hijen e personit juridik.

2. Rregullat dhe kriteret e parashikuara në këtë Kod rreth përjashtimit nga dënimi penal të personit fizik, për aq sa nuk bien ndesh, janë të zbatueshme edhe për personin juridik.

## Neni 134

### **Ekzekutimi i dënimit për personat juridikë**

1. Ekzekutimi i dënimeve penale ndaj personit juridik, për aq sa janë të zbatueshme, ndjek rregullat e përcaktuara në ligjin për ekzekutimin e dënimeve penale.

2. Të gjitha entet rregullatore apo kontrolluese që veprojnë në fushat përkatëse të veprimtarisë së personit juridik në varësi të llojit të dënimit penal që duhet ekzekutuar, marrin masat përkatëse për të zbatuar vendimin e dënimit në përputhje me urdhrin e ekzekutimit të lëshuar nga prokurori.

## KREU V

### CAKTIMI I DËNIMIT

SEKSIONI I  
INDIVIDUALIZIMI I DËNIMIT PENAL

Neni 135

**Rregulla të përgjithshme për caktimin e dënimit**

1. Gjykata cakton dënimin duke respektuar dispozitat e pjesës së përgjithshme të këtij Kodi dhe kufijtë e dënimeve të parashikuara në ligj për veprën penale.

2. Në mënyrë të përgjithshme, në caktimin e dënimit, gjykata merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe përcakton qartë efektin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese në mënyrën e parashikuar në dispozitat më poshtë.

3. Gjykata, në rastin në shqyrtim, identifikon qëllimin parësor mbi të cilin mbështet arsyet kryesore të caktimit të dënimit penal, pikë së pari rrezikshmërinë bazë që përmban vepra penale e kryer dhe, me pas elementet e tjera të saj.

4. Kur vepra penale ka mbetur në tentativë, dënimi penal caktohet në varësi të rëndësisë së veprës penale, afërsisë apo mundësisë së ardhjes së pasojës dhe zbatohen lehtësirat e përcaktuara në dispozitat e këtij Kodi mbi tentativën. Rregullat e përcaktuara në këtë Kod që lidhen me përgjegjësinë e bashkëpunëtorëve janë të zbatueshme edhe në rastin kur vepra ka mbetur në tentativë.

Neni 136

**Ndikimi i rrethanave për efekt të caktimit të dënimit**

1. Rrethanat lehtësuese apo rënduese, që përbëjnë shkak të natyrës personale, mund të lehtësojnë apo rëndojnë përgjegjësinë e personave që i përmbushin këto rrethana.

2. Gjykata, në rastet kur vepra penale është kryer në bashkëpunim, nuk mund të përdorë si rrethana për lehtësimin apo rëndimin e dënimit për bashkëpunëtorët e tjerë, shkaqet që lidhen ekskluzivisht me një person.

3. Kur nuk gjenden rrethana lehtësuese apo rënduese, dënimi për veprën penale të kryer do të jepet ashtu siç vlerësohet e përshtatshme nga gjykata, në vlerësim të rëndësisë së saj, të rrethanave konkrete të kryerjes së veprës, të pasojave të ardhura dhe elementeve që lidhen me personin që e ka kryer atë.

4. Kur rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese konkurrojnë me njëra-tjetrën do të vlerësohen dhe kompensohen në mënyrë racionale për të individualizuar dënimin bazuar në vlerën e tyre në raport me rëndësinë e veprës së kryer. Në rastin e përparësisë së ndonjëres prej tyre përkundrejt tjetrës gjykata zbaton rregullat e efektit përkatës të përcaktuar në këtë ligj.

Neni 137

**Rrethanat lehtësuese**

1. Lehtësojnë dënimin rrethanat që vijojnë:

a) kur vepra është kryer nën ndikimin e tronditjes psikike të shkaktuar nga provokimi ose veprime të padrejta të viktimës apo të ndonjë personi tjetër të lidhur me të;

b) kur vepra është kryer nën ndikimin e veprimeve apo të udhëzimeve të padrejta të eprorit;

c) kur personi që ka kryer veprën tregon pendim të thellë shfaqur me ndryshimin e sinqertë të sjelljes ndaj viktimës, ndaj veprës që ka kryer, reflekton pozitivisht në mënyrë të besueshme, kontribuon në zbulimin e së vërtetës dhe veprime të tjera që të japin besim se autori nuk do të kryejë më vepër penale;

ç) kur personi ka zëvendësuar dëmin, material dhe/apo moral, të shkaktuar nga vepra penale ose ka ndihmuar aktivisht për të zhdukur ose pakësuar pasojat e veprës penale;

d) kur personi paraqitet në organet kompetente pas kryerjes së veprës penale dhe bashkëpunon për zbulimin e rrethanave të kryerjes së veprës;

dh) kur marrëdhëniet ndërmjet personit që ka kryer veprën penale dhe viktimës janë normalizuar;

e) kur bashkë me personin është dënuar edhe personi juridik;

ë) kur, në varësi nga vepra penale, autori ka publikuar me shpenzimet e veta, ndjesën e tij për cenimin e bërë ndaj figurës, personalitetit, reputacionit apo jetës familjare të viktimës;

f) kur autori i veprës penale paraqet zhvillim të metë mendor, por jo në gjendje papërgjegjshmërie ndaj veprës penale.

2. Lidhur me rrethanat lehtësuese të parashikuara nga shkronjat “ç” dhe “dh” të këtij neni, palët, nën autoritetin e prokurorit, përcaktojnë kushtet thelbësore që përmban zëvendësimi i dëmit apo normalizimi i marrëdhënieve me qëllim sigurimin e marrëveshjes së drejtë e të vullnetshme.

3. Përveç rrethanës së parashikuar në shkronjën “e” të këtij neni, të gjitha të tjerat duhet të jenë të pranishme që në fazën e hetimeve paraprake.

4. Në çështjet që lidhen me dhunën në familje apo vepra penale në dëm të të miturve, rrethanat lehtësuese zbatohen nën kushtin e parashikimeve konkrete që dispozitat e pjesës së posaçme të këtij Kodi kanë rregulluar trajtimin tërësor të tyre.

5. Për qëllim të caktimit të dënimit ndaj personit juridik, rrethanat që lehtësojnë dënimin të shënuara në paragrafin e parë të këtij neni janë të zbatueshme për aq sa përshtaten me natyrën e subjektit dhe rregullat e tjera që duhet të ndiqen sipas parashikimeve të këtij Kodi.

#### Neni 138

### **Zbatimi i praktikës gjyqësore**

1. Gjykata, pavarësisht nga rrethanat lehtësuese të përmendura në nenin 137, mund të marrë në konsideratë edhe rrethanat të tjera për sa ky Kod ka parashikuar në dispozita të tjera ose, nëse praktikata gjyqësore i kanë pranuar si të tilla që justifikojnë lehtësimin e dënimit.

2. Pjesa e posaçme e këtij Kodi, apo ligje penale jashtë tij, për aq sa lidhen me objektin e rregullimit të tyre, mund të përmbajnë rrethana të tjera lehtësuese që merren parasysh nga gjykata në caktimin e dënimit.

#### Neni 139

### **Ndikimi i rrethanave lehtësuese në caktimin e dënimit**

1. Nëse gjykata vëren praninë e dy rrethanave lehtësuese dhe të asnjë rrethane rënduese, jep një dënim jo më të lartë se një e dyta e dënimit që parashikon dispozita përkatëse. Ky rregull nuk zbatohet në rastet kur vepra penale parashikon dënim në maksimum mbi pesëmbëdhjetë vjet burgim.

2. Nëse gjykata vëren praninë e një rrethane lehtësuese dhe, kur vepra penale është kryer nga pakujdesia apo është kundërvajtje penale, atëherë zbatohet rregulli i paragrafit më lart.

3. Kur autori i veprës penale është një i ri prej moshës 18 deri në 21 vjeç, prania e tre apo më shumë rrethanave lehtësuese dhe asnjë rënduese, mund të lejojë gjykatën për të trajtuar të dënuarin si të mitur. Ky rregull nuk zbatohet për veprat penale që, sipas dispozitës së posaçme, dënohen në maksimum mbi dhjetë vjet burgim.

4. Në rastet kur është e pranishme rrethana e parashikuar nga shkronja “f” e nenit 137.1, pasi vlerëson të gjitha rrethanat për caktimin e dënimit, në varësi nga shkalla e zhvillimit të metë të personit, gjykata lehtëson dënimin deri në një të katërtën e tij.

5. Rrethana lehtësuese, e parashikuar në shkronjën “dh” të paragrafit të parë të nenit 137, lehtëson dënimin e një personi që ka kryer një vepër penale ndaj fëmijëve apo një vepër penale të dhunës në familje nëse dispozita përkatëse e pjesës së posaçme të këtij Kodi e lejon një gjë të tillë, apo ajo rregullon mënyrën e procedimit nëse vepra penale ndiqet mbi ankimin e viktimës. Në të kundërt, rrethana lehtësuese sipas shkronjës “dh” nuk ka efekt.

## Neni 140

### **Rrethanat rënduese**

1. Rrethanat që rëndojnë dënimin, përveç se kur përbëjnë elementet e veprës, të ndonjë vepre tjetër penale ose, rrethana të cilësuar të saj të parashikuara në pjesën e posaçme të këtij Kodi, janë:

a) kryerja e veprës i shtyrë nga motive që shoqërojnë dashjen e personit në kryerjen e atyre veprave penale që në përmbajtjen e tyre nuk kanë rrethanë cilësuese kryerjen e veprës mbi bazën e një motivi;

b) kryerja e veprës për të vënë para përgjegjësisë ose për të fshehur përgjegjësinë penale të një tjetri apo, për të shmangur dënimin për një vepër penale tjetër ose, për të realizuar, ose për të siguruar për vete a për të tretët fitime pasurore, ose çdo lloj përfitimi tjetër material;

c) kur autori i veprës penale, në mënyrë të vullnetshme dhe çnjerëzore e ka bërë viktimën të lëngojë duke i shkaktuar asaj vuajtje dhe dëmtime të panevojshme për arritjen e qëllimit të kryerjes së veprës;

ç) kryerja e një krimi pas dhënies së një dënimi për një krim të kryer më parë. Për qëllim të kësaj dispozite një dënim i mëparshëm i shuar ose që duhej shuar për shkak rehabilitimi apo parashkrimi të ekzekutimit të tij, nuk përbën rrethanë rënduese;

d) kryerja e veprës penale pas vendosjes së personit nën mbikëqyrje elektronike;

dh) kryerja e veprimeve që rëndojnë apo shtojnë pasojat e veprës penale, nëse veprimet e mëvonshme nuk përbëjnë elemente të ndonjë vepre tjetër penale ose rrethana të cilësuar të saj;

e) kryerja e veprës penale duke shpërdoruar funksionin publik ose shërbimin fetar;

ë) kur vepra është kryer kundër fëmijëve, grave shtatzëna ose personave që për shkaqe të vulnerabilitetit, nuk mund të mbrohen;

f) kryerja e veprës penale gjatë ose pas dhënies së urdhrave gjyqësorë të mbrojtjes nga dhuna në familje kur janë në lidhje ndërmjet tyre;

g) kur vepra është drejtuar ndaj përfaqësuesve të shteteve të tjera;

gj) kur vepra është kryer duke përfituar nga marrëdhëniet familjare, të bashkëjetesës, të miqësisë, të mikpritjes;

h) kur kryerja e veprës penale në bashkëpunim, përveçse kur parashikohet që vepra penale është kryer nga një bashkëpunim i veçantë i cili dënohet më vete nga pjesa e posaçme e këtij Kodi;

i) kryerja e veprës penale më shumë se një herë. Do të quhet vepër e kryer më shumë se një herë ajo vepër e dytë, e cila është e njëjtë me të parën ose hyn në të njëjtën kategori objekti të mbrojtur nga ligji penal;

j) kur vepra është kryer duke përdorur armë, municione luftarake, lëndë plasëse, djegëse, helmuese dhe radioaktive;

k) kur vepra është kryer e shtyrë nga motive që kanë të bëjnë me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, ksenofobinë, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike ose aftësinë e kufizuar apo çdo motiv tjetër i papranueshëm i pranuar gjerësisht si i tillë edhe nga ky Kod;

l) kur vepra penale kryhet me paramendim nëpërmjet fshehjes së abuzimit me epërsinë, ose përfitimit të përparësisë nga rrethana të vendit, kohës ose ndihmës prej personave të tjerë, të cilat shkaktojnë dobësimin e mbrojtjes së viktimës apo të lehtësojnë mosndëshkimin e personit;

ll) kur personi kryhen veprën penale duke përfituar nga gjendja e nevojës së viktimës;

m) kur vepra penale është kryer me paramendim për të fituar shpërbllim, përfitim të çfarëdollojshëm apo premtim të tillë;

n) kur personi shfrytëzon statusin e tij publik për të kryer veprën penale;

nj) kryerja e veprës penale në mënyrë të hapur duke sfiduar rendin juridik e publik, nevojën për siguri të qytetarëve dhe bindjen ndaj sistemit të normave juridike;

o) në rastin kur bashkohen të paktën dy cilësitë e bashkëpunëtorit si ekzekutor, organizator dhe nxitës, në të njëjtin person.

2. Për qëllim të ligjit penal, me motiv përmendur në shkronjën “a” të paragrafit të parë të këtij neni do të kuptohet çdo shtysë e brendshme e deformuar në padobishmëri shoqërore që formon arsyen përse autori kërkon të arrijë qëllimin për kryerjen e veprës penale dhe, përmbahet e shprehur në xhelozinë, zilinë, smirën, hakmarrjen, gjakmarrjen, kotësinë, lakminë, përtacinë, epshin, makutërinë apo krenarinë.

3. Për efekt të caktimit të dënimit për personat juridikë, rrethanat që rëndojnë dënimin të shënuara në paragrafin e parë të këtij neni, për aq sa janë të zbatueshme, do të konsiderohen të tilla edhe në rastet e caktimit të dënimit për ta.

4. Rrethanat rënduese duhet të shënohen qartësisht në aktin e ngritjes së akuzës nga ana e organit procedues pasi ka hetuar edhe lidhur me to përgjatë hetimit për tërësinë e faktit penal.

## Neni 141

### **Ndikimi i rrethanave rënduese në caktimin e dënimit**

1. Kur vërtetohet prania e të paktën një rrethane rënduese, gjykata jep dënimin penal mbi një të dytën e masës së dënimit që përmban dispozita penale konkrete.

2. Nëse rrethanat rënduese janë tre apo më shumë, atëherë masa e dënimit që jep gjykata është jo më pak se tre të katërtat e maksimumit të dënimit të parashikuar nga dispozita e posaçme.

3. Në rastin e pranisë së rrethanës rënduese që lidhet me kryerjen disa herë të të njëjtës vepre penale apo të së njëjtës natyre për shkak të objektit të njëjtë të prekur, gjykata përpos dënimit të personit për aq herë sa vepra ka kryer, rrit dënimin edhe me deri një të pestën e shumës së dënimeve të dhëna.

4. Në rastin e pranisë së rrethanës rënduese që lidhet me kryerjen e një krimi për të cilin personi është dënuar më parë, gjykata përpos dënimit të personit, rrit dënimin edhe me deri një të tetën e dënimit të ri për shkak të përsëritjes së përgjithshme.

5. Në rastin e pranisë së rrethanës rënduese që lidhet me kryerjen e një krimi të kryer me dashje të të njëjtit lloj ose natyrë për të cilin personi është dënuar më parë, gjykata rrit dënimin e caktuar me një të katërtën për shkak të përsëritjes së posaçme.

6. Në veprat penale të kryera nga pakujdesia rregullat e paragrafëve më sipër nuk zbatohen.

7. Për qëllim të kësaj dispozite një dënim i mëparshëm i shuar ose që duhej shuar për shkak rehabilitimi apo parashkrimi të ekzekutimit të tij, nuk përbën rrethanë rënduese.

#### Neni 142

### **Dënimi me burgim për të miturit**

1. Për të miturit, që në kohën e kryerjes së veprës penale nuk kanë mbushur moshën 18 vjeç, dënimi me burgim vendoset në përputhje me rregullimet e Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit.

2. Kur i mituri ka kryer dy apo më shumë vepra penale, zbatohen urdhërimet e këtij Kodi mbi bashkimin e dënimeve në njërën prej mënyrave të caktuara në nenet 150, 151 dhe 153 të këtij Kodi, por asnjëherë më shumë sesa njëzet e pesë vjet burgim.

3. Personat deri në 21 vjeç në rastet kur plotësojnë kriteret e përcaktuara në dispozitat e këtij ligji, barazohen me të miturit deri në 18 vjeç.

#### Neni 143

### **Përfshirja e të miturit nga dënimi**

1. Në rastin kur, për çfarëdolloj shkak është e pamundur shmangia e të miturit nga procedimi penal, gjykata, nisur nga rrezikshmëria e pakët e veprës penale, nga rrethanat konkrete të kryerjes së saj, nga sjellja e mëparshme e të miturit, mënyra e rritjes dhe edukimit, problemeve të shfaqura përgjatë rritjes në familjen e tij, nga nevoja e tij për të ndjekur procesin edukativ, mësimor apo shoqëror të domosdoshëm, jetës së bashku me vëllezër e motra apo arsyet e tjera të përmendura në Kodin e Drejtësisë Penale për të Miturit, mund ta përfshijë atë nga dënimi.

2. Në këto raste, nëse masat e tjera alternative të parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur vlerësohen si të paefektshme për rishoqërimin dhe riedukimin e të miturit, gjykata vendos dërgimin e tij në një institucion edukimi. Në të gjitha rastet gjykata vlerëson së pari interesin më të lartë të të miturit.

#### Neni 144

### **Përfshirja ose ulja e dënimit për bashkëpunëtorët e drejtësisë dhe viktimat**

1. Personi që ka premtuar, ofruar, propozuar ose ka dhënë shpërblim ose përfitime të tjera, që sipas dispozitave të posaçme të këtij Kodi përbëjnë korrupsion aktiv, mund të përfitojë përfshirje nga dënimi, ose ulje të tij nëse bën kallëzim dhe jep ndihmesë aktive në procedimin penal të këtyre veprave, me kushtin që të mos jetë ai që të ketë ofruar më parë premtimin, shpërblimin apo përfitimin. Në dhënien e vendimit gjykata mban parasysh kohën e arsyeshme kur është bërë kallëzimi në raport me kryerjen e veprës, kontributin e personit për hetimin e saj, ardhjen ose jo të pasojave apo rëndësinë e veprës penale konkrete.

2. Edhe personi që është duke vuajtur dënimin penal për kryerjen e njëres prej krimeve të parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni, mund të përfitojë uljen e dënimit apo shuarjen e tij nëse, gjatë kohës së vuajtjes së dënimit penal jep kontribut thelbësor në hetimin e rasteve të tjera të kryerjes së krimeve të tilla.

3. Viktima e krimeve që lidhen me trafikimin e personit, përjashtohet nga fillimi i procedimit penal ose dënimi për kryerjen e krimeve gjatë periudhës së trafikimit kur shkaqet që e kanë detyruar t'i kryejë veprimet apo mosveprimet e kundërligjshme janë të lidhura ngushtësisht me pozicionin e saj si viktimë e trafikimit dhe nën ndikimin e tij. Kur është rasti, prokurori kërkon në gjykatën e seancës paraprake pushimin e procedimit duke parashtruar hollësisht të gjitha shkaqet që e kanë çuar viktimën në kryerjen e veprimeve në kundërshtim me ligjin.

4. Personi që ka kryer njëren nga veprat penale që ka lidhje me trafikun e narkotikëve, armëve apo municioneve, trafikimin e personave ose për vepra penale të kryera nga strukturat e bashkëpunimit të posaçëm, që bashkëpunon dhe ndihmon organet e ndjekjes penale në luftën kundër tyre ose, sipas rastit, në zbulimin e personave të tjerë, që kryejnë krime të tilla, nuk mund të dënohet më tepër se gjysma e dënimit të parashikuar për veprën e kryer prej tij. Në raste të veçanta, ky person mund të përjashtohet nga dënimi kur konkurrojnë edhe rrethana lehtësuese në favor të tij dhe bashkëpunon në çdo fazë të procedimit duke paraqitur të dhëna të cilat janë të reja dhe vendimtare për të qartësuar përgjegjësinë penale që rrjedh prej fakteve.

5. Paragrafi i parë dhe i katërt i këtij neni janë të zbatueshëm edhe ndaj bashkëpunëtorit, nëse ai, me vullnetin e tij të plotë, përpara se sa vepra penale të kryhet apo të tentohet thelbësisht të kryhet, pavarësisht rolit të dhënë deri në atë çast, pavarësisht nëse vepra është kryer nga të tjerë apo ka mbetur në tentativë, bën veprime serioze për të shmangur kryerjen e saj edhe duke kallëzuar në organet e rendit publik.

#### Neni 145

### **Ulja e dënimit nën kufijtë e parashikuar nga ligji**

1. Gjykata, në rastet kur vepra penale e kryer nga i pandehuri dënohet në minimumin e saj jo më shumë se sa pesë vjet burgim, kur çmon që ajo është kryer në rrethana rastësore dhe, autori i saj gjendet i përfshirë për shkaqe të rënda ekonomike, familjare apo personale, tregon pendim të thellë për veprën e kryer, për rrjedhojë paraqet rrezikshmëri të pakët, ka kontribuar përgjatë zhvillimit të hetimeve duke furnizuar me prova organin procedues, kur janë të pranishme më shumë se sa tre nga rrethanat lehtësuese dhe asnjë rrethanë rënduese, ka të drejtë të caktojë një dënim nën minimumin ose një lloj dënimi më të butë se ai që parashikon dispozita përkatëse.

2. Kjo dispozitë nuk zbatohet ndaj përsëritësve në krim, ata që kanë kryer veprat penale të korrupsionit të çdo forme, ata që kanë kryer veprat penale të trafikimit të lëndëve narkotike, veprat penale kundër drejtësisë apo për veprat penale të kryera nga persona në format e veçanta të bashkëpunimit.

#### Neni 146

### **Zëvendësimi i dënimit me burgim me pagimin e një shume të hollash në favor të shtetit**

1. Gjykata, në rastet kur është kryer një vepër penale e lehtë dhe autori i saj përmbush të gjitha kriteret e tjera të përshkruara në paragrafin e parë të neni 145 të këtij Kodi, me kërkesë të tij, mund të vendosë zëvendësimin e dënimit me burgim me pagimin e një shume të hollash në favor të

shtetit, duke llogaritur një ditë burgim me gjashtë mijë lekë. Gjykata shpall vendimin e pazëvendësuar dhe cakton afatin dhjetë ditor si kufi brenda të cilit i dënuari duhet të paguajë shumën e gjobës që konverton kohën e dënimit me burgim. Pagesa e të hollave në favor të shtetit bëhet pas dhënies së vendimit.

2. Ky zëvendësim nuk mund të vendoset pa dëgjuar viktimën, nëse ka, dhe prokurorin.

3. Kjo dispozitë nuk zbatohet në rastet e veprave penale të kryera nga nëpunësit publikë, veprat penale të korrupsionit, veprat penale kundër drejtësisë, atyre të trafikimit të çdolloji, kundër të miturve apo dhunës në familje.

#### Neni 147

### **Pranimi i pagimit të gjobës**

1. Për kundërvajtjet penale për të cilat, veç gjobës, parashikohet njëkohësisht dënimi me burgim, gjykata, me kërkesën e autorit të kundërvajtjes penale pranon që ai të paguajë aty për aty një shumë të hollash në favor të buxhetit të shtetit, e barabartë me gjysmën e maksimumit të gjobës së parashikuar për kundërvajtjet penale në pjesën e përgjithshme të këtij Kodi.

2. Kërkesa mund të paraqitet në çdo fazë të gjykimit deri përpara dhënies së vendimit përfundimtar të shkallës së parë.

#### Neni 148

### **Llogaritja e paraburgimit**

Koha e paraburgimit ose e arrestit në shtëpi, llogaritet në dënimin me burgim ose me gjobë, si dhe në detyrimin për kryerjen e një pune në interes publik, si më poshtë:

- a) një ditë paraburgim baras me një ditë burgim;
- b) një ditë paraburgim baras me shtatë mijë lekë gjobë;
- c) një ditë paraburgim baras me njëzet orë pune në interes publik;
- ç) një ditë arrest shtëpie është e barabartë me një ditë burgim;
- d) një ditë arrest shtëpie është e barabartë me tre mijë lekë gjobë;
- dh) një ditë arrest shtëpie është e barabartë me pesëmbëdhjetë orë pune në interes publik.

## SEKSIONI II

### DËNIMI PËR DISA VEPRA PENALE

#### Neni 149

### **Konkurrimi i normave penale**

1. Veprimet që mund të cilësohen juridikisht sipas dy ose më shumë dispozitave të këtij Kodi vlerësohen si vepra penale më vete nëse kanë prekur apo rrezikuar të prekin objekte të ndryshme normash të mbrojtura nga ligji penal.

2. Në rastet e konkurrimit të normave, vepra penale e veçantë në çdo rast do të zbatohet përpara asaj të përgjithshme dhe, jepet një dënim i vetëm.

3. Norma penale më e rëndë ose përfundimtare do të përthithë normat e tjera të prekura përgjatë realizimit të veprës penale më të rëndë kur, janë parashikuar si veprime ose mosveprime të kundërligjshme dhe përfshihen në natyrën e normës më të rëndë.

4. Norma ndihmëse do të zbatohet vetëm në mungesë të asaj kryesore, si në rastet kur zëvendësimi është i përmendur shprehimisht në normë, ashtu dhe kur është i nënkuptuar.

5. Në mungesë të kritereve të mësipërme, norma penale që parashikon dënim më të rëndë do të përjashtojë ato që parashikojnë dënime më të lehta për faktin që përbën vepër penale.

6. Pjesa e posaçme e këtij Kodi nuk përmban rrethana cilësuese që lidhen me përsëritjen apo kryerjen e veprës penale më shumë se një herë, ndaj do të zbatohet vepra penale konkrete aq herë sa është kryer ajo në varësi të numrit të viktimave prej saj, përveç rastit të paragrafit të parë të nenit 152 të këtij Kodi.

#### Neni 150

### **Caktimi i dënimeve për një veprim**

1. Kur veprimi ose mosveprimi përmban elementet e disa veprave penale, me një veprim të vetëm janë kryer dy a më shumë vepra penale apo kur, njëra vepër penale ka shërbyer për të kryer tjetrën pazgjidhshmërisht, gjykata më parë cakton dënimin për çdo vepër penale dhe, në përfundim jep një dënim të vetëm që përbëhet:

a) nga dënimi më i rëndë që ka caktuar për njërën nga veprat penale, por jo nëse njëra prej tyre dënohet në maksimum deri në dhjetë vjet burgim;

b) ose dënimin më të rëndë të shtuar kur njëra prej tyre dënohet mbi dhjetë vjet burgim.

2. Në rastin kur me një veprim janë kryer tre apo më shumë vepra penale dënimi i bashkuar nuk mund të jetë më i ulët sesa bashkimi aritmetik i dy masave më të larta të dënimeve të dhëna, pavarësisht kufirit më të lartë të burgimit të parashikuar në nenin 72 të këtij Kodi, por asnjëherë më shumë sesa dyzet vjet burgim.

3. Gjukata në vendimin përfundimtar jep një ose më shumë nga dënimet plotësuese të dhëna më vete për çdo vepër të veçantë.

#### Neni 151

### **Caktimi i dënimit për disa veprime**

1. Kur personi ka kryer disa veprime që shkaktojnë respektivisht disa vepra penale për të cilat nuk është dhënë ende vendim, gjykata më parë cakton dënimin për çdo vepër penale dhe në përfundim jep një dënim të vetëm, që përbëhet nga dënimi më i rëndë i shtuar.

2. Dënimi më i rëndë i shtuar, në rastin kur personi ka kryer një krim kundër jetës me dashje, apo humbja e jetës së viktimës vjen nga veprimet me dashje të personit, përbëhet nga shuma e përgjithshme e dënimeve të dhëna për secilën vepër penale, në rastet kur të paktën dy prej tyre përmbajnë mundësinë e dënimit edhe njëzet vjet burgim, pavarësisht kufirit më të lartë të burgimit të parashikuar në nenin 72 të këtij Kodi, por gjithmonë jo më shumë sesa dyzet e pesë vjet burgim.

3. Dënimi më i rëndë i shtuar, për të gjitha veprat penale të tjera të ndryshme nga parashikimi në paragrafin e dytë, nuk mund të kapërcejë shumën e përgjithshme të dënimeve të caktuara veç e veç, as kufirin më të lartë të parashikuar për llojin e dënimit të dhënë.

4. Në rastin kur janë kryer tre apo më shumë vepra penale dënimi i dhënë nuk mund të jetë më i ulët sesa bashkimi aritmetik i dy masave më të larta të dënimeve të dhëna, pavarësisht kufirit më të lartë të burgimit të parashikuar në nenin 72 të këtij Kodi, por gjithmonë jo më shumë sesa 40 vjet burgim.

5. Gjykata në vendimin përfundimtar jep një ose më shumë nga dënimet plotësuese të dhëna më vete për çdo vepër të veçantë.

#### Neni 152

##### **Krimi vazhdues**

1. Kushdo që me veprim ose mosveprim, në përmbushje të të njëjtit mendim kriminal, kryen të njëjtin krim që tipikisht arrihet të kryet vetëm në këtë mënyrë, me të njëjtat veprime kriminale apo të ngjashme, ndaj të njëjtit objekt të dëmtuar, vlerësohet se po kryen një krim vazhdues dhe, do të dënohet vetëm një herë për veprimet e konsideruara si një të vetme, në bazë të pasojës më të rëndë të ardhur. Në këtë rast gjykata, në varësi të veprimeve të dënueshme të kryera nga autori, shton dënimin deri në trefishin e dënimin të caktuar, por jo më shumë se sa dyfishi i maksimales së dënimin që parashikohet për krimin në dispozitën penale përkatëse.

2. Në veprat penale kundër pasurisë dënimi do të marrë parasysh të gjithë dëmin e ardhur.

3. Rregulli i paragrafit të parë nuk zbatohet për veprat penale kundër nderit e dinjitetit, atyre që lidhen me lirinë seksuale, dhunën në familje apo kur viktimja janë të miturit.

#### Neni 153

##### **Bashkimi i dënimeve**

1. Kur i dënuari, para vuajtjes së plotë të dënimin, dënohet për një vepër penale të kryer para dhënies së vendimit të parë, zbatohen të njëjtat rregulla të dispozitave përkatëse për caktimin e dëmit kur janë kryer disa vepra penale. Në varësi të llojit të konkurrencimit të tyre, pjesa e vuajtur e dënimin llogaritet në dënimin e ri në njërin nga mënyrat e përcaktuara në nenet 150 dhe 151 të këtij Kodi.

2. Kur i dënuari, pas dhënies së vendimit, por para vuajtjes së plotë të dënimin, kryen një vepër penale të re, gjykata bën bashkimin e dënimin të ri me pjesën e mbetur të dënimin të mëparshëm, duke ndjekur rregullat e parashikuara nga nenet 150 dhe 151 të këtij Kodi.

#### Neni 154

##### **Periudha e sigurisë**

1. Gjykata, me dhënien e vendimit përfundimtar cakton edhe një periudhë të sigurisë brenda të cilës nuk lejohet zbatimi i lirimin para kohe me kusht. Ajo shpreh vlerësimin e arsyeve përse e cakton periudhën e sigurisë duke pranuar efektin parandalues të këtij elementi të vendimit, ndikimin të rehabilitimiti i përgjithshëm i viktimës, nevojës së përmirësimit të rendit e sigurisë publike si dhe, pengimit të veprimtarisë së mëtejshme kriminale të të dënuarit.

2. Për dënimet me burgim të dhëna nga 20 vjet e lart apo me burgim të përjetshëm, caktimi i periudhës së sigurisë është i detyrueshëm.

3. Në rastin kur gjykata cakton dënimin me burgim ndaj të dënuarit që ka kryer një veprë penale të rëndë, kur vlerëson të dobishme, mund të vendosë edhe caktimin e një periudhe sigurie, gjatë së cilës nuk lejohet zbatimi i lirit para kohe me kusht, sidomos kur është e pranishme njëra nga këto rrethana:

a) kur autori i veprës penale, në mënyrë të vullnetshme dhe çnjerëzore e ka bërë të lëngojë viktimën duke i shkaktuar asaj vuajtje dhe dëmtime të panevojshme për arritjen e qëllimit të kryerjes së veprës;

b) kur vepra është kryer kundër fëmijëve, grave shtatzëna ose personave që, për shkaqe të ndryshme, nuk mund të mbrohen;

c) kur kryerja e veprës penale është shtyrë nga motive që kanë të bëjnë me gjininë, racën, fenë, kombësinë, gjuhën, bindjet politike, fetare ose sociale;

ç) kur vepra është kryer duke përfitur nga marrëdhëniet familjare ose të bashkëjetesës.

4. Periudha e sigurisë mund të shtrihet për afatin kohor nga tre të katërtat e dënimit të dhënë nga gjykata deri në kohëzgjatjen e plotë të dënimit penal.

5. I dënuari lejohet të bëjë ankim edhe vetëm ndaj urdhërimit të gjykatës lidhur me periudhën e sigurisë të caktuar prej saj.

## KREU VI

### ZËVENDËSIMI DHE ALTERNATIVAT E DËNIMIT ME BURGIM

#### SEKSIONI I

#### ALTERNATIVAT E DËNIMIT DHE ZËVENDËSIMI I TIJ

##### Neni 155

#### **Zëvendësimi i dënimit të shkurtër me burgim me një lloj tjetër dënimi**

1. Gjkata kur çmon të caktojë në vendimin përfundimtar dënim me burgim deri në tre vjet, mund ta zëvendësojë atë me lirinë e kontrolluar. Mendimi i prokurorit dhe viktimës së veprës penale është i detyruar të dëgjohet në seancë.

2. Zbatimit i paragrafit të parë të këtij neni mund të kërkohet nga i dënuari edhe pranë gjykatës së ekzekutimit përpara se të fillojë ekzekutimi i dënimit me burgim.

3. Asnjë masë alternative për zëvendësimin e dënimit me burgim nuk jepet nëse ajo nuk kërkohet nga autori i veprës penale.

4. Viktima e veprës penale ka të drejtë të ankojë vendimin gjyqësor që pranon zëvendësimin e dënimit me burgim me një alternative të tij dhe lirinë para kohe me kusht.

##### Neni 156

#### **Kriteret e përgjithshme të zëvendësimit të burgimit**

1. Gjkata në vlerësimin e mundësisë së zëvendësimit të dënimit të shkurtër me burgim në një lloj tjetër dënimi, bazohet në kriteret e përgjithshme të caktimit të dënimit dhe individualizimit të tij, duke zgjedhur dënim më të përshtatshëm për riintegrimin e të dënuarit në shoqëri.

2. Nëse gjykata vlerëson se i dënuari nuk do të respektojë detyrimet që rrjedhin nga zëvendësimi i dënimit me burgim me kohëzgjatje të shkurtër në një lloj tjetër dënimi, apo bie ndesh me nevojën e sigurisë publike, nuk e zëvendëson atë.

#### Neni 157

### **Kushtet e zëvendësimit të burgimit të shkurtër me një lloj tjetër dënimi**

1. Personat që janë dënuar për disa vepra penale, edhe nëse prej bashkimit të dënimeve, rezultojnë të dënuar deri në dy vjet, apo ata që kanë kryer vepër penale brenda periudhës pesëvjeçare nga dënimi i mëparshëm, nuk përfitojnë nga mundësia e zëvendësimit të dënimit të shkurtër me një lloj tjetër dënimi.

2. Personat që janë dënuar për vepra penale të shoqëruara me përdorimin e dhunës fizike a psikike, krime seksuale kundër të miturve, apo për dhunë në familje, apo në bashkëpunim në forma të posaçme në organizata, grupe të strukturuar kriminale apo banda, apo korrupsionit të të gjitha llojeve, apo për vepra penale kundër sistemit të drejtësisë dhe rendit publik, apo krime financiare dhe në fushën e taksave, tatimeve dhe shoqërive tregtare, nuk mund të përfitojnë nga mundësia e zëvendësimit të dënimit të shkurtër me burgim me një lloj tjetër dënimi.

3. Gjykata mund të vendosë të refuzojë zëvendësimin e dënimit të një të dënuari me burgim edhe për vepra të tjera penale nga ato të parashikuara në paragrafin e mësipërm, kur ka shkaqe të bazuara lidhur me parandalimin e posaçëm të dala edhe përgjatë fazës së ekzekutimit të vendimit.

#### Neni 158

### **Zëvendësimi i dënimit me burgim për personat e rinj**

1. Gjykata, kur me dhënien e vendimit të dënimit, vlerëson të caktojë një dënim me burgim deri në tre vjet, për personat e rinj deri në 21 vjeç, mund ta zëvendësojë burgimin me lloje të tjera dënimi zëvendësues, si puna në interes publik e konvertuar me ditët e burgimit ose qëndrimi në burgim vetëm në fundjavë deri në përfundimin e periudhës së parashikuar të dënimit me burgim.

2. Kushtet dhe kriteret e shënuara në nenet 156 dhe 157 të këtij Kodi janë të detyrueshme edhe në rastin e parashikimeve të paragrafit më sipër.

#### Neni 159

### **Llojet e dënimeve alternative**

Gjykata, kur vëren se janë plotësuar kushtet e kriteret përkatëse për zëvendësimin e dënimit me burgim, jep një nga këto dënime alternative:

- a) Liri të kontrolluar;
- b) Gjysmëliri;
- c) Qëndrim në shtëpi;
- ç) Pezullim të ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënie në provë të të dënuarit;
- d) Kusht detyrues për të hequr dorë nga përdorimi i alkoolit ose drogës;
- dh) Pezullim të ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimin për kryerjen e një pune në interes publik;
- e) pezullim të procedimit dhe vënie në provë të të pandehurit;
- ë) pagim të gjobës për kundërvajtjet penale;

f) qortim gjyqësor.

Neni 160

### **Liria e kontrolluar**

1. Liria e kontrolluar konsiston në zbatimin e vullnetshëm të këtyre detyrimeve kryesore prej të dënuarit:

a) për të mos u larguar nga vendbanimi ose vendqëndrimi i tij, përveç rasteve kur është autorizuar paraprakisht nga mbikëqyrja ligjore për arsye studimi, pune, kualifikimi ose aftësimi profesional, apo për nevojën për trajtim ose arsye shëndeti, apo nevoja familjare;

b) për t'u larguar ose për të mos qëndruar në një njësi administrative të caktuar për një periudhë kohore të përcaktuar nga gjykata;

c) për t'u paraqitur një herë në ditë pranë policisë gjyqësore në orën e caktuar. Organet mbikëqyrëse mbajnë parasysh oraret dhe arsyet e studimit, punësimit, apo ato shëndetësore;

ç) për të mos mbajtur asnjë lloj arme zjarri apo të ftohtë, municion, eksploziv;

d) të respektojë ndalimin për të drejtuar mjete kur është pezulluar leja e drejtimit të mjetit;

dh) të respektojë ndalimin për të dalë jashtë shtetit;

e) të respektojë detyrimin për të njoftuar policinë gjyqësore për ndryshimin e adresave dhe arsyeve kur të lëvizë;

ë) të paraqitet pranë shërbimit të provës për t'u këshilluar lidhur me riintegrimin e tij në shoqëri dhe çdo detyrim tjetër të vendosur nga gjykata.

2. Në varësi të llojit të veprës penale të kryer, cilësive personale të të pandehurit dhe efektit që do të sjellë zbatimi i detyrimeve të parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni për riintegrimin e tij në shoqëri, gjykata vendos ndaj tij një apo disa detyrime që janë sa më pranë këtij qëllimi.

Neni 161

### **Gjysmëliria**

1. Gjukata kur çmon të caktojë në vendimin përfundimtar dënim me burgim deri në tre vjet, mund ta zëvendësojë dënimin me gjysmëlirinë bazuar në rrethanat ngushtësisht personale të personit të dënuar, që lidhen me punën, arsimin, kualifikimin ose aftësimin e tij profesional, përgjegjësitë thelbësore familjare apo, nevojën për trajtim ose rehabilitim mjekësor. Rrethanat e cituara vlerësohen edhe më vete nëse rëndësia e tyre është jetike për të ardhmen e personit në rastin në shqyrtim.

2. Kushtet dhe kriteret e shënuara në nenet 156 dhe 157 të këtij Kodi janë të detyrueshme edhe në rastin e parashikimeve të paragrafit më sipër.

3. Personi i dënuar, që vuan dënimin me gjysmëliri, është i detyruar të kthehet në burg, pasi të ketë kryer detyrimet jashtë burgut, brenda periudhës kohore, si rregull nga ora 20.00 deri në orën 7.00, ose në një periudhë kohore të përafërt të përcaktuar nga gjykata.

4. Për personat e rinj deri në njëzet e një vjeç, në zbatim të paragrafit të parë të nenit 158 të këtij Kodi, gjysmëliria fillon të vuhet prej ditës së premte ora 19.00 deri të hënën ora 09.00.

5. Kur personi i dënuar nuk përmbush detyrimet për të cilat i është zëvendësuar dënimi kryesor, sipas këtij neni, zbatohen dispozitat e parashikuara lidhur me shkeljen e kushteve dhe detyrimeve gjatë kohës së provës.

6. Si rregull, gjykata do të japë dënimin në gjysmëliri, vetëm nëse vlerëson që alternativat e tjera të dënimit janë të papërshtatshme.

7. Caktimi i dënimit në gjysmëliri mund të jepet edhe ndaj të dënuarve që kanë pa shlyer deri në dy vjet burgim, pavarësisht masës së dënimit kryesor që ata kanë marrë në çastin e dënimit të tyre. Në këtë rast, dispozitat që lidhen me lirimin para kohe me kusht kanë efekt për aq sa janë të zbatueshme edhe lidhur me gjysmëlinë. Kriteret e parashikuara në nenet 156 dhe 157 të këtij Kodi janë detyruese.

8. Mënyra e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të dhënë në gjysmëliri dhe mbikëqyrjes së tij, përcaktohet nga ligji për ekzekutimin e vendimeve penale.

## Neni 162

### **Qëndrimi në shtëpi**

1. Për dënimet me burgim deri në tre vjet, ose kur pjesa e mbetur e dënimit, sipas një vendimi për një periudhë më të gjatë burgimi, është tre vjet, gjykata mund të vendosë vuajtjen e dënimit të dhënë me qëndrimin në shtëpi të të dënuarit apo në një qendër të kujdesit shëndetësor të ngarkuar për trajtimin e masave mjekësore apo rehabilituese, kur ekzistojnë rrethanat e mëposhtme:

- a) për gratë shtatzëna ose nënat me fëmijë, nën moshën 16 vjeç, që jetojnë me të;
- b) për baballarët, që kanë përgjegjësi prindërore për fëmijën, që jeton me të, nën moshën 16 vjeç, kur nëna e tij ka vdekur apo është e pazonja për t'u kujdesur për të;
- c) për persona, në kushte të rënda shëndetësore, që kërkojnë kujdes të vazhdueshëm nga shërbimi shëndetësor, jashtë institucionit të vuajtjes së dënimit, apo që vuajnë nga sëmundje të rënda që kërkojnë ndihmë të specializuar;
- ç) për personat që janë të paaftë nga ana shëndetësore ose nga ana mendore;
- d) për të rinj, deri në moshën 21 vjeç, me nevoja të dokumentuara shëndetësore, studimore, të punës apo përgjegjësi familjare.

2. Gjukata, në rrethanat e parashikuara në shkronjat "a" dhe "b" të paragrafit të parë të këtij neni, nuk mund të vendosë vuajtjen e dënimit të dhënë me qëndrim në shtëpi të të dënuarve që kanë kryer një krim ndaj bashkëshortit, bashkëjetuesit apo fëmijës së tij.

3. Kushtet dhe kriteret e shënuara në nenet 156 dhe 157 të këtij Kodi janë të detyrueshme edhe në rastin e zbatimit të qëndrimit në shtëpi.

4. Gjukata mund të lejojë personat e dënuar me qëndrim në shtëpi të largohen nga vendbanimi, për plotësimin e nevojave të domosdoshme familjare, për t'u angazhuar në veprimtari pune, edukimi apo arsimimi ose për programe rehabilitimi, por jo më shumë kohë sesa duhet për përmbushjen e nevojës. Mendimi i shërbimit të provës është i detyrueshëm për t'u dëgjuar. Në këtë rast, zbatohen rregullat e detyrimeve gjatë kohës së provës dhe, gjykata përcakton masat që duhet të marrë shërbimi i provës.

5. Në qoftë se personi i dënuar largohet pa autorizimin e gjykatës nga vendbanimi apo shkel detyrimet e caktuara në vendimin e gjykatës, zbatohen dispozitat e parashikuara lidhur me shkeljen e kushteve dhe detyrimeve gjatë kohës së provës.

6. Në rastin kur, shkaku i lejimit të të dënuarit të qëndrojë në shtëpi ka rënë apo është shuar, ai mund t'i drejtohet gjykatës për të përfituar një alternativë tjetër të burgimit nëse janë kushtet e rrethanat që alternativa e kërkuar përmbushet prej tij. Deri ditën e gjykimit të kërkesës së re, i dënuari do të vazhdojë të qëndrojë në shtëpi.

7. Mënyra e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të qëndrimit në shtëpi dhe mbikëqyrjes së tij, përcaktohet nga ligji për ekzekutimin e vendimeve penale.

#### Neni 163

#### **Pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia në provë e të dënuarit**

1. Për shkak të rrezikshmërisë së paktë të personit, moshës, kushteve shëndetësore apo mendore, mënyrës së jetesës dhe të nevojave, veçanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, rrethanave të kryerjes së veprës penale, si dhe të sjelljes pas kryerjes së saj, shpërblimit të dëmit viktimës, gjykata, kur jep dënim me burg deri në pesë vjet, mund të urdhërojë, që i dënuari të vihet në shërbimin e provës dhe plotësojë detyrimet lidhur me të. Në këtë rast, gjykata pezullon ekzekutimin e dënimit, me kushtin që, gjatë kohës së provës i dënuari të mos kryejë veprë tjetër penale dhe të përmbushë detyrimet e caktuara prej saj.

2. Rrethanat e cituara në paragrafin e parë, vlerësohen edhe më vete nëse rëndësia e tyre është jetike për të ardhmen e personit në rastin në shqyrtim, por, kur përherë duket qartë që alternativa i shërben riintegritet shoqëror të të dënuarit.

3. Kushtet dhe kriteret e shënuara në nenet 156 dhe 157 të këtij Kodi janë të detyrueshme edhe në rastin e parashikimeve të paragrafit më sipër.

4. Gjykata urdhëron që i dënuari të përmbushë jo më pak se sa dy nga kushtet e detyrueshme, të parashikuara në nenin 164 të këtij Kodi, lidhur me detyrimet e të dënuarit të vendosur në provë. Lloji i detyrimeve për t'u përmbushur caktohet nga gjykata në varësi të veprës penale të kryer, personalitetit të të dënuarit, nevojës së tij për riintegritet dhe sigurisë publike.

5. Për dënimet deri në dy vjet burgim të pezulluara nga gjykata, afati i provës është sa dyfishi i kohës së dënimit të dhënë me burgim, por përherë jo më pak sesa tre muaj.

6. Afati i provës, me përjashtim të rregullit të parashikuar në paragrafin më sipër të këtij neni, është 25 muaj deri në 5 vjet. Afati i provës mund të shkurtohet ose zgjatet në varësi të mënyrës së ekzekutimit të provës dhe kushteve personale të të dënuarit, por pa cenuar afatin minimal dhe maksimal të parashikuar në këtë paragraf.

7. Prokurori pranë gjykatës që ka dhënë vendimin mbi pezullimin e burgimit dhe vendosjen në provë të të dënuarit, pavarësisht se vendimi mund të mos jetë i formës së prerë, e ekzekuton atë menjëherë pas dhënies së vendimit prej gjykatës kompetente nëse i dënuari është dakord të fillojë zbatimin e provës, edhe kur një gjykatë më e lartë do të shprehet për vendimin. Nëse vendimi i ekzekutuar do të ndryshojë më vonë, zbatohen kriteret e përgjithshme të kompensimit të dënimeve me njëri-tjetrin ose, sipas rastit, të kompensimit për burgim të bazuar në përlllogaritjet e nenit 148 të këtij Kodi dhe ligjit të veçantë.

#### Neni 164

#### **Kushtet detyruese për vënien në shërbim prove të të dënuarit**

1. I dënuari i vënë në provë detyrohet nga gjykata të plotësojë një apo më tepër prej kushteve detyruese të mëposhtme:

a) të ushtrojë një veprimtari profesionale ose të marrë një arsim apo formim profesional ose universitar;

- b) të shfrytëzojë pagën dhe të ardhurat e tjera ose pasurinë për përmbushjen e detyrimeve financiare dhe familjare;
  - c) të riparojë dëmin civil të shkaktuar;
  - ç) të ndalohej të drejtojë automjete të caktuara;
  - d) të mos ushtrojë veprimtari profesionale kur vepra penale ka lidhje me këtë veprimtari;
  - dh) të mos frekuentojë apo mos qëndrojë në vende të caktuara;
  - e) të mos frekuentojë lokale që shërbejnë pije alkoolike, apo të mos abuzojë me alkoolin;
  - ë) të qëndrojë në banesën e tij në orare të caktuara;
  - f) të mos shoqërohet me persona të caktuar, kryesisht me të dënuar apo bashkëpunëtorët e veprës penale;
  - g) të mos zotërojë, mbajë apo përdorë armë zjarri apo armë të ftohta;
  - gj) të largohet ose të mos qëndrojë në një njësi administrative të caktuar për një periudhë kohore të përcaktuar nga gjykata deri në pesë vjet.
  - h) të mjekohet ose rehabilitohet në një institucion shëndetësor ose t'i nënshtrohet një programi të trajtimit, mjekësor apo rehabilitues;
  - i) t'i nënshtrohet një trajtimi, apo programi mjekësor ose rehabilitimi, me qëllim që të ndalojë përdorimin e alkoolit ose lëndëve narkotike, apo varësinë ose abuzimin me barnat mjekësore.
2. Llojet e kushteve të shënuara në paragrafin e parë të këtij neni, nuk jepen në rastet kur gjykata ka zbatuar ndaj të dënuarit dënime plotësuese të ngjashme.
3. Në përcaktimin e detyrimeve për të dënuarin, gjykata merr parasysh moshën e tij, gjendjen mendore, mënyrën e jetesës dhe nevojat, veçanërisht ato të lidhura me familjen, edukimin ose punën, motivet e kryerjes së veprës penale, qëndrimin pas kryerjes së veprës penale, si dhe rrethana të tjera, që ndikojnë në vendosjen e detyrimeve, sipas këtij neni dhe mbikëqyrjen e tyre.
4. Periudha për përmbushjen e një detyrimi të parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni, përcaktohet nga gjykata brenda periudhës së caktuar të provës.

#### Neni 165

#### **Kushti detyrues ndaj varësisë kronike nga përdorimi i alkoolit ose drogës**

1. Gjukata, ndaj të dënuarit të vënë në provë, i cili është në kushtet e varësisë kronike ndaj alkoolit apo lëndëve narkotike, vendos detyrimin për t'iu nënshtuar trajtimeve mjekësore për heqjen dorë nga përdorimi i alkoolit apo drogës.
2. Trajtimi mjekësor për heqjen dorë nga përdorimi i alkoolit apo drogës bëhet në një institucion mjekësor të specializuar sipas përcaktimit të Ministrisë së Drejtësisë.
3. Detyrimi sipas këtij neni, nuk jepet në rastet kur gjykata ka zbatuar ndaj të dënuarit dënim plotësues të ngjashëm.
4. Gjatë kohës së provës për disintoksitimin, i dënuari është i detyruar:
  - a) të paraqitet rregullisht dhe të informojë në vazhdimësi shërbimin e provës për përmbushjen e kushteve dhe detyrimeve të caktuara nga gjykata. Informimi shoqërohet me raportet përkatëse të personave përgjegjës që merren me disintoksitimin e të dënuarit;
  - b) të marrë pëlqimin nga shërbimi i provës për ndryshimin e vendbanimit, qendrës së punës apo për lëvizjet e shpeshta brenda vendit. Në këtë rast ai duhet të paraqesë të gjitha arsyet përse është duke lëvizur nga vendbanimi, qendra e punës apo jashtë shtetit.
5. Shërbimi i provës mbikëqyr nga afër ekzekutimin e vendimit të gjykatës dhe i raporton menjëherë prokurorit, kur personi i dënuar nuk përmbush detyrimin e vendosur apo frekuenton

mjedise që lehtësojnë shkeljen e kushtit të provës. Në këtë rast, zbatohen dispozitat e parashikuara në këtë Kod për shkeljen e kushteve dhe detyrimeve të të dënuarit gjatë kohës së vënies në shërbimin e provës.

#### Neni 166

### **Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik**

1. Gjykata, për shkak të rrethanave të kryerjes së veprës së lehtë penale, për shkak të rrezikshmërisë së paket të personit, kur ka caktuar një dënim deri në dy vjet burgim, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe zëvendësimin e tij me detyrimin që i dënuari të përmbushë një punë në interes publik.

2. Puna në interes publik nënkupton kryerjen nga i dënuari të një pune, që është në gjendje ta kryejë me pëlqimin e tij dhe pa shpërblim, në favor të interesit publik apo shoqatës së caktuar në vendimin e gjykatës, për një kohë nga dyzet deri në dyqind e dyzet orë.

3. Kushtet dhe kriteret e shënuara në nenet 156 dhe 157 të këtij Kodi janë të detyrueshme edhe në rastin e parashikimeve të paragrafit më sipër.

4. Puna në interes publik kryhet brenda afatit prej gjashtë muajsh nga dita e fillimit të saj.

5. Në vendimin e saj gjykata përcakton numrin e orëve të punës dhe detyrimin që i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës. Shërbimi i provës, nëse gjykata nuk është shprehur për këtë, vendos llojin e punës që do të kryhet, përcakton vendin e kryerjes së punës dhe ditët e javës kur do të kryhet ajo, duke pasur parasysh, për aq sa është e mundur, punësimin e rregullt të të dënuarit apo detyrimet e tij familjare. Kohëzgjatja e punës në interes publik nuk i kalon tetë orë në ditë.

6. Lidhur me llojin dhe vendin e punës në interes publik, gjykata mban parasysh përzgjedhjen që i dënuari bën për shkak të aftësive e mundësive të tij si dhe, nga lista vjetore e dërguar nga Shërbimi Rajonal i Provës ku shënohen vendet e punës më të mundshme për t'u kryer.

7. Pas përfundimit të punës, dënimi konsiderohet i paqenë dhe nuk shënohet në regjistrin e gjendjes gjyqësore.

8. Ekzekutimi i vendimit të gjykatës për dhënien e punës në interes publik bëhet sipas parashikimeve të ligjit për ekzekutimin e vendimeve penale.

9. Prokurori pranë gjykatës që ka dhënë vendimin pavarësisht se nuk është i formës së prerë, e ekzekuton atë menjëherë pas shqiptimit të vendimit prej gjykatës kompetente nëse i dënuari është dakord të fillojë zbatimin e provës, edhe kur një gjykatë më e lartë do të shprehet për vendimin. Nëse vendimi i ekzekutuar do të ndryshojë më vonë, zbatohen kriteret e përgjithshme të kompensimit të dënimeve ndër njëri-tjetrin ose, sipas rastit, të kompensimit për burgim të bazuar në përlllogaritjet e nenit 148 të këtij Kodi dhe ligjit të veçantë.

#### Neni 167

### **Shkelja e kushteve dhe e detyrimeve gjatë kohës së provës**

1. Nëse i dënuari, gjatë afatit të provës, kryen një vepër tjetër penale, gjykata ndryshon detyrimet që ka vendosur, zëvendëson dënimin e dhënë me një dënim tjetër, apo revokon, tërësisht ose pjesërisht, vendimin e pezullimit. Nëse vepra tjetër penale është më e rëndë nga ajo sipas së cilës personi është dënuar më parë, gjykata revokon vendimin e pezulluar.

2. Nëse i dënuari, gjatë afatit të provës, shkel kushtet ose detyrimet që i janë vendosur, përveçse kur ai provon se ishte në pamundësi për t'i përmbushur ato, shërbimi i provës i raporton menjëherë prokurorit.

3. Për shkelje të lehta dhe për herë të parë të kushteve ose të detyrimeve që i janë vendosur nga gjykata, prokurori ka të drejtë të japë paralajmërim, i cili regjistrohet në dosjen personale të të dënuarit.

4. Për shkelje të rënda ose të përsëritura, prokurori i kërkon gjykatës ndryshimin e detyrimit të vendosur, shtimin e detyrimeve të tjera, zëvendësimin e tyre me një tjetër, ose revokimin e vendimit të pezullimit të dënimit dhe vuajtjen e pjesës së mbetur të dënimit në burg. Në rastin e revokimit, gjykata rillogarit pjesën e dënimit të mbetur me burgim, duke marrë parasysh periudhën kohore të kaluar në shërbimin e provës, kufizimet e lirisë personale të përfituesit gjatë kësaj periudhe, sjelljen e të dënuarit dhe vlerësimet e shërbimit të provës.

5. Në çdo rast gjykata kompetente e shqyrtimit të çdo rrethane që lidhet me mënyrën e përmbushjes së detyrimeve apo kontrollin e përgjithshëm të periudhës së provës do të vlerësohet të jetë gjykata e vendit ku po ekzekutohet dënimi alternativ.

#### Neni 168

### **Pezullimi i procedimit dhe vënia në provë e të pandehurit**

1. Në procedimet për vepra të lehta penale ose për veprat penale që ndiqen nga viktimia akuzuese sipas nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale, i pandehuri që pranon fajësinë, mund t'i kërkojë gjyqtarit kompetent pezullimin e procedimit duke u vënë në provë.

2. Për veprat penale që ndiqen me kërkesën e viktimës akuzuese sipas nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale, nuk mund të zbatohet pezullimi i procedimit nëse mungon pëlqimi i saj, ndërsa në veprat e tjera pëlqimi i prokurorit apo viktimës, nëse ka të tillë, nuk është i detyrueshëm.

3. Kërkesa e të pandehurit paraqitet në çeljen e seancës dhe, kur çmohet e bazuar në mënyrë të arsyeshme, gjyqtari vendos pezullimin e procedimit dhe vendosjen e të pandehurit në provë nëse, do i shërbejë moscenimit të nevojave të tij të punës, studimit, familjes apo shëndetit. Sjellja e penduar përgjatë kohës që nga kryerja e veprës penale është thelbësore në pranimin e kërkesës së tij.

4. Gjyqtari urdhëron të pandehurin që, gjatë periudhës së provës të ndërmarrë veprime që synojnë eliminimin e pasojave të dëmshme ose të rrezikshme që rrjedhin nga vepra penale, si dhe, kur është rasti, shpërblimin e dëmit të shkaktuar prej saj. Vënia në provë përfshin vendosjen e të pandehurit në mbikëqyrjen e shërbimit të provës për kryerjen e një programi të përshtatshëm për personin e tij që mund të përfshijë, ndër të tjera, punë vullnetare me rëndësi shoqërore, ose respektimin e urdhërimeve që kanë të bëjnë me vendbanimin, lirinë e lëvizjes, ndalimin për të frekuentuar vende të caktuara. Zbatohen, për aq sa janë të përshtatshme, rregullat e përgjithshme të parashikuara nga neni 166 i këtij Kodi.

5. Nëse i pandehuri nuk përmbush detyrimet e vendosura apo kryhen një tjetër vepër penale, zbatohen rregullat e parashikuara në nenin 167 të këtij Kodi.

6. Pezullimi i procedimit duke u vënë në provë të pandehurin nuk mund të jepet më shumë se një herë apo në rastet kur ai është i dënuar më parë.

#### Neni 169

### **Pasojat e përmbushjes së detyrimeve**

Pas përfundimit të periudhës së provës, kur gjyqtari konstaton se detyrimet e vendosura ndaj të pandehurit janë përmbushur plotësisht, pasi merr edhe mendimin e palëve të tjerë në gjykim, vendos pushimin e procedimit penal. Pushimi i procedimit penal nuk pengon zbatimin e sanksioneve administrative plotësuese nëse parashikohen me ligj.

Neni 170

### **Pagimi i gjobës për kundërvajtjet penale**

1. Për kundërvajtjet penale, për të cilat ligji parashikon vetëm dënimin me gjobë, përveç shpenzimeve procedurale, autori lejohet të paguajë, përpara çeljes së debatit gjyqësor ose përpara dhënies së vendimit përfundimtar të shkallës së parë, një shumë që korrespondon me një të tretën e maksimumit të dënimit të parashikuar në ligj për kundërvajtjen e kryer.
2. Pagimi i gjobës sjell pushimin e akuzës penale.

Neni 171

### **Qortimi gjyqësor**

1. Qortimi gjyqësor është alternativë ndaj dënimit penal me burgim për autorin e një vepre penale për të cilën parashikohet në ligj dënim me burgim deri në një vit ose me gjobë dhe kur, duke marrë parasysh mënyrën e kryerjes së veprës penale, karakterin veçanërisht të lehtë të saj, pasojën e vogël të shkaktuar, gjendjen rastësore në kryerjen e veprës, formën e ulet të fajit, të gjitha rrethanat që kanë të bëjnë me personalitetin e autorit. Vlerësohen në veçanti edhe marrëdhëniet e tij me viktimën dhe shpërblimin e dëmit si elemente thelbësore që plotësojnë kushtet për arritjen e qëllimit të dënimit pa caktuar dënim me burgim.

2. Qortimi gjyqësor nuk mund të jepet nga gjykata nëse i pandehuri e refuzon këtë alternativë të dënimit penal. Kur ai jep pëlqimin, atëherë urdhërohet nga gjykata që të publikojë vendimin gjyqësor në mjedisin ku ka kryer veprën penale, apo kur është rasti, edhe më gjerë. Gjykata vendos edhe lidhur me shpenzimet përkatëse, kohën dhe mënyrën e publikimit të vendimit gjyqësor si detyrime ndaj të dënuarit. Zbatohen për aq sa janë të përshtatshme rregullat e përcaktuara në nenin 88 të këtij Kodi.

Neni 172

### **Efektet e dënimit të zëvendësuar**

Për çdo efekt juridik dënimi me gjysmëliri, ai me liri të kontrolluar, si dhe puna në interes publik e konvertuar me ditët e burgimit ose qëndrimi në burgim vetëm në fundjavë, konsiderohen si lloji i dënimit me burgim të cilin kanë zëvendësuar.

Neni 173

### **Detyrimet e shërbimit të provës**

1. Shërbimi i provës, në lidhje me alternativat e dënimit me burgim, ndjek në mënyrë të vazhdueshme ecurinë e zbatimit të vendimit gjyqësor nga i dënuari dhe i paraqet gjykatës raporte periodike lidhur me sjelljen dhe respektimin e detyrimeve prej tij për periudha kohore të

konsideruara si të vlefshme nga vendimi gjyqësor apo të përcaktuara nga ky Kod, bazuar në llojin e veprës penale të kryer nga i dënuari dhe detyrimeve të vendosura ndaj tij.

2. Shërbimi i Provës evidenton me saktësi kohën e shlyerjes së alternativës së dënimit me burgim duke përpiluar një raport të përbashkët në prani të të dënuarit dhe subjekteve publike apo private pranë të cilave është shlyer alternativa e dënimit. Raporti depozitohet pranë prokurorit që konstaton mbarimin e shlyerjes së dënimit alternativ.

3. Raportet me shkrim të shërbimit të provës, në rastin kur është i thirrur në gjykim, përpara se sa gjykata të japë vendimin gjyqësor për çështjet që rregullon ky seksion, nuk kanë efekt detyrues për të. Raportet, kur paraqiten edhe kryesisht nga shërbimi i provës, i nënshtrohen rregullave të përgjithshme të trajtimit të provave në gjykimin penal.

4. Çdo shkelje përgjatë kryerjes së detyrave të mbikëqyrjes, trajtimit apo kontrollit të të dënuarit, bërë nga personat përgjegjës të ngarkuar nga vendimi gjyqësor apo një akt që rrjedh prej tij, krijonjë përgjegjësi penale sipas parashikimeve në pjesën e posaçme të këtij Kodi.

## SEKSIONI II LIRIMI ME KUSHT

Neni 174

### **Lirimi me kusht**

1. Personi i cili është duke shlyer dënimin me burgim, kur ka dhënë prova pjesëmarrjeje aktive në programin e trajtimit, ecuri pozitive të sjelljes, ka pranuar programin psikologjik të trajnimit, duke përfutur prej tij, ka ndërtuar marrëdhënie korrekte e konstruktive me punonjësit e sistemit të riedukimit, të dënuarit e tjerë, familjarët, miqtë dhe komunitetin, ka zëvendësuar dëmin e shkaktuar dhe ka bërë përpjekje të vazhdueshme për normalizimin e marrëdhënieve me viktimën, ka ndërprerë kontaktet me botën e krimit dhe jep besim në riedukimin e tij, të gjitha të përshkruara objektivisht në fakte, përpara përfundimit të ekzekutimit të dënimit, mund të lirohet me kusht nga ekzekutimi i mëtejshëm i tij, nëse nuk ka periudhë kohore të ndryshme sigurie, dhe ka shlyer:

- a) jo më pak se dy të tretat e dënimit të dhënë për krime dënuar deri në pesë vjet burgim;
- b) jo më pak se tre të katërtat e dënimit të dhënë për krime dënuar mbi pesë vjet deri në maksimumin e parashikuar nga ligji.

2. Në masën e dënimit të shlyer llogaritet edhe koha e përfutur me amnisti ose falje.

3. Në masën e dënimit të shlyer nuk llogariten ditët që i dënuari ka përfutur nga lejet e zakonshme apo të posaçme të dhëna nga administrata penitenciare.

Neni 175

### **Lirimi me kusht për shkak të ligjit**

1. Kur i dënuari me burgim për një vepër penale të lehtë, ka plotësuar jo më pak sesa dy të tretat e dënimit të dhënë dhe plotëson njëkohësisht kriteret e përcaktuara në paragrafin e parë të nenit 174 të këtij Kodi, përfiton automatikisht lirimin para kohe me kusht.

2. Në këtë rast mbi të rëndojnë të paktën tre nga detyrimet e parashikuara në nenet 164 e 179 të këtij Kodi, të cilat vendosen nga autoriteti i shërbimit të provës bazuar në eksperiencën më të mirë të tyre.

## Neni 176

### **Procedura e gjykimit të kërkesës**

1. Kërkesa për lirimin para kohe me kusht paraqitet personalisht nga i dënuari. Ajo i drejtohet gjykatës së vendit ku i dënuari po shlyen dënimin. Instituti i Ekzekutimit të Vendimeve Penale ku i dënuari po shlyen dënimin, merr masat për përcjelljen e menjëhershme të kërkesës pranë gjykatës kompetente, duke i njoftuar pa vonesë kopje të saj prokurorit pranë gjykatës së vendit të ekzekutimit dhe shërbimit përkatës të provës. Autoritetet e Institutit të Ekzekutimit të Dënimit shoqërojnë kërkesën me një raport të hollësishëm që përmban të dhënat e detajuara për sa kërkohet nga përmbajtja e nenit 174 të këtij Kodi dhe detyrimet e vëna nga ligji për ekzekutimin e vendimeve penale për subjektet pjesëmarrëse.

2. Në seancën gjyqësore të lirimit para kohe me kusht, përveç të dënuarit, prokurorit dhe shërbimit të provës, gjykata dëgjon edhe mendimin e viktimës së veprës penale. Gjykata, nëpërmjet debatit gjyqësor, shqyrton hollësisht nëse janë plotësuar kriteret e lirimit para kohe me kusht të shënuara në nenin 174 të këtij Kodi.

3. Në vlerësimin e përgjithshëm të të gjitha rrethanave të shënuara në paragrafin parë të nenit 174, gjykata përfundon nëse i është arritur qëllimit të dënimit për edukimin e tij dhe, mbi këtë vlerësim të japë vendimin e saj. Gjendja e kriminalitetit në vend dhe prirjet në politikën penale të zbatuara nga gjykatat në dhënie të vendimeve për krimet e kryera në përgjithësi, janë elemente që merren parasysh në zbatimin e lirimit para kohe me kusht. Edhe palët e tjera në këtë proces, sipas interesave që përfaqësojnë, vlerësojnë të njëjtat rrethana.

4. Vendimi i gjykatës që urdhëron lirimin para kohe me kusht ekzekutohet menjëherë.

5. Gjykata përcakton në vendim, përpos detyrimeve të veçanta që i dënuari duhet të përmbushë, edhe periudhën kohore të kushtit për të dënuarin e liruuar para kohe që është e barabartë me kohën e mbetur të dënimit, përveç rasteve kur koha mund të zgjatet sipas parashikimit të nenit 163, paragrafi 6 të këtij Kodi. Kalimi me sukses i periudhës së kushtit nga i liruari para kohe, shuan pjesën e mbetur të ekzekutimit të dënimit me burgim.

## Neni 177

### **Refuzimi i kërkesës**

Gjykata, përtej rastit kur i dënuari nuk ka përmbushur kriteret e shënuara në nenin 174 të këtij Kodi, mund të vendosë të refuzojë zëvendësimin e dënimit me burgim me lirimin para kohe me kusht kur ka shkaqe të bazuara lidhur me sigurinë publike në vend dhe parandalimin e posaçëm të lindura edhe përgjatë fazës së ekzekutimit të vendimit me burgim.

## Neni 178

### **Ndalimi i përfitimit të lirimit para kohe me kusht**

Nuk lejohet lirimi me kusht për të dënuarin përsëritës për krime të rënda të kryera me dashje, si dhe për të dënuarit për kryerjen e veprave penale të vrasjeve që përmbajnë motiv apo paramendim, krimeve të rënda terroriste, në veprat penale me forma të veçanta të bashkëpunimit si krerë të organizimit, drejtimit dhe ekzekutimit, krimit të marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale me të mitur, kur ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e fëmijës së mitur.

## Neni 179

### **Detyrimet e të liruarit me kusht**

1. Gjykata urdhëron të dënuarin, që për periudhën e kohës së caktuar të kushtit të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të përmbushë detyrimet që vendimi gjyqësor cakton për të dënuarit gjatë kohës së shërbimit të provës të parashikuara nga ky Kod. Lloji i detyrimeve caktohen në përputhje me nevojën e riintegrit të të dënuarit në shoqëri, përmirësimit të marrëdhënieve me viktimën apo komunitetin, ndjekjes së procesit të shkollimit apo punësimit etj., elemente që shkojnë përkrah natyrës së personit dhe mundësive të institucioneve publike për të ndjekur procesin e riintegrit.

2. Kur i dënuari nuk mban kontakte me shërbimin e provës ose kur nuk i përmbush detyrimet e përcaktuara sipas dispozitave për kushtet dhe detyrimet e të dënuarit gjatë nënshtrimit në shërbimin e provës të parashikuara nga ky Kod të urdhëruara nga gjykata, përveçse kur i dënuari provon se ishte në pamundësi për t'i përmbushur ato, gjykata zgjat afatin e kushtit, ose shton detyrimet ndaj tij, ose mund të vendosë revokimin e vendimit për lirim para kohe me kusht dhe vijimin e ekzekutimit për pjesën e mbetur të dënimit nëse vlerësohet që alternativat e para kanë qenë të paefektshme.

3. Zgjatja e afatit të kohës së kushtit nuk mund të kalojë një vit mbi afatin e përgjithshëm të përcaktuar në nenin 176, paragrafi 5 i këtij Kodi.

4. Nëse vërtetohet rasti sipas paragrafit të dytë të këtij neni, i dënuari nuk mund të paraqesë kërkesë të re për lirim përpara kohe me kusht brenda një viti nga dita e revokimit të vendimit gjyqësor të mëparshëm.

## Neni 180

### **Revokimi i lirit me kusht**

1. Lirimi me kusht revokohet nga gjykata, kur i dënuari për një krim të kryer me dashje, gjatë kohës së kushtit, kryen krim tjetër me dashje, apo ndodhet në kushtet e nenit 179, paragrafi 2, i këtij Kodi.

2. Gjykata llogarit pjesën e dënimit të mbetur me burgim, duke marrë parasysh periudhën kohore të kaluar në liri me kusht, kufizimet e lirisë personale të të liruarit me kusht gjatë kësaj periudhe, sjelljen e të liruarit me kusht dhe vlerësimet e shërbimit të provës.

3. Për pjesën e dënimit të mbetur dhe dënimin për veprën penale të kryer më pas zbatohen dispozitat për bashkimin e dënimeve.

## Neni 181

### **Mundësia e lirit me kusht për të dënuarin me burgim të përjetshëm**

1. Lirimi me kusht i të dënuarit me burgim të përjetshëm mund të lejohet, pasi ka shlyer jo më pak se tridhjetë e pesë vjet burgim deri në ditën e bërjes së kërkesës dhe, vetëm nëse gjatë shlyerjes së dënimit ka dhënë prova pjesëmarrjeje në programin e trajtimit, ka shfaqur një pendim të sigurt në bazë të sjelljes në tërësi, vullnetit të tij për t'u integruar në shoqëri, që rezulton nga interesi për vlerat etike dhe shoqërore, prova të mirësisë dhe solidaritetit, në qëndrimin e mbajtur për viktimën e veprës së kryer prej tij, zëvendësimin e dëmeve që u ka shkaktuar atyre, ndërprerjes së kontakteve

me botën e krimit, dhe synimit për të fshirë pasojat e dëmshme të veprës penale, jo thjesht ekonomike, por edhe sociale, psikologjike apo të rendit publik.

2. Kërkesa për lirim para kohe me kusht paraqitet personalisht nga i dënuari. Ajo i drejtohet gjykatës së vendit ku i dënuari po shlyen dënimin. Instituti i Ekzekutimit të Vendimeve Penale ku i dënuari po shlyen dënimin, merr masat për përcjelljen e menjëhershme të kërkesës pranë gjykatës kompetente, duke i njoftuar pa vonesë kopje të saj prokurorit pranë gjykatës së vendit të ekzekutimit dhe shërbimit përkatës të provës. Autoritetet e Institutit të Ekzekutimit të Dënimit shoqërojnë kërkesën me një raport të hollësishëm që përmban të dhënat e detajuara për sa kërkohet nga përmbajtjet e paragrafit të parë të këtij neni dhe nenit 174 të këtij Kodi dhe detyrimet e vëna nga ligji për ekzekutimin e vendimeve penale për subjektet pjesëmarrëse.

3. Në seancën gjyqësore të lirit para kohe me kusht, përveç të dënuarit, prokurorit dhe shërbimit të provës, gjykata dëgjon edhe mendimin e viktimës së veprës penale. Gjykata e përbërë nga tre gjyqtarë, nëpërmjet debatit gjyqësor, shqyrton hollësisht nëse janë plotësuar kriteret e lirit para kohe me kushte të shënuara në këtë nen dhe nenin 174 të këtij Kodi.

4. Në vlerësimin e përgjithshëm të të gjitha rrethanave gjykata duhet të çmojë nëse i është arritur qëllimit të dënimit për edukimin e tij dhe, mbi këtë vlerësim të japë vendimin e saj. Gjendja e kriminalitetit në vend dhe prirjet në politikën penale të zbatuara nga gjykatat në dhënien e vendimeve për krimet e kryera në përgjithësi, janë elemente që merren parasysh në zbatimin e lirit para kohe me kusht. Edhe palët e tjera në këtë proces, sipas interesave që përfaqësojnë, vlerësojnë të njëjtat rrethana.

5. Vendimi i gjykatës që urdhëron lirim para kohe me kusht ekzekutohet menjëherë.

#### Neni 182

### **Detyrimet e personit të dënuar me burgim të përjetshëm të liruar me kusht**

1. Gjykata, kur pranon kërkesën, urdhëron të dënuarin me burgim të përjetshëm që të mbajë kontakte me shërbimin e provës për një periudhë pesëvjeçare nga dita që vendimi merr formë të prerë dhe të përmbushë disa nga detyrimet e të dënuarit gjatë nënshtrimit në shërbimin e provës të parashikuara nga ky Kod.

2. Kur i dënuari me burgim të përjetshëm nuk mban kontakte me shërbimin e provës ose kur nuk i përmbush detyrimet e përcaktuara sipas dispozitave për detyrimet e të dënuarit gjatë nënshtrimit në shërbimin e provës të parashikuara nga ky Kod, përveçse kur mospërmbushja vjen nga rrethana objektive të pranuar, gjykata vendos revokimin e vendimit dhe vijimin e ekzekutimit të vendimit me burgim të përjetshëm. I dënuari nuk mund ta përsërisë më kërkesën për lirim para kohe me kusht.

#### Neni 183

### **Detyrimet e shërbimit të provës**

1. Shërbimi i provës, në lidhje me lirim para kohe me kusht, ndjek në vazhdimësi ecurinë e zbatimit të vendimit gjyqësor nga i dënuari dhe i paraqet gjykatës raporte periodike lidhur me sjelljen dhe respektimin e detyrimeve prej tij për periudha kohore të konsideruara si të vlefshme prej vetë shërbimit, bazuar në llojin e veprës penale të kryer nga i dënuari dhe detyrimeve të vendosura ndaj tij.

2. Shërbimi i provës evidenton me saktësi kohën e shlyerjes së alternativës së dënimit me burgim duke përpiluar një raport të përbashkët në prani të të dënuarit dhe subjekteve publike apo private pranë të cilave janë shlyer detyrimet e vendosura përgjatë kohës së provës. Raporti depozitohet pranë prokurorit që konstaton mbarimin e shlyerjes së alternativës së lirimit para kohe me kusht.

3. Raportet me shkrim të shërbimit të provës, në rastin kur është i thirrur në gjykim, përpara se sa gjykata të japë vendimin gjyqësor për çështjet që rregullon ky seksion, nuk kanë efekt detyrues për të. Raportet, kur paraqiten edhe kryesisht nga shërbimi i provës, i nënshtrohen rregullave të përgjithshme të trajtimit të provave në gjykimin penal.

4. Çdo shkelje përgjatë kryerjes së detyrave të mbikëqyrjes, trajtimit apo kontrollit të të dënuarit, bërë nga personat përgjegjës të ngarkuar nga vendimi gjyqësor apo një akt që rrjedh prej tij, kanë përgjegjësi penale sipas parashikimeve në pjesën e posaçme të këtij Kodi.

## TITULLI IV SHUARJA E VEPRËS PENALE DHE E DËNIMEVE

### KREU I SHUARJA E VEPRËS PENALE

#### Neni 184

#### **Shkaqet e shuarjes së veprës penale dhe mosekzekutimit të dënimit**

Vepra penale shuhet:

- a) për shkak të parashkrimit,
- b) amnistisë,
- c) vdekjes së autorit të kryerjes së saj;
- ç) vdekjes së viktimës së veprës penale që ndiqet mbi ankimin ose me kërkesë të viktimës akuzuese nëse nuk ka paraqitur kërkesën përpara vdekjes së saj.

#### Neni 185

#### **Parashkrimi i ndjekjes penale**

1. Shuhet vepra penale kur nga çasti i kryerjes apo tentativës së kryerjes së saj dhe, deri në çastin e ngritjes së akuzës nga prokurori, kanë kaluar:

- a) dyzet vjet në rastin e krimeve që parashikojnë dënim me burgim të përjetshëm;
- b) njëzet e pesë vjet për krimet që parashikojnë dënim mbi dhjetë vjet burgim ose dënim tjetër më të rëndë;
- c) dhjetë vjet për krimet që parashikojnë dënim mbi pesë deri në dhjetë vjet burgim;
- ç) pesë vjet për krimet që parashikojnë dënim deri në pesë vjet burgim ose gjobë;
- d) tre vjet për kundërvajtjet penale që parashikojnë dënim deri në dy vjet burgim;
- dh) dy vjet për kundërvajtjet penale që parashikojnë dënim me gjobë.

2. Për veprat penale që lidhen me prokurimin apo përvetësimin e fondeve të BE-së, krimeve seksuale, korrupsionit të zyrtarëve publikë, krimet mjedisore, krimet ndaj të miturve dhe dhunës në familje, afatet e parashkrimit të shënuara në paragrafin e parë të këtij neni, dyfishohen.

3. Nuk parashkruhen krimet e luftës, gjenocidit dhe ato kundër njerëzimit, të parashikuara në këtë Kod.

4. Pavaresisht nga plotesimi i afateve të shënuara në këto dispozite, cdonjeri ka të drejtë të mos përfitojë nga kalimi i tyre dhe të kërkojë të gjykohet nga një gjykatë kompetente e drejtesise.

#### Neni 186

### **Fillimi i afateve të parashkrimit**

1. Afati i parashkrimit të veprës penale fillon të ecë në momentin që përmbushen të gjitha elementet e figurës së veprës penale ose kur është vërtetuar veprimi i fundit që përbën pjesë të veprës penale.

2. Në veprat penale të qëndrueshme ose vazhduese, afati i parashkrimit do të fillojë në çastin e përfundimit të veprimeve të fundit që janë pjesë e atyre veprave. Kur pasoja e veprave të tilla penale, që përbën elemente të figurës së veprës penale, ka ardhur më vonë, atëherë afati do të fillojë nga momenti i ardhjes së kësaj pasoje.

3. Në rast se vepra penale është kryer ndaj një të mituri, afati i parashkrimit fillon të ecë në momentin që ky i fundit mbush moshën tetëmbëdhjetë vjeç.

4. Në rastin kur një hetim penal rifillon për çdo shkak pas pushimit të akuzës apo çështjes që një gjykatë kompetente ka bërë më parë, afati i parashkrimit fillon të numërohet nga momenti i përshkuar në paragrafin e parë të këtij neni.

#### Neni 187

### **Pezullimi i parashkrimit**

1. Afati i parashkrimit të veprës penale pezullohet në rastet e mëposhtme:

a) për kohën që organi procedues ka ndalim ligjor për të ushtruar apo vazhduar ndjekjen penale;

b) për kohën që është i nevojshëm ekzekutimi i një letërporosie drejtuar autoriteteve të huaja për njoftimet dhe marrjen e provave;

c) për kohën që autori qëndron në arrati për t'iu shmangur ndjekjes penale;

ç) në rast se i pandehuri ndodhet jashtë shtetit dhe organi kompetent paraqet një kërkesë për ekstradimin e tij, afati i parashkrimit pezullohet:

i. deri sa i pandehuri t'iu dorëzohet autoriteteve shqiptare;

ii. deri sa refuzimi i kërkesës për ekstradim t'iu njoftohet autoriteteve shqiptare;

iii. deri sa të tërhiqet kërkesa për ekstradim;

iv. deri sa i pandehuri të jetë larguar nga territori i shtetit të kërkuar.

2. Pavarësisht pezullimit, afati maksimal i parashkrimit nuk mund të kalojë mbi një të dytën e afateve të parashikuara në nenin 185 të këtij Kodi.

#### Neni 188

### **Ndërprerja e parashkrimit**

Afati i parashkrimit të veprës penale ndërpritet me marrjen e vendimit të prokurorit për njoftimin e akuzës ose paraqitjen e kërkesës për gjykim nga viktimat akuzuese.

## KREU II SHUARJA E DËNIMIT

Neni 189

### **Shkaqet e shuarjes së dënimit**

Dënimi nuk ekzekutohet:

- a) për shkak të parashkrimit;
- b) amnistisë;
- c) faljes;
- ç) vdekjes së të dënuarit.

Neni 190

### **Parashkrimi i ekzekutimit të dënimit**

1. Vendimi i dënimit nuk ekzekutohet kur nga dita që ka marrë formë të prerë kanë kaluar:
  - a) tridhjetë e pesë vjet për vendimin që përmban dënim me burgim të përjetshëm;
  - b) njëzet e pesë vjet për vendimin që përmban dënim mbi pesëmbëdhjetë vjet burgim;
  - c) pesëmbëdhjetë vjet për vendimin që përmban dënim mbi pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet burgim;
  - ç) pesë vjet për vendime që përmbajnë dënim me burgim deri në pesë vjet ose dënime të tjera më të lehta.
2. Për veprat penale që lidhen me prokurimin apo përvetësimin e fondeve të BE-së, krimeve seksuale dhe korrupsionit të zyrtareve publikë, afatet e parashkrimit të shënuara në paragrafin e parë të këtij neni, nëse i dënuari është fshehur apo arratisur për t'i shpëtuar ekzekutimit të dënimit dyfishohen.

Neni 191

### **Fillimi i afateve të parashkrimit**

1. Afati i parashkrimit të ekzekutimit të dënimit fillon nga dita që vendimi i dënimit ka marrë formë të prerë.
2. Në rast të revokimit të alternativave të dënimit me burgim afati i parashkrimit fillon nga dita që vendimi i revokimit merr formë të prerë.
3. Në rast falje dënimi apo të zbutjes së tij për shkaqe të tjera ligjore, afati i parashkrimit llogaritet duke marrë për bazë dënimin e ri, ndërsa ecja e afatit do të jetë nga dënimi i mëparshëm.

Neni 192

### **Pezullimi dhe ndërprerja e parashkrimit të ekzekutimit të dënimit**

1. Afati i parashkrimit të ekzekutimit të dënimit pezullohet në rastet e mëposhtme:

a) në rast se i dënuari ndodhet jashtë shtetit dhe organi kompetent paraqet një kërkesë për ekstradimin e tij, afati i parashkrimit pezullohet:

- i. deri sa i dënuari t'i dorëzohet autoriteteve shqiptare;
- ii. deri sa refuzimi i kërkesës për ekstradim t'i njoftohet autoriteteve shqiptare;
- iii. deri sa të tërhiqet kërkesa për ekstradim;
- iv. deri sa i pandehuri të jetë larguar nga territori i shtetit të kërkuar;

b) në rastet në të cilat është vendosur shtyrja e ekzekutimit të dënimit, duke filluar nga momenti i paraqitjes së kërkesës nga i dënuari;

c) në rastet e dënimeve me gjobë për kohën e shqyrtimit gjyqësor të kundërshtimit të veprimeve përmbartimore;

2. Pavarësisht pezullimit, afati maksimal i parashkrimit të ekzekutimit nuk mund të kalojë dyfishin e afateve të parashikuara në nenin 190 të këtij Kodi.

3. Afati i parashkrimit të ekzekutimit të dënimit ndërpritet nëse i dënuari largohet nga vendi i qëndrimit.

4. Pas çdo ndërprerje fillon një afat i ri parashkrimi.

Neni 193

### **Mosparashkrimi i ekzekutimit të dënimit**

Nuk parashkruhet ekzekutimi i dënimit për krimet e luftës dhe ato kundër njerëzimit.

Neni 194

### **Amnistia**

1. Me aktin e amnistisë organi kompetent përjashton nga ndjekja penale, nga vuajtja tërësisht apo pjesërisht e dënimit ose bën zëvendësimin e dënimit me një lloj dënimi më të butë.

2. Amnistia shtrihet për ato vepra penale të kryera deri një ditë para shpalljes së saj, veç rastit kur në aktin përkatës vendoset ndryshe.

3. Konsiderohen vepra penale të kryera deri një ditë para shpalljes së amnistisë ato vepra, të cilat figurojnë të regjistruara në organet e rendit publik apo ato të procedimit.

Neni 195

### **Falja**

1. Me aktin e faljes organi kompetent përjashton tërësisht apo pjesërisht personin nga vuajtja e dënimit të dhënë me një vendim gjyqësor ose bën zëvendësimin e dënimit me një lloj dënimi më të butë.

2. Për aq sa është e zbatueshme organi kompetent që ushtron të drejtën e faljes nuk mund të anashkalojë orientimet që garanton ky ligj lidhur me politikën penale në tërësi.

Neni 196

### **Rehabilitimi**

1. Quhen të padënuar:
  - a) ata që janë dënuar me burgim për një kohë deri në gjashtë muaj ose me çdo dënim tjetër më të lehtë dhe që gjatë dy vjetëve nga dita e shlyerjes, parashkrimit, amnistisë ose faljes së dënimit apo nga dita e përfundimit të periudhës së provës nuk kanë kryer vepër tjetër penale;
  - b) ata që janë dënuar me burgim për një kohë mbi gjashtë muaj deri në pesë vjet dhe që gjatë pesë vjetëve nga dita e shlyerjes, parashkrimit, amnistisë ose faljes së dënimit apo nga dita e përfundimit të periudhës së provës nuk kanë kryer vepër tjetër penale;
  - c) ata që janë dënuar me burgim për një kohë mbi pesë deri në dhjetë vjet dhe që gjatë shtatë vjetëve nga dita e shlyerjes, parashkrimit, amnistisë ose faljes së dënimit apo nga dita e përfundimit të periudhës së provës nuk kanë kryer vepër tjetër penale;
  - ç) ata që janë dënuar me burgim për një kohë mbi dhjetë deri në njëzet vjet dhe që gjatë dhjetë vjetëve nga dita e shlyerjes, parashkrimit, amnistisë ose faljes së dënimit apo nga dita e përfundimit të periudhës së provës nuk kanë kryer vepër tjetër penale.
2. Rehabilitimi nuk zbatohet për të dënuarit për krimet e luftës dhe ato kundër njerëzimit, atyre për krime seksuale ndaj të miturve dhe, për të dënuarit me burgim më tepër sesa njëzet vjet.
3. Në rast se ndaj të dënuarit përveç dënimit me burgim është caktuar edhe dënimi plotësues afati i rehabilitimit fillon nga dita e shlyerjes së dënimit plotësues.
4. Për të dënuarit që në kohën e kryerjes së veprës penale kanë qenë të mitur afatet e rehabilitimit të parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni përgjysmohen.
5. Për çdo parregullsi mbi zbatimin e paragrafit të parë të këtij neni, personi i drejtohet gjykatës penale.
5. Në rast se gjatë periudhës së rehabilitimit i dënuari kryen një vepër tjetër penale atëherë afati i rehabilitimit për dënimin e parë dyfishohet, ndërsa për dënimin e ri fillon një afat i ri rehabilitimi.
6. Në rast se pas përfundimit të periudhës së rehabilitimit i dënuari kryen një vepër tjetër penale afati i rehabilitimit për dënimin e ri do të jetë sa dyfishi i afateve të parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni.

## PJESA E POSAÇME

### TITULLI I KRIME KUNDËR LIGJIT NDËRKOMBËTAR

Neni 197

#### **Gjenocidi**

Dhënia e urdhrave ose kryerja me qëllim e krimeve që synojnë shkatërrimin, në tërësi ose pjesërisht të grupit kombëtar, etnik, racor ose fetar, të tilla si:

- a) vrasja e anëtarëve të grupit;
- b) shkaktimi i dëmtimeve serioze trupore ose mendore, anëtarëve të grupit;
- c) imponimi i kushteve të jetës një grupi, me qëllim që të sjellin shkatërrimin e tij fizik, të plotë ose të pjesshëm.
- ç) imponimi i masave me qëllim parandalimin e lindjeve brenda grupit;
- d) transferimi i dhunshëm i fëmijëve të një grupi në një grup tjetër;

dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm kur si rezultat i tyre ka ardhur vrasja apo vdekja e viktimës dhe, nga dhjetë deri në njëzet vjet burgim për rastet e tjera.

Neni 198

### **Krime kundër njerëzimit**

1. Dhënia e urdhrave ose kryerja e krimeve të mëposhtme, si pjesë e një sulmi të gjerë sistematik të qëllimtë, drejtuar kundër çdo popullsie civile, apo një pjese të saj, si:

- a) vrasje;
- b) shfarosje;
- c) skllavërim;
- ç) deportim ose transferim i dhunshëm i popullsisë;
- d) burgosje ose privim i rëndë i lirisë fizike, duke shkelur rregullat themelore të së drejtës ndërkombëtare;
- dh) torturë;
- e) përdhunim, skllavërim seksual, prostitucion i detyruar, shtatzëni e detyruar, sterilizim i detyruar apo çdo formë tjetër e dhunës seksuale e krahasueshme me këto;
- ë) persekutim i çdo grupi të identifikueshëm të bashkësisë, në bazë të përkatësisë politike, racore, kombëtare, etnike, kulturore, fetare ose gjinore, ashtu siç është parashikuar në paragrafin e tretë të këtij neni, ose për shkaqe të tjera që janë të gjithëpranuara si të palejueshme në bazë të së drejtës ndërkombëtare, në lidhje me çdo akt të përmendur në këtë paragraf ose çdo krim brenda juridiksionit të Gjykatës Ndërkombëtare Penale;
- f) zhdukje e detyruar e personave;
- g) krimi i aparteidit;
- gj) akte të tjera të ngjashme jonjerëzore që shkaktojnë qëllimisht vuajtje të mëdha, ose dëmtime serioze trupore ose të shëndetit fizik a mendor;

dënohen jo me pak sesa njëzet e pesë vjet burgim ose me burgim të përjetshëm. Nëse viktimat të krimeve të përmendura në këtë paragraf janë të miturit apo persona me aftësi të kufizuara, dënohen me burgim jo më pak sesa 30 vjet ose, me burgim të përjetshëm.

2. Për qëllim të këtij ligji, në përmbajtjen e krimeve të parashikuara në paragrafin e parë, do të kuptohen:

- a) “Sulmi i drejtuar kundër çdo popullsie civile” nënkupton mënyrën e sjelljes që përfshin kryerjen e shumëfishtë të akteve të parashikuara në paragrafin e parë kundër çdo popullsie civile, në pajtim me ose në ndihmë të politikës shtetërore ose organizative për të kryer një sulm të tillë;
- b) “Shfarosja” përfshin imponimin e qëllimshëm të kushteve të jetës një grupi, ndër të tjera, heqjen e mundësisë për ushqim dhe barna, me qëllim shkatërrimin e një pjese të popullsisë;
- c) “Skllavërimi” nënkupton ushtrimin e një ose të gjitha kompetencave që lidhen me të drejtën e pronësisë mbi një person si dhe, ushtrimin e një kompetence të tillë nëpërmjet trafikimit të personave, sidomos të grave dhe fëmijëve;
- c) “Deportimi ose transferimi i dhunshëm i popullsisë” nënkupton zhvendosjen e dhunshme të personave, përmes dëbimit ose akteve të tjera detyruese, nga rajoni në të cilin ata qëndrojnë në mënyrë të ligjshme, dhe që nuk bazohet në të drejtën ndërkombëtare;
- d) “Tortura” nënkupton shkaktimin e qëllimshëm të dhimbjeve ose vuajtjeve të rënda fizike ose mendore një personi të ndaluar ose nën kontrollin e të akuzuarit. Nuk përfshihen në konceptin e

torturës dhimbja ose vuajtja që rrjedh në mënyrë të pazgjidhshme nga vendimet e marra nga gjykata në mënyrë të ligjshme ;

dh) “Shtatzënia e dhunshme” nënkupton izolimin e paligjshëm të një gruaje të lënë shtatzënë me dhunë, me qëllim ndikimin në përbërjen etnike të çdo popullsie, ose kryerjen e shkeljeve të tjera të rënda të së drejtës ndërkombëtare;

e) “Persekutimi” nënkupton privimin e qëllimshëm dhe të rëndë nga të drejtat themelore, që është në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare, bazuar mbi identitetin e grupit ose bashkësisë;

e) “Krimi i aparteidit” nënkupton aktet çnjerëzore të ngjashme me ato të parashikuara në paragrafin e parë, të kryera në kontekstin e regjimit të institucionalizuar të shtypjes sistematike dhe dominimit të një grupi racor mbi grupin ose grupet e tjera racore dhe të kryera me qëllimin mbajtjen e atij regjimi;

f) “Zhdukja e detyruar e personave” nënkupton arrestimin, ndalimin ose rrëmbimin e personave nga autoritetet, të përkrahur ose pranuar nga shteti ose organizata politike, e pasuar nga refuzimi për të njohur një privim të tillë lirie ose për të dhënë informacion rreth fatit ose vendndodhjes së këtyre personave, me qëllim largimin e tyre nga mbrojtja ligjore për një periudhë të gjatë kohe.

3. Për qëllim të këtij ligji, fjala “gjini” kuptohet se ka të bëjë me të dy gjinitë, mashkullore e femërore, brenda kontekstit të shoqërisë. Fjala “gjini” nuk nënkupton ndonjë koncept të ndryshëm nga ai i përmendur më sipër.

Neni 199

### **Krimet e luftës kundër personave**

1. Shkelja e rregullave të së drejtës ndërkombëtare gjatë një konflikti të armatosur ndërkombëtar ose një konflikti të armatosur që nuk ka karakter ndërkombëtar, kur janë kryer si pjesë e një plani ose qëllimi politik, ose si pjesë e kryerjes së krimeve të tilla në shkallë të gjerë, duke urdhëruar ose kryer një nga veprimet e mëposhtme:

a) vrasjen e një personi që duhet të mbrohet sipas të drejtës ndërkombëtare humanitare;

b) marrjen peng të një personi që duhet të mbrohet sipas të drejtës ndërkombëtare humanitare;

c) trajtimin mizor ose çnjerëzor të një personi që duhet të mbrohet sipas të drejtës ndërkombëtare humanitare duke i shkaktuar dëmtime ose vuajtje të mëdha fizike apo mendore, veçanërisht duke e torturuar ose gjymtuar atë;

ç) skllavërimin seksual, përdhunimin, prostitucionin e detyruar ose privimin e një personi që duhet të mbrohet sipas të drejtës ndërkombëtare humanitare nga aftësia e tij ose e saj riprodhuese, ose izolimin e paligjshëm të një gruaje të lënë shtatzënë me dhunë me qëllim ndikimin në përbërjen etnike të çdo popullsie;

d) rekrutimin ose regjistrimin e fëmijëve nën moshën pesëmbëdhjetë vjeç në forcat e armatosura ose në grupe të armatosura, ose përdorimin e tyre për të marrë pjesë aktivisht në konflikte;

dh) deportimin ose transferimin e dhunshëm, nëpërmjet dëbimit ose akte të tjera detyruese, të një personi që duhet të mbrohet sipas të drejtës ndërkombëtare humanitare, nga zona në të cilën qëndron në mënyrë të ligjshme në një shtet tjetër ose në një zonë tjetër në kundërshtim me një rregull të përgjithshëm të së drejtës ndërkombëtare;

e) dhënien e dënimit ose vënien në ekzekutim të një dënimi kryesor në lidhje me një person që duhet të mbrohet sipas së drejtës ndërkombëtare humanitare, sidomos dënimin me vdekje ose me burgim, pa iu nënshtruar një gjykimi të drejtë dhe të rregullt që ofron garancitë ligjore të pranuar nga e drejta ndërkombëtare;

ë) ekspozimin e një personi që duhet të mbrohet sipas të drejtës ndërkombëtare humanitare ndaj rrezikut të vdekjes ose dëmtimit të rëndë të shëndetit në këto mënyra:

- i. duke kryer eksperimente mbi këtë person, pa dhënë më parë pëlqimin e tij/saj vullnetar dhe të shprehur, ose kur eksperimentet në fjalë nuk janë as të nevojshme nga pikëpamja mjekësore dhe as të kryera në interesin e tij/saj personal;
- ii. duke marrë inde trupore ose organe nga një person i tillë për qëllime transplantimi për aq sa nuk përbën marrje të gjakut ose lëkurës për qëllime terapeutike në përputhje me parimet mjekësore të njohura përgjithësisht dhe kur personi nuk ka dhënë më parë vullnetarisht dhe në mënyrë të shprehur pëlqimin e tij/saj;
- iii. duke përdorur për personin metoda trajtimi që nuk njihen nga shkenca e mjekësisë, pa qenë këto metoda të nevojshme nga pikëpamja mjekësore dhe pa u dhënë më parë pëlqimi i tij/saj vullnetar dhe në mënyrë të shprehur;

f) trajtimin e një personi që duhet të mbrohet sipas të drejtës ndërkombëtare humanitare në mënyrë poshtëruese dhe degraduese,

dënohet me burgim jo më pak sesa njëzet e pesë vjet dhe, kur si pasojë ka ardhur vrasja apo vdekja e personit, jo më pak sesa tridhjetë vjet ose, me burgim të përjetshëm. Burgimi i përjetshëm jepet edhe nëse ndonjë prej krimeve të përmendura në këtë paragraf, pavarësisht nëse ka sjellë vdekjen apo vrasjen e viktimës, është kryer ndaj viktimave të mitur apo personave të paaftë për të vepruar.

2. Dhënia e urdhrorit ose vrasja a plagosja, për qëllimet e parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni, gjatë një konflikti të armatosur ndërkombëtar ose një konflikti të armatosur që nuk ka karakter ndërkombëtar, e një pjesëtari të forcave të armatosura kundërshtarë ose e një luftëtari të palës kundërshtarë pasi ky i fundit ka hedhur poshtë armët pa kushte ose është vendosur jashtë fushëbetejës për shkak të sëmundjes, plagëve, ndalimit ose çfarëdolloj shkakut tjetër, dënohet me burgim jo më pak se njëzet e pesë vjet ose me burgim të përjetshëm.

3. Dhënia e urdhrave ose kryerja e akteve të mëposhtme gjatë një konflikti të armatosur ndërkombëtar:

a) mbajtja në mënyrë të paligjshme si i burgosur ose pengimi i pajustificuar për t'u kthyer në shtëpi i një personi të mbrojtur sipas shkronjës “dh” të paragrafit të parë të këtij neni;

b) transferimi, nga anëtari i një force pushtuese, i pjesëve të popullsisë së saj civile në territorin e pushtuar;

c) shtrëngimi i një personi të mbrojtur sipas shkronjës “dh” të paragrafit të parë të këtij neni, nëpërmjet përdorimit të forcës apo kërcënimit për t'i shkaktuar një dëm të rëndë, për të shërbyer në forcat e një fuqie armiqësore;

ç) shtrëngimi nëpërmjet përdorimit të forcës apo kërcënimit për t'i shkaktuar një dëm të rëndë një shtetasi të palës kundërshtarë për të marrë pjesë në operacionet e luftës të drejtuara kundër vetë shtetit të tij/saj,

dënohet me burgim jo më pak sesa njëzet vjet dhe, kur si rezultat i veprimeve të mësipërme, ka ardhur vdekja e personit, jo më pak sesa njëzet e pesë vjet ose, me burgim të përjetshëm.

4. Në kuptim të këtij neni, me akt ndërkombëtar do të jenë Konventat e Gjenevës të 12 gushtit 1949. Ndërsa personat të cilët duhet të mbrohen sipas të drejtës ndërkombëtare humanitare janë si më poshtë:

a) në një konflikt të armatosur ndërkombëtar: personat e mbrojtur sipas cilësimeve të Konventave të Gjenevës dhe të Protokollit Shtesë të Konventave të Gjenevës, janë përkatësisht të plagosurit, të sëmurët, të mbijetuarit nga fundosja e anijes, të burgosurit e luftës dhe civilët;

b) në një konflikt të armatosur që nuk ka karakter ndërkombëtar, janë: të plagosurit, të sëmurët, të mbijetuarit nga fundosja e anijes si dhe personat që nuk marrin pjesë aktive në veprimet luftarake, të cilët janë nën pushtetin e palës kundërshtare;

c) në një konflikt të armatosur ndërkombëtar dhe në një konflikt të armatosur që nuk ka karakter ndërkombëtar: pjesëtarët e forcave të armatosura dhe luftëtarët e palës kundërshtare, ku secili syresh kanë hedhur poshtë armët ose nuk kanë mjete të tjera mbrojtjeje.

#### Neni 200

### **Krimet e luftës me përdorimin e mjeteve të ndaluara të luftimeve**

1. Dhënia e urdhrave ose kryerja gjatë një konflikti të armatosur ndërkombëtar ose një konflikti të armatosur që nuk ka karakter ndërkombëtar, kur janë kryer si pjesë e një plani ose qëllimi politik, e veprimeve të mëposhtme:

a) përdorimi i helmeve ose armëve helmuese;

b) përdorimi i armëve biologjike ose kimike;

c) përdorimi i plumbave që zgjerohen ose shpërndahen lehtësisht në trupin e njeriut, veçanërisht plumbat me mbështjellje të fortë të cilët nuk e mbulojnë në tërësi pjesën e brendshme ose që janë me prerje,

dënohet me burgim jo më pak se njëzet e pesë vjet.

2. Kur nga kryerja e akteve të parashikuara në paragrafin e parë shkaktohet vdekja ose dëmtimi i rëndë i një civili ose i një personi të mbrojtur sipas të drejtës ndërkombëtare humanitare, dënohet jo më pak sesa tridhjetë vjet burgim, ose me burgim të përjetshëm.

3. Shkaktimi me dashje i vdekjes së viktimit duke përdorur mjetet e përmendura në paragrafin e parë, dënohet me burgim jo më pak sesa tridhjetë vjet, ose me burgim të përjetshëm.

#### Neni 201

### **Krimet e luftës kundër pasurisë dhe të drejtave të tjera**

1. Dhënia e urdhrave ose kryerja, gjatë një konflikti të armatosur ndërkombëtar ose një konflikti të armatosur që nuk ka karakter ndërkombëtar, kur janë kryer si pjesë e një plani ose qëllimi politik, të plaçkitjes ose shkatërrimit masiv, përvetësimit ose konfiskimit të pasurisë së palës kundërshtare në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare, përveç rasteve kur shkatërrimi, përvetësimi ose konfiskimi kërkohet për shkak të nevojave të konfliktit të armatosur, kur pasuria është në pushtetin e palës së autorit të krimit, dënohet nga pesëmbëdhjetë deri në njëzet e pesë vjet burgim.

2. Deklarimi për të njëjtat qëllime, gjatë një konflikti të armatosur ndërkombëtar dhe në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare, i të drejtave dhe veprimeve të të gjithë shtetasve të palës armiqësore ose të një pjese të konsiderueshme të tyre, si të hequra apo të pezulluara dhe, të drejtat e tyre nuk lejohen të shqyrtohen në një gjykatë, dënohet nga dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet burgim.

#### Neni 202

### **Krimet e luftës kundër operacioneve humanitare dhe shenjave dalluese**

1. Dhënia e urdhrave ose kryerja gjatë një konflikti të armatosur ndërkombëtar ose gjatë një konflikti të armatosur që nuk ka karakter ndërkombëtar, kur janë kryer si pjesë e një plani ose qëllimi politik, të veprimeve të mëposhtme:

a) drejtimi i një sulmi kundër personelit, instalimeve, materialeve, njësive ose automjeteve të përfshira në një ndihmë humanitare ose mision paqeruajtës në pajtim me Kartën e Kombeve të Bashkuara, për sa kohë ata kanë të drejtë të mbrojnë civilët ose objektet civile sipas të drejtës ndërkombëtarëve humanitare;

b) drejtimi i një sulmi kundër personelit, ndërtesave, materialeve, njësive mjekësore dhe transportuese, që përdorin shenjat dalluese të Konventave të Gjenevës, në pajtim me të drejtën ndërkombëtare humanitare,

dënohet nga dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet burgim.

2. Dhënia e urdhrave ose përdorimi i padrejtë, gjatë një konflikti të armatosur ndërkombëtar ose një konflikti të armatosur që nuk ka karakter ndërkombëtar, i shenjave dalluese të Konventave të Gjenevës, të flamurit të paqes, të flamurit ose të simboleve ushtarake ose të uniformës së armikut ose të Kombeve të Bashkuara, ku ka shkaktuar vdekjen ose dëmtimin e rëndë të personit dënohet me burgim jo më pak se njëzet e pesë vjet apo me burgim të përjetshëm.

## Neni 203

### **Agresioni ushtarak**

1. Kryerja e një lufte agresioni ose çdo akti tjetër agresioni, kur janë kryer si pjesë e një plani ose qëllimi politik, pavarësisht nëse është shpallur luftë më parë apo jo, duke komanduar një aksion të armatosur të një shteti kundër sovranitetit, integritetit territorial ose pavarësisë politike të një shteti tjetër, nëpërmjet:

a) pushtimit ose sulmit nga forcat e armatosura të një shteti të territorit të një shteti tjetër ose çdo pushtim ushtarak, qoftë edhe i përkohshëm, që rezulton nga një ndërhyrje ose sulm i tillë ose çdo lloj aneksimi, me përdorimin e forcës, i territorit të një shteti tjetër ose të një pjese të tij;

b) bombardimit nga forcat e armatosura të një shteti kundër territorit të një shteti tjetër ose përdorimi i çdo arme tjetër nga një shtet kundër territorit të një shteti tjetër;

c) bllokimit të porteve ose brigjeve të një shteti nga forcat e armatosura të një shteti tjetër;

ç) sulmit nga forcat e armatosura të një shteti kundër forcave tokësore, detare ose ajrore të një shteti tjetër ose kundër flotës së tij detare ose ajrore;

d) përdorimit të forcave të armatosura të një shteti që ndodhen në territorin e një shteti tjetër me marrëveshjen e këtij të fundit, në kundërshtim me kushtet e përcaktuara në marrëveshje, ose çdo zgjatje e qëndrimit të tyre në territorin në fjalë pas përfundimit të marrëveshjes;

dh) lejimit nga një shtet që territori i tij, i vënë në dispozicion të një shteti tjetër, të përdoret nga ky i fundit për të kryer një akt agresioni kundër një shteti të tretë,

dënohet me burgim jo më pak se 15 vjet ose me burgim të përjetshëm.

2. Planifikimi, përgatitja ose fillimi i luftës së agresionit ose çdo akti tjetër agresioni dënohet me burgim nga 5 deri në 10 vjet.

3. Dhënia e urdhrave ose dërgimi, me qëllimin e zhvillimit të një lufte agresioni të një shteti kundër një shteti tjetër, i grupeve të armatosura mercenare ose forcave të tjera të armatosura paraushtarake në një shtet tjetër, në mënyrë që këto forca të arrijnë qëllimet e një lufte agresioni, dënohet me burgim nga 7 deri në 12 vjet.

4. Zbatimi i detyrave në përputhje me urdhrin e dhënë për veprim nga forcat e armatosura ose nga forcat e armatosura paraushtarake me qëllim të zhvillimit të një lufte agresioni, dënohet me burgim nga 3 deri në 7 vjet.

5. Për qëllim të këtij neni:

a) "krim agresioni" nënkupton planifikimin, përgatitjen, fillimin ose ekzekutimin, nga një person i aftë për të ushtruar në mënyrë efektive kontrollin ose për të drejtuar veprimtarinë politike ose forcën ushtarake të një shteti, e një akti agresioni që për nga karakteri, rrezikshmëria dhe përmasat e tij përbën një shkelje të dukshme të Kartës së Kombeve të Bashkuara të 26 qershorit 1945;

b) "akt agresioni" nënkupton përdorimin e forcave të armatosura nga një shtet kundër sovranitetit, integritetit territorial ose pavarësisë politike të një shteti tjetër, ose në çdo mënyrë tjetër që vjen në kundërshtim me Kartën e Kombeve të Bashkuara.

#### Neni 204

### **Shkelja e detyrave të mbikëqyrjes**

1. Moskryerja me dashje ose me pakujdesi e detyrave të mbikëqyrjes nga komandanti ushtarak, ndaj vartësit nën komandën e tij ose nën kontrollin e tij efektiv, kur vartësi kryen njërin prej krimeve të parashikuara nga nenet 197-203 të këtij Kodi si dhe kur komandanti ka qenë në gjendje të parashikonte dhe të parandalonte kryerjen e afërt të një krimi të tillë, dënohet me burgim nga 7 deri në 15 vjet.

2. Moskryerja me dashje ose nga pakujdesia e detyrave të mbikëqyrjes nga eprori civil, ndaj vartësit nën autoritetin e tij ose nën kontrollin e tij efektiv, kur vartësi kryen njërin prej krimeve të parashikuara nga nenet 197-203 të këtij Kodi si dhe kur komandanti ka qenë në gjendje të parashikonte dhe të parandalonte kryerjen e afërt të një krimi të tillë, dënohet me burgim nga 3 deri në 7 vjet.

3. Në kuptim të këtij neni, me komandantin ushtarak do të barazohet çdo person që në mënyrë efektive jep urdhra ose ushtron komandë dhe kontroll në një njësi. Me eprorin civil do të barazohet çdo person që ushtron efektivisht komandën dhe kontrollin në një organizatë civile ose në një ndërmarrje.

#### Neni 205

### **Mosraportimi i krimeve të luftës**

Mosraportimi, nga komandanti ushtarak ose eprori civil, për kryerjen nga një vartës të njërit prej krimeve të parashikuara nga nenet 197-203 të këtij kreu, pranë organeve kompetente, dënohet me burgim nga 4 deri në 8 vjet.

#### Neni 206

### **Shpërndarja e materialeve pro gjenocidit ose krimeve kundër njerëzimit**

1. Ofrimi ose shpërndarja e qëllimshme në publik, ose nëpërmjet sistemeve kompjuterike, e materialeve, që mohojnë, minimizojnë, në mënyrë të ndjeshme, miratojnë ose justifikojnë akte, që përbëjnë gjenocid, krim kundër njerëzimit, krim lufte ose agresionit, drejtuar kundër një grupi personash ose një anëtarit të një grupi të tillë të përcaktuar duke iu referuar racës, ngjyrës ose

sjelljes, fesë, prejardhjes kombëtare, kur ka gjasa që të kryhen përmbi racën, ngjyrën, sjelljen, fenë, përkatësinë kombëtare nxitja e dhunës ose urrejtjes kundër një grupi të tillë ose një anëtar të një grupi të tillë, dënohet me burgim nga dy deri në kater vjet.

2. Provokimi nëpërmjet çdo forme për të kryer krimet e gjenocidit, krime kundër njerëzimit, krime të luftës apo agresionit, kur pasoja e kërkuar ende nuk ka ardhur, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.

3. Për qëllim të dy paragrafëve më lart do të vlerësohen si krime të gjenocidit, krime kundër njerëzimit, krime të luftës apo agresionit, përkufizimet e parashikuara në këtë ligj, në të drejtën ndërkombëtare dhe/apo të njohura si të tilla me vendime të formës së prerë dhe të detyrueshme të gjykatave ndërkombëtare penale të krijuara në përputhje me instrumentet përkatëse ndërkombëtare të njohura nga shtetet palë.

Neni 207

### **Kryerja e veprave penale nga personat juridikë**

Kur veprat penale të përmendura në këtë titull janë kryer edhe nga një person juridik, ai dënohet me pesëfishin e gjobës të caktuar në nenin 123 të këtij Kodi dhe, mbyllet e veprimtarisë së tij përgjithmonë.

Neni 208

### **Dënimet plotësuese**

1. Kur veprat penale të parashikuara në këtë titull kryhen nga zyrtari publik, gjykata, krahas dënimit kryesor cakton edhe dënimin plotësues të heqjes të së drejtës për të ushtruar funksione publike sipas parashikimeve të nenit 76 të këtij Kodi.

2. Gjykata, kur çmon se nga kryerja e krimeve të parashikuara në këtë titull janë përfituar të mira materiale, urdhëron konfiskimin e tyre, përveç sendeve që kanë shërbyer për kryerjen e veprave penale.

Neni 209

### **Konkurrimi i veprave**

Në të gjitha rastet kur autorit, për të kryer një prej veprave penale të parashikuara në këtë titull, i është dashur të kryejë veprime që përbëjnë vepër penale më vete, atëherë kjo e fundit konkurren me veprën që ai ka dashur të kryejë.

## **TITULLI II**

### **VEPRAT PENALE KUNDËR PAVARËSISË DHE RENDIT KUSHTETUES**

#### **KREU I**

### **VEPRA PENALE KUNDËR PAVARËSISË DHE TËRËSISË TERRITORIALE**

## Neni 210

### **Dorëzimi i territorit**

1. Dorëzimi plotësisht, pjesërisht apo edhe përkohësisht i territorit një shteti, fuqie apo agjentëve të huaj, me qëllim cenimin e pavarësisë dhe integritetit territorial të vendit, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.

2. Kur mungon qëllimi i parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni dhe dorëzimi nuk varet nga detyrimet e caktuara nga ligji, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

## Neni 211

### **Cenimi i territorit**

Kryerja e veprimeve të atilla që favorizojnë një fuqi, agjenturë apo një shtet të huaj, me qëllim cenimin ose vënien në rrezik të tërësisë tokësore të vendit dhe rendin kushtetues, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.

## Neni 212

### **Marrëveshja për ndërhyrje të armatosur**

Marrëveshja e bërë me fuqi, agjentë apo shtete të huaja për të shkaktuar ndërhyrje të armatosur kundër territorit të Republikës së Shqipërisë, dënohet me burgim nga dhjetë deri nëpesëmbëdhjetë vjet.

## Neni 213

### **Sabotimi**

1. Shkatërrimi apo dëmtimi i mjeteve, pajisjeve, aparaturave, armatimit, teknikës luftarake apo objekteve mbrojtëse ushtarake, me qëllim uljen e aftësisë mbrojtëse të vendit, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

2. Shkatërrimi, dëmtimi ose ndryshimi i destinacionit të çdo dokumenti, ndërtimi, pajisjeje, instalimi, aparature, pajisjeje teknike ose sistemi të përpunimit të automatizuar të të dhënave ose kryerja e punimeve të dobëta në to, të bëra në mënyrë të tillë që dëmtojnë interesat themelore të shtetit për të ulur aftësinë mbrojtëse të vendit, dënohet me burgim nga dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

3. Kur këto veprime kryhen në interes të një fuqie, agjente ose shteti të huaj, dënohet me burgim nga dymbëdhjetë deri në njëzet vjet.

## Neni 214

### **Sigurimi i mjeteve për sabotim**

Prodhimi apo mbajtja e mjeteve për të kryer veprimet e parashikuara në nenin 213 të këtij Kodi, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet.

## Neni 215

### **Marrëveshja për dorëzimin e territorit**

1. Marrëveshja e bërë për të kryer krimet e parashikuara në nenin 210 të këtij Kodi, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet.
2. Kur mungon qëllimi i parashikuar në paragrafin e parë të nenit referues apo, dorëzimi nuk varet nga detyrimet e caktuara nga ligji, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet.

## Neni 216

### **Sigurimi i informatave**

Sigurimi i informatave, të dhënave ose skedarëve të informatizuar, rreth objekteve apo dokumenteve sekrete me karakter ushtarak apo të çdo lloji tjetër një shteti, me qëllim që ato t'i jepen një agjente apo fuqie të huaj për të dëmtuar interesat themelore të shtetit, cenuar pavarësinë apo integritetin territorial të vendit, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.

## Neni 217

### **Zbulimi i kodeve me rëndësi kombëtare**

1. Zbulimi i çdo të dhëne që mund të çojë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në zbulimin e përdorimit të një kodi të sigurisë së brendshme kombëtare, të një identiteti të fshehur ose të një cilësie të rreme të një agjenti të një shërbimi sekret apo të përkatësisë së tij në njërin prej këtyre shërbimeve, që për shkak të rëndësisë së shërbimit mbahen nën sekret me rëndësi kombëtare në identitetin e vërtetë, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.
2. Kur nga ky zbulim është shkaktuar dëmtimi i integritetit trupor ose mendor i këtyre personave ose bashkëshortëve, bashkëjetuesve ose të paralindurve ose të paslindurve të tyre të drejtpërdrejtë, dënohet me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.
3. Kur nga zbulimi i të dhënave është shkaktuar vdekja e këtyre personave ose e bashkëshortit, bashkëjetuesit, të parë lindurve ose të paslindurve të drejtpërdrejtë, dënohet me burgim nga njëzet deri në tridhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.
4. Ky nen gjen zbatim për zbulimin e çdo informacioni që mund të çojë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në identifikimin real ose të supozuar të një personi si burim ose bashkëpunëtor i një shërbimi të përmendur në paragrafin e parë të këtij neni.

## Neni 218

### **Zbulimi i identitetit**

1. Zbulimi ose përhapja, me çfarëdo mjeti ose mënyre, e çdo informacioni që mund të çojë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në identifikimin e një personi si pjesëtar i njësisë së forcave speciale ose njësisë ndërkombëtare të ndërhyrjes së specializuar në luftën kundër terrorizmit, që vepron në ruajtje të interesave kombëtare apo të forcave ndërkombëtare në luftën kundër terrorizmit të çfarëdo lloji, dënohet me burgim nga pesë deri në dymbëdhjetë vjet.

2. Kur nga ky zbulim është shkaktuar dëmtimi i integritetit trupor ose mendor i këtyre personave ose bashkëshortëve, bashkëjetuesve ose të paralindurve ose të paslindurve të tyre të drejtpërdrejtë, dënohet me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.

3. Kur nga zbulimi i të dhënave është shkaktuar vdekja e këtyre personave ose e bashkëshortit, bashkëjetuesit, të parëlindurve ose të paslindurve të drejtpërdrejtë, dënohet jo më pak se sa njëzet e pesë vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.

4. Ky nen gjen zbatim për zbulimin e çdo informacioni që mund të çojë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në identifikimin real ose të supozuar të një personi si burim ose bashkëpunëtor i një shërbimi të përmendur në paragrafin e parë të këtij neni.

#### Neni 219

### **Zbulimi i të dhënave sekrete industriale**

Zbulimi ndaj të tretëve apo përdorimi i të dhënave të cilat përbëjnë sekret tregtar, praktika të reja industriale, shpikje, zbulime shkencore ose profesionale të njohura si sekret shtetëror nga ligji përkatës për shkak të interesave kombëtare të mbrojtura, që kryhet nga ana e personave publikë me detyrë ruajtjen e tyre, pavarësisht qëllimit për të cilën kryhet, dënohet me burgim nga pesë deri në tetë vjet dhe, shoqërohet me dënimin plotësues të heqjes të së drejtës për të ushtruar funksione publike.

#### Neni 220

### **Humbja e dokumenteve sekrete**

Humbja e dokumenteve apo materialeve të tjera që, sipas ligjit të njohur publikisht, përbëjnë sekret shtetëror, nga personi që i janë besuar për ruajtje apo për përdorim, dënohet me gjobë ose me burgim një deri në tre vjet dhe shoqërohet me dënimin plotësues të heqjes të së drejtës për të ushtruar funksione publike.

#### Neni 221

### **Provokimi i luftës**

1. Kryerja e veprimeve të atilla agjenturore apo edhe haptazi armiqësore, nga persona vendas apo të huaj, që synojnë të provokojnë luftë apo të vënë Republikën e Shqipërisë përpara rrezikut të ndërhyrjes nga fuqi të huaja, dënohet me burgim nga gjashtë deri në dymbëdhjetë vjet.

2. Kur lufta ka ndodhur, dënohet nga njëzet deri në tridhjetë vjet, ose me burgim të përjetshëm.

#### Neni 222

### **Tradhtia ndaj Atdheut**

1. Vënia në shërbim të një shteti apo një fuqie të huaj të çdo shtetasi shqiptar, me qëllim kryerjen e veprave kundër pavarësisë dhe integritetit të Republikës së Shqipërisë, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.

2. Kur tradhtia kryhet nga një person në shërbim në forcat e armatosura, shërbimet e sigurisë kombëtare apo cilido person tjetër që është betuar të mbrojë Kushtetutën dhe interesat kombëtare të Atdheut, dënohet me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.

Neni 223

### **Marrja e shpërblimeve**

Marrja apo marrëveshja për të marrë shpërblim apo përfitime të tjera materiale, për të kryer në favor të shteteve, agjenturave apo fuqive të huaja një nga krimet e parashikuara në këtë kre, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.

Neni 224

### **Provokimi**

Provokimi për të kryer ndonjërin nga krimet e parashikuara në këtë kre të këtij titulli të Kodit Penal dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Neni 225

### **Gjendja e luftës**

Në rast se krimet e parashikuara në këtë kre kryhen në gjendjen e luftës apo situatës së jashtëzakonshme të deklaruar sipas ligjit, dënimi me burgim do të shtohet me një të tretën e dënimit që gjykata do të jepte nëse krimi do të kryhej në gjendje normale.

Neni 226

### **Juridiksioni i veçantë**

Kur secila nga veprat penale të parashikuara në këtë kre të titullit II të Kodit Penal, është shkaktuar në dëm të fuqive nënshkruese të Traktatit të Atlantikut të Veriut ose Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut, gjykata shqiptare ka juridiksion në gjykimin dhe shqyrtimin e tyre, pavarësisht parashikimeve të përgjithshme të bëra në nenin 13 të këtij Kodi.

Neni 227

### **Kryerja e veprës nga personi juridik**

1. Kur veprat penale të përmendura në nenet 213, 214, 216, 218, 219, 221, 223 dhe 224 të këtij kreu, janë kryer edhe nga një person juridik, gjykata cakton një nga masat paraprake të përshtatshme, sipas nenit 121, paragrafi i tretë, që siguron zbatimin e vendimit përfundimtar të gjykatës, dhe mbështetur në nenin 121, paragrafi i dytë i këtij Kodi, dënohen:

- a) me gjobë deri në pesëfishin e vlerës së parashikuar në nenin 123; ose
- b) me mbarimin e personit juridik.

2. Gjukata në çdo rast vendos edhe konfiskimin e mjediseve në të cilat autorët e veprës kanë vepruar për kryerjen e veprave penale dhe publikimin e vendimit gjyqësor.

Neni 228

### **Dënimet plotësuese**

1. Nëse veprat penale të parashikuara në nenet e këtij kreu kryhen nga zyrtari publik, atëherë gjykata, krahas dënimit kryesor cakton edhe dënimin plotësues heqjen e së drejtës për të ushtruar një funksion publik në zbatim të nenit 76 të këtij Kodi.

2. Nëse i dënuari është shtetas i huaj, por ndodhet në Republikën e Shqipërisë, gjykata vendos edhe dënimin plotësues nxjerrjen e tij jashtë territorit të Republikës.

3. Në çdo rast gjykata vendos masën e zëvendësimit të demit të shkaktuar dhe, përveç sendeve që kanë shërbyer për kryerjen e veprave penale, kur vepra penale është kryer nga subjektet me qëllim përfitimi material apo të premtuar, vendoset konfiskimi i të ardhurave nga vepra penale apo të premtuara.

## KREU II VEPRAT PENALE KUNDËR RENDIT KUSHTETUES

### Neni 229 **Kryengritja**

1. Pjesëmarrja në veprime masive të dhunshme, si vendosje pengesash apo barrikadash për të ndaluar forcat e rendit, rezistenca me armë apo çarmatosja e tyre, pushtimi me forcë i ndërtesave, kryerja e plaçkitjeve, grumbullimi apo vënia në dispozicion e armëve, municioneve dhe njerëzve, krijimi i lehtësirave në favor të kryengritësve, të bëra për të përmbysur rendin kushtetues, dënohen më burgim nga pesëmbëdhjetë deri në njëzet e pesë vjet.

2. Udhëheqja ose organizimi i kryengritjes, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm.

### Neni 230 **Atentati**

1. Kryerja e vrasjeve, rrëmbimeve, torturave apo akteve të tjera të dhunës kundër përfaqësuesve më të lartë të shtetit, me qëllim për të përmbysur rendin kushtetues, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.

2. Për efekt të këtij neni, me përfaqësues të lartë të shtetit do të kuptohen, Kryetari i Shtetit, Kryeministri, Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë si dhe, çdo individ që është duke i zëvendësuar ata në detyrë, qoftë edhe përkohësisht.

3. Për qëllim të këtij kreu, me përmbysje të rendit kushtetues do të kuptohet veprimi për të cenuar apo përmbysur të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, liritë vetjake dhe ato politike të tij, sistemin qeverisës apo formën e tij, cenimin e sovranitetit apo tërësisë territoriale të vendit, ndarjen e pushteteve apo, edhe vetëm zëvendësimin e viktimës në ushtrimin e detyrës kushtetuese me një prej mënyrave të shënuara në paragrafin e parë të këtij neni.

### Neni 231 **Komploti**

Marrja e vendimeve, sigurimi i bashkëpunëtorëve apo kushteve materiale, të dhënave, mjeteve apo planeve nga një grup njerëzish me qëllim për të kryer njërën prej veprave penale të parashikuara në nenet 229, 230, 232 të këtij Kodi, dënohet me burgim nga 5 deri në 15 vjet.

#### Neni 232

### **Thirrjet për armatosje ose krijim turmash të armatosura**

1. Thirrjet për veprime të dhunshme apo për armatosje kundër rendit kushtetues, krijimi apo organizimi i turmave apo trupave të armatosura në kundërshtim me ligjin, me qëllim për t'iu kundërvënë rendit kushtetues, dënohen me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.

2. Me cenim të rendit kushtetues do të kuptohet veprimi i qëllimtë prej personave që synojnë cunimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, lirive vetjake dhe ato politike të tij, sistemin qeverisës apo formën e tij, cenimin e sovranitetit apo tërësisë territoriale të vendit, ndarjen e pushteteve apo, edhe vetëm thirrjet për zëvendësimin e viktimës në ushtrimin e detyrës kushtetuese me një prej mënyrave të shënuara në paragrafin e parë të këtij neni.

3. Nëse thirrjet për të kryer krimet e parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni bëhen nëpërmjet çdo mjeti komunikimi ose kompjuterik apo telematik, dënimi penal shtohet me një të katërtën e tij.

#### Neni 233

### **Rikrijimi i partive dhe shoqatave antikushtetuese**

1. Rikrijimi i një partie, organizate ose shoqate të ndaluar të veprjë nga gjykata kompetente si antikushtetuese apo vazhdimi i veprimtarisë në mënyrë të fshehtë ose të hapur të saj, shpërndarja e shkrimeve apo përdorimi i simboleve të tyre, dënohet me gjobë ose me burgim deri në katër vjet.

2. Nëse personi drejtues i partisë, organizatës apo shoqatës së deklaruar antikushtetuese vazhdon të ushtrojë funksionet sipas paragrafit të parë të këtij neni, dënohet me një të tretën e dënimit më shumë.

#### Neni 234

### **Shpërndarja e shkrimeve antikushtetuese**

Shpërndarja apo futja e materialeve, shkrimeve apo simboleve nga jashtë në Republikën e Shqipërisë, të cilat synojnë përmbysjen e rendit kushtetues a cenimin e tërësisë tokësore të vendit, dënohet me gjobë ose me burgim nga një deri në tre vjet.

#### Neni 235

### **Përdhosja e Republikës dhe simboleve të saj**

1. Përdhosja e Himnit Kombëtar, flamurit apo stemës së Republikës të ekspozuara në institucionet shtetërore, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj ose, jo më pak se sa dy dënime plotësuese kur çmohet se arrihet qëllimi i dënimit penal nëpërmjet tyre.

2. Përdhosja e Republikës, Presidentit, Kuvendit, Këshillit të Ministrave, Gjykatës Kushtetuese ose sistemit gjyqësor, forcave të armatosura apo dëshmorëve të Atdheut, dënohet me burgim deri në tre vjet.

3. Përdhosja publikisht e Kombit Shqiptar, dënohet me burgim nga një deri në katër vjet.

4. Nëse përdhosja sipas paragrafëve më sipër, kryhet gjatë një feste publike ose ceremonie zyrtare, dënohet me burgim deri në katër vjet.

5. Për qëllim të këtij ligji me përdhosje do të kuptohet dhunimi i diçkaje të shenjtë, vetive të larta morale apo vlerave të nderuara botërisht, poshtërimi, bërja e padobishme, përçmimi, tallja, përlyerja, apo përbuzja e institucioneve të përmendura në këtë dispozitë.

#### Neni 236

### **Kryerja e veprës nga personi juridik**

1. Kur veprat penale të përmendura në nenet e këtij kreu, janë kryer edhe nga një person juridik, ai dënohet:

a) me gjobë deri në pesëfishin e vlerës së parashikuar në nenin 123 të këtij Kodi, ose mbarimin e personit juridik kur kanë kryer krimet e parashikuar në nenet 229, 230, 231 të këtij Kodi dhe,

b) me gjobë deri në trefishin e vlerës së parashikuar në nenin 123, ndalimin për të kryer në të ardhmen veprimtarinë nëpërmjet së cilës është kryer vepra penale deri në pesë vjet, kur janë kryer veprat penale të parashikuar në nenet 232, 233, 234 të këtij Kodi.

2. Gjykata në çdo rast vendos edhe konfiskimin e mjediseve në të cilat autorët e veprës kanë vepruar për kryerjen e veprave penale dhe publikimin e vendimit gjyqësor.

#### Neni 237

### **Dënimet plotësuese**

Kur veprat penale të parashikuara në nenet e këtij kreu kryhen nga zyrtari publik, atëherë gjykata, krahas dënimit kryesor cakton edhe dënimin plotësues të heqjes së përhershme të së drejtës për të ushtruar një funksion publik, sipas nenit 76 të këtij Kodi.

#### Neni 238

### **Konkurrimi i veprave**

Në të gjitha rastet kur, për të kryer një prej veprave penale të parashikuara në këtë kre, autorit i është dashur të kryejë veprime që përbëjnë vepër penale më vete, atëherë kjo e fundit konkurren me veprën që ai ka dashur të kryejë.

## KREU III

### VEPRAT PENALE TË TERRORIZMIT

#### Neni 239

### **Aktet terroriste**

1. Akt terrorist vlerësohet të jetë çdo veprim, i kryer me qëllim për të përhapur frikë serioze e pasiguri në masë, për të detyruar autoritetet qeveritare vendase dhe/ose të huaja apo një organizatë ndërkombëtare që të kryejnë ose mos kryejnë veprime të caktuara, ose për të shkaktuar shkatërrim ose destabilizim të rëndë të strukturave themelore politike, kushtetuese, ekonomike ose sociale shqiptare, të një shteti tjetër, të institucioneve ose organizatave ndërkombëtare.

2. Kryerja e veprimeve si më poshtë :

a) dhuna kundër personit, duke shkaktuar vdekjen ose dëmtim të rëndë të trupit ose shëndetit mendor;

b) Kapja ose marrja e paligjshme e kontrollit të mjeteve të transportit ajror, mjetet e transportit detar ose mjeteve të tjera të transportit publik, të platformave të fiksuara përmes përdorimit të dhunës apo me anë të çdo forme tjetër kanosjeje;

c) Shkaktimi i dëmtimit ose rrezikut të sigurisë së personit në bord të mjeteve të transportit ajror, mjeteve të transportit detar, mjeteve të tjera të transportit publik apo platformave të fiksuara në mënyrë të paligjshme;

ç) Shkatërrimi ose shkaktimi i dëmtimit të rëndë të mjeteve të transportit ajror, mjeteve të transportit detar apo ngarkesës së saj, mjeteve të tjera të transportit publik, platformave të fiksuara, duke rrezikuar sigurinë e fluturimit, lundrimit apo funksionimit;

d) Vendosja ose përdorimi i paligjshëm i pajisjeve apo substancave në mjetet e transportit ajror, mjetet e transportit detar, mjeteve të tjera të transportit publik, apo platformat, godina, hapësira, ndërtesa të fiksuara në shërbim, me qëllim për të shkaktuar shkatërrim, dëmtim ose rrezikimin e sigurisë së jetës së personit apo funksionimit;

dh) Ndërhyrja e paligjshme në funksionimin e objekteve të infrastrukturës së transportit, duke rrezikuar sigurinë e mjetit të transportit ajror, mjetit të transportit detar, mjetit të transportit publik, ngarkesave apo udhëtarëve të tyre;

e) Shpërndarja e informacionit të rremë që rrezikon sigurinë e mjetit të transportit ajror, mjetit të transportit detar, mjetit të transportit publik, ngarkesave apo udhëtarëve të tyre;

ë) Shpërndarja e informacionit të rremë ose kërcënimeve lidhur me infrastrukturën kritike, duke shkaktuar panik, ndërprerje ose frikë publike;

f) Marrja peng ose rrëmbimi i personit, ose mbajtja në detyrim, me kërcënimin e jetës;

g) Posedimi, përdorimi, transferimi, tjetërsimi apo shpërndarja e materialeve bërthamore apo krijimi i mundësive për posedim, përdorim, transferim, tjetërsim apo shpërndarje të materialeve bërthamore në mënyrë të paligjshme, me qëllim për të shkaktuar vdekje, dëmtim të rëndë të trupit ose dëmtime të rënda të pronës;

gj) Përfitimi, posedimi, transferimi, tjetërsimi, shpërndarja ose përdorimi i armëve biologjike, kimike ose radiologjike, ose hulumtimi për prodhimin e armëve të shkatërrimit në masë.

h) Kryerja e veprimeve të dhunshme duke përdorur pajisje, substanca ose armë kundër individëve në aeroporte, porte, ose qendra transporti, shkolla, spitale, qendra tregtare apo çdo mjedis i mbyllur ose i hapur me grumbullim të madh njerëzish, duke shkaktuar ose synuar të shkaktojë dëmtime të rënda ose vdekje.

i) Shkatërrimi ose dëmtimi i rëndë i pronës publike ose private, infrastrukturës, sistemeve të transportit, sistemeve ushtarake, sistemeve apo infrastrukturave kritike ose sistemeve të informacionit, duke rrezikuar jetën e individëve;

j) Ndërprerja e furnizimit me shërbime të rëndësishme, si: uji, energjia, ose burimet e tjera të rëndësishme, apo kryerja e veprimeve me qëllim për të shkaktuar vdekje ose dëmtime të rënda të

qytetarëve ose personave që nuk janë pjesë aktive në konflikte ushtarake, për qëllimet e përcaktuara më sipër.

k) Përhapjen, vendosjen, shkarkimin ose shpërthimin e lëndëve plasëse ose të pajisjeve të tjera vdekjeprurëse, në mjedise publike, në zyrat e një shteti ose qeverie, sistemin e transportit publik, në infrastrukturën publike ose infrastrukturën e sistemeve kompjuterike, si dhe shpërndarjen në mjedis të substancave të rrezikshme, shkaktimin e zjarreve, të përmytjeve, shpërthimeve, me qëllim shkaktimin e vdekjes ose dëmtimeve të rënda trupore ose me qëllim shkaktimin e shkatërrimeve masive të vendeve, mjediseve ose sistemeve të lartpërmendura, kur ky shkatërrim sjell a mund të sjellë humbje të mëdha ekonomike;

l) Nderhyrja ose shkaktimi i ndërprerjes së furnizimit me ujë, energji elektrike ose çdo burim natyror tjetër të rëndësishëm; apo çdo vepër tjetër që rrezikon të shkaktojë vdekjen ose plagosjen e rëndë të civilëve ose të çdo personi tjetër që nuk merr pjesë aktive në veprimet luftarake në një situatë konflikti të armatosur;

ll) Sabotimi ose shkatërrimi i ndërtesave të infrastrukturës kritike si qendra të energjisë, ujësjellësit, rrjetet e komunikimit, sistemet e transportit ose instalimet e naftës dhe gazit.

m) Marrja peng ose hyrja e paligjshme në ndërtesa të infrastrukturës kritike me qëllim për të detyruar autoritetet ose për të shkaktuar dëme;

n) Posedimi i paligjshëm, prodhimi, transportimi, përdorimi ose tregtimi i armëve ose materialeve që mund të shkaktojnë dëme të konsiderueshme në infrastrukturën kritike ose rrezikim të sigurisë publike, duke përfshirë materiale kimike, biologjike, radiologjike ose bërthamore.

nj) Ndryshim ose pengim i funksionimit të sistemeve të infrastrukturës kritike, duke shkaktuar humbje ekonomike të konsiderueshme, vështirësi publike ose rrezikim të sigurisë publike.

o) Sulmi i qëllimshëm ndaj pasurive apo personelit të infrastrukturës kritike si pjesë e një fushate terroriste më të gjerë për të nënminuar shtetin ose për të krijuar frikë te popullata, dënohen me burgim jo më pak se njëzet e pesë vjet ose me burgim të përjetshëm.

3. Vjedhja masive e pasurive për të synuar kryerjen e çilesdo prej krimeve të parashikuara në paragrafet me lart të këtij neni, denohet nga dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet burgim.

4. Zhvatja masive e pasurive nepermjet shantazhit, shtrengimit apo detyrimit kundër vullnetit të personit, që synojnë kryerjen e çilesdo prej krimeve të parashikuara në paragrafet me lart të këtij neni, denohet nga pesëdhjetë deri në njëzetë vjet burgim.

5. Falsifikimi ose përdorimi i dokumenteve administrative të falsifikuara me qëllim për të kryer apo që, për shkak të natyrës së tyre, ndihmojnë të kryejnë njërën prej veprave penale të parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni, dënohet nga dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet burgim.

## Neni 240

### **Terrorizmi bërthamor**

1. Kryerja në mënyrë të paligjshme dhe të qëllimshme e veprimeve si më poshtë:

a) Zotërimi i materialit radioaktiv ose, prodhimi a zotërimi i një pajisje:

i. me qëllimin për të shkaktuar vdekje ose dëmtime të rënda të shëndetit, ose

ii. me qëllimin për të shkaktuar dëme thelbësore në pronë ose mjedis,

dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë deri në njëzet e pesë vjet.

b) Përdorimi në çfarëdo mënyre e materialit ose pajisjeve radioaktive ose, përdorimi apo dëmtimi i një objekti bërthamor në një mënyrë që çliron ose rrezikon çlirimin e materialit radioaktiv:

i. me qëllimin për të shkaktuar vdekje ose dëmtime të rënda të shëndetit, ose  
ii. me qëllimin për të shkaktuar dëme thelbësore në pronë ose mjedis, ose  
iii. me qëllimin për të detyruar një person fizik ose juridik, organizatë ndërkombëtare ose një shtet që të detyrojë të kryejë ndonjë veprim ose të përmbahet për të kryer veprimet e tij të pavarura, dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë deri në tridhjetë vjet.

2. Kanosja serioze, për të kryejë një vepër penale të parashikuar në paragrafin e parë (b) të këtij neni, dënohet me burgim nga tetë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

3. Kanosja serioze, ose edhe për përdorimin e forcës për të shtënë në dorë në mënyrë të paligjshme dhe të qëllimshme materiale radioaktive, një pajisje ose objekt bërthamor, dënohet me burgim nga dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

4. Vepra penale vleresohet e kryer edhe nëse personi tenton të kryejë ndonjë prej veprimeve të përcaktuar në paragrafin e parë të këtij neni.

5. Për qëllim të këtij ligji, “material radioaktiv” nënkupton materialin bërthamor dhe substanca të tjera radioaktive që përmbajnë nuklide, të cilat i nënshtrohen shpërbërjes spontane që emetojnë një ose më shumë lloje të rrezatimit jonizues, si grimcat alfa, beta, neutron dhe rrezet gama dhe, që për shkak të vetive të tyre radiologjike ose të zbrëthyeshme, mund të shkaktojnë vdekje, lëndime të rënda trupore ose dëme thelbësore në pronë ose në mjedis.

6. Për qëllim të këtij ligji, “material bërthamor” nënkupton plutoniumin, përveç atij me përqendrim izotop që kalon 80 për qind në plutonium-238; uranium-233; uranium i pasuruar në izotopin 235 ose 233; uranium që përmban përzierjen e izotopeve që gjenden në natyrë, përveçse në formën e xeherorëve ose të mbetjeve të xeherorëve; ose çdo material që përmban një ose më shumë nga sa më sipër; “uraniumi i pasuruar në izotopin 235 ose 233” nënkupton uraniumin që përmban izotopin 235 ose 233 ose, të dyja në një sasi të tillë që raporti i shumës së këtyre izotopeve me izotopin 238 është më i madh, sesa raporti i izotopit 235 me izotopi 238 që gjendet në natyrë.

7. Për qëllim të këtij ligji, “objekt bërthamor” nënkupton:

a) çdo reaktor bërthamor, duke përfshirë reaktorët e instaluar në anije, automjete, avionë ose objekte hapësinore për t’u përdorur si burim energjie për të shtyrë këto anije, automjete, avionë ose objekte hapësinore ose për çdo qëllim tjetër;

b) çdo impiant ose mjet transporti që përdoret për prodhimin, ruajtjen, përpunimin ose transportin e materialit radioaktiv.

8. Termi “pajisje” nënkupton:

a) çdo pajisje shpërthyes bërthamore; ose

b) çdo pajisje për shpërndarjen e materialit radioaktiv ose që lëshon rrezatim, e cila, për shkak të vetive radiologjike, mund të shkaktojë vdekje, lëndime të rënda trupore ose dëme thelbësore në pronë ose në mjedis.

9. Termi “objekt shtetëror ose qeveritar” përfshin çdo objekt ose mjet transporti të përhershëm ose të përkohshëm që përdoret ose zotërohet nga përfaqësues të një shteti, anëtarë të një qeverie, legjislatura ose gjyqësori apo nga zyrtarë ose punonjës të një shteti ose çdo autoriteti ose enti tjetër publik ose nga punonjës ose zyrtarë të një organizate ndërqeveritare, në lidhje me detyrat e tyre zyrtare.

1. Terrorizëm kibernetik vlerësohen të jenë veprimet e ndërmarra me qëllim të shkaktimit të terrorit, nëpërmjet përdorimit të teknologjisë së informacionit si dhe sistemeve të lidhura me to që shkaktojnë dëme të konsiderueshme për sistemet kibernetike, rrjetet, informacionin e ndjeshëm dhe infrastrukturën kritike.

2. Kryerja e veprimeve si më poshtë:

a) sulmet kibernetike në infrastrukturën kritike. Kjo përfshin sulmet e drejtuara kundër sistemeve të energjisë, transportit, komunikimit, financave, shëndetësisë dhe të tjera, duke synuar të shkaktojnë ndërprerje të rëndësishme, dëmtim të konsiderueshëm apo rrezikim të sigurisë publike.

b) shpërndarja e virusit ose sëmundjeve. Kjo përfshin shpërndarjen e softuerëve të dëmshëm, viruseve, trojanëve dhe të tjera forma të kodit të rrezikshëm që mund të infektojnë sisteme kompjuterike dhe të shkaktojnë dëme të rëndësishme për informacionin dhe infrastrukturën.

c) hacking dhe hyrje e paligjshme. Kjo përfshin hyrjen në sisteme të mbrojtura dhe të autorizuara pa leje dhe të drejta përkatëse, duke synuar të zhvillojë veprime të paligjshme, si përdorimi i informacionit të ndjeshëm, shkatërrimi i të dhënave apo pengimi i sistemeve të tjera.

ç) sulmet që pengojnë marrjen e shërbimeve. Kjo përfshin sulmet që synojnë të mbushin sistemet e rrjetit me trafik të tepërt, duke e ngopur kapacitetin dhe duke shkaktuar ndërprerje të shërbimeve të rëndësishme për organizatat apo institucionet viktime.

d) vjedhja e të dhënave të ndjeshme. Kjo përfshin hyrjen dhe vjedhjen e informacionit të ndjeshëm, si të dhënat personale, financiare, komerciale, apo të tjera të mbrojtura me ligj, me qëllim përfitimin e paligjshëm apo dëmtimin e individëve apo organizatave të prekura.

dh) anonimiteti dhe maskimi i identitetit. Kjo përfshin përdorimin e teknologjisë kibernetike për të fshehur identitetin dhe për të vepruar në mënyrë anonime në veprimtari që kërcënojnë sigurinë publike ose shkaktojnë dëme të rënda, dënohen me burgim jo më pak se njëzet vjet.

#### Neni 242

### **Rekrutimi i personave për kryerjen e akteve me qëllime terroriste**

1. Rekrutimi i një ose më shumë personave për kryerjen e veprave me qëllime terroriste ose të financimit të terrorizmit, edhe kur këto vepra drejtohen kundër një shteti tjetër, institucioni apo organizate ndërkombëtare, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohen me burgim jo më pak se tetë vjet deri në pesëmbëdhjetë vjet.

2. Organizimi ose ndihma që jepet në drejtim të udhëtimit të individëve drejt një shteti të ndryshëm nga shteti i vendbanimit ose shtetësisë me qëllim për të kryer, planifikuar, përgatitur ose marrë pjesë në akte terroriste dënohet me burgim nga dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

3. Kur vepra penale e parashikuar në dy paragrafët e mësipërm synon rekrutimin e fëmijëve me qëllimin për të kryer akte terroriste, dënimi respektiv shtohet deri në një të dytën e tij.

#### Neni 243

### **Trajnimi për kryerjen e veprave me qëllime terroriste**

1. Çdo formë trajnimi, përgatitje ose dhënie e udhëzimeve, edhe në mënyrë anonime ose në rrugë elektronike, për prodhimin ose përdorimin e lëndëve eksplozive, zjarrit dhe municioneve luftarake, të armëve të tjera dhe lëndëve kimike, bakteriologjike apo bërthamore ose të çdo natyre tjetër, të dëmshme dhe të rrezikshme për njerëzit dhe pasurinë, si dhe të teknikave e të metodave të tjera për kryerjen e veprave me qëllime terroriste dhe pjesëmarrja në veprimtari të tilla, edhe kur këto

vepra drejtohen kundër një shteti tjetër, institucioni apo organizate ndërkombëtare, nëse nuk përbëjnë vepër tjetër penale, dënohen me burgim nga dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

2. Kur vepra penale e parashikuar në paragrafin më lart synon trajnimin e fëmijëve me qëllimin për të kryer akte terroriste, dënimi respektiv shtohet deri në një të dytën e tij.

#### Neni 244

### **Marrja e trajnimit për kryerjen e akteve me qëllime terroriste**

Marrja e instruksioneve, njohurive ose aftësive praktike nga një person tjetër për prodhimin ose përdorimin e eksplozivëve, armëve të zjarrit ose armëve të tjera, substancave të dëmshme ose të rrezikshme, apo metodave ose teknikave të tjera specifike me qëllim kryerjen ose dhënien e kontributit në kryerjen e një vepre penale me qëllime terroriste dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

#### Neni 245

### **Nxitja publike për kryerjen e akteve me qëllime terroriste**

1. Thirrja, nxitja dhe propaganda për kryerjen e aktit terrorist, kryer nëpërmjet çdo forme komunikimi, shpërndarje apo promovimi të mesazheve, ideologjive apo materialeve që nxitin, inkurajojnë ose glorifikojnë kryerjen e akteve terroriste, mbështetjen ose miratimin e dhunës, ofrimin e udhëzimeve ose udhëheqjes për të kryer akte terroriste, apo promovimin e objektivave, synimeve, apo ideologjisë së organizatave terroriste, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me burgim nga katër deri në dhjetë vjet, kur kryhet në format e mëposhtme:

a) Rekrutimi dhe inkurajimi nëpërmjet internetit nëpërmjet përdorimit të platformave online, mediave sociale, faqeve të internetit, ose forumeve të bisedave për të rekrutuar individë për veprimtari terroriste ose për t'i nxitur ata të kryejnë akte dhune.

b) Shpërndarja e materialeve udhëzuese që ofrojnë informacion të detajuar, udhëzime, apo manuale se si të kryhet aksioni terrorist.

c) Promovimi i organizatave terroriste përfshirë promovimin dhe glorifikimin e organizatave terroriste përmes fjalimeve, literaturës, videove, apo postimeve në media sociale që synon të tërheqë mbështetje, të rekrutojë anëtarë, dhe të krijojë një mjedis që normalizon apo justifikon aktet e terrorizmit.

ç) Inkurajimi i dhunës nëpërmjet fjalimeve apo tubimeve publike apo fjalimeve publike që inkurajojnë drejtpërdrejt individë apo grupe për të kryer akte të dhunshme, përdorimin e gjuhës sprovokuese, nxitjen e urrejtjes, dhe inkurajimin e dhunës kundër objekteve të caktuara në bazë të fesë, etnisë, kombësisë, apo faktorëve të tjerë.

d) Përdorimi dhe shpërndarja e materialit të shtypur të propagandës, si: broshurave, pllakateve, apo fletëve, që promovojnë terrorizmin, nxisin dhunën, apo ofrojnë mbështetje për organizatat terroriste.

2. Kur krimet e përmendura në këto dispozite, drejtohen ndaj fëmijëve, dënimi i parashikuar shtohet deri në 1/3 e tij.

### **Kanosja për kryerjen e veprave me qëllime terroriste**

Kanosja serioze për kryerjen e veprave për qëllime terroriste, që i bëhet një autoriteti publik, edhe të një shteti tjetër, institucioni apo organizate ndërkombëtare, dënohet me burgim nga dy deri në gjashtë vjet.

### **Financimi i terrorizmit**

1. Financim i terrorizmit është veprimi i ofrimit, përdorimit ose transferimit të fondeve, pasurisë, burimeve financiare, ose formave të tjera të vlerës që nuk janë paraja e gatshme, me qëllim të përdorimit të tyre për të kryer veprime terroriste, organizuar, rekrutuar, trajnuar ose për të mbështetur individët, grupet ose organizatat terroriste.

2. Kryerja e veprimeve si më poshtë :

a) Pagesat me forma të tjera të vlerës që nuk janë para të gatshme. Kjo përfshin transaksionet dhe veprimtaritë që lidhen me përdorimin e formave të tjera të vlerës për të financuar terrorizmin, përfshirë pagesat elektronike, transaksionet me kartë krediti ose debiti, transferimet bankare, këmbimet, pagesat ose transfertat e monedhës virtuale, ose çdo lloj transaksioni tjetër që nuk përfshin paratë e gatshme.

b) Mbledhja e fondeve nëpërmjet institucioneve financiare. Kjo përfshin veprimet që synojnë të mbledhin fonde për të financuar terrorizmin duke përdorur institucione financiare, si bankat, institucionet e pagesave, apo institucione të tjera financiare përfshirë hapjen e llogarive bankare të fshehta, transferimet e fondeve përmes institucioneve financiare, ose përdorimin e kanaleve të tjera financiare për të mbledhur dhe transferuar fonde për qëllime terroriste.

c) Mbledhja e fondeve nëpërmjet organizatave jofitimprurëse. Kjo përfshin veprimet që synojnë të mbledhin fonde për të financuar terrorizmin duke përdorur organizata jofitimprurëse, fondacione, ose organizata të tjera të ngjashme përfshirë përdorimin e organizatave të fshehta për të mbledhur dhe transferuar fonde pa u identifikuar, për të financuar veprimet terroriste.

ç) Pastrimi i parave për financimin e terrorizmit. Kjo përfshin veprimet që synojnë të fshehin burimet e paligjshme të fondeve dhe pasurisë për të financuar terrorizmin përfshirë veprimet e përfitimit të paligjshëm, blerjen e pronave ose bizneseve me fonde të paligjshme, apo përdorimin e shërbimeve financiare për të transferuar dhe fshehur fonde të fituara në mënyrë të paligjshme nëpërmjet operacioneve të paqëndrueshme me qëllim financimin e terrorizmit.

d) Mbështetja nëpërmjet transaksioneve tregtare. Kjo përfshin veprimet që synojnë të përdorin transaksione tregtare për të financuar terrorizmin përfshirë përdorimin e transaksioneve fiktive tregtare, të inflacionuara, apo të çuditshme për të transferuar fonde dhe vlera nëpërmjet rrjedhës së tregtisë për qëllime të përcaktuara terroriste.

dh) Kërkesa ose pranimi i fondeve për terrorizëm. Kjo përfshin veprimet që synojnë të kërkojnë ose të pranojnë fonde apo kontributet për të financuar terrorizmin përfshirë thirrjet publike, kërkesat private, apo marrjen e fondeve nga burime të ndryshme për të mbështetur veprimet terroriste.

e) Përdorimi i donacioneve të bamirësisë për qëllime terrorizmi. Kjo përfshin përdorimin e donacioneve bamirëse ose të dhurimeve për të financuar veprimet terroriste përfshirë përdorimin e organizatave bamirëse për të marrë dhe transferuar fonde për qëllime të ndryshme terroriste, dënohen jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.

2. Dispozitat e këtij neni zbatohen:

a) për të gjitha fondet, ku përfshihen pasuri të çdo lloji, të trupëzuara ose të patrupëzuara, të luajtshme ose të paluajtshme, pavarësisht nga mënyra e fitimit të tyre, dhe dokumente ligjore ose instrumente të çdo lloji, edhe në formë elektronike ose digjitale, që tregojnë të drejta ose interesa mbi pasuri të tilla, përfshirë kreditë bankare, çeqet e udhëtarëve, çeqet bankare, urdhërpagesat, aksionet, letrat me vlerë, bonot, çeqet e garantuara bankare, letrat e kreditit, si dhe çdo instrument tjetër financiar, apo mënyra pagese jo me para në dorë ose, të ngjashme me to;

b) pavarësisht nëse personi që kryen një nga veprat e parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni, ndodhet në të njëjtin shtet a në një shtet të ndryshëm nga ai, në të cilin ndodhet organizata terroriste a terroristi i vetëm ose nga shteti në të cilin është kryer a do të kryhet vepra me qëllime terroriste;

c) në rastin e parashikuar nga paragrafi i parë i këtij neni, pavarësisht nëse fondet janë përdorur në fakt për të kryer veprën ose veprat, për të cilat ishin dhënë ose grumbulluar, apo nëse mund të vendoset një lidhje mes fondeve dhe një apo më shumë veprave konkrete me qëllime terroriste, apo çfarë vepre konkrete penale do të kryhet.

3. Dijenia dhe qëllimi, sipas paragrafit të parë të këtij neni, nxirren nga rrethana fakti objektive.

Neni 248

### **Financimi i udhëtimit jashtë vendit për qëllime terrorizmi**

Ofrimi ose mbledhja në çdo formë, direkt ose indirekt, pjesërisht ose plotësisht i fondeve për të mundësuar udhëtimin jashtë vendit të një ose më shumë personave për qëllime terrorizmi duke ditur se fondet do të përdoren pjesërisht ose plotësisht për këtë qëllim dënohet me burgim nga shtatë deri në dhjetë vjet.

Neni 249

### **Fshehja e fondeve dhe e pasurive të tjera që financojnë terrorizmin**

1. Transferimi, konvertimi, fshehja, lëvizja ose tjetërsimi i fondeve dhe i pasurive të tjera, ndaj të cilave zbatohen masat kundër financimit të terrorizmit, për të shmangur zbulimin dhe vendndodhjen e tyre, dënohen me burgim nga katër deri në dymbëdhjetë vjet.

2. Kur kjo vepër kryhet gjatë ushtrimit të një veprimtarie profesionale, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Neni 250

### **Dhënia e informacioneve nga persona që ushtrojnë funksione publike ose në ushtrim të detyrës a profesionit**

1. Vënia në dijeni e personave të shpallur ose e personave të tjerë për të dhënat për verifikimin ose hetimin e fondeve dhe pasurive të tjera, ndaj të cilave zbatohen masa kundër financimit të terrorizmit, nga persona që ushtrojnë funksione publike ose që janë në ushtrim të detyrës a profesionit, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.

2. Subjekti që jep informacionin e shënuar në paragrafin e parë të këtij neni vlerësohet si bashkëpunëtor i jashtëm i organizatës terroriste nëse vepron në kushtet e kërkuara nga paragrafi i shtatë i nenit 50 të këtij Kodi. Kur janë kushtet e parashikuara në nenin 57, paragrafi 3 të Kodit Penal, ai vlerësohet si bashkëpunëtor i zakonshëm i organizatës terroriste.

#### Neni 251

### **Kryerja e shërbimeve dhe veprimeve me persona të shpallur**

1. Dhënia e fondeve dhe pasurive të tjera, kryerja e shërbimeve financiare, si dhe e transaksioneve të tjera me persona të shpallur, ndaj të cilëve zbatohen masa kundër financimit të terrorizmit, dënohen me burgim nga katër deri në dhjetë vjet.

2. Subjekti që kryhen veprimet e shënuara në paragrafin e parë të këtij neni vlerësohet si bashkëpunëtor i jashtëm i organizatës terroriste nëse vepron në kushtet e kërkuara nga paragrafi i shtatë i nenit 50 të këtij Kodi. Kur janë kushtet e parashikuara në nenin 57, paragrafi 3 të këtij Kodi, ai vlerësohet si bashkëpunëtor i zakonshëm i organizatës terroriste.

#### Neni 252

### **Ekstremizmi**

1. Pranimi, promovimi, ose mbështetja e ideologjive ekstremiste që propagandojnë, mbështesin ose përdorin dhunën për të arritur objektivat politike, fetare, ideologjike, ose sociale përfshirë individë apo grupime që përdorin ose nxitin dhunën si mjet për të shprehur bindjet e tyre ekstreme, për të sfiduar normat shoqërore dhe për të nënminuar parimet e demokracisë, të drejtave të njeriut dhe bashkëjetesës paqësore, nëpërmjet formave të mëposhtme, vlerësohen si ekstremizëm.

2. Kryerja e veprimeve si më poshtë :

a) Nxitja e dhunës me anë të çdo akti të promovimit, nxitjes, apo glorifikimit të dhunës, nëpërmjet fjalëve, publikimeve, mediave sociale, apo mënyrave të tjera, me qëllim radikalizimin e individëve dhe inkurajimin e tyre për të kryer akte të dhunshme në shërbim të ideologjive ekstremiste.

b) Rekrutimi dhe radikalizimi duke përfshirë rekrutimin, radikalizimin, apo induktimin e individëve për t'u bashkuar apo mbështetur grupet ekstremiste të dhunshme nëpërmjet bindjes ose detyrimit të individëve për të marrë pjesë në akte të dhunshme, ose për të ofruar mbështetje materiale dhe ideologjike për të përparuar synimet e ekstremizmit të dhunshëm.

c) Shpërndarja e propagandës ose publikimi i materialeve propagandistike që advokojnë, miratojnë, apo glorifikojnë ekstremizmin e dhunshëm nëpërmjet shpërndarjes ose nxitjes përmes mjeteve të ndryshme, si platformat online, mediat sociale, apo publikimeve fizike, me qëllim të radikalizimit të individëve dhe promovimit të akteve të dhunshme.

ç) Financimi i ekstremizmit të dhunshëm nëpërmjet ofrimit ose mbledhjes së fondeve, burimeve, apo mbështetjes materiale për qëllim të financimit të veprimtarive ekstremiste të dhunshme me

anë të transaksioneve financiare, donacioneve, mbledhjes së fondeve, apo çdo mjet tjetër që përdoret për të financuar akte të ekstremizmit të dhunshëm, rekrutimin e individëve, apo mbështetjen e veprimtarive të grupimeve ekstremiste të dhunshme.

d) Pjesëmarrja në veprimtari ekstremiste të dhunshme nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në akte të dhunshme apo ofrimin e ndihmës, përfshirë mbështetjen logjistike, për individët apo grupet që angazhohen në veprimtari ekstremiste të dhunshme.

dh) Posedimi, prodhimi, apo shpërndarja e materialeve ekstremiste, si: dokumente, video, ose përmbajtje online, që promovojnë ekstremizmin e dhunshëm, nxisin urrejtje, apo inkurajojnë akte të dhunshme kundër individëve apo grupimeve bazuar në racë, fe, etni apo karakteristika të tjera të mbrojtura, dënohen nga pesë deri në dhjetë vjet burgim.

3. Kur krimet e permendura në këto dispozite, drejtohen ndaj femijeve, denimi i parashikuar shtohet deri në 1/3 e tij.

#### Neni 253

### **Kryerja e krimeve nga personi juridik**

1. Kryerja e krimeve të parashikuara në nenet 239, 240, 241, 242, 243, 245, 247, 248, 249 dhe 252 nga personi juridik mbështetur në nenin 123 të këtij Kodi, dënohen me gjobë deri në pesëfishin e vlerës së parashikuar ose/dhe, mbarimin e personit juridik.

2. Kryerja e krimeve të parashikuara në nenet 250 dhe 251 nga personi juridik mbështetur në nenin 123 të këtij Kodi, dënohen me gjobë deri në trefishin e vlerës së parashikuar ose/dhe, mbarimin e personit juridik.

#### Neni 254

### **Dënimet plotësuese**

1. Nëse krimet e këtij kreu kryhen nga zyrtari publik, atëherë gjykata, krahas dënimit kryesor cakton edhe dënimin plotësues heqjen e së drejtës për të ushtruar një funksion publik, sipas nenit 76 të këtij Kodi.

2. Në çdo rast gjykata vendos masën e zëvendësimit të dëmit të shkaktuar dhe, përveç sendeve që kanë shërbyer për kryerjen e veprave penale, kur vepra penale është kryer nga subjektet me qëllim përfitimi material apo të premtuar, vendoset konfiskimi i të ardhurave nga vepra penale apo të premtuara.

3. Gjkata në çdo rast vendos edhe konfiskimin e mjediseve në të cilat autorët e veprës kanë vepruar për kryerjen e veprave penale dhe, urdhëron publikimin e vendimit gjyqësor.

#### Neni 255

### **Konkurrimi i veprave penale dhe bashkëpunimi**

1. Në të gjitha rastet kur, për të kryer një prej veprave penale të këtij kreu, autori ka kryer veprime që përbëjnë vepër penale më vete, atëherë kjo e fundit konkurren me veprën që ai ka dashur të kryejë.

2. Nëse për kryerjen e ndonjëres prej veprave penale të parashikuara në këtë kre, autorit të posaçëm i është dashur të bashkëpunojë me një person tjetër, pavarësisht cilësive të posaçme të këtij të fundit, ata do të përgjigjen për kryerjen në bashkëpunim të veprës penale të parashikuar në këtë kre, apo çfarëdolloj vepre penale që konkurren me to.

KREU IV  
VEPRAT PENALE KIBERNETIKE

Neni 256  
**Përkufizimet**

Për qëllimet e këtij ligji, do të zbatohen përkufizimet e mëposhtme :

(a) "sistem i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit" nënkupton një pajisje ose grup pajisjesh të ndërlidhura ose të lidhura, një ose më shumë prej të cilave, në bazë të një programi, përpunohet automatikisht të dhënat kompjuterike, si dhe të dhënat kompjuterike të ruajtura, të përpunuara, të marra ose të transmetuara nga ajo pajisje ose grup pajisjesh për qëllime të funksionimit, përdorimit, mbrojtjes së tij ose të tyre dhe mirëmbajtje;

(b) "të dhëna elektronike" nënkupton një paraqitje të fakteve, informacioneve ose koncepte në një formë të përshtatshme për përpunim në një sistemi të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, duke përfshirë një program të përshtatshëm për duke bërë që një sistem informacioni të kryejë një funksion;

(c) "pa të drejtë" nënkupton sjelljen e përmendur, duke përfshirë aksesin, ndërhyrjen ose përgjimin, gjë që nuk është autorizuar nga pronari ose nga një bartës tjetër i së drejtës, sistemit ose të një pjese të tij, ose nuk lejohet sipas legjislacionit kombëtar.

(c) me ndërhyrje të paautorizuar përmendur në këtë kre, do të kuptohet aksesin pa të drejtë në të gjithë ose në një pjesë të një sistemi të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, shkelja e masave të sigurisë me qëllim marrëjen e të dhënave elektronike, të dhënave personale ose për qëllime të tjera të pandrejta ose në lidhje me një sistem të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit që është e lidhur me një sistem tjetër të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, për të cilat nuk lejohet ndërhyrja e paautorizuar sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

(d) Për sa lidhet me dispozitat e këtij seksioni, do të vlerësohet të jetë e paligjshme, cdo sjellje, autorizim i kërkuar, leje për ushtrim të veprimtarive të përmendura edhe kur kryhet sipas një autorizimi të lëshuar nga një autoritet kompetent i një shteti, nëse një autorizim i tillë është marrë me mashtrim ose me korrupsion, zhvatje ose detyrim, ose nëse një autorizim i tillë është në shkelje të dukshme të kërkesave ligjore thelbësore përkatëse, apo në kapercim të kushteve të atij autorizimi.

**Neni 257**  
**Përgjimi i paligjshëm i të dhënave elektronike**

1. Përgjimi i paligjshëm kryer me dashje, me mjete teknike të transmetimeve jopublike, i të dhënave elektronike nga/ose brenda një sistemi, përfshirë emetimet elektromagnetike nga një sistem të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit që mban të dhëna të tilla, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.

2. Kur kjo vepër kryhet nga/ose brenda sistemeve të informacionit dhe komunikimit ushtarake, të sigurisë kombëtare, të rendit publik, të mbrojtjes civile apo në çdo sistem tjetër të teknologjië së informacionit dhe komunikimit, me rëndësi të veçantë publike, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

3. Për qëllim të këtij kreu, me përgjim do të kuptohet akti i kryer nga një person që nuk është i autorizuar për të marrë pjesë në veprimin apo komunikimin që synohet të dokumentohet, i kryer me çfarëdo lloj forme a mjete, që synon marrjen dijoni rreth një veprimi apo komunikimi, qoftë fizik apo virtual, të personave të tretë.

## **Neni 258**

### **Hyrja e paautorizuar në sistemet e informacionit**

1. Hyrja e paautorizuar apo në tejkalim të autorizimit për të hyrë në një sistem të teknologjië së informacionit dhe komunikimit apo në një pjesë të tij përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

2. Kur vepra penale është kryer nga shkelje të masave të sigurisë, me qëllimin e përfitimit të të dhënave elektronike, klonimit të tyre, qëllimet e tjera të padrejta ose në marrëdhënie me një sistem të teknologjië së informacionit dhe komunikimit që është i lidhur me një sistem tjetër, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet.

3. Kur kjo vepër kryhet në sistemet të teknologjië së informacionit dhe komunikimit ushtarake, të sigurisë kombëtare, të rendit publik, të mbrojtjes civile, të shëndetësisë apo në çdo sistem tjetër informacioni ose të dhënave elektronike me rëndësi të veçantë publike, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.

4. Qëndrimi me mashtrim, në një sistem të teknologjië së informacionit dhe komunikimit apo në një pjesë të tij, i bërë me qëllimin e përfitimit të të dhënave, sipas paragrafëve të mësipërm të këtij neni, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

## **Neni 259**

### **Ndërhyrja në të dhënat elektronike**

1. Ndërhyrja me dashje në të dhenat elektronike që ka shkaktuar dëmtimin, shtrembërimin, ndryshimin, fshirjen apo suprimimin, bërjen të papërdorshëm, ose të paarritshëm, ose paraqet si të paarritshëm, plotësisht ose pjesërisht, të dhënat të tjetrit pa qenë i autorizuar për ta bere ate, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

2. Kur kjo vepër kryhet në të dhënat elektronike ushtarake, të sigurisë kombëtare, të rendit publik, të mbrojtjes civile, të shëndetësisë apo në çdo të dhënë tjetër kompjuterike, me rëndësi të veçantë publike, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.

## **Neni 260**

### **Ndërhyrja në sistemet e teknologjië së informacionit dhe komunikimit**

1. Krijimi i pengesave serioze dhe të paautorizuara që kanë cenuar funksionimin e një sistemi informacioni, programi ose komunikimi elektronik, nëpërmjet futjes, dëmtimit, shtrembërimin, ndryshimit, fshirjes apo suprimimit të të dhënave, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.

2. Kur kjo vepër kryhet në sistemet informatike, programet apo komunikimet elektronike ushtarake, të sigurisë kombëtare, të rendit publik, të mbrojtjes civile, të shëndetësisë apo në çdo sistem tjetër me rëndësi të veçantë publike, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

### **Neni 261**

#### **Falsifikimi kompjuterik**

1. Futja, ndryshimi, fshirja apo heqja e të dhënave elektronike, pa të drejtë, për krijimin e të dhënave të rreme, me qëllim paraqitjen dhe përdorimin e tyre si autentike, pavarësisht nëse të dhënat e krijuara janë drejtpërdrejt të lexueshme apo të kuptueshme, dënohen me burgim nga dy deri në gjashtë vjet.

2. Kur kjo vepër kryhet nga personi, që ka për detyrë ruajtjen dhe administrimin e të dhënave kompjuterike, ose kryhet në sistemet e informatike të ushtrisë, të sigurisë kombëtare, të rendit publik, të mbrojtjes civile, dënohet nga tre deri në tetë vjet.

### **Neni 262**

#### **Mashtrimi kompjuterik**

1. Futja, ndryshimi, fshirja ose heqja e të dhënave elektronike apo ndërhyrja në çfarëdo mënyre në funksionimin e një sistemi informacioni të tillë, me qëllim për t'i siguruar vetes apo të tretëve përfitim ekonomik të padrejtë apo për t'i shkaktuar një të treti pakësimin e pasurisë, dënohen me burgim nga dy deri në gjashtë vjet.

2. Po kjo vepër, kur kryhet në sistemin informatik bankar apo në çdo sistem informatik financiar që ruan, përdor, shërben, lejon lëvizjen e vlerave monetare, çdo instrument jomaterial të pagesës, letrave me vlerë, sendeve të çmuara apo çdolloj mjeti shkëmbimi apo pagese të lejuar nga ligji, apo mjete pagese në çdo mënyrë digjitale, dënohet me burgim nga tetë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

3. Kur vepra penale respektive kryhet nga nëpunësi që ka për detyrë të mirëmbajë, administrojë e përdorë sistemin informatik, dënimi me burgim rritet deri në një të dytën e tij.

4. Kur veprat penale respektive, kryhen nëpërmjet vjedhjes së identitetit digjital ose përdorim të padrejtë të tij, dënimi me burgim rritet respektivisht me një të tretën e tij.

### **Neni 263**

#### **Mashtrimi me mjetet e pagesës**

1. Transferimi me mashtrim i parave, vlerave monetare ose valutës virtuale duke përdorur karta krediti, debiti, çeqe udhëtimi, dhe të dhëna të lidhura me to, ose çdo instrument tjetër material ose jomaterial të pagesës ose, çdo instrument tjetër fizik apo elektronik të pagesës, kryer me dashje dhe në mënyrë të paligjshme, duke i siguruar vetes ose një tjetri një përfitim të paligjshëm në dëm të zotëruesit të tyre, dënohet me burgim nga katër deri në dhjetë vjet.

2. Kur vepra penale respektive kryhet nga nëpunësi që ka për detyrë të mirëmbajë, administrojë e përdorë sistemin kompjuterik, dënimi me burgim rritet deri në një të dytën e tij.

## **Neni 264**

### **Vjedhja e identitetit**

Personi i cili, me dashje, pa të drejtë ose autorizim të ligjshëm ose, në tejkalim të një autorizimi të ligjshëm, duke përdorur një sistem informatik, transferon, zotëron ose përdor si mjet identifikimi identitetin e një personi tjetër me qëllim për të kryer, ose për të ndihmuar ose nxitur një vepër që përbën krim, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

## **Neni 265**

### **Ngacmimi kibernetik**

1. Një person, i cili pa të drejtë fillon çdo komunikim elektronik, me qëllim për të detyruar, frikësuar, ngacmuar ose shkaktuar shqetësime të konsiderueshme emocionale të një personi tjetër, duke përdorur një sistem kompjuterik, kryen keqpërdorim të të dhënave personale, bën që persona të tjerë t'iu kontaktojnë, kërcënon me dëmtim të jetës, integritetit fizik, shëndetit ose lirisë së tij, të një të afërmi të tij ose të një personi tjetër të afërt, shpërndan një imazh të këtij personi, një prej të afërmeve të tyre ose një personi tjetër të afërt me ta ose, e bën atë të aksesueshëm për publikun, shpërndan materiale me përmbajtje që e bën personin të neveritshëm ose degradues në opinionin publik, nën pretendimin e autorësisë së personit ose, të bëhet i aksesueshëm për publikun, ose kryen sjellje të tjera të rënda, të përsëritur dhe armiqësore, dënohet me burgim nga një deri në katër vjet.

2. Vënia e një personi në mënyrë të përsëritur ose të vazhdueshme, nën mbikqyerje, nëpërmjet sistemeve të teknologjië dhe informacionit, pa pëlqimin e tij, ose pa një autorizim ligjor, për të gjurmuar apo monitoruar lëvizjet e tij, dënohet nga një deri në pesë vjet.

3. Po kjo vepër kur shkaktën vdekjen e viktimës apo dëmtim të rëndë të shëndetit të saj, të një të afërmi të viktimës ose një personi tjetër të afërt me viktimën, e vë viktimën, një të afërm të saj ose një person tjetër të afërt me viktimën në rrezik të vdekjes ose dëmtimit serioz të shëndetit, autori do të përgjigjet për pasojën e ardhur bazuar në dispozitën e veçantë që e parashikon atë në pjesën e posaçme të këtij Kodi, në varësi të formës së fajit të shfaqur prej tij.

4. Nëse viktimë është i mitur, dënimi i bashkuar penal për veprat e kryera shtohet deri në një të dytën e tij.

## **Neni 266**

### **Mbledhja e të dhënave personale**

1. Mbledhja, mbajtja ose ruajtja e të dhënave personale përmes mënyrave mashtruese, të padrejta ose të jashtëligjshme të kryera në hapësirën kibernetike apo telematike, që lidhen me të dhëna personale që zbulojnë drejtpërdrejtë ose indirekt origjinën racore, mendimet politike, filozofike ose fetare, lidhjet me sindikatat, shëndetin apo orientimin seksual të një personi, të kryera me qëllim pasurimi vetjak ose pasurimin e të tretëve ose për të dëmtuar një person tjetër, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

2. Përdorimi, pa pëlqimin e tij, të imazhit të një personi ose të një të dhëne tjetër të indentifikueshme, për të bërë reklama ose për të hapur profile false në rrjetet sociale, faqet e kontaktit ose cdo mjet përhapje publike, i kryer me qëllim përfitimi për vete osë të tjerë, ose për të dëmtuar personin, dënohet me burgim deri në katër vjet.

## **Neni 267**

### **Përvetësimi, përpunimi dhe shpërndarja e paautorizuar e të dhënave**

1. Përvetësimi apo përpunimi i paautorizuar apo në tejkalim të autorizimit të ligjshëm, i të dhënave elektronike, në rrjetet dhe sistemet e informacionit në fushën e mbrojtjes, të rendit publik, apo në çdo rrjet dhe sistem tjetër të informacionit, me rëndësi të veçantë publike, dënohet me burgim nga gjashtë deri në dymbëdhjetë vjet.

2. Kur vepra penale sipas paragrafit të parë është kryer në shkelje të masave të sigurisë, me qëllim përvetësimin e të dhënave elektronike, klonimin e tyre, apo qëllime të tjera të paligjshme, dënimi me burgim shtohet deri në një të tretën e tij.

3. Kur të dhënat elektronike të përvetësuara në mënyrë të paligjshme nga rrjetet dhe sistemet e informacionit në fushën e mbrojtjes, të rendit publik, apo në çdo rrjet dhe sistem tjetër të informacionit me rëndësi të veçantë publike, kërkohet të bëhet shpërndarja e tyre në media dhe platforma komunikimi, dënimi me burgim shtohet deri në një të dytën e tij.

4. Përvetësimi ose përpunimi i të dhënave elektronike jo të natyrës së përmendur në paragrafin e parë të këtij neni, me qëllim ndryshimin dhe deformimin e tyre, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet.

5. Shpërndarja e paautorizuar e të dhënave elektronike të përmendura në paragrafin e katërt të këtij neni, të përvetësuara në mënyrë të paligjshme, rrit dënimin deri në një të dytën e tij.

6. Në rast se të dhënat elektronike të përvetësuara në mënyrë të paligjshme, janë publikuar nga individë apo grupe individësh, të cilët janë subjekt i kësaj vepre penale, personat e tretë që rishpërndajnë këto të dhëna në çdo medium mediatik apo social, kur janë në dijeni rreth paligjshmërisë së mbledhjes së të dhënave elektronike, dënohen me burgim nga një deri në katër vjet.

## **Neni 268**

### **Zbulimi i sekretit dhe shkelja e detyrimeve**

1. Zbulimi te të tretët nga dhënësi i shërbimit, mbajtësi, kontrolluesi, apo personat që kanë rënë në dijeni për shkak të detyrës apo profesionit, të kërkesës, akteve hetimore, urdhrit, autorizimit, apo vendimit të organit procedues për bërjen e një porosie prodhimi, për ruajtjen e përsheptuar të të dhënave kompjuterike e telefonike të memorizuara, apo për ruajtjen e përsheptuar dhe hapjen e pjesshme të të dhënave të trafikut, ose për mbledhjen e të dhënave kompjuterike a telefonike në kohë reale, apo interceptimit i të dhënave të përmbajtjes ose i veprimeve të kryera, apo të dhënave të mbledhura, ose të regjistruara sipas urdhrit të organit procedues në lidhje me hetimin penal, që janë paralajmëruar nga organi procedues për moszbulimin e tyre, dënohet me burgim deri në pesë vjet.

2. Shkelja e detyrimeve të shënuara në aktin e organit procedues në lidhje me hetimin penal nga dhënësi i shërbimit, mbajtësi, kontrolluesi, apo personat e urdhëruar me porosinë e prodhimit, ruajtjen e përsheptuar të të dhënave kompjuterike a telefonike të memorizuara, apo ruajtjen e përsheptuar dhe hapjen e pjesshme të të dhënave të trafikut, ose mbledhjen e të dhënave kompjuterike a telefonike në kohë reale, apo interceptimin i të dhënave të përmbajtjes, dënohet me burgim nga një deri në shtatë vjet burgim.

**Neni 269**  
**Abuzimi me nënshkrimin elektronik**

Shkelja e detyrimeve të përcaktuara me ligj në lëshimin e një certifikate të cilësuar, nga personi që ofron shërbime të certifikimit të nënshkrimit elektronik, me qëllimin për të marrë një përfitim të padrejtë për vete ose për të tjerët, ose për t'u shkaktuar dëm të tjerëve, dënohet me burgim nga dy deri në shtatë vjet.

**Neni 270**  
**Mashtrimi nëpërmjet komunikimit elektronik**

1. Personi i cili, me dashje, pa të drejtë ose autorizim të ligjshëm ose tej një autorizimi:
  - a) transmeton mesazhe të shumta të postës elektronike të karakterit mashtrues promocional apo bizneseve të paqena, nga/ose përmes një sistemi të tillë kibernetik me qëllim për të mashtruar përdoruesit; ose
  - b) përdor një sistem kibernetik të mbrojtur për të transmetuar ose ritransmetuar shumëfish mesazhet e postës elektronike, me qëllim për të mashtruar përdoruesit, ose çdo ofrues të postës elektronike ose të shërbimit të internetit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.
2. Procedimi për këtë veprë fillon me ankimin e viktimës dhe pushon kur ai heq dorë prej tij.

**Neni 271**  
**Shitja e paautorizuar e kartave SIM**

Shkelja e rregullave të caktuara për shpërndarjen, shitjen dhe pajisjen me produkte/karta SIM dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

**Neni 272**  
**Keqpërdorimi i pajisjeve**

Prodhimi, shitja, dhënia në përdorim, shpërndarja apo çdo veprim tjetër, për vënien në dispozicion të një pajisjeje apo importimi i tyre, ku përfshihen edhe një program kompjuterik, një fjalëkalim, një kod hyrjeje apo një e dhënë e tillë e ngjashme, të cilat janë krijuar ose përshtatur për hyrjen në një sistem informatik ose në një pjesë të tij, me qëllim kryerjen e veprave penale, të parashikuara në nenet 258, 259, 262, 263, 266 dhe 267 të këtij Kodi, dënohen me burgim nga një deri në pesë vjet.

**Neni 273**  
**Kryerja e krimeve nga personi juridik**

1. Kryerja e krimeve të parashikuara në nenet 257, 258, paragrafi i dytë, i tretë dhe i katërt, neni 259, paragrafi i dytë, nenet 260, 262, 263, 265 dhe 266 të këtij Kodi nga personi juridik mbështetur në nenin 123 të këtij Kodi dënohen me gjobë deri në pesëfishin e vlerës së parashikuar, ose mbarimin e personit juridik.

2. Kryerja e krimeve të parashikuara në nenet 261, 272, 267, 268 dhe 269 të këtij Kodi nga personi juridik mbështetur në nenin 123 të këtij Kodi dënohen me gjobë deri në trefishin e vlerës së parashikuar, ose ndalimin për të hyrë në marrëdhënie kontraktore me sektorin publik.

3. Kryerja e krimeve të parashikuara në nenet 264, 266, 270 dhe 271 të këtij Kodi nga personi juridik dënohet me gjobë deri në dyfishin e vlerës së parashikuar në nenin 123 të këtij Kodi, ose detyrimin që brenda tre muajve të marrë masat e duhura sipas nenit 24, paragrafi 5 të këtij Kodi.

### **Neni 274**

#### **Dënimet plotësuese**

1. Kur veprat penale të parashikuara në këtë seksion kryhen nga zyrtari publik, atëherë gjykata, krahas dënimit kryesor cakton edhe dënimin plotësues heqjen e së drejtës për të ushtruar një funksion publik sipas parashikimeve të nenit 76 të këtij Kodi.

2. Në çdo rast gjykata vendos masën e zëvendësimit të dëmit të shkaktuar dhe, përveç sendeve që kanë shërbyer për kryerjen e veprave penale, kur vepra penale është kryer nga subjektet me qëllim përfitimi material apo të premtuar, vendoset konfiskimi i të ardhurave nga vepra penale apo të premtuara.

3. Për veprat penale të lehta të parashikuara në nenet 258, paragrafi 1, 259, paragrafi 1, 266, 270 dhe 271 të këtij Kodi, kur çmohet e arsyeshme, gjykata mund të vendosë dhënien e jo më pak sesa dy dënimeve plotësuese në vend të dënimit kryesor.

4. Gjkata në çdo rast vendos edhe konfiskimin e mjediseve të personit juridik të cilat ai ka vepruar për kryerjen e veprave penale.

### **Neni 275**

#### **Konkurrimi i veprave dhe bashkëpunimi**

1. Në të gjitha rastet kur, për të kryer një prej veprave penale të parashikuara në këtë seksion, autorit i është dashur të kryejë veprime që përbëjnë vepër penale më vete, atëherë kjo e fundit konkurren me veprën që ai ka dashur të kryejë.

2. Nëse për kryerjen e ndonjëres prej veprave penale të parashikuara në këtë kre, autorit të posaçëm i është dashur të bashkëpunojë me një person tjetër, pavarësisht cilësive të posaçme të këtij të fundit, ata do të përgjigjet për kryerjen në bashkëpunim të veprës penale të parashikuar në këtë kre, apo çfarëdolloj vepre penale që konkurren me to.

## **KREU V**

### **VEPRAT PENALE QË CENOJNË MARRËDHËNIET ME SHTETET E TJERA**

#### **Neni 276**

##### **Veprime të dhunshme ndaj personave të mbrojtur ndërkombëtarisht**

Kryerja e veprave të dhunshme ndaj personave të mbrojtur ndërkombëtarisht, dënohet me burgim nga dy deri në dhjetë vjet.

#### **Neni 277**

##### **Veprimet e dhunshme ndaj vendeve të punës së personave të mbrojtur ndërkombëtarisht**

1. Kryerja e veprimeve të dhunshme ndaj vendeve të punës, banimit, mjeteve të transportit të personave të mbrojtur ndërkombëtarisht, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

2. Kur nga vepra kanë ardhur pasoja të rënda materiale apo janë sjellë ndërlikime në marrëdhëniet dypalëshe, dënohet me burgim nga dy deri në dhjetë vjet.

### TITULLI III VEPRAT PENALE KUNDËR AUTORITETIT TË SHTETIT

#### KREU I VEPRAT PENALE QË CENOJNË VEPRIMTARINË POLITIKE DHE SISTEMIN E ZGJEDHJEVE

##### **Neni 278**

##### **Vonesa apo mungesa për përmbushjen e funksioneve të veprimeve për përgatitjen, publikimin dhe rishikimin e listave zgjedhore**

Moskryerja e veprimeve të parashikuara në funksionet e tyre për të hartuar, mbajtur, publikuar, shpallur ose rishikuar listat zgjedhore, sipas ligjit për zgjedhjet, pa shkak të përligjur nga personat, të cilët janë të detyruar me ligj për përgatitjen, mbajtjen dhe përditësimin e listave zgjedhore, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre muaj.

##### **Neni 279**

##### **Refuzimi për shpalljen e listave zgjedhore dhe të dhënave të tjera**

Refuzimi pa shkak të përligjur për të shpallur ose publikuar listat e zgjedhësve dhe të dhënat e nevojshme për zhvillimin e procesit zgjedhor, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

##### **Neni 280**

##### **Regjistrimi ose fshirja e paligjshme e emrit të zgjedhësit në listën zgjedhore**

Regjistrimi me dashje në listën e një zone zgjedhore i një zgjedhësi që nuk e kishte të drejtën të përfshihej në atë listë të zonës zgjedhore, ose fshirja e zgjedhësit që nuk duhet të fshihej nga lista, ose mosregjistrimi i zgjedhësit që sipas ligjit për zgjedhjet kishte të drejtë të regjistrohej, apo mosfshirja e zgjedhësit që sipas ligjit për zgjedhjet duhej të ishte fshirë, nga funksionari i ngarkuar me përgatitjen, publikimin apo shpalljen, ose rishikimin e listave zgjedhore, dënohet me gjobë ose me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet dhe me dënimin plotësues të ndalimit për të ushtruar funksione publike deri në dy vjet.

##### **Neni 281**

##### **Cenimi apo pengimi i procesit zgjedhor**

1. Cenimi apo pengimi i procesit zgjedhor nëpërmjet kanosjes, dhunës, duke penguar funksionarët e administrimit të zgjedhjeve të ushtrojnë sipas ligjit funksionet zgjedhore në qendrat e votimit, apo numërimin apo të përpunimit të të dhënave, brenda apo jashtë selisë përkatëse apo vendit ku ushtrojnë funksionet, dënohet me burgim nga një deri në katër vjet.

2. Kur veprat penale të parashikuara në këtë titull kryhen nga zyrtari publik, gjykata, krahas dënimit kryesor cakton edhe dënimin plotësues të heqjes të së drejtës për të ushtruar funksione publike sipas parashikimeve të nenit 76 të këtij Kodi.

### **Neni 282**

#### **Pengimi i subjekteve zgjedhore**

Pengimi me anë të kanosjes, dhunës, apo me çdo mënyrë tjetër i subjekteve zgjedhore apo i kandidatëve për të zhvilluar veprimtarinë e tyre në përputhje me ligjin gjatë fushatës zgjedhore, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

### **Neni 283**

#### **Dëmtimi me dashje i materialit zgjedhor**

1. Dëmtimi, prishja, shkatërrimi me dashje, apo zëvendësimi në kundërshtim me ligjin e pajisjeve, vulave, kodeve të sigurisë apo çdo materiali tjetër zgjedhor të parashikuar nga ligji, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

2. Po këto vepra kur kryhen nga personat përgjegjës për administrimin zgjedhor ose në bashkëpunim, që kanë sjellë pavlefshmërinë e tyre apo kanë cenuar rezultatin e votimit, dënohen me burgim nga tre deri në tetë vjet dhe me dënimin plotësues të heqjes të së drejtës për të ushtruar funksione publike sipas parashikimeve të nenit 76 të këtij Kodi.

### **Neni 284**

#### **Falsifikimi i materialit zgjedhor dhe rezultateve të zgjedhjeve**

1. Falsifikimi, shpërndarja ose përdorimi i fletëve të votimit, i dokumenteve dhe materialit zgjedhor, me qëllim ndryshimin e rezultatit të zgjedhjeve, qoftë edhe pjesërisht, nëpërmjet paraqitjes së të dhënave, që dihen se janë të pasakta, zëvendësimi i të saktave me të rreme ose, nëpërmjet futjes në kuti të fletëve të votimit në mënyrë të paligjshme, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

2. Po kjo vepër kur kryhet nga personat që kanë për detyrë të administrojnë procesin zgjedhor, ka cenuar integritetin e rezultatit të zgjedhjeve apo ka sjellë pavlefshmërinë e tyre, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet dhe dënimin plotësues të heqjes të së drejtës për të ushtruar funksione publike sipas parashikimeve të nenit 76 të këtij Kodi.

### **Neni 285**

#### **Tjetërsimi i rezultateve**

Tjetërsimi i rezultatit të zgjedhjeve, referendumeve apo i zgjedhjeve të organeve kushtetuese nga ana e funksionarëve të ngarkuar me administrimin e zgjedhjeve, ose referendumeve, ose

komisioneve për administrimin e procesit të votimit dhe zgjedhjes së anëtarëve apo titullarëve të organeve kushtetuese, dënohet nga pesë deri në dhjetë vjet burgim, dhe me dënimin plotësues të heqjes së të drejtës për të ushtruar funksione publike sipas parashikimeve të nenit 76 të këtij Kodi.

### **Neni 286**

#### **Shkelja e fshehtësisë së votimit**

1. Shkelja e rregullave që garantojnë fshehtësinë e votimit nga ana e zgjedhësit, nëpërmjet fotografimit të fletës së votimit, ose filmimit të saj, ose dokumentimit me çdo mjet dhe formë të mënyrës se si ka votuar për ta shfaqur te persona të tjerë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim nga tre muaj deri në dy vjet.

2. Shkelja e rregullave që garantojnë fshehtësinë e votimit nga ana e funksionarëve të ngarkuar me zgjedhjet, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim nga gjashtë muaj deri në dy vjet dhe ndalimin e përkohshëm për të ushtruar funksione publike.

3. Nxitja me ose pa shpërblim, ose detyrimi i zgjedhësit për të shkelur rregullat që garantojnë fshehtësinë e votimit, sipas paragrafit të parë të këtij neni, dënohet nga dy deri në katër vjet burgim.

### **Neni 287**

#### **Votimi më shumë se një herë ose pa u identifikuar**

1. Votimi më shumë se një herë në të njëjtat zgjedhje, votimi për persona të tjerë, duke paraqitur dokumente identifikimi të rreme, apo duke përdorur dokumente të zgjedhësve të tjerë, dënohet me burgim nga dy deri në katër vjet.

2. Lejimi me dashje i kryerjes së kësaj vepre nga komisionerët zgjedhorë, apo edhe të votimit në emër të personave të tjerë pavarësisht nëse paraqiten apo jo dokumentet e tyre të identifikimit, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

3. Lejimi me dashje nga komisionerët zgjedhorë i votimit, pa kryer identifikimin e shtetasit sipas ligjit, dënohet me burgim nga dy deri në katër vjet.

### **Neni 288**

#### **Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje**

1. Kanosja që i bëhet zgjedhësit apo personave të familjes a të afërme të ngushtë të tij për të votuar në kundërshtim me vullnetin e tyre të lirë, apo për të marrë pjesë ose jo në votime, për të nënshkruar në mbështetje të një kandidature, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

2. Kanosja apo përdorimi i dhunës që i bëhet komisionerit, vëzhguesit, numëruesit, si dhe çdo funksionari tjetër të ngarkuar me zgjedhjet për ta penguar në kryerjen e detyrës, apo për shkak të veprimtarisë së tij në administrimin zgjedhor dënohet me burgim nga një deri në katër vjet.

3. Kur veprimet e mësipërme kryhen nga më shumë se tre persona të mbledhur, me tregimin e armës së zjarrit apo armës së ftohtë, me shkresa anonime, dënohet me burgim nga tre deri në gjashtë vjet.

4. Kur veprimet e dhunës apo frikësimit të zgjedhësve apo funksionarëve të administrimit të zgjedhjeve, bëhen nga persona të dënuar për kryerjen më parë të veprave penale të dhunshme, trafikëve të ndryshme apo prishës së proceseve zgjedhore, dënohen me burgim nga pesë deri në tetë vjet.

5. Nëse personat sipas paragrafit të pestë të këtij neni, janë thirrur për mbështetje nga përfaqësues apo funksionarë të administratës zgjedhore ose partiake të garës zgjedhore, dënimi për këta të fundit shtohet deri me një të dytën.

6. Kur veprimet e parashikuara në paragrafin e parë dhe të dytë të këtij neni kryen nga funksionarë publikë ose funksionarë të ngarkuar me procesin zgjedhor, dënimi me burgim shtohet deri me një të tretën dhe me dënimin plotësues me gjobë ose ndalim për të ushtruar funksione publike deri në dy vjet.

### **Neni 289**

#### **Ndikimi i zgjedhësve nëpërmjet dizinformimit**

1. Ndikimi përmes gënjeshtreve dhe informacioneve të rreme me qëllim për të ushtruar ndikim të paligjshëm te zgjedhësit, për të votuar në kundërshtim me vullnetin e tyre të lirë, apo për të marrë pjesë ose jo në votime, për të nënshkruar në mbështetje të një kandidature, kur ndikimi ka cenuar lirinë e zgjedhësit për të votuar, dënohet me gjobë ose me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

2. Kur ndikimi sipas paragrafit të parë bëhet nëpërmjet mjeteve të komunikimit të çfarëdolloji apo vjen si pasojë e varësisë ndaj zgjedhësve, për shkak të marrëdhënieve të punës apo, duke përfituar nga nevoja e tyre, rrit dënimin deri në një të dytën e tij.

### **Neni 290**

#### **Pengimi i zgjedhësit**

1. Pengimi i plotë ose i pjesshëm, nëpërmjet kanosjes, dhunës, gënjeshtres, ose dëmtimit të dokumentit të identifikimit, i së drejtës së shtetasit për të zgjedhur, ose shtyrja e shtetasit, po nëpërmjet kanosjes, dhunës, gënjeshtres ose dëmtuar dokumentin e identifikimit për të ushtruar të drejtën në kundërshtim me vullnetin e tij, dënohet me gjobë ose burgim nga një deri në katër vjet.

2. Kur pengimi i zgjedhësit për të votuar në mënyrën e parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni, bëhet në qendrën e tij të votimit, dënohet me burgim nga dy deri në gjashtë vjet.

3. Kur veprat e mësipërme kryen nga funksionarët zgjedhorë, dënohen me burgim nga tre deri në shtatë vjet dhe me dënimin plotësues të ndalimit për të ushtruar funksione publike deri në tre vjet.

### **Neni 291**

#### **Braktisja e detyrës nga anëtarët e komisioneve zgjedhore**

1. Braktisja e detyrës, ndërprerja pa shkak të përligjur, apo refuzimi për të kryer detyrën nga personat e ngarkuar me administrimin e procesit të votimit dhe të numërimit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në dy vjet.

2. Kur veprimet e mësipërme kryhen duke marrë me vete ose duke zhdukur materialet zgjedhore, ose kur kanë sjellë pasoja të rënda për integritetin e procesit të votimit, apo kanë çuar në pavlefshmërinë e zgjedhjeve, qoftë edhe të pjesshme, dënohet me burgim nga dy deri në shtatë vjet, dhe dënimin plotësues të heqjes të së drejtës për të ushtruar funksione publike sipas parashikimeve të nenit 76 të këtij Kodi.

## **Marrja ose përdormi i paligjshëm i dokumenteve të identifikimit**

1. Dhënia e dokumentit të identifikimit me qëllim përdorimin e tij në mënyrë të paligjshme për zgjedhje, garantimin e mospjesëmarrjes në votime, për të ndikuar në mënyrën e votimit, ose për çdo qëllim tjetër të paligjshëm që lidhet me zgjedhjet, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

2. Marrja e dokumentit të identifikimit të shtetasve të tjerë, me qëllim përdorimin e tij në mënyrë të paligjshme për zgjedhje, moslejimin për të votuar, për të ndikuar në mënyrën e votimit, ose për çdo qëllim tjetër të paligjshëm që lidhet me zgjedhjet, dënohet me burgim nga një deri në katër vjet.

### Neni 293

## **Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore**

1. Pjesëmarrja e një punonjësi që kryen një detyrë shtetërore në shërbimin civil ose në një funksion jopolitik në administratën shtetërore, në kundërshtim me ligjin, në veprimtari politike ose fushatën zgjedhore, të një partie politike ose kandidati në zgjedhje, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim nga gjashtë muaj deri në dy vjet.

2. Detyrimi ose organizimi për të marrë pjesë në veprimtari zgjedhore të një subjekti zgjedhor i nxënësve të arsimit parauniversitar nga punonjës që kryejnë një detyrë shtetërore në arsimin publik, ose detyrë a funksion kudo në administratën publike apo subjekteve politike në garën zgjedhore, dënohet me gjobë ose me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

3. Detyrimi ose kërkesa drejtuar shtetasve, nga një punonjës që kryen një detyrë në administratën shtetërore apo subjekteve politike në garën zgjedhore, që kundër vullnetit të tyre ose nën kërcënimin e përdorimit të masave administrative ose disiplinore, për të marrë pjesë në veprimtari zgjedhore të një subjekti zgjedhor, për të marrë ose jo pjesë në zgjedhje, për të mbështetur ose jo një parti politike ose një kandidat në zgjedhje, ose për të votuar në një mënyrë të caktuar, dënohet me burgim nga një deri në katër vjet.

4. Përdorimi nga një punonjës që kryen një detyrë shtetërore, i të mirave publike, funksionit ose veprimtarisë shtetërore, ose i burimeve financiare ose njerëzore, me qëllim favorizimin e një partie politike ose kandidati në zgjedhje, në kundërshtim me ligjin dhe qëllimin e detyrës, dënohet me burgim nga një deri në katër vjet, dhe me dënimin plotësues të heqjes të së drejtës për të ushtruar funksione publike sipas parashikimeve të nenit 76 të këtij Kodi.

### Neni 294

## **Shpërdorimi i autoritetit policor**

Shpërdorimi i autoritetit policor nga punonjësi i Policisë së Shtetit ose i Policisë së Burgjeve për të ndikuar në mbështetjen e një partie politike ose kandidati në zgjedhje, nëpërmjet mosushtrimit të funksionit me paanësi sipas ligjit, pjesëmarrjes në veprimtari politike të një partie politike ose kandidati në zgjedhje, me kryerjen e çdo veprimi ose dhënien e urdhrave, këshillave apo çdo lloji tjetër propagande që favorizon një parti politike ose kandidat në zgjedhje, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet, dhe me dënimin plotësues të ndalimit për të ushtruar funksione publike deri në tre vjet.

Neni 295

### **Shpërdorimi i autoritetit ushtarak**

Shpërdorimi i autoriteti ushtarak nga oficeri ose kuadri ushtarak për të ndikuar në votim tek ushtarakët e tjerë që ka në varësi, me dhënie urdhrash, këshilla apo me çfarëdolloj propagande, dënohet me burgim nga një deri në katër vjet, dhe me dënimin plotësues të ndalimit për të ushtruar funksione publike deri në dy vjet.

Neni 296

### **Korrupsioni aktiv në zgjedhje**

Ofrimi ose dhënia e të hollave, të mirave materiale, premtimi për vend pune ose favorizime të tjera në cilëndo formë në kundërshtim me ligjin, për zgjedhësin ose persona të tjerë të lidhur me të, me qëllim marrjen e firmës për paraqitjen e një kandidati në zgjedhje, për të votuar në një mënyrë të caktuar, për të marrë pjesë ose jo në votime, ose për t'u angazhuar në veprimtari të paligjshme për mbështetjen e një kandidati ose partie politike, dënohet me burgim nga tre deri në gjashtë vjet.

Neni 297

### **Korrupsioni pasiv në zgjedhje**

Kërkimi ose pranimi nga zgjedhësi apo nga personat e familjes a të afërmit e tij të ngushtë i të hollave, të mirave materiale, ose favorizimeve të tjera në cilëndo formë në kundërshtim me ligjin, për vete ose të tjerët, me qëllim për të dhënë firmën për paraqitjen e një kandidati në zgjedhje, për të votuar në një mënyrë të caktuar, për të marrë pjesë ose jo në votime, ose për t'u angazhuar në veprimtari të paligjshme në mbështetjen e një kandidati ose partie politike, dënohet me burgim nga dy deri në shtatë vjet dhe me dënimin plotësues të heqjes të së drejtës për të ushtruar funksione publike sipas parashikimeve të nenit 76 të këtij Kodi.

Neni 298

### **Dënimet plotësuese**

1. Kur veprat penale të parashikuara në këtë seksion kryhen nga nëpunësi publik, atëherë gjykata, krahas dënimit kryesor cakton edhe dënimin plotësues heqjen e së drejtës për t'u zgjedhur apo punuar në shërbimin publik për një kohë të arsyeshme, ose çdo dënim tjetër plotësues që çmon që ndikon në arritjen e qëllimeve të dënimit, gjithmonë nëse dispozita konkrete nuk ka parashikuar ndryshe.

2. Në çdo rast gjykata vendos masën e zëvendësimit të dëmit të shkaktuar dhe, përveç sendeve që kanë shërbyer për kryerjen e veprave penale, kur vepra penale është kryer nga subjektet me qëllim përfitimi material apo të premtuar, vendoset konfiskimi i të ardhurave nga vepra penale apo të premtuara.

3. Për veprat penale të lehta të parashikuara në nenet 278, 279, 286, 289, 291, paragrafi 1, 292, paragrafi 1 dhe 293 të këtij Kodi kur çmohet e arsyeshme, gjykata mund të vendosë dhënien e jo

më pak sesa dy dënimeve plotësuese në vend të dënimit kryesor një prej të cilave është ndalimi i të drejtës për t'u zgjedhur kur autori është anëtar i subjektit elektoral ose kandidat i tij në zgjedhje.

Neni 299

### **Konkurrimi i veprave dhe bashkëpunimi**

1. Në të gjitha rastet kur, për të kryer një prej veprave penale të parashikuara në këtë kre, autorit i është dashur të kryejë veprime që përbëjnë vepër penale më vete, atëherë kjo e fundit konkurren me veprën që ai ka dashur të kryejë.

2. Nëse për kryerjen e ndonjërës prej veprave penale të parashikuara në këtë kre, autorit të posaçëm i është dashur të bashkëpunojë me një person tjetër, pavarësisht cilesive të posaçme të këtij të fundit, ata do të përgjigjen për kryerjen në bashkëpunim të veprës penale të parashikuar në këtë kre, apo çfarëdolloj vepre penale që konkurren me to.

## **KREU II**

### **VEPRAT PENALE KUNDËR VEPRIMTARISË SHTETËRORE TË KRYERA NGA ZYRTARËT PUBLIKË OSE NË SHËRBIM PUBLIK**

Neni 300

### **Përkufizime**

1. Për qëllim të këtij ligji penal, me zyrtar publik do të kuptohet çdo person që ushtron një detyrë në pushtetin legjislativ, ekzekutiv apo gjyqësor, një ent ose kompani publike, i zgjedhur apo emëruar, përkohësisht apo i përhershëm, me pagë apo jo, pavarësisht nga vjetërsia e tij, veprimtaria e të cilit rregullohet nga ligji i të drejtës publike, përveç subjekteve të përmendura në paragrafin e dytë të këtij neni. Të njëjtën cilësi mban edhe personi që ushtron veprimtari private të bazuar në ligjin e së drejtës publike apo aktet nënligjore të autorizuara prej tij, që kanë parashikuar se veprimtaria përbën funksion publik, ose edhe çdo person tjetër që thërret të shërbejë edhe përkohësisht në një shërbim publik për shkaqe të lidhura me nevojat apo emergjencën përkarshi publikut.

2. Për qëllim të këtij ligji me termin “zyrtar publik i lartë” do të kuptohen subjektet e përcaktuara në nenin 135, paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 75/a e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë.

3. Person publik i huaj do të kuptohet çdo person që mban një detyrë publike, ekzekutive, gjyqësore apo legjislative në një shtet të huaj, emëruar apo zgjedhur dhe, çdo person që ushtron një funksion publik në një shtet të huaj, përfshirë agjenci apo kompani publike.

4. Zyrtar publik i një organizate ndërkombëtare do të kuptohet një nëpunës civil i organizatave të njohura apo të pranuar ndërkombëtare ose, çdo person që është autorizuar nga organizatat e tilla të veprojë në emër të tyre.

## Neni 301

### **Konflikti i interesit**

1. Personi zyrtar që merr pjesë personalisht në shqyrtimin e një çështje zyrtare për të cilën ka ditur apo rezulton qartazi që duhej ta dinte që ai, ndonjë i afërmi i tij, ose ndonjë person juridik që ka të bëjë me të ka interes financiar apo, cdo interes tjetër apo, kur ushtron padrejtësisht ndikimin hierarkik në zgjidhjen e çështjes në të cilën vlerësohet në konflikt, dënohet me gjobë ose me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet.

2. Nëse çështja zyrtare është prokurim apo ankand publik organizuar për shpërndarjen e fondeve publike, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

3. Nëse subjekti në konflikt është personi i caktuar me detyrën e mbikëqyrësit, administrimit, likuidimit apo çdo lloj autoriteti mbikëqyrës, që ka një interes të çfarëdoshëm në një institucion, kompani, ndërmarrje tregtare apo operacion tregtar në momentin e kryerjes së detyrës, mban apo ruan interesin, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë duke kompromentuar paanësinë apo objektivitetin në kryerjen e shërbimit, dënimi sipas paragrafit të parë shtohet deri në një të dytën e tij.

4. Për qëllim të këtij neni, shprehja “merr pjesë” nënkupton ushtrimin e autoritetit zyrtar përmes :

vendimit, miratimit, mbështetjes në krijimin e rrethanave që një organ apo person zyrtar të vendosë në konflikt të interesit, të mosmiratimit, rekomandimit, këshillimit, hetimit, mbikëqyrjes, administrimit, likuidimit, pagesës ose në ndonjë mënyrë tjetër të ushtrimin të ndikimit të padrejtë për një çështje zyrtare.

5. Për qëllim të këtij neni, shprehja “çështje zyrtare” nënkupton procedurën gjyqësore ose çdo procedurë tjetër zyrtare; aplikim, kërkesë për vendim ose përcaktim tjetër zyrtar; kontratë, ankand ose prokurim fondesh publike, ose ndonjë çështje tjetër që prek interesat financiare të personit zyrtar, anëtarit të familjes apo ndonjë personi juridik që ka të bëjë me të.

6. Për qëllim të këtij neni, shprehja “person juridik që ka të bëjë me të” nënkupton personin juridik me të cilin zyrtari apo anëtari i familjes ka marrëdhënie financiare aktuale apo të ardhshme, përfshirë anëtarësinë, të punës apo dobi financiare të çfarëdo natyre.

7. Për qëllimet e këtij neni, “një i afërm i tij” do të thotë bashkëshorti ose bashkëshortja, prindi, prindi adoptues, fëmija, fëmija i adoptuar, vëllai ose motra, gjyshi ose gjyshja, nipat e mbesat nga vajza dhe djali, hallat dhe tezet, nipat e mbesat nga vëllai dhe motra, dajat dhe xhaxhallarët, njerku/njerka, thjeshtri/thjeshtra, vëllai/motra nga njëri prind, i afërmi i gjakut që jeton në të njëjtën shtëpi ose personi me të cilin autori jeton në bashkësi jashtëmartesore.

8. Cdo person që inicion, nxit, inkurajon apo kryen cdonjerën nga veprimet e shënuara në paragrafin 4 të këtij neni, do vlerësohet si bashkepunetor në kryerjen e kesaj vepre penale.

## Neni 302

### **Diskriminimi i shtetasve**

1. Për qëllime të këtij neni, me shprehjen “diskriminim” kuptohet çdo dallim, përjashtim, kufizim i të drejtave të përcaktuara me Kushtetutë, marrëveshje të ratifikuara ndërkombëtare ligj ose akte të tjera të përgjithshme apo trajtimi i diferencuar, qoftë dhe i privilegjuar i paparashikuar ligjërisht, ndërmjet personave fizikë, apo anëtarëve të personave juridikë në bazë të origjinës, seksit, gjendjes

familjare, shtatzënisë, pamjes fizike, vulnerabilitetit të veçantë që rrjedh nga situata ekonomike e dukshme ose e njohur për autorin, mbiemrit, vendbanimit, gjendjes shëndetësore, humbjes së autonomisë, paaftësisë fizike, karakteristikave gjenetike, moralit, orientimit seksual, identitetit gjinor, moshës, mendimeve politike, veprimtarive sindikale, aftësisë për t'u shprehur në një gjuhë tjetër përveç gjuhës shqipe, përkatësisë ose mospërkatësisë së vërtetë ose të supozuar ndaj një grupi etnik, një kombi, një race të pretenduar ose një besimi fetar specifik, apo çdo shkak tjetër, që ka si qëllim apo pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të respektimit të parimit të barazisë të çdo personi përpara ligjit apo të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të tij.

2. Cilido që kryen një prej sjelljeve diskriminuese të parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

3. Diskriminimi i përcaktuar në paragrafin e parë të këtij neni, i kryer ndaj një personi fizik ose juridik, dënohet nga një deri në katër vjet burgim kur kryhet me qëllim:

- a) për të refuzuar furnizimin e mallrave ose shërbimeve;
- b) për të penguar ushtrimin normal të çdo veprimtarie ekonomike;
- c) për të refuzuar punësimin, sanksionuar ose licencuar një person fizik/juridik;
- ç) për ta kushtëzuar furnizimin e mallrave ose shërbimeve me praninë e një kushti të bazuar në një nga elementet e përmendura në paragrafin e parë të këtij neni;
- d) për të bërë një ofertë pune, një kërkesë për periudhë stazhi profesional praktike ose një periudhë trajnimi në një kompani që i nënshtrohet një gjendje të bazuar në një nga elementet e përmendura në paragrafin e parë të këtij neni.

4. Ndalimi i diskriminimit i përshkruar në nenin e mësipërm nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi apo, kur për shkak të natyrës së aktiviteteve profesionale, ose të kushteve në të cilat profesioni ose veprimtaria ushtrohet, këto karakteristika përbëjnë një kërkesë të vërtetë dhe profesionale të domosdoshme, me kusht që qëllimi i trajtimit të ndryshëm të jetë i përligjur dhe kërkesa të mos jetë disproporcionale me atë çfarë është e domosdoshme për realizimin e saj.

### Neni 303

#### **Shpërdorimi i detyrës**

1. Zyrtari publik, i ngarkuar drejtperdrejt apo terthorazi, me administrimin e fondeve publike, që synon, me dashje dhe qellim kriminal, t'i shkaktojë dëm ekonomik veprimtarisë së institucionit të tij apo një personi tjetër, ngaqë:

- a) ushtron kompetencat në mënyrë të paligjshme;
- b) tejkalon autoritetin e tij ligjor duke përdorur fondet jashtë destinacionit të tyre, ose
- c) krijon pengesa për të përmbushur një detyrë që rrjedh nga tagrat e tij ligjorë ose nga një vendim gjyqësor, kur veprimi nuk përbën ndonjë vepër penale më të rëndë, dënohet me burgim deri në katër vjet.

2. Termi “ligj” i përdorur në paragrafin e parë të këtij neni do të kuptojë aktin e nxjerre nga organi legjislativ qendror apo vendor në përputhje me kompetencat që Kushtetuta apo ligjet organike të vendit u kanë ngarkuar atyre për të vepruar.

3. Nëse vepra e mësipërme kryhet në dëm të personave në nevojë, të pambrojtur, apo nisur nga motivimi politik, dënohet me burgim nga dy deri në shtatë vjet.

Neni 304

### **Kryerja e veprimeve arbitrare**

1. Dhënia e urdhrave ose kryerja e veprimeve arbitrare nga ana e zyrtarit publik ose atij që kryen një shërbim publik, gjatë ushtrimit të detyrës së tij, të cilat prekin lirinë e shtetasve ose krijojnë pasoja në ushtrimin apo gëzimin e tyre prej shtetasve, ose që cenojnë rëndë besimin e shtetasve në institucionet publike, dënohet me gjobë ose me burgim deri në katër vjet.

2. Kur veprimet sipas paragrafi të parë të këtij neni kryen nga nëpunës se shërbimit gjyqsor apo sistemit të drejtësisë, denimi shtohet deri në 1/3 me shume.

Neni 305

### **Mosmarrja e masave për të ndërprerë gjendjen e paligjshme**

1. Mosmarrja e masave ose moskërkimi pranë personit kompetent, që të ndërpritet gjendja e paligjshmërisë si rezultat i një veprimi arbitrar, që ka prekur lirinë e shtetasit, nga ana e personit të ngarkuar me një funksion shtetëror ose në shërbim publik, që vjen në dijeni të asaj gjendjeje për shkak të funksionit apo shërbimit, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

2. Kur vepra penale është kryer nga varetetit e eprorit dhe, ky i fundit nuk merr masa për ndërprerjen e gjendjes së paligjshmerisë, denimi penal ulet deri në 1/3 e parashikuar në paragrafin parë të këtij neni.

3. Kur veprimet sipas paragrafi të parë të këtij neni kryen nga nëpunës se shërbimit gjyqsor apo sistemit të drejtësisë, denimi shtohet deri në 1/3 me shume.

Neni 306

### **Perdhosja e autoritetit të zyres**

1. Kryerja me dashje nga një zyrtar publik i veprimeve që cenojnë rëndë aktet normative që rregullojnë veprimtarinë e rregullt të institucionit shtetëror, që sjellin cenim të rëndë të autoritetit të saj, ulje të besimit të publikut dhe imazhin e institucionit përballë tij, neperkemb dukshëm rëndësinë e funksioneve publike duke i nënshtuar autoritetin e saj plotësisht të interesave apo nevojave private e personale, mosperputhja dukshëm e veprimeve me dashje me qëllimet e veprimtarisë publike që kanë çuar në devijim të interesit publik drejt kenaqjes së ushtrimit të autoritetit abuziv prej zyrtarit dhe që, në interesin e tyre, kanë dhunuar hapur parimet demokratike të ushtrimit të autoritetit shtetëror, dënohet me gjobë ose me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

2. Perkufizimi i shënuar në nenin 235, paragrafi i 5 i këtij Kodi, gjen zbatim edhe në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 307

### **Mbajtja në burg pa vendim**

Zyrtari publik i caktuar për ekzekutimin e një dënimi penal ose masë sigurimi personal, që pranon dikë pa një urdhër të autoritetit kompetent, ose nuk i bindet një urdhri për lirimin e personit të dhënë nga autoriteti kompetent, ose padrejtësisht zgjat periudhën e qëndrimit në institucionet e ekzekutimit të dënimit penal ose të masës së sigurimit personal, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

#### Neni 308

### **Zbulimi i akteve ose i të dhënave sekrete**

1. Zbulimi i të dhënave zyrtare, informimi i fakteve, skedarëve të informatizuar, shifrave që, sipas ligjit janë e duhet të qëndrojnë sekrete ose bërja e mundur me çdo mënyrë e zbulimit të tyre, nga zyrtari publik ose personi i ngarkuar me një shërbim publik, në shkelje të detyrimeve që lidhen me detyrën ose shërbimin e tij apo duke abuzuar me pozitën e tij, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet dhe shoqërohet me dënimin plotësues të heqjes së të drejtës për të ushtruar funksione publike.

2. Nëse zbulimi i tyre kryhet nga pakujdesia, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet dhe shoqërohet me dënimin plotësues të heqjes së të drejtës për të ushtruar funksione publike për një kohë të caktuar.

3. Përdorimi në mënyrë të paligjshme i të dhënave zyrtare të cilat duhet të qëndrojnë sekrete nga zyrtari publik ose personi i ngarkuar me një shërbim publik për të siguruar për vete apo për të tjerë një përfitim material të paligjshëm, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet dhe shoqërohet me dënimin plotësues të heqjes të së drejtës për të ushtruar funksione publike.

4. Nëse ky fakt kryhet me qëllimin për të siguruar një përfitim jopasuror të padrejtë për vete ose për të tjerë ose për t'i shkaktuar të tjerëve një dëm të padrejtë, apo ndikuar nga qëllime politike, dënohet me burgim nga një deri në gjashtë vjet dhe shoqërohet me dënimin plotësues të heqjes të së drejtës për të ushtruar funksione publike.

#### Neni 309

### **Kryerja e funksionit apo shërbimit pas dhënies fund të tij**

Vazhdimi i ushtrimit të funksionit shtetëror apo të shërbimit publik nga ana e personit që është vënë në dijeni të vendimit apo rrethanës që u ka dhënë fund ushtrimit të tyre, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj.

#### Neni 310

### **Përvetësimi i pasurisë duke shpërdoruar detyrën**

1. Përvetësimi i fondeve, aseteve apo i një sendi të luajtshëm nga zyrtari publik ose personi që kryen shërbim publik, të cilin e posedon apo e mban për shkak të detyrës ose shërbimit, për shkak të besimit të dhënë për ta administruar pasurinë, apo duke përfituar nga natyra e detyrës që kryen, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.

2. Nëse autori është person zyrtar i zgjedhur, apo sendi apo e mira tjetër materiale prek investimet apo interesat financiare të Bashkimit Evropian, dënimi rritet deri në një të tretën.

3. Kjo veprë konkurren me veprën penale të shpërdorimit të detyrës.

#### Neni 311

### **Përvetësimi i pasurisë gjatë kryerjes së detyrës**

1. Personi zyrtar i cili gjatë kontrollit të banesës, lokaleve, personit apo gjatë çdo procedure që mundëson atë të trajtojë pasurinë e viktimës, merr pasurinë e luajtshme me qëllim përfitimi për vete apo të tjerë, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.
2. Kjo veprë konkurrin me veprën penale të shpërdorimit të detyrës.

#### Neni 312

### **Përdorimi i pasurisë në mënyrë të padrejtë**

1. Marrja ose përdorimi qoftë edhe i përkohshëm në mënyrë të padrejtë nga zyrtari publik, për vete ose për të tjerët, të një shume të hollash, letra me vlerë apo pasuri tjetër të luajtshme që i është besuar atij në detyrë ose në përgjithësi në vendin e punës apo, në të cilat ka qasje për shkak të shërbimit apo punës së tij, ose dhënia e pasurisë publike një personi tjetër, gjatë kohës që ushtron funksionin ose shërbimin publik, në kundërshtim me rregullat e administrimit financiar, kur qëllimi i kryerjes së veprës nuk është përvetësimi i tyre, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.
2. Kur fondet, sendi apo e mira tjetër materiale prek investimet apo interesat financiare të Bashkimit Evropian, dënimi me burgim shtohet deri në një të tretën e tij.

#### Neni 313

### **Pranimi i dhuratave**

Pranimi nga zyrtari publik, i çdo lloj dhurate, për vete ose për persona të tjerë, dhënë atij për shkak të ushtrimit të funksionit të tij publik, kur ajo mbahet e padeklaruar me qëllim për ta përvetësuar për vete, dënohet me gjobë ose me burgim nga tre muaj deri në tre vjet.

#### Neni 314

### **Pasurimi i paligjshëm**

Pasurimi i paligjshëm, nëpërmjet shtimit domethënës, të rëndësishëm e të pajustificuar te saj, e cila kapercen mundësinë për tu siguruar me të ardhurat e ligjshme të deklaruara nga zyrtari publik, dënohet me burgim nga 2 deri në 7 vjet.

#### Neni 315

### **Zhvatja**

Moskryerja e qëllimtë e detyrës nga zyrtari publik, kushtëzimi i plotësimit të detyrës publike me qëllimin e përfitimit material ose jo material, për vete ose për persona të tjerë, krijimi artificialisht i rrethanave negative në dëm të viktimës me qëllim manipulimin e nevojës së tij dhe ta detyrojë atë të paguajë, zvarritja e përfundimit të saj me synimin për të marrë paraprakisht përfitimin e

paligjshëm, dënohet me burgim nga pesë deri në tetë vjet dhe dënimin plotësues të heqjes së ushtrimit të funksioneve publike për një periudhë nga pesëmbëdhjetë deri në njëzet vjet.

Neni 316

### **Fshehja e pasurisë**

Zyrtari publik që, qëllimisht fsheh me çdo mënyrë burimin e paligjshëm të pasurisë së një tjetri që e ka krijuar atë, ose zotëron në mënyrë të pandërprerë një pasuri të kujtudo që e ka përfituar nga njëra prej veprave penale të parashikuara nga nenet 301, 310, 315, 318, 322, 323, 324, 325, 326, 327, 328 dhe 329 të këtij kreu, duke e ditur mënyrën e paligjshme të krijimit të saj, kur nuk përbën vepër penale më të rëndë, dënohet me burgim nga dy deri në gjashtë vjet.

Neni 317

### **Arkëtimi dhe pagesa e kundërligjshme**

Personi zyrtar që me dashje arkëton pagesë nga viktimja, e cila nuk është e detyruar që të paguajë ose, arkëton më shumë sesa viktimja është e detyruar të paguajë apo, që gjatë pagesës ose dërgesës, paguan ose dërgon më pak sa është dashur, kryen kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

Neni 318

### **Mashtrimi në detyrë**

Personi zyrtar, i cili me qëllim për të përfituar në mënyrë të kundërligjshme, për vete apo për të tjerë, krijon, përdor ose paraqet në të rremë raportin e llogarive apo, me çdo mënyrë tjetër vë në lajthim viktimën për të kryer pagesa ose transfertat të kundërligjshme të parave, të pasurisë ose të drejtave të tjera reale, apo i kërkon transfertat e paligjshme si favorizime për shkak të raportit ndikues përmbi viktimën, dënohet me burgim nga katër deri në dhjetë vjet.

Neni 319

### **Shpërdorimi i kontributeve**

1. Shpërdorimi i kontributeve të bëra nga qytetarët në mbështetje të thirrjes së bërë nga administrata publike për lehtësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore, duke i përdorur ato në vepra dhe veprimtari të ndryshme nga destinacioni për të cilin janë grumbulluar, dënohet me burgim nga një deri në katër vjet.

2. Kur kontributi është siguruar nga fonde të BE-së, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet.

Neni 320

### **Refuzimi për deklaram ose deklarimi i rremë i pasurive apo interesave private**

1. Refuzimi i deklaramit të pasurisë apo interesave private nga personi që sipas ligjit përkatës ka detyrimin ligjor për të bërë deklaramin e tyre, kur më parë ndaj tij janë marrë masa administrative për shkelje të njëjta, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre muaj.

2. Deklarimi i rremë apo fshehja e qëllimtë e pasurive apo interesave private nga subjektet e paragrafit të parë të këtij neni, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

Neni 321

### **Përdorimi i shpikjeve**

Përdorimi për përfitimin e vet ose të një tjetri nga zyrtari publik ose personi që ushtron një shërbim publik, i një shpikjeje ose zbulimi shkencor apo i një teknike të re industriale, për të cilat është vënë në dijeni për shkak të detyrës ose shërbimit dhe që, sipas ligjit duhet të qëndrojnë sekrete, dënohet me burgim nga katër deri në tetë vjet dhe shoqërohet me dënimin plotësues të heqjes të së drejtës për të ushtruar funksione publike.

Neni 322

### **Shkelja e barazisë së kandidatëve ekonomikë në procedurat e koncesionit**

1. Kryerja e qëllimtë e veprimeve te pabarabarta nga personi i ngarkuar me funksione shtetërore apo në shërbim publik, që shmangin garën reale, konkurrimin e ndershëm dhe cenojnë barazinë e kandidatëve, operatorëve ekonomikë, në procedurat e kërkuara nga ligji për hyrjen në një prokurim koncesionar/partneritet publik-privat, marrja e masave me qëllim për të diskriminuar apo favorizuar subjekte të veçanta tregtare, duke vendosur apo ndikuar të vendosë fitues të procesit një subjekt të pamerituar, kur me pare janë marre masa administrative perkatese, dënohet me burgim nga dy deri në tetë vjet.

2. Dënimi i mësipërm shtohet me një të dytën nëse veprimet e mësipërme janë bërë për të mbështetur subjekte që dihej apo duheshin përjashtuar nga gara për shkak të pengesave ligjore që rëndojnë mbi ta.

3. Nëse vepra penale është kryer për qëllim përfitimi ajo konkurren me veprën penale të korrupsionit pasiv të personave që ushtrajnë funksione publike.

4. Me togfjalëshin “kur më parë janë marre masa administrative perkatese” përdorur në këtë nen, kuptohet fakti i fillimit të procedimit penal ndaj subjektit tatimor, vetëm nëse ndaj tij janë marrë masa administrative më parë për një shkelje tjetër të ngjashme dhe, dënimet përkatëse administrative mase që përfshihet në ligjin perkates qe rregullon veprimtarine e fushes, pervec rastit te permendur ne paragrafin 3 te ketij neni. Për sa lidhet me efektin e përsëritjes, subjekti nuk vlerësohet si përsëritës i kryerjes së veprës penale në kuptim të ligjit penal.

Neni 323

### **Shkelja e barazisë së kandidatëve ekonomikë në procedurat e prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë**

1. Kryerja e qëllimtë e veprimeve te pabarabarta nga personi i ngarkuar me funksione shtetërore apo në shërbim publik, që shmangin garën reale, konkurrimin e ndershëm dhe cenojnë barazinë e kandidatëve, operatorëve ekonomikë, në procedurat e kërkuara nga ligji në një prokurim në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, marrja e masave me qëllim për të diskriminuar apo favorizuar subjekte të veçanta tregtare, kur prokurimi është deri në vlerën e prokurimit të thjeshtuar, sipas parashikimeve të legjislacionit të fushës, apo kur për të njëjtat arsye është vendosur apo ndikuar të

vendoset fitues të procesit një subjekt të pamerituar, kur me pare jane marre masa administrative perkatese , dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

2. Po kjo vepër, kur kryhet në procedurat mbi këtë vlerë, dënohet me burgim nga dy deri në gjashtë vjet.

3. Po kjo vepër, kur procedurat e prokurimit publik zhvillohen në kufirin e lartë monetar, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.

4. Dënimi i mësipërm shtohet me një të dytën nëse veprimet e mësipërme të përcaktuara në tre paragrafët më lart, janë bërë për të mbështetur subjekte që dihej apo duheshin përjashtuar nga gara për shkak të pengesave ligjore që rëndojnë mbi ta.

5. Nëse vepra penale është kryer për qëllim përfitimi ajo konkurren me veprën penale të korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike.

6. Me togfjalëshin “kur më parë jane marre masa administrative perkatese” përdorur në këtë nen, kuptohet fakti i fillimit të procedimit penal ndaj subjektit tatimor, vetëm nëse ndaj tij janë marrë masa administrative më parë për një shkelje tjetër të ngjashme dhe, dënimet përkatëse administrative mase që përfshihet në ligjin perkates qe rregullon veprimtarine e fushes, pervec rastit te permendur ne paragrafin 5 te ketij neni. Për sa lidhet me efektin e përsëritjes, subjekti nuk vlerësohet si përsëritës i kryerjes së veprës penale në kuptim të ligjit penal.

#### Neni 324

### **Shkelja e barazisë së kandidatëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik**

1. Kryerja e qëllimtë e veprimeve te pabarabarta nga personi i ngarkuar me funksione shtetërore apo në shërbim publik, që për qëllim përfitimi, për qëllim përfitimi, shmangin garën reale, konkurrimin e ndershëm dhe cenojnë barazinë e kandidatëve, operatorë ekonomikë, në procedurat e kërkuara nga ligji në një prokurim publik, marrja e masave me qëllim për të diskriminuar apo favorizuar subjekte të veçanta tregtare, kur prokurimi është në vlerën e kufirit të prokurimeve me vlerë të vogël sipas parashikimeve të legjisllacionit të fushës, apo kur për të njëjtat arsye është vendosur apo ndikuar të vendoset fitues i procesit një subjekt i pamerituar, kur me pare jane marre masa administrative perkatese, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

2. Po kjo vepër, kur kryhet në procedurat mbi këtë vlerë, dënohet me burgim nga dy deri në tetë vjet.

3. Dënimi i mësipërm shtohet me një të dytën nëse veprimet e mësipërme janë bërë për të mbështetur subjekte që dihej që duheshin përjashtuar nga gara për shkak të pengesave ligjore që rëndojnë mbi ta.

4. Nëse nga kryerja e veprës penale sipas paragrafeve te ketij neni ka ardhur dem ekonomik i rendesishem, denimi perkates shtohet deri ne 1/3 e tij.

5. Nëse vepra penale është kryer për qëllim përfitimi ajo konkurren me veprën penale të korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike.

6. Me togfjalëshin “kur më parë jane marre masa administrative perkatese” përdorur në këtë nen, kuptohet fakti i fillimit të procedimit penal ndaj subjektit tatimor, vetëm nëse ndaj tij janë marrë masa administrative më parë për një shkelje tjetër të ngjashme dhe, dënimet përkatëse administrative mase që përfshihet në ligjin perkates qe rregullon veprimtarine e fushes, pervec rastit te permendur ne paragrafin 5 te ketij neni. Për sa lidhet me efektin e përsëritjes, subjekti nuk vlerësohet si përsëritës i kryerjes së veprës penale në kuptim të ligjit penal.

## Neni 325

### **Shkelja e barazisë së kandidatëve ekonomikë në procedurat e ankandit publik**

1. Kryerja e qëllimtë e veprimeve të pabarabarta nga personi i ngarkuar me funksione shtetërore apo në shërbim publik, që për qëllim përfitimi, shmangin garën reale, konkurrimin e ndershëm dhe cenojnë barazinë e kandidatëve, operatorëve ekonomikë, në procedurat e kërkuara nga ligji në një ankand publik, marrja e masave me qëllim për të diskriminuar apo favorizuar subjekte të veçanta tregtare, kur ankandi është në vlerën një milion lekë, apo kur për të njëjtat arsye është vendosur apo ndikuar të vendoset fitues i procesit një subjekt i pamërituar, kur me pare janë marrë masa administrative perkatese, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet.

2. Po kjo vepër, kur kryhet në procedurat mbi këtë vlerë, dënohet me burgim nga një deri në shtatë vjet.

3. Dënimi i mësipërm shtohet me një të dytën nëse veprimet e mësipërme janë bërë për të mbështetur subjekte që dihej që duheshin përjashtuar nga ankandi për shkak të pengesave ligjore që rëndojnë mbi ta.

4. Nëse nga kryerja e veprës penale sipas paragrafeve të këtij neni ka ardhur dëm ekonomik i rëndësishëm, dënimi perkates shtohet deri në 1/3 e tij.

5. Nëse vepra penale është kryer për qëllim përfitimi ajo konkurren me veprën penale të korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike.

6. Me togfjalëshin “kur më parë janë marrë masa administrative perkatese” përdorur në këtë nen, kuptohet fakti i fillimit të procedimit penal ndaj subjektit tatimor, vetëm nëse ndaj tij janë marrë masa administrative më parë për një shkelje tjetër të ngjashme dhe, dënimet perkatese administrative mase që përfshihet në ligjin perkates që rregullon veprimtarinë e fushes, përveç rastit të përmendur në paragrafin 5 të këtij neni. Për sa lidhet me efektin e përsëritjes, subjekti nuk vlerësohet si përsëritës i kryerjes së veprës penale në kuptim të ligjit penal.

## Neni 326

### **Keqadministrimi i fondeve të BE-së përgjatë procedurave të prokurimit publik**

1. Në cilindo rast të kryerjes së prokurimit publik të përmendur në dispozitat e këtij kreu, kur prokurohen apo shpërndahen nëpërmjet garës së subjekteve tregtare vendase apo të huaja, fonde të BE-së, dënimi me burgim do të shtohet me një të tretën për secilën nga veprat penale të kryera.

2. Përdorimi ose paraqitja e deklaratave ose dokumenteve të rreme, të pasakta ose të paplota, që ka si pasojë shpërdorimin ose mbajtjen e gabuar të fondeve ose asetëve nga buxheti i BE ose buxhetet e menaxhuara nga ose në emër të tij, dënohet me burgim nga dy deri në shtatë vjet.

3. Keqpërdorimi i fondeve ose aktiveve të tilla për qëllime të ndryshme nga ato për të cilat janë dhënë fillimisht, kur dëmtohen interesat financiare të Bashkimit dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.

## Neni 327

### **Ndikimi i paligjshëm**

1. Premtimi, ofrimi ose dhënia një nëpunësi publik ose çdo personi tjetër, drejtpërdrejt, në mënyrë të tërthortë ose nëpërmjet çdo ndërmjetësi, e një përfitimi të parregullt, me qëllim që zyrtari publik, ose personi tjetër, të keqpërdorë ndikimin e tij të vërtetë ose të supozuar me qëllim që një organ administrativ ose publik të japë një përfitim të parregullt për nxitësin e parë të këtij akti ose

për çdo person tjetër të lidhur me të, pavarësisht nëse ndikimi ka arritur apo jo qëllimin e synuar, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

2. Kërkimi ose pranimi nga një nëpunës publik ose çdo person tjetër, drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë, i një përfitimi të parregullt për vete ose këdo tjetër, me qëllim që nëpunësi publik, ose çdo person tjetër, të keqpërdorë ndikimin e tij të vërtetë ose të supozuar, me qëllim që të përfitohet për nxitësit një përfitim i parregullt nga një organ administrativ ose publik, pavarësisht nëse ndikimi ka arritur apo jo qëllimin e synuar, dënohet me burgim nga dy deri në shtatë vjet.

3. Për qëllim të këtij ligji me zyrtarin publik do të kuptohet edhe çdo zyrtar publik i huaj.

Neni 328

### **Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike**

1. Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt, tërthorazi ose nëpërmjet çdo ndërmjetësi, i çdo lloj përfitimi të parregullt, dhurate ose i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte, dhurate apo premtimi që do marrë përfitim të parregullt, nga personi që ushtron funksione publike, për të kryer ose mos kryer një veprim ne perputhje me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet.

2. Kur nga këto veprime dëmtohen ose rrezikojnë të demtohen interesat financiare të Bashkimit Evropian, dënimi me burgim shtohet deri në një të tretën e tij.

Neni 329

### **Korrupsioni pasiv i nëpunësve të huaj publikë**

1. Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt, tërthorazi ose nëpërmjet çdo ndërmjetësi, i çdo lloj përfitimi të parregullt, dhurate apo premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte, dhurate a premtimi që do marrë përfitim të parregullt, nga nëpunësi i huaj publik, nëpunësi i një organizate publike ndërkombëtare, strukturave të BE-së, anëtari i një asambleje të huaj publike apo anëtari i një asambleje ndërkombëtare parlamentare, për të kryer ose për të mos kryer një veprim ne perputhje me detyrën a funksionin e tij, kur cenohen interesat e shtetit apo shtetasit shqiptar, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet.

2. Kur nga këto veprime dëmtohen ose rrezikojnë të demtohen interesat financiare të Bashkimit Evropian, dënimi me burgim shtohet deri në një të tretën e tij.

Neni 330

### **Konspiracioni për korrupsion**

Krijimi i planeve, rrethanave apo gjetja e bashkëpunëtorëve për të kryer cilëndo prej krimeve të korrupsionit të parashikuara në këtë kre, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

Neni 331

### **Shkelja e paprekshmërisë së banesës**

1. Hyrja, kontrolli ose qëndrimi në banesën e një personi apo në mjedise të tjera që njehsohen me të, kundër vullnetit apo pëlqimit të tij, nga punonjësi i ngarkuar me një funksion shtetëror apo në shërbim publik gjatë ushtrimit të detyrës së tij, apo, qoftë edhe duke shfrytëzuar detyrën, por në

keqpërdorim të pozitës publike në mungesë të një akti ligjor apo tej rasteve të parashikuara me ligj, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

2. Për qëllim të këtij ligji me shprehjen “apo në mjedise që barazohen me të” kuptohen, por nuk kufizohen në banesën dhe kopshtin rrethues, edhe mjediset e biznesit, zyrës, hotelit apo dhomat e marra me qera.

#### Neni 332

### **Pengimi dhe shkelja e fshehtësisë së korrespondencës**

1. Hapja pa autorizim e letrës, telegramit, faksimilit apo çdo dokumenti tjetër të mbyllur ose, dërgesë apo komunikim elektronik të personit që i drejtohet ky material/komunikim ose, në ndonjë mënyrë tjetër cenon fshehtësinë e materialeve të tilla apo kur, pa autorizim mban, fsheh, asgjëson ose i dorëzon një personi tjetër letrën, telegramin, faksimilin, komunikimin elektronik apo çdo dokument tjetër të mbyllur ose dërgesë të personit që i drejtohet materiali/komunikimi, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

2. Ndërhyrja pa autorizim në bazën e të dhënave kompjuterike të personit që i përkasin këto të dhëna ose këto të dhëna shfrytëzohen apo i vihen në dispozicion një personi tjetër, dënohet me gjobë ose burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet.

3. Kur vepra penale sipas parashikimeve të paragrafit të parë ose të dytë të këtij neni kryhet me qëllim përfitimi pasuror apo për t'i shkaktuar dëm personit që i drejtohen/përkasin këto të dhëna, dënohet me gjobë ose me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet.

#### Neni 333

### **Rrethana të cilësuar**

Nëse çdo njëra nga veprat penale të këtij kreu do të kryhet nga zyrtarë të lartë publikë, dënimi respektiv i dhënë për veprën e kryer do të shtohet deri në një të tretën më shumë.

#### Neni 334

### **Dënimet plotësuese**

1. Për kryerjen e veprave penale të parashikuara në këtë kre, gjykata, krahas dënimit kryesor cakton edhe dënimin plotësues, heqjen e së drejtës për të punuar në shërbimin publik, ose çdo dënim tjetër që çmon të arsyeshëm, në përputhje me natyrën e veprës dhe veprimeve të kryera nga i dënuari, gjithmonë nëse dispozita konkrete nuk ka parashikuar ndryshe.

2. Në çdo rast gjykata vendos masën e zëvendësimit të dëmit të shkaktuar dhe, përveç sendeve që kanë shërbyer për kryerjen e veprave penale, kur vepra penale është kryer nga subjektet me qëllim përfitimi material apo te premtuar, vendoset konfiskimi i të ardhurave nga vepra penale apo te premtuara.

3. Për veprat penale të lehta të parashikuara në nenet 302, 305, 308, paragrafi 2, 309, 312, paragrafi 1, 312, 317, 320 dhe 332, paragrafi 1 të këtij Kodi kur çmohet e arsyeshme, gjykata mund të vendosë dhënien e jo më pak se sa dy dënimeve plotësuese në vend të dënimit kryesor.

Neni 335

### **Konkurrimi i veprave dhe bashkëpunimi**

1. Në të gjitha rastet kur, për të kryer një prej veprave penale të parashikuara në këtë kre, autorit i është dashur të kryejë veprime që përbëjnë vepër penale më vete, atëherë kjo e fundit konkurren me veprën që ai ka dashur të kryejë.

2. Nëse për kryerjen e ndonjëres prej veprave penale të parashikuara në këtë kre, autorit të posaçëm i është dashur të bashkëpunojë me një person tjetër, pavarësisht cilësive të posaçme të këtij të fundit, ata do të përgjigjen për kryerjen në bashkëpunim të veprës penale të parashikuar në këtë kre, apo çfarëdolloj veprave penale që konkurren me to.

### **KREU III**

### **VEPRAT PENALE KUNDËR VEPRIMTARISË SHETËTËRORE TË KRYERA NGA SHETËTASIT**

Neni 336

### **Korrupsioni aktiv ndaj personave që ushtrojnë funksione publike**

1. Premtimi, ofrimi ose dhënia, drejtpërdrejt, tërthorazi ose nëpërmjet çdo ndërmjetësi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, personit që ushtron funksionin publik, për vete ose për persona të tjerë për të kryer ose mos kryer një veprim ne perputhje me detyrën a funksionin e tij, dënohen me burgim nga tre deri në tetë vjet.

2. Kur nga këto veprime dëmtohen ose rrezikojnë të dëmtohen interesat financiare të Bashkimit Evropian, dënimi me burgim shtohet deri në një të tretën e tij.

Neni 337

### **Korrupsioni aktiv ndaj nëpunësve të huaj publikë**

1. Premtimi, ofrimi ose dhënia, drejtpërdrejt, tërthorazi ose nëpërmjet çdo ndërmjetësi, i çdo lloj përfitimi të parregullt, për vete ose për persona të tjerë, nëpunësit të huaj publik, nëpunësit të një organizate publike ndërkombëtare ose mbikombëtare, anëtarit të një asambleje të huaj publike apo anëtarit të një asambleje ndërkombëtare a mbikombëtare parlamentare, për të kryer ose për të mos kryer një veprim ne perputhje me detyrën a funksionin e tij, dënohen me burgim, nga tre deri në tetë vjet.

2. Kur nga këto veprime dëmtohen ose rrezikojnë të dëmtohen interesat financiare të Bashkimit Evropian, dënimi me burgim shtohet deri në një të tretën e tij.

Neni 338

### **Kundërshtimi i punonjësit që kryen një detyrë shtetërore ose një shërbim publik**

1. Kundërshtimi me dhunë fizike apo kanosje që i bëhet një punonjësi që kryen një detyrë shtetërore apo një shërbim publik, me qëllim për ta penguar atë për të kryer detyrën apo shërbimin

sipas ligjit, kur cilësitë e tij janë të dukshme apo të njohura, dënohet me gjobë ose me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet.

2. Kur viktimja sipas paragrafit të parë të këtij neni janë profesionistët e arsimit dhe shëndetësisë, dënimi me burgim shtohet deri në një të tretën e tij.

3. Në rast se kundërshtimi sipas paragrafit të parë apo të dytë të këtij neni bëhet në mjediset e punës, në mjedise publike, me sende të rrezikshme për jetën apo shëndetin, me sende të ndaluara për t'u mbajtur e përdorur në mjedise publike të caktuara për shkak të natyrës së veprimtarisë, apo kryhet nga një numër i madh personash, dënimi shtohet deri në një të dytën e tij.

#### Neni 339

### **Mosbindja ndaj urdhrave të punonjësit të policisë**

1. Mosbindja ndaj urdhrave të ligjshme të punonjësit të policisë, kur cilësitë e tij janë të dukshme apo të njohura, kur kanë shkaktuar ndërprerjen ose çrregullime gjatë kryerjes së detyrave në shërbim publik, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë.

2. Mosbindja, me qëllim për ta penguar atë për të kryer detyrën sipas ligjit kur kanë shkaktuar ndërprerjen ose çrregullime, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

3. Po kjo vepër, kur kryhet duke ushtruar dhunë fizike apo kanosje, dënohet me burgim nga dy deri në shtatë vjet.

4. Në rast se mosbindja sipas paragrafit të parë, të dytë, të tretë të këtij neni bëhet në mjediset publike, me sende të rrezikshme për jetën apo shëndetin, me sende të ndaluara për t'u mbajtur e përdorur në mjediset publike të caktuara për shkak të natyrës së veprimtarisë, apo kryhet nga një numër i madh personash, dënimi shtohet respektivisht deri në një të dytën e tij.

#### Neni 340

### **Mbajtja e mjeteve të rrezikshme**

1. Fshehja ose mbajtja e një mjeti transporti të çdo lloji, i cili, në lidhje me karakteristikat e deklaruar dhe të miratuara, paraqet ndërhyrje, modifikime ose rregullime teknike, të tilla që vënë në rrezik sigurinë fizike të punonjësve të policisë, dënohet me gjobë ose me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

2. Ndërhyrja në mjetet e transportit duke bërë modifikime ose rregullime teknike që vënë në rrezik sigurinë fizike të punonjësve të policisë, dënohet me gjobë ose me burgim nga një deri në tre vjet.

3. Në rastin kur autori është mbajtës i një leje, autorizimi, licence ose çdo lloj titulli tjetër që i mundëson kryerjen e veprimtarive të përmendura në paragrafët e mësipërm, dënimit kryesor i shtohet dhe dënimi plotësues i heqjes së të drejtës së ushtrimit të një veprimtarie ose mjeshtërie.

#### Neni 341

### **Shkelja e konkurrimit të ndershëm në prokurimin publik**

1. Paraqitja e dokumentacionit të rremë, apo bërja e marrëveshjeve të fshehta kundërligjore me ofertues të tjerë për të shmangur garën reale, apo ndërmarrja e çdo veprimi tjetër të paligjshëm me qëllim për të mashtruar dhe ndikuar në vendimin e një autoriteti kontraktues në procedurën e prokurimit publik, kryer nga çdo subjekt ofertues që me dashje shkel rregullat e prokurimit publik gjatë një oferte për fitimin e kontratës së prokurimit publik, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet.

2. Shkelja e procedurave dhe rregullave të prokurimit publik për moszbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata e prokurimit publik me qëllim të përfitimit për vete apo, duke shkaktuar dëme buxhetore, kryer me dashje nga subjektet fituese të procedurës ose nënkontraktorët e tij, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me burgim nga dy deri në shtatë vjet.

3. Dënimi i mësipërm shtohet deri me një të dytën nëse veprimet e mësipërme janë bërë nga subjekte që dihej apo duheshin përjashtuar nga gara për shkak të pengesave ligjore që rëndojnë mbi ta.

4. Nëse shmangia e garës reale sipas paragrafit të parë të këtij neni, bëhet nga subjektet ofertuese apo persona të lidhur me ta, nëpërmjet përdorimit të dhunës ose kërcënimeve ndaj zyrtarit publik për ta shtrënguar atë që të kryejë një veprim në kundërshtim me detyrat apo bindjen e tij, apo për të siguruar trajtim të privilegjuar ose marrjen e një vendimi të favorshëm, dënimi shtohet deri në një të dytën e tij.

#### Neni 342

### **Mospërbushja e qëllimtë e kontratës publike**

1. Mospërbushja e qëllimtë e detyrimeve që rrjedhin nga një kontratë furnizimi e lidhur me shtetin, me një ent publik ose me një shoqëri që ofron shërbime publike, duke mos ofruar sendet apo shërbimet, plotësisht apo pjesërisht, të cilat janë të domosdoshme për një institucion publik ose për një shërbim publik, nëse furnizimi ka të bëjë me:

a) sende ushqimore ose mjekësore të destinuara për çerdhe, kopshte apo spitale të vlerësuara jetike për mirërritjen e fëmijëve apo kur vë në rrezik jetën a shëndetin e pacientëve;

b) sende apo shërbime që synojnë të shmangin një rrezik të përbashkët ose një fatkeqësi publike, apo vlerësohen jetike në situata emergjence;

c) sende apo shërbime me natyrë të domosdoshme për funksionalitetin normal në komunikimin tokësor, ujor ose ajror ose për komunikime telematike, telegrafike ose telefonike, mungesa e të cilave rrezikon të sjellë çrregullime thelbësore që cenojnë veprimtarinë e rregullt publike për një kohë jo të shkurtër,

dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

2. Për këtë fakt përgjigjen edhe nënkontraktorët, ndërmjetësit, agjentët dhe përfaqësuesit e furnitorëve, kur ata nuk kanë kryer furnizimin duke shkelur detyrimet e tyre kontraktore.

#### Neni 343

### **Pengimi i punëve publike**

Pengimi apo kundërshtimi me sulm ose me dhunë i kryerjes së punëve publike ose të punëve me dobi publike, dënohet me burgim deri në tre vjet.

#### Neni 344

## **Uzurpimi i detyrës shtetërore**

1. Ndërhyrja në ushtrimin e një funksioni publik, duke kryer një nga veprimet e parashikuara për mbajtësin e vërtetë të këtij funksioni, duke kryer një veprimtari në kushte të tilla që mund të krijojnë konfuzion në sytë e publikut në raport me ushtrimin e një funksioni publik ose një veprimtari të parashikuar vetëm për zyrtarët publikë ose ministrorë, dënohet me burgim nga një deri në katër vjet.

2. Veshja e një uniforme, kostumi ose mbajtja e dekoratave që rregullohen nga autoritetet publike,

ose një shenjë tjetër dalluese që rregullohet a përdoret nga autoritetet publike, apo përdorimi i dokumenteve ose materialeve të shkruara, akteve gjyqësore ose jashtëgjyqësore ose dokumenteve administrative, të cilat paraqesin një ngjashmëri të tillë që mund të shkaktojë keqkuptim për publikun, dënohet me gjobë ose me burgim nga katër muaj deri në tre vjet.

Neni 345

### **Uzurpimi i titullit**

1. Kryerja pa të drejtë, i një detyre që lidhet me titull profesional të rregulluar me ligj ose, nga një diplomë zyrtare ose, i një cilësie kushtet e atribuimit të së cilës janë përcaktuar me ligj, apo përdorimi i gënjeshtërt i një dokumenti që dëshmon cilësinë profesionale të pretenduar, dënohet me gjobë apo me burgim nga një deri në tre vjet.

2. Kur vepra kryhet me qëllim fitimi apo ka dëmtoar interesa të viktimës, dënohet me gjobë ose me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet.

Neni 346

### **Fshehja e pasurisë**

Cilido person që, qëllimisht fsheh me çdo mënyrë burimin e paligjshëm të pasurisë të cilitdo që e ka krijuar atë, ose zotëron në mënyrë të pandërprerë një pasuri të kujtudo që e ka përfituar nga njëra prej veprave penale të parashikuara nga nenet 301, 310, 315, 318, 322, 323, 324, 325, 326, 327, 328 dhe 329 të këtij Kodi duke e ditur mënyrën e paligjshme të krijimit të pasurisë, kur nuk përbën vepër penale më të rëndë, dënohet me burgim nga dy deri në tetë vjet.

Neni 347

### **Dhuna për shkak të detyrës**

1. Përdorimi i dhunës ose kanosjeve ndaj zyrtarit publik, kur cilësitë e tij janë të dukshme apo të njohura, për ta shtrënguar atë që të kryejë një veprim në kundërshtim me detyrat e tij, ose që të mos kryejë një detyrë apo shërbim, apo për të siguruar trajtim të privilegjuar ose marrjen e një vendimi siç kërkohet prej autorit, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

2. Nëse dhuna ose kanosja përdoren për ta shtrënguar zyrtarin publik, kur cilësitë e tij janë të dukshme apo të njohura, që të kryejë një veprim që ka lidhje me detyrën e tij ose për të ndikuar në kryerjen e tij, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

3. Kur vepra penale sipas paragrafit të parë ose të dytë të këtij neni, kryhet ndaj personit të zgjedhur, për shkak të veprimtarisë së tij, kur cilësitë e tij janë të dukshme apo të njohura, dënimi shtohet deri në një të tretën e tij.

4. Kur vepra penale sipas paragrafit të parë ose të dytë të këtij neni kryhet ndaj punonjësit të policisë, profesionistit shëndetësor apo arsimor, për shkak të veprimtarisë së tij dhe, kur cilësitë e personit janë të dukshme ose të njohura, dënohet me burgim nga dy deri në gjashtë vjet.

5. Kur vepra penale sipas paragrafit të parë ose të dytë të këtij neni kryhet ndaj pjesëtarit të familjes së një personi që kryen një detyrë shtetërore ose një shërbim publik, për të penguar në kryerjen e detyrës apo të shërbimit ose për shkak të kësaj veprimtarie, dënohen me burgim nga dy deri në pesë vjet.

6. Kur vepra penale sipas paragrafit të parë ose të dytë të këtij neni, kur kryhet në mjediset e institucionit ku personi ushtron detyrën shtetërore, funksionin apo shërbimin publik, apo në mënyrë publike, dënimi me burgim shtohet deri në një të dytën e tij.

Neni 348

### **Përdorimi pa të drejtë i shenjave dhe emblemave**

Përdorimi apo vendosja në automjetet private e shenjave, flamurëve apo emblemave të jashtme zyrtare të cilat janë të njëjta dhe tipike për përdorim të lejuar nga zyrtarët e policisë së shtetit, ushtarake apo, çdo institucioni publik, dënohet me gjobë ose burgim deri në tre vjet.

Neni 349

### **Rebelimi i të burgosurve**

1. Përdorimi i dhunës, nga ana e të burgosurve ndaj punonjësit që kryen një detyrë shtetërore apo në shërbim publik, që bëhet për ta detyruar të kryejë një veprim që nuk duhej ta kryente, për ta penguar në ushtrimin e detyrës apo të shërbimit, ose për shkak të veprimtarisë, kur cilësitë e tij janë të dukshme apo të njohura, dënohet me burgim nga një vit deri në katër vjet.

2. Kur dhuna ushtrohet nga një grup personash ose shoqërohet me trazira e çrregullime apo me kanosje e frikësime, dënohet me burgim nga dy deri në shtatë vjet.

Neni 350

### **Rrethana të cilësuar**

Nëse çdo njëra nga veprat penale të këtij kreu do të kryhet ndaj zyrtarëve të lartë publikë, dënimi respektiv i dhënë për veprën e kryer do të shtohet deri në një të tretën.

Neni 351

### **Kryerja e krimeve nga personi juridik**

1. Kryerja e krimeve të parashikuara në nenet 327, 336, 337, 341 dhe 342 të këtij Kodi nga personi juridik, mbështetur në nenin 123 të këtij Kodi dënohen me gjobë deri në pesëfishin e vlerës së parashikuar, ose ndalimin për të hyrë në marrëdhënie kontraktore me sektorin publik.

2. Kryerja e krimeve të parashikuara në nenin 340, paragrafi 3, nga personi juridik mbështetur në nenin 123 të këtij Kodi dënohen me gjobë deri në trefishin e vlerës së parashikuar.

Neni 352

### **Dënimet plotësuese**

1. Në çdo rast gjykata vendos masën e zëvendesimit të dëmit të shkaktuar dhe, përveç sendeve që kanë shërbyer për kryerjen e veprave penale, kur ajo është kryer nga subjektet me qëllim përfitimi material apo të premtuar, vendoset konfiskimi i të ardhurave nga vepra penale apo të premtuara.

2. Për veprat penale të lehta të parashikuara në nenet 339, paragrafi 1, 340, 343, 344 dhe 348 të këtij Kodi, kur çmohet e arsyeshme, gjykata mund të vendosë dhënien e jo më pak se sa dy dënimeve plotësuese në vend të dënimit kryesor.

Neni 353

### **Konkurrimi i veprave dhe bashkëpunimi**

1. Në të gjitha rastet kur, për të kryer një prej veprave penale të parashikuara në këtë seksion, autorit i është dashur të kryejë veprime që përbëjnë vepër penale më vete, atëherë kjo e fundit konkurren me veprën që ai ka dashur të kryejë.

2. Nëse për kryerjen e ndonjërës prej veprave penale të parashikuara në këtë kre, autorit të posaçëm i është dashur të bashkëpunojë me një person tjetër, pavarësisht cilësive të posaçme të këtij të fundit, ata do të përgjigjen për kryerjen në bashkëpunim të veprës penale të parashikuar në këtë kre, apo çfarëdolloj vepre penale që konkurren me to.

## **KREU IV**

### **VEPRAT PENALE KUNDËR RENDIT, SIGURISË DHE SHËNDETIT PUBLIK**

#### **SEKSIONI I**

#### **MBROJTJA E RENDIT PUBLIK NGA ARMËT E PALIGJSHME**

Neni 354

### **Përkufizim**

1. Për qëllim të konceptit armë, armë shpërthyes apo municion të përmendura në këtë ligj do të shërbejnë përkufizimet e përcaktuara në ligjin përkatës të armëve, mbajtja e të cilave kërkon licencë apo autorizim të posaçëm të çdo lloji të kategorizuar mbi bazën e aftësisë së tyre vdekjeprurëse apo, i aftë për të realizuar efektin dëmtues apo shkatërrues të njëjtë me atë të armës së zjarrit apo asaj shpërthyes, përfshirë edhe armët e printuara 3D.

2. Për sa lidhet me dispozitat e këtij kreu, do të vlerësohet te jetë e paligjshme, çdo sjellje, autorizim i kërkuar, leje për ushtrim të veprimtarive të përmendura në këtë kre edhe kur kryhet sipas një autorizimi të lëshuar nga një autoritet kompetent i një shteti, nëse një autorizim i tillë është marrë me mashtrim ose me korrupsion, zhvatje ose detyrim, ose nëse një autorizim i tillë është në shkelje të dukshme të kërkesave ligjore thelbësore përkatëse.

Neni 355

## **Mbajtja pa leje e armëve, armëve shpërthyese dhe e municioneve**

1. Mbajtja e armëve, e armëve shpërthyese ose e lëndëve plasëse në automjete apo në çdo mjet tjetër të motorizuar, në mjedise publike ose në mjedise të hapura për publikun, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.

2. Mbajtja e armëve të përmendura në paragrafin e parë të këtij neni në mjediset e shkollave, qendrave të ngjashme të edukimit të fëmijëve apo në një territor deri në treqind metra përreth tyre, e shton dënimin deri në një të dytën e tij.

3. Mbajtja e armëve në banesë, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga një deri në katër vjet.

4. Mbajtja e municionit luftarak, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me gjobë ose me burgim nga një deri në tre vjet.

5. Mbajtja e armëve shpërthyese ose lëndëve plasëse në banesë, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga një deri në katër vjet.

6. Me fjalën banesë, për qellim të këtij seksioni, do të kuptojmë çdo mjedis ku personi jeton, punon, kalon kohë qoftë edhe të pjesshme apo e përdor atë pavarësisht nga destinacioni që ka.

7. Vlerësohen si armë zjarri të përmendura në paragrafin e parë edhe armët imituese kur mbahen në mënyrë të hapur dhe që krijojnë pa asnjë dyshim përshtypjen dhe frikën te njerëzit sikur janë të vërteta. Në këtë rast, vepra përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë. Nëse arma imituese me cilësitë e vërteta si të një arme zjarri përdoret në shoqërim të një krimi tjetër për të krijuar efektin frikësues të barabartë me atë të një arme të vërtetë, dënohet me burgim deri në tre vjet.

Neni 356

### **Prodhimi i paligjshëm i armëve**

Prodhimi ose montimi i armëve:

- a) nga pjesë dhe përbërës të trafikuar ilegalisht, ose
- b) pa autorizimin e autoritetit kompetent në përputhje me ligjin përkatës, ose
- c) pa numërtimin e tyre sipas ligjit në çastin e prodhimit, dënohet me burgim nga dy deri në tetë vjet.

Neni 357

### **Prodhimi i paligjshëm i lëndëve shpërthyese dhe municioneve**

Prodhimi apo montimi i lëndëve shpërthyese apo municioneve:

- a) nga pjesë apo përbërës të trafikuar ilegalisht; ose
- b) pa autorizimin e organit kompetent në përputhje me ligjin përkatës; dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet.

Neni 358

### **Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja e armëve të ftohta**

1. Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja e armëve të ftohta, si: shpata, bajoneta, thika dhe mjete të tjera të përgatitura e për sulm kundër personave ose për vetëmbrojtje, pa lejen e organeve kompetente, përbën kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

2. Blerja, shitja apo mbajtja në automjete apo në çdo mjet tjetër të motorizuar, në mjedise publike ose në mjedise të hapura për publikun, e armëve të flohta, si: shpata, bajoneta, thika dhe mjete të tjera të përgatitura e për sulm kundër personave ose për vetëmbrojtje, pa lejen e organeve kompetente, dënohen me burgim nga një deri në katër vjet.

3. Mbajtja e armëve të përmendura në paragrafin e parë dhe të dytë të këtij neni në mjediset e shkollave, qendrave të ngjashme të edukimit të fëmijëve apo në një territor deri në treqind metra përreth tyre, e shton dënimin deri në një të dytën e tij.

Neni 359

### **Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe atyre sportive**

Prodhimi, mbajtja, shitja ose blerja e armëve të gjuetisë ose e atyre sportive, si dhe e municioneve të tyre, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj. Kur çmohet e arsyeshme dhe efektive, gjykata jep jo më pak se sa dy dënime plotësuese në vend të dënimit kryesor.

Neni 360

### **Blerja e armëve, lëndëve shpërthyese dhe municioneve**

Blerja, shitja apo çdo tjetërsim i armëve, lëndëve shpërthyese apo municioneve, pa lejen e organeve kompetente, dënohet me burgim nga dy deri në gjashtë vjet.

Neni 361

### **Prodhimi i paligjshëm i pjesëve dhe përbërësve të armëve**

Prodhimi apo montimi i pjesëve dhe përbërësve të armëve të zjarrit:

- a) të trafikuara ilegalisht, ose
- b) pa autorizimin e autoriteteve shtetërore në përputhje me ligjin përkatës dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

Neni 362

### **Numërtimi i rremë**

Numërtimi i një arme të prodhuar tërësisht, ose pjesërisht me shenjë apo shifër të rreme në kohën e prodhimit, ose numërtimi i rremë i një arme të importuar, ose numërtimi i rremë i një arme në kohën e transferimit të stoqeve nga shteti për te një subjekt jo ushtarak, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet.

Neni 363

### **Heqja dhe ndryshimi i numërtimit të armëve**

Fshirja, heqja ose ndryshimi i numërtimit të armës, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

Neni 364

## **Trafikimi i armëve dhe i municioneve**

Importimi, eksportimi ose sigurimi në çfarëdo mënyre i armëve, shitja, dërgimi, lëvizja apo transferimi i tyre, pjesëve apo përbërësve të tyre apo municioneve shpërthyesë apo luftarake, nga dhe, përmes territorit të Shqipërisë te territori i një shteti tjetër, pa autorizimin ligjor të organit kompetent shtetëror lëshuar në përputhje me ligjin përkatës, dënohet nga pesë deri në dymbëdhjetë vjet burgim.

Neni 365

### **Trafikimi i paligjshëm i armëve të panumërtuara**

Eksportimi, importimi ose sigurimi në çfarëdo mënyre, shitja, dërgimi, lëvizja apo transferimi nga dhe përmes territorit të Shqipërisë në territorin e një shteti tjetër, i armëve të panumërtuara individualisht në kohën e prodhimit, ose në kohën e importit, ose në kohën e transferimit nga stoqet shtetërore te një subjekt jo ushtarak, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Neni 366

### **Shkelja e rregullave mbi lëndët plasëse dhe djegëse**

1. Shkelja e rregullave të caktuara për mbajtjen, prodhimin, përdorimin, ruajtjen, transportimin dhe shitjen e lëndëve plasëse apo djegëse, që krijojnë rrezik për mjedisin apo jetën e shëndetin e njerëzve, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

2. Kur nga kryerja e veprës penale ka ndodhur vdekja apo dëmtimi i shëndetit të njerëzve, apo janë shkaktuar dëme të mjedisit, personi do të mbajë përgjegjësi për to, sipas dispozitave konkrete të parashikuara në këtë Kod, në varësi të formës së fajit me të cilin është kryer vepra penale sipas paragrafit të parë të këtij neni.

Neni 367

### **Shkelja e rregullave mbi lëndët bërthamore dhe radioaktive**

1. Shkelja e rregullave të caktuara për mbajtjen, prodhimin, përdorimin, ruajtjen, transportimin, eliminimin ose asgjësimin në kundërshtim me ligjin, te energjisë bërthamore ose i elementeve radioaktive që rrezikojnë jetën ose shëndetin e njerëzve, pronën e tyre ose mjedisin, edhe kur nuk është realizuar shpërthimi, kur nuk përbën krimin e terrorizmit bërthamor, dënohet me burgim nga pesë deri në trembëdhjetë vjet.

2. Shkelja e rregullave të caktuara për funksionimin e një objekti bërthamor ose radioaktiv, ose ndërhyrja gjatë zhvillimit të veprimtarive që përfshijnë përdorimin e materialeve ose pajisjeve që prodhojnë rrezatim jonizues, jashtë kushteve të paragrafit më lart, duke krijuar një gjendje rreziku serioz për jetën, shëndetin e njerëzve ose mjedisin, kur nuk përbën krimin e terrorizmit bërthamor, dënohet me burgim nga tetë deri në tetëmbëdhjetë vjet.

Neni 368

## **Trafikimi i lëndëve plasëse dhe djegëse**

Importimi, eksportimi, tranzitimi dhe tregtimi i tyre, në kundërshtim me ligjin për lëndët plasëse apo djegëse, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.

### **Neni 369**

#### **Trafikimi dhe prodhimi i lëndëve bërthamore dhe radioaktive**

1. Blerja, posedimi, trafikimi, lehtësimi, trajtimi, transformimi, përdorimi, ruajtja, mbajtja, transportimi ose eliminimi, import, eksport ose asgjесimi në kundërshtim me ligjin, i materialeve bërthamore ose substancave të tjera radioaktive të rrezikshme që shkaktojnë ose mund të shkaktojnë vdekjen ose dëmtime të rënda të shëndetit të njerëzve, ose dëme thelbësore në cilësinë e ajrit, cilësinë e tokës ose cilësinë e ujërave, ose të kafshëve ose të bimëve, kur nuk përbëjnë krimin e terrorizmit bërthamor, dënohet me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.

2. Prodhimi i materialeve ose substancave të tilla pa lejen e autoriteteve përkatëse, kur nuk përbëjnë krimin e terrorizmit bërthamor, dënohen me burgim nga tetë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

### **Neni 370**

#### **Trafikimi i substancave kimike ose i substancave të tjera**

1. Trafikimi, blerja, posedimi, lehtësimi, trajtimi, transformimi, ruajtja, mbajtja, transportimi, asgjесimi ose eliminimi, në kundërshtim me ligjin, i lëndëve kimike apo substancave që shërbejnë për prodhimin e tyre, qe jane të afta të shkaktojnë vdekjen ose dëmtime të rënda të shëndetit të njerëzve, ose dëme thelbësore në cilësinë e ajrit, cilësinë e tokës ose cilësinë e ujërave, të kafshëve ose të bimëve, ekosistemit ne teresine e tij, dënohet me burgim nga tetë deri në gjashtëmbëdhjetë vjet.

2. Prodhimi i materialeve ose substancave të tilla pa lejen e autoriteteve përkatëse, dënohet me burgim nga tetë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

### **Neni 371**

#### **Stërvitja për prodhimin dhe përdorimin e paligjshëm të armëve dhe lëndëve të tjera të rrezikshme**

Përgatitja, stërvitja dhe dhënia e udhëzimeve, në çdo formë, edhe në mënyrë anonime apo në rrugë elektronike, në kundërshtim me ligjin, për prodhimin ose përdorimin e lëndëve eksplozive, të armëve të zjarrit dhe municioneve luftarake, të armëve të tjera dhe lëndëve kimike, bakteriologjike, bërthamore, radioaktive apo të çdo natyre tjetër, që shkaktojnë ose mund të shkaktojnë rrezik për mjedisin, njerëzit, pasurinë, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohen me burgim nga dy deri në shtatë vjet.

## Neni 372

### **Kryerja e veprës nga personi juridik**

1. Kur veprat penale të përmendura në nenet e këtij kreu, janë kryer edhe nga një person juridik, dhe mbështetur në nenin 123 të këtij Kodi, dënohen:

a) me gjobë deri në pesëfishin e vlerës së parashikuar në nenin 123 dhe mbarimin e personit juridik kur kanë kryer krimet e parashikuara në nenet 355, 356, 357, 360, 362, 364, 365, 366, paragrafi 2, 367, 367, 368 dhe 369;

b) me gjobë deri në katërfishin e vlerës së parashikuar në nenin 123, kur janë kryer veprat penale të parashikuara në nenet 361, 363,, 366, paragrafi 1, 371, dhe

c) me gjobë deri në dyfishin e vlerës së parashikuar në nenin 123, kur është kryer vepra penale e parashikuar në nenin 358.

## Neni 373

### **Dënimet plotësuese dhe masat penale**

1. Kur veprat penale të parashikuara në këtë seksion kryhen nga zyrtari publik, atëherë gjykata, krahas dënimit kryesor cakton edhe dënimin plotësues heqjen e së drejtës për të ushtruar një funksion publik.

2. Në çdo rast gjykata vendos masën e zëvendësimit të dëmit të shkaktuar dhe, përveç sendeve objekt ose, që kanë shërbyer për kryerjen e veprave penale, kur ajo është kryer nga subjektet me qëllim përfitimi material apo të premtuar, vendoset konfiskimi i të ardhurave nga vepra penale apo të premtuara.

3. Në raste të veçanta, kur çmohet e dobishme për arritjen e qëllimit të plotë të dënimit penal, gjykata, pas vlerësimit të arsyeshëm rreth raportit ndërmjet vlerës dhe sasisë së sendeve objekt i veprës penale me vlerën e mjediseve ku ruhen ato si dhe, faktit nëse këto mjedise përdoren zakonisht për këtë qëllim, vendos edhe konfiskimin e mjediseve ku mbahen sendet objekt i veprës penale të përmendura në dispozitat e këtij kreu.

4. Gjkata vendos edhe masën penale të regjistrimit dhe shkëmbimit të të dhënave që përmbajnë armët e çfarëdolloji të përmendura në dispozitat e këtij kreu me qëllim krijimin e rrethanave të përshtatshme për njohjen dhe parandalimin e kryerjes së krimeve me natyrë edhe ndërkombëtare. Kur arma si mjet i kryerjes së veprës penale urdhërohet të shkatërrohet, të dhënat e saj ruhen jo më pak sesa tridhjetë vjet. Gjkata urdhëron prokurorin të njoftojë organet përkatëse për marrjen e kësaj mase penale.

## Neni 374

### **Konkurrimi i veprave**

Në të gjitha rastet kur, për të kryer një prej veprave penale të parashikuara në këtë seksion, autorit i është dashur të kryejë veprime që përbëjnë vepër penale më vete, atëherë kjo e fundit konkurren me veprën që ai ka dashur të kryejë.

SEKSIONI II  
MBROJTJA E RENDIT PUBLIK NGA LËNDËT NARKOTIKE DHE SUBSTANCAT  
PSIKOTROPE

**Neni 375**

**Autorizimi apo leja e paligjshme**

Per sa lidhet me dispozitat e ketij seksioni, do të vleresohet te jetë e paligjshme, cdo sjellje, autorizim i kerkuar, leje per ushtrim te veprimtarive te permendura edhe kur kryhet sipas një autorizimi të lëshuar nga një autoritet kompetent i një shteti, nëse një autorizim i tillë është marrë me mashtrim ose me korrupsion, zhvatje ose detyrim, ose nëse një autorizim i tillë është në shkelje të dukshme të kërkesave ligjore thelbësore përkatëse, apo ne kapercim te kushteve te atij autorizimi.

**Neni 376**

**Mbajtja, shitja dhe trafikimi i hashashit dhe kanabis sativa dhe prekursorëve te tyre**

1. Kushdo që, pa autorizim blen ose posedon me qëllim të shitjes apo shpërndarjes, ose ofron prodhimin, fabrikimin, përpunimin dhe përdorimin e bimës së hashashit ose kanabis sativa, ose prodhon, fabrikon, nxjerr, përgatit, propozon, ofron për shitje, shpërndan, shet, dorëzon me çfarëdolloj kushti, ndërmjetëson, dërgon, dërgon në transit, transporton, importon apo eksporton substanca ose preparate që shërbejnë për prodhimin e lëndës narkotike dhe psikotrope dhe, i çdo produkti tjetër shtesë që shërbejnë për këtë qëllim të klasifikuara me ligj të veçantë në kategorinë e lëndëve narkotike ose psikotrope, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.
2. Kushdo që, pa autorizim posedon, shpërndan, ofron për shitje ose shet, transporton, dorëzon, ndërmjetëson, dërgon brenda vendit, ose dërgon në transit bimën e hashashit ose kanabis sativa, të klasifikuara me ligj të veçantë në kategorinë e lëndëve narkotike ose psikotrope, dënohet me gjobë ose, me burgim nga tre deri në tetë vjet.
3. Importimi, eksportimi ose sigurimi në çfarëdo mënyre, për qëllimet e këtij paragrafi, të bimës së hashashit ose kanabis sativa, të klasifikuara me ligj të veçantë në kategorinë e lëndëve narkotike ose psikotrope, apo shitja, dërgimi, lëvizja apo transferimi i tyre, si dhe, i substancave apo preparateve për përpunimin dhe përdorimin e tyre, prej nga dhe, përmes territorit të Shqipërisë në territorin e një shteti tjetër apo anasjelltas, pa autorizimin ligjor të organit kompetent shtetëror të lëshuar në përputhje me ligjin përkatës, dënohet me burgim nga katër deri në dhjetë vjet.
4. Organizimi, drejtimi apo financimi i veprimtarisë së parashikuar në paragrafin e parë dhe të dytë të këtij neni, e shton dënimin edhe me një të tretën.
5. Organizimi, drejtimi apo financimi i veprimtarisë së parashikuar në paragrafin e tretë të këtij neni, e shton dënimin edhe me një të dytën.
6. Nëse organizimi, drejtimi dhe financimi i veprave penale të parashikuara në paragrafi i parë, i dytë dhe i tretë i këtij neni bëhet prej ose në favor të organizatave kriminale, dënohet me burgim nga dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet.
7. Krijimi i kushteve apo lehtësirave për veprimtari të tilla nga persona me funksione shtetërore, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.

8. Mbajtja e lëndës narkotike, sipas paragrafit të dytë të këtij neni, me qëllimin e përdorimit vetjak nuk është e dënueshme nëse sasia e lëndës së kapur nuk i kalon dhjetë gram, dhe nuk ka për qëllim asnjë nga parashikimet e shprehura në këtë dispozitë. Për qëllim të këtij paragrafi nuk ka rëndësi vendi ku është kapur autori që posedon lëndën narkotike, me kushtin që të jetë mbajtur larg demonstrimit në publik.

9. Personi, që kryen veprën e parashikuar nga paragrafi i dytë i këtij neni për herë të parë dhe që posedon më pak se njëzet gram të substancave narkotike apo substancave psikotrope dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet. Gjykata mund ta përjashtojë autorin nga dënimi nëse ai tregon personin që e ka furnizuar me substancën narkotike ose, ai ka kontribuar vullnetarisht në mënyrë të konsiderueshme në zbulimin e furnizuesit.

### **Neni 377**

#### **Mbajtja, shitja dhe trafikimi i heroinës dhe prekursorëve të tyre**

1. Kushdo që, pa autorizim blen ose posedon me qëllim të shitjes apo shpërndarjes, ose ofron prodhimin, fabrikimin, përpunimin dhe përdorimin e heroinës, ose prodhon, fabrikon, nxjerr, përgatit, propozon, ofron për shitje, shpërndan, shet, dorëzon me çfarëdolloj kushti, ndërmjetëson, dërgon, dërgon në transit, transporton, importon apo eksporton substanca ose preparate që shërbejnë për prodhimin e kesaj lënde narkotike dhe, i çdo produkti tjetër shtesë që shërbejnë për këtë qëllim të klasifikuara me ligj të veçantë në kategorinë e lëndëve narkotike ose psikotrope, dënohet me burgim nga katër deri në shtatë vjet.

2. Kushdo që, pa autorizim posedon, shpërndan, ofron për shitje ose shet, transporton, dorëzon, ndërmjetëson, dërgon brenda vendit, ose dërgon në transit heroinë të gatshme për përdorim, pavarësisht cilësisë në përbërjen e saj apo përzierjes, të klasifikuara me ligj të veçantë në kategorinë e lëndëve narkotike ose substancave psikotrope, dënohet me gjobë ose, me burgim nga katër deri në dhjetë vjet.

3. Importimi, eksportimi ose sigurimi në çfarëdo mënyre për qëllimet e këtij paragrafi, të heroinës si lëndë të gatshme për përdorim, pavarësisht cilësisë në përbërjen e saj apo përzierjes, të klasifikuar me ligj të veçantë në kategorinë e lëndëve narkotike ose substancave psikotrope, apo shitja, dërgimi, lëvizja apo transferimi i tyre, si dhe, i bimëve, substancave apo preparateve për përpunimin dhe përdorimin e tyre, prej nga dhe, përmes territorit të Shqipërisë te territori i një shteti tjetër apo anasjelltas, pa autorizimin ligjor të organit kompetent shtetëror lëshuar në përputhje me ligjin përkatës, dënohet me burgim nga gjashtë deri në trembëdhjetë vjet.

4. Organizimi, drejtimi apo financimi i veprimtarisë së parashikuar në paragrafin e parë dhe të dytë të këtij neni, e shton dënimin edhe me një të tretën.

5. Organizimi, drejtimi apo financimi i veprimtarisë së parashikuar në paragrafin e tretë të këtij neni, e shton dënimin edhe me një të dytën.

6. Nëse organizimi, drejtimi dhe financimi i veprave penale të parashikuara në paragrafin e parë, të dytë dhe të tretë të këtij neni bëhet prej ose në favor të organizatave kriminale, dënohet me burgim nga dymbëdhjetë deri në tetëmbëdhjetë vjet.

7. Krijimi i kushteve apo lehtësirave për veprimtari të tilla nga persona me funksione shtetërore, dënohet me burgim nga gjashtë deri në dhjetë vjet.

8. Mbajtja e lëndës narkotike sipas paragrafit të dytë të këtij neni me qëllimin e përdorimit vetjak nuk është e dënueshme nëse sasia e lëndës së kapur nuk i kalon tre gram, dhe nuk ka për qëllim

asnjë nga parashikimet e shprehura në këtë dispozitë. Për qëllim të këtij paragrafi nuk ka rëndësi vendi ku është kapur autori që posedon lëndën narkotike, me kushtin që të jetë mbajtur larg demonstrimit në publik.

9. Personi, që kryen veprën e parashikuar nga paragrafi i dytë i këtij neni për herë të parë dhe që posedon më pak se katër gram të substancës narkotike apo psikotropike dënohet me burgim nga një deri në tre vjet. Gjykata mund ta përjashtojë autorin nga dënimi nëse ai tregon personin që e ka furnizuar me substancën narkotike ose, ai ka kontribuar vullnetarisht në mënyrë të konsiderueshme në zbulimin e furnizuesit.

### **Neni 378**

#### **Mbajtja, shitja dhe trafikimi i kokainës dhe prekursorëve të tyre**

1. Kushdo që, pa autorizim blen ose posedon me qëllim të shitjes apo shpërndarjes, ose ofron prodhimin, fabrikimin, përpunimin dhe përdorimin e kokainës, ose prodhon, fabrikon, nxjerr, përgatit, propozon, ofron për shitje, shpërndan, shet, dorëzon me çfarëdolloj kushti, ndërmjetëson, dërgon, dërgon në transit, transporton, importon apo eksporton substanca ose preparate që shërbejnë për prodhimin e kësaj lënde narkotike dhe, i çdo produkti tjetër shtesë që shërbejnë për këtë qëllim të klasifikuara me ligj të veçantë në kategorinë e lëndëve narkotike ose psikotrope, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.

2. Kushdo që, pa autorizim posedon, shpërndan, ofron për shitje ose shet, transporton, dorëzon, ndërmjetëson, dërgon brenda vendit, ose dërgon në transit kokainë të gatshme për përdorim, pavarësisht cilësisë në përbërjen e saj ose përzierjes, të klasifikuara me ligj të veçantë në kategorinë e lëndëve narkotike ose substancave psikotrope, dënohet me gjobë ose me burgim nga gjashtë deri në dymbëdhjetë vjet.

3. Importimi, eksportimi ose sigurimi në çfarëdo mënyre për qëllimet e këtij paragrafi, të kokainës si lëndë të gatshme për përdorim, pavarësisht cilësisë në përbërjen e saj ose përzierjes, të klasifikuar me ligj të veçantë në kategorinë e lëndëve narkotike ose substancave psikotrope, apo shitja, dërgimi, lëvizja apo transferimi i tyre, si dhe, i bimëve, substancave apo preparateve për përpunimin dhe përdorimin e tyre, prej nga dhe, përmes territorit të Shqipërisë te territori i një shteti tjetër apo anasjelltas, pa autorizimin ligjor të organit kompetent shtetëror lëshuar në përputhje me ligjin përkatës, dënohet me burgim nga dhjetë deri në gjashtëmbëdhjetë vjet.

4. Organizimi, drejtimi apo financimi i veprimtarisë së parashikuar në paragrafin e parë dhe të dytë të këtij neni, e shton dënimin edhe me një të tretën.

5. Organizimi, drejtimi apo financimi i veprimtarisë së parashikuar në paragrafin e tretë të këtij neni, e shton dënimin edhe me një të dytën.

6. Nëse organizimi, drejtimi dhe financimi i veprave penale të parashikuara në paragrafin e parë, të dytë dhe të tretë të këtij neni bëhet prej ose në favor të organizatave kriminale, dënohet me burgim nga trembëdhjetë deri në njëzet vjet.

7. Krijimi i kushteve apo lehtësirave për veprimtari të tilla nga persona me funksione shtetërore, dënohet me burgim nga shtatë deri në dhjetë vjet.

8. Mbajtja e lëndës narkotike sipas paragrafit të dytë të këtij neni me qëllimin e përdorimit vetjak nuk është e dënueshme nëse sasia e lëndës së kapur nuk i kalon tre gram, dhe nuk ka për qëllim asnjë nga parashikimet e shprehura në këtë dispozitë. Për qëllim të këtij paragrafi nuk ka rëndësi

vendi ku është kapur autori që posedon lëndën narkotike, me kushtin që të jetë mbajtur larg demonstrimit në publik.

### **Neni 379**

#### **Mbajtja, shitja dhe trafikimi i lëndëve të tjera narkotike, atyre industriale apo sintetike dhe prekursorëve të tyre**

1. Kushdo që, pa autorizim blen ose posedon me qëllim të shitjes apo shpërndarjes, ose ofron prodhimin, fabrikimin, përpunimin dhe përdorimin e lendeve narkotike me bazë industriale apo sintetike, ose prodhon, fabrikon, nxjerr, përgatit, propozon, ofron për shitje, shpërndan, shet, dorëzon me çfarëdolloj kushti, ndërmjetëson, dërgon, dërgon në transit, transporton, importon apo eksporton substanca ose preparate që shërbejnë për prodhimin e kesaj lënde narkotike dhe, i çdo produkti tjetër shtesë që shërbejnë për këtë qëllim të klasifikuara me ligj të veçantë në kategorinë e lëndëve narkotike ose psikotrope, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.
2. Kushdo që, pa autorizim posedon, shpërndan, ofron për shitje ose shet, transporton, dorëzon, ndërmjetëson, dërgon brenda vendit, ose dërgon në transit lëndë të tjera narkotike, si dhe ato me bazë industriale apo sintetike të gatshme për përdorim, pavarësisht cilësisë në përbërjen e tyre, të klasifikuara me ligj të veçantë në kategorinë e lëndëve narkotike ose substancave psikotrope, dënohet me gjobë ose me burgim nga shtatë deri në trembëdhjetë vjet.
3. Importimi, eksportimi ose sigurimi në çfarëdo mënyre për qëllimet e këtij paragrafi, të lëndëve të tjera narkotike, atyre me bazë industriale apo sintetike, si lëndë të gatshme për përdorim, pavarësisht cilësisë në përbërjen e tyre, të klasifikuar me ligj të veçantë në kategorinë e lëndëve narkotike ose substancave psikotrope, apo shitja, dërgimi, lëvizja apo transferimi i tyre, si dhe, i lëndëve të para, substancave apo preparateve për përpunimin dhe përdorimin e tyre, prej nga dhe, përmes territorit të Shqipërisë në territorin e një shteti tjetër apo anasjelltas, pa autorizimin ligjor të organit kompetent shtetëror lëshuar në përputhje me ligjin përkatës, dënohet me burgim nga dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet.
4. Organizimi, drejtimi apo financimi i veprimtarisë së parashikuar në paragrafin e parë dhe të dytë të këtij neni, e shton dënimin edhe me një të tretën.
5. Organizimi, drejtimi apo financimi i veprimtarisë së parashikuar në paragrafin e tretë të këtij neni, e shton dënimin edhe me një të dytën.
6. Nëse organizimi, drejtimi dhe financimi i veprave penale të parashikuara në paragrafin e parë, të dytë dhe të tretë të këtij neni bëhet prej ose në favor të organizatave kriminale, dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë deri në njëzet vjet.
7. Krijimi i kushteve apo lehtësirave për veprimtari të tilla nga persona me funksione shtetërore, dënohet me burgim nga shtatë deri në dhjetë vjet.
8. Mbajtja e lëndës tjetër narkotike, atyre me bazë industriale apo sintetike sipas paragrafit të parë të këtij neni me qëllimin e përdorimit vetjak nuk është e dënueshme nëse sasia e lëndës së kapur nuk i kalon tre gram, dhe nuk ka për qëllim asnjë nga parashikimet e shprehura në këtë dispozitë. Për efekt të këtij paragrafi nuk ka rëndësi vendi ku është kapur autori që posedon lëndën narkotik, me kushtin që të jetë mbajtur larg demonstrimit në publik.

### **Neni 380**

## **Ngritja e laboratorëve të posaçëm për prodhimin e lëndëve narkotike**

1. Ngritja e laboratorëve të posaçëm për prodhimin, përpunimin, përzierjen, ruajtjen, rafinimin e lëndëve të para me të cilat prodhohen lëndët narkotike, edhe ato me bazë industriale apo sintetike, të cituara në nenet më lart të këtij seksioni, dënohet me burgim nga pesë deri në tetë vjet.
2. Organizimi, drejtimi apo financimi i veprimtarisë së parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni, e shton dënimin edhe me një të dytën.

### **Neni 381**

#### **Rrethana të cilësuar**

Kryerja e ndonjëres prej veprave penale të parashikuara nga nenet 375, 376, 377, 378 dhe 379 të këtij Kodi në mjediset e shkollave, qendrave të ngjashme të edukimit të fëmijëve apo në një territor deri në treqind metra përreth tyre, e shton dënimin deri në një të dytën për veprën respektive të kryer.

### **Neni 382**

#### **Kultivimi i bimëve narkotike**

1. Kultivimi i cfaredo bime narkotike, kur ligji perkates e ka vleresuar si te tille, të cilat shërbejnë ose dihet se shërbejnë për prodhimin dhe nxjerrjen e lëndëve narkotike dhe psikotrope, kryer pa lejen dhe autorizimin ligjor të organit kompetent, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.
2. Organizmi, drejtimi apo financimi i kësaj veprimtarie, dënohen me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.
3. Me kultivim të bimëve narkotike do të kuptojmë mbjelljen e bimëve apo pemëve dhe kujdesin për rritjen e tyre derisa prodhimi nuk është korrur ende. Prodhimi i korrur apo i magazinuar do të klasifikohet sipas llojit respektiv të lëndës narkotike të parashikuar në këtë seksion.

### **Neni 383**

#### **Mbajtja, prodhimi dhe transportimi i pajisjeve**

Prodhimi, mbajtja, transportimi ose shpërndarja e pajisjeve apo materialeve që përdoren për prodhimin ose trafikimin e paligjshëm të lëndes narkotike a psikotrope, dënohet me burgim deri në tre vjet.

### **Neni 384**

#### **Përshtatja e mjediseve ose mjeteve për përdorim droge**

1. Përshtatja ose lejimi për përshtatjen e lokalit, banesës, mjeteve motorike dhe të çdo mjete tjetër publik ose privat për grumbullimin e personave me qëllim që ata të konsumojnë lende narkotike ose psikotrope, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.
2. Nëse vepra penale si më sipër kryhet në një lokal jo më larg se sa treqind metra nga një shkollë apo qendër tjetër e edukimit të të miturve, dënimi i mësipërm shtohet deri me një të dytën.

### **Neni 385**

#### **Krijimi i lehtësirave për marrjen dhe përdorimin e drogës**

Krijimi nga ana e personave, që për shkak të detyrës administrojnë lende narkotike ose psikotrope, i lehtësirave për marrjen dhe përdorimin e këtyre substancave, në kundërshtim me dispozitat ligjore përkatëse, dënohet nga tre deri në shtatë vjet.

### **Neni 386**

#### **Hedhja ose braktisja e shiringave**

1. Hedhja ose braktisja e shiringave ose instrumenteve të rrezikshme, të përdorura për marrjen e lende narkotike ose psikotrope, në vende publike ose të hapura për publikun, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit. Kur çmohet e arsyeshme, gjykata jep jo më pak se sa dy dënime plotësuese në vend të dënimit kryesor.
2. Nëse vepra penale si më sipër kryhet në afërsi jo më larg se sa treqind metra nga një shkollë apo qendër tjetër e edukimit të të miturve, dënohet me burgim nga një deri në katër vjet.

### **Neni 387**

#### **Nxitja për përdorimin e drogës**

1. Nxitja e të tjerëve për përdorimin e lëndëve narkotike dhe psikotrope, dënohet, në varësi të llojit të lëndës së klasifikuar në këtë seksion, me burgim deri në katër vjet.
2. Dhënia për përdorim të të tjerët, pa dijeninë apo pëlqimin e tyre, dënohet, në varësi të llojit të lëndës së klasifikuar në këtë seksion, me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.
3. Kur nxitja apo dhënia pa pëlqim bëhet ndaj të miturve, ose një personi që vuan nga një çrregullim i rëndë mendor, ose në një shkollë apo vend tjetër që siguron edukim për të miturit ose në të cilin ata ushtrojnë veprimtari sportive ose veprimtari sociale, ose në afërsinë e tij të menjëhershme, ose në një institucion penal, ose kur kjo vepër penale kryhet nga një zyrtar publik, punonjës shëndetësor, punëtor i mirëqenies, mësues, mbikëqyrës ose trajner i të miturit, përmes abuzimit të pozicionit të tyre, dënohet, pavarësisht nga lloji i lëndës narkotike të klasifikuar në këtë seksion, me burgim nga dhjetë deri në njëzetë vjet.

### **Neni 388**

#### **Përdorimi i paligjshëm i teknologjisë së lartë**

Prodhimi dhe përdorimi i sistemeve telematike, mjeteve dhe pajisjeve të teknologjisë së lartë, në rastet e veprave penale të parashikuara në nenet 375, 376, 377, 378, 379, 380, 382, 383, 384 dhe 387, të këtij Kodi, ose për të mundësuar, lehtësuar, mbështetur, justifikuar apo inkurajuar konsumimin e lëndëve narkotike dhe psikotrope ose, për të transmetuar a përhapur njoftime publicitare me të njëjtat qëllime për stimulimin e përdorimit të tyre, dënohet me burgim nga dy deri në gjashtë vjet.

## **Neni 389**

### **Rrethana te posacme**

1. Ne rastet kur cdo njera prej veprave penale te permendura ne kete kre do kete si objekt sasi te medha te lendes narkotike, denimi penal me burgim shtohet deri ne ½ e tij.
2. Vleresohet si sasi e madhe lende narkotike, atehere kur :
  - a. ka permbajtur jo me pak se sa 10 kg per cdo menyre kryerje te saj ne rastin e parshikimeve te nenit 376 te ketij Kodi ;
  - b. ka permbajtur jo me pak se sa 2 kg per cdo menyre kryerje te saj ne rastin e parashikimeve te nenit 377 te ketij Kodi ;
  - c. ka permbajtur jo me pak se sa 2 kg per cdo menyre kryerje te saj ne rastin e parashikimeve te nenit 378 te ketij Kodi ;
  - c. ka permbajtur jo me pak se sa 500 gr per cdo menyre kryerje te saj ne rastin e parashikimeve te nenit 379 te ketij Kodi ;
3. Ne rastin e parashikuar ne nenin 382 do vleresohet si sasi e madhe atehere kur prodhimi i pritshem i saj nuk arrin me pak se sa 50 kg.
4. Kur nga kryerja e seciles nga veprat penale te permendura ne kete seksion, do te rezultoje vdekja apo demtimi i rende i shendetit te nje personi per shkak te perdorimit te lendes narkotike, autori do te pergjigjet per te sipas dispozites perkatese qe parashikon pasojen e ardhur bazuar ne formen e fajit te shfaqur.

## **Neni 390**

### **Konkurrimi i veprave penale dhe bashkëpunimi**

1. Nëse mënyrat e kryerjes së veprave penale të parashikuara që kanë bërë të mundur kryerjen e ndonjëres prej tyre, përbëjnë vepra penale më vete, atëherë ato konkurrojnë me veprën penale të cilës i kanë shërbyer për të sjellë apo tentuar pasojën.
2. Nëse për kryerjen e ndonjëres prej veprave penale të parashikuara në këtë kre, autorit të posaçëm i është dashur të bashkëpunojë me një person tjetër, pavarësisht cilësive të posaçme të këtij të fundit, ata do të përgjigjen për kryerjen në bashkëpunim të veprës penale të parashikuar në këtë kre, apo çfarëdolloj vepre penale që konkurron me to.

## **Neni 391**

### **Kryerja e veprës nga personi juridik**

1. Kur veprat penale të përmendura në nenet e këtij seksioni, janë kryer edhe nga një person juridik, dhe mbështetur në nenin 123 të këtij Kodi dënohen:
  - a) me gjobë deri në pesëfishin e vlerës së parashikuar, ose mbarimin e personit juridik kur kanë kryer krimet e parashikuar në nenet 376, 377, 378, 379, 380, 382, 387, 388 dhe 385 të këtij Kodi;
  - b) me gjobë deri në katërfishin e vlerës së parashikuar, kur është kryer vepra penale e parashikuar në nenin 384 të këtij Kodi, dhe
  - c) me gjobë deri në dyfishin e vlerës së parashikuar kur është kryer vepra penale e parashikuar në nenin 383 të këtij Kodi.

## **Neni 392**

## **Dënimet plotësuese dhe masat penale**

1. Kur veprat penale të parashikuara në këtë seksion kryhen nga zyrtari publik, atëherë gjykata, krahas dënimit kryesor cakton edhe dënimin plotësues heqjen e së drejtës për të ushtruar një funksion publik.

2. Në çdo rast, gjykata vendos masën e zëvendësimit të dëmit të shkaktuar dhe, përveç sendeve që kanë shërbyer për kryerjen e veprave penale, kur ajo është kryer nga subjektet me qëllim përfitimi material apo të premtuar, vendoset konfiskimi i të ardhurave nga vepra penale apo të premtuara.

3. Në raste të veçanta, kur çmohet e dobishme për arritjen e qëllimit të plotë të dënimit penal, kur krimi i kryer është mbështetur, lehtësuar apo favorizuar edhe nga përdorimi i mjediseve, gjykata vendos edhe konfiskimin e tyre ku janë mbajtur, prodhuar apo tregtuar lëndët narkotike të përmendura në dispozitat e këtij kreu. Në këtë rast, gjykata vlerëson në mënyrë të arsyeshme rreth raportit ndërmjet vlerës dhe sasisë së sendeve objekt i veprës penale me vlerën e mjediseve ku ruhen ato si dhe faktit nëse këto mjedise përdoren zakonisht për këtë qëllim.

4. Në çdo rast, gjykata do të vendosë dënimin plotësues të ndjekjes së seancave për disintoksitim për të gjithë ata që janë përdorues të lëndëve narkotike, pavarësisht nëse përjashtohen apo jo nga dënimi kryesor penal.

5. Gjkata vendos edhe masën penale të regjistrimit dhe shkëmbimit të të dhënave që lidhen me lloje, vende, teknologji apo edhe persona që mundësojnë kryerjen e krimeve të rënda të përmendura në dispozitat e këtij seksioni me qëllim krijimin e rrethanave të përshtatshme për njohjen dhe parandalimin e kryerjes së tyre, me shtrirje apo natyrë edhe ndërkombëtare. Ajo urdhëron prokurorin të njoftojë organet përkatëse për marrjen e kësaj mase penale.

### **SEKSIONI III**

#### **VEPRAT PENALE KUNDËR RENDIT DHE SIGURISË PUBLIKE**

##### **Neni 393**

##### **Pjesëmarrja në veprime luftarake në një shtet të huaj**

1. Pjesëmarrja në formacione luftarake, organizata ushtarake ose paraushtarake në një konflikt të armatosur që zhvillohet në territorin e një shteti të huaj ose pjesëmarrja në çdo lloj trajnimi të zhvilluar nga këto struktura, pa qenë shtetas në shtetin e huaj, pa qenë pjesëtar i forcave të armatosura të njëjës prej palëve në konflikt ose misionëve ushtarake zyrtare të forcave të armatosura të një shteti që nuk është palë në konflikt ose misionëve ushtarake zyrtare të një organizate ndërkombëtare, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet.

2. Kur kjo veprë penale kryhet me qëllim përmbysjen e rendit kushtetues ose shkeljen e integritetit territorial të një shteti të huaj, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.

##### **Neni 394**

##### **Organizimi për pjesëmarrje në veprime luftarake në një shtet të huaj**

Nxitja, rekrutimi, organizimi, drejtimi, stërvitja, vënia në dispozicion e pajisjeve, krijimi ose përdorimi i fondeve ose mjeteve të tjera për financimin, mbështetjen materiale të personave, në çdo lloj forme dhe mënyre, për të kryer veprën penale të parashikuar nga neni 393 të këtij Kodi, dënohet me burgim nga gjashtë deri në dymbëdhjetë vjet.

### **Neni 395**

#### **Thirrja për pjesëmarrje në veprime luftarake të dhunshme në një shtet të huaj**

Thirrja në mënyrë publike me çdo lloj forme, mjete dhe mënyre për të kryer veprën penale të parashikuar nga neni 393 ose 394 të këtij Kodi, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

### **Neni 396**

#### **Themelimi i shoqatave diskriminuese**

1. Themelimi i grupeve ose çdo organizimi tjetër të panjohur ligjërisht, i grupeve paramilitare, me qëllim nxitjen e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të urrejtjes, armiqësisë, diskriminimit ose dhunës kundër personave, grupeve ose bashkimeve të njerëzve për shkak të përkatësisë së tyre etnike, racore, kombëtare, ideologjike, fetare ose besimit, origjinën e tyre kombëtare, seksin, moshën, orientimin ose identitetin seksual ose gjinor, arsyet gjinore, të përjashtimit shoqëror, gjendjes familjare, sëmundjes, paaftësisë ose varfërisë dënohet me burgim nga dy deri në gjashtë vjet.

2. Anëtarët aktivë, dënohen deri me një të tretën e dënimit më shumë.

3. Lehtësimi i themelimit, organizimit ose i kryerjes së veprimtarive të organizimeve të përmendura më lart, nëpërmjet ndihmave ekonomike ose çdo ndihme tjetër, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

### **Neni 397**

#### **Nxitja e urrejtjes ose dhunës**

1. Nxitja e urrejtjes, dhunës ose grindjeve të drejtuar kundër një grupi personash ose anëtari të këtij grupi, për shkak të racës, ngjyrës, etnisë, fesë ose orientimit seksual, si dhe përgatitja, përhapja ose ruajtja e shkrimeve me përmbajtje të tillë, me synim përhapjen e tyre, , kur rrezikojnë ose prishin rendin dhe paqen publike, ose kryhen nëpërmjet kërcënimeve, fyerjeve ose shpifjeve, kur nuk perbejne nje vepër me te rende dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

2. Kur vepra sipas paragrafit të parë kryhet duke shpërndarë në publik nëpërmjet teknologjive të informacionit dhe komunikimit, materiale që përmbajnë një nxitje të tillë, dënimi shtohet deri në një të tretën 1/3.

### **Neni 398**

#### **Thirrja për urrejtje kombëtare**

Vënia në rrezik e paqes publike duke bërë thirrje për urrejtje kundër pjesëve të popullsisë, duke fyer ose shpifur për to, duke kërkuar përdorimin e dhunës ose të veprimeve arbitrare kundër tyre, kur rrezikojnë ose prishin rendin dhe paqen publike, ose kryhen nëpërmjet kërcënimeve, fyerjeve ose shpifjeve, kur nuk perbejne nje vepër me te rende dënohet me burgim nga nje deri në pesë vjet.

### **Neni 399**

#### **Organizimi i grumbullimeve apo manifestimeve të paligjshme**

Organizimi i një grumbullimi apo manifestimi publik, që shkel kriteret e përcaktuara në ligj për zhvillimin e tij, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë.

### **Neni 400**

#### **Organizimi i grumbullimeve dhe manifestimeve me pjesëmarrje të personave të armatosur**

1. Organizimi i grumbullimeve dhe manifestimeve me pjesëmarrje të personave të armatosur dënohet me gjobë ose me burgim nga një deri në tre vjet.
2. Pjesëmarrja e personave të armatosur në grumbullime dhe manifestime të tilla përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.
3. Vepra penale sipas paragrafit të dytë të këtij neni konkurren me veprën penale të armëmbajtjes pa leje kur subjekti nuk zotëron lejen përkatëse për mbajtjen e armës.

### **Neni 401**

#### **Përhapja e informatave të rreme që ngjallin panik**

Përhapja e informatave apo njoftimeve të rreme, me fjalë, me shkrim apo me çdo mënyrë tjetër, me qëllim që të ngjallin një gjendje pasigurie dhe paniku te njerëzit, dënohet me gjobë ose me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

### **Neni 402**

#### **Njoftimi i rremë në organet e rendit**

Njoftimi i rremë i bërë në organet e rendit që synon t'i vërë ato në lëvizje të panevojshme, gjendje gatishmërie apo alarmi, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

### **Neni 403**

#### **Disinformimi i ekipeve të urgjencës**

Disinformimi me dashje i ekipeve të urgjencës që dëmton gatishmërinë e tyre, e bërë me çdo mjet lajmërimi e thirrjeje, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj.

### **Neni 404**

#### **Zhdukja dhe vjedhja e dokumenteve**

1. Zhdukja, dëmtimi plotësisht apo pjesërisht apo vjedhja e dokumenteve me rëndësi të veçantë historike kombëtare, kulturore, sociale, shkencore, juridiko-administrative, që janë klasifikuar si të tilla nga ligji përkatës, dënohet me burgim nga dy deri në tetë vjet.

2. Kur vepra penale sipas paragrafit më sipër kryhet nga personeli i ngarkuar për ruajtjen dhe administrimin e tyre, dënimi me burgim shtohet deri në një të dytën.

#### **Neni 405**

##### **Asgjësimi i dokumenteve**

1. Krijimi i zhurmave shqetësuese, si: muzika me zë të lartë përtej normës së lejuar në aktet dhe ligjet e posaçme, përdorimi jashtë rregullave i sinjaleve akustike, si dhe çdo lloj tjetër zhurme që vjen nga sjellje të papëlqyeshme apo nga kafshët, kur kryhen në rrugë, sheshe, qendra banimi, punë apo vende publike, që cenojnë dukshëm qetësinë e gëzimit të jetës dhe pronës apo mospërfillin haptazi rregullat e mjedisit urban dhe respektin për të, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë ose me burgim deri në tre muaj.

2. Kur kundërvajtja penale sipas paragrafit të parë, kryhet nga personat që mbajnë leje të organizojnë rastet që mund të prodhojnë zhurma, siguruar nëpërmjet zyrtarëve publikë, në tejkallim të kushteve të saj, dënimi penal shtohet me një të dytën e tij.

#### **Neni 406**

##### **Prishja e qetësisë publike**

1. Krijimi i zhurmave shqetësuese, si: muzika me zë të lartë përtej normës së lejuar në aktet dhe ligjet e posaçme, përdorimi jashtë rregullave i sinjaleve akustike, si dhe çdo lloj tjetër zhurme që vjen nga sjellje të papëlqyeshme apo nga kafshët, kur kryhen në rrugë, sheshe, qendra banimi, punë apo vende publike, që cenojnë dukshëm qetësinë e gëzimit të jetës dhe pronës apo mospërfillin haptazi rregullat e mjedisit urban dhe respektin për të, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë ose me burgim deri në tre muaj.

2. Kur kundërvajtja penale sipas paragrafit të parë, kryhet nga personat që mbajnë leje të organizojnë rastet që mund të prodhojnë zhurma, në tejkallim të kushteve të saj, siguruar nëpërmjet nëpunësve publikë, dënimi penal shtohet me një të dytën e tij.

#### **Neni 407**

##### **Përdorimi pa të drejtë i emblemës së Kryqit të Kuq ose Gjysmëhënës së Kuqe**

Përdorimi pa të drejtë i flamurit, shenjës apo emblemës së Kryqit të Kuq, Gjysmëhënës së Kuqe ose Luanit të Kuq e Diellit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë.

#### **Neni 408**

##### **Provokimi i kryerjes së një krimi**

1. Provokimi që synon të kryhet një krim, krijimit të një motivi për autorin ta kryejë atë nëpërmjet disinformimit apo gënjeshtërisë së çdo lloji, përmes nxitjes së drejtpërdrejtë, kontakteve të hapura ose të tërthorta, mjeteve të komunikimit masiv, shtypit apo përhapjes në valë komunikimi, ose çdo mjet të ngjashëm me to, kur provokuesi nuk ka dijeni për autorin e mundshëm të kryerjes së krimin të synuar, dënohet me gjobë ose me burgim deri në katër vjet.

2. Nëse krimi ndodh të kryhet, provokatori do të vlerësohet si nxitës në bashkëpunim. Në këtë rast krimet e kryera nuk konkurrojnë me njëra-tjetrën.

#### **Neni 409**

#### **Mbështetja e kryerjes së një krimi**

1. Mbështetja e autorit të krimit për veprën që ka kryer, duke lartësuar publikisht veprimin e tij, mbështetur nëpërmjet justifikimit të veprimit dhe paraqitur atë si të dobishëm, si zgjidhje e pranueshme e situatës, apo përdhosja, mospërfillja, anashkalimi i rendit juridik apo, të drejtave themelore të viktimës të prekura nga krimi i kryer, dënohet me burgim nga një deri në katër vjet.

2. Nëse mbështetja bëhet nëpërmjet mjeteve të komunikimit masiv të çfarëdo lloji, dënimi rritet deri në një të tretën e tij.

3. Nëse mbështetja sipas paragrafit të parë të këtij neni bëhet përgjatë kohës kur krimi është duke u kryer dhe, ajo ka ndikuar tek autori për vazhdimin drejt përfundimit të saj, mbështetësi është në rolin e bashkëpunëtorit përkrahës në kryerjen e krimit që ka mbështetur. Në këtë rast krimet e kryera nuk konkurrojnë me njëra-tjetrën.

#### **Neni 410**

#### **Goditja e sportistit, trajnerit, arbitrit, ndërmjetësit sportiv**

1. Goditja ose vepra të tjera dhune ndaj sportistit, trajnerit, arbitrit, ndërmjetësit sportiv apo çdo personi të lidhur me veprimtarinë sportive, kryer për shkak të saj, nga persona jashtë kësaj veprimtarie, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet.

2. Po kjo vepër, kur kryhet në mjedise sportive, apo është kryer nga drejtues apo anëtarë të klubeve sportive, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

3. Në çdo rast, gjykata jep dënimin plotësues të ndalimit të autorit për të marrë pjesë në veprimtari sportive për një periudhë deri në pesë vjet.

#### **Neni 411**

#### **Veprimet e dhunshme në veprimtaritë sportive**

1. Hyrja në fushën e lojës, gjatë kohës së zhvillimit të veprimtarisë sportive, nga persona të paautorizuar, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë deri në njëqind mijë lekë.

2. Kur nga kjo vepër ka ardhur pengimi i zhvillimit normal të veprimtarisë sportive, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre muaj.

3. Hedhja e sendeve të forta në fushën e lojës ose mbi masën e njerëzve, mbajtja apo përdorimi i lëndëve piroteknike, fishekzjarrëve, flakadanëve, gjatë zhvillimit të një veprimtarie sportive, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

4. Kur nga veprimet e përmendura në paragrafin e tretë është dëmtuar çdo person që merr pjesë në veprimtarinë sportive, dënimi me burgim shtohet deri në një të dytën e tij.

5. Në çdo rast, gjykata jep dënimin plotësues të ndalimit të autorit për të marrë pjesë në veprimtaritë sportive për një periudhë kohore deri në pesë vjet.

#### **Neni 412**

## **Kryerja e veprës nga personi juridik**

Kur veprat penale të përmendura në nenet 393, 394, 395, 397, 398, 400 dhe 401 të këtij seksioni janë kryer edhe nga një person juridik, dënohet me gjobë deri në pesëfishin e parashikuar në nenin 123 të këtij Kodi ose, me mbylljen e veprimtarisë.

### **Neni 413** **Dënimet plotësuese**

1. Nëse veprat penale të parashikuara në këtë kre kryhen nga zyrtari publik, atëherë gjykata, krahas dënimit kryesor cakton edhe dënimin plotësues, heqjen e së drejtës për të ushtruar një funksion publik, në zbatim të nenit 76 të këtij Kodi.

2. Në çdo rast, gjykata vendos masën e zëvendësimit të dëmit të shkaktuar dhe, përveç sendeve që kanë shërbyer për kryerjen e veprave penale, kur ajo është kryer nga subjektet me qëllim përfitimi material apo të premtuar, vendoset konfiskimi i të ardhurave nga vepra penale apo të premtuara.

3. Për veprat penale të lehta të parashikuara në nenet 399, 400, 401, 402, 403, 406, 407 dhe 410, paragrafi 1 të këtij Kodi, kur çmohet e arsyeshme, gjykata mund të vendosë dhënien e jo më pak se sa dy dënimeve plotësuese në vend të dënimit kryesor.

### **Neni 414** **Konkurrimi i veprave penale**

Nëse mënyrat e kryerjes së veprave penale të parashikuara që kanë bërë të mundur kryerjen e ndonjëres prej tyre, përbëjnë vepra penale më vete, atëherë ato konkurrojnë me veprën penale të cilës i kanë shërbyer për të sjellë apo tentuar pasojën.

## **SEKSIONI IV** **VEPRAT PENALE KUNDËR SIGURISË RRUGORE**

### **Neni 415** **Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor**

1. Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim nga pesë muaj deri në dy vjet vetëm në rastin e vërtetuar sipas paragrafit të dytë të këtij neni.

2. Gjkata do të japë dënim për veprën penale të parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni vetëm nëse shkelja e mësipërme shoqërohet edhe me pasoja në jetën apo dëmtimin e rëndë të shëndetit të paktën të një personi, apo për dëmtimin e lehtë të shëndetit të dy apo më shumë personave, përndryshe shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor trajtohet si shkelje administrative, përveç parashikimit ndryshe në nenin 416 të këtij seksioni. Në varësi nga numri i viktimave, shkalla e dëmtimit të tyre dhe forma apo lloji i fajit me të cilën është kryer vepra penale, personi do të përgjigjet për secilën prej tyre sipas dispozitave përkatëse që klasifikojnë veprën penale, në varësi të pasojës së ardhur. Në këto raste, gjykata cakton dënimin edhe për kundërvajtjen penale të parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni.

3. Me togfjalëshin “automjet apo mjete të motorizuara” të përmendura në dispozitat e këtij kreu do të vlejné përkufizimet përkatëse të përcaktuara në Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë.

### **Neni 416**

#### **Shkeljet e rënda të rregullave të qarkullimit rrugor**

1. Kryerja në shkelje të rëndë dhe në mospërfillje haptazi të rregullave të qarkullimit rrugor e njëjës prej veprimeve të mëposhtme:

a) Parakalimi i gabuar ose drejtimi në mënyrë të parregullt i automjetit gjatë parakalimit kur parakalimi i gabuar ka rrezikuar seriozisht kryerjen e një aksidenti rrugor;

b) Drejtimi i automjetit në mënyrë të parregullt në afërsi të vendkalimeve të këmbësorëve duke mos respektuar sinjalistikën rrugore ndaluese;

c) Drejtimi i automjetit me shpejtësi mbi atë të lejuarën në vende me fushëpamje të kufizuar, në kryqëzime rrugore, vendkalime ose vendkalime hekurudhore;

ç) Kthimi, lëvizja mbrapa ose në kundërshtim me drejtimin e trafikut të automjetit ose tentimi për të kryer këto veprime në një autostradë ose në një rrugë interurbane kryesore;

d) Mosmarrja e masave për të bërë të dallueshëm automjetet e ndalura ose të prishura në një distancë të mjaftueshme, kur kjo kërkohet për të garantuar sigurinë e qarkullimit rrugor dhe ka rrezikuar seriozisht kryerjen e një aksidenti rrugor;

dh) Dhënia në mënyrë a shpejtësi të tillë automjetit, duke mospërfillur rregullat bazë e thelbësore të qarkullimit, si kryerja e nje veprimi qe terheq vemendjen nga drejtimi i automjetit, apo mosrespektimi i shenjave te ndalimit te detyrueshem ne trafik, qe sfidojnë dhe vënë në rrezik jetën, shëndetin, integritetin trupor të një personi tjetër ose një pronë me vlerë të konsiderueshme;

e) Përdorimin e një automjeti me probleme teknike të tilla që ka krijuar apo përbën rrezik për jetën dhe sigurinë e njerëzve gjatë qarkullimit rrugor, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

2. Procedimi penal për çdonjërin nga llojet e shkeljeve të përcaktuara në paragrafin e parë të këtij neni, do të fillojë vetëm kur më parë ndaj autorit të shkeljes janë marrë masa të karakterit administrativ për çdo shkelje të qarkullimit rrugor që ai ka kryer më parë. Fillimi i procedimit penal për shkeljet e rënda të qarkullimit rrugor, ndërpret çdo procedurë administrative që ndërmerret nga autoriteti kompetent për trajtimin e tyre.

3. Nëse nga kryerja e çdonjëres prej shkeljeve të përmendura në paragrafin e parë të këtij neni, do të vijné pasoja në jetën e shëndetin e njerëzve apo dëmtime të pasurisë, kjo vepër konkurren me atë që parashikon pasojën e ardhur, sipas rregullave të shprehura në nenin 415, paragrafi 2 të këtij Kodi.

### **Neni 417**

#### **Largimi nga vendi i aksidentit**

1. Largimi nga vendi i aksidentit i drejtuesit të automjetit, drejtuesit të çdo mjeti të motorizuar ose jo, të përfshirë në një aksident që ka sjellë si pasojë dëmtim të shëndetit apo jetës së viktimës, përpara se:

a) të jetë përcaktuar identiteti i tij, mjeti në përdorim dhe lloji i përfshirjes së tyre në raport me palët e tjera të përfshira në aksident dhe të çdo personi që ka pësuar lëndime ose dëmtime;

b) të kenë pritur për një periudhë të përshtatshme kohore për të bërë përcaktimet më lart, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

2. Nuk do të vleresohet largim nga vendi i aksidentit vetëm rasti kur autori i veprës penale dërgon në spital viktimën, pasi më parë ka njoftuar organet e rendit publik për veprimin dhe, rikthehet përsëri në vendin e ngjarjes, për të verifikuar informacionet sipas paragrafit të parë të këtij neni.

### **Neni 418**

#### **Garat motorike të paligjshme**

1. Organizimi, zhvillimi i një gare motorike të paligjshme, marrja pjesë në një garë motorike të paligjshme me shpejtësi të papërshtatshme, në shkelje të rëndë e me mospërfillje të rregullave të qarkullimit rrugor, që synojnë të arrijnë shpejtësi maksimale të lëvizjes së mjetit, kur këto veprime kryhen brenda hapesires së qarkullimit rrugor, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

2. Nëse nga kryerja e shkeljes së përmendur në paragrafin e parë të këtij neni, do të vijë rrezik i hapur për njerëzit, ose kur vijnë pasoja në jetën e shëndetin e njerëzve apo dëmtime të pasurisë, kjo vepër konkurren me atë që parashikon pasojën e ardhur, sipas rregullave të shprehura në nenin 415, paragrafi 2 të këtij Kodi.

### **Neni 419**

#### **Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt**

1. Drejtimi i automjeteve apo mjeteve të tjera të motorizuara në gjendje të dehur, pas përdorimit të lëndëve narkotike apo nën efektin e barnave që sipas rekomandimit të mjekut ndikojnë në drejtimin e automjetit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim nga pesë ditë deri në një vit.

2. Drejtimi i automjeteve apo mjeteve të tjera të motorizuara nga persona të cilët nuk janë në gjendje për drejtimin e tyre në mënyrë të sigurt, për shkak të paaftësisë mendore ose fizike, kur kjo e fundit është e një natyre të tillë që personi nuk mund të pajiset me dëshmi aftësie për drejtimin e automjeteve, kur vepra kryhet në praninë dhe me pëlqimin e prindit, prindit birësues ose kujdestarit të tij, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

3. Drejtimi i automjeteve apo mjeteve të tjera të motorizuara nga të miturit nën moshën për t'u pajisur me leje drejtimi të automjeteve, kur vepra kryhet në praninë dhe me pëlqimin e prindit, prindit birësues ose kujdestarit të tij, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj.

4. Nëse nga kryerja e shkeljeve të përmendura në këtë nen, do të vijë rrezik i hapur për njerëzit, ose kur vijnë pasoja në jetën e shëndetin e njerëzve apo dëmtime të pasurisë, kjo vepër konkurren me atë që parashikon pasojën e ardhur, sipas rregullave të shprehura në nenin 415, paragrafi 2 dhe, do të përgjigjet për to, prindi i të miturit ose kujdestari i personit të paaftë, në rast se këtij të fundit i është caktuar një i tillë.

### **Neni 420**

#### **Drejtimi i mjetit pa dëshminë e aftësisë**

1. Drejtimi i automjeteve apo mjeteve të tjera të motorizuara pa dëshminë përkatëse të aftësisë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me burgim deri në gjashtë muaj.

2. Për qëllim të zbatimit të paragrafit të parë, me togfjalëshin “pa dëshminë përkatëse të aftësisë”, do të vlerësojmë rastet kur personi nuk e ka fituar ende dëshminë e aftësisë pas kursit të posaçëm, ose ka humbur të gjitha pikët e caktuara me ligj dhe, rrjedhimisht leja e drejtimit është e pavlefshme, ose kur i është pezulluar leja e drejtimit administrativisht, ose kur i është hequr leja e drejtimit përkohësisht ose përfundimisht me vendim gjyqësor ose, kur drejton një mjet jo më shumë se sa një muaj nga dita kur ka kaluar afati i lejes së drejtimit të mjetit.

#### **Neni 421**

#### **Refuzimi për të kryer testet**

Refuzimi nga drejtuesi i automjetit për t’iu nënshtruar testeve të përcaktuara me ligj për verifikimin e nivelit të alkoolit dhe pranisë së drogave toksike, narkotikëve dhe substancave psikotrope, pas kërkesës që i është bërë nga punonjësi i policisë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë.

#### **Neni 422**

#### **Moskryerja e detyrës nga autoriteti rrugor**

1. Moskryerja e detyrës nga autoriteti rrugor apo çdo person juridik që administron rrjetin rrugor, qoftë edhe përkohësisht, lejimi i qarkullimit të mjeteve në rrugë të pambaruara, me mungesa teknike që sjellin rrezik, mungesa thelbësore të sinjalistikës apo lejimi i kushteve të këqija të rrugëve që përbëjnë rrezik, vendosja e pengesave në rruge apo hyrje-daljeve në kundërshtim me Kodin Rrugor, apo kur nuk ka vepruar për të rikthyer sigurinë në rrugë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

2. Nëse nga kryerja e veprës së përmendur në paragrafin e parë, do të vijnë pasoja në jetën e shëndetin e njerëzve apo dëmtime të pasurisë, kjo vepër konkurren me atë që parashikon pasojën e ardhur, sipas rregullave të shprehura në nenin 415, paragrafi 2 të këtij Kodi.

#### **Neni 423**

#### **Përdorimi i paligjshëm i rrugëve urbane**

1. Qarkullimi në autostrada dhe në rrugë interurbane kryesore i karrocave, mjeteve me pedal, patinave, çiklomotorëve, motorëve me fuqi nën kufirin e lejuar nga dispozitat e Kodit Rrugor, kur është marrë më parë masa administrative, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në një muaj.

2. Qarkullimi i këmbësorëve në autostrada dhe në rrugë interurbane kryesore, me përjashtim të zonave të shërbimit dhe atyre të qëndrimit, kur është marrë më parë masa administrative, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë.

3. Kur nga vepra penale vijnë pasoja në jetën e shëndetin e njerëzve apo dëmtime të pasurisë, kjo vepër konkurren me atë që parashikon pasojën e ardhur, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 415, paragrafi 2 të këtij Kodi.

#### **Neni 424**

#### **Moskryerja e procedurave të kontrollit teknik të mjeteve**

Moskryerja e procedurave të kontrollit teknik të mjeteve motorike, apo kryerja e tyre në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, nga personi i cili ka për detyrë ta kryejë atë, kur kanë krijuar apo përbëjnë rrezik për jetën dhe sigurinë e njerëzve gjatë qarkullimit rrugor ose, kur kanë sjellë ndotjen tej normave të lejuara të ajrit, ujërave apo tokës, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

#### **Neni 425**

#### **Pengimi i qarkullimit të mjeteve të transportit**

1. Vënia e pengesave, ndalimi me çdo mjet e mënyrë i qarkullimit të mjeteve të transportit automobilistik, ose hedhja e lëndëve të rrëshqitshme ose të ndezshme në to, dënohet me gjobë ose me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

2. Kur mosrivendosja e sigurisë në rrugë, prej autorit që është njoftuar nga organet e rendit publik se duhet ta bëjë, ose ka krijuar rrezik të rëndë, ose prej personave që kanë detyrimin për të administruar mbarëvajtjen në transport, dënimi me burgim shtohet deri me një të dytën e tij.

3. Nëse nga kryerja e veprës të përmendur në paragrafin e parë, do të vijnë pasoja në jetën e shëndetin e njerëzve apo dëmtime të pasurisë, kjo veprë konkurron me atë që parashikon pasojën e ardhur, sipas rregullave të shprehura në nenin 415, paragrafi 2 të këtij Kodi.

#### **Neni 426**

#### **Kryerja e punimeve pa leje në rrugët publike**

1. Kryerja e punimeve për ndërtimin, modifikimin ose rehabilitimin e rrugëve publike, ose planifikimi për të ndërtuar një rrugë për të hyrë në autostradën publike pa lejen e ndërtimit të lëshuar sipas ligjit dhe akteve nënligjore, dënohet me gjobë ose burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

2. Instalimi i bordeve të ndërtimit apo reklamave në rrugë, pa leje ndërtimi të lëshuar në përputhje me ligjin ose shkelja e kushteve të përcaktuara në leje, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj.

#### **Neni 427**

#### **Kryerja e veprës nga personi juridik**

Kur veprat penale të përmendura në nenet 418, 422, 425, 426, të këtij seksioni janë kryer edhe nga një person juridik, dënohet me gjobë deri në pesëfishin e parashikuar në nenin 123 të këtij Kodi.

#### **Neni 428**

#### **Dënimet plotësuese**

1. Nëse veprat penale të parashikuara në këtë seksion kryhen nga zyrtari publik, gjykata krahas dënimit kryesor cakton edhe dënimin plotësues, heqjen e së drejtës për të punuar në shërbimin publik, ose çdo dënim tjetër plotësues që çmon të arsyeshëm, në përputhje me natyrën e veprës dhe veprimeve të kryera nga i dënuari, gjithmonë nëse dispozita konkrete nuk ka parashikuar ndryshe.

2. Në çdo rast, gjykata vendos masën e zëvendësimit të dëmit të shkaktuar dhe, përveç sendeve që kanë shërbyer për kryerjen e veprave penale, kur ajo është kryer nga subjektet me qëllim përfitimi material apo të premtuar, vendoset konfiskimi i të ardhurave nga vepra penale apo të premtuara.

3. Gjkata vendos edhe masën penale të regjistrimit dhe shkëmbimit të të dhënave që lidhen me shkeljet e kryera, dëmet e shkaktuara, ndalimet për të drejtuar mjete transporti të personave që i kanë kryer veprat penale të përmendura në dispozitat e këtij kreu me qëllim krijimin e rrethanave të përshtatshme për njohjen dhe parandalimin e kryerjes së tyre. Ajo urdhëron prokurorin të njoftojë organet përkatëse për marrjen e kësaj mase penale.

4. Për veprat penale të lehta të parashikuara në nenet 417, 418 paragrafi 1, 419, 420, 421, 422 dhe 424 të këtij Kodi kur çmohet e arsyeshme, gjykata mund të vendosë dhënien e jo më pak se sa dy dënimeve plotësuese në vend të dënimit kryesor.

#### **Neni 429**

#### **Konkurrimi i veprave penale dhe bashkëpunimi**

1. Nëse mënyrat e kryerjes së veprave penale të parashikuara që kanë bërë të mundur kryerjen e ndonjërës prej tyre, përbëjnë vepra penale më vete, atëherë ato konkurrojnë me veprën penale të cilës i kanë shërbyer për të sjellë apo tentuar pasojën.

2. Nëse për kryerjen e ndonjërës prej veprave penale të parashikuara në këtë kre, autorit të posaçëm i është dashur të bashkëpunojë me një person tjetër, pavarësisht cilësive të posaçme të këtij të fundit, ata do të përgjigjen për kryerjen në bashkëpunim të veprës penale të parashikuar në këtë kre, apo çfarëdolloj vepre penale që konkurron me to.

### **SEKSIONI VI**

#### **VEPRAT PENALE NË FUSHËN E QARKULLIMIT HEKURUDHOR, UJOR E AJROR**

#### **Neni 430**

#### **Përkufizime**

1. Për qëllime të këtij seksioni të ligjit penal, do të përbëjë pirateri çdo veprim i mëposhtëm:

- a) përdorimi i paligjshëm i forcës ose bllokimit ose çdo veprim i vjedhjes, i kryer për qëllime private nga ekuipazhi ose pasagjerët e një anije private ose hidroplani privat dhe i drejtuar:
  - i. në det të hapur, kundër një anijeje ose hidroplani tjetër ose kundër personave dhe pronës në bordin e anijeve dhe hidroplanëve të tillë;
  - ii. kundër një anijeje, hidroplani, personave ose pronës në një vend jashtë juridiksionit të çdo shteti.

b) pjesëmarrja e vullnetshme në një operacion të një anije ose një hidroplani me dijeninë të fakteve që e bëjnë atë anije pirate ose hidroplan pirat;

c) nxitja ose lehtësimi me dashje të veprimeve që përshkruhet në paragrafët më lart të këtij neni.

2. Veprimet e kryera nga një anije lufte, qeveritare ose hidroplan qeveritar, ekuipazhi i të cilës ka rebeluar dhe ka marrë anijen ose hidroplanin nën kontroll, vlerësohen si pirateri.

3. Një anije ose hidroplan vlerësohet si anije ose hidroplan pirat, në qoftë se mendohet që personat që e kanë nën kontroll ta përdorin për një nga veprimet e përmendura në paragrafët e mësipërm të këtij neni.

### **Neni 431**

#### **Pirateria**

1. Marrja e kontrollit të një mjete lundrimi në det të hapur, ose në një vend jashtë juridiksionit të çdo shteti, apo të një platforme të paluajtshme duke përdorur forcën, kanosjen ose çdo akt të dhunshëm, dënohet nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet burgim.

2. Nëse kryerja e veprës penale sipas paragrafit të parë është shoqëruar edhe me përdorimin e pajisjeve apo substancave që sjellin shkatërrimin ose dëmtimin e mjeteve, ose nëse një veprim i tillë vë në rrezik sigurinë e udhëtimit, dënohet nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet burgim.

3. Nëse autori ka për qëllim shkatërrimin apo dëmtimin e një anijeje tregtare në lundrim apo të ngarkesës së saj, ose të një platforme të paluajtshme, duke përdorur armë zjarri, nëpërmjet shpërthimit apo vënies së zjarrit, dënohet nga tetë deri në gjashtëmbëdhjetë vjet burgim.

4. Nëse si pasojë e veprës penale të parashikuar nga paragrafët e mësipërm të këtij neni, vdes një ose më shumë persona, ose anija shkatërrohet, mbytet apo shkaktohen dëmtime materiale të mëdha, personi do të mbajë përgjegjësi për secilën viktimë në përputhje me shkallën dhe llojin e fajit me të cilin është kryer vepra penale. Nëse, qoftë edhe njëra prej vrasjeve, është kryer me paramendim, personi dënohet me burgim të përjetshëm.

### **Neni 432**

#### **Sulmi ndaj avionëve dhe mjeteve të tjera të transportit**

1. Marrja e kontrollit të një avioni civil në fluturim, ose në një vend jashtë juridiksionit të çdo shteti, mjeteve të tjera të transportit, apo të një platforme të paluajtshme duke përdorur forcën, kanosjen ose çdo akt të dhunshëm, apo të një platforme të paluajtshme duke përdorur forcën ose me kërcënim, përveç rasteve kur krimi përbën akt terrorist sipas nenit 239 të këtij Kodi, dënohet nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet burgim.

2. Nëse kryerja e veprës penale sipas paragrafit të parë është shoqëruar edhe me përdorimin e pajisjeve apo substancave që sjellin shkatërrimin ose dëmtimin e mjeteve, ose nëse një veprim i tillë vë në rrezik sigurinë e fluturimit apo të udhëtimit, dënohet nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet burgim.

3. Nëse autori ka për qëllim shkatërrimin apo dëmtimin e një avioni civil në fluturim, apo të ngarkesës së tij, mjeteve të tjera të transportit, ose të një platforme të paluajtshme, duke përdorur armë zjarri, nëpërmjet shpërthimit apo vënies së zjarrit, dënohet nga tetë deri në gjashtëmbëdhjetë vjet burgim.

4. Kushdo që ka për qëllim pengimin e operacioneve aeroportuale apo vënien në rrezik të sigurisë e trafikut ajror apo të mjeteve të tjera të transportit, apo ushtron dhunë kundër personit të punësuar në një aeroport ndërkombëtar, ose dëmton seriozisht apo shkatërron pajisje të aeroportit dënohet nga dy deri në tetë vjet burgim.

5. Nëse si pasojë e veprës penale të parashikuar nga paragrafët e mësipërm të këtij neni, vdes një ose më shumë persona, ose avioni shkatërrohet, apo shkaktohen dëmtime materiale të mëdha, personi do të mbajë përgjegjësi për secilën viktimë në përputhje me shkallën dhe llojin e fajit me të cilin është kryer vepra penale. Nëse, qoftë edhe njëra prej vrasjeve, është kryer me paramendim, personi dënohet jo më pak se sa tridhjetë vjet ose, me burgim të përjetshëm.

6. Një avion vlerësohet se është në fluturim nga çasti i përfundimit të hipjes së të gjithë ekuipazhit dhe pasagjerëve dhe mbylljes së të gjitha dyerve të jashtme deri në çastin e hapjes së këtyre dyerve për të zbritur. Në rast të një ulje të detyrueshme, një fluturim quhet se zgjat deri në çastin kur autoritetet kompetente marrin nën përgjegjësi avionin, personat dhe sendet që ndodhen në të.

### **Neni 433**

#### **Rrezikimi i qarkullimit hekurudhor, uJOR ose ajror**

1. Shkelja e rregullave në lidhje me sigurinë e qarkullimit hekurudhor, uJOR ose ajror nga personi i cili:

a) ka në kontroll një segment ose mjet hekurudhor, një anije ose një avion, duke mos qenë në gjendje të kontrollojë mjetin në mënyrë të sigurt për shkak të konsumimit të pijeve alkoolike ose substancave të tjera intoksikuese, ose për shkak të një sëmundjeje mendore ose paaftësisë fizike, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.

b) duke qenë në kontroll të një mjete të tillë ose në cilësinë e personit përgjegjës për sigurinë e qarkullimit hekurudhor, uJOR ose ajror, dënohet me burgim nga katër deri në dhjetë vjet.

2. Shkelja e disiplinës së punës në transportin hekurudhor, uJOR ose ajror prej punonjësve të këtij transporti, kur krijon rrezik, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

3. Nëse nga vepra penale e parashikuar në paragrafin e parë dhe të dytë të këtij neni shkaktohen pasoja në jetën, shëndetin e personave, në varësi nga numri, shkalla e tyre dhe forma apo lloji i fajit me të cilin është kryer ajo, personi do të përgjigjet për secilën prej tyre sipas dispozitave penale përkatëse që klasifikojnë veprën penale në varësi të pasojës së ardhur dhe formës së fajit të shfaqur.

### **Neni 434**

#### **Ndërhyrjet e rrezikshme në qarkullimin hekurudhor, uJOR ose ajror**

1. Ndërhyrja në sigurinë e qarkullimit hekurudhor, uJOR ose ajror nëpërmjet:

a) shkatërrimit, dëmtimit ose heqjes së strukturave ndihmëse ose mjeteve të transportit;

b) ngritjes së pengesave;

c) dhënies së shenjave ose sinjaleve të rreme;

ç) kryerjes së çdo akti tjetër ndërhyrjeje me rrezikshmëri të njëjtë,

kur ka krijuar rrezik për jetën, shëndetin ose tërësinë trupore të një personi tjetër ose të pasurisë me vlerë të konsiderueshme, dënohet me burgim deri në katër vjet.

2. Nëse veprimet e mësipërme kryhen me qëllimin për të shkaktuar një aksident, apo kanë shkaktuar përplasje të mjeteve të transportit, ose për të lehtësuar apo fshehur një vepër penale tjetër ose kur nga vepra shkaktohet dëmtimi i rëndë i shëndetit të një ose disa personave, kur nuk përbën vepër penale më të rëndë, në varësi nga numri, shkalla e tyre dhe forma apo lloji i fajit me të cilin është kryer ajo, personi do të përgjigjet edhe për secilën prej tyre sipas dispozitave penale përkatëse që kualifikojnë veprën penale në varësi të pasojës së ardhur.

3. Po kjo vepër e bërë nga pakujdesia, dënohet me burgim nga katër deri në tetë vjet.

### **Neni 435**

#### **Vënia në rrezik e trafikut ajror, detar ose rrugor**

1. Kushdo që pengon të vendoset, shkatërron, dëmton, heq, apo në çdo mënyrë tjetër e bën të papërdorshme apo të padukshme shenjën apo mjetin që garanton sigurinë e rrugëve, shinave, detit, ujërave të brendshme, apo trafikun ajror, kryhen kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

2. Kushdo që pengon të vendoset, shkatërron, dëmton, heq, apo në çdo mënyrë tjetër e bën të papërdorshme apo të padukshme shenjën apo mjetin ose mekanizmin që garanton sigurinë e çfarëdolloj trafiku, apo ngre pengesa, jep informata të rreme, shenja apo sinjale, ose në çdo mënyrë tjetër vë në rrezik trafikun ajror, detar, rrugor dhe për pasojë vë në rrezik jetën apo sigurinë e njerëzve apo sendeve me një vlerë të konsiderueshme dënohet nga dy deri në pesë vjet burgim.

3. Nëse vepra penale e parashikuar në paragrafin e dytë të këtij neni, është kryer nga pakujdesia, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

4. Nëse nga veprat penale të parashikuara në paragrafin e parë, të dytë dhe të tretë të këtij neni shkaktohen pasoja në jetën, shëndetin e personave, në varësi nga numri, shkalla e tyre dhe forma apo lloji i fajit me të cilin është kryer ajo, personi do të përgjigjet për secilën prej tyre sipas dispozitave penale përkatëse që e klasifikojnë veprën penale në varësi të pasojës së ardhur.

5. Në rastet kur dëmtimet e viktimës klasifikohen të lehta, çështja penale fillon edhe kryesisht, por pushohet nëse viktima e kërkon atë.

### **Neni 436**

#### **Transmetimi i paautorizuar**

Transmetimi nga një anije ose nga instalimet në det i ndonjë programi radioteleviziv drejtuar publikut të gjerë, në kundërshtim me parashikimet e së drejtës ndërkombëtare, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

### **Neni 437**

#### **Abuzimi me sinjalet e telekomunikacionit ndërkombëtar**

Transmetimi i një sinjali nevoje ose rreziku të përcaktuar ndërkombëtarisht ose transmetimi i sinjaleve të sigurisë të përcaktuara ndërkombëtarisht kur këto nuk janë të përshtatshme ose keqpërdorimi i sinjalit telekomunikues të përcaktuar ndërkombëtarisht, pa qenë e nevojshme, dënohet me gjobë ose me burgim nga tre muaj deri në tre vjet.

### **Neni 438**

#### **Kryerja e veprës nga personi juridik**

Kur veprat penale të përmendura në këtë seksion janë kryer edhe nga një person juridik, ai dënohet:

- a) me gjobë deri në pesëfishin e parashikuar në nenin 123 të këtij Kodi ose;
- b) mbylljen e veprimtarisë së tij përgjithmonë ose për një kohë të përshtatshme që gjykata vlerëson të arsyeshme.

### **Neni 439**

#### **Konkurrimi i veprave penale**

Në të gjitha rastet kur, për të kryer një prej veprave penale të parashikuara në këtë kre, autorit i është dashur të kryejë veprime që përbëjnë veprë penale më vete, atëherë kjo e fundit konkurren me veprën që ai ka dashur të kryejë.

### **Neni 440**

#### **Dënimet plotësuese**

1. Kur veprat penale të parashikuara në këtë seksion kryhen nga zyrtari publik, atëherë gjykata, krahas dënimit kryesor cakton edhe dënimin plotësues, heqjen e së drejtës për të ushtruar një funksion publik.

2. Në çdo rast, gjykata vendos masën e zëvendësimit të dëmit të shkaktuar dhe, përveç sendeve që kanë shërbyer për kryerjen e veprave penale, kur ajo është kryer nga subjektet me qëllim përfitimi material apo të premtuar, vendoset konfiskimi i të ardhurave nga vepra penale apo të premtuara.

3. Gjkata vendos edhe masën penale të regjistrimit dhe shkëmbimit të të dhënave që lidhen me shkeljet e kryera, dëmet e shkaktuara, ndalimet për të drejtuar mjete transporti të personave që i kanë kryer veprat penale të përmendura në dispozitat e këtij kreu me qëllim krijimin e rrethanave të përshtatshme për njohjen dhe parandalimin e kryerjes së krimeve me natyrë ndërkombëtare. Ajo urdhëron prokurorin të njoftojë organet përkatëse për marrjen e kësaj mase penale.

4. Për veprat penale të lehta të parashikuara në nenet 435, paragrafi 1, 436 dhe 437 të këtij Kodi kur çmohet e arsyeshme, gjykata mund të vendosë dhënien e jo më pak se sa dy dënimeve plotësuese në vend të dënimit kryesor.

## **SEKSIONI VI**

### **VEPRAT PENALE QË CENOJNË SHËNDETIN PUBLIK**

### **Neni 441**

#### **Shkaktimi i epidemisë**

1. Shkaktimi i një epidemie nëpërmjet shpërndarjes së bakteve ose viruseve patogjenë, dënohet me burgim jo më pak se sa njëzetë e pesë vjet ose me burgim të përjetshëm.

2. Kur kjo veprë është kryer nga pakujdesia, dënohet me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.

### **Neni 442**

## **Përhapja e sëmundjeve infektive**

1. Përhapja me dashje e sëmundjes infektive me rrezikshmëri të lartë për shëndetin, nëpërmjet kryerjes së veprimeve ose mosveprimeve nga personi që është diagnostikuar si mbartës i sëmundjes apo nga personi që ka për qëllim përhapjen e saj, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

2. Po kjo vepër, kur ka shkaktuar pasoja të rënda për shëndetin ose rrezik për jetën e njerëzve, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet.

### **Neni 443**

#### **Përhapja e sëmundjeve seksualisht të transmetueshme**

1. Me përjashtim të rastit, kur përbën vepër penale më të rëndë, transmetimi një personi tjetër nëpërmjet marrëdhënieve seksuale ose çdo akti seksual të barasvlershëm i një sëmundjeje veneriane, duke e ditur autori se është i infektuar me këtë sëmundje, dënohet me burgim nga dy deri në gjashtë vjet.

2. Vepra penale ndiqet me ankim të viktimës, me përjashtim të rastit kur viktima është e mitur.

### **Neni 444**

#### **Mosraportimi i shenjave të sëmundjeve infektive apo pandemike**

Mosraportimi i sëmundjeve infektive apo pandemike prej zyrtarëve publikë të ngarkuar me administrimin apo trajtimin e sëmundjeve infektive apo pandemike, sipas detyrimeve që ligji u ka ngarkuar për të plotësuar, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë. Kur çmohet e arsyeshme, gjykata mund të vendosë dhënien e jo më pak se sa dy dënimeve plotësuese në vend të dënimit kryesor.

### **Neni 445**

#### **Mosrespektimi i rregullave për parandalimin e sëmundjeve**

1. Mosrespektimi i rregullave me të cilat organi kompetent shtetëror urdhëron ekzaminime, dezinfektime, karantinë ose masa të tjera për parandalimin ose ndalimin e përhapjes së një sëmundjeje ngjitëse që paraqet rrezik për jetën e shëndetin e njerëzve dhe kafshëve, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet. Kur çmohet e arsyeshme, gjykata mund të vendosë dhënien e jo më pak se sa dy dënimeve plotësuese në vend të dënimit kryesor.

2. I njëjti dënim do të jepet dhe për mosrespektimin e urdhërimeve apo udhëzimeve me të cilat organi shtetëror kompetent ka vendosur masa për ndalimin ose parandalimin e sëmundjeve ngjitëse të kafshëve që mund të transmetohen te njerëzit dhe për rrjedhojë paraqitet rreziku i transmetimit të sëmundjes ngjitëse te njerëzit.

3. Nëse veprat penale të përmendura në paragrafët më lart kryhen nga pakujdesia, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë ose me burgim deri në tre muaj. Kur çmohet e arsyeshme, gjykata mund të vendosë dhënien e jo më pak se sa dy dënimeve plotësuese në vend të dënimit kryesor.

## **Neni 446**

### **Moszbatimi i masave gjatë gjendjes së jashtëzakonshme**

1. Moszbatimi ose kryerja e veprimeve në kundërshtim me aktet ligjore apo nënligjore të nxjerra nga organet shtetërore, në funksion të gjendjes së epidemisë apo të zbatimit të masave të jashtëzakonshme, nga personi, ndaj të cilit është dhënë më parë masë administrative, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj. Kur çmohet e arsyeshme, gjykata mund të vendosë dhënien e jo më pak se sa dy dënimeve plotësuese në vend të dënimit kryesor.

2. Po kjo vepër, kur është kryer në ushtrim të aktivitetit tregtar, duke vendosur në rrezik shëndetin e njerëzve, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit. Kur çmohet e arsyeshme, gjykata mund të vendosë dhënien e jo më pak se sa dy dënimeve plotësuese në vend të dënimit kryesor.

3. Moszbatimi i urdhrave të dhënë nga organet kompetente për karantinim ose izolimin, apo shkelja e rregullave të karantinës ose të izolimit nga personi mbartës ose jo i sëmundjes infektive, të cilit i është njoftuar ky detyrim nga autoritetet shtetërore përkatëse, kur nuk përbën vepër tjetër penale më të rëndë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

## **Neni 447**

### **Prodhimi i lëndëve të rrezikshme për jetën**

1. Shkelja e rregullave të caktuara për mbajtjen, prodhimin, përdorimin, ruajtjen, transportimin dhe shitjen e lëndëve helmuese me efekt të fortë që krijojnë rrezik për jetën e shëndetin e njerëzve apo që mund të shkaktojnë katastrofa në njerëz, dënohet me gjobë ose me burgim nga një deri në katër vjet.

2. Prodhimi, përpunimi, dërgimi, transportimi, sigurimi, furnizimi, tregtimi i lëndëve helmuese me efekt të fortë që krijojnë rrezik për jetën e shëndetin e njerëzve apo që mund të shkaktojnë katastrofa në njerëz, pa qenë i pajisur me lejen apo autorizimin nga organet kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.

3. Kur shkeljet e rregullave të përcaktuara në ligj bëhen nga personi i autorizuar për t'i importuar, eksportuar ose tranzituar, gjatë kësaj veprimtarie, dënimi me burgim rritet me një të tretën e tij në raport me paragrafin e parë të këtij neni.

4. Kur nga vepra penale ka ndodhur vdekja apo dëmtimi i shëndetit të njerëzve, apo dëme të mjedisit, personi do të mbajë përgjegjësi për to, sipas dispozitave konkrete të parashikuara në këtë Kod, në varësi të formës së fajit me të cilën është kryer vepra penale sipas paragrafëve përkatës të këtij neni.

## **Neni 448**

### **Prodhimi i barnave të papërshtatshme**

Prodhimi, importimi, eksportimi, furnizimi, ndërmjetësimi, tregtimi, ofrimi ose hedhja në treg, ose ruajtja për një kohë nga këto qëllime, i barnave, përfshirë ato për përdorim njerëzor dhe veterinar, si dhe barnat eksperimentale, pa qenë i pajisur me lejen ose autorizimin e nevojshëm të përcaktuar me ligj, ose i produkteve mjekësore që nuk kanë dokumentet e konformitetit të përcaktuar me ligj,

ose që janë të dëmtuara, të skaduara ose që nuk përmbushin kërkesat teknike në lidhje me përbërjen, qëndrueshmërinë dhe efikasitetin e tyre, dhe në këtë mënyrë përbëjnë rrezik për jetën ose shëndetin e njerëzve, dënohet me burgim nga dy deri në gjashtë vjet.

#### **Neni 449**

#### **Paraqitja mashtruese e barnave**

1. Përpunimi ose prodhimi i:

a) një bari (medikamenti), përfshirë si ato për përdorim njerëzor, ashtu dhe veterinar, si dhe barna eksperimentale; ose një substancë aktive (princip aktiv) ose një substancë ndihmëse të produktit mjekësor në fjalë;

b) një produkti mjekësor, si dhe aksesorëve, elementeve ose materialeve që janë thelbësore për integritetin e tij;

duke paraqitur në mënyrë mashtruese: identitetin (origjinalitetin) e tij, duke përfshirë, sipas rastit, paketimin dhe etiketimin, datën e skadencës, emrin ose përbërjen e ndonjë prej përbërësve të tij, ose, sipas rastit, dozën e tij; origjinën e tij, duke përfshirë prodhuesin, vendin e prodhimit, vendin e origjinës dhe mbajtësin e lejes për hedhjen në treg ose të dokumenteve të konformitetit; të dhëna në lidhje me pajtueshmërinë me detyrimet ose kërkesat ligjore, licencat, lejet, dokumentet e konformitetit ose autorizimet; ose historikun e tij, duke përfshirë të dhënat dhe dokumentet në lidhje me kanalet e shpërndarjes së përdorur, me kusht që ato të jenë të destinuara për konsum publik ose përdorim nga palët e treta dhe të përbëjnë rrezik për jetën ose shëndetin e njerëzve, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

2. Ndryshimi, gjatë prodhimit ose përgatitjes ose në një kohë të mëvonshme, i sasisë, dozës, datës së skadencës ose përbërjes origjinale, siç është autorizuar ose deklaruar, së ndonjë prej barnave, substancave, substancave ndihmëse, produkteve mjekësore, pajisjeve, aksesorëve, elementëve ose materialeve të përmendura në paragrafin e mësipërm, në mënyrë të tillë që ul sigurinë, efikasitetin ose cilësinë e tyre, duke krijuar rrezik për jetën ose shëndetin e njerëzve, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet.

#### **Neni 450**

#### **Tregtimi i barnave të rrezikshme**

Importimi, eksportimi, reklamimi, ofrimi, ekspozimi, shitja, lehtësimi, hedhja në treg, dërgimi, paketimi, furnizimi, përfshi dhe ndërmjetësimin, transportimi, tranzitimi, shpërndarja ose nxjerrja në treg, e ndonjë prej barnave, substancave (principeve) aktive, substancave ndihmëse, produkteve mjekësore, aksesorëve, elementeve ose materialeve të përmendura në nenet 447 dhe 448, duke pasur dijeni për falsifikimin ose ndryshimin e tij dhe duke krijuar në këtë mënyrë rrezik për jetën ose shëndetin e njerëzve, dënohet me burgim nga katër deri në tetë vjet.

#### **Neni 451**

#### **Publiciteti i produkteve të dëmshme**

1. Shpërndarja e përmbajtjeve, përdorimi i të cilave mund të krijojë rrezik për shëndetin e njerëzve,

që synojnë posaçërisht të nxisin ose lehtësojnë konsumin e produkteve, preparateve, substancave ose përdorimin e teknikave të marrjes së tyre, ose eliminimit të produkteve ushqimore në favor të tyre, pa qartësuar subjektet që u ndalohej përdorimi i tyre, veçanërisht të miturit ose personat me aftësi të kufizuara që kanë nevojë për mbrojtje të veçantë, si dhe, shpjegimi i qartë i subjekteve që mund t'i përdorin ato pa rrezik, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

2. Përhapja publike nëpërmjet internetit, telefonit ose çdo teknologjie tjetër informacioni ose komunikimi i përmbajtjeve të tilla zëvendësuese ushqimore sipas paragrafit të parë të këtij neni dënohet me burgim nga një deri në katër vjet.

3. Gjykata mund të caktojë si dënim plotësues marrjen e masave të nevojshme për tërheqjen e materialeve me përmbajtjen e përmendur në paragrafin e parë të këtij neni, për ndërprerjen e shërbimeve që ofrojnë kryesisht materiale me përmbajtje të tilla ose bllokimin e tyre në rastin kur janë të vendosur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

### **Neni 452** **Rrethanat e cilësuar**

1. Përveç kur dispozitat e këtij seksioni parashikojnë posaçërisht, do të vlerësohen rrethanat të cilësuar në kryerjen e veprave penale më lart, atëherë kur ato kryhen:

a) nga një zyrtar publik, mjek, personel shëndetësor, mësues, edukator, trajner fizik ose sportiv gjatë ushtrimit të detyrës, profesionit ose zanatit;

b) kur barnat, substancat (principet) aktive, substancat ndihmëse, produktet mjekësore, aksesoret, elementet ose materialet e përmendura janë ofruar përmes mediave me përhapje të gjerë ose, u janë ofruar ose siguruar të miturve, personave me aftësi të kufizuara që kanë nevojë për mbrojtje të veçantë, ose personave veçanërisht vulnerabël në lidhje me produktin e ofruar;

c) nga një grup kriminal që kanë objektiv kryerjen e këtyre veprave penale;

ç) vepra është kryer në institucione të hapura për publikun nga menaxherët ose punonjësit e tyre.

2. Në këtë rast dënimi përkatës rritet deri në një të dytën e dënimit me burgim që parashikon vepra penale e kryer nga autori i saj.

### **Neni 453** **Kryerja e veprës nga personi juridik**

Kur veprat penale të përmendura në këtë seksion janë kryer edhe nga një person juridik, ai dënohet:

a) me mbylljen e veprimtarisë së tij përgjithmonë ose për një kohë të përshtatshme që gjykata vlerëson të arsyeshme kur kryhen veprat e përmendura në nenin 441, 447, 448, 449, 450, ose

b) me gjobë deri në pesëfishin e parashikuar në nenin 123 të këtij Kodi, për veprat e përmendura në nenin 446 nenin 451 të këtij Kodi.

### **Neni 454** **Konkurrimi i veprave penale**

Nëse mënyrat e kryerjes së veprave penale të parashikuara që kanë bërë të mundur kryerjen e ndonjëres prej tyre, përbëjnë vepra penale më vete, atëherë ato konkurrojnë me veprën penale të cilës i kanë shërbyer për të sjellë apo tentuar pasojën.

#### **Neni 455**

#### **Dënimet plotësuese**

1. Nëse veprat penale të parashikuara në dispozitat e këtij kreu kryhen nga nëpunësi publik, gjykata, krahas dënimit kryesor cakton edhe dënimin plotësues, heqjen e së drejtës për të punuar në shërbimin publik, ose çdo dënim tjetër plotësues që çmon të arsyeshëm, në përputhje me natyrën e veprës dhe veprimeve të kryera nga i dënuari, gjithmonë nëse dispozita konkrete nuk ka parashikuar ndryshe.

2. Në çdo rast, gjykata vendos masën e zëvendësimit të dëmit të shkaktuar dhe, përveç sendeve që kanë shërbyer për kryerjen e veprave penale, kur ajo është kryer nga subjektet me qëllim përfitimi material apo të premtuar, vendoset konfiskimi i të ardhurave nga vepra penale apo të premtuara.

3. Në raste të veçanta, kur çmohet e dobishme për arritjen e qëllimit të plotë të dënimit penal, gjykata, pas vlerësimit të arsyeshëm rreth raportit ndërmjet vlerës dhe sasisë së sendeve objekt i veprës penale me vlerën e mjediseve ku ruhen ato si dhe, faktit nëse këto mjedise përdoren zakonisht me këtë qëllim, vendos edhe konfiskimin e mjediseve ku mbahen sendet objekt i veprës penale të përmendura në dispozitat e këtij seksioni.

4. Gjykata vendos edhe masën penale të regjistrimit dhe shkëmbimit të të dhënave që lidhen me shkeljet e kryera, dëmet e shkaktuara, llojet e barnave, sëmundjeve të shkaktuara si dhe, personave që i kanë kryer veprat penale të përmendura në dispozitat e këtij seksioni me qëllim krijimin e rrethanave të përshtatshme për njohjen dhe parandalimin e kryerjes së tyre. Ajo urdhëron prokurorin të njoftojë organet përkatëse për marrjen e kësaj mase penale.

### **SEKSIONI VII**

### **VEPRAT PENALE NË FUSHËN E USHQIMIT**

#### **Neni 456**

#### **Përkufizime**

Për qëllim të këtij seksioni çdo dokument i rremë ose me përmbajtje të rremë në lidhje me ndonjë prej barnave, substancave aktive, substancave ndihmëse, pajisjeve mjekësore, aksesorëve, elementeve ose materialeve të përmendura, përfshi paketimin, etiketimin dhe mënyrën e përdorimit të tij, që shërbejnë për paraqitjen, tregtimin apo ruajtjen e tyre, do të vlerësohet si dokument zyrtar në kuptim të Kodit Penal dhe dënohet sipas dispozitave që parashikojnë falsifikimin e tij.

#### **Neni 457**

#### **Helmimi i ujit të pijshëm**

1. Helmimi ose shtimi i substancave infektive ose i substancave të tjera që mund të shkaktojnë dëmtime serioze në shëndetin e njerëzve, në ujin e pijshëm ose në produktet ushqimore të destinuara për përdorim publik ose konsum nga një komunitet njerëzish, kur nuk përbëjnë veprë penale më të rëndë, dënohen me burgim nga dy deri në shtatë vjet.

2. Kur nga vepra penale ka ndodhur vdekja apo dëmtimi i shëndetit të njerëzve dhe kafshëve, personi do të mbajë përgjegjësi për to, sipas dispozitave konkrete të parashikuara në këtë Kod, në varësi të formës së fajit me të cilin është kryer vepra penale sipas paragrafit të parë të këtij neni.

#### **Neni 458**

### **Prodhimi i ushqimeve dhe lëndëve të tjera ushqimore të rrezikshme për shëndetin**

1. Prodhimi, përpunimi, ruajtja, tregtimi, importimi, eksportimi i ushqimeve, pijeve dhe lëndëve të tjera ushqimore, përdorimi i kimikateve, materialeve dhe lëndëve shtesë në prodhimin e përpunimin e artikujve ushqimorë në kundërshtim me standardet ligjore të lejuara, ose përdorimi i tyre të kafshët dhe bimët që përdoren si ushqim, në kundërshtim me kërkesat ligjore, duke i bërë ushqimet të pasigurta për konsum, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet.

2. Kur nga vepra penale ka ndodhur vdekja apo dëmtimi i shëndetit të njerëzve dhe kafshëve, personi do të mbajë përgjegjësi për to, sipas dispozitave konkrete të parashikuara në këtë Kod, në varësi të formës së fajit me të cilin është kryer vepra penale sipas paragrafit të parë të këtij neni.

#### **Neni 459**

### **Ofrimi i ushqimit të pasigurtë**

1. Therja e kafshëve për shitje ose përdorimi i produkteve shtazore për konsum njerëzor, duke e ditur që atyre iu janë përdorur trajtime terapeutike me substancat e përmendura në nenin 457 të këtij Kodi, dënohet me gjobë ose me burgim deri në katër vjet.

2. Hedhja për konsum publik e mishit ose produkteve të kafshëve të destinuara për ushqim, pa respektuar periudhat e pritjes, të parashikuara në ligj, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

#### **Neni 460**

### **Mashtrimi me produktet ushqimore**

Importimi, prodhimi, ruajtja, falsifikimi, publiciteti, tregtimi apo vendosja në qarkullim me ndonjë mënyrë tjetër e ushqimeve, materialeve ose lëndëve shtesë në prodhimin e përpunimin e artikujve ushqimorë, në të cilët janë shënuar të dhëna të cilat nuk i korrespondojnë përmbajtjes, llojit, kategorizimit, prejardhjes, sasisë apo cilësisë së produktit apo produkte pa të dhënat e mësipërme, siç parashikohet në legjislacionin në fuqi, dënohet me burgim deri në tre vjet.

#### **Neni 461**

### **Paraqitja e rremë e produktit ushqimor**

Ofrimi në treg i produkteve ushqimore duke mos plotësuar ose ndryshuar kërkesat e përcaktuara në ligj për skadencën ose përbërjen, fshehja ose marrja e produkteve ushqimore që synohen të

bëhen të papërdorshme ose të dezinfektohen, me qëllim tregtimin e tyre, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj.

#### **Neni 462**

#### **Prishja e shenjave të organeve shtetërore në fushën e sigurisë ushqimore**

1. Heqja ose ndryshimi i shenjave bllokuese apo ushtrimi i aktivitetit pas bllokimit në kundërshtim me masat e përkohshme ose përfundimtare, të vendosura nga organet inspektuese të autoritetit kombëtar të ushqimit, me qëllim prodhimin ose tregtimin e ushqimeve të pasigurta dënohet me burgim deri në tre vjet.

2. Po kjo veprë, kur kryhet në bashkëpunim me punonjësin që ka vendosur ose ndjek zbatimin e masave, më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda për shëndetin e njeriut, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet.

#### **Neni 463**

#### **Kryerja e veprës nga personi juridik**

1. Kur veprat penale të përmendura në këtë seksion janë kryer edhe nga një person juridik, ai dënohet:

a) me gjobë deri në pesëfishin e parashikuar në nenin 123 të këtij Kodi, për të gjitha veprat penale të këtij seksioni; ose

b) ndalimin për të kryer në të ardhmen veprimtarinë nëpërmjet së cilës është kryer vepra deri në dhjetë vjet.

#### **Neni 464**

#### **Dënimet plotësuese**

1. Nëse veprat penale të parashikuara në dispozitat e këtij kreu kryhen nga zyrtari publik, atëherë gjykata, krahas dënimit kryesor cakton edhe dënimin plotësues, heqjen e së drejtës për të ushtruar një funksion publik.

2. Në çdo rast gjykata vendos masën e zëvendësimit të dëmit të shkaktuar dhe, përveç sendeve që kanë shërbyer për kryerjen e veprave penale, kur ajo është kryer nga subjektet me qëllim përfitimi material apo të premtuar, vendoset konfiskimi i të ardhurave nga vepra penale apo të premtuara.

3. Gjkata vendos edhe masën penale të regjistrimit dhe shkëmbimit të të dhënave që përmbajnë armët e çfarëdolloji të përmendura në dispozitat e këtij kreu me qëllim krijimin e rrethanave të përshtatshme për njohjen dhe parandalimin e kryerjes së krimeve me natyrë edhe ndërkombëtare.

4. Për veprat penale të lehta të parashikuara në nenet 459, paragrafi 2, 460, 461 dhe 462, paragrafi 1 të këtij Kodi, kur çmohet e arsyeshme, gjykata mund të vendosë dhënien e jo më pak se sa dy dënimeve plotësuese në vend të dënimit kryesor.

#### **Neni 465**

#### **Konkurrimi i veprave penale dhe bashkëpunimi**

1. Nëse mënyrat e kryerjes së veprave penale të parashikuara që kanë bërë të mundur kryerjen e ndonjërës prej tyre, përbëjnë vepra penale më vete, atëherë ato konkurrojnë me veprën penale të cilës i kanë shërbyer për të sjellë apo tentuar pasojën.

2. Nëse për kryerjen e ndonjërës prej veprave penale të parashikuara në këtë kre, autorit të posaçëm i është dashur të bashkëpunojë me një person tjetër, pavarësisht cilësive të posaçme të këtij të fundit, ata do të përgjigjen për kryerjen në bashkëpunim të veprës penale të parashikuar në këtë kre, apo çfarëdolloj vepre penale që konkurron me to.

## SEKSIONI VII VEPRAT PENALE KUNDËR KUFIJVE SHTETËRORE

### **Neni 466 Përkufizime**

1. Për qëllime të këtij kreu:

a) shprehja "kontrabandë e migrantëve" nënkupton çdo veprim me qëllim të realizimit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të një përfitimi financiar ose të një përfitimi tjetër pasuror nga hyrja e paligjshme në Republikën e Shqipërisë e një personi i cili nuk është shtetas i Republikës së Shqipërisë, ose i një shtetasi shqiptar apo shtetasi të huaj në shtetin në të cilin nuk është banor i përhershëm ose shtetas i atij shteti;

b) "Dokument i rremë udhëtimi ose identifikimi" nënkupton çfarëdo dokument udhëtimi ose identifikimi, i cili:

i. është falsifikuar ose ndryshuar në ndonjë mënyrë të caktuar nga cilido person, përveçse nga personi ose organi i autorizuar në bazë të ligjit për të prodhuar ose lëshuar dokument udhëtimi ose identifikimi;

ii. është lëshuar ose është siguruar në mënyrë të parregullt, nëpërmjet paraqitjes së të dhënave të falsifikuara, korrupsionit, kërcënimit ose të ndonjë mënyre tjetër të paligjshme; ose

iii. shfrytëzohet nga personi i cili nuk është mbajtësi i tij i vërtetë dhe i ligjshëm.

2. "Kalim i paligjshëm i kufirit" vlerësohet kalimi i kufirit shtetëror shqiptar pa iu përmbajtur kërkesave të domosdoshme për kalimin e ligjshëm të tij për në shtetin pritës ose anasjelltas.

### **Neni 467 Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror**

1. Kalimi i paligjshëm i kufijve shtetërorë shqiptarë përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet. Kur çmohet e arsyeshme, gjykata mund të vendosë dhënien e jo më pak se sa dy dënimeve plotësuese në vend të dënimit kryesor.

2. Çdo ndihmë e dhënë për kalimin e paligjshëm të kufirit, përveç rastit kur veprimet kryhen me qëllimin e dhënies së ndihmës humanitare ndaj personit që po kalon kufirin, dënohet me burgim nga një deri në katër vjet.

3. Kur vepra penale sipas paragrafit të parë, bëhet me qëllim fitimi apo mbështetet nga zyrtarë publikë, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.

4. Çdo pasojë e ardhur në jetën, shëndetin apo pasurinë e personave, që kalojnë kufirin në mënyrë të paligjshme, do të kualifikohet sipas dispozitave përkatëse të këtij Kodi, bazuar në dëmin e shkaktuar dhe formën konkrete të fajit të shfaqur për kryerjen e tyre.

#### **Neni 468**

#### **Organizimi i kalimit të paligjshëm të kufijve**

1. Kryerja e akteve të mëposhtme, qëllimisht dhe për të marrë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë një përfitim financiar ose material, nëpërmjet:

- a) kontrabandës së emigrantëve;
- b) krijimit të mundësive për kontrabandë të emigrantëve, duke paraqitur dokumente udhëtimi dhe identifikimi të falsifikuara ose duke gjetur, siguruar ose poseduar dokumente të tilla;
- c) krijimit të mundësisë për një person, i cili nuk është shtetas ose nuk ka qëndrim të përhershëm në shtetin e interesuar, pa plotësuar kërkesat e domosdoshme për të qëndruar ligjërisht në këtë shtet nëpërmjet mënyrave të përmendura në shkronjën “b” të këtij paragrafi ose nëpërmjet mjeteve të tjera ligjore, dënohet me burgim nga dy deri në shtatë vjet.

2. Çdo bashkëpunim, organizim, ose drejtim i personave të tjerë për të kryer veprat penale të parashikuara nga paragrafi i parë i këtij neni, rrit dënimin deri në një të tretën e tij.

3. Nëse nga kryerja e kësaj vepre penale rrezikohet ose ka të ngjarë të rrezikohet siguria e migrantëve, apo mundësohet shfrytëzimi i tyre, apo trajtimi jonjerëzor ose degradues, dënimi rritet deri në një të dytën e tij.

4. Çdo pasojë e ardhur në jetën, shëndetin apo pasurinë e emigrantit, do të kualifikohet sipas dispozitave përkatëse të këtij Kodi, bazuar në dëmin e shkaktuar dhe në formën konkrete të fajit të shfaqur për kryerjen e tyre.

5. Kur vepra përkatëse penale e parashikuar në paragrafët e këtij neni, kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik, dënimi me burgim shtohet me një të katërtën e dënimit të dhënë përkatësisht në to.

6. Kjo dispozitë nuk zbatohet ndaj emigrantëve, përveç rastit kur ata janë pjesë e organizimit të trafikut.

#### **Neni 469**

#### **Ndihma për kalimin e kufirit të Bashkimit Evropian**

1. Ndihma dhënë nga një shtetas shqiptar për një person që nuk është shtetas i një shteti anëtar të Bashkimit Evropian, që synon t’i sigurojë hyrjen ose kalimin tranzit në territorin e këtij shteti, në kundërshtim me legjislacionin e shtetit anëtar në lidhje me hyrjen dhe daljen e të huajve, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet.

2. Ndihma e dhënë, me qëllim fitimi, që synon sigurimin e qëndrimit jo shtetas i një shteti anëtar të Bashkimit Evropian, në territorin e një shteti anëtar të Bashkimit Evropian, në kundërshtim me legjislacionin e këtij shteti në lidhje me qëndrimin e të huajve, dënohet me burgim nga katër deri në dhjetë vjet.

3. Nuk ndëshkohet dhënia e ndihmës, kur veprimet kryhen me qëllim humanitar ndaj personit që kalon kufirin ose qëndron në territorin e një shteti.

#### **Neni 470**

#### **Shkelja e rregullave mbi fluturimet**

1. Shkelja e rregullave mbi fluturimet ndërkombëtare, si: hyrja ose dalja nga territori i Republikës së Shqipërisë pa leje fluturimi, mosrespektimi i vijave të fluturimit, i vendeve të zbritjes, i korridoreve ajrore apo lartësisë së caktuar të fluturimit, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

2. Nëse vepra penale është kryer nga personi juridik, dënohet me gjobë dhe me heqjen e të drejtës për ushtrimin e veprimtarisë, apo mbylljen e përkohshme të saj.

### **Neni 471** **Punësimi i paligjshëm**

1. Punësimi i paligjshëm i shtetasve të cilët janë viktimë të kontrabanduara, sipas neneve 469 dhe 470 të këtij Kodi:

- a) kur kryhet në mënyrë të përsëritur apo vazhduese;
  - b) duke punësuar në të njëjtën kohë një numër të konsiderueshëm të shtetasve me qëndrim të parregullt;
  - c) në kushte pune të tilla që përbëjnë shfrytëzim të veçantë;
  - ç) kur punëdhënësi është në dijeni se shtetasi i huaj i vendeve të treta me qëndrim të parregullt është viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore;
  - d) duke punësuar në mënyrë të paligjshme një të mitur,
- dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet. Kur çmohet e arsyeshme, gjykata mund të vendosë dhënien e jo më pak se sa dy dënimeve plotësuese në vend të dënimit kryesor.

2. Gjkata, përveç dënimit kryesor, cakton edhe dënimin plotësues të publikimit të vendimit gjyqësor.

3. Në rast se vepra penale kryhet nga personi juridik, gjykata cakton dënimin e mbylljes së veprimtarisë së tij për një kohë që çmohet e arsyeshme në varësi të rëndësisë së shkeljes dhe pasojave që ajo ka sjellë.

4. Kur punësimi i paligjshëm është ndihmuar edhe nga mosveprimi i inspektorëve shtetërorë, dënimi përkatës shtohet me një të dytën.

### **Neni 472** **Kryerja e veprës nga personi juridik**

1. Kur veprat penale të përmendura në këtë seksion janë kryer edhe nga një person juridik, dënohet:

- a) me gjobë deri në pesëfishin e parashikuar në nenin 123 të këtij Kodi, ose;
- b) mbylljen e veprimtarisë së tij përgjithmonë ose për një kohë të përshtatshme që gjykata vlerëson të arsyeshme.

### **Neni 473** **Dënimet plotësuese**

1. Kur veprat penale të parashikuara në këtë seksion kryhen nga zyrtari publik, atëherë gjykata, krahas dënimit kryesor që shtohet deri në ½ e tij, cakton edhe dënimin plotësues, heqjen e së drejtës për të ushtruar një funksion publik.

2. Në çdo rast, gjykata vendos masën e zëvendësimit të dëmit të shkaktuar dhe, përveç sendeve që kanë shërbyer për kryerjen e veprave penale, kur ajo është kryer nga subjektet me qëllim përfitimi material apo të premtuar, vendoset konfiskimi i të ardhurave nga vepra penale apo të premtuara.

3. Gjykata vendos edhe masën penale të regjistrimit dhe shkëmbimit të të dhënave që lidhen me shkeljet e kryera, territoret e origjinës apo tranzit, mjetet e përdorura si dhe personave që i kanë kryer veprat penale të përmendura në dispozitat e këtij kreu me qëllim edhe ndalimin e tyre për të hyrë në të ardhmen në territorin shqiptar apo, krijimin e rrethanave të përshtatshme për njohjen dhe parandalimin e kryerjes së tyre. Ajo urdhëron prokurorin të njoftojë organet përkatëse për marrjen e kësaj mase penale.

#### **Neni 474**

### **Konkurrimi i veprave dhe bashkëpunimi**

1. Në të gjitha rastet kur, për të kryer një prej veprave penale të parashikuara në këtë seksion, autorit i është dashur të kryejë veprime që përbëjnë vepër penale më vete, atëherë kjo e fundit konkurren me veprën që ai ka dashur të kryejë.

2. Nëse për kryerjen e ndonjëres prej veprave penale të parashikuara në këtë kre, autorit të posaçëm i është dashur të bashkëpunojë me një person tjetër, pavarësisht cilësive të posaçme të këtij të fundit, ata do të përgjigjen për kryerjen në bashkëpunim të veprës penale të parashikuar në këtë kre, apo çfarëdolloj vepre penale që konkurren me to.

## **KREU V FALSIFIKIMET**

### **SEKSIONI I FALSIFIKIMI I MONEDHAVE DHE LETRAVE ME VLERË**

#### **Neni 475 Përkufizime**

1. Për qëllim të këtij seksioni, monedha përfshin monedhat elektronike, metalike, si dhe kartëmonedhat që kanë kurs ligjor, si dhe ato që nuk janë emetuar apo nuk janë hedhur ende në qarkullim, por që janë destinuar për t'u hedhur në qarkullim si monedha me kurs ligjor. Me monedhën kombëtare barazohen monedhat kombëtare të vendeve të Bashkimit Evropian si dhe ato të shteteve të tjera të huaja.

2. Para elektronike është vlere monetare e regjistruar në mënyrë elektronike ose në mënyrë magnetike, e cila emetohet me pranimin e fondeve me qëllim kryerjen e transaksionit të pagesës dhe që përfaqëson një detyrim të emetuesit të parasë elektronike ndaj pranuesit të saj, i cili mund të jetë një person fizik ose juridik, i ndryshëm nga emetuesi i parasë elektronike.

3. Monedhë e falsifikuar vlerësohet edhe ajo monedhë, e cila, pavarësisht faktit se është prodhuar në vende dhe me materiale të ligjshme, është realizuar, me dijeni, në kundërshtim me kushtet e

emetimit të përcaktuara nga autoriteti kompetent ose është hedhur në qarkullim në mungesë të një urdhri emetimi.

4. Me qarkullim të monedhës apo letrës me vlerë kuptohet realizimi i shkëmbimit të saj me kundërvlerën në mall apo shërbim, si dhe çdo plotësim nëpërmjet saj i nevojave të qarkulluesit të monedhës.

5. Me shpërndarje kuptohet çdo lëvizje e monedhës apo letrës me vlerë të tretët, e cila nuk vlerësohet si qarkullim i tyre.

#### **Neni 476**

#### **Falsifikimi ose prodhimi i monedhave të falsifikuara**

1. Falsifikimi i monedhave kombëtare apo të huaja që kanë kurs ligjor dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet.

2. Hedhja në qarkullim e monedhave të falsifikuara dënohet me burgim nga pesë deri në dymbëdhjetë vjet.

3. Eksportimi ose importimi i monedhave të falsifikuara, shton dënimin e parashikuar në paragrafin e dytë deri në një të tretën e tij.

4. Transportimi, shpërndarja të tretët e monedhave duke e ditur që janë të falsifikuara, dënohet me burgim nga dy deri në shtatë vjet.

5. Të njëjtat vepra penale, të kryera nga personi i autorizuar ligjërisht për të prodhuar apo ruajtur monedhën, dënohen respektivisht me burgim deri në një të dytën më shumë.

#### **Neni 477**

#### **Falsifikimi i titujve apo letrave me vlerë**

1. Falsifikimi i titujve të borxheve, titujve të pjesëmarrjeve, obligacioneve, çeqeve, kambialeve, kartave të kredit apo debitit, çekut të udhëtarëve, aksioneve apo kuotave në shoqëritë tregtare, interesat, dividendët, letrat e tjera që ligji i njuh me vlerë monetare apo çdo mënyrë tjetër pagese jo me para në dorë, nëpërmjet çdolloj mënyre të kryerjes së veprës penale të parashikuar në paragrafët e nenit 475 të këtij Kodi, dënohet me burgim nga katër deri në dhjetë vjet.

2. Nëse vepra e mësipërme është kryer nga nëpunësi publik që lëshon një certifikatë të tillë, dënimi me burgim shtohet deri në një të dytën e tij.

#### **Neni 478**

#### **Mbajtja e monedhave të falsifikuara**

1. Personi që, në dijeni të plote për mbajtjen ose pranimin për të mbajtur monedha të falsifikuara me qëllim shpërndarjen e tyre të tretët ose hedhjes së tyre në qarkullim, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

2. Përdorimi ose shpërndarja e monedhave të falsifikuara nga personi që i ka marrë fillimisht me mirëbesim ato, pas konstatimit që janë të falsifikuara, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

3. Të njëjtat dënime zbatohen edhe nëse ndodh mbajtja ose pranimi për mbajtje i titujve të borxheve, titujve të pjesëmarrjeve, obligacioneve, çeqeve, kambialeve, kartave të kredit apo debitit, çekut të udhëtarëve, aksioneve apo kuotave në shoqëritë tregtare, interesat, dividendët, letrave të tjera që ligji i njuh me vlerë monetare apo çdo mënyrë tjetër pagese jo me para në dorë, që janë të falsifikuara.

4. Të njëjtat vepra penale, të kryera nga personi i autorizuar ligjërisht për të prodhuar apo ruajtur letrat me vlerë, dënohet respektivisht me burgim deri në një të dytën më shumë.

#### **Neni 479**

### **Prodhimi ose mbajtja e mjeteve për falsifikim**

1. Prodhimi, ose mbajtja pa leje e materialeve, mjeteve, programeve informatike ose çdo elementi tjetër të destinuar posaçërisht për prodhimin ose falsifikimin e monedhave apo letrave me vlerë, apo prodhimi i mjeteve për të realizuar çdo falsifikim, dënohet me burgim deri në tre vjet.

2. Nëse vepra e parashikuar në paragrafin e parë do të konsistojë në sigurimin, blerjen, tjetërsimin, mbajtjen apo prodhimin e filigranës, i hologramit ose elementeve përbërëse të tjera të monedhës që garantojnë mbrojtjen nga falsifikimi ose ndryshimi, dënimi me burgim shtohet deri në një të tretën e tij.

#### **Neni 480**

### **Sigurimi i kushteve për falsifikim**

Sigurimi i kushteve materiale apo i planeve dhe bashkëpunëtorëve të tjerë për të kryer çfarëdolloj falsifikimi të parashikuar në këtë seksion, dënohet me burgim deri në tre vjet.

## **SEKSIONI II FALSIFIKIMET**

#### **Neni 481**

### **Përkufizime**

1. Për qëllim të këtij seksioni, me dokument kuptohet çdo akt i nxjerrë nga organet publike, vendase apo të huaja që shërbejnë për çdo arsye në qarkullimin civil të Republikës së Shqipërisë, në formë të shkruar apo elektronike që përmban informacion, të dhëna ose fakte që shërbejnë për të evidentuar veprimtarinë e organit publik pavarësisht formës së tij, mënyrës e vendit ku ruhet, apo nëse u është drejtuar apo jo shtetasve për përdorim a njohje. Edhe regjistrat apo procesverbalet që pasqyrojnë mënyrën e nxjerrjes së aktit, përmbajtjen apo pasojën e sjellë, janë dokumente në kuptim të këtij seksioni.

2. Barazohen me dokumentin zyrtar të gjitha dokumentet private, vendase apo të huaja, të lëshuara nga administratat përkatëse, si: shkollore, tregtare, shëndetësore apo konsullore, të cilat janë hartuar për shkak të procedurave ligjore për t'u trajtuar në çfarëdo mënyre nga administrata publike, ose ato dokumente të cilat i janë drejtuar një zyre publike për t'u shqyrtuar nga kjo e fundit, pavarësisht formës së paraqitjes.

3. Për qëllim të këtij seksioni vlerësohen falsifikim jo vetëm ndryshimet mekanike të elementeve përbërëse të dokumentit apo ndryshimit të formës zyrtare të tij, por edhe kur, pavarësisht respektimit të elementeve formale të tij, të dhënat e përmbajtjes së tij janë të gënjeshtërt.

4. Me fjalën përdorim, të përmendur në këtë seksion, kuptojmë paraqitjen e dokumentit në çdo organ publik, vendas apo të huaj, entitet privat, vendas apo të huaj, përpara çdo personi që ushtron një funksion publik apo është thirrur edhe përkohësisht të kryejë një të tillë, apo kudo tjetër ku personi kërkon të mbështesë të drejtën e tij, pavarësisht faktit nëse paraqitja e dokumentit i është kërkuar apo është bërë me iniciativën e tij.

#### **Neni 482**

##### **Falsifikimi i dokumenteve**

1. Falsifikimi ose përdorimi i dokumenteve të falsifikuara dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet.

2. Kur falsifikimi bëhet nga personi që ka për detyrë të lëshojë dokumentin, dënimi me burgim shtohet deri në një të dytën e tij.

#### **Neni 483**

##### **Falsifikimi i vulave dhe i formularëve**

1. Falsifikimi ose përdorimi i vulave apo i formularëve të falsifikuar ose paraqitja e rrethanave të rreme në formular që u drejtohet organeve shtetërore, dënohet me burgim nga dy deri në katër vjet.

2. Kur falsifikimi bëhet nga personi që ka për detyrë hartimin e tyre, dënimi shtohet deri në një të dytën.

3. Për qëllim të termit formular, të përdorur në paragrafin një të këtij neni, do të vlerësohen edhe formularët e thjeshtë të bërë nga individë, pavarësisht formës së tyre, që i drejtohen institucioneve publike, në përmbushje të kriterëve të vendosura nga këto të fundit.

#### **Neni 484**

##### **Falsifikimi i stampave**

1. Falsifikimi ose përdorimi i stampave të falsifikuara ose paraqitja e rrethanave të rreme në këto të fundit, dënohet me burgim nga një deri në katër vjet.

2. Kur falsifikimi bëhet nga personi që ka për detyrë hartimin e tyre, dënimi shtohet deri në një të dytën.

3. Për qëllim të termit stampë, të përdorur në paragrafin e parë të këtij neni, do të vlerësohen pullat e emetuara nga Shteti Shqiptar, pullat e përdorura nga autoriteti tatimor, shenjat e vendosura nga autoritetet shtetërore që përdoren për të vërtetuar kryerjen e procedurës së detyrës së tyre sipas ligjit, përveçse kur Kodi Penal ka parashikuar dispozita më vete që rregullojnë shenjat e veçanta.

4. Vlerësohet si stampë edhe çdo shenjë që përdoret nga subjektet private në zbatim të detyrimeve të tyre që rrjedhin nga ligji që synojnë të paraqesin në publik standardin e prodhimeve të tyre, përveçse kur Kodi Penal ka parashikuar dispozita speciale që rregullojnë shenjat e veçanta.

#### **Neni 485**

## **Falsifikimi i të dhënave të mjeteve**

1. Ndërhyrja në mjetet e transportit ose mbajtja e një mjeti transporti të modifikuar ose rregulluar në numrat e prodhimit, numrat e targave, ndryshimin e tyre pa raportuar në institucionet që mbajnë regjistrat përkatës apo çdo ndërhyrje tjetër që synon të rrisë vlerën e makinës apo, të kryer për çdo qëllim tjetër të autorit, dënohet me gjobë ose me burgim nga një deri në katër vjet.

2. Në rastin kur autori është mbajtës i një leje, autorizimi, licence ose çdo lloj titulli tjetër që i mundëson kryerjen e veprimtarive të përmendura në paragrafin më sipër, dënimit kryesor i shtohet dhe dënimi plotësues i heqjes së të drejtës së ushtrimit të një veprimtarie ose mjeshtërie.

### **Neni 486**

#### **Sigurimi i kushteve për falsifikimin e dokumenteve**

Sigurimi i kushteve materiale, apo i planeve dhe bashkëpunëtorëve të tjerë për të kryer çfarëdo falsifikimi të parashikuar në këtë seksion, apo prodhimi i mjeteve për të realizuar çdo falsifikim të dokumenteve, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose burgim deri në dy vjet. Kur çmohet e arsyeshme, gjykata mund të vendosë dhënien e jo më pak se sa dy dënimeve plotësuese në vend të dënimit kryesor.

### **Neni 487**

#### **Qëllimi**

Kur veprat penale të parashikuara në këtë seksion kryhen me qëllim fitimi, apo për të sjellë çdo përfitim për autorin e saj, apo për të dëmtuar çdo person tjetër, apo për t'u përdorur në publik për çdo efekt, dënimi me burgim shtohet deri në një të dytën e tij.

### **Neni 488**

#### **Kryerja e veprës nga personi juridik**

Kur veprat penale të përmendura në nenet e këtij kreu, janë kryer edhe nga një person juridik, mbështetur në nenin 123, të këtij Kodi dënohen me gjobë deri në pesëfishin e vlerës së parashikuar ose mbarimin e personit juridik kur kanë kryer krimet e parashikuar në nenet 476, 477, 478, 482, 483, 484, 485 dhe 485 të këtij Kodi.

### **Neni 489**

#### **Dënimet plotësuese**

1. Nëse veprat penale të parashikuara në këtë kre kryhen nga zyrtari publik, atëherë gjykata, krahas dënimit kryesor cakton edhe dënimin plotësues, heqjen e së drejtës për të ushtruar një funksion publik, në zbatim të nenit 76 të këtij Kodi.

2. Në çdo rast, gjykata vendos masën e zëvendësimit të dëmit të shkaktuar dhe, përveç sendeve që kanë shërbyer për kryerjen e veprave penale, kur ajo është kryer nga subjektet me qëllim përfitimi material apo të premtuar, vendoset konfiskimi i të ardhurave nga vepra penale apo të premtuara.

3. Në raste të veçanta, kur çmohet e dobishme për arritjen e qëllimit të plotë të dënimit penal, gjykata, pas vlerësimit të arsyeshëm rreth raportit ndërmjet vlerës dhe sasisë së sendeve objekt i veprës penale me vlerën e mjediseve ku prodhohen ato si dhe, faktit nëse këto mjedise përdoren zakonisht për këtë qëllim, vendos edhe konfiskimin e mjediseve ku mbahen sendet objekt i veprës penale të përmendura në dispozitat e këtij kreu.

4. Gjukata, kur është rasti, vendos edhe masën penale të regjistrimit dhe shkëmbimit të të dhënave që lidhen me cilesite e mjeteve të sofistikuara të falsifikimeve të përmendura në dispozitat e këtij kreu me qëllim krijimin e rrethanave të përshtatshme për njohjen dhe parandalimin e kryerjes së krimeve me natyrë edhe ndërkombëtare.

### **Neni 490**

#### **Zbatimi i dispozitave, konkurrimi i veprave dhe bashkëpunimi**

1. Dispozitat përkatëse të këtij kreu do të zbatohen aq herë sa janë të falsifikuara dokumentet, monedhat, letrat me vlerë, dokumentet e dëmtuara apo të zhdukura.

2. Nëse mënyrat e kryerjes së veprave penale të parashikuara që kanë bërë të mundur kryerjen e ndonjëres prej tyre, përbëjnë vepra penale më vete, atëherë ato konkurrojnë me veprën penale të cilës i kanë shërbyer për të sjellë apo tentuar pasojën.

3. Nëse për kryerjen e ndonjëres prej veprave penale të parashikuara në këtë kre, autorit të posaçëm i është dashur të bashkëpunojë me një person tjetër, pavarësisht cilësive të posaçme të këtij të fundit, ata do të përgjigjen për kryerjen në bashkëpunim të veprës penale të parashikuar në këtë kre, apo çfarëdolloj vepra penale që konkurron me to.

### **KREU VI**

#### **VEPRAT PENALE TË KRYERA NGA BANDA E ARMATOSUR DHE ORGANIZATA KRIMINALE**

### **Neni 491**

#### **Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale**

1. Krijimi, organizimi, drejtimi ose financimi i organizatës kriminale dënohen me burgim nga tre deri në tetë vjet, vetëm nëse është formuar për të kryer një krim të rëndë.

2. Pjesëmarrja në një organizatë kriminale për të përmbushur qëllimin e saj, dënohet me burgim nga dy deri në gjashtë vjet.

3. Nëse pjesëtari i organizatës kriminale, që nuk ka marrë pjesë në kryerjen e një krimi të rëndë, heq dorë vullnetarisht nga anëtarësia dhe kontribuon në hetimet për zbulimin e veprimtarisë dhe anëtarëve të tjerë të grupit, mund të përjashtohet nga dënimi penal.

4. Nëse organizata kriminale është e armatosur dhe pjesëtarët e saj zotërojnë armë dhe lëndë shpërthyesë që kanë për qëllim përmbushjen e veprimtarisë së saj kriminale, edhe nëse ato mbahen të fshehura ose në vende të veçanta, dënimi me burgim shtohet me një të tretën, pavarësisht dënimit që do të marrin për armët e mbajtura pa leje.

5. Kur veprimtaritë ekonomike, të ndërmarra ose të kontrolluara nga pjesëtarë të organizatës kriminale, financohen tërësisht ose pjesërisht me produktet e krimit, masa e dënimit, sipas paragrafëve të sipërpërmendur në këtë nen, shtohet me një të tretën deri në një të dytën e tij, pavarësisht dënimit që do të marrin për veprën penale të pastrimit të parave.

6. Nëse organizata kriminale do të kryejë ndonjë krim të rëndë që, sipas pjesës së posaçme të këtij Kodi apo ligjeve penale, cilësohet si e kryer nga kjo formë bashkëpunimi, atëherë ata do të përgjigjen për krimin e veçantë që kanë kryer si dhe, respektivisht, sipas paragrafëve një dhe dy të këtij neni.

7. Nëse dispozita materiale e pjesës së posaçme të këtij Kodi apo të ligjit material të veçantë nuk është shprehur që krimi i rëndë kryhet cilësisht nga organizata kriminale, atëherë kjo e fundit do të dënohet sipas përcaktimeve në dispozitën penale përkatëse, paragrafëve një dhe dy të këtij neni si dhe, pas orientimeve të dhëna nga neni 59 i këtij Kodi, edhe me tre vite burgim shtesë për shkak të kryerjes së krimit nga organizata kriminale.

### **Neni 492**

#### **Kryerja e veprave penale nga banda e armatosur**

1. Krijimi, organizimi, drejtimi ose financimi i bandës së armatosur dënohen me burgim nga dy deri në tetë vjet, vetëm nëse është formuar për të kryer krime të rënda.

2. Pjesëmarrja në një bandë të armatosur për të përmbushur qëllimin e saj, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

3. Nëse pjesëtari i bandës së armatosur që nuk ka kryer krim të rëndë, heq dorë vullnetarisht nga anëtarësia dhe kontribuon në hetimet për zbulimin e veprimtarisë dhe anëtarëve të tjerë të grupit, mund të përjashtohet nga dënimi penal.

4. Nëse banda e armatosur, kryhen veprimtari ekonomike, që financohen tërësisht ose pjesërisht me produktet e krimit, masa e dënimit, sipas paragrafëve të sipërpërmendur në këtë nen, shtohet me një të tretën deri në një të dytën e tij, pavarësisht dënimit që do të marrin për veprën penale të pastrimit të parave.

5. Pavarësisht emërimit të kësaj forme bashkëpunimi, mbajtja e armëve prej anëtarëve të bandës së armatosur do të përbëjë krim më vete.

6. Nëse banda e armatosur do të kryejë ndonjë krim që, sipas pjesës së posaçme të këtij Kodi apo ligjeve penale materiale të veçanta, cilësohet si e kryer nga kjo formë bashkëpunimi, atëherë ata do të përgjigjen për veprën e veçantë që kanë kryer si dhe, respektivisht, sipas paragrafëve një dhe dy të këtij neni.

7. Nëse dispozita materiale e pjesës së posaçme të këtij Kodi apo të ligjit material të veçantë nuk është shprehur që krimi kryhet cilësisht nga banda e armatosur, atëherë kjo e fundit do të dënohet sipas përcaktimeve në dispozitën penale përkatëse, paragrafëve një dhe dy të këtij neni si dhe, pas orientimeve të dhëna nga neni 59 i këtij Kodi, edhe me dy vite burgim shtesë për shkak të kryerjes së krimit të rëndë nga banda e armatosur.

### **Neni 493**

#### **Kryerja e veprave penale nga grupi i strukturuar kriminal**

1. Krijimi, organizimi, drejtimi ose financimi i një grupi të strukturuar kriminal dënohen me burgim nga dy deri në pesë vjet, vetëm nëse është formuar për të kryer krime të rënda.

2. Pjesëmarrja në grupin e strukturuar kriminal për të përmbushur qëllimet e tij, dënohet me burgim nga dy deri në katër vjet.

3. Nëse pjesëtari i grupit të strukturuar kriminal që nuk ka kryer krim të rëndë, heq dorë vullnetarisht nga anëtarësia dhe kontribuon në hetimet për zbulimin e veprimtarisë dhe anëtarëve të tjerë të grupit, mund të përjashtohet nga dënimi penal.

4. Nëse grupi i strukturuar kriminal është i armatosur dhe pjesëtarët e tij zotërojnë armë dhe lëndë shpërthyesë, që kanë për qëllim përmbushjen e veprimtarisë së tij kriminale, edhe nëse ato mbahen të fshehura ose në vende të veçanta, dënimi me burgim shtohet me një të tretën, pavarësisht dënimit që do të marrin për armët e mbajtura pa leje.

5. Kur veprimtaritë ekonomike, të ndërmarra ose të kontrolluara nga pjesëtarë të grupit të strukturuar kriminal, financohen tërësisht ose pjesërisht me produktet e krimit, masa e dënimit, sipas paragrafëve të sipërpërmendur në këtë nen, shtohet me një të tretën deri në një të dytën e tij, pavarësisht dënimit që do të marrin për veprën penale të pastrimit të parave.

6. Nëse grupi i strukturuar kriminal do të kryejë ndonjë krim qe, sipas pjesës së posaçme të këtij Kodi apo ligjeve penale materiale të veçanta, cilësohet si e kryer nga kjo formë bashkëpunimi, atëherë ata do të përgjigjen për veprën e veçantë që kanë kryer si dhe, respektivisht, sipas paragrafit të parë apo të dytë të këtij neni.

7. Nëse dispozita materiale e pjesës së posaçme të këtij Kodi apo të ligjit material të veçantë nuk është shprehur që krimi kryhet cilësisht nga grupi i strukturuar kriminal, atëherë kjo e fundit do të dënohet sipas përcaktimeve në dispozitën penale përkatëse, të paragrafëve një dhe dy të këtij neni si dhe, pas orientimeve të dhëna nga neni 59 i këtij Kodi, edhe me tre vite burgim shtesë për shkak të kryerjes së krimit nga grupi i strukturuar.

#### **Neni 494**

#### **Kryerja e veprave penale nga organizata terroriste**

1. Krijimi, organizimi, drejtimi dhe financimi i organizatës apo grupeve terroriste dënohen me burgim nga katër deri në dhjetë vjet, vetëm nëse është formuar për të kryer krime të rënda.

2. Pjesëmarrja në një organizatë terroriste për të kontribuar në arritjen e qëllimeve të saj, dënohet me burgim nga dy deri në gjashtë vjet.

3. Nëse pjesëtari i organizatës terroriste, që nuk ka kryer krim të rëndë, heq dorë vullnetarisht nga anëtarësia dhe kontribuon në hetimet për zbulimin e veprimtarisë dhe anëtarëve të tjerë të grupit, mund të përjashtohet nga dënimi penal.

4. Nëse organizata terroriste është e armatosur dhe pjesëtarët e saj zotërojnë armë dhe lëndë shpërthyesë që kanë për qëllim përmbushjen e veprimtarisë së saj kriminale, edhe nëse ato mbahen të fshehura ose në vende të veçanta, dënimi me burgim shtohet me një të tretën, pavarësisht dënimit që do të marrin për armët e mbajtura pa leje.

5. Kur veprimtaritë ekonomike, të ndërmarra ose të kontrolluara nga pjesëtarë të organizatës terroriste, financohen tërësisht ose pjesërisht me produktet e krimit, masa e dënimit, sipas paragrafëve të sipërpërmendur në këtë nen, shtohet me një të tretën deri në një të dytën e tij, pavarësisht dënimit që do të marrin për veprën penale të pastrimit të parave.

6. Nëse organizata terroriste do të kryejë ndonjë krim, e cila, sipas pjesës së posaçme të këtij Kodi apo ligjeve penale materiale të veçanta, cilësohet si e kryer nga kjo formë bashkëpunimi, atëherë ata do të përgjigjen për krimin e veçantë që kanë kryer si dhe, respektivisht, sipas paragrafëve një dhe dy të këtij neni.

7. Nëse dispozita materiale e pjesës së posaçme të këtij Kodi apo të ligjit material të veçantë nuk është shprehur që krimi kryhet cilësisht nga organizata terroriste, atëherë kjo e fundit do të dënohet sipas përcaktimeve në dispozitën penale përkatëse, paragrafëve një dhe dy të këtij neni si dhe, pas orientimeve të dhëna nga neni 59 i këtij Kodi, edhe me tre vite burgim shtesë për shkak të kryerjes së krimit nga organizata terroriste

## TITULLI IV

### VEPRAT PENALE KUNDËR SISTEMIT TË DREJTËSISË

#### KREU I

### VEPRAT PENALE KUNDËR VEPRIMTARISË GJYQËSORE

#### **Neni 495**

#### **Pengimi i drejtësisë**

1. Kryerja e veprimeve që pengojnë zbulimin e së vërtetës si, ndryshimi i vendit të ngjarjes duke prishur, fshirë, ndryshuar, lëvizur apo asgjësuar gjurmët e faktit penal, apo edhe më pas duke krijuar a paraqitur te dhëna apo indicie të rreme që devijojnë qëllimisht pistat hetimore larg autorëve të mundshëm, duke ndryshuar, falsifikuar, prishur indicie, lëvizur sende, shkatërruar, marre, fshehur ose ndryshuar sende apo komunikime, shkatërruar, bërë të papërdorshem të dokumenteve publike a private, të transkriptuara apo origjinale ose, duke publikuar në të rremë pista fiktive të ngjarjeve apo autoreve të tyre, ose duke mos ofruar informacionin e kërkuar nga organet e ndjekjes penale ose gjykata, të cilat kanë sjellë vështirësimin apo pengimin e zbulimit të faktit penal dhe autorit të tij, dënohet nga një deri në pesë vjet burgim.

2. Kur vepra penale kryhet nga zyrtarët publikë në shpërdorim të funksioneve të tyre, dënohet me burgim dy deri në gjashtë vjet.

3. Nëse krimi kryhet nga profesionistë të drejtësisë në shpërdorim të funksioneve të tyre, dënimi shtohet deri në një të dytën dhe shoqërohet me dënimin plotësues të heqjes së të drejtës për të ushtruar funksione publike.

4. Vepra penale vlerësohet e kryer edhe nëse veprimet sipas paragrafit të parë të këtij neni pengojnë zbulimin e një krimi që është në kompetencën e Gjykatës Ndërkombëtare Penale për t'u shqyrtuar.

#### **Neni 496**

#### **Përkrahja e autorit të krimit**

1. Përkrahja e autorit, pas kryerjes së një krimi të kryer prej tij, nëpërmjet furnizimit me ushqime, me mjete të tjera për jetesë ose sigurimi i një banese, vendqëndrimi ose me çdo mënyrë tjetër me qëllim që t'i shpëtojë kërkimit, kapjes ose arrestimit, me kusht që të mos jetë në rolin e bashkëpunëtorit në kryerjen e veprës penale, dënohet me gjobë ose me burgim nga një deri në pesë vjet.

2. Po kjo vepër kur kryhet në lidhje me krimet kundër pavarësisë dhe tërësisë territoriale të shtetit, rendit kushtetues ose përbën akt terrorist, apo krimi është i dënueshëm mbi njëzetë vjet

burgim, apo krimet e kryera nga bashkëpunimi i posaçëm, dënohet me burgim nga dy deri në shtatë vjet.

3. Përfshihen nga përgjegjësia penale për kryerjen e kësaj veprë të paralindurit dhe të paslindurit, vëllezërit dhe motrat, bashkëshorti, bashkëjetuesi, adoptuesit dhe të adoptuarit.

#### **Neni 497**

#### **Fshehja ose asgjësimi i kufomës**

1. Fshehja ose asgjësimi i kufomës së një personi, viktimë e vrasjes apo e veprave të tjera të dhunshme, e bërë për çfarëdo qëllimi, dënohet me gjobë ose me burgim nga një deri në pesë vjet.

2. Po kjo veprë e kryer nga autori ose bashkëpunëtori i krimit, dënohet me burgim dy deri në gjashtë vjet.

#### **Neni 498**

#### **Moskallëzimi i krimit**

1. Moskallëzimi në organet gjyqësore, të ndjekjes penale ose administrative i një krimi, i cili mund të parandalohet ende ose, t'i kufizohen pasojat, apo autorët ka gjasa që të kryejnë krime të reja që mund të ndalohen, nga cilido që ka marrë dënim për këto rrethana, dënohet me gjobë ose me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

2. Kur krimi i përmendur në paragrafin e parë drejtohet kundër pavarësisë dhe tërësisë territoriale të shtetit, rendit kushtetues ose përbën akt terrorist, apo krimi mund të jetë i dënueshëm përmbi njëzetë vjet burgim, dënim i rritet deri në një të tretën e dënimit sipas paragrafit të parë të këtij neni.

3. Përfshihen nga detyrimi për kallëzim të paralindurit dhe të paslindurit, vëllezërit dhe motrat, bashkëshorti, adoptuesi dhe të adoptuarit, si edhe personat që janë të detyruar të ruajnë një sekret të njohur për shkak të detyrës apo profesionit për sa lidhet me lëndën që kanë në shqyrtim, me përjashtim të krimeve të kryera në dëm të të miturve. Ky rregull nuk zbatohet nëse krimi që nuk kallëzohet bën pjesë në llojet e parashikuara në paragrafin e dytë të këtij neni.

4. Përfshihen nga detyrimi për kallëzim nuk zbatohet për veprat penale të dhunës në familje ndaj të miturve dhe krimet seksuale ndaj tyre.

5. Moskallëzimi nga prindi, kujdestari, birësuesi, njerku apo njerka, të paralindurit, gjini e afërt me viktimën, nga personi që është në marrëdhënie familjare me viktimën e mitur, nga mësuesi, edukatori, udhëheqësi fetar, mjeku, infermieri, specialisti i kujdesit shëndetësor, apo çdo person tjetër të cilit i është besuar kujdesi i përkohshëm i të miturit ose që në ndonjë mënyrë tjetër ka autoritet ndaj tij, në organet e ndjekjes penale, në gjykatë, në organet e rendit publik, të pushtetit ose të administratës, i krimit të dhunës në familje ndaj të miturve apo i krimeve seksuale ndaj të miturve, kur këta të fundit janë nën kujdesin apo përgjegjësinë e subjekteve të mësipërme që vihen në dënim për këto krime të cilat janë duke u kryer apo që janë kryer, dënim i burgim i rritet deri në një të dytën e atij të parashikuar nga paragrafi i parë i këtij neni.

6. I njëjti dënim sipas paragrafit të pestë parashikohet dhe për cilindo që ka dënim për privimin, trajtimet e rënda, sulmet ose dhunën seksuale, të kryera në dëm të një personi i cili nuk është në gjendje të vetëmbrohet për shkak të moshës, sëmundjes, gjendjes së dobësisë, paftësisë fizike ose psikike ose, të shtatzënisë.

7. Moskallëzimi i krimit nga zyrtarët publikë në përmbushje të detyrimit të tyre sipas Kodit të Procedurës Penale, e shton dënimin deri në një të dytën e atij të parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni.

#### **Neni 499**

#### **Krijimi i provave për të sajuar zhdukjen e personit**

1. Krijimi i rrethanave të faktit apo provave për të simuluar zhdukjen apo vdekjen e një personi, me qëllim përfitimin material apo çdolloy përfitimi tjetër personal, apo me qëllim që të keqdrejtojnë organet publike në hetimet e tyre, dënohet me burgim deri në tre vjet.
2. Kur nga krijimi i zhdukjes apo vdekjes së rremë të personit fitohet pasuri apo çdo përfitim material tjetër, kjo veprë penale konkurren me mashtrimin.

#### **Neni 500**

#### **Keqdrejtimi i organeve proceduese për autorin e krimit**

1. Keqdrejtimi i organeve proceduese për autorin e vërtetë të kryerjes së një krimi nga personi që merr përsipër në mënyrë të gënjeshtërt kryerjen e tij apo me qëllim që të shtyjë në lëvizje organet publike në hetimet e tyre, dënohet me burgim deri në tre vjet.
2. Kur vepra penale sipas paragrafit të parë të këtij neni është bërë me qëllim përfitimi, dënimi shtohet deri në një të tretën e tij.

#### **Neni 501**

#### **Kanosja për të mos kallëzuar**

Kanosja, që i bëhet viktimës së veprës penale, që jashtë vullnetit të tij të lirë, të mos kallëzojë, të mos beje ankim, apo të tërheqë kallëzimin ose ankimin e bërë, dënohet me burgim nga një deri në katër vjet.

#### **Neni 502**

#### **Kallëzimi i rremë**

1. Kallëzimi për kryerjen e një krimi që dihet se nuk është kryer ose për kryerjen e një krimi nga një person që dihet se nuk e ka kryer atë, si edhe, krijimi i provave të rreme me qëllim që të fillojë hetimi penal ndaj një personi të pafajshëm, dënohet me gjobë ose me burgim nga një deri në pesë vjet.
2. Kur vepra penale kryhet nga zyrtari publik për raste që lidhen me rrethin e detyrave të tij, dënohet me burgim nga dy deri në gjashtë vjet.
3. Për qëllim të kësaj dispozite nuk do të ketë rëndësi forma me të cilën do të bëhet kallëzimi, anonim ose jo, apo vendi e institucioni që i drejtohet kallëzuesi, mjafton që hetimi të ketë filluar me iniciativën e kallëzuesit.

#### **Neni 503**

#### **Mosparaqitja për të deklaruar ose dëshmuar mbi provën**

1. M Mosparaqitja menjëherë për të dëshmuar para organeve të prokurorisë, gjykatës, organeve të rendit apo administratës, për provën e njohur që e bën të pafajshëm personin që akuzohet, është arrestuar ose është dënuar për një krim, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim nga gjashtë muaj deri në dy vjet.

2. Përrjashtohen nga detyrimi për kallëzim autori i veprës penale si dhe, personat që vijnë në dijeni të provës për shkak të detyrës apo profesionit për sa lidhet me lëndën që kanë në shqyrtim kur sekreti profesional apo ligji i detyron të mos kallëzojnë e dëshmojnë për të.

#### **Neni 504**

#### **Deklaratat e rreme përpara prokurorit**

1. Kushdo që, gjatë hetimeve apo procedimit penal, i pyetur nga një prokuror hesht apo refuzon që të japë informacionin e duhur lidhur me hetimin ose, jep të dhëna, me gojë ose me shkrim, që ai e di se janë, tërësisht ose pjesërisht të rreme apo, fsheh fakte ose prova, dënohet me gjobë ose me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

2. Dispozitat e këtij neni nuk janë të zbatueshme në rast se akti është kryer në çdo fazë të procedimit penal nga një person i dyshuar ose i pandehur për veprën penale, me kusht që të mos i atribuoj kryerjen e veprës një personi tjetër ose nga dikush, që duhej të ishte përjashtuar nga kërkesa për informacion apo për të dëshmuar, për çdo arsye të ligjshme, ose që nuk ishte paralajmëruar për të drejtën për të mos dëshmuar apo për t'iu përgjigjur pyetjeve.

3. Kur krimi i përmendur në paragrafin e parë kryhet në rastet kur shqyrtohen krime kundër pavarësisë dhe tërësisë territoriale të shtetit, rendit kushtetues ose përbën akt terrorist, të krimeve të kryera në dëm të të miturve, dhunës në familje, apo krimi mund të jetë i dënueshëm përmbi njëzetë vjet burgim, apo te kryera nga bashkëpunimi i posaçëm, dënimi rritet deri në një të dytën e dënimit sipas paragrafit të parë të këtij neni.

4. Vepra penale vlerësohet e kryer edhe nëse veprimet sipas paragrafit të parë të këtij neni bëhen përpara prokurorit të Gjykatës Ndërkombëtare Penale.

#### **Neni 505**

#### **Deklaratat e rreme përpara oficerit të policisë gjyqësore**

1. Kushdo që, gjatë hetimit, i pyetur nga një oficer i policisë gjyqësore hesht apo refuzon që të japë informacionin e duhur lidhur me hetimin, jep të dhëna, me gojë ose me shkrim, që ai e di se janë, tërësisht ose pjesërisht të rreme apo, fsheh fakte ose prova, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

2. Dispozitat e këtij neni nuk janë të zbatueshme në rast se akti është kryer në çdo fazë të procedimit penal nga një person i dyshuar ose i pandehur për veprën penale, me kusht që të mos i atribuoj kryerjen e veprës një personi tjetër ose nga dikush, që duhej të ishte përjashtuar nga kërkesa për informacion apo për të dëshmuar, për çdo arsye të ligjshme, ose që nuk ishte paralajmëruar për të drejtën për të mos dëshmuar apo për t'iu përgjigjur pyetjeve.

3. Kur krimi i përmendur në paragrafin e parë kryhet në rastet kur shqyrtohen krime kundër pavarësisë dhe tërësisë territoriale të shtetit, rendit kushtetues ose përbën akt terrorist, të krimeve të kryera në dëm të të miturve, dhunës në familje, apo krimi mund të jetë i dënueshëm përmbi njëzetë vjet burgim, apo te kryera nga bashkëpunimi i posaçëm, dënimi rritet deri në një të dytën e dënimit sipas paragrafit të parë të këtij neni.

**Neni 506**  
**Refuzimi për të dëshmuar përpara gjykatës**

1. Refuzimi apo heshtja për t'iu përgjigjur pyetjeve të gjykatës rreth dijenisë për kryerjen e një fakti penal apo autorit të tij, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim nga pesë ditë deri në një vit.

2. Kur refuzimi apo heshtja për të dëshmuar bëhet me qëllim fitimi apo çdo interes tjetër të dhënë apo të premtuar, dënohet me burgim nga një deri në katër vjet dhe konfiskim të çdo lloj pasurie që rrjedh ose fitohet drejtpërdrejt ose tërthorazi nga kryerja e veprës penale, apo dhe i shpërblimeve, të dhëna ose të premtuara, për kryerjen e veprës penale.

3. Për qëllim të kësaj dispozite, do të barazohet me refuzimin për të dëshmuar edhe mosparaqitja e qëllimshme që synon refuzimin për të dëshmuar.

4. Dispozitat e këtij neni nuk janë të zbatueshme në rast se refuzimi behet nga një person që duhej të ishte përjashtuar nga kërkesa për të dëshmuar, për çdo arsye të ligjshme, ose që nuk ishte paralajmëruar për të drejtën për të mos dëshmuar apo për t'iu përgjigjur pyetjeve.

**Neni 507**  
**Dëshmia e rreme**

1. Dëshmia e rreme e bërë përpara gjykatës, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet.

2. Kur dëshmia e rremë bëhet me qëllim fitimi apo çdo interes tjetër të dhënë apo të premtuar, dënohet me burgim dy deri në pesë vjet dhe konfiskim të çdo lloj pasurie që rrjedh ose fitohet drejtpërdrejt ose tërthorazi nga kryerja e veprës penale, apo dhe i shpërblimeve, të dhëna ose të premtuara, për kryerjen e veprës penale.

3. Kur krimi i përmendur në paragrafin e parë kryhet në rastet kur shqyrtohen krime kundër pavarësisë dhe tërësisë territoriale të shtetit, rendit kushtetues ose përbën akt terrorist, të krimeve të kryera në dëm të të miturve, dhunës në familje, apo krimi mund të jetë i dënueshëm përmbi njëzetë vjet burgim, apo kur është kryer nga bashkëpunimi i posaçëm, dënimi rritet deri në një të dytën e dënimit sipas paragrafit të parë të këtij neni.

4. Përjashtohen nga përgjegjësia penale personat nëse tërheqin vullnetarisht dëshminë e rreme përpara se sa gjyqtari të ketë kërkuar procedimin ndaj tij.

5. Vepra penale vlerësohet e kryer edhe nëse veprimet sipas paragrafit të parë të këtij neni kryhen përpara Gjykatës Ndërkombëtare Penale.

**Neni 508**  
**Kanosja e gjyqtarit**

1. Kanosja, kundërshtimi me dhunë, goditjet dhe vepra të tjera dhune që i bëhen gjyqtarit apo anëtarëve të trupit gjykues, prokurorit, avokatit, çdo arbitri të caktuar për një çështje, apo familjareve të tyre, gjatë ushtrimit të detyrës apo për shkak të saj, dënohen me gjobë ose me burgim dy deri në shtatë vjet.

2. Në konceptin dhunë të përdorur në paragrafin e parë të këtij neni do të përfshihet shkaktimi deri i dëmtimeve të lehta.

**Neni 509**  
**Fyerja e gjyqtarit**

1. Fyerja e gjyqtarit apo anëtarëve të trupit gjykues, prokurorit, avokatit ose anëtarit të arbitrazhit, gjatë ushtrimit të detyrës apo për shkak të saj, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim nga pesë ditë deri në tre muaj.
2. Ndjekja penale fillon me ankimin e viktimës dhe pushon me heqjen dorë prej saj.

**Neni 510**  
**Mosparaqitja e ekspertit apo përkthyesit**

Mosparaqitja e ekspertit apo përkthyesit, pa shkaqe të arsyeshme ose, refuzimi pa shkak prej tyre për të bërë betimin apo kryer detyrat e caktuara nga organi i ndjekjes penale ose gjykata, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim nga pesë ditë deri në gjashtë muaj si dhe, shoqërohet me dënimin plotësues të heqjes së të drejtës së ushtrimit të profesionit ose funksionit publik nëse zotërojnë të tilla.

**Neni 511**  
**Përkthimi i rremë**

1. Shtrembërimi i përmbajtjes së një dokumenti apo shkrimi, kontekstit të fjalëve nëpërmjet shtrembërimit të thelbit të tyre, të dhënë për përkthim nga organet e ndjekjes penale apo gjykata ose përkthimi i rremë përpara tyre, që synojnë të keqdrejtojnë organin procedues, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim nga tre muaj deri në dy vjet.
2. Kur përkthimi i rremë bëhet me qëllim fitimi apo çdo interes tjetër të dhënë apo të premtuar, dënohet me gjobë ose me burgim nga një deri në pesë vjet.
3. Dënimi kryesor shoqërohet me dënimin plotësues të heqjes së të drejtës së ushtrimit të profesionit dhe konfiskim të çdo lloj pasurie që rrjedh ose fitohet drejtpërdrejt ose tërthorazi nga kryerja e veprës penale, apo dhe i shpërblimeve, të dhëna ose të premtuara, për kryerjen e veprës penale.

**Neni 512**  
**Ekspertimi i rremë**

1. Dhënia e rezultateve të rreme në raportet e ekspertimit të bëra me shkrim apo me gojë përpara organeve të ndjekjes penale ose gjykatës, që synojnë të keqdrejtojnë organin procedues, dënohet me gjobë ose me burgim nga një deri në katër vjet.
2. Kur ekspertimi i rremë bëhet me qëllim fitimi apo çdo interes tjetër të dhënë apo të premtuar, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.
3. Dënimi kryesor shoqërohet me dënimin plotësues të heqjes së të drejtës së ushtrimit të profesionit dhe konfiskim të çdo lloj pasurie që rrjedh ose fitohet drejtpërdrejt ose tërthorazi nga kryerja e veprës penale, apo dhe i shpërblimeve, të dhëna ose të premtuara, për kryerjen e veprës penale.

**Neni 513**

## **Ndikimi me dhunë në mbarëvajtjen e procesit gjyqësor**

1. Ushtrimi i qëllimshëm, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet një ndërmjetësi, i forcës fizike, kërcënimeve ose frikësimit për të nxitur dëshmi të rremë ose për të ndërhyrë në dhënien e një dëshmie të pavërtetë apo paraqitjen e çfarëdo lloji prove të gënjeshtër në një proces gjyqësor, apo hetim paraprak, për të nxitur refuzimin e detyrave gjate procedimit, dënohet me burgim nga një deri në katër vjet.

2. Kur veprimet e përshkruara në paragrafin e parë të këtij neni kryhen në lidhje me procedimet penale për veprat penale të korrupsionit aktiv dhe pasiv, korrupsionit në sektorin privat, përvetësimi i paligjshëm, trafikimi i influencave, krimet kundër autoritetit të shtetit, pasurimi i paligjshëm, dënimi shtohet deri në një të tretën e tij.

3. Po kjo vepër e kryer për të penguar zhvillimin e rregullt të hetimeve paraprake apo gjykimit për vepra penale për të cilat parashikohet dënim me burgim mbi dhjetë vjet, dënohet me burgim tre deri në tetë vjet.

4. Nëse veprimet e përshkruara në paragrafin e parë të këtij neni kryhen nga një person që kryen një detyrë në sektorin e drejtësisë ose të zbatimit të ligjit, dënimi shtohet deri në një të dytën e tij, respektivisht lidhur me paragrafët dy apo tre të këtij neni dhe, shoqërohet me ndalimin e ushtrimit të funksioneve publike deri në plotësimin e afatit të rehabilitimit dhënë prej vendimit kryesor.

### **Neni 514**

#### **Publikimi i gjeneraliteteve të të miturit**

1. Publikimi me çdo mjet i gjeneraliteteve apo fotografive të të pandehurve, dëshmitarëve, të akuzuarve apo viktimave të mitur të veprës penale, ose publikimi qoftë dhe i pjesshëm i akteve procedurale josekrete deri pa përfunduar hetimet paraprake, ose riprodhimi me çdo mjet qoftë dhe i pjesshëm i akteve të shqyrtimit gjyqësor kur gjykimi zhvillohet me dyer të mbyllura, jashtë rasteve të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

2. Nëse kjo vepër kryhet nga personat juridikë dënohet me gjobë dhe me një nga dënimet sipas nenit 123 të këtij Kodi.

### **Neni 515**

#### **Zbulimi i akteve ose i të dhënave sekrete të procedimit penal**

1. Zbulimi i akteve sekrete ose i të dhënave, që përmbajnë aktet sekrete, nga prokurori ose oficeri i policisë gjyqësore, gjyqtari apo sekretari gjyqësor, avokati ose çdo subjekt që vjen në dijeni për to për shkak të detyrës gjyqësore, si dhe mosrespektimi i detyrimeve të përcaktuara në nenin 103 të Kodit të Procedurës Penale, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

2. Zbulimi i akteve sekrete ose i të dhënave, që përmbajnë aktet sekrete, nga cilido, që është paralajmëruar nga prokurori ose oficeri i policisë gjyqësore për moszbulimin e tyre, e shton dënimin e parashikuar në paragrafin e parë deri në një të tretën e tij. Nëse kjo vepër kryhet nga personat juridikë dënohet me gjobë ose me një nga dënimet e tjera parashikuar në nenin 123 të këtij Kodi.

3. Publikimi i akteve sipas paragrafit të parë të këtij neni, që sigurohen nga nëpunës apo burime zyrtare, që synojnë shfrytëzimin e tyre për interesa të çfarëdo lloji të publikuesit duke u sjellë dëm

interesave publike që lidhen me hetimin apo gjykimin e çështjeve, dënohet me gjobë ose me burgim deri në katër vjet. Nëse kjo veprë kryhet nga personat juridikë dënohet me gjobë ose me një nga dënimet sipas nenit 123 të këtij Kodi.

#### **Neni 516**

#### **Zbulimi i bashkëpunëtorit të drejtësisë**

1. Zbulimi i të dhënave sekrete apo konfidenciale, që kanë lidhje me identitetin, procesin e bashkëpunimit, të mbrojtjes ose për vendndodhjen e dëshmitarëve e të bashkëpunëtorëve të drejtësisë, të cilët përfitojnë mbrojtje të veçantë sipas ligjeve në fuqi, dënohet me burgim nga dy deri në gjashtë vjet.

2. Zbulimi që ka sjellë si pasojë vdekjen, plagosjen e rëndë ose ka rrezikuar seriozisht jetën apo shëndetin e dëshmitarëve ose të bashkëpunëtorëve të drejtësisë, të familjarëve të tyre apo të punonjësve të policisë, të ngarkuar me mbrojtjen e tyre dënohet sipas dispozitës penale të posaçme bazuar në llojin e pasojës së ardhur dhe, konkurren me paragrafin një të këtij neni.

3. Publikimi me çfarëdolloj forme i akteve të përmendura në paragrafin e parë të këtij neni, shton dënimin deri në një të tretën e tij. Nëse kjo veprë kryhet nga personat juridikë dënohet me gjobë ose me një nga dënimet sipas nenit 123 të këtij Kodi.

#### **Neni 517**

#### **Dhënia e informacioneve**

1. Dhënia e informacioneve të rëndësishme që lidhen me operacione arrestimesh, vendndodhje dokumentesh apo personash, ngjarje kriminale, rekorde kriminale, lëvizje personash, pavarësisht shkaqeve të dhënies së tij, përveçse kur ka shkaqe padënueshmërie, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

2. Nëse informacioni është dhënë në shërbim të personave të organizuar në bashkëpunim të veçantë, dënimi sipas paragrafit të parë rritet deri në një të dytën e tij.

3. Kur informacioni jepet nga zyrtari publik që mban informacionin apo bie në kontakt me të ngaqë ka dijeni për arsyet e kërkimit të tij, vepra konkurren me krimin që kryhet me ndihmën edhe të informacionit të dhënë autorëve të tyre.

4. Publikimi me çfarëdolloj forme i akteve të përmendura në paragrafin e parë të këtij neni, shton dënimin deri në një të tretën e tij. Nëse kjo veprë kryhet nga personat juridikë dënohet me gjobë ose me një nga dënimet sipas nenit 123 të këtij Kodi.

#### **Neni 518**

#### **Zhdukja ose humbja e fashikullit**

1. Humbja me çdo mënyrë e fashikullit të hetimit ose të gjyimit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë dhe me dënimin plotësues të ndalimit të ushtrimit të detyrës deri në dy vjet..

2. Zhdukja e fashikullit ose e dokumenteve, shkresave ose të dhënave të tjera që ndodhen në të me synim që të dëmtojë apo favorizojë shtetas të caktuar, apo dëmtojë interesat e shtetit, dënohet me gjobë ose me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet dhe me dënimin plotësues të ndalimit të ushtrimit të detyrës deri në katër vjet.

3. Fshehja e qëllimshme e akteve të shenuara në paragrafet më lart të këtij neni, kur kanë shkaktuar vonesa në kryerjen e procedimit, cenim të rendesishëm të të drejtave të personave të interesuar, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet dhe me dënimin plotësues të ndalimit të ushtrimit të detyrës deri në katër vjet.

### **Neni 519**

#### **Përdorimi i dhunës gjatë hetimeve**

Përdorimi i dhunës nga personi i ngarkuar për zhvillimin e hetimeve për ta detyruar shtetasin të bëjë deklaratë, të dëshmojë ose të pohojë fajësinë apo pafajësinë e tij a të një tjetri, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet dhe shoqërohet me dënimin plotësues të heqjes së të drejtës së ushtrimit të funksionit publik.

### **Neni 520**

#### **Arrestimi i paligjshëm**

1. Kryerja e një arrestimi nga zyrtari publik, haptazi të paligjshëm, me vetëdije të plotë për mungesën e shkakut material për arrestimin e personit apo, kur ai nuk ka asnjë lidhje me veprën penale që ka ndodhur, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

2. Procedimi penal për veprën e kryer sipas paragrafit të parë të këtij neni, do të fillojë kur organi kompetent procedues ka deklaruar arrestin e paligjshëm sipas të metave të shënuara në paragrafin e parë.

### **Neni 521**

#### **Ngritja e paligjshme e akuzës penale**

1. Prokurori që, me vetëdije të plotë për pathemelësinë në ligj të vendimit të tij, ngre akuzë penale për një person në keqbesim ndaj ushtrimit të funksionit mbështetës të dhënies së drejtësisë, kur nga hetimi i paanshëm rezulton qartazi që akuza është e pabazuar, dënohet me gjobë ose me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet.

2. Kur ngritja e akuzës në keqbesim, sipas paragrafit të parë të këtij neni, lidhet me krime të rënda apo, kur viktimë ka vajtuar më shumë se sa një vit paraburgim, dënimi shtohet deri në një të dytën ndërsa ndalimi për ushtrimin e funksionit publik shtrihet deri në afatet e plotësimit të kohës së rehabilitimit prej dënimit kryesor.

### **Neni 522**

#### **Dhënia e një vendimi në keqbesim**

1. Gjyqtari që me vetëdije të plotë për pathemelësinë në ligj të vendimit të tij e jep atë në keqbesim ndaj ushtrimit të funksionit të dhënies së drejtësisë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në katër vjet dhe me ndalim të ushtrimit të funksionit publik.

2. Kur vendimi i dhënë në keqbesim sipas paragrafit të parë të këtij neni lidhet me krime të rënda apo, kur viktimë ka vuajtur dy apo më shumë vjet burgim si pasojë e vendimit gjyqësor,

dënimi shtohet deri në një të dytën, ndërsa ndalimi për ushtrimin e funksionit publik shtrihet deri në afatet e plotësimit të kohës së rehabilitimit prej dënimit kryesor.

3. Për qëllim të kësaj dispozite me vendim gjyqësor do të kuptohen të gjitha llojet e vendimeve që ligjet procedurale të Korpusit Ligjor të Republikës së Shqipërisë kanë parashikuar në përmbajtjen e tyre, të cilat janë deklaruar haptazi të pathemelta në ligj nga një vendim përfundimtar i një gjykate më të lartë kompetente.

#### **Neni 523**

#### **Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe oficerit të policisë gjyqësore**

Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt, tërthorazi ose nëpërmjet çdo ndërmjetësi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, për vete ose për persona të tjerë, gjyqtarit, prokurorit, oficerit të policisë gjyqësore, anëtarit të organeve të qeverisjes së gjyqësorit apo prokurorisë ose, nëpunësit civil të organeve të drejtësisë, për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohen me burgim nga dy deri në shtatë vjet dhe konfiskim të çdo lloj pasurie që rrjedh ose fitohet drejtpërdrejt ose tërthorazi nga kryerja e veprës penale, apo dhe i shpërblimeve, të dhëna ose të premtuara, për kryerjen e veprës penale.

#### **Neni 524**

#### **Korrupsioni aktiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare**

Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt, tërthorazi ose nëpërmjet çdo ndërmjetësi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, për vete ose për persona të tjerë, gjyqtarit ose zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare, për të kryer apo për të mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohen me burgim nga dy deri në shtatë vjet dhe shoqërohet me dënimin plotësues të heqjes së të drejtës së ushtrimit të funksionit publik dhe konfiskim të çdo lloj pasurie që rrjedh ose fitohet drejtpërdrejt ose tërthorazi nga kryerja e veprës penale, apo dhe i shpërblimeve, të dhëna ose të premtuara, për kryerjen e veprës penale.

#### **Neni 525**

#### **Korrupsioni aktiv i arbitrit vendas dhe të huaj**

Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt, tërthorazi ose nëpërmjet çdo ndërmjetësi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, për vete ose për persona të tjerë, arbitrit vendas ose të huaj, për të kryer apo për të mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohen me burgim nga dy deri në shtatë vjet dhe shoqërohet me dënimin plotësues të heqjes së të drejtës së ushtrimit të funksionit publik dhe konfiskim të çdo lloj pasurie që rrjedh ose fitohet drejtpërdrejt ose tërthorazi nga kryerja e veprës penale, apo dhe i shpërblimeve, të dhëna ose të premtuara, për kryerjen e veprës penale.

#### **Neni 526**

#### **Korrupsioni aktiv i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja**

Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt, tërthorazi ose nëpërmjet çdo ndërmjetësi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, për vete ose për persona të tjerë, i anëtarëve të jurive gjyqësore të

huaja, për të kryer apo për të mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohen me burgim dy deri në shtatë vjet dhe shoqërohet me dënimin plotësues të heqjes së të drejtës së ushtrimit të funksionit publik dhe konfiskim të çdo lloj pasurie që rrjedh ose fitohet drejtpërdrejt ose tërthorazi nga kryerja e veprës penale, apo dhe i shpërblimeve, të dhëna ose të premtuara, për kryerjen e veprës penale.

#### **Neni 527**

#### **Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit apo oficerit të policisë gjyqësore**

Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt, tërthorazi ose nëpërmjet çdo ndërmjetësi, i çdo lloj përfitimi të parregullt ose i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi, që vjen nga përfitimi i parregullt, nga gjyqtari, prokurori, oficeri i policisë gjyqësore, anëtarit të organeve të qeverisjes së gjyqësorit apo prokurorisë ose, nëpunës civilë të organeve të drejtësisë, për të kryer ose mos kryer një veprim që lidhet me detyrën e funksionin e tij, dënohen me burgim nga katër deri në dhjetë vjet dhe shoqërohet me dënimin plotësues të heqjes së të drejtës së ushtrimit të funksionit publik dhe, konfiskim të çdo lloj pasurie që rrjedh ose fitohet drejtpërdrejt ose tërthorazi nga kryerja e veprës penale, apo dhe i shpërblimeve, të dhëna ose të premtuara, për kryerjen e veprës penale.

#### **Neni 528**

#### **Korrupsioni pasiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare**

Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt, tërthorazi ose nëpërmjet çdo ndërmjetësi, i çdo lloj përfitimi të parregullt ose i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, apo pranimi i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga gjyqtari ose zyrtari i një gjykate ndërkombëtare, për të kryer apo për të mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga katër deri në dhjetë vjet dhe shoqërohet me dënimin plotësues të heqjes së të drejtës së ushtrimit të funksionit publik, publikimin e vendimit gjyqësor dhe konfiskim të çdo lloj pasurie që rrjedh ose fitohet drejtpërdrejt ose tërthorazi nga kryerja e veprës penale, apo dhe i shpërblimeve, të dhëna ose të premtuara, për kryerjen e veprës penale.

#### **Neni 529**

#### **Korrupsioni pasiv i arbitrit vendas dhe të huaj**

Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt, tërthorazi ose nëpërmjet çdo ndërmjetësi, i çdo lloj përfitimi të parregullt ose i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, apo pranimi i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga arbitri vendas ose i huaj për të kryer apo për të mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet dhe shoqërohet me dënimin plotësues të heqjes së të drejtës së ushtrimit të funksionit publik, publikimin e vendimit gjyqësor dhe konfiskim të çdo lloj pasurie që rrjedh ose fitohet drejtpërdrejt ose tërthorazi nga kryerja e veprës penale, apo dhe i shpërblimeve, të dhëna ose të premtuara, për kryerjen e veprës penale.

### **Neni 530**

#### **Korrupsioni pasiv i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja**

Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt, tërthorazi ose nëpërmjet çdo ndërmjetësi, i çdo lloj përfitimi të parregullt ose i një premtimi të tillë, për vete a për persona të tjerë, apo pranimi i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga një anëtar i jurive gjyqësore të huaja, për të kryer apo për të mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet dhe shoqërohet me dënimin plotësues të heqjes të së drejtës të ushtrimit të funksionit publik, publikimin e vendimit gjyqësor dhe konfiskim të çdo lloj pasurie që rrjedh ose fitohet drejtpërdrejt ose tërthorazi nga kryerja e veprës penale, apo dhe i shpërblimeve, të dhëna ose të premtuara, për kryerjen e veprës penale.

### **Neni 531**

#### **Korrupsioni aktiv i dëshmitarit, i ekspertit ose përkthyesit**

1. Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt, tërthorazi ose nëpërmjet çdo ndërmjetësi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, për vete ose për persona të tretë, deklaruesit, dëshmitarit, ekspertit ose përkthyesit, për të siguruar deklarime ose dëshmi, ekspertim ose përkthim të rremë ose, për të refuzuar kryerjen e detyrimeve të tyre përpara organeve të ndjekjes penale dhe gjykatës, dënohen me burgim nga dy deri në pesë vjet.

2. Po kjo veprë e kryer në rastet kur hetimet paraprake apo gjykimi zhvillohen për vepra penale për të cilat parashikohet dënim me burgim mbi dhjetë vjet dënohet me burgim tre deri në tetë vjet.

### **Neni 532**

#### **Trafiku i influencës në sistemin e drejtësisë**

1. Premtimi, ofrimi ose dhënia një nëpunësi civil të sistemit të drejtësisë dhe prokurorisë, drejtpërdrejtë, tërthorazi, apo nëpërmjet çdo ndërmjetësi, i një përfitimi të parregullt, me qëllim që nëpunësi civil i sistemit të drejtësisë dhe prokurorisë të keqpërdorë ndikimin e tij të vërtetë ose të prezumuar me qëllim që një gjyqtar apo prokuror, ose anëtarit të organeve të qeverisjes së gjyqësorit apo prokurorisë, të japë një përfitim të parregullt për nxitësin e parë të këtij akti ose për çdo person tjetër të lidhur me të, pavarësisht nëse ndikimi ka arritur apo jo qëllimin e synuar, dënohet me burgim nga dy deri në gjashtë vjet.

2. Kërkimi ose pranimi nga një nëpunës civil i sistemit të drejtësisë dhe prokurorisë, drejtpërdrejtë, tërthorazi ose nëpërmjet çdo ndërmjetësi, i një përfitimi të parregullt për vete ose këdo tjetër, me qëllim që të keqpërdorë ndikimin e tij të vërtetë ose të prezumuar, me qëllim që të përfitohet për nxitësit një përfitim i parregullt nga një gjyqtar apo prokuror, ose institucion i qeverisjes së organeve të drejtësisë, pavarësisht nëse ndikimi ka arritur apo jo qëllimin e synuar, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.

### **Neni 533**

#### **Pasurimi i paligjshëm**

Pasurimi i paligjshëm, nëpërmjet shtimit domethënës, të rëndësishëm e të pajustificuar te saj, e cila kapercen mundesine per tu siguruar me te ardhurat e ligjshme te deklaruar nga gjyqtari,

prokurori, oficeri i policise gjyqsore, cdo nepunesi civil i sistemit te drejtesise, dënohet me burgim nga 2 deri ne 7 vjet.

#### **Neni 534**

#### **Zhvatja në sistemin e drejtësisë**

Moskryerja e qëllimtë e detyrës nga zyrtari i sistemit të drejtësisë, prokurorisë apo qeverisjes së tyre, kushtëzimi i plotësimit të detyrës publike me qëllimin e përfitimit material ose jo material, për vete ose për persona të tjerë, krijimi artificialisht i rrethanave negative në dëm të viktimës me qëllim që të detyrojë atë të paguajë, ose zvarritja e përfundimit të saj me synimin për të marrë paraprakisht përfitimin e paligjshëm apo arritjen e cilitdo qëllimi të paligjshëm, dënohet me burgim nga pesë deri në tetë vjet.

#### **Neni 535**

#### **Refuzimi për të kryer detyrën**

Refuzimi për të gjykuar çështjen apo votuar nga gjyqtari, për çdo shkak të paligjshëm, ose nën pretekstin se ligji është i paqartë, i pamjaftueshëm ose të heshtjes së ligjit, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

#### **Neni 536**

#### **Ndikimi në pavarësinë e gjykatës**

Bërja apo publikimi i komenteve me anë të të cilave synohet haptazi të ushtrohet ndikim në aftësinë e gjykatës për të marrë vendimet, nëpërmjet krijimit të rrethanave shtypëse ndaj pavarësisë së saj, shtrembërimit të qëllimshëm të cilësisë së provave apo paraqitjes së tyre në kundërshtim me përmbajtjen e vërtetë, imponimit për të krijuar pabesueshmërinë në publik të aftësisë së gjykatës për të qenë e pavarur, të kryera për çdo interes apo përfitim, për të dëmtuar apo favorizuar persona të veçantë, e kryer përpara dhënies së një vendimi gjyqësor, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

#### **Neni 537**

#### **Tarifat e papërshtatshme të shërbimit**

Përcaktimi i papërshtatshëm i tarifave ose shpërblimeve për kryerjen e detyrave nga nëpunësit publikë, avokatët, këshilltarët ose personat e tjerë që ofrojnë sipas profesionit të njohur me ligj çdo ndihmë a këshillë, të cilat dihen se nuk u takojnë atyre vetë ose, për shkak të shërbimit të ofruar u takojnë në një shumë më të vogël, edhe kur marrëveshja ndërmjet palëve është e njohur nga ligji përkatës me kushtin që, disproporcioni ndërmjet tarifës së kërkuar me vlerën e punës apo kohën e shpenzuar për të jetë qartësisht i dukshëm, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet si dhe dënimin plotësues të heqjes së të drejtës së ushtrimit të funksionit publik për një kohë deri në pesë vjet.

#### **Neni 538**

#### **Konflikti i interesit nga avokati**

1. Ofrimi ose dhënia e shërbimeve nëpërmjet këshillave dhe asistencës të dyja palëve në të njëjtën çështje ligjore nga avokatët ose personat e tjerë që ofrojnë ndihmë juridike, në lidhje me çështjet që u janë besuar në këtë cilësi, në kundërshtim me detyrën e tyre, dënohet me gjobë dhe dënimin plotësues të heqjes të së drejtës për të ushtruar profesion publike sipas parashikimeve të nenit 82 të këtij Kodi.

2. Avokatet që bashkëpunojnë me palën kundërshtare në dëm të klientit të tyre, dënohen me burgim nga një deri në katër vjet.

3. Ndalimet e këtij neni zbatohen edhe për avokatët apo personat e tjerë, anëtarë të së njëjtës zyre që ofrojnë ndihmë juridike, kur shërbejnë palëve kundërshtare në të njëjtën çështje.

### **Neni 539**

#### **Mosparaqitja në seancë gjyqësore**

1. Mosparaqitja e përsëritur pa shkak të justifikuar përpara gjykatës në shqyrtimin e një çështjeje penale me të pandehur të paraburgosur, duke shkaktuar zvarritje të gjykimit, e kryer me dashje për të nëpërkëmbur rëndësinë e funksionit dhe detyrës nga ana e prokurorit apo avokatit, kur gjykata ka zbatuar më parë rregullat e përcaktuara nga Kodi i Procedurës Penale, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë.

2. Kur mosparaqitja në seancë gjyqësore në cilësitë e paragrafit të parë të këtij neni, kryhet nga gjyqtari apo personeli ndihmës i tij që ndikojnë në zvarritjen e gjykimit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me qortim gjyqësor ose me gjobë.

### **Neni 540**

#### **Dëshmitë autovizive dhe kompetenca e gjykatës**

Për sa lidhet me këtë seksion, do të vlerësohet se dëshmitë, deklaratimet apo kallëzimet e bëra nëpërmjet sistemeve autovizive, kur paraqiten si të dënueshme penalisht, janë bërë në territorin e Republikës së Shqipërisë nëse kanë sjellë pasojën këtu, pavarësisht vendit ku është kryer fizikisht dëshmia.

### **Neni 541**

#### **Krimet e kryera përpara Gjykatës Ndërkombëtare Penale**

Nëse çdo krim i parashikuar në këtë kre të Kodit Penal do të kryhet përpara Gjykatës Ndërkombëtare Penale apo në një procedim që ka lidhje me kompetencën e asaj Gjykate, dënimi përkatës i parashikuar nga dispozitat respektive që parashikojnë krimin e kryer sipas këtij kreu, do të rritet deri në një të tretën e tij.

## **KREU II**

### **VEPRAT PENALE KUNDËR AUTORITETIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE**

### **Neni 542**

#### **Pengimi i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore**

1. Fshehja, tjetërsimi, konsumimi, dëmtimi apo shkatërrimi i sendeve për të cilat një gjykatë ka urdhëruar me vendim sekuestron, çdo barrë civile, konfiskimin apo zgjidhjen përfundimtare të çdolloj çështje, ose kryerja e veprimeve të tjera që synojnë të mos ekzekutohet ose të pengohet ekzekutimi i vendimit gjyqësor, dënohet me gjobë ose me burgim nga një deri në gjashtë vjet.

2. Krijimi i çdo rrethane që pengon ekzekutimin e një vendimi gjyqësor, që përmban të drejta të subjekteve ndërgjyqëse, masa të sigurimit personal apo ndaluese të tilla, detyrime për të kryer veprime, apo çdo lloj natyre të drejtë të shprehur në vendimin gjyqësor, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

3. Në rastet kur pengimi i ekzekutimit të vendimit gjyqësor ka të bëjë me dhënien e ndihmës për arratisjen e një personi ndaj të cilit është lëshuar një vendim gjyqësor për arrestimin e tij, dënimi i parashikuar në paragrafin e dytë të këtij neni, shtohet deri në një të tretën e tij.

4. Ndjekja penale lidhur me kundërvajtjen penale të parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni, ushtrohet mbi bazën e ankimit të kreditorit ose të përfaqësuesit ligjor të tij dhe çështja pushohet me heqjen dorë nga ankimi.

5. Për aq sa ato janë të zbatueshme, vendimet e prokurorit, të oficerit të policisë gjyqësore dhe, të komisioneve hetimore parlamentare barazohen me vendimet gjyqësore.

### **Neni 543**

#### **Mosekzekutimi pa shkaqe të përligjura i vendimit**

1. Mosekzekutimi pa shkaqe të përligjura i një vendimi gjyqësor, apo të çdo organi tjetër, vendimi i të cilit është i ekzekutueshëm sipas ligjit, nga punonjësi i ngarkuar me ligj për ekzekutimin e vendimeve, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim nga tre muaj deri në dy vjet.

2. Kur kjo vepër kryhet me qëllim fitimi ose çdo interes tjetër të dhënë ose të premtuar, si dhe për të favorizuar persona që kanë interes për mosekzekutimin e vendimit, dënohet me gjobë ose me burgim dy deri në katër vjet.

3. Dënimi kryesor, sipas rastit, mund të shoqërohet me dënimin plotësues të heqjes së të drejtës për të ushtruar profesionin dhe konfiskimin e çdo lloj pasurie që rrjedh ose fitohet drejtpërdrejt ose tërthorazi nga kryerja e veprës penale, apo dhe i shpërblimeve, të dhëna ose të premtuara, për kryerjen e veprës penale.

### **Neni 544**

#### **Prishja e shenjave dhe vulave**

Prishja e vulave dhe shenjave të tjera të vendosura mbi sende të ndryshme nga organet e ndjekjes penale dhe ato gjyqësore, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj.

### **Neni 545**

#### **Moszbatimi i dënimeve plotësuese dhe masave penale**

1. Kryerja e veprimeve në kundërshtim me vendimin e gjykatës në lidhje me detyrimet e lindura nga dënimet plotësuese dhe masave penale të dhëna prej saj, ose moszbatimin e saj, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim nga tre muaj deri në dy vjet.
2. Kur vepra penale kryhet nga zyrtarët publik, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet dhe shoqërohet me dënimin plotësues të heqjes të së drejtës për të ushtruar funksionin publik.

### **Neni 546**

#### **Vetëgjyqësia**

1. Përdorimi i dhunës ndaj sendeve, me qëllimin për të realizuar një të drejtë të pretenduar, ushtruar në mënyrë arbitrare nga personi që ka mundësinë për t'iu drejtuar institucioneve kompetente shtetërore për shqyrtim, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë.
2. Në kuptim të ligjit penal, dhuna ndaj sendeve nënkupton dëmtimin, transformimin ose ndryshimin e destinacionit të sendit.
3. Dhunë ndaj sendeve ka edhe në rastet kur ndryshohet, modifikohet ose fshihet tërësisht ose pjesërisht apo kur pengohet ose çrregullohet funksionimi i një sistemi informatik ose telematik.
4. Përdorimi i dhunës fizike ose kanosjes ndaj personave, me qëllimin për të realizuar një të drejtë të pretenduar, ushtruar në mënyrë arbitrare nga personi që ka mundësinë për t'iu drejtuar institucioneve kompetente shtetërore për shqyrtim, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në tridhjetë ditë.
5. Vepra penale ndiqet me ankimin e viktimës dhe pushon kur ajo heq dorë nga ankimi.

### **Neni 547**

#### **Mospërfillja e autoritetit gjyqësor**

1. Mospërfillja e vendimit gjyqësor të leshuar sipas procedurës ligjore, neperkembja, perdhosja publike e kompetencës së autoritetit gjyqësor, anashkalimi i detyrimit për ta zbatuar urdherat e tij, zhvlerësimi me vetëgjyqësi i përmbajtjes së vendimit duke vetdeklaruar epersinë e të drejtës individuale përmbi çfarë vendimi gjyqësor ka urdheruar duke mos ndjekur rrugën ligjore të vlerësimit të tij sepse vlerësohet njëanshmerisht si e drejtë e prekur padrejtesisht nga vendimi gjyqësor, duke cenuar rëndë autoritetin e pushtetit të pavarur gjyqësor, dënohet me gjobë ose me burgim nga një deri në katër vjet.
2. Kur vepra penale sipas paragrafit të parë të këtij neni kryhet nga avokate apo subjekte profesionale tjetër që kanë kontakt procedural me autoritetin gjyqësor përgjatë një procedure gjyqësore, dënimi shtohet deri në 1/3 e tij dhe shoqërohet me dënimin plotësues të heqjes të së drejtës për të ushtruar veprimtarinë profesionale.
3. Në kuptim të kësaj dispozite barazohen me vendimin gjyqësor çdo akt i nxjerre nga organet gjyqësore, të prokurorisë apo të organeve që ky ligj i ka barazuar me ta, të cilat sjellin detyrime për subjektet që u drejtohen.

### **Neni 548**

#### **Futja ose mbajtja e sendeve të ndaluara në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale**

1. Futja ose mbajtja e sendeve të ndaluara në institucionin e ekzekutimit të vendimeve me burgim, të cilat, sipas legjislacionit në fuqi, janë të ndaluara, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

2. Po kjo veprë, kur kryhet nga personi që ka për detyrë ruajtjen dhe sigurinë fizike ose që për shkak të detyrës ose profesionit ka të drejtë të hyjë në institucionet e burgimit, dënohet me burgim nga dy deri në shtatë vjet dhe shoqërohet me dënimin plotësues të heqjes të së drejtës për të ushtruar funksionin publik.

#### **Neni 549**

#### **Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit**

1. Largimi nga vendi i qëndrimit të detyrueshëm i personit të ndaluar apo arrestuar, të dënuarit, të paraburgosurit apo kujtdo që ka detyrimin për të qëndruar në një territor a vend të caktuar, për shkak të vendimeve gjyqësore, të prokurorit ose arrestit në flagrancë, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

2. Kur vepra penale kryhet me dhunë ose me përdorimin e armëve, substancave zjarrvënëse, eksplozive dhe helmuese, nga struktura të organizuara të bashkëpunimit, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

3. Për efekt të kësaj dispozite, subjekt i paragrafit të parë të këtij neni është çdo person i cili:

- a) është i paraburgosur;
- b) është në pritje për t'u paraqitur përpara gjykatës gjatë kohës që është ndaluar ose arrestuar në flagrancë;
- c) është njoftuar për një urdhër ndalimi ose vendim caktim mase sigurimi me arrest, të cilët janë ende në fuqi;
- ç) është duke shlyer dënimin me burgim;
- d) po i nënshtrohet procedurave të ekstradimit.

4. Përbëjnë arratisje edhe veprimet e mëposhtme:

- a) kur i paraburgosuri ose i dënuari i vendosur në një institucion shëndetësor ose spitalor, largohet me qëllimin për t'iu shmangur mbikëqyrjes ndaj së cilës është vendosur;
- b) kur i dënuari i shmanget mbikëqyrjes dhe kontrollit në rastet kur është vendosur jashtë institucioneve të ekzekutimit të dënimeve me burgim, kur është me arrest në shtëpi dhe mbikëqyret me mjete elektronike ose nëse përfiton nga gjysmëliria ose nga një leje daljeje;
- c) kur i dënuari i vendosur nën mbikëqyrje elektronike neutralizon me çdo mjet dhe mënyrë pajisjen që mundëson përcaktimin e pranisë ose mungesës së tij në distancë, në vendin e caktuar nga gjykata.

5. Në rastin e bashkimit të dënimeve, sipas nenit 153 të këtij Kodi, gjykata kur cakton dënimin penal për të burgosurin që largohet nga vendi i vuajtjes së dënimit, zbaton bashkimin aritmetik të dënimit për këtë veprë penale me dënimet e tjera që vendosen ose janë vendosur ndaj të burgosurit.

#### **Neni 550**

#### **Dhënia e ndihmës një të burgosuri për t'u larguar**

1. Dhënia e këshillave, informatave, mjeteve apo çdo mundësie, personit të ndaluar apo arrestuar ose të dënuarit, kur ai synon që të largohet nga vendi i qëndrimit të detyruar, dënohet me burgim nga një deri në katër vjet.

2. Kur dhënia e ndihmës bëhet nga i ngarkuari me ruajtjen, mbikëqyrjen apo transportimin, ose që për shkak të funksionit ka të drejtë të hyjë në institucionet e burgimit apo të ketë lidhje me të ndaluar, arrestuar apo të burgosur, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet dhe shoqërohet me dënimin plotësues të heqjes së të drejtës për të ushtruar funksionin publik.

3. Në rastet kur largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit ka ardhur si pasojë e pakujdesisë së nëpunësve që janë ngarkuar me ruajtjen, mbikëqyrjen apo transportimin, ose që për shkak të funksionit kanë të drejtë të hyjnë në institucione burgimi apo të kenë lidhje me të burgosur, dënimi i parashikuar në paragrafin e dytë, ulet deri në një të dytën e tij.

### **Neni 551**

#### **Kryerja e veprës nga personi juridik**

Kur veprat penale të parashikuara në nenet 495, 496, 497, 502, 508, 510, 511, 512, 513, 514, 515, 516, 517, 523, 524, 525, 526, 531, 532, 536, 537, 538, 542, 545, 546 dhe 550 të këtij titulli, janë kryer edhe nga një person juridik, dënohet:

a) me gjobë deri në pesëfishin e parashikuar në nenin 123 të këtij Kodi; ose

b) mbylleten e veprimtarisë së tij përgjithmonë ose për një kohë të përshtatshme që gjykata vlerëson të arsyeshme.

### **Neni 552**

#### **Dënimet plotësuese**

1. Kur veprat penale të parashikuara në këtë titull kryhen nga zyrtari publik, atëherë gjykata, krahas dënimit kryesor cakton edhe dënimin plotësues, heqjen e së drejtës për të ushtruar një funksion publik, në zbatim të nenit 76 të këtij Kodi.

2. Në çdo rast, gjykata vendos masën e zëvendësimit të dëmit të shkaktuar dhe, përveç sendeve që kanë shërbyer për kryerjen e veprave penale, kur ajo është kryer nga subjektet me qëllim përfitimi material apo të premtuar, vendoset konfiskimi i të ardhurave nga vepra penale apo të premtuara.

3. Për veprat penale të lehta të parashikuara në nenet 503, 506, paragrafi i parë, 509, 510, 511, paragrafi i parë, 514, 518, paragrafi i parë, 520, 522, 535, 536, paragrafi i parë, 538, paragrafi i parë, 539, 544, 545, paragrafi i parë, 546, paragrafi i parë, kur çmohet e arsyeshme, gjykata mund të vendosë dhënien e jo më pak se sa dy dënimeve plotësuese në vend të dënimit kryesor.

### **Neni 553**

#### **Konkurrimi i veprave dhe bashkëpunimi**

1. Në të gjitha rastet kur, për të kryer një prej veprave penale të parashikuara në këtë kre, autorit i është dashur të kryejë veprime që përbëjnë vepër penale më vete, atëherë kjo e fundit konkurren me veprën që ai ka dashur të kryejë. Këto vepra penale të kryera nga autori konkurrojnë edhe me veprat penale që ai ka pasur qëllim të realizojë.

2. Nëse për kryerjen e ndonjëres prej veprave penale të parashikuara në këtë kre, autorit të posaçëm i është dashur të bashkëpunojë me një person tjetër, pavarësisht cilësive të posaçme të këtij të fundit, ata do të përgjigjet për kryerjen në bashkëpunim të veprës penale të parashikuar në këtë kre, apo çfarëdolloj vepre penale që konkurren me to.

TITULLI V  
VEPRAT PENALE KUNDËR MJEDISIT DHE REGJIMIT TË TOKËS

KREU I  
VEPRAT PENALE KUNDËR MJEDISIT

**Neni 554**  
**Autorizimi apo leja e paligjshme**

Per sa lidhet me dispozitat e ketij kreu, do të vleresohet te jetë e paligjshme, cdo sjellje, autorizim i kerkuar, leje per ushtrim te veprimtarive te permendura edhe kur kryhet sipas një autorizimi të lëshuar nga një autoritet kompetent i një shteti, nëse një autorizim i tillë është marrë me mashtrim ose me korrupsion, zhvatje ose detyrim, ose nëse një autorizim i tillë është në shkelje të dukshme të kërkesave ligjore thelbësore përkatëse, apo ne kapercim te kushteve te atij autorizimi.

**Neni 555**  
**Emetimet e paligjshme të mbetjeve**

1. Shkaktimi ose kryerja në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në kundërshtim me ligjin ose të akteve të tjera për mbrojtjen e mjedisit, e emetimeve, derdhjeve, shkarkimeve, nxjerrjeve ose gjurmimeve, groposjeve, zhurmave, dridhjeve, injeksioneve ose depozitimeve, në atmosferë, tokë, nëntokë ose ujëra tokësore, nëntokësore ose detare, duke përfshirë detin e hapur, me ndikim edhe në hapësirat ndërkufitare, si dhe ujëmbledhësit që, më vete ose së bashku me të tjerë, shkaktojnë ose mund të shkaktojnë dëme thelbësore në cilësinë e ajrit, tokës, ujit, të kafshëve ose bimëve, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet si ose, me gjobë, dhe me heqje të së drejtës për të ushtruar një veprimtari ose tregti për një periudhë nga një deri në dy vjet.

2. Nëse sjelljet e mësipërme, më vete ose së bashku me të tjera, mund të dëmtojnë rëndë ekuilibrin e sistemeve natyrore, dënimi me burgim caktohet nga dy deri në pesë vjet ose, me gjobë dhe, heqja e së drejtës për të ushtruar një veprimtari vendoset për një periudhë prej dy deri në katër vjet.

3. Nëse nga kryerja e veprave penale të parashikuara në këtë dispozitë, do të krijohet rrezik për dëmtimin serioz të shëndetit të njerëzve apo vdekjen e tyre, autori do të përgjigjet edhe në bazë të dispozitës përkatëse që parashikon veprën e kryer ne varesi te llojit te fajit te shfaqur.

**Neni 556**  
**Emetimi i rrezatimit**

1. Shkarkimi, emetimi ose futja në ajër, tokë, ose ujë e një sasive materialeve ose rrezatimi, ose ekspozimi me çdo mjet tjetër ndaj këtij rrezatimi, që vë në rrezik cilësinë e ajrit, tokës, ujit, e kafshëve ose e bimëve, apo pronën e një ose disa personave, dënohet me burgim nga kater deri në tetë vjet ose dhe me gjobë.

2. Vendosjen në treg, ne kundërshtim me rregullat e percaktuara ne aktet normative, të një produkti përdorimi i të cilit rezulton në shkarkimin, emetimin ose futjen e një sasive materialeve ose

substancash, energjie ose rrezatimi jonizues në ajër, tokë ose ujë dhe që, ka të ngjarë të shkaktojë vdekjen ose dëmtim serioz të çdo personi ose dëmtim thelbësor në cilësinë e ajrit, tokës ose ujit, ose dëmtim thelbësor në një ekosistem, kafshë ose bimë, denohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet dhe me gjobe.

3. Nëse nga kryerja e veprave penale të parashikuara në këtë dispozitë, do të rezultojnë vdekje apo dëmtime të shëndetit të tyre, autori do të përgjigjet edhe në bazë të dispozitës përkatëse që parashikon veprën e kryer në baze të formës së fajit të shfaqur.

### **Neni 557**

#### **Ndotja nga materialet bërthamore dhe substancat radioaktive të rrezikshme**

1. Ndotja e mjedisit për shkak të prodhimit, përpunimit, trajtimit, përdorimit, mbajtjes, ruajtjes, transportit, importit, eksportit ose asgjësimit të materialit radioaktiv ose substancave radioaktive, ku një sjellje e tillë, të bera në kundërshtim me aktet ligjore vendase dhe nderkombetare të pranuar për trajtimin e lendeve të tilla, kur një sjellje e tillë ka të ngjarë të shkaktojë vdekjen ose lëndimin e rëndë të çdo personi ose, shkakton dëme të konsiderueshme për cilësinë e ajrit, tokës ose ujit, ose dëmtime të konsiderueshme në pasurinë e personave apo të një ekosistemi, kafshë ose bimë, dënohet me gjobë ose me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.

2. Nëse nga kryerja e veprave penale të parashikuara në këtë dispozitë, do të rezultojnë vdekje apo dëmtime të shëndetit të njerezve, autori do të përgjigjet edhe në bazë të dispozitës përkatëse që parashikon veprën e kryer.

### **Neni 558**

#### **Substancat ozonholluese**

Prodhimi, vendosja në treg, importi, eksporti, përdorimi ose lëshimi i substancave që shkatërrojnë ozonin, qofshin vetëm ose si përzierje, siç referohet në aktet e brendshme ligjore apo ato nderkombetare, ose prodhimi, vendosja në treg, importi, eksporti ose përdorimi i produkteve dhe pajisjeve dhe pjesëve të tyre, që përmbajnë substanca që shkatërrojnë ozonin ose funksionimi i të cilave mbështetet në ato substanca të përmendura në aktet normative vendase apo nderkombetare, ose prodhimi, vendosja në treg, importi, eksporti ose përdorimi i produkteve dhe pajisjeve, dhe pjesëve të tyre, që përmbajnë gazra serë të fluorizuar ose funksionimi i të cilave mbështetet në ato gaze të përmendura në ato akte, ose vënien në punë të këtyre produkteve dhe pajisjeve, dënohet me burgim nga dy deri në shtatë vjet dhe gjobë.

### **Neni 559**

#### **Dëmtimi i zonës së mbrojtur**

Dëmtimi i rëndë i një zone të mbrojtur natyrore në ndonjë nga elementet që kanë shërbyer për ta cilësuar atë si të tillë, përveç çfarë paarshtkohet në nenin 569 të këtij Kodi, dënohet me burgim nga një deri në katër vjet dhe me gjobë.

### **Neni 560**

## **Mbledhja e mbetjeve**

1. Mbledhja, grumbullimi, transportimi, shfrytëzimi, shndërrimi, ose moskryerja e kontrolleve apo e mbikëqyrjes në mënyrë të përshtatshme e veprimtarive të tilla, moskujdesi i duhur të vendeve të depozitimit, kryer në kundërshtim me ligjin ose aktet e tjera normative, në mënyrë të tillë që shkaktojnë ose mund të shkaktojnë dëme thelbësore në cilësinë e ajrit, tokës ose ujit, te kafshët ose bimët, dënohet me burgim nga katër muaj deri në tre vjet dhe kur mund të apo, dëmtojnë seriozisht ekuilibrin e sistemeve natyrore-ekologjike dënohet me burgim nga dy deri në gjashtë vjet.
2. Kushdo që, jashtë rasteve të përmendura në paragrafin më lart, transferon një sasi jo të papërfillshme mbetjesh, një apo disa dërgesa që kanë lidhje me cilindo nga rastet e përmendura në legjislacionin e Bashkimit Evropian për transferimin e mbetjeve, dënohet me burgim nga tre muaj deri në një vit dhe, me dënimin plotësues heqjen e së drejtës për ushtrimin e profesionit ose veprimtarisë për një periudhë deri në tre vjet.
3. Nëse nga kryerja e veprave penale të parashikuara në këtë dispozitë, do të krijohet rrezik për dëmtimin serioz të shëndetit të njerëzve, ose rezultojnë vdekje apo dëmtime të shëndetit të tyre, autori do të përgjigjet edhe në bazë të dispozitës përkatëse që parashikon pasojën e veprës së kryer.

### **Neni 561**

#### **Asgjësimi i paligjshëm i mbetjeve**

1. Asgjësimi apo djegia e mbetjeve të braktisura, ose mbetjeve të depozituara në mënyrë të pakontrolluar, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj.
2. Asgjësimi apo djegia e mbetjeve me këtë destinacion, të kryera në kundërshtim me ligjin ose aktet e tjera normative, në mënyrë të tillë që shkaktojnë ose mund të shkaktojnë dëme thelbësore në cilësinë e ajrit, tokës ose ujit, te njerëzit, kafshët ose bimët, dënohet me burgim nga katër muaj deri në tre vjet;
  - kur mund të apo, dëmtojnë seriozisht ekuilibrin e sistemeve natyrore-ekologjike dënohet me burgim nga dy deri në gjashtë vjet.
3. Kur, në përputhje me paragrafët më lart në këtë dispozitë, janë asgjësuar apo djegur mbetje të atilla që shtojnë pasojat e përmendura më lart, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet.
4. Dënimi rritet me një të tretën nëse veprat e përmendura më lart janë kryer në kuadër të veprimtarisë së një shoqërie ose nga një veprimtari e organizuar kriminale ose kur janë kryer në territore të cilat, në kohën e konsumimit të faktit, janë shpallur nga organet kompetente si territore në gjendje emergjente në sektorin e mbetjeve.
5. Mjetet e përdorura për transportin e mbetjeve, objekt material i veprave penale të përmendura në paragrafët e këtij neni konfiskohen, përveç rastit kur mjete i përket një personi të tretë që është në mirëbesim.
6. Ndaj autorit të veprës penale, gjykata cakton si dënim dhe masa plotësuese rikthimin e gjendjes së mëparshme të vendeve të dëmtuara, pagimin e dëmshpërblimit të dëmit mjedisor të shkaktuar dhe, konfiskimin e sipërfaqes tokësore në të cilën është kryer vepra.

### **Neni 562**

#### **Shfrytëzimi i paligjshëm i impianteve të rrezikshme**

1. Shfrytëzimi, në kundërshtim me ligjin ose akte të tjera normative, i impianteve apo objekteve në të cilat kryhet një veprimtari e rrezikshme ose ku ruhen apo përdoren substanca ose preparate të rrezikshme, montimi apo cmontimi në mënyrë të tillë që shkaktojnë ose ka të ngjarë të shkaktojnë dëme thelbësore në cilësinë e ajrit, tokës ose ujit, kafshëve ose bimëve, ose ka të ngjarë të dëmtojnë seriozisht ekuilibrin e sistemeve natyrore, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.

2. Nëse nga kryerja e veprave penale të parashikuara në këtë dispozitë, do të krijohet rrezik për dëmtimin serioz të shëndetit të njerëzve, ose rezultojnë vdekje apo dëmtime të shëndetit të tyre, autori do të përgjigjet edhe në bazë të dispozitës përkatëse që parashikon veprën e kryer.

### **Neni 563**

#### **Çlirimi i gazeve**

Emetimi ose çlirimi i gazeve të fluorizuar, qofshin edhe te perziere, që shkaktojnë efektin serrë, siç përcaktohet në ligjin për reduktimin e shkarkimeve të gazeve serrë të fluoruara, ose prodhimi, hedhja në treg, importimi, eksportimi i tyre, përdorimi i produkteve dhe pajisjeve dhe pjesëve të tyre që përmbajnë ose varen nga këto gazra, dënohet me burgim nga tre deri në gjashtë vjet.

### **Neni 564**

#### **Riciklimi i anijeve**

Riciklimi i anijeve në kundërshtim me aktet normative vendase apo, ndërkombëtare ku Shqipëria është palë, kur kryhet në sasi të konsiderueshme në një dërgesë të vetme ose në disa dërgesa që janë të lidhura ndërmjet tyre, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet ose me gjobë.

### **Neni 565**

#### **Shkarkesat e anijeve**

1. Shkarkimi i substancave ndotëse nga anijet, kur nuk janë rastet përjashtimore të parashikuara në aktet normative vendase apo ndërkombëtare, ku Shqipëria është palë, dënohet me burgim nga dy deri në tetë vjet.

2. Paragrafi i parë i kësaj dispozite nuk zbatohet në rastet kur shkarkimi nuk shkakton përkeqësim të cilësisë së ujit, përveçse kur është kryer në mënyrë të përsëritur nga i njëjti autor dhe të marrë së bashku, shkaktojnë përkeqësim të cilësisë së ujit.

### **Neni 566**

#### **Shfrytëzimi i paligjshëm i burimeve minerare**

1. Shfrytëzimi i pasurive minerare në kundërshtim me ligjet ose aktet nënligjore të organeve kompetente dënohet me gjobë ose me burgim deri në katër vjet.

2. Kur kjo vepër kryhet në një zonë të mbrojtur, dënimi shtohet deri në një të tretën e tij.

3. Kur nga kryerja e veprës është shkaktuar një dëm i konsiderueshëm apo është marrë një përfitim i konsiderueshëm material ose kur vepra është kryer për qëllim përfitimi ose për qëllim të shkaktimit të dëmit, dënimi sipas paragrafit të parë shtohet deri në një të dytën e tij.

4. Sendet të cilat kanë qenë të destinuara ose janë përdorur për kryerjen e veprës penale, ose janë përfituar nga vepra penale, do të konfiskohen.

#### **Neni 567**

#### **Shfrytëzimi i paligjshëm e ujit**

Shfrytëzimi e ujërave sipërfaqësore ose nxjerrja e atyre nëntokësore, kryer në kundërshtim me ligjin perkates, që shkakton ose mund të shkaktojë dëme të konsiderueshme në gjendjen ose potencialin ekologjik të trupave ujqorë sipërfaqësorë ose në gjendjen sasiore të trupave ujqorë nëntokësorë, dënohet me gjobë ose me burgim nga dy deri në gjashtë vjet.

#### **Neni 568**

#### **Tregtimi i paligjshëm i lëndës drusore**

Futja ose vënia në dispozicion në tregun e brendshëm ose atë të Bashkimit Evropian e lëndës drusore ose produkteve të drurit me burim të paligjshëm, me përjashtim të rasteve kur bëhet fjalë për një sasi të papërfillshme, dënohet me gjobë ose burgim nga një deri në tre vjet.

#### **Neni 569**

#### **Dëmtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër**

Vrasja, shkatërimi, zotërimi, marrja e ekzemplarëve të specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër ose pjesëve apo nënprodukteve të tyre, duke shkelur kërkesat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e faunës së egër dhe për zonat e mbrojtura apo të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë ka ndodhur mbi një sasi të papërfillshme të këtyre ekzemplarëve dhe ka ndikim të papërfillshëm mbi statusin e ruajtjes së specieve, dënohet me gjobë ose me burgim nga dy deri në pesë vjet.

#### **Neni 570**

#### **Tregtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër**

Tregtimi i ekzemplarëve të specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër ose pjesëve apo nënprodukteve të tyre, duke shkelur kërkesat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e faunës së egër dhe për zonat e mbrojtura apo të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë ka ndodhur mbi një sasi të papërfillshme të këtyre ekzemplarëve dhe ka ndikim të papërfillshëm mbi statusin e ruajtjes së specieve, dënohet me gjobë ose me burgim nga dy deri në kater vjet.

## **Neni 571**

### **Peshkimi i paligjshëm**

1. Gjuajtja e peshkut, kafshëve ose organizmave të tjera të ujërave të ëmbla ose të kripura gjatë sezonit të ndaluar ose brenda një zone ku peshkimi është i ndaluar, ose gjuajtja e peshqve të mbrojtur ose e kafshëve ose e organizmave të tjera të ujërave të ëmbla ose detare që janë të ndaluara të kapen, ose gjuajtja e peshkut, kafshëve ose organizmave të specieve të veçanta, të ujërave të ëmbla ose detare, pa lejen përkatëse nga organet kompetente, qoftë edhe në pronësi private të një personi tjetër, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj.
2. Kur, gjuajtja e peshkut, kafshëve ose organizmave të tjera të ujërave të ëmbla ose të kripura shënuar në paragrafin e parë të këtij neni, bëhet duke përdorur eksplozivë, energji elektrike, helme, preparate trulllosëse ose me çdo mënyrë ose me pajisje, të cilat dëmtojnë riprodhimin e tyre ose të cilat janë të ndaluara, ose zhvendosja e peshqve, kafshëve ose organizmave të tjera të ujërave të ëmbla ose detare nga habitat i tyre në një vend tjetër, pa miratimin e organit kompetent shtetëror, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.
3. Gjuajtja e peshkut, kafshëve ose organizmave të tjera të ujërave të ëmbla ose të kripura në rezervatin e peshkimit të tjetrit, me mënyrat e përcaktuara në paragrafin e dytë të këtij neni, dënohet me gjobë ose me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

## **Neni 572**

### **Prerja e paligjshme e pyjeve**

Prerja pa leje e pemëve, apo dëmtimi i pyjeve, në kohë dhe vende të ndaluara, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

## **Neni 573**

### **Prerja e drurëve dekorativë dhe frutorë**

1. Prerja e drurëve, frutorë apo dekorativë dhe, dëmtimi i lulishteve, oborreve dhe parqeve nëpër qytete përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë.
2. Prerja e drurëve në pemëtore, ullishta e vreshta, pasi është refuzuar më parë leja e prerjes nga organet kompetente, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me burgim deri në gjashtë muaj.

## **Neni 574**

### **Shkelja e karantinës së bimëve**

1. Shkelja e rregullave për karantinën e bimëve, kur ka sjellë pasoja të lehta materiale ose që rrezikojnë jetën e shëndetin e njerëzve, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë.
2. Kur shkelja e rregullave ka sjellë pasoja të rënda materiale ose përhapjen e sëmundjeve, apo rrezikon shëndetin e njerëzve, dënohet me gjobë ose burgim deri në dy vite.

## **Neni 575**

### **Shkelja e karantinës së kafshëve**

1. Shkelja e rregullave për karantinën e kafshëve, kur ka sjellë pasoja të lehta materiale ose që rrezikojnë jetën e shëndetin e njerëzve, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë.
2. Kur shkelja e rregullave ka sjellë pasoja të rënda materiale ose përhapjen e sëmundjeve, apo rrezikon shëndetin e njerëzve, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.
3. Mosgroposja e kafshëve të infektuara, sipas protokolleve përkatëse që rregullojnë trajtimin e rasteve të infektimit masiv në mbrojtje të shëndetit publik, dënohet me gjobë ose me burgim deri në katër vjet.
4. Në rastin kur vepra penale e parashikuar në paragrafin e tretë të këtij neni është lehtësuar në kryerjen e saj nga mungesa e kontrollit apo edhe mbështetja prej nëpunësit publik, dënimi për subjektet shtohet deri në një të dytën e tij.
5. Nëse nga kryerja e veprave penale të parashikuara në këtë dispozitë, rezultojnë vdekje apo dëmtime të shëndetit të njerëzve, autori do të përgjigjet edhe në bazë të dispozitës përkatëse që parashikon veprën e kryer.

#### **Neni 576**

#### **Kryerja e veprave penale me pakujdesi**

Nëse çdonjëra nga veprat penale të parashikuara në këtë kre do të kryhet me pakujdesi të rëndë, gjykata cakton dënim deri në një të dytën më të ulët se sa masa e tij parashikuar në dispozitën përkatëse.

#### **Neni 577**

#### **Kryerja e veprës nga personi juridik**

1. Kur veprat penale të përmendura në këtë kre, janë kryer nga një person juridik, edhe kur ai ka deshtuar të marre masat përkatëse për të rregulluar veprimtarinë sipas kompetencës që zoteron, dënimi me gjobë i përmendur në dispozitën përkatëse do të jetë:
  - a) deri dyfishin deri në katërfishin e dëmit të shkaktuar, kur vepra penale e kryer dënohet me burgim mbi dy vjet deri në gjashtë vjet për personin fizik.
  - b) deri në dyfishin ose në trefishin e dëmit të shkaktuar në të gjitha rastet e tjera.
2. Në përputhje me nenin 123 të këtij Kodi, gjykata mund të caktojë mbylljen apo pezullimin e veprimtarisë së tij për një kohë të përshtatshme.

#### **Neni 578**

#### **Kryerja e veprës penale nga zyrtari publik**

1. Punonjësi ose funksionari publik, i cili, me dijeni, ka raportuar në favor të dhënies së licencave haptazi të kundërligjshme që lejojnë vënien në funksionim të veprimtarive industriale ose veprimtarive ndotëse të përmendura në nenet e mësipërme, ose që, gjatë inspektimeve të kryera, me dashje nuk ka evidentuar shkeljet e ligjit ose normave të tjera, ose që me dashje nuk ka kryer kontrole të detyrueshme, dënohet si bashkëpunëtor në veprën penale respektive të kryer dhe dënohet deri me një të tretën më shumë se dënimi i dhënë për bashkëpunëtorët e tjerë.

2. Me të njëjtat dënime do të dënohet edhe punonjësi ose zyrtari publik, i cili, vetë ose si anëtar i një organi kolegjal, ka marrë vendim ose ka votuar në favor të dhënies së lejes apo licencës, duke e ditur se dhënia e saj është në kundërshtim me ligjin.

### **Neni 579**

#### **Rrethana cilësuese**

Kryerja e veprave penale të përmendura në nenet e mësipërme të këtij kreu, dënohen deri në një të tretën më shumë të dënimit të përcaktuar në dispozitat përkatëse, kur në kryerjen e ndonjë prej veprimeve ose mosveprimeve të përmendura në to, konkurren ndonjëra prej rrethanave vijuese:

a) kur veprimtaria industriale ose veprimtaria në tërësi kryhet në mënyrë të kundërligjshme, pa marrë më parë autorizimin e detyrueshëm ose miratimin administrativ të objektit të saj (leje apo licencë);

b) kur nuk janë respektuar urdhrat e autoritetit administrativ për korrigjimin ose pezullimin e veprimtarive të përcaktuara në nenin e mësipërm;

c) kur është falsifikuar ose fshehur informacioni për aspektet mjedisore të veprimtarisë;

ç) kur është penguar veprimtaria inspektuese e administratës kompetente;

d) kur është shkaktuar një rrezik dëmtimi i pakthyeshëm ose katastrofik i ekosistemit;

dh) kur ka pasur nxjerrje (marrje) të paligjshme të ujit gjatë një periudhe kufizimesh;

e) kur vepra penale është kryer me qëllim përfimi të çfarëdollojshëm ;

f) kur vepra penale është kryer në kuadrin e një bashkëpunimi të posaçem anetaresh ;

g) kur vepra penale është kryer ndaj një zone të klasifikuar si zone e mbrojtur.

### **Neni 580**

#### **Kryerja e veprës penale nga subjektet profesioniste**

Nëse ndonjëra nga veprat penale të parashikuara në këtë kre do të kryhet nga profesionistë që ushtrojnë profesionin në fushën e mjedisit, vepra penale do të vlerësohet si e kryer në rrethana të cilësuar sipas nenit 579 të këtij kreu dhe, dënimi për veprën përkatëse të kryer do të përmbajë edhe dënimin plotësues të heqjes deri në pesë vjet të së drejtës për të ushtruar profesionin.

### **Neni 581**

#### **Dënimet plotësuese**

1. Nëse veprat penale të parashikuara në këtë kre kryhen nga zyrtari publik, atëherë gjykata, krahas dënimit kryesor cakton edhe dënimin plotësues, heqjen e së drejtës për të ushtruar një funksion publik, në zbatim të nenit 76 të këtij Kodi.

2. Në çdo rast gjykata vendos masën e zëvendësimit të dëmit të shkaktuar dhe, përveç sendeve që kanë shërbyer për kryerjen e veprave penale, kur ajo është kryer nga subjektet me qëllim përfitimi material apo të premtuar, vendoset konfiskimi i të ardhurave nga vepra penale apo të premtuara.

3. Në raste të veçanta, kur çmohet e dobishme për arritjen e qëllimit të plotë të dënimit penal, gjykata, pas vlerësimit të arsyeshëm rreth raportit ndërmjet vlerës dhe sasisë së sendeve objekt i veprës penale me vlerën e mjediseve ku ruhen ato si dhe, faktit nëse këto mjedise përdoren zakonisht me këtë qëllim, vendos edhe konfiskimin e mjediseve ku mbahen sendet objekt i veprës penale të përmendura në dispozitat e këtij kreu.

4. Për veprat penale të lehta të parashikuara nën 561, paragrafi i parë dhe i dytë, 571, 572, 573, 574 dhe 575, paragrafi i parë dhe i dytë kur çmohet e arsyeshme, gjykata mund të vendosë dhënien e jo më pak se sa dy dënimeve plotësuese në vend të dënimit kryesor.

### **Neni 582**

#### **Zbatimi i dispozitave, konkurrimi i veprave dhe bashkëpunimi**

1. Nëse mënyrat e kryerjes së veprave penale të parashikuara që kanë bërë të mundur kryerjen e ndonjërës prej tyre, përbëjnë vepra penale më vete, atëherë ato konkurrojnë me veprën penale të cilës i kanë shërbyer për të sjellë apo tentuar pasojën.

2. Nëse për kryerjen e ndonjërës prej veprave penale të parashikuara në këtë kre, autorit të posaçëm i është dashur të bashkëpunojë me një person tjetër, pavarësisht cilësive të posaçme të këtij të fundit, ata do të përgjigjen për kryerjen në bashkëpunim të veprës penale të parashikuar në këtë kre, apo çfarëdolloj vepre penale që konkurron me to.

## **KREU II**

### **VEPRAT PENALE KUNDËR REGJIMIT JURIDIK TË TOKËS DHE TË NDËRTIMEVE**

### **Neni 583**

#### **Autorizimi apo leja e paligjshme**

Per sa lidhet me dispozitat e ketij seksioni, do të vleresohet te jetë e paligjshme, cdo sjellje, autorizim i kerkuar, leje per ushtrim te veprimtarive te permendura edhe kur kryhet sipas një autorizimi të lëshuar nga një autoritet kompetent i një shteti, nëse një autorizim i tillë është marrë me mashtrim ose me korrupsion, zhvatje ose detyrim, ose nëse një autorizim i tillë është në shkelje të dukshme të kërkesave ligjore thelbësore përkatëse, apo ne kapercim te kushteve te atij autorizimi.

### **Neni 584**

#### **Shpërdorimi i tokës**

Shpërdorimi i tokës në kundërshtim me destinacionin e saj përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë.

### **Neni 585**

#### **Pushtimi i tokës**

1. Pushtimi i tokës përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

2. Po kjo vepër, e kryer në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, zonat e mbrojtura ose zonat e rëndësisë kombëtare të trashëgimisë kulturore, dënohet me gjobë ose me burgim nga dy deri në katër vjet.

### **Neni 586**

#### **Dëmtimi i tokës dhe fondit pyjor**

1. Shkatërrimi apo dëmtimi me dashje me zjarr, me pasoja të rënda materiale, i fondit pyjor, i fidanishtes pyjore, i grumbullit pyjor ose i çdo njësie të ngjashme me to, dënohet me burgim nga katër deri në tetë vjet.

2. Shkaktimi i zjarrit në sipërfaqe fondi pyjor apo kullotash që synojnë të ndryshojnë destinacionin e tokës për qëllime ndërtimore, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

3. Kryerja e akteve të tjera të dhunshme, për të ndryshuar destinacionin e përdorimit të tokës ose për të siguruar një përfitim të padrejtë për vete ose për të tretë, dënohet me burgim deri në katër vjet.

4. Kur zjarri shkaktohet në një kohë kur kushtet e motit ose të terrenit rrisin ndjeshëm rrezikun e përhapjes së tij, apo kur vendoset pranë qendrave ose vendeve të banuara, dënimi shtohet deri në një të tretën e tij.

5. Nëse nga kryerja e veprave penale të parashikuara në këtë dispozitë, do të krijohet rrezik për dëmtimin serioz të shëndetit të njerëzve, ose rezultojnë vdekje apo dëmtime të shëndetit të tyre, autori do të përgjigjet edhe në bazë të dispozitës përkatëse që parashikon veprën e kryer.

6. Në të gjitha rastet, gjykata vendos që klasifikimi i tokës në zonat e prekura nga zjarri në pyje nuk mund të ndryshohet brenda një periudhe deri në tridhjetë vjet. Gjykata mund të vendosë kufizime ose ndalime të shfrytëzimeve që po kryheshin në zonat e prekura nga zjarri, si dhe të ndërhyrjeve për administrimin e lëndës drusore të djegur nga zjarri.

### **Neni 587**

#### **Ndërtimi i paligjshëm**

1. Ndërtimi i kryer pa leje ose në kushtet e një lejeje të shfuqizuar në tokën në pronësi të vet, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj.

2. Po kjo vepër, e kryer për plotësimin e nevojave për strehim, dënohet me gjobë.

3. Po kjo vepër, e kryer në tokën publike ose shtetërore apo në tokën e tjetrit, dënohet me burgim deri në tre vjet.

4. Po kjo vepër, e kryer në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, zonat e mbrojtura ose zonat e rëndësisë kombëtare të trashëgimisë kulturore, dënohet me gjobë ose me burgim nga dy deri në pesë vjet.

5. Për qëllim të këtij kreu edhe ndërtimi shtesë përmbi lejen e dhënë nga organi kompetent apo, ndërtimi pa leje që ngrihet përmbi struktura mbi tokë, vlerësohet si ndërtim i paligjshëm.

6. Ndërtimet pa leje sipas parashikimeve të paragrafit të tretë dhe të katërt të këtij neni i nënshtrohen konfiskimit.

## **Neni 588**

### **Favorizimi i ndërtimeve pa leje**

1. Kryerja e veprimeve për të favorizuar instrumentet e planifikimit, projektet e urbanizimit, ndarjen në parcela, rindarje në parcela, ndërtimin ose kryerjen e punimeve ose dhënien e licencave në kundërshtim me legjislacionin në fushën e rregullimit të territorit, ose fshehja e shkeljeve të këtij legjislacioni gjatë kryerjes së inspektimeve ose moskryerja e inspektimeve të detyrueshme, nga personi që kryen një detyrë shtetërore ose shërbim publik, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

2. Dhënia e vendimeve ose dhënia e votës në favor të miratimit të instrumenteve të planifikimit, urbanizimit, ndarjes në parcela, rindarjes në parcela, projekteve të ndërtimit ose të ndërtimit ose dhënien e licencave të përmendura në paragrafin më lart, duke qenë në dijeni për paligjshmërinë e këtyre veprimeve, nga personi që kryen një detyrë shtetërore ose një shërbim publik, i vetëm ose si anëtar i një organi kolegjal, dënohet me burgim deri në tre vjet.

## **Neni 589**

### **Dhënia e ndihmës për ndërtim të paligjshëm**

Cilido që ofron dhe kryen shërbime sipërmarrjeje, mbikëqyrjeje, zbatim punimesh në një ndërtim që dihet se është i paligjshëm, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

## **Neni 590**

### **Projektimi, mbikëqyrja, zbatimi ose kolaudimi i paligjshëm i ndërtimeve**

1. Projektimi, mbikëqyrja, zbatimi ose kolaudimi i punimeve të ndërtimit në kundërshtim me ligjin, dokumentet e planifikimit, standardet profesionale në fuqi ose në kundërshtim me lejen e zhvillimit ose të ndërtimit dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

2. Nxitja ose detyrimi i projektuesit, mbikëqyrësit, zbatuesit ose kolauduesit të punimeve të ndërtimit për të shkelur rregullat që garantojnë kryerjen e ndërtimeve në përputhje me ligjin, dokumentet e planifikimit, standardet profesionale në fuqi ose në kundërshtim me lejen e zhvillimit ose të ndërtimit, sipas paragrafit të parë të këtij neni, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

3. Nëse nga kryerja e veprave penale të parashikuara në këtë dispozitë, do të vijnë pasoja të rënda materiale, krijohet rrezik apo rezultojnë dëmtime të shëndetit apo jetës së njerëzve, autori do të përgjigjet edhe në bazë të dispozitës përkatëse që parashikon veprën e kryer në varësi të formës së fajit të shfaqur prej tij.

## **Neni 591**

### **Moskryerja e detyrave nga zyrtari publik**

Lejimi i punimeve të ndërtimeve të paligjshme nga ndërtuesit, investitorët ose teknikët drejtues, në toka të destinuara për rrugë, zona të gjelbra, pasuri publike ose vende të cilëve iu është njohur ligjërisht ose administrativisht vlera e tyre e peizazhit, ekologjike, artistike, historike ose kulturore, ose që gëzojnë mbrojtje të veçantë, prej zyrtarit publik të ngarkuar me ruajtjen e tyre, dënohet me gjobë ose me burgim deri në katër vjet.

**Neni 592**  
**Rrethana të cilësuar**

Nëse ndonjëra nga veprat penale të përmendura në këtë kre, do të kryhet nën rrethanat e përmendura më poshtë, dënimi përkatës i parashikuar në secilën prej tyre, shtohet deri në një të dytën e dënimit që përmban dispozita përkatëse, kur:

- a) kur nga vepra preket një sipërfaqe me rëndësi të konsiderueshme;
- b) shkaktohen pasoja të mëdha ose serioze të erozionit në sipërfaqet e prekura;
- c) ndryshohen ndjeshëm kushtet e jetës së kafshëve ose bimëve, ose preket një hapësirë e mbrojtur natyrore;
- ç) në çdo rast, kur shkaktohet përkeqësim ose shkatërrim i rëndë i burimeve të prekura;
- d) kur autori vepron për të marrë përfitim ekonomik.

**Neni 593**  
**Dënimet plotësuese**

1. Kur vepra penale të parashikuara në këtë seksion kryhen nga cilido që ofron dhe kryen shërbime sipërmarrjeje, projektuesit, mbikëqyrësit, zbatuesit ose kolauduesit të punimeve të ndërtimit, atëherë gjykata, krahas dënimit kryesor cakton edhe dënimin plotësues heqjen e së drejtës për të ushtruar profesionin ose veprimtarinë ose çdo dënim tjetër që çmon të arsyeshëm, në përputhje me natyrën e veprës dhe veprimeve të kryera nga i dënuari, gjithmonë nëse dispozita konkrete nuk ka parashikuar ndryshe.

2. Nëse veprat penale të parashikuara në këtë seksion kryhen nga personi juridik, gjykata, krahas dënimit kryesor cakton edhe dënimin plotësues ndalimin për të përfituar ndihmë nga shteti, të hyjë në marrëdhënie kontraktore me sektorin publik ose të përfitojë lehtësira fiskale për një periudhë prej dhjetë vjetësh, bazuar në rëndësinë dhe natyrën e veprës penale të kryer, gjithmonë nëse dispozita konkrete nuk ka parashikuar ndryshe.

3. Në çdo rast gjykata vendos masën e zëvendësimit të dëmit të shkaktuar dhe, përveç sendeve që kanë shërbyer për kryerjen e veprave penale, kur ajo është kryer nga subjektet me qëllim përfitimi material apo të premtuar, vendoset konfiskimi i të ardhurave nga vepra penale apo të premtuara.

4. Në çdo rast, gjykata mund të urdhërojë prishjen e veprës dhe kthimin në gjendjen fillestare të mjedisit fizik të ndryshuar nga autori me shpenzimet e këtij të fundit, pa cenuar dëmshpërblimin që u takon personave të tretë në mirëbesim.

**Neni 594**  
**Rrethana të cilësuar**

Nëse çdonjëra nga veprat penale të këtij kreu kryhen nga personi zyrtar, dënimi ndaj tij shtohet deri në një të dytën.

**Neni 595**  
**Bashkëpunimi dhe konkurrimi i veprave penale**

1. Nëse për kryerjen e ndonjëres prej veprave penale të parashikuara në këtë kre, autorit të posaçëm i është dashur të bashkëpunojë me një person tjetër, pavarësisht cilësive të posaçme të këtij të fundit, ata do të përgjigjen për kryerjen në bashkëpunim të veprës penale të parashikuar në këtë kre, apo çfarëdolloj vepre penale që konkurron me to.

2. Nëse mënyrat e kryerjes së veprave penale të parashikuara që kanë bërë të mundur kryerjen e ndonjëres prej tyre, përbëjnë vepra penale më vete, atëherë ato konkurrojnë me veprën penale të cilës i kanë shërbyer për të sjellë apo tentuar pasojën.

## TITULLI VI

### VEPRAT PENALE KUNDËR EKONOMISË

#### KREU I

#### VEPRAT PENALE NË FUSHËN E TATIMEVE

##### **Neni 596**

##### **Përkufizime**

1. Për qëllime të këtij ligji, me togfjalëshin “evazion tatimor”, përveç sa është shënuar në ligjin e posaçëm lidhur me të, kuptohet edhe, çdo veprim i paligjshëm i mospagimit të detyrimeve tatimore duke fshehur të ardhurat publike, të fituara në mënyrë të ligjshme ose të paligjshme, prej zbulimit dhe mbledhjes nga ana e autoriteteve tatimore. Cdo procedure që shërben për pagimin e detyrimeve tatimore, afat kohor, formular, mënyrë apo procedurë të vepruari, autoritet kompetent kontrollues apo vlerësues i çështjeve fiskale, janë të përcaktuara në ligjin përkatës që rregullon procedurën tatimore.

2. Për qëllime të këtij ligji me togfjalëshin, “e ardhur publike” kuptohet pjesa e vlerës së pasurisë që sipas tarifës përkatëse të caktuar me ligj, duhet t’i paguhet shtetit.

3. Për qëllime të këtij ligji me togfjalëshin “e ardhur e fituar në mënyrë të paligjshme” kuptohet pasuria apo vlera që kërkohet të futet në qarkullimin ekonomik apo të regjistrohet pa qenë e deklaruar më parë për efekte tatimore dhe, pavarësisht burimit prej nga vjen ajo.

4. Me detyrime tatimore do të pranohen detyrime të çdo lloji, përfshirë kontributet, taksat kombëtare, lokale, detyrimet që paguhen në doganë, akcizat dhe, çdo taksë tjetër e caktuar me ligj. Avantazhet tatimore përfshijnë lehtësitë tatimore të përdorura në praktikën fiskale.

5. Me togfjalëshin “zbulim vullnetar të detyrimeve”, kuptohet nisma individuale e autorit të veprës penale, përfshirë edhe personin juridik, për të raportuar vullnetarisht gjendjen e evazionit tatimor që ka shkaktuar sjellja e tij e mëparshme përkundër detyrimeve tatimore, e cila kryhet përpara sesa evazoni të jetë zbuluar nga autoriteti tatimor ose të ketë filluar ndaj subjektit qoftë edhe kontrolli administrativ rutinë i veprimtarisë së tij ekonomike. Programi i zbulimit vullnetar të detyrimeve përfundon me mosfillimin e procedimit ndaj subjektit deklarues vullnetar, ose kur ai ka filluar, me pushimin e tij, por nuk shuan të drejtën e autoritetit tatimor për të vendosur dënimet përkatëse për subjektin e tatueshëm. I njëjti rregull do të vlejë edhe në rastin kur e drejta e autoritetit tatimor për përcaktimin e vlerësimit është parashkruar.

6. Me togfjalëshin “kur më parë është dënuar për shkelje administrative” përdorur në këtë kre, kuptohet fakti i fillimit të procedimit penal ndaj subjektit tatimor, person të tatueshëm, vetëm nëse

ndaj tij janë marrë masa administrative më parë për një shkelje tjetër të çfarëdoshme, që përfshihet në njërin prej formave të evazionit fiskal që ky Kod përmban. Shkelja e mëparshme e kryer nga subjekti i tatueshëm gjatë veprimtarisë së tij, e cila përfshihet në juridiksionin e autoritetit tatimor, është trajtuar administrativisht prej tyre dhe është vendosur rreth saj me dënimet përkatëse administrative. Për sa lidhet me efektin e përsëritjes, subjekti i tatueshëm nuk vlerësohet përsëritës i kryerjes së veprës penale në kuptim të ligjit penal.

7. Të gjitha shkeljet e kryera për herë të parë nga subjekti i tatueshëm, që sipas këtij Kodi përbëjnë evazion tatimor, vlerësohen dhe trajtohen nga autoriteti tatimor brenda kompetencës administrative të tij duke dhënë dënimet përkatëse në përputhje me ligjin për procedurat tatimore.

Autoriteti Tatimor ushtron oportunitetin për ta kërkuar ndjekjen penale ndaj një subjekti të tatueshëm që ka realizuar evazion tatimor edhe nëse ai më parë nuk ka qenë i dënuar administrativisht për ndonjë shkelje nën juridiksionin tatimor për t'u shqyrtuar, vetëm kur vlera e evazionit të konstatuar përbën evazion të konsiderueshëm. Ky rregull i paraprin zbatimit të çdo vepre penale të parashikuar në dispozitat e këtij kreu.

8. Me togfjalëshin “evazion i konsiderueshëm” përdorur në këtë kre, kuptohet rasti kur autori i veprës penale:

a) shkakton një dëm që i kalon pesë për qind të të ardhurave bruto të tatimpaguesit të realizuara në vitin e kaluar apo të parashikuara të realizohen në vitin që është kryer shkelja;

b) abuzon me autoritetin ose pozicionin e tij si zyrtar publik në Autoritetin Tatimor;

c) pavarësisht parashikimeve të paragrafit gjashtë dhe tetë “a” të këtij neni, subjekti në mënyrë të përsëritur nuk ka paguar detyrimet, ose ka nxjerrë avantazhe të padrejta tatimore duke përdorur dokumente të falsifikuara;

ç) vepron si anëtar i një grupi të formuar me qëllim kryerjen e veprimeve të përmendur në këtë paragraf ose si anëtar i një grupi të bashkëpunimit të posaçëm;

d) vlerësohet me objektivitet që rasti ka rëndësi të posaçme publike, duke u bazuar, përgjithësisht në këto elemente:

i. vlera proporcionale e evazionit në raport me të ardhurat e subjektit, xhiros së tij, madhësisë organizative, historisë së tij fiskale, apo edhe ndikimit që ndjekja penale mund të ketë përmbi punonjësit e tij;

ii. kur janë përdorur si ndërmjetës të veprimtarive tregtare ose mjeteve siguroese a garantuese, persona ose subjekte fizike apo juridike pa personalitet juridik ose pa histori biznesi të qartë;

iii. kur janë përdorur territoret ku nuk zbatohen detyrimet tatimore, kur fshehin ose vështirësojnë përcaktimin e identitetit të tatimpaguesit ose të evazorit tatimor, vështirësojnë përcaktimin e shumës së shmangur ose të pasurisë së tatimpaguesit ose të evazorit tatimor dhe kur, tatimpaguesi nuk i ka dhënë informacione organeve tatimore për transaksionet me subjekte në këto vende, edhe pas kërkesës me shkrim nga organi tatimor kompetent me qëllim për të fshehur detyrimin tatimor dhe jo për shkaqe të paqartësive të ligjit që rregullon këtë veprimtari.

9. Për sa lidhet me qëllimet e nenit 610 të këtij Kodi ( BE ), përdoren përkufizimet e mëposhtme:

(a) “Interesa financiare të BE-së” janë të gjitha të ardhurat, shpenzimet dhe asetet e mbuluara nga, të përftuara përmes apo për t'u derdhur në:

(i) buxhetin e BE-së;

(ii) buxhetet e institucioneve, organeve, zyrave dhe agjencive të BE-së, në zbatim të traktateve apo buxheteve që administrohen dhe monitorohen prej tyre, drejtpërdrejtë apo tërthorazi;

10. Pavarësisht sa është përmendur në paragrafin e gjashtë, të shtatë dhe të tetë të këtij neni, kur një rast vlerësohet nga Prokurori i Shtetit me rëndësi të posaçme publike hetimi penal fillon kryesisht, duke shkaktuar ndërprerjen e procedimit administrativ të filluar nga Autoriteti Tatimor.

#### **Neni 597**

#### **Evazioni nëpërmjet tatimit mbi vlerën e shtuar**

Krijimi i skemave mashtruese lidhur me tatimin mbi vlerën e shtuar, që zvogëlojnë detyrimin tatimor me qëllim rritjen e vlerës kreditore të rimbursueshme të tij, nëpërmjet lëshimit të faturave të falsifikuara, apo manipulimit të sistemit kontabël të llogarive, që kanë si efekt zvogelimin e buxhetit të shtetit, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet.

#### **Neni 598**

#### **Evazioni nëpërmjet transaksioneve të pakryera**

1. Paraqitja e të dhënave të pavërteta nëpërmjet faturave të falsifikuara që u takojnë transaksioneve të pakryera, marrëveshjeve apo sjelljeve mashtruese, apo manipulimit të sistemit kontabël të llogarive, të bëra me synimin e kryerjes së evazionit tatimor, dënohet me burgim nga katër deri në nëntë vjet.

2. Kur evazioni i kryer sipas paragrafit të parë është evazion i konsiderueshëm, dënimi shtohet deri në një të dytën e tij.

#### **Neni 599**

#### **Mosparaqitja e informacionit**

Mosparaqitja e informacionit në autoritetin tatimor, ose paraqitja e tij në mënyrë të pjesshme apo jo në përputhje me ligjin, që synon kryerjen e evazionit tatimor, ose të krijojë çdo avantazh fiskal të padrejtë, dënohet me gjobë ose me burgim nga një deri në katër vjet.

#### **Neni 600**

#### **Shkelje e detyrimit për mbajtjen e dokumentacionit të të dhënave tatimore**

1. Mosmbajtja e regjistrave, çdo dokumentacioni kontabël, librave si dhe informacionit financiar që i kërkohet të mbahet nga personi i tatueshëm në bazë të ligjit për procedurat tatimore, që shërbejnë si bazë për vlerësimin e drejtë tatimor, ose mbajtja e tyre në mënyrë të tillë që shqyrtimi i veprimtarisë tregtare ose gjendjes financiare të vështirësohet, ose shkatërrimi, dublimi i bilanceve dhe regjistrave kontabël, fshehja, dëmtimi në masë të madhe ose bërja e papërdorshme e tyre, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

2. Për efekt të këtij kreu, përveç sa përmendet në dispozitat e tjera të tij, veprimet e mëposhtme, vlerësohen që shërbejnë për kryerjen e evazionit fiskal:

- a) nuk përmbushet detyrimi sipas vlerësimit të drejtpërdrejtë të bazave tatimore;
- b) nuk janë regjistruar në librat e detyrueshëm veprime tregtare, akte, veprime të tjera ose në pergjithësi transaksione ekonomike ose i ka regjistruar me shifra të ndryshme nga ato të vërtetat;
- c) janë bërë shënime fiktive kontabël në dokumentacionin për mbajtjen e llogarive për qëllime tatimore.

**Neni 601**  
**Kërkesat e parregullta**

Paraqitja e qëllimshme e dokumenteve apo kërkesave të falsifikuara, ose qëllimisht të paplota, përpara autoritetit tatimor, për të mbështetur kthimin e paligjshëm të detyrimeve tatimore të paguara më parë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

**Neni 602**  
**Mosmbajtja e regjistrave**

1. Shtytja apo lejimi i qëllimtë që inspektori tatimor bën në favor të subjektit tregtar që të mos mbajë regjistrat, dokumentacionin kontabël, librat si dhe çdo informacion financiar që kërkohet të mbahet në bazë të ligjit për procedurat tatimore, ose t'i mbajë në mënyrë të tillë që vështirësojnë shqyrtimin e veprimtarisë tregtare ose gjendjes financiare të subjektit, ose shkatërrimin, fshehjen, dëmtimin në masë të madhe ose bërjen të papërdorshëm të regjistrave, dokumentacionit kontabël, librave si dhe informacionit financiar, të detyrueshëm për t'Û mbajtur nga subjektet tatimore, dënohet me burgim nga dy deri në shtatë vjet dhe, dënimin plotësues të heqjes të së drejtës për të ushtruar funksione publike sipas parashikimeve të nenit 76 të këtij Kodi.

2. Kur veprimet e mësipërme janë të nxitura apo kryhen ngaqë inspektori tatimor ka interesa materiale të subjekti tregtar, dënimi me burgim rritet deri me një të dytën e tij.

**Neni 603**  
**Prishja e shenjave të bllokimit apo pezullimit të veprimtarisë tregtare**

Prishja e shenjave dalluese të vendosura nga administrata tatimore për bllokimin apo pezullimin e veprimtarisë tregtare, ose ushtrimi i veprimtarisë tregtare pas njoftimit të vendimit të administratës tatimore për bllokimin apo pezullimin e saj, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

**Neni 604**  
**Mospagimi i detyrimeve mbi bazë vetëdeklarimi**

Mospagimi vullnetar i detyrimeve që bazohen mbi vetëdeklarimin e tyre, pjesërisht apo plotësisht, ose në afatin e caktuar në ligjin përkatës, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

**Neni 605**  
**Ndërhyrja në aparatet matëse**

Ndërhyrja në funksionimin e rregullt të pajisjeve fiskale, pajisjeve elektronike të faturimit, me qëllim mosregjistrimin e plotë të të dhënave për efekt të evazionit fiskal, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

**Neni 606**

## **Konspiracioni për të kryer evazion fiskal**

Krijimi i planeve, rrethanave apo gjetja e bashkëpunëtorëve për të kryer evazion serioz fiskal të parashikuara në këtë kre, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

### **Neni 607**

#### **Kryerja e veprës penale nga subjektet profesioniste**

Nëse ndonjëra nga veprat penale të parashikuara në këtë kre do të kryhet nga ekspertë tatimorë, avokatë, auditues ligjorë, nga personat përgjegjës për hartimin e dorëzimin e deklaratave tatimore apo këshilltarë të tjerë që ushtrojnë profesionin në fushën tatimore, vepra penale do të vlerësohet si evazion i konsiderueshëm sipas shkronjës “c” të paragrafit tetë të nenit 596 të këtij kreu dhe, dënimi për veprën përkatëse të kryer do të përmbajë edhe dënimin plotësues të heqjes deri në pesë vjet të së drejtës për të ushtruar profesionin.

### **Neni 608**

#### **Shpërdorimi i autoritetit tatimor**

1. Inspektorët e ngarkuar me mbledhjen e tatimeve, tarifave ose detyrimeve të tjera fiskale, kur dinë që subjekti tatimor nuk duhet të paguajë ose, duhet të paguajë më pak, ose duhet të paguajë më shumë sesa vlera tatimore e përcaktuar padrejtësisht prej tyre, apo nuk ndërmarrin hapat e nevojshëm për vlerësimin e rregullt të detyrimit tatimor, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet si dhe, me dënimin plotësues të heqjes të së drejtës për të ushtruar funksione publike sipas parashikimeve të nenit 76 të këtij Kodi.

2. Ndërhyrja e padrejtë, për çfarëdo qëllimi, në funksionimin normal të sistemit informatik që monitoron, administron, kontrollon veprimtarinë ekonomike të subjekteve tregtare, dënohet me burgim nga një deri në gjashtë vjet dhe me dënimin plotësues të heqjes të së drejtës për të ushtruar funksione publike sipas parashikimeve të nenit 76 të këtij Kodi.

### **Neni 609**

#### **Sekreti tatimor**

1. Zbulimi ose përdorimi i të dhënave personale ose i sekretit tregtar të një subjekti tregtar për të cilat ka marrë dizeni në cilësinë e zyrtarit publik gjatë:

a) një procedure administrative, një procedure auditimi ose procese gjyqësore për çështje tatimore;

b) një procedimi penal që lidhet me një veprë penale në fushën e tatimeve;

c) përpunimit të të dhënave, njoftimit të vlerësimit tatimor, sipas parashikimeve të ligjit për procedurat tatimore,

dënohet me gjobë ose burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

2. Të dhënat personale ose sekretet tregtare, do të vlerësohen se janë të ditura nga subjekti, nëse ato rezultojnë nga të dhëna ku autori ka akses dhe për të cilat ka autorizim për t'u njohur me to. Informacionet në lidhje me persona të identifikuar ose të identifikueshëm të vdekur si dhe ato që

kanë të bëjnë me shoqata me ose pa zotësi juridike apo pasuri, barazohen me të dhënat personale të tjetrit.

3. Në kuptim të këtij neni, me zyrtarin publik do të barazohen:

- a) edhe personat të cilëve iu janë besuar funksione të posaçme të shërbimit publik;
- b) ekspertët zyrtarë të njohur si konsulentë tatimore apo kontabël.

4. Në rastin kur vepra e parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni kryhet për shkak të interesit apo favorizimit të një konkurrenti të subjektit tregtar viktimë, dënimi me burgim shtohet deri në një të dytën e tij.

## **Neni 610**

### **Evazioni kundër interesave financiare të Bashkimit Evropian**

1. Nëse secila nga mënyrat me poshte të përmendura si forma të kryerjes të veprave penale të drejtohet kundër financave të Bashkimit Evropian, e shton dënimin deri në një të tretën.

(a) në lidhje me shpenzimet që nuk lidhen me prokurimin, çdo veprim ose mosveprim në lidhje me:

(i) përdorimi ose paraqitja e deklaratave ose dokumenteve të rreme, të pasakta ose jo të plota, që ka si efekt shpërdorimi ose mbajtja e gabuar e fondeve ose aseteve nga buxheti i BE ose buxhetet e menaxhuara nga ose në emër të tij;

(ii) moszbulimi i informacionit në kundërshtim me një detyrim specifik, me të njëjtin efekt; ose

(iii) keqpërdorimi i këtyre fondeve ose aseteve për qëllime të ndryshme nga ato për të cilat ato janë dhënë fillimisht

(b) në lidhje me shpenzimet e lidhura me prokurimin, të paktën kur kryhen me qëllim të përfitimit të paligjshëm për autorin ose një tjetër duke shkaktuar humbje për interesat financiare të Unionit, çdo veprim ose mosveprim në lidhje me:

(i) përdorimi ose paraqitja e deklaratave ose dokumenteve të rreme, të pasakta ose të paplota, që ka si pasojë shpërdorimin ose mbajtjen e gabuar të fondeve ose aseteve nga buxheti i BE ose buxhetet e menaxhuara nga ose në emër të tij;

(ii) moszbulimi i informacionit në kundërshtim me një detyrim specifik, me të njëjtin efekt; ose

(iii) keqpërdorimi i fondeve ose aktiveve të tilla për qëllime të ndryshme nga ato për të cilat janë dhënë fillimisht, gjë që dëmton interesat financiare të BE;

(c) në lidhje me të ardhurat e ndryshme nga të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta të TVSH-së të përmendura në pikën (d), çdo veprim ose mosveprim që lidhet me:

(i) përdorimi ose paraqitja e deklaratave ose dokumenteve të rreme, të pasakta ose të paplota, që ka si efekt zvogëlimin e paligjshëm të burimeve të buxhetit të BE ose buxheteve të menaxhuara nga ose në emër të tij;

(ii) moszbulimi i informacionit në kundërshtim me një detyrim specifik, me të njëjtin efekt; ose

(iii) aplikimi i gabuar i një përfitimi të përfituar ligjshëm, me të njëjtin efekt;

(d) në lidhje me të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta të TVSH-së, çdo veprim ose mosveprim i kryer në skemat mashtruese ndërkufitare në lidhje me:

(i) përdorimi ose paraqitja e deklaratave ose dokumenteve të rreme, të pasakta ose jo të plota në lidhje me TVSH-në, që ka si efekt pakësimin e burimeve të buxhetit të BE;

(ii) moszbulimi i informacionit të lidhur me TVSH-në në kundërshtim me një detyrim specifik, me të njëjtin efekt; ose

(iii) paraqitjen e deklaratave të sakta në lidhje me TVSH-në për qëllime të maskimit me mashtrim të mospagesës ose krijimit të gabuar të të drejtave për rimbursimin e TVSH-së.

2. Nëse evazoni serioz kryhet në cdonjerën nga format e parashikuara në këto dispozite duke përdorur një shtet tjetër për të fshehur tatimin, që sjell si efekt cenimin e financave të BE, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet.

### **Neni 611**

#### **Kryerja e veprës nga personi juridik**

1. Nëse një person juridik ka kryer ndonjë prej veprave penale të parashikuara në këtë kre, dënimi me gjobë do të jetë:

- a) mbi pesëfishin e vlerës së evazionit serioz fiskal;
- b) deri në pesëfishin e vlerës së evazionit për çdo vepër tjetër të parashikuar në këtë kre;
- c) nga dyfishi deri në trefishin e vlerës së evazionit të tentuar për t'u kryer;
- ç) për të gjitha rastet e tjera kur vepra penale nuk ka sjellë dëm material apo përfitim të tillë, zbatohen rregullat e përcaktuara në nenin 123 të këtij Kodi.

2. Në rastet veçanërisht të rënda, kur pasojat nga evazoni tatimor janë të larta, të përsëritura, të kryera me pjesëmarrjen e profesionistëve të veprimtarisë apo të subjekteve të krimit të organizuar, kur lidhjet e evazionit me territoret që kanë vështirësuar apo pamundësuar marrjen e informacionit të duhur tatimor me gjithë kërkesat e Autoritetit Tatimor, gjykata vendos mbylljen e veprimtarisë së personit juridik.

3. Për veprat penale të lehta të parashikuara në dispozitat e këtij kreu, kur çmohet e arsyeshme dhe në përputhje me natyrën e veprës penale të kryer, gjykata mund të vendosë ndaj personit juridik dhënien e jo më pak sesa dy dënimeve plotësuese në vend të dënimit kryesor, si: caktimin e një mbikëqyrësi ligjor, detyrimin që brenda tre muajve të marrë masat e përshtatshme organizative për të mos lejuar kryerjen e veprave penale, të mos marrë ndihmë nga shteti apo të mos hyjë në marrëdhënie me sektorin publik dhe, publikimin e vendimit gjyqësor.

### **Neni 612**

#### **Dënimet dhe masat plotësuese**

1. Nëse veprat penale të parashikuara në këtë seksion kryhen nga zyrtari publik, atëherë gjykata, krahas dënimit kryesor cakton edhe dënimin plotësues, heqjen e së drejtës për të ushtruar një funksion publik në përputhje me nenin 76 të Kodit Penal.

2. Në çdo rast gjykata vendos masën e zëvendësimit të dëmit të shkaktuar dhe, përveç sendeve që kanë shërbyer për kryerjen e veprave penale, kur ajo është kryer nga subjektet me qëllim përfitimi material apo të premtuar, vendoset konfiskimi i të ardhurave nga vepra penale apo të premtuara si dhe, publikimi i vendimit gjyqësor.

3. Gjkata vendos edhe masën penale të regjistrimit dhe shkëmbimit të të dhënave që përmbajnë të dhëna rreth evazorit lidhur me rastet kur janë përdorur territoret ku nuk zbatohen detyrimet tatimore për të kryer evazionin tatimor, me qëllim krijimin e rrethanave të përshtatshme për njohjen dhe parandalimin e kryerjes së krimeve me natyrë edhe ndërkombëtare.

4. Për të njëjtat arsye të përmendura në paragrafin e tretë të nenit 611, gjykata mund të japë ndaj autorit të veprës penale dy apo më shumë dënime plotësuese në vend të dënimit kryesor.

**Neni 613**  
**Konkurrimi i veprave dhe bashkëpunimi**

1. Për qëllim të këtij kreu, falsifikimi i dokumenteve të përmendura në dispozitat e tij nëpërmjet të cilave është kryer evazioni tatimor, përbën veprë penale më vete që konkurren me veprën penale të evazionit dhe, procedohet më vete kryesisht jo sipas procedurës së parashikuar në nenin 596, paragrafi 6 të këtij Kodi.

2. Nëse për kryerjen e ndonjëres prej veprave penale të parashikuara në këtë kre, autorit të posaçëm i është dashur të bashkëpunojë me një person tjetër, pavarësisht cilësive të posaçme të këtij të fundit, ata do të përgjigjen për kryerjen në bashkëpunim të veprës penale të parashikuar në këtë kre, apo çfarëdo veprë penale që konkurren me to.

**KREU II**  
**VEPRAT PENALE NË FUSHËN E DOGANAVE**

**Neni 614**  
**Përkufizime dhe oportuniteti i autoritetit doganor**

1. Për qëllime të këtij Kreu, termat “territor doganor”, “autoritet doganor”, “rregjim doganor”, “rregjim i posaçëm”, “magazinim i përkohshëm”, “mbikëqyrje doganore”, “kontroll doganor”, “përdorim i veçantë”, “detyrime importi”, “detyrime eksporti” kanë të njëjtin kuptim si në Kodin Doganor.

2. Për qëllime të këtij Kreu, togfjalëshi “hedhje për përdorim në territor të produkteve të akcizës”, ka të njëjtin kuptim si në legjislacionin për akcizën.

3. Shkelja e kryer për herë të parë nga subjekti gjatë veprimtarisë së tij përfshihet në juridiksionin e autoritetit doganor, trajtohet administrativisht prej tyre duke zbatuar dënimet përkatëse administrative. Për sa lidhet me efektin e përsëritjes, në këto raste subjekti nuk vlerësohet përsëritës i kryerjes së veprës penale në kuptim të ligjit penal.

4. Autoriteti Doganor ushtron oportunitetin për ta kërkuar ndjekjen penale ndaj një subjekti kontrabandues që ka kryer një shkelje doganore, edhe nëse ai më parë nuk ka qenë i dënuar administrativisht për ndonjë shkelje nën juridiksionin doganor për t’u shqyrtuar, vetëm kur vlera e tarifës doganore të shmangur përbën vlerë të konsiderueshme. Ky rregull i paraprin zbatimin të çdo veprë penale të parashikuar në dispozitat e këtij kreu.

5. Me togfjalëshin “tarifë e shmangur në vlerë të konsiderueshme” përdorur në dispozitat e këtij kreu, kuptohet rasti kur autori i veprës penale:

a) llogarit në mënyrë të pasaktë qëllimisht detyrimet në një shkallë të gjerë ose nxjerr avantazhe të padrejta doganore në vlerë mbi dhjetë milionë lekë;

b) abuzon me autoritetin ose pozicionin e tij si zyrtar publik në Autoritetin Doganor;

c) pavarësisht parashikimeve të paragrafit të parë të këtij neni, subjekti në mënyrë të përsëritur nuk ka paguar detyrimet, ose ka nxjerrë avantazhe të padrejta doganore duke përdorur dokumente të falsifikuara;

ç) vepron si anëtar i një grupi të formuar me qëllim kryerjen e veprimeve kontrabande ose si anëtar i një grupi të bashkëpunimit të posaçëm.

d) vlerësohet me objektivitet që rasti ka rëndësi të posaçme publike, përgjithësisht në këto elemente:

- i. vlera proporcionale e shmangies doganore në raport me të ardhurat e subjektit, xhiros së tij, madhësisë organizative, historisë së tij të biznesit;
- ii. kur vlerësohet objektivisht e pamundur të verifikohet në tregun e brendshëm sasia apo vlera e mallit të kaluar pa paguar detyrimet doganore;
- iii. në rastin kur lloji i mallit të kaluar kontrabandë është i rrezikshëm për jetën apo shëndetin e njerëzve.

6. Pavarësisht sa është përmendur në paragrafët e mësipërm të këtij neni, kur një rast vlerësohet nga Prokurori i Shtetit me rëndësi të posaçme publike hetimi penal fillon kryesisht dhe, shkakton ndërprerjen e procedimit administrativ të filluar nga Autoriteti Doganor.

7. Per sa lidhet me dispozitat e këtij kreu, do të vlerësohet te jetë e paligjshme, cdo sjellje, autorizim i kërkuar, leje për ushtrim të veprimtarive të përmendura edhe kur kryhet sipas një autorizimi të lëshuar nga një autoritet kompetent i një shteti, nëse një autorizim i tillë është marrë me mashtrim ose me korrupsion, zhvatje ose detyrim, ose nëse një autorizim i tillë është në shkelje të dukshme të kërkesave ligjore thelbësore përkatëse, apo në kapercim të kushteve të atij autorizimi.

## **Neni 615**

### **Kontrabanda**

1. Hyrja apo dalja e mallrave, në ose nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, pa i paraqitur ato tek autoritetet doganore, kryer për t'iu shmangur kontrollit dhe/ose mbikëqyrjes doganore përbën kontrabandë dhe dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet dhe konfiskimin e mallit kontrabandë

2. Kur vepra penale e parashikuar në paragrafin e parë është bërë me mallra të ndaluara që qarkullojnë për shkak të kufizimeve ligjore, dënohet me burgim nga dy deri në shtatë vjet dhe konfiskimin e mallit kontrabandë dhe mjetit të transportit të tyre.

## **Neni 616**

### **Kontrabanda në një regjim doganor**

1. Vendosja e mallrave në magazinimin e përkohshëm, në një regjim doganor ose riekспорт pas përfundimit të magazinimit të përkohshëm, nëpërmjet:

- a) fshehjes së plotë ose të pjesshme;
- b) deklarimit të rremë të llojit, vlerës dhe origjinës së mallrave, duke paraqitur fatura, certifikata ose çdo lloji tjetër dokumenti të rremë, të pasaktë, të paplotë ose të pazbatueshëm;
- c) paraqitjes së një deklarate të rreme ose kryerjes së çdo veprimi, që ka për qëllim shmangien nga detyrimet e importit apo eksportit, përfitimim pjesor a tërësor të një rimbursimi apo reduktimi

nga tarifatat doganore, taksat, tatimet, akciza ose të një avantazhi të çfarëdoshëm që lidhet me mallrat,

përbën kontrabandë dhe dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet dhe, konfiskimin e mallit kontrabandë dhe mjetit të transportit të tyre.

2. Nëse vepra penale e parashikuar nga paragrafi i parë i këtij neni, kryhet për mallra të ndaluara ose të kufizuara për të qarkulluar në Republikën e Shqipërisë, dënohet me burgim nga dy deri në tetë vjet dhe konfiskimin e mallit kontrabandë dhe mjetit të transportit të tyre.

3. Nëse vepra penale e parashikuar nga paragrafi i parë i këtij neni, kryhet për mallra për të cilat paguhet akcizë, dënohet me burgim nga një deri në gjashtë vjet dhe konfiskimin e mallit kontrabandë dhe mjetit të transportit të tyre.

4. Nëse vepra penale e parashikuar nga paragrafi i parë i këtij neni, kryhet për mallra për të cilat janë pjesë pasurisë kulturore, dënohet me burgim nga dy deri në shtatë vjet dhe konfiskimin e mallit kontrabandë dhe mjetit të transportit të tyre.

### **Neni 617**

#### **Mosrespektimi i transitit**

Mosrespektimi nga mbajtësi i regjimit të transitit i detyrimit për paraqitjen e mallrave të paprekura në zyrën doganore të destinacionit dhe në përputhje me masat e ndërmarra nga autoritetet doganore për të siguruar identifikimin e tyre, dënohet me gjobe ose me burgim deri në katër vjet.

### **Neni 618**

#### **Qarkullim i mallit nën rrëgjim**

Çlirimi për qarkullim të lirë i mallrave të vendosura nën regjimin e përdorimit të veçantë përfundimtar (end-use) me përjashtim nga detyrimi ose me një reduktim të nivelit të detyrimit, në kundërshtim me kushtin që rregullon përdorimin të veçantë përfundimtar (end-use) dhe pa paguar detyrimet e importit, përbën kontrabandë dhe dënohet me gjobe ose me burgim deri në katër vjet.

### **Neni 619**

#### **Largimi i mallrave nga zonat doganore pa paguar detyrimet**

Largimi i mallrave nga zonat doganore pa lejen e organeve doganore dhe pa paguar detyrimet që duhen paguar, me përjashtim të rasteve të përjashtimit nga detyrimi me dhënien e garancive, siç parashikohet nga legjislacioni doganor, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim nga tre muaj deri në dy vjet.

### **Neni 620**

#### **Kontrabanda nga kapiteni, piloti ose ekuipazhi**

Transportimi i mallrave pa manifest, ose refuzimi i paraqitjes së manifestit dhe dokumenteve përkatëse shoqëruese të tyre, ngarkimi, shkarkimi ose transportimi i mallrave, udhëtarëve dhe bagazheve të tyre pa lejen e autoriteteve doganore, qëndrimi në vende ku nuk ka zyrë doganore

ose ndalimi në afërsi të portit ose aeroportit pa lejen e autoriteteve doganore, shkarkimi ose transportimi i mallrave në kundërshtim me legjislacionin doganor, mungesa në bordin e mjetit të mallrave që duhet të gjendeshin aty, në bazë të manifestit dhe dokumenteve të tjera doganore, e kryer kjo, sipas rastit, nga kapiteni, piloti ose ekuipazhi, dënohet me burgim nga dy deri në shtatë vjet.

### **Neni 621**

#### **Manipulimi i shenjave të sigurisë së autoriteteve doganore**

1. Thyerja apo heqja e vulës doganore, zëvendësimi, ndërrimi ose falsifikimi i shenjave e tjera të sigurisë të vendosura nga autoritetet doganore për qëllime mbikëqyrjeje, kontrolli ose, për pezullimin e veprimtarisë tregtare në mjediset ekonomike apo të vendosura mbi mjetin e transportit apo mallra, ose falsifikimi në çfarëdo mënyre i numrit të identifikimit të mjetit të transportit, të bëra me qëllim shmangien nga kontrolli doganor, dënohet me gjobë ose me burgim nga dy deri në katër vjet.

2. Në rastin kur kjo veprë penale kryhet nga anëtarët e organeve drejtuese të personit juridik ose, nga administratori i shoqërisë tregtare, dënimi i dhënë në paragrafin një të këtij neni, shoqërohet me dënimin plotësues të heqjes së të drejtës për të ushtruar detyra drejtuese pranë personave juridikë publikë ose privatë.

### **Neni 622**

#### **Perdorimi dhe transportimi i mallrave kontrabandë**

1. Kushdo që tregton, tjetërson, transporton, ruan, depoziton, mban ose përpunon mallra për të cilat ka dijeni që janë kontrabandë, ose hedh për konsum në territor ose shkatërron mallra të vendosura në magazinim të përkohshëm, në një regjim të posaçëm të ndryshëm nga transiti dhe, përdorimi i veçantë përfundimtar (end-use), me pezullim të plotë ose të pjesshëm nga detyrimet importit, nëpërmjet shmangies nga kontrolli dhe/ose mbikëqyrja doganore apo në kundërshtim me kushtet që rregullojnë regjimin doganor përkatës, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet.

2. Hedhja për konsum në territor e produkteve të akcizës, pa paguar detyrimet e akcizës përbën kontrabandë dhe dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

3. Kur kjo veprë penale kryhet nga nëpunës të administratës publike ose, nga punonjës të doganave apo prej atyre që, për shkak të llojit të punës që kryejnë janë të lidhur me veprimtarinë doganore, qofshin edhe subjekte private, dënimi me burgim shtohet me një të tretën dhe, caktohet dënimi plotësues i ndalimit të së drejtës për të ushtruar funksione publike.

4. Në çdo rast, gjykata cakton dënimin plotësues të konfiskimit të çdo lloj pasurie që rrjedh ose fitohet drejtpërdrejt ose tërthorazi nga kryerja e veprës penale, apo dhe i shpërblimeve, të dhëna ose të premtuara, për kryerjen e veprës penale e mjeteve të transportit.

### **Neni 623**

#### **Nxjerrja nga territori i mallrave**

Nxjerrja nga territori i mallrave të vendosura në magazinim të përkohshëm, në një regjim të posaçëm të ndryshëm nga transiti dhe, përdorimi i veçantë përfundimtar (end-use), me përjashtim

të plotë ose të pjesshëm nga detyrimet e eksportit, nëpërmjet shmangies nga kontrolli dhe/ose mbikëqyrja doganore, përbën kontrabandë dhe dënohet me burgim nga një deri në katër vjet.

#### **Neni 624**

#### **Mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe i sendeve me vlerë**

Mosdeklarimi, në hyrje ose dalje nga territori i Republikës së Shqipërisë, i shumëve në të holla, i çdo lloj instrumenti të negociushe të mbajtesit, metaleve ose gurëve të çmuar si dhe, i sendeve me vlerë dhe objekteve antikë, përtej vlerës së lejuar nga ligji për mosdeklarimin, kur burimi i tyre është i pajustificuar ligjërisht, nëse nuk përbën veprë penale më të rëndë, përbën kundërvajtje penale dhe, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre muaj.

#### **Neni 625**

#### **Kryerja e veprës nga personi juridik**

1. Nëse një person juridik ka kryer ndonjëherë prej veprave penale të parashikuara në këtë kre, dënimi me gjobë do të jetë:

a) mbi pesëfishin e vlerës së papaguar të detyrimit doganor, kur është kryer vepra penale e parashikuar në nenet 609, 610 e 615 të këtij Kodi ;

b) deri në pesëfishin e vlerës së papaguar të detyrimit doganor, kur është kryer vepra penale e parashikuar në nenet 617, 618, 619 të këtij Kodi ;

c) nga dyfishi deri në trefishin e vlerës së papaguar të detyrimit doganor, kur është kryer vepra penale e parashikuar në nenet 614, 616 dhe 617 të këtij Kodi ;

ç) për të gjithë rastet e tjere kur vepra penale nuk ka sjelle dëm material apo përfitim të tillë, zbatohen rregullat e percaktuara në nenin 123 të këtij Kodi.

2. Në rastet vecanerisht të rënda, kur pasojat nga shmangia e detyrimeve doganore janë të larta, të perseritura, të kryera në konkurrencë të krimeve të rënda duke shfrytëzuar importin apo eksportin e mallrave të lejuar, apo prej subjekteve të krimit të organizuar, gjykata vendos mbylljen e veprimtarisë së personit juridik.

3. Për veprat penale të lehta të parashikuara në dispozitat e këtij kreu kur cmohet e arsyeshme dhe e përputhur me natyrën e veprës penale të kryer, gjykata mund të vendosë ndaj personit juridik dënimin e jo me pak se sa dy denimeve plotësuese në vend të dënitimit kryesor si, caktimi i një mbikqyersi ligjor, detyrimin që brenda 3 muajve të marrë masat e pershtateshme organizative për të mos lejuar kryerjen e veprave penale, të mos marrë ndihmë nga shteti apo të mos hyjë në mardhenije me sektorin publik dhe, publikimin e vendimit gjyqsor.

#### **Neni 626**

#### **Dënimet dhe masat plotësuese**

1. Nëse veprat penale të parashikuara në këtë seksion kryhen nga zyrtari publik, atëherë gjykata, krahas dënitimit kryesor cakton edhe dënimin plotësues, heqjen e së drejtës për të ushtruar një funksion publik në përputhje me nenin 76 të Kodit Penal.

2. Në çdo rast gjykata vendos masën e zëvendësimit të dëmit të shkaktuar dhe, përveç sendeve që shmangen nga detyrimi doganor për të paguar, apo ato që kanë shërbyer për transportimin dhe kryerjen e veprave penale, kur ajo është kryer nga subjektet me qëllim përfitimi material apo të

premtuar, vendoset konfiskimi i te ardhurave nga vepra penale apo te premtuara si dhe, publikimi i vendimit gjyqsor.

3. Gjykata vendos edhe masen penale te rregjistrimit dhe shkembimit të të dhenave qe permbajnë të dhena rreth subjektit lidhur me rastet kur vepra penale ka rendesi per njohjen dhe parandalimin e kryerjes se krimeve me natyre edhe nderkombetare.

4. Për të njëjtat arsye te permenduara ne paragrafin 3 të nenit 625 të këtij Kodi, gjykata mund te jape ndaj autorit te veprës penale dy apo më shumë denime plotesuese ne vend të dënimit kryesor.

### **Neni 627**

#### **Konkurrimi i veprave dhe bashkepunimi**

1. Për qëllim të këtij kreu, fallsifikimi i dokumenteve te permendur ne dispozitat e tij nepermjet te cilave është kryer shmangia doganore, përbën vepër penale më vete qe konkurren me veprën penale të kontrabandes dhe, procedohet me vehte kryesisht jo sipas procedures se parashikuar ne nenin 614, paragrafi 4 të ketij Kodi.

2. Nese per kryerjen e ndonjeres prej veprave penale te parashikuara në këtë kre, autorit te poscem i është dashur te bashkepuoje me person tjetër, pavaresisht cilesive te posaçme të këtij te fundit, ata do të përgjigjet per kryerjen ne bashkepunim te veprës penalee te parashikuar në këtë kre, apo cfardolloj vepre penale qe konkuron me to.

### **KREU III**

#### **VEPRAT PENALE TË KRYERA NË SHOQËRITË TREGTARE DHE KUNDËR PUNONJËSVE**

### **SEKSIONI I**

#### **VEPRAT PENALE NË SHOQËRITË TREGTARE DHE KONKURRENCA E PALIGJSHME**

### **Neni 628**

#### **Oportuniteti i autoritetit publik dhe shkeljet administrative**

1. Autoriteti publik i fushes përkatëse qe rregullon dhe mbikqyr veprimtarine ekonomike te subjekteve tregtare, per sa lidhet me nenet 630, 631, 636, 637, 638, 634, 894, 838 dhe 899 të këtij ligji duhet te vleresoje rendesine e shkeljes, dobishmerine e trajtimit administrativ te saj në përputhje me kompetencen sipas ligjit duke ndjekur rregullin qe, çdo shkelje e pare e kryer ne fushen e veprimtarise se subjektit tregtar te atilla sic permenden ne keto dispozita, do të trajtohet administrativisht, perveçse se kur:

- a) vleresohet me objektivitet qe perben nje rast me rendesi te posaçme publike ;
- b) është kryer me bashkepunimin e një zyrtari publik, sidomos te një profesionisti te fushes brenda te ciles është kryer shkelja ;
- c) kur vlerat e konstatuara si fitim apo premtim per tu fituar, apo dem te shkaktuar ndaj publikut apo te treteve, perbejne dem/vlera serioze ;
- ç) kur vlerat materiale proporcionale te fituara apo premtuara, ne raport me te ardhurat e subjektit, perbejne arritje te dukshme pergjate historise se biznesit te tij ;

d) kur pergjate kryerjes se ketyre veprave penale jane perdorur apo kryer vepra te tjera penale qe kane mbeshtetur, shoqeruar apo sherbejne per te fshehur te ardhurat e siguruara nga veprimtaria e paligjshme;

dh) kur eshte kryer nga persona nepermjet bashkepunitimit te vleresuar si i posacem nga ligji penal.

2. Pavarësisht sa është përmendur në paragrafin 1, shkronja “a”, kur një rast vlerësohet nga prokurori i Shtetit me rëndësi të posaçme publike hetimi penal fillon kryesisht, duke shkaktuar ndërprerjen e procedimit administrativ të filluar nga organi publik.

## **Neni 629**

### **Shkelja e barazisë në kryerjen e veprimtarive ekonomike**

Kufizimi i lëvizjes së lirë të kapitalit dhe punës në një zonë apo fushe të caktuar, ndalimi ose kufizimi i të drejtës së një personi juridik ose fizik që në një zonë apo fushe të caktuar të merret me tregtinë e mallrave dhe shërbimeve, vendosja e një shoqërie në pozitë të pafavorshme në raport me personat e tjerë juridikë dhe fizikë për kushtet e punës ose tregtimit të mallrave dhe shërbimeve, ose kufizimi i shkëmbimit të lirë të mallrave dhe shërbimeve, duke keqpërdorur pozitën ose autoritetin zyrtar ose pozitën apo ndikimin shoqëror dënohet me gjobe ose me burgim nga një deri në kater vjet.

## **Neni 630**

### **Abuzimi me pozicionin e monopolit në treg**

1. Abuzimi duke ruajtur një pozitë monopoli ose mbizotëruese në treg, nga një person juridik, nëpërmjet lidhjes së marrëveshjeve ose kryerjes së veprimeve të tilla, si pasojë e të cilave një person juridik ose konsumatorët kufizohen apo kushtëzohen në lidhje me qarkullimin e lirë të mallrave dhe shërbimeve ose aksesin e tyre në treg, ose nepermjet lidhjes së një marrëveshjeje ose kryerjes së veprimeve që krijojnë përqendrim të ndërmarrjeve për të arritur pozicion monopoli ose për të forcuar ndjeshëm një pozitë mbizotëruese të krijuar më parë që shpie në shfuqizimin ose kufizimin e konsiderueshëm dhe të përhershëm të konkurrencës në treg, dënohet me burgim nga dy deri në gjashtë vjet.

2. Per qëllim të këtij ligji, me termin “përqendrim të ndërmarrjeve, do të kuptohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit të monopolit të tregut, si rrjedhojë e bashkimit të dy ose më shumë ndërmarrjeve ose pjesë ndërmarrjesh të pavarura nga njëra-tjetra, veprim që ruan qëllimet e percaktuara në paragrafin e parë të këtij neni.

## **Neni 631**

### **Marrëveshjet për unifikim të çmimeve**

Marrëveshjet të cilat kanë objekt ose pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, veçanërisht marrëveshjet që caktojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë çmimet e blerjes ose të shitjes, kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, shërbimet, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet, ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit apo zbatojnë kushte të ndryshme për transaksione të njëjta në marrëdhëniet tregtare me palët e tjera, duke i vendosur subjektet jashtë marrëveshjes në gjendje të pafavorshme konkurrence, që çojnë në dobësimin ose

në kufizimin e vazhdueshëm të konkurrencës në treg në dëm të konsumatorit, dënohet me burgim nga një deri në katër vjet.

### **Neni 632**

#### **Konkurrenca e paligjshme nëpërmjet dhunës**

1. Kryerja e veprimeve të kanosjes ose dhunës, për të shmangur konkurrencën e ligjshme, bërë nga personi që ka interesa në zhvillimin e aktivitetit të shoqërisë tregtare ose të personit fizik, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet dhe, dënimin plotësues të heqjes së të drejtës për të marrë pjesë në gara/tenderë, për vende pune publike apo për të përfituar fonde publike.

2. Nëse sjellja e parashikuar nga paragrafi i parë i këtij neni kryhet nga administratorët apo ortakët e shoqërisë tregtare, dënohet me burgim është nga dy deri në pesë vjet dhe, dënimin plotësues të heqjes së të drejtës për të marrë pjesë në gara/tenderë, për vende pune publike apo për të përfituar fonde publike.

3. Kur veprimet e parashikuara në paragrafin e parë, drejtohen për të përfituar nga veprimtaritë të financuara plotësisht ose pjesërisht, apo në çfarëdo mënyre nga shteti ose entet publike, dënimi me burgim shtohet me një të tretën dhe dënimin plotësues të heqjes së të drejtës për të marrë pjesë në gara/tenderë, për vende pune publike apo për të përfituar fonde publike.

4. Nëse puna ose shërbimi për të cilin zhvillohet konkurrenca është përfituar nga subjekti i veprës penale, dënohet me burgim nga tre deri në gjashtë vjet dhe shoqërohet me dënimin plotësues të konfiskimit të të ardhurave apo vlerës së caktuar për punën apo shërbimin.

### **Neni 633**

#### **Konkurrenca e pandershme**

Bërja e një oferte për të shitur ose blerë të njëjtat mallra ose për t'i ofruar të njëjtin shërbim një shoqërie ose një personi fizik tregtar, vendas a të huaj, nga përfaqësuesi i një personi juridik ose fizik, duke ditur më parë se një tjetër person juridik ose fizik vendas ka arritur një marrëveshje paraprake ose është duke lidhur një kontratë me të njëjtën shoqëri ose person fizik tregtar, vendas a të huaj, për të kryer veprimtari tregtare, në mënyrë që ata të tërhiqen nga lidhja e kontratës për të cilën janë shprehur dakord apo që kontrata të lidhet me kushte më pak të favorshme për personin juridik ose fizik të parë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

### **Neni 634**

#### **Konspiracioni për të abuzuar me tregun**

Krijimi i planeve, rrethanave apo gjetja e bashkëpunëtorëve për të kryer veprat penale të parashikuara në nenet 630, 631, 632, 633, 635, 652 dhe 653 të këtij seksioni, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

### **Neni 635**

#### **Përdorimi i paligjshëm e informacionit të privilegjuar**

1. Për qëllimet e këtij ligji, marrëdhëniet e brendshme lindin kur një person zotëron informacion të brendshëm, pavaresisht cilesise, punesimit apo burimit te informacionit dhe, e përdor atë informacion duke blerë ose asgjësuar, për llogari të tij ose për llogari të një pale të tretë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, instrumente financiare rreth të cilave ka të bëjë informacioni.

2. Përdorimi i paligjshëm i informacionit të privilegjuar, nga një person i brendshëm, për të cilin publiku nuk ka dijeni dhe, që përdoret me qëllim fitimi material për vete, për një palë të tretë apo në dëm të kësaj të fundit, denohet me burgim nga një deri në katër vjet, kur kryet në njërin nga mënyrat e mëposhtme:

a) përdorimi i informacionit të brendshëm duke anuluar ose ndryshuar një urdhër në lidhje me një instrument financiar me të cilin lidhet informacioni, kur porosia është vendosur përpara se personi i interesuar të zotëronte informacionin e brendshëm, konsiderohet gjithashtu si transaksion i brendshëm ;

b) në lidhje me ankandet e lejimeve të shkarkimeve ose produkteve të tjera të ankandeve të bazuara në to, të cilat mbahen në përputhje aktet normative vendase apo nderkombetare, përdorimi i informacionit të brendshëm të përmendur në paragrafin 2, shkronja “a” të këtij neni përfshin gjithashtu paraqitjen, modifikimin ose tërheqjen e një oferte nga një person për llogari të tij ose për llogari të një pale të tretë.

c) rekomandon, në bazë të atij informacioni, që një person tjetër të blejë ose të disponojë instrumente financiare me të cilat lidhet ai informacion, ose e shtyn atë person të bëjë një blerje ose asgjësim të tillë; ose

c) rekomandon, në bazë të atij informacioni, që një person tjetër të anulojë ose të ndryshojë një urdhër në lidhje me një instrument financiar me të cilin lidhet ai informacion, ose ta shtyjë atë person të bëjë një anulim ose ndryshim të tillë.

3. Per efekt te ligjit penal, cdo rekomandim apo perdorim i informacionit te brendshem te permendura me lart, ne favor te nje te treti perben nxitje ne kryerjen e vepres penale sipas parashikimeve te nenit 53 te ketij Kodi.

4. Kur veprimtaria sipas paragrafit të dytë të këtij neni kryhet për tregtimin e mallrave apo shërbimeve, dënohet me gjobë ose me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

### **Neni 636**

#### **Tregtimi i paligjshëm i titujve**

Ndërmjetësimi i paautorizuar për blerjen ose shitjen e titujve apo çdo token digjital i tyre, kryer në kundërshtim me rregullat ligjore të vendosura në legjislacionin për tregjet e kapitalit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim nga tre muaj deri në dy vjet.

### **Neni 637**

#### **Regjistrimi i titujve në bursë në mënyrë të paautorizuar**

Regjistrimi në sistemin shumëpalësh tregtimi ose lejimi në regjistrim pranë tyre të shoqërive anonime publike ose çdo subjekti tregtar që nuk i plotëson kushtet e ligjit për tregjet e kapitalit si anëtar tregtimi i bursës, dënohet me burgim nga dy deri në katër vjet.

### **Neni 638**

#### **Krijimi i bursës pa licencë**

Krijimi ose operimi i një burse nga një person i palicensuar ose i panjohur nga Autoriteti Mbikëqyres, apo që vepron tej kushteve të përcaktuara në ligjin për tregjet e kapitali, dënohet me gjobë ose me burgim deri në katër vjet.

### **Neni 639**

#### **Paraqitja e të dhënave të rreme**

1. Paraqitja e të dhënave të rreme në dokumentet të shoqërisë, nga administratori, eksperti kontabël ose anëtarët e organeve drejtuese të shoqërisë tregtare në balance ose në komunikimet ligjore të shoqërisë drejtuar ortakëve, organeve mbikëqyrëse ose kontrolluese, apo publikut, që japin informacion të rremë ose refuzojnë dhënien e informacioneve të imponuara nga ligji, lidhur me gjendjen ekonomike, pasurore ose financiare të shoqërisë ose të grupit të cilit ajo i përket, dënohen me burgim nga një deri në pesë vjet.

2. E njëjta masë dënimi zbatohet edhe në rast se dhënia e informacioneve të rreme ka të bëjë me sende në posedim ose në administrim të shoqërisë për llogari të të tretëve.

3. Nëse dhënia e informacioneve të rreme apo çdo element objektiv i shënuar në paragrafin e parë të kësaj dispozite, përbën vepër penale më vete, atëherë konkurren bashkë me të.

### **Neni 640**

#### **Formimi fiktiv i kapitalit**

1. Formimi apo rritja në mënyrë fiktive e kapitalit të shoqërisë prej ortakëve, administratorëve apo anëtarëve të organeve drejtuese të shoqërisë tregtare, edhe pse pjesërisht, nëpërmjet shpërndarjes së aksioneve apo kuotave përtej vlerës reale të kapitalit të shoqërisë, ose nënshkrimi reciprok të aksioneve apo kuotave, ose mbivlerësimit të sendeve në natyrë apo të krediteve, ose mbivlerësimit të pasurisë së shoqërisë në rastin e transformimit, kryejnë kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë.

2. Nëse formimi fiktiv i kapitalit apo çdo element objektiv i shënuar në paragrafin e parë të kësaj dispozite, përbën vepër penale më vete, atëherë konkurren bashkë me të.

### **Neni 641**

#### **Falsifikimi i nënshkrimeve**

Falsifikimi i nënshkrimeve dhe derdhjeve apo deklarimi i rremë i derdhjeve të fondeve të shoqërisë, apo publikimi i nënshkrimeve dhe derdhjeve për persona fiktivë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet.

### **Neni 642**

#### **Dhënia e informacioneve të rreme**

Shpërndarja e një parashikimi të mundshëm financiar, të ndryshëm nga ai që përcaktohet nga ligji, nga personi anëtar i drejtorisë apo i këshillit mbikëqyrës të një emetuesi, apo lejimi ose mundësimi i paraqitjes të të dhënave të rreme ose paraqitjes së rreme të fakteve me vlerë materiale në një dokument të tillë, dënohet me burgim nga dy deri në katër vjet.

### **Neni 643**

#### **Zbulimi i të dhënave të shoqërisë**

Zbulimi te të tretet i të dhënave konfidenciale të shoqërisë tregtare që synojnë të krijojnë përfitime për vete apo epërsi për një shoqëri tregtare rivale ku subjekti ka apo kërkon të ketë interesa të çfarëdoshme, kryer nga administratori, eksperti kontabël apo çdo punonjës tjetër që për shkak të funksionit ka dijeni për informacione sekrete të shoqërisë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj dhe, dënimin plotësues të heqjes së të drejtës për të ushtruar detyra drejtuese pranë personave juridikë publikë dhe privatë.

### **Neni 644**

#### **Emetimi i parregullt i aksioneve**

Emetimi i parregullt i aksioneve bërë përpara regjistrimit të shoqërisë apo kur regjistrimi është bërë në mënyrë të kundërligjshme, apo kur formalitetet e shoqërisë ende nuk janë plotësuar, apo kur ndryshimi i statutit me rastin e zmadhimit të kapitalit ende nuk është bërë ose nuk është regjistruar apo është bërë në mënyrë të kundërligjshme, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë.

### **Neni 645**

#### **Shpërdorimi i kompetencave**

Shpërdorimi i kompetencave që u njeh ligji, aktet e nenligjore apo aktet brendeshme të shoqërisë, nga ortakët, administratorët apo anëtarët e organeve drejtuese të shoqërisë tregtare me qëllim për të siguruar për vete ose për të tjerët çfarëdolloj përfitimi, apo për të favorizuar një shoqëri tjetër ku kanë interesa, dënohen me gjobë ose burgim deri në pesë vjet.

### **Neni 646**

#### **Shpërndarja e paligjshme e përfitimeve dhe e rezervave**

1. Shpërndarja e përfitimeve që efektivisht nuk ekzistojnë ose që me ligj janë të destinuara për të qenë rezerva, ose shpërndarja e rezervave që me ligj nuk mund të shpërndahen, të bëra nga administratori i shoqërisë ose, organi vendimmarrës i shoqërisë tregtare, kur fakti nuk përbën një veprë penale më të rëndë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë.

2. Kthimi i përfitimeve të shpërndara apo krijimi i rezervave përpara afatit të miratimit të bilancit vjetor e shuan veprën penale.

### **Neni 647**

#### **Kthimi i padrejtë i pjesëve të kapitalit themeltar**

Kthimi tek ortakët apo aksionerët e pjesëve të kapitalit themeltar, me përjashtim të rasteve të zvogëlimit të ligjshëm të kapitalit të shoqërisë kryer nga administratorët, përbën kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë.

## **Neni 648**

### **Shpërndarja e padrejtë e aktiveve të shoqërisë nga ana e likuiduesve**

1. Ruajtja ose shpërndarja e pasurisë së shoqërisë tregtare për/dhe në favor të ortakëve të saj, nga ana e likuiduesit të emëruar për administrimin e shoqërisë, bërë më parë se të shlyhen kreditorët e shoqërisë, duke u shkaktuar dëm këtyre të fundit, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet dhe, dënimin plotësues të heqjes të së drejtës së ushtrimit të profesionit.
2. Ndjekja penale ushtrohet vetëm mbi bazën e ankimit të viktimës ose përfaqësuesit ligjor të saj dhe, çështja pushohet me heqjen dorë nga ankimi nëse është shlyer dëmi i shkaktuar deri sa nuk ka filluar shqyrtimi gjyqësor.

## **Neni 649**

### **Pengimi i kontrolleve**

1. Pengimi apo ndalimi i ortakëve apo organeve të tjera të shoqërisë të ushtrojnë kontroll në veprimtarinë e shoqërisë në përputhje me ligjin, kryer nga administratori nëpërmjet fshehjes së dokumenteve, ose formave të gënjeshtres, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë dhe, dënimin plotësues të heqjes së të drejtës për të ushtruar detyra drejtuese pranë personave juridikë publikë dhe privatë.
2. Ndjekja penale fillon mbi bazën e ankimit të viktimës ose përfaqësuesit ligjor të saj dhe çështja pushohet me heqjen dorë nga ankimi.

## **Neni 650**

### **Veprime në dëm të kreditorëve**

1. Zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë, ose bashkimi i saj me shoqëri të tjera, ose prishja e shoqërisë tregtare, që synojnë shmangien e detyrimeve të shoqërisë ndaj kreditorëve, duke u shkaktuar dëm atyre, kryer nga administratorët e shoqërisë tregtare dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.
2. Procedimi fillon mbi bazën e ankimit të kreditorëve dhe pushohet kur hiqet dore prej tij, nëse shlyerja e dëmit kreditorëve realizohet deri përpara fillimit të gjykimit.

## **Neni 651**

### **Mbajtja e padrejtë e dy cilësive**

Mbajtja njëkohësisht e cilësisë së ortakut të shoqërisë dhe të personit përgjegjës për hartimin e pasqyrave financiare në të njëjtën shoqëri tregtare, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë.

## **Neni 652**

### **Korrupsioni aktiv në sektorin privat**

1. Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt, tërthorazi ose nëpërmjet çdo ndërmjetësi, i çdo lloj përfitimi të parregullt, për vete ose për persona të tjerë, bërë në drejtim të administratorit,

drejtorit të përgjithshëm, personit përgjegjës të ngarkuar me hartimin e dokumenteve kontabël të shoqërisë, anëtarëve të organeve drejtuese të shoqërisë tregtare apo likuidatorit, ose çdo personi që punon në një pozicion drejtues në sektorin privat, për të kryer ose moskryer një veprim në kundërshtim me detyrën ose funksionin e tij, pavarësisht nëse do të arriheshin përfitime apo jo, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet dhe, dënimin plotësues të konfiskimit të çdo lloj pasurie që rrjedh ose fitohet drejtpërdrejt ose tërthorazi nga kryerja e veprës penale, apo dhe i shpërblimeve, të dhëna ose të premtuara, për kryerjen e veprës penale.

2. Kur vepra penale kryhet nga persona në nivele drejtuese të shoqërive tregtare private, përkrah dënimeve të parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni, gjykata cakton edhe dënimin plotësues të heqjes së të drejtës për të ushtruar funksione drejtuese në shoqëritë tregtare private.

### **Neni 653**

#### **Korrupsioni pasiv në sektorin privat**

Kërkimi apo marrja, drejtpërdrejt, tërthorazi ose nëpërmjet çdo ndërmjetësi, e çdo lloj përfitimi të parregullt apo një premtim të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte apo premtimi se do të pranojnë një ofertë, që vjen nga përfitimi i parregullt, për të kryer ose mos kryer një veprim në kundërshtim me detyrën apo funksionin e tij, i bere nga administratorët, drejtorët e përgjithshëm, personit përgjegjës të ngarkuar me hartimin e dokumenteve kontabël të shoqërisë, anëtarët e organeve drejtuese të shoqërisë tregtare, likuidatorët e tyre, ose nga personat që punojnë në çdo pozicion drejtues në sektorin privat, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet dhe, dënimet plotësuese të konfiskimit të çdo lloj pasurie që rrjedh ose fitohet drejtpërdrejt ose tërthorazi nga kryerja e veprës penale, apo dhe i shpërblimeve, të dhëna ose të premtuara, për kryerjen e veprës penale dhe të heqjes së të drejtës për të ushtruar detyra drejtuese pranë personave juridikë publikë dhe privatë.

### **Neni 654**

#### **Kryerja e veprës nga personi juridik**

1. Nëse një person juridik ka kryer ndonjëherë prej veprave penale të parashikuara në dispozitat e këtij seksioni, dënimi me gjobë do të jetë:

a) mbi pesëfishin e vlerës së gjobës së parashikuar në nenin 123 të Kodit Penal kur janë kryer veprat penale të parashikuara nga nenet 630, 631, 632, 633, 652 dhe 653 të këtij Kodi;

b) deri në pesëfishin e vlerës së gjobës së parashikuar në nenin 123 të Kodit Penal kur janë kryer veprat penale të parashikuara nga nenet 634, 635, 641 të këtij Kodi;

c) nga dyfishi deri në trefishin e vlerës së gjobës së parashikuar në nenin 123 të Kodit Penal kur janë kryer veprat penale të parashikuara nga nenet 629, 636, 637, 639 dhe 650 të këtij Kodi;

ç) për veprat penale të parashikuara në nenet 643, 644, 646, 667 të këtij kreu zbatohen rregullat e përcaktuara në nenin 123 të Kodit Penal.

2. Për veprat penale të lehta të parashikuara në dispozitat e këtij seksioni kur çmohet e arsyeshme dhe në përputhje me natyrën e veprës penale të kryer, gjykata mund të vendosë ndaj personit juridik dhënien e jo më pak se sa dy dënimeve plotësuese në vend të dënimit kryesor si, ndalimin për të kryer në të ardhmen një veprimtari që ka përbërë veprën penale të kryer, detyrimin që brenda tre muajve të marrë masat e përshtatshme organizative për të mos lejuar kryerjen e veprave penale, të

mos marrë ndihmë nga shteti apo të mos hyjë në marrëdhënie me sektorin publik dhe, publikimin e vendimit gjyqësor.

### **Neni 655**

#### **Dënimet plotësuese**

1. Kur veprat penale të parashikuara në këtë seksion kryhen nga zyrtari publik, atëherë gjykata, krahas dënimit kryesor cakton edhe dënimin plotësues të heqjes të së drejtës për të ushtruar funksione publike sipas parashikimeve të nenit 76 të këtij Kodi.

2. Në çdo rast gjykata vendos masën e zëvendësimit të dëmit të shkaktuar dhe, përveç sendeve që kanë shërbyer për kryerjen e veprave penale, kur ajo është kryer nga subjektet me qëllim përfitimi material apo të premtuar, vendoset konfiskimi i të ardhurave nga vepra penale apo të premtuara.

3. Për të njëjtat arsye të përmendura në paragrafin e dytë të nenit 654, gjykata mund të japë ndaj autorit të veprës penale dy apo më shumë dënime plotësuese në vend të dënimit kryesor.

4. Gjkata vendos edhe masën penale të regjistrimit dhe shkëmbimit të të dhënave që përmbajnë të dhëna rreth subjektit lidhur me rastet kur vepra penale ka rëndësi për njohjen dhe parandalimin e kryerjes së krimeve me natyrë edhe ndërkombëtare.

### **Neni 656**

#### **Konkurrimi i veprave dhe bashkëpunimi**

1. Në të gjitha rastet kur, për të kryer një prej veprave penale të parashikuara në këtë seksion, autorit i është dashur të kryejë veprime që përbëjnë vepër penale më vete, atëherë kjo e fundit konkurren me veprën që ai ka dashur të kryejë.

2. Nëse për kryerjen e ndonjërës prej veprave penale të parashikuara në këtë kre, autorit të posaçëm i është dashur të bashkëpunojë me ndonjë person tjetër, pavarësisht cilësive të posaçme të këtij të fundit, ata do të përgjigjen për kryerjen në bashkëpunim të veprës penale të parashikuar në këtë kre, apo çfarëdolloj vepre penale që konkurren me to.

### **Neni 657**

#### **Kryerja e veprës penale nga subjektet profesioniste**

1. Në të gjitha rastet kur, për të kryer një prej veprave penale të parashikuara në këtë seksion, autorit i është dashur të kryejë veprime që përbëjnë vepër penale më vete, atëherë kjo e fundit konkurren me veprën që ai ka dashur të kryejë.

2. Nëse për kryerjen e ndonjërës prej veprave penale të parashikuara në këtë kre, autorit të posaçëm i është dashur të bashkëpunojë me ndonjë person tjetër, pavarësisht cilësive të posaçme të këtij të fundit, ata do të përgjigjen për kryerjen në bashkëpunim të veprës penale të parashikuar në këtë kre, apo çfarëdolloj vepre penale që konkurren me to.

SEKSIONI II  
VEPRAT PENALE KUNDËR PUNONJËSVE

**Neni 658**  
**Përkufizime**

Për qëllim të këtij seksioni, togfjalëshat “ose me urdhërimet administrative të lëshuara më parë” ose “ose dënimit administrativ të dhënë më parë për këtë shkelje, përdorur në dispozitat më poshtë, do të kuptojmë dënimin administrativ që autori ka marrë nga organet publike për shkeljet që ka kryer në të shkuarën për raste të tjera të ngjashme të tyre që përmenden në përmbajtjen e dispozitave konkrete.

**Neni 659**  
**Diskriminimi i punonjësve**

Diskriminimi serioz në vendin e punës, publik ose privat, ndaj çdo personi për shkak të ideologjisë, fesë ose besimeve të tyre, situatës së tyre familjare, përkatësisë së tyre në një grup etnik, racor ose kombëtar, origjinës së tyre kombëtare, gjinisë, moshës, orientimit ose identitetit seksual ose gjinor, arsytet që lidhen me gjininë, gjendjen e pamundësive të dukshme ekonomike ose përjashtimi social, sëmundja që vuan ose paafësia e tij, duke penguar përfaqësimin ligjor ose sindikal të punëtorëve, marrëdhëniet me punonjës të tjerë të kompanisë, kur nuk janë riparuar dëmet ekonomike që janë shkaktuar dhe rivendoset situata e barazisë para ligjit pas urdhrimit ose dënimimit administrativ të dhënë më parë për këtë shkelje, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

**Neni 660**  
**Punësimi i paligjshëm**

1. Vendosja, nëpërmjet mashtrimit ose abuzimit me një situatë nevojë e punonjësve në shërbim të punëdhënësit, në kushte pune ose sigurimesh shoqërore që dëmtojnë, shtypin ose kufizojnë të drejtat e njohura me ligj, nga kontratat kolektive ose nga kontratat individuale, vendosja e kushteve të paligjshme për punëtorët nëpërmjet punësimit të tyre sipas përcaktimeve që nuk kanë lidhje me kontratën e punës, ose i mbajnë ato në kundërshtim me parashikimet ligjore ose me urdhërimet administrative të lëshuara më parë për shkelje të tilla ose punësimi njëkohësisht i një numri të madh punonjësish pa njoftuar regjistrimin e tyre në organet kompetente shtetërore ose, sipas rastit, pa marrë autorizimin përkatës të punës, me kusht që numri i punëtorëve të prekur të jetë të paktën:

a) njëzet e pesë për qind, në kompani ose qendra pune që punësojnë më shumë se njëqind punëtorë,

b) pesëdhjetë për qind, në kompani ose qendra pune që punësojnë më shumë se dhjetë punëtorë dhe jo më shumë se njëqind, ose

c) të gjithë, në shoqëri ose qendra pune që punësojnë më shumë se pesë dhe jo më shumë se dhjetë punëtorë,

përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në tridhjetë ditë.

2. Kryerja e veprimeve të mësipërme me dhunë ose kanosje, dënohet me burgim deri në tre vjet.

**Neni 661**  
**Punësimi i të huajve pa leje pune**

1. Punësimi në mënyrë të përsëritur i shtetasve të huaj që nuk kanë leje pune, ose punësimi i një të mituri të cilit i mungon leja e punës, dënohet me gjobë ose me burgim nga një deri në katër vjet.
2. Kur punësimi i shtetasve të huaj pa leje pune bëhet në kushte që dëmtojnë, shtypin ose kufizojnë të drejtat që iu njihen me ligj, marrëveshje kolektive ose kontratë individuale pune, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

**Neni 662**  
**Rekrutimi me dredhi i krahut të punës**

Rekrutimi i personave ose shtytja e personave me qëllim që ata të vendosin për t'u larguar nga puna e tyre duke iu ofruar me mashtrim, dredhi ose në të rremë, punësim ose kushte pune që nuk i mundësojnë në të vërtetë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose burgim deri në dyzet e pesë ditë.

**Neni 663**  
**Ngacmimi në punë**

Ngacmimi i vazhdueshëm i një personi me fjalë ose sjellje të përsëritura, duke pasur si qëllim ose efekt përkeqësimin e kushteve të punës, cenimin e të drejtave dhe dinjitetin e tij, dëmtimin e shëndetit fizik ose mendor ose vënien në rrezik të së ardhmes së tij profesionale, apo cenimin e integritetit të tij seksual apo përfitime të këtij lloji, pavarësisht nëse ndodhet apo jo në pozicion epror me viktimën, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

**Neni 664**  
**Nxitja për emigrim**

1. Kushdo që nxit ose jep ndihmë për emigrimin e një personi në një vend tjetër duke simuluar një kontratë ose leje qëndrimi të rreme të një shteti të huaj, ose duke përdorur një mashtrim tjetër të ngjashëm, që krijojnë bindjen për të ndjekur orientimin për emigrim, dënohet me gjobë ose me burgim deri në katër vjet.
2. Në çdo rast gjykata zbaton dënime plotësuese kur vepra penale është kryer edhe nga personi juridik i përshtatshëm sipas shkallës së përgjegjësisë së tij dhe pasojës së ardhur dhe, konfiskim të përfitimeve materiale nëse kanë ardhur apo janë premtuar nga transaksioni.
3. Kur vepra penale sipas paragrafit të parë të këtij neni kryhet për qëllime fitimi, ajo konkuron me mashtrimin.

**Neni 665**  
**Pengimi për ushtrimin e lirisë së organizimit**

1. Pengimi ose kufizimi i ushtrimit të lirisë së organizimit të së drejtës për grevë, me mashtrim ose duke abuzuar me një situatë nevojë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë.

2. Kryerja e veprimeve të mësipërme nëpërmjet shtrëngimit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtëdhjetë ditë.

### **Neni 666**

#### **Detyrimi për të marrë pjesë ose jo në grevë**

Detyrimi i punonjësit që kundër vullnetit të marrë apo të mos marrë pjesë në grevë ose krijimi i pengesave dhe vështirësive për të vazhduar punën kur punonjësi dëshiron të punojë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në një muaj.

### **Neni 667**

#### **Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë**

1. Shkaktimi i vdekjes ose dëmtimit të lehtë apo të rëndë të shëndetit të personit ardhur si pasojë e mosrespektimit të rregullave që kanë të bëjnë me punën, prodhimin, shërbimin, të përcaktuara në ligj, në aktet e Këshillit të Ministrave apo në rregulloret përkatëse të sigurimit teknik, të disiplinës teknike, të mbrojtjes në punë, të higjienës dhe sigurimit nga zjarri, prej personave të ngarkuar me ligj apo akte të autorizuara prej tij me marrjen e masave dhe kujdesin për respektimin e rregullave, dënohet sipas rastit në përputhje me numrin e viktimave dhe llojit të dëmtimit të tyre, bazuar në llojin dhe shkallën e fajit në kryerjen e veprës sipas dispozitave përkatëse që klasifikojnë veprën penale në varësi të pasojës së ardhur.

2. Shkelja e rregullave sipas paragrafit të parë, prej personave të ngarkuar me ligj apo akte të autorizuara prej tij me marrjen e masave dhe kujdesin për respektimin e rregullave, është e dënueshme penalisht si kundërvajtje penale me gjobë ose me burgim nga tre muaj deri në një vit, vetëm në rastin e ardhjes së pasojave në jetën e shëndetit e viktimave, përndryshe trajtohet administrativisht nga inspektorati përkatës shtetëror. Në këtë rast, kundërvajtja penale konkurren me veprat penale pasojë të kualifikuara sipas dëmit të vërtetuar nga shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë.

3. Shkelja e rregullave sipas paragrafit të parë është e dënueshme penalisht si kundërvajtje penale edhe në rastin e ardhjes së pasojave të rënda në dëm të pronës. Në këtë rast, kundërvajtja penale konkurren me veprat penale të kualifikuara sipas dëmit të vërtetuar nga shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë.

### **Neni 668**

#### **Kryerja e veprës nga personi juridik**

1. Nëse një person juridik ka kryer veprën penale të parashikuara nga nenet 659, 660, 661, 662, 664, 665 dhe 667 të këtij seksioni, caktimi i dënimit me gjobë do të ndjekë rregullat e përcaktuara në nenin 123 të Kodit Penal.

2. Për veprat penale të lehta të parashikuara në dispozitat e këtij kreu kur çmohet e arsyeshme dhe në përputhje me natyrën e veprës penale të kryer, ose kur çmon të drejtë për të zbatuar dënimin plotësues krahas dënimit kryesor për vepra të rënda penale, gjykata mund të vendosë dhënien e jo më pak se sa dy dënimeve plotësuese në vend të dënimit kryesor si, caktimin e një mbikëqyrësi

ligjor, detyrimin që brenda tre muajve të marrë masat e përshtatshme organizative për të mos lejuar kryerjen e veprave penale, të mos marrë ndihmë nga shteti apo të mos hyjë në marrëdhënie me sektorin publik etj., dhe publikimin e vendimit gjyqësor.

#### **Neni 669**

#### **Konkurrimi i veprave dhe bashkëpunimi**

1. Në të gjitha rastet kur, për të kryer një prej veprave penale të parashikuara në këtë seksion, autorit i është dashur të kryejë veprime që përbëjnë vepër penale më vete, atëherë kjo e fundit konkurren me veprën që ai ka dashur të kryejë.

2. Nëse për kryerjen e ndonjërës prej veprave penale të parashikuara në këtë kre, autorit të posaçëm i është dashur të bashkëpunojë me ndonjë person tjetër, pavarësisht cilësive të posaçme të këtij të fundit, ata do të përgjigjen për kryerjen në bashkëpunim të veprës penale të parashikuar në këtë kre, apo çfarëdolloj veprë penale që konkurren me to.

#### **Neni 670**

#### **Dënimet plotësuese**

1. Nëse veprat penale të parashikuara në këtë seksion kryhen nga zyrtari publik, dënimi përkatës shtohet deri në një të tretën e tij dhe, krahas dënimit kryesor, gjykata cakton edhe dënimin plotësues, heqjen e së drejtës për të ushtruar një funksion publik.

2. Në çdo rast gjykata vendos masën e zëvendësimit të dëmit të shkaktuar dhe, përveç sendeve që kanë shërbyer për kryerjen e veprave penale, kur ajo është kryer nga subjektet me qëllim përfitimi material apo të premtuar, vendoset konfiskimi i të ardhurave nga vepra penale apo të premtuara.

3. Për të njëjtat arsye të përmendura në paragrafin e dytë të nenit 668 të këtij Kodi, gjykata mund të japë ndaj autorit të veprës penale dy apo më shumë dënime plotësuese në vend të dënimit kryesor.

### **KREU IV**

### **VEPRAT NË LIDHJE ME USHTRIMIN E VEPRIMTARISË BANKARE DHE FINANCIARE**

#### **Neni 671**

#### **Ushtrimi i veprimtarisë bankare pa licencë**

1. Ushtrimi i veprimtarisë bankare nga subjekte të palicencuara sipas legjislacionit bankar në fuqi, dënohet nga gjashtë muaj deri në katër vjet dhe, dënimin plotësues të konfiskimit të çdo lloj pasurie që rrjedh ose fitohet drejtpërdrejt ose tërthorazi nga kryerja e veprës penale.

2. Kur vepra penale kryhet nga persona juridikë dënohet me gjobë mbi pesëfishin e vlerës së përfitimit material apo të premtuar, konfiskimin e çdo lloj pasurie që rrjedh ose fitohet drejtpërdrejt ose tërthorazi nga kryerja e veprës penale si dhe, mbylljen e veprimtarisë.

#### **Neni 672**

#### **Ushtrimi i veprimtarive financiare pa licencë**

1. Ushtrimi i një ose disa veprimtarive financiare të ndryshme nga veprimtaria bankare, nga subjekte të palicencuara sipas legjislacionit bankar dhe/ose financiar në fuqi, dënohet me gjobë ose burgim nga katër muaj deri në tre vjet dhe, dënimin plotësues të konfiskimit të çdo lloj pasurie që rrjedh ose fitohet drejtpërdrejt ose tërthorazi nga kryerja e veprës penale.

2. Kur vepra penale kryhet nga persona juridikë dënohet me gjobë deri në pesëfishin e vlerës së përfitimit material apo të premtuar, konfiskimin e çdo lloj pasurie që rrjedh ose fitohet drejtpërdrejt ose tërthorazi nga kryerja e veprës penale si dhe, mbylljen e veprimtarisë.

### **Neni 673**

#### **Përdorimi i paautorizuar dhe përhapja e informacionit të privilegjuar ne sistemin bankar**

1. Për qëllimet e këtij neni, marrëdhëniet e brendshme lindin kur një person zotëron informacion të brendshëm te sistemit bankar, pavaresisht cilesise, punesimit apo burimit te informacionit dhe, e përdor atë informacion duke blerë ose asgjësuar, për llogari të tij ose për llogari të një pale të tretë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, instrumente financiare rreth të cilave ka të bëjë informacioni.

2. Përdorimi i paligjshëm i informacionit të privilegjuar te sistemit bankar, nga një person i brendshëm, për të cilin publiku nuk ka dijeni dhe, që përdoret me qëllim fitimi material për vete, për një palë të tretë apo në dëm të kësaj të fundit, denohet me burgim nga tre deri ne shtate vjet, kur kryet në njërin nga mënyrat e mëposhtme:

a) përdorimi i informacionit të brendshëm ne sistemin bankar duke anuluar ose ndryshuar një urdhër në lidhje me një instrument financiar me të cilin lidhet informacioni, kur porosia është vendosur përpara se personi i interesuar të zotëronte informacionin e brendshëm, konsiderohet gjithashtu si transaksion i brendshëm ;

b) në lidhje me ankandet e lejimeve të shkarkimeve ose produkteve të tjera të ankandeve të bazuara në to, të cilat mbahen në përputhje aktet normative vendase apo nderkombetare, përdorimi i informacionit të brendshëm te sistemit bankar të përmendur në paragrafin 2, shkronja “a” të këtij neni përfshin gjithashtu paraqitjen, modifikimin ose tërheqjen e një oferte nga një person për llogari të tij ose për llogari të një pale të tretë.

c) rekomandon, në bazë të atij informacioni, që një person tjetër të blejë ose të disponojë instrumente financiare me të cilat lidhet ai informacion, ose e shtyn atë person të bëjë një blerje ose asgjësim të tillë; ose

c) rekomandon, në bazë të atij informacioni, që një person tjetër të anulojë ose të ndryshojë një urdhër në lidhje me një instrument financiar me të cilin lidhet ai informacion, ose ta shtyjë atë person të bëjë një anulim ose ndryshim të tillë.

3. Per efekt te ligjit penal, cdo rekomandim apo perdorim i informacionit te brendshem te sistemit bankar te permendura me lart, ne favor te nje te treti perben nxitje ne kryerjen e vepres penale sipas parashikimeve te nenit 53 te ketij Kodi.

### **Neni 674**

#### **Dënimet plotësuese**

1. Nëse veprat penale të parashikuara në këtë kre kryhen nga zyrtari publik, atëherë gjykata, krahas dënimit kryesor cakton edhe dënimin plotësues heqjen e së drejtës për të punuar në shërbimin publik, ose çdo dënim tjetër plotësues që çmon të arsyeshëm, në përputhje me natyrën

e veprës dhe veprimeve të kryera nga i dënuari, gjithmonë nëse dispozita konkrete nuk ka parashikuar ndryshe.

2. Në çdo rast gjykata vendos masën e zëvendësimit të dëmit të shkaktuar dhe, përveç sendeve që kanë shërbyer për kryerjen e veprave penale, kur ajo është kryer nga subjektet me qëllim përfitimi material apo të premtuar, vendoset konfiskimi i të ardhurave nga vepra penale apo të premtuara.

### **Neni 675**

#### **Konkurrimi i veprave dhe bashkëpunimi**

1. Për efekt të këtij seksioni, nëse ndonjëra nga mënyrat e kryerjes së veprave penale të tij që kanë bërë të mundur kryerjen e ndonjërës prej tyre, janë vepra penale më vete, atëherë ato konkurrojnë me veprën penale të cilës i kanë shërbyer për të sjellë apo tentuar pasojën.

2. Nëse për kryerjen e ndonjërës prej veprave penale të parashikuara në këtë kre, autorit të posaçëm i është dashur të bashkëpunojë me ndonjë person tjetër, pavarësisht cilësive të posaçme të këtij të fundit, ata do të përgjigjen për kryerjen në bashkëpunim të veprës penale të parashikuar në këtë kre, apo çfarëdolloj veprë penale që konkurron me to.

### **KREU V**

#### **VEPRAT PENALE NË FUSHËN E LOJËRAVE TË FATIT DHE GARAVE SPORTIVE**

### **Neni 676**

#### **Autorizimi apo leja e paligjshme**

Per sa lidhet me dispozitat e këtij seksioni, do të vlerësohet te jetë e paligjshme, cdo sjellje, autorizim i kerkuar, leje per ushtrim te veprimtarive te permendura edhe kur kryhet sipas një autorizimi të lëshuar nga një autoritet kompetent i një shteti, nëse një autorizim i tillë është marrë me mashtrim ose me korrupsion, zhvatje ose detyrim, ose nëse një autorizim i tillë është në shkelje të dukshme të kërkesave ligjore thelbësore përkatëse, apo ne kapercim te kushteve te atij autorizimi.

### **Neni 677**

#### **Organizimi ose ushtrimi i veprimtarive të lojërave të fatit në kundërshtim me ligjin**

1. Organizimi ose ushtrimi i veprimtarive të lojërave të fatit në kundërshtim me ligjin që përmban kategoritë e tyre, apo sigurimi i mjeteve për të kryer zhvillimin e lojërave të fatit, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet.

2. Po kjo vepër, nëse në lojë marrin pjesë persona nën moshën njëzet e një vjeç, apo kryerja publikisht e tyre, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

3. Vlerësohet si lojë e kryer publikisht edhe kur ato organizohen në klube ose festa private me pjesëmarrje të gjerë njerëzish.

4. Reklamimi i lojërave të paligjshme të fatit, e kryer me çdo mjet publicitar, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

5. Kur kjo vepër ndihmohet nga personi i ngarkuar me funksione shtetërore apo në shërbim publik, që ka lidhje me veprimtarinë e lojërave të fatit, dënimi me burgim për të shtohet me një të katërtën e dënimit të dhënë.

### **Neni 678**

#### **Vënia në dispozicion e lokaleve për lojëra të palejuara**

1. Vënia në dispozicion e mjediseve për organizimin apo luajtjen e lojërave të fatit në kundërshtim me ligjin që kategorizon llojet e tyre, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj.

2. Lejimi i futjes së personave nën njëzet e një vjeç e shton dënimin me një të tretën e tij.

### **Neni 679**

#### **Paracaktimi i rezultateve në garat sportive**

1. Kërkimi, pranimi i premtimeve ose i një përfitimi për vete ose për një të tretë në këmbim të ndikimit në zhvillimin ose rezultatin e një gare të organizuar sportive në dobi të kundërshtarit në garë, si rezultat i të cilit do të përfitohet një përfitim i paligjshëm në të holla, apo çdo përfitim tjetër, nga sportisti ose trajneri, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

2. Ofrimi, premtimi ose dhënia një sportisti ose trajneri një përfitim për veten ose një të tretë në këmbim të ndikimit në zhvillimin ose rezultatin e një gare të organizuar sportive në dobi të kundërshtarit në garë, si rezultat i të cilit përfitohet një përfitim i paligjshëm, dënohet me burgim deri në katër vjet.

3. Kërkimi, pranimi i premtimeve ose i një përfitimi për vete ose për një të tretë në këmbim të ndikimit në zhvillimin ose rezultatin e një gare të organizuar sportive në një mënyrë të tillë që vjen në kundërshtim me rregullat dhe lojën e ndershme sportive, si rezultat i të cilit përfitohet një përfitim i paligjshëm, kryer nga gjyqtari, arbitri ose çdo person tjetër që mbikëqyr garën, shton dënimin e parashikuar në paragrafin e dytë të këtij neni edhe deri në një të tretën e tij.

4. Ofrimi, premtimi ose dhënia një gjyqtari, arbitri ose çdo personi tjetër që mbikëqyr garën një përfitim për veten ose një të tretë në këmbim të ndikimit në zhvillimin ose rezultatin e një gare të organizuar sportive në një mënyrë që është në kundërshtim me rregullat dhe lojën e ndershme sportive, si rezultat i të cilës përfiton një përfitim të paligjshëm, e shton dënimin e parashikuar në paragrafin e dytë të këtij neni deri në një të dytën e tij.

5. Garë e organizuar sportive sipas kësaj dispozite është çdo ngjarje sportive në Shqipëri ose jashtë saj, e cila:

a) organizohet nga një organizatë sportive kombëtare ose ndërkombëtare ose me udhëzimet e saj ose e njohur prej saj dhe

b) ndjek rregullat e lojës të miratuara nga një organizatë sportive kombëtare ose ndërkombëtare me efekt detyrues për organizatat anëtare të saj.

6. Trajner në kuptimin e kësaj dispozite është personi i cili gjatë garës sportive merr vendime për përdorimin dhe udhëzimin e sportistëve. Barazohen me trajnerin individët që, për shkak të pozicionit të tyre profesional ose financiar, mund të ndikojnë ndjeshëm në udhëzimin e sportistëve.

7. Po kjo vepër e kryer në veprimtari ndërkombëtare apo kur ekipet përfaqësuese të Republikës së Shqipërisë marrin pjesë, shton dënimin respektiv të veprës së kryer sipas këtij neni, deri në një të dytën e tij.

#### **Neni 680**

##### **Paracaktimi i rezultateve të garës në baste publike**

Nëse secila nga mënyrat e kryerjes së paracaktimit të rezultateve të garave sportive të parashikuara në nenin 679 të këtij Kodi prej subjekteve përkatëse të përmendura në të, synon të manipulojë një bast publik të lejuar sipas ligjit, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet si dhe me konfiskimin e të gjitha të ardhurave të siguruara nga vepra penale.

#### **Neni 681**

##### **Ndalimi i luajtjes në baste publike**

1. Luajtja në bastet publike që kanë lidhje me garat sportive e trajnerëve, sportistëve gjyqtarëve, arbitrave apo e kujtdo tjetër që ka një pozicion aktiv, ndikues përmbi veprimtarët e atyre garave, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me përjashtim nga veprimtaritë përkatëse për një periudhë deri në pesë vjet si dhe, konfiskim të përfitimeve që vijnë nga vepra penale.

2. Nëse subjektet e përcaktuar në paragrafin e parë të këtij neni, marrin pjesë në lojra të organizuara në mënyrë të paligjshme sipas nenit 677 të këtij Kodi, kryejnë kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë ose me burgim deri në një vit dhe, me përjashtim nga veprimtaritë përkatëse për një periudhë pesë vjeçare si dhe, konfiskim të përfitimeve që vijnë nga vepra penale.

#### **Neni 682**

##### **Përdorimi i substancave të ndaluara**

1. Përshkrimi, sigurimi, shpërndarja, furnizimi, dhënia, ofrimi ose lehtësimi, pa justifikim terapeutik, i substancave ose grupeve farmakologjike të ndaluara, apo dhe i metodave jo të rregullta të tyre, që synojnë të rrisin kapacitetet fizike të sportistëve ose të modifikojnë rezultatet e garave, të cilat për shkak të përmbajtjes, marrjes në mënyrë të përsëritur ose rrethanave të tjera që konkurrojnë, rrezikojnë jetën ose shëndetin e sportistëve, dënohet me burgim nga dy deri në gjashtë vjet.

2. Kur vepra penale është kryer ndaj një të mituri, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.

3. Kur vepra është kryer nëpërmjet gënjeshtërisë ose shpërdorimit të besimit ose frikësimit, dënimi sipas paragrafit përkatës rritet deri në një të tretën e tij.

4. Kur autori ka përfituar nga një marrëdhënie varësie në punë ose profesionale, dënimi sipas paragrafit përkatës, rritet deri në një të dytën e tij.

#### **Neni 683**

##### **Rrethanat cilësuese**

Kur çdonjëra prej veprave penale të këtij kreu kryhet përmbi baza tregtare me qëllim të vazhdueshëm, dënimi me burgim shtohet deri edhe në një të dytën në raport me dënimin që dispozita përkatëse ka parashikuar.

#### **Neni 684**

##### **Kryerja e veprës nga personi juridik**

1. Nëse një person juridik ka kryer ndonjë prej veprave penale të shënuara më poshtë, dënimi me gjobë do të jetë:

a) deri në pesëfishin e vlerës së përfitimit të paligjshëm kur janë shkelur nenet 677, 678 dhe 679 të këtij kreu;

b) për veprat penale të parashikuara në nenet 681, 682 dhe 683 të këtij kreu zbatohen rregullat e përcaktuara në nenin 123 të këtij Kodi.

2. Gjykata mund të caktojë si dënim plotësues pezullimin e veprimtarisë së tij për një kohë të përshtatshme.

#### **Neni 685**

##### **Kryerja e veprës në bashkëpunim**

Nëse për kryerjen e ndonjë prej veprave penale të parashikuara në këtë kre, autorit të posaçëm i është dashur të bashkëpunojë me ndonjë person tjetër, pavarësisht cilësive të posaçme të këtij të fundit, ata do të përgjigjen për kryerjen në bashkëpunim të veprës penale të parashikuar në këtë kre, apo çfarëdolloj vepre penale që konkurron me to.

#### **Neni 686**

##### **Dënimet plotësuese dhe konkurrimi**

1. Nëse veprat penale të parashikuara në këtë seksion kryhen edhe nga zyrtari publik i caktuar sipas ligjit, atëherë gjykata, krahas dënimit kryesor cakton edhe dënimin plotësues, heqjen e së drejtës për të ushtruar një funksion publik.

2. Në çdo rast gjykata vendos masën e zëvendësimit të dëmit të shkaktuar dhe, përveç sendeve që kanë shërbyer për kryerjen e veprave penale, kur ajo është kryer nga subjektet me qëllim përfitimi material apo të premtuar, vendoset konfiskimi i të ardhurave nga vepra penale apo të premtuara.

3. Për veprat penale të lehta të parashikuara në nenet 677, paragrafi 1, 678 dhe 679 kur çmohet e arsyeshme, gjykata mund të vendosë dhënien e jo më pak se sa dy dënimeve plotësuese në vend të dënimit kryesor.

4. Për qëllim të këtij seksioni, nëse mënyrat e kryerjes së veprave penale të parashikuara këtu që kanë bërë të mundur kryerjen e ndonjë prej tyre, përbëjnë vepra penale më vete, atëherë ato konkurrojnë me veprën penale të cilës i kanë shërbyer për të sjellë apo tentuar pasojën.

KREU VI  
VEPRAT PENALE NË FUSHËN E FALIMENTIMIT

**Neni 687**  
**Falimentimi**

Kryerja e akteve të mëposhtme, duke qenë në një gjendje mbiborxhi, pamundësie pagese ose të falimentimit faktik ose të afërt:

a) heqja, fshehja, shkatërrimi, dëmtimi ose bërja të papërdorshme e pjesëve të aseteve të cilat në rastin e hapjes së procedurës së falimentimit do t'i përkisnin pasurisë së tij, në kundërshtim me standardet e rregullta të biznesit;

b) hyrja në sipërmarrje me humbje, ose spekulative, ose tregtia spekulative me mallra ose letra me vlerë, me kontrata me afat në të ardhmen, ose shpenzimi i shumave të ekzagjeruara, ose hyrja në borxh duke kryer shpenzime që nuk kanë logjikë ekonomike, duke luajtur bixhoz ose baste, veprime të kryera në kundërshtim me standardet e rregullta të biznesit;

c) sigurimi i mallrave ose letrave me vlerë me kredi dhe, shitja e tyre apo sendeve të prodhuara nga këto mallra nën vlerën e tregut, në kundërshtim me standardet e rregullta të biznesit;

ç) krijimi në mënyrë të rreme i të drejtave të dikujt tjetër ose njohja e të drejtave fiktive;

d) mosmbajtja e librave kontabël të cilët duhet të mbahen në mënyrë të detyrueshme sipas ligjit, ose mbajtja apo ndërhyrja në to në mënyrë të tillë që të vështirësohet kontrolli i gjendjes pasurore aktuale;

dh) heqja, fshehja, shkatërrimi ose dëmtimi në mënyrë të fshehtë, përpara përfundimit të afatit të ruajtjes për ata që janë të detyruar sipas ligjit të mbajnë libra, e librave të kontabilitetit ose e dokumentacionit tjetër që duhet të mbajë tregtari, duke vështirësuar në këtë mënyrë kontrollin e gjendjes pasurore aktuale,

e) hartimi i bilanceve në mënyrë të tillë që e bën të vështirë kontrollin e gjendjes pasurore aktuale ose, moshartimi në kohën e caktuar i bilancit të aktiveve ose të inventarit-në kundërshtim me ligjin;

ë) zvogëlimi i pasurisë neto, fshehja ose mbulimi i rrethanave aktuale të biznesit në çdo mënyrë tjetër, e cila bie ndesh me standardet e rregullta të biznesit, dënohet me burgim nga katër deri në dhjetë vjet.

**Neni 688**  
**Falimentimi i provokuar**

1. Shkaktimi i gjendjes së mbiborxhit, pamundësisë së pagesës ose falimentimit me një nga veprimet e përmendura në nenin 677 dënohet me burgim nga pesë deri në dymbëdhjetë vjet.

2. Kryerja e kësaj vepre për shkak të lakmisë, ose kur vendosen shumë persona në gjendje rreziku për humbjen e aseteve të tyre që i janë besuar autorit, ose në rrezik të vështirësive financiare, dënimi i parashikuar në paragrafin e parë shtohet deri në një të tretën e tij.

**Neni 689**  
**Fshehja e gjendjes së falimentimit**

Hyrja në marrëdhënie ekonomike tregtare me të tretët nga personi juridik që kërkon të fshehtë gjendjen e paaftësisë paguese dhe faktike të falimentit duke rrezikuar të dëmtojë kreditorët e tij, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

#### **Neni 690**

#### **Deklarimi i kreditorëve inekzistentë**

Deklarimi i kreditorëve të paqenë ose mosdeklarimi i ekzistencës së atyre të vërtetë, pasurive të tjera që do të përfshihen në, ose fshehja e detyrimeve ndaj shtetit në rastin e falimentit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

#### **Neni 691**

#### **Trajtimi preferencial i kreditorëve**

1. Dhënia, duke qenë në dijeni të falimentimit të vet, e një garancie ose kompensimi një kreditori për të cilën ai kreditor nuk e gëzon të drejtën në përgjithësi për ta marrë, ose jo në atë mënyrë, ose jo në atë kohë kur i jepet, duke e trajtuar me dashje këtë kreditor në mënyrë preferenciale ndaj kreditorëve të tjerë, dënohet me burgim nga një deri në katër vjet.

2. Dënimi shtohet deri me një të dytën më shumë ndaj likuidatorit të kompanive të shpallura të falimentuara, të cilët kanë kryer ndonjë nga faktet e parashikuara në paragrafin e parë.

#### **Neni 692**

#### **Trajtimi preferencial i debitorëve**

1. Heqja, fshehja, shkatërrimi, dëmtimi ose bërja të papërdorshme e pjesëve të aseteve të cilat në rastin e hapjes së procedurës së falimentimit do t'i përkisnin pasurisë së falimentimit, në një mënyrë të tillë që vjen në kundërshtim me standardet e rregullta të biznesit, kur çdonjëri prej këtyre veprimeve kryhet duke qenë në dijeni të falimentimit të afërt të tjetrit ose, kur kryhet pas pezullimit të pagesave, në procedurat e falimentimit ose në një procedurë tjetër ku do të merret vendim për nisjen e procedurës së falimentimit ndaj një personi tjetër, me pëlqimin e tyre ose në emër të tyre, dënohet me burgim nga tre deri në gjashtë vjet.

2. Kryerja e kësaj vepre për shkak të lakmisë ose kur vendosen shumë persona në gjendje rreziku për humbjen e atyre aseteve që i janë besuar autorit, dënimi sipas paragrafit të parë shtohet deri në një të tretën e tij.

#### **Neni 693**

#### **Pengimi i mbarëvajtjes së procedurës së falimentimit**

Krijimi i çfarëdo lloj pengese që synon të cenojë mbarëvajtjen e procedurës së falimentimit të filluar sipas ligjit, kur nuk përbën ndonjë prej veprave penale të parashikuara në këtë kre, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj.

#### **Neni 694**

#### **Kryerja e veprës penale nga subjektet profesionale**

Nëse ndonjëra nga veprat penale të parashikuara në këtë seksion do të kryhet nga ekspertë të fushës, avokatë apo këshilltarë të tjerë që ushtrojnë profesionin në fushat e përmendura në dispozitat penale të këtij kreu, dënimi për veprën pëkatëse të kryer do të përmbajë edhe dënimin plotësues të heqjes deri në pesë vjet të së drejtës për të ushtruar profesionin.

#### **Neni 695**

#### **Kryerja e veprës në bashkëpunim**

Nëse për kryerjen e ndonjërës prej veprave penale të parashikuara në këtë kre, autorit të posaçëm i është dashur të bashkëpunojë me ndonjë person tjetër, pavarësisht cilësive të posaçme të këtij të fundit, ata do të përgjigjen për kryerjen në bashkëpunim të veprës penale të parashikuar në këtë kre, apo çfarëdolloj vepre penale që konkurron me to.

#### **Neni 696**

#### **Dënimet plotësuese dhe konkurrimi**

1. Nëse veprat penale të parashikuara në këtë seksion kryhen edhe nga zyrtari publik i caktuar sipas ligjit, atëherë gjykata, krahas dënimit kryesor cakton edhe dënimin plotësues, heqjen e së drejtës për të ushtruar një funksion publik.

2. Nëse për kryerjen e ndonjërës prej veprave penale të parashikuara në këtë kre, autorit të posaçëm i është dashur të bashkëpunojë me ndonjë person tjetër, pavarësisht cilësive të posaçme të këtij të fundit, ata do të përgjigjen për kryerjen në bashkëpunim të veprës penale të parashikuar në këtë kre, apo çfarëdolloj vepre penale që konkurron me to.

3. Për qëllim të këtij seksioni, nëse mënyrat e kryerjes së veprave penale të parashikuara këtu që kanë bërë të mundur kryerjen e ndonjërës prej tyre, përbëjnë vepra penale më vete, atëherë ato konkurrojnë me veprën penale të cilës i kanë shërbyer për të sjellë apo tentuar pasojën.

4. Për veprat penale të lehta të parashikuara në nenet 689, 690 dhe 693, kur çmohet e arsyeshme, gjykata mund të vendosë dhënien e jo më pak se sa dy dënimeve plotësuese në vend të dënimit kryesor.

### **KREU VII**

#### **VEPRAT PENALE NË FUSHËN E PASTRIMIT TË PARAVE**

#### **Neni 697**

#### **Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale**

1. Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, qe rrjedhin nga vepra penale për të cilat ky kod parashikon dënim me burgim nga tre vjet e lart, nëpërmjet:

a) këmbimit ose transferimit të pasurisë, me qëllim fshehjen ose mbulimin e origjinës së paligjshme të saj, duke ditur se kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;

b) fshehjes ose mbulimit të natyrës së vërtetë, burimit, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes, pronësisë ose të drejtave në lidhje me pasurinë, duke ditur që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;

c) fitimit të pronësisë, posedimit ose përdorimit të pasurisë, duke e ditur në çastin e marrjes në dorëzim të saj, që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;

ç) kryerjes së veprimeve financiare ose transaksioneve të copëzuara për shmangien nga raportimi, sipas legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave;

d) investimit në veprimtari ekonomike ose financiare të parave a sendeve, duke ditur se janë produkte të veprës penale ose veprimtarisë kriminale;

dh) këshillimit, ndihmës, nxitjes, thirrjes publike apo cilitdo rol të përshkruar në nenin 49 të këtij Kodi, për kryerjen e secilës prej veprave të përcaktuara më sipër;

dënohet me burgim nga katër deri në tetë vjet.

2. Kur kjo vepër kryhet gjatë ushtrimit të një veprimtarie profesionale, dënohet me burgim nga shtatë deri në dymbëdhjetë vjet.

Me veprimtari profesionale në kuptimin e këtij paragrafi do të kuptohet jo vetëm veprimtaria e profesionistëve që merren me administrimin e parave në banka, por edhe atyre që vihen në rolin e shënuar në shkronjën “dh” të paragrafit një të këtij neni.

3. E njëjta vepër, kur ka sjellë pasoja të rënda, dënohet jo më pak se dyëmbëdhjetë vjet me burgim.

4. Me pasojë të rëndë në kuptim të këtij paragrafi do të kuptohet rasti kur vlera e parave të pastruara apo tentuar për t’u pastruar kalon shumë prej 1.000.000.000 lekë ose, kur kanë shkaktuar dëm të interesave të publikut, punëmarrësve, dëm të imazhit dhe besimit publik të shtetit, ndërlikim të marrëdhënieve me shtete apo organizma ndërkombëtare që monitorojnë çështjet e pastrimit të parave.

5. Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe kur:

a) vepra penale, produktet e së cilës pastrohen, është kryer nga një person që nuk mund të merret si i pandehur ose që nuk mund të dënohet;

b) ndjekja penale për veprën, produktet e së cilës pastrohen, është parashkruar ose amnistuar;

c) personi që kryen pastrimin e produkteve është i njëjtë me personin që ka kryer veprën, nga e cila kanë rrjedhur produktet;

ç) për veprën penale, nga e cila kanë ardhur produktet, nuk është filluar asnjëherë çështja penale apo nuk është dhënë një dënim me vendim penal të formës së prerë;

d) vepra penale, produktet e së cilës pastrohen, është kryer nga një person, pavarësisht shtetësisë së tij, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe është njëkohësisht e dënueshme, si në shtetin e huaj, ashtu edhe në Republikën e Shqipërisë;

dh) personi që kryhen pastrimin e produkteve është i ndryshëm nga personi që ka kryer veprën produktet e të cilës po pastrohen, por nga të gjitha rrethanat e rastit del qartë që ai administron të ardhurat e krimit për shkak të lidhjes së qëndrueshme që ka me autorin e krimit, besimit të ndërsjellë të njëri-tjetri, lidhjes familjare apo të gjakut dhe, kur nga të gjitha rrethanat rezulton qartazi që ai ka për detyrë të realizojë pastrimin edhe pa orientimin apo udhëzimet e personit që ka kryer krimin që ka sjellë të ardhurat.

6. Dijenia dhe qëllimi për efekt të kësaj dispozite, nxirren edhe nga rrethanat objektive të faktit.

## **Neni 698**

### **Përvetësimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale**

1. Kushdo që blen, merr, fsheh apo, në një mënyrë tjetër, përvetëson për vete ose për një palë të tretë, apo ndihmon në blerjen, marrjen, fshehjen ose përdorimin e parave apo mallrave të tjera, duke ditur se një person tjetër ka përfituar këto para apo mallra, si pasojë e kryerjes së një vepre penale ose veprimtarie kriminale, dënohet me burgim nga dy deri në tre vjet.

2. Paragrafi i parë i këtij neni zbatohet pavarësisht nëse ka ndalim ligjor për të marrë në përgjegjësi penale personin që ka kryer veprën penale, nga e cila rrjedh përvetësimi i parave ose i mallrave të tjera.

#### **Neni 699**

#### **Çelja e llogarive anonime**

Çelja e depozitave ose e llogarive bankare, anonime ose me emra fiktivë, dënohet me burgim nga dy deri në tre vjet.

#### **Neni 700**

#### **Kryerja e veprës nga personi juridik**

1. Nëse një person juridik ka kryer ndonjëherë prej veprave penale të parashikuara në këtë kre, dënimi me gjobë do të jetë:

a) mbi pesëfishin e vlerës së parave apo pasurive të pastruara siç parashikohet në paragrafin e tretë të nenit 697 të këtij Kodi;

b) deri në pesëfishin e parave apo pasurive të pastruara siç parashikohet në paragrafin e dytë të nenit 697 të këtij Kodi;

c) nga dyfishi deri në trefishin e parave apo pasurive të pastruara siç parashikohet në paragrafin e dytë të nenit 697 të këtij Kodi;

ç) për të gjitha rastet e tjera kur vepra penale nuk ka sjellë dëm material apo përfitim të tillë, zbatohen rregullat e përcaktuara në nenin 123 të këtij Kodi.

2. Gjykata mund të caktojë gjithashtu mbylljen apo pezullimin e veprimtarisë së tij për një kohë të përshtatshme dhe, publikimin e vendimit gjyqësor.

#### **Neni 701**

#### **Dënimet plotësuese**

1. Kur veprat penale të parashikuara në këtë seksion kryhen nga zyrtari publik, atëherë gjykata, krahas dënimit kryesor cakton edhe dënimin plotësues të heqjes të së drejtës për të ushtruar funksione publike sipas parashikimeve të nenit 76 të këtij Kodi.

2. Në çdo rast, do të vendoset konfiskimi i vlerës së parave të pastruara, të ardhurave të realizuara nga vepra penale apo të premtuara si dhe, masën e zëvendësimit të dëmit të shkaktuar.

#### **Neni 702**

#### **Konkurrimi i veprave dhe bashkëpunimi**

1. Në të gjitha rastet kur, për të kryer një prej veprave penale të parashikuara në këtë seksion, autorit i është dashur të kryejë veprime që përbëjnë veprën penale më vete, atëherë kjo e fundit konkurren me veprën që ai ka dashur të kryejë.

2. Nëse për kryerjen e ndonjërisë prej veprave penale të parashikuara në këtë kre, autorit të posaçëm i është dashur të bashkëpunojë me ndonjë person tjetër, pavarësisht cilësive të posaçme të këtij të fundit, ata do të përgjigjen për kryerjen në bashkëpunim të veprës penale të parashikuar në këtë kre, apo çfarëdolloj veprave penale që konkurron me to.

## TITULLI VII

### VEPRAT PENALE KUNDËR FËMIJËVE, FAMILJES DHE MARTESËS

#### KREU I

#### VEPRAT PENALE KUNDËR FËMIJËVE

##### **Neni 703**

##### **Përkufizime**

Për qëllime të këtij kreu do të kuptohen:

a) shprehja “trafikim i të miturve” nënkupton rekrutimin, transportimin, transferimin, pritjen, strehimin, fshehjen, duke përfshirë shkëmbimin ose transferimin e kontrollit mbi këta persona me anë të kanosjes ose të përdorimit të forcës apo me forma të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, kurthit, shpërdorimit të detyrës ose duke përfituar nga gjendja shoqërore, fizike apo psikike, ose me anë të dhënies ose marrjes së pagesave apo përfitimeve për të arritur miratimin e personit që ka kontroll mbi të miturin, me qëllim të shfrytëzimit të tij si brenda ashtu dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

b) shprehja “shfrytëzim” përfshin, por nuk kufizohet në, shfrytëzimin e prostitucionit të të miturve, pornografisë ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, lëmshës, shërbimeve ose punës së detyruar, skllavërisë ose veprimeve të ngjashme me skllavërinë, robërisë, veprimtarise kriminale ose heqjes së organeve apo qelizave.

c) Rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi ose marrja e një fëmije për qëllim shfrytëzimi do të konsiderohet “trafikim i qenieve njerëzore” edhe nëse kjo nuk përfshin një nga mjetet e parashtruara në paragrafin “a” të këtij neni;

ç) kompromisi apo pëlqimi i viktimës së trafikimit për qëllime shfrytëzimi nuk është i vlefshëm në lidhje me shfrytëzimin e synuar.

d) “Fëmijë” do të nënkuptojë çdo person fizik, nën moshën 18 vjeç, që është objekt trafikimi qeniesh njerëzore, siç përcaktohet në këtë nen.

dh) “Viktimë” do të nënkuptojë çdo person fizik të mitur që është objekt i trafikimit të qenieve njerëzore, siç përcaktohet në këtë nen.

##### **Neni 704**

##### **Trafikimi i të miturve**

1. Trafikimi i të miturve dënohet me burgim nga dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet.
2. Organizimi, drejtimi dhe financimi i trafikimit të të miturve dënohen me burgim nga pesëmbëdhjetë deri në njëzetë vjet.

3. Vepra penale e parashikuar nga paragrafi një i këtij neni e kryer ndaj të miturit nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet.

4. Vepra penale e parashikuar nga paragrafi një i këtij neni dënohet jo më pak se njëzetë vjet burgim nëse veprimet e parashikuara në të janë kryer:

a) duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore ose çrregullim të rëndë për shëndetin mendor apo fizik viktimës;

b) kur vepra kryhet nga gjini e afërt me viktimën ose kur vepra është kryer nga një person që është në marrëdhënie familjare me viktimën;

c) kur vepra është kryer nga mësuesi, udhëheqësi fetar, specialisti i kujdesit shëndetësor, personi të cilit i është besuar kujdesi për viktimën ose që në ndonjë mënyrë tjetër ka autoritet ndaj viktimës;

ç) kur vepra është kryer nga një person që është “maskuar” ose që simulon cilësinë e një funksionari publik ose nga një person i ngarkuar me një shërbim publik.

5. Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e viktimës së mitur, dënohet me burgim jo më pak se njëzetë e pesë vjet ose me burgim të përjetshëm.

6. Tentativa për kryerjen e krimit të mësipërm ndëshkohet njëlloj si krimi i kryer.

7. Gjykata vendos edhe konfiskimin e mjediseve ku mbahen fëmijët e trafikuar që kanë shërbyer për strehimin e tyre.

## **Neni 705**

### **Veprime që lehtësojnë trafikimin**

1. Falsifikimi, zotërimi ose sigurimi i dokumentit të identitetit, i pasaportave, i vizave ose i dokumenteve të tjera të udhëtimit, apo mbajtja, heqja, fshehja, dëmtimi ose shkatërrimi i tyre me synimin për të realizuar trafikimin e të miturve, dënohet me burgim nga katër deri në dhjetë vjet.

2. Kur vepra është kryer nga personi që ka për detyrë të lëshojë letërnjoftimin, pasaportën, vizën apo dokumentin e udhëtimit, dënimi i parashikuar në paragrafin e parë, shtohet deri me një të dytën e tij.

3. Kur vepra e kryer sipas parashikimit të paragrafit të parë, ka mundësuar trafikimin e fëmijëve, por është kryer pa dijeninë e autorit mbi këtë fakt, dënimi i parashikuar në atë paragraf, ulet me një të dytën e tij.

## **Neni 706**

### **Fshehja e dokumenteve të identifikimit të viktimave të mitur të skllavërisë ose trafikimit**

1. Cilido që fsheh, mban, heq, dëmton ose shkatërron dokumentet personale të identifikimit apo pasaportën e të miturit për të cilin ka dijeni se është viktimë e veprave penale të trafikimit të genieve njerëzore, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

2. Kur vepra penale kryhet nga personi zyrtar në shpërdorim të funksionit të tij apo me autorizim të tij, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.

## **Neni 707**

### **Përfitimi ose përdorimi i shërbimeve të ofruara nga të miturit e trafikuar**

1. Kushdo që shfrytëzon ose mundëson shërbimet seksuale të viktimës së mitur të trafikimit nën moshën 16 vjeç, dënohet me burgim nga dhjetë deri në njëzetë vjet.

2. Kur vepra penale e parashikuar nga paragrafi një i këtij neni kryhet ndaj të viktimës së mitur të moshës 16 deri nën 18 vjeç, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

3. Kur vepra penale e parashikuar nga paragrafi një i këtij neni kryhet ndaj viktimës me aftësi të ulët mendore ose fizike, çrregullime apo paaftësi mendore, fizike ose shtatzënisë, dënohet me burgim nga tetë deri në shtatëmbëdhjetë vjet.

4. Kur vepra penale kryhet nga personi zyrtar në keqpërdorim të pozitës apo në bazë të autorizimeve të tij, dënohet me burgim nga shtatë deri në trembëdhjetë vjet.

5. Nëse vepra penale e parashikuar nga paragrafi një, dy dhe tre i këtij neni rezulton me vdekjen e viktimës së mitur të trafikimit, dënohet jo më pak se njëzet e pesë vjet ose me burgim të përjetshëm.

6. Për qëllime të këtij neni, nuk është e rëndësishme nëse personi e ka ditur apo jo se viktima është viktimë e mitur e trafikimit, përveç nëse për arsye objektivist të justifikuara, mosnjohja ka qenë e paevitueshme dhe ai nuk e ka ditur dhe nuk ka mundur ta dijë se personi është viktimë e trafikimit.

## **Neni 708**

### **Keqtrajtimi i të miturit**

1. Keqtrajtimi fizik ose psikologjik i të miturit në vijimësi, ose periodikisht nga prindërit, prindërit adoptues, kujdestari apo çdo person tjetër që ushtron autoritet prindëror mbi fëmijën apo është i detyruar të kujdeset për të, dënohet me burgim nga një deri në katër vjet.

2. Detyrimi, shfrytëzimi, shtytja ose përdorimi i të miturit për të punuar jashtë rasteve të lejuara me ligj për moshën e tij, me synimin për të siguruar të ardhura, të lypë para ose lëmshë në ushqime, sende etj., apo të kryejë veprimtari që dëmtojnë zhvillimin e tij mendor dhe/ose fizik, apo pengojnë arsimimin e detyrueshëm të tij, i kryer nga personat e shënuar në paragrafin e parë, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet dhe shoqërohet detyrimisht me dënimin plotësues të heqjes së të drejtës për ushtrimin e përgjegjësisë prindërore.

3. Dënimet e parashikuara nga paragrafët një dhe dy të këtij neni rriten deri me një të dytën nëse veprimet e parashikuara në to janë kryer:

a) ndaj një të mituri nën moshën 10 vjeç;

b) duke shfrytëzuar cilësitë specifike të të miturit si aftësitë e kufizuara mendore apo fizike.

4. Kur nga vepra penale sipas paragrafëve një, dy, tre është shkaktuar dëmtimi i rëndë i shëndetit mendor apo dëmtim i rëndë fizik i të miturit, dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë deri në njëzet e pesë vjet.

5. Kur nga vepra penale sipas paragrafëve një, dy, tre është shkaktuar vdekja e të miturit, dënohet me burgim jo më pak se njëzet e pesë vjet ose me burgim të përjetshëm.

## **Neni 709**

### **Braktisja e fëmijëve të mitur**

1. Braktisja e të miturit nën moshën 16 vjeç nga prindërit, prindërit adoptues, kujdestari apo çdo person tjetër që ushtron autoritet prindëror mbi fëmijën apo çdo person që është i detyruar të kujdeset për të, në një vend çfarëdo dënohet nga tre deri në shtatë vjet burgim, përveç rastit kur

rrethanat e braktisjes kanë pasur si qëllim të garantojnë dhe sigurojnë mbarëvajtjen, shëndetin dhe sigurinë fizike të të miturit.

2. Dënimi i parashikuar nga paragrafi një i këtij neni rritet deri me një të tretën nëse vepra penale është kryer ndaj një të mituri nën moshën dhjetë vjeç.

3. Braktisja e të miturit në një vend apo në një mënyrë që rrezikon ose dëmton rëndë shëndetin e tij, apo rrezikon jetën e tij, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.

4. Braktisja e të miturit që ka rezultuar në gjymtimin ose paaftësinë e përhershme të këtij të fundit dënohet nga dhjetë deri në njëzet vjet burgim, dhe kur braktisja e të miturit ka rezultuar me vdekjen e këtij të fundit dënohet jo më pak se njëzet e pesë vjet burgim.

5. Dënimi shtohet me një të tretën nëse vepra penale e parashikuar nga paragrafët një deri katër të këtij neni është kryer për përfitim material apo për motive të tjera të dobëta.

6. Nuk konsiderohet braktisje në kuptim të kësaj dispozite, nëse fëmija lihet të qëndrojë me prindin tjetër përveç rasteve kur ky i fundit, objektivisht, nuk ka asnjë mundësi për ta rritur, edukuar apo siguruar mirëqenien e fëmijës.

## **Neni 710**

### **Ndërmjetësimi për braktisjen e fëmijëve**

Ndërmjetësimi dhe nxitja e kryer me ose pa qëllim fitimi, ndërmjet një personi apo çifti që dëshiron të birësojë një fëmijë dhe një prindi/prindërve që dëshiron/jnë të braktisin fëmijën e tij/tyre të sapolindur ose ende të palindur, dënohet me gjobë ose me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

## **Neni 711**

### **Ndryshimi apo modifikimi i statusit civil të fëmijës**

1. Regjistrimi i një lindjeje të paqenë në regjistrat e gjendjes civile, ose fshehja e një të porsalinduri, duke i zhdukur gjendjen civile, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet.

2. Ndryshimi i gjendjes civile nëpërmjet zëvendësimit të të porsalindurit, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

3. Përpilimi i aktit të lindjes nga personi i ngarkuar me këtë detyrë, duke ndryshuar gjendjen civile të të porsalindurit nëpërmjet paraqitjes së të dhënave të rreme, shton dënimin deri në një të dytën përkatësisht me veprën penale të kryer.

4. Në këtë rast, vepra penale nuk konkurren me falsifikimin e dokumentit.

## **Neni 712**

### **Fshehja e gjendjes civile të fëmijës**

Lënia ose paraqitja në një jetimore ose në një vend tjetër bamirësie, të një fëmije të regjistruar në regjistrat e gjendjes civile si fëmijë i lindur nga martesë ose të cilit i është njohur atësia ose amësia, duke fshehur gjendjen e tij civile, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj.

## **Neni 713**

## **Marrja ose mbajtja e kundërligjshme e fëmijës**

1. Marrja ose mbajtja e kundërligjshme e fëmijës duke e larguar nga prindi, prindi adoptues, kujdestari apo personi tjetër i cili ushtron të drejtën prindërore mbi fëmijën, ose e merr dhe/ose mban fëmijën duke e larguar nga Institucioni të cilit i është besuar fëmija, ose pengon ekzekutimin e vendimit të detyrueshëm të Gjykatës mbi dhënien e fëmijës në besim, për rritje dhe edukim prindit tjetër, prindit tjetër adoptues, kujdestarit, personit tjetër ose institucionit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj.
2. Nëse fëmija është me aftësi të kufizuara, mendore apo fizike, dhe largohet nga subjekti që është duke e mbikëqyrur atë apo ushtron përgjegjësinë prindërore apo kujdestarinë në bazë të një titulli, dënimi sipas paragrafit të dytë, shtohet deri në një të dytën e tij.
3. Ndjekja penale për këtë veprë fillon dhe pushon me kërkesën e viktimës.

### **Neni 714**

#### **Mosnjoftimi i ndryshimit të vendbanimit**

Mosnjoftimi brenda një muaji i ndryshimit të vendbanimit, të interesuarve ose organit të ekzekutimit, nga personi që sipas vendimit gjyqësor detyrohet me dhënien e mjeteve të nevojshme për jetesë fëmijëve, prindërve ose bashkëshortit të vet, si dhe ai të cilit i janë besuar fëmijët pas zgjidhjes së martesës, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre muaj.

### **Neni 715**

#### **Mosekzekutimi i masave për mbrojtjen e fëmijëve**

Mospërbushja apo mosekzekutimi i masave edukative dhe masave të tjera të përcaktuara nga gjykata ose nga një organ tjetër kompetent përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj.

### **Neni 716**

#### **Marrja dhe mbajtja e të miturve jashtë shtetit**

1. Marrja dhe/ose mbajtja ose dërgimi i një të mituri nën moshën katërmëdhjetë vjeç për të qëndruar jashtë shtetit, në mungesë të një titulli ligjor/gjyqësor, duke e larguar nga prindi që ushtron përgjegjësinë prindërore, ose nga kujdestari, kundër vullnetit të të njëjtit prind ose kujdestar, duke u ndaluar atyre plotësisht ose pjesërisht të ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, në rastin kur nuk përbën veprë penale më të rëndë, dënohet me burgim nga një deri në katër vjet.
2. Nëse vepra penale e parashikuar në paragrafin e parë është kryer kundër një të mituri mbi katërmëdhjetë vjeç dhe me pëlqimin e tij, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose burgim deri në gjashtë muaj. Në këtë rast ndjekja penale fillon me ankimin e viktimës dhe pushon kur ajo heq dorë prej tij.

### **Neni 717**

#### **Abuzimi me fëmijët**

Kryerja e përsëritur e veprimeve nga një person apo grup i tillë, që synojnë të cenojnë apo dëmtojnë një person apo grup tjetër personash, nëpërmjet fjalëve apo veprimeve fizike që ndikojnë psikologjikisht te viktima e keqtrajtimit, duke i bërë ata të ndihen fizikisht apo emocionalisht, i dëmtuar, i kërcënuar, nëpërkëmbur, nënshtruar, frikësuar apo mënjeluar, apo të ndihen pa kontroll të vetes për shkak të veprimeve si më poshtë :

- a) thirrja me epitete fyese që synojnë të ngacmojnë, tallin, nëpërkëmbin, nënshtrajnë apo kërcënojnë viktimën, kryer edhe online;
  - b) rrahjet, goditjet, pengimet apo shtyrjet;
  - c) dëmtimi ose marrja e sendeve personale;
  - ç) injorimi, lënia mënjane, vetëm, apo përhapja e thashethemeve, kryer edhe online;
  - d) dërgimi i mesazheve abuzive, fotografive apo imazheve në rrjetet sociale, telefon apo lojërave online;
- dënohet me burgim nga një deri në katër vjet.

### **Neni 718** **Moskujdesi ndaj fëmijës**

1. Privimi i fëmijës nga kujdesi ose ushqimi në mënyrë të tillë që të cenohet shëndeti i tij, nga prindi ose çdo person tjetër që ushtron autoritetin prindëror mbi të, dënohet me burgim deri në katër vjet.

2. Në kuptim të këtij neni, privim nga kujdesi është edhe lënia e një fëmije nën dymbëdhjetë vjeç të vetëm në shtëpi për ore të gjata, në një rrugë apo mjedise publike me frekuentim të lartë njerëzish apo mjedesh motorike ose, edhe në mjedise turistike jashtë vëmendjes prindërore, ose neglizhimi serioz në lidhje me shkollimin ose edukimin e fëmijës nga prindi, kujdestari ose çdo person tjetër që ushtron autoritet prindëror mbi ta, përfshi dhe mosregjistrimin ose mosfrekuentimin e fëmijës në një institucion arsimor pa një justifikim të vlefshëm.

3. Mospërbushja e detyrave nga drejtori i një institucioni arsimor në lidhje me mosfrekuentimin serioz të procesit mësimdhënës prej një fëmije që haptazi do të cenojë rëndë formimin edukativ të fëmijës, mundësinë e përfshirjes së tij në veprimtari të paligjshme apo që mund të përbëjë rrezik për jetën e shëndetin e fëmijës, përbën moskujdes dhe dënohet sipas paragrafit të parë të këtij neni.

### **Neni 719** **Mosraportimi i abuzimit të fëmijëve**

1. Pavarësisht nga zbatimi i dispozitave të tjera ligjore, cilido që konstaton, merr dijeni drejtpërdrejt, ose ka arsye të bazuara për të dyshuar se një fëmijë ka pësuar një incident të abuzimit, keqtrajtimit, braktisjes apo moskujdesit kudo dhe prej kujt do, nuk raporton menjëherë abuzimin ose moskujdesin, dënohet me gjobë ose me burgim nga një deri në tre vjet. Kjo dispozitë nuk konkurren me moskallëzimin e krimit.

2. Cilido që gjatë angazhimit profesional lidhur me fëmijën, përfshirë edhe subjektet që nuk kanë detyrimin për kallëzim sipas ligjit penal, ka arsye të bazuara për të dyshuar se fëmija ka qenë i nënshtruar ndaj dhunës, kanosjes për përdorim të dhunës, abuzimit seksual apo çdo lloj forme

tjetër keqtrajtimi dhe nuk e raporton menjëherë rastin, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

### **Neni 720**

#### **Porosia për të lindur fëmijë**

1. Për qëllime të këtij neni “Porosia për të lindur fëmijë (Surrogacia)” është një marrëdhënie në marrëveshje, pavarësisht formës së saj, ku një femër/grua madhore (nëna surrogate) kundrejt pagesës ose përfitimeve të tjera, jep pëlqimin dhe me vullnetin e saj, merr përsipër të mbajë në trupin e saj dhe të lindë një fëmijë gjenetikisht të lidhur ose jo me nënën porositëse apo përfituesit, në favor të një personi apo çifti/personave përfitues që do të jenë në të ardhmen prindërit e fëmijës pas lindjes, duke ushtruar më pas të drejtat dhe autoritetin prindëror ndaj tij.

2. Përfshirja me qëllim përfitimi e një ndërmjetësi midis një personi ose një çifti që dëshiron të mirëpresë një fëmijë me një grua që pranon ta mbajë këtë fëmijë brenda trupit të saj dhe ta sjellë në jetë, në mënyrë që t’ua dorëzojë pas lindjes atyre, kur nëna e porositur dihet që përdoret rëndom të plotësojë porosi të tilla vetëm për këtë qëllim, duke vendosur në rrezik jetën dhe shëndetin e saj apo të fëmijës, kur inseminimi apo edhe lindja bëhen jashtë mjediseve të përshtatshme/palicensuara për kryerjen e procedurave të tilla apo për lindjen e fëmijëve, dënohen me gjobë ose me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

3. Nëse vepra sipas parashikimit të paragrafit dy të këtij neni, kryhet nga një person që ushtron një profesion shëndetësor, dënim shtohet deri në një të tretën e tij.

### **Neni 721**

#### **Nxitja e të miturve në kryerjen e veprave penale**

1. Nxitja ose tërheqja e të miturve për të kryer një vepër penale, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet.

2. Kur nxitja ose tërheqja bëhet për kryerjen e një veprë penale të rëndë, dënohet me burgim nga katër deri në tetë vjet.

3. Kur nxitja ose tërheqja bëhet për kryerjen e një veprë penale shumë të rëndë, dënohet me burgim nga gjashtë deri në dymbëdhjetë vjet.

4. Kjo dispozitë zbatohet ndaj personit që kryen veprimet sipas paragrafëve më lart, pavarësisht nga zbatimi ndaj tij të dispozitës që parashikon krimin e kryer nga i mituri.

### **Neni 722**

#### **Nxitja për përdorimin e drogës**

1. Provokimi, nxitja, shtytja, tërheqja drejtpërdrejt e një të mituri për të përdorur lëndë narkotike, psikotrope apo stimulantë të tjerë në mënyrë të paligjshme dënohet me burgim nga një deri në katër vjet.

2. Kur vepra penale kryhet ndaj një të mituri nën moshën katërbëdhjetë vjeç, ose kur veprimet janë kryer në mjediset e institucioneve arsimore ose në mjediset e godinave/lokaleve të administruara prej tyre, si dhe në vendet e posaçme të hyrjes dhe daljes së nxënësve nga këto

institucione ose në një distancë të afërt rreth këtyre institucioneve ose godinave/lokaleve, dënohet me burgim nga dy deri në gjashtë vjet.

3. Kjo dispozitë zbatohet ndaj personit që kryen veprimet sipas paragrafëve më lart, pavarësisht nëse ai do të përgjigjet apo jo për kryerjen e ndonjë vepre tjetër penale.

### **Neni 723**

#### **Nxitja e të miturve për të mbajtur apo shpërndarë substanca narkotike**

1. Provokimi, nxitja, shtytja, tërheqja drejtpërdrejt e një të mituri për të mbajtur, ofruar ose shpërndarë lëndë narkotike dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.

2. Kur vepra penale kryhet ndaj një të mituri nën moshën katërmëdhjetë vjeç, ose kur veprimet janë kryer në mjediset e institucioneve arsimore ose në mjediset e godinave/lokaleve të administruara prej tyre, si dhe në vendet e posaçme të hyrjes dhe daljes së nxënësve nga këto institucione ose në një distancë të afërt rreth këtyre institucioneve ose godinave/lokaleve, dënohet me burgim nga katër deri në nëntë vjet.

3 Kjo dispozitë zbatohet ndaj personit që kryen veprimet sipas paragrafëve më lart, pavarësisht nga zbatimi ndaj tij të dispozitës që parashikon krimin e kryer nga i mituri.

### **Neni 724**

#### **Nxitja e të miturve për të përdorur pije alkoolike**

1. Provokimi, nxitja apo shtytja drejtpërdrejt i një të mituri për konsumim të tepërt të pijeve alkoolike, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose deri në një vit burgim.

2. Kur vepra penale e parashikuar në paragrafin një të këtij neni kryhet ndaj një të mituri nën moshën katërmëdhjetë vjeç ose kur veprimet janë kryer në mjediset e institucioneve arsimore ose në mjediset e godinave/lokaleve të administruara prej tyre, si dhe në vendet e posaçme të hyrjes dhe daljes së nxënësve nga këto institucione ose në një distancë të afërt rreth këtyre institucioneve ose godinave/lokaleve, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

3. Nëse veprat penale si më sipër, kryhen në mënyrë demonstrative në mjedise publike duke sfiduar hapur normat e sjelljes së mirë, apo nxitja synon të kthejë të miturin në përdorues të rregullt të alkoolit, dënohet me burgim nga një deri në katër vjet.

### **Neni 725**

#### **Nxitja për të braktisur familjen ose vendin e qëndrimit**

1. Provokimi, nxitja apo shtytja e drejtpërdrejtë që i bëhet një të mituri për të braktisur familjen e tij apo vendin ku ai është duke qëndruar me pëlqimin e prindërve apo kujdestarit të tij ligjor, dënohet me burgim nga një deri në katër vjet.

2. Kur autori i kësaj vepre penale e kthen të miturin pranë familjes, në vendbanimin ose vendqëndrimin e tij ose, e vendos atë në një vend të njohur dhe të sigurt, kur fëmija nuk është bërë objekt i asnjë ngacmimi, abuzimi ose çdo akti tjetër kriminal si dhe, pa iu vënë në rrezik jeta, shëndeti, integriteti fizik ose liria dhe paprekshmëria seksuale, dënimi sipas paragrafit të parë ulet deri në një të dytën, me kushtin që vendi i qëndrimit të të miturit t'i jetë komunikuar prindërve ose

kujdestarit të tij ose, kurdoherë mungesa e fëmijës të mos ketë tejkaluar afatin prej njëzet e katër orë.

#### **Neni 726**

#### **Shpërndarja e mesazheve me rrezik për të miturit**

1. Prodhimi, shpërndarja përmes programeve audiovizive apo kompjuterike, përmes komunikimit me publikun në internet apo, tregtimi me çfarëdo mënyre i pajisjeve apo mesazhi me një natyrë të dhunshme, frikësuese, apo që nxit terrorizëm, ose që mund të shkaktojë dëm serioz për dinjitetin njerëzor ose, që iu drejtohet apo nxit të miturit të përfshihen në lojëra ose çdo veprimtari tjetër që i vë ata në rrezik për shëndetin mendor apo fizik, kur mesazhi ka të ngjarë të shihet ose perceptohet nga i mituri, dënohet nga një deri në pesë vjet burgim.

2. Gjykata vendos gjithmonë për mbylljen e veprimtarisë së burimit që shpërndan, prodhon programet që përbëjnë veprën penale sipas paragrafit të parë, për një kohë që ajo e sheh të përputhur me rëndësinë e veprës së kryer dhe interesit më të lartë të fëmijës.

#### **Neni 727**

#### **Komunikimi i detyrueshëm me seksionin për të mitur të gjykatës civile**

Kur fillon një procedim penal për cilëndo prej veprave të parashikuara në këtë seksion, nëse janë kryer në dëm të një të mituri ose nga një prej prindërve të një të mituri në dëm të prindit tjetër, prokurori është i detyruar të kërkojë në gjykatën penale dhe atë civile për të mitur marrjen e masave të mbrojtjes dhe çdo masë tjetër të nevojshme sipas Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, ose ligjeve të posaçme që rregullojnë këtë marrëdhënie, Kodit të Familjes dhe legjislacionit të zbatueshëm për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve.

#### **Neni 728**

#### **Kryerja e veprës nga personi juridik**

1. Nëse një person juridik ka kryer ndonjërin prej veprave penale të shënuara më poshtë, dënimi me gjobë do të jetë:

a) mbi pesëfishin e vlerës së përfitimit të paligjshëm kur janë shkelur nenet 704, 708, 706 dhe 708, paragrafi 2, 726 të këtij kreu;

b) për veprat penale të parashikuara në nenet 707, 709, 711, 715, 716, 717, 718, 721, 722, 723, 724 dhe 725 të këtij kreu, gjykata cakton dyfishin e vlerës së gjobës së përmendur në nenin 123 të këtij Kodi.

2. Në rastet veçanërisht të rënda, kur pasojat nga krimet e përmendura në këtë kre janë të rënda, të përsëritura, të kryera në konkurrim të krimeve të rënda duke shfrytëzuar fshehtas veprimtarinë tregtare të lejuara, apo prej subjekteve të krimit të organizuar, gjykata vendos mbylljen e veprimtarisë së personit juridik.

#### **Neni 729**

#### **Kryerja e veprës në bashkëpunim**

Nëse për kryerjen e ndonjërës prej veprave penale të parashikuara në këtë kre, autorit të posaçëm i është dashur të bashkëpunojë me ndonjë person tjetër, pavarësisht cilësive të posaçme të këtij të fundit, ata do të përgjigjen për kryerjen në bashkëpunim të veprës penale të parashikuar në këtë kre, apo çfarëdolloj vepre penale që konkurron me to.

### **Neni 730**

#### **Dënimet plotësuese dhe konkurrimi**

1. Nëse veprat penale të parashikuara në këtë seksion kryhen edhe nga nëpunësi publik i caktuar sipas ligjit, atëherë gjykata, krahas dënimit kryesor cakton edhe dënimin plotësues, heqjen e së drejtës për të punuar në shërbimin publik, ose çdo dënim tjetër plotësues që çmon të arsyeshëm, në përputhje me natyrën e veprës dhe veprimeve të kryera nga i dënuari, gjithmonë nëse dispozita konkrete nuk ka parashikuar ndryshe.

2. Në çdo rast gjykata vendos masën e zëvendësimit të dëmit të shkaktuar dhe, përveç sendeve që kanë shërbyer për kryerjen e veprave penale, kur ajo është kryer nga subjektet me qëllim përfitimi material apo te premtuar, vendoset konfiskimi i te ardhurave nga vepra penale apo te premtuara. 3. Për qëllim të këtij seksioni, nëse mënyrat e kryerjes së veprave penale të parashikuara këtu që kanë bërë të mundur kryerjen e ndonjërës prej tyre, përbëjnë vepra penale më vete, atëherë ato konkurrojnë me veprën penale të cilës i kanë shërbyer për të sjellë apo tentuar pasojën.

4. Gjkata vendos edhe masën penale të regjistrimit dhe shkëmbimit të të dhënave që përmbajnë të dhëna rreth subjektit lidhur me rastet kur vepra penale ka rëndësi për njohjen dhe parandalimin e kryerjes së krimeve me natyrë edhe ndërkombëtare.

5. Për veprat penale të lehta të parashikuara në nenet 710, 712, 713, paragrafi i parë, 714, 715, 719, 720, 724, paragrafi i parë dhe i dytë kur çmohet e arsyeshme, gjykata mund të vendosë dhënien e jo më pak se sa dy dënimeve plotësuese në vend të dënimit kryesor.

## **KREU II**

### **VEPRAT PENALE KUNDËR FAMILJES**

#### **Neni 731**

##### **Përkufizime**

1. Në kuptim të këtij kreu me dhunë në familje vlerësohen të gjitha aktet e dhunës fizike, psikologjike ose ekonomike që ndodhin brenda familjes ndërmjet bashkëshortëve ose partnerëve aktualë, fëmijëve, ish-bashkëshortëve ose partnerëve pavarësisht nga fakti nëse autori i veprës penale ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën, me pasojë cenimin e integritetit fizik, psiko-social dhe ekonomik të viktimës.

2. Vlerësohet si akt i dhunës në familje, përtej subjekteve të parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni, ajo e kryer nga anëtarët e njësisë shtëpiake, kur varësia apo lidhja e tyre është e përhershme e pandërprerë, biologjike dhe gëzojnë interesa të përbashkëta.

3. Me njësi shtëpiake kuptohet banesa ose çdo mjedis i përdorur pavarësisht nëse është në pronësi apo përdorim familjar.

#### **Neni 732**

## Dhuna në familje

1. Në kuptim të këtij neni dhunë në familje vlerësohen të gjitha aktet e dhunës fizike, psikologjike ose ekonomike që ndodhin brenda familjes ndërmjet bashkëshortëve ose partnerëve aktualë, fëmijëve, ish-bashkëshortëve ose partnerëve pavarësisht nga fakti nëse autori i veprës penale ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën, me pasojë cenimin e integritetit fizik, psiko-social dhe ekonomik të viktimës.

2. Vlerësohet si akt i dhunës në familje, përtej subjekteve të parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni, ajo e kryer nga anëtarët e njësisë shtëpiake, kur varësia apo lidhja e tyre është e përhershme e pandërprerë, biologjike dhe gëzojnë interesa të përbashkëta.

3. Me njësi shtëpiake kuptohet banesa ose çdo mjedis i përdorur pavarësisht nëse është në pronësi apo përdorim familjar.

2. Rrahja, si dhe çdo vepër tjetër dhune në familje, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

3. Kanosja serioze për vrasje ose plagosje të rëndë, ndaj subjekteve të përcaktuara në paragrafin e parë të këtij neni, dënohet me gjobë ose me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

4. Dëmtimi i lehtë i shëndetit me dashje ndaj subjekteve të përcaktuara në paragrafin e parë të këtij neni, dënohet me burgim nga një deri në katër vjet.

5. Po kjo vepër penale dënohet nga dy deri në shtatë vjet burg kur kryhet në një nga rrethanat e mëposhtme:

a) kur është kryer nga një person që ushtron një funksion publik apo shtetëror, ose ushtron një funksion apo detyrë që e ngarkon me detyrimin ligjor të inicijë, hetojë, gjykojë apo asistojë për shkak detyre në hetimin/gjykimin e veprave të tilla;

b) kur është kryer ndaj një të mituri;

c) kur është kryer në prani të fëmijës/fëmijëve të mitur;

ç) kur është kryer ndaj viktimës me cilësi të veçanta, me aftësi të kufizuara fizike, mendore ose ndaj grave shtatzëna;

d) kur është kryer nga disa persona në bashkëpunim me njëri-tjetrin;

dh) kur autori është dënuar më parë për vepra penale të një natyre të ngjashme;

e) kur vepra penale është paraprirë ose shoqëruar me dhunë ekstreme;

ë) kur është kryer me përdorimin ose nën kërcënimin për përdorimin e një arme;

f) kur ka shkaktuar dëmtim të rëndë fizik ose psikologjik të viktimës.

6. Po kjo vepër penale dënohet nga tre deri në tetë vjet burgim kur kryhet në prani të dy ose më shumë rrethanave të parashikuara në paragrafin e pestë të këtij neni.

7. Dëmtimi i rëndë i shëndetit me dashje ndaj subjekteve të përcaktuara në paragrafin e parë të këtij neni, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.

8. Vepra penale sipas paragrafit të shtatë të këtij neni, dënohet nga pesë deri në trembëdhjetë vjet burg kur kryhet në prani të një prej rrethanave të parashikuara në paragrafin e pestë të këtij neni dhe, nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet burg, kur kryhet në prani të dy ose më shumë prej këtyre rrethanave.

9. Dënimi kryesor për kryerjen e krimit sipas këtij neni shoqërohet detyrimisht, sipas cilësisë së autorit të veprës apo viktimës, me një nga dënimet plotësuese, si më poshtë:

a) të humbjes/heqjes së përgjegjësisë prindërore ose të kujdestarisë ligjore;

b) të ndalimit të së drejtës për të ushtruar funksione publike;

c) të detyrimit për të paguar dëmin që i është shkaktuar viktimës;

- c) të detyrimit për t' u larguar përkohësisht nga banesa e përbashkët ku jetojnë autori dhe viktimat;
- d) të ndalimit për t'iu afruar viktimës, të afërmeve të saj apo për të komunikuar me ta;
- dh) të detyrimit për të marrë pjesë në seanca terapeutike sociale, dezintoksitimi apo kurse edukimi për menaxhimin e sjelljes, vetëkontrollit, agresivitetit dhe emocioneve.

### **Neni 733**

#### **Ndjekja penale**

1. Neni 732 i këtij Kodi gjen zbatim edhe kur fakti është konsumuar jashtë territorit nga një shtetas shqiptar ose nga një i huaj me banim në Shqipëri ose në dëm të një shtetasi shqiptar ose të një të huaji me banim në Shqipëri.
2. Për sa parashikohet në nenin 732 të këtij Kodi, rrethanat që lidhen me kulturën, zakonet, fenë, shoqërinë, traditën, sjelljen e duhur apo nderin vetjak, nuk përdoren nga gjykata si elemente që lehtësojnë dënimin penal.
3. I mituri i pranishëm në keqtrajtimet e përmendura në këtë nen, vlerësohet si viktimë e veprës penale.

### **Neni 734**

#### **Mospërbushja e detyrimeve ligjore familjare**

1. Mosekzekutimi i detyrimeve të caktuara në bazë të një vendimi gjyqësor ose të një prej titujve ekzekutivë të përmendur në dispozitat përkatëse të Kodit të Familjes, nga personi i ngarkuar me detyrimin për të paguar në favor të fëmijës së mitur, paraardhësit, pasardhësit, ose bashkëshortit një pension, kontribut, ose përfitime të çdo lloji për shkak të një prej detyrimeve familjare të parashikuara nga ligji, për më shumë se dy muaj pa e përbushur plotësisht këtë detyrim megjithëse ka mundësitë të bëjë atë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose burgim nga tre muaj deri në dy vjet.
2. Mosekzekutimi i detyrimeve të caktuara në bazë të një vendimi gjyqësor ose të një prej titujve ekzekutivë të përmendur në dispozitat përkatëse të Kodit të Familjes, nga personi i ngarkuar me detyrimin për të paguar një pension, kontribut, ose përfitime të çdo lloji, në favor të fëmijës së mitur, paraardhësit, pasardhësit ose bashkëshortit, për më shumë se dy muaj dhe i ka mundësitë për ta përbushur këtë detyrim, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose burgim nga tre muaj deri në dy vjet.
3. Në këtë rast ndjekja penale fillon me ankimin e viktimës dhe pushon kur ajo heq dorë prej tij.
4. Dënimi i parashikuar nga paragrafi i parë i këtij neni rritet deri me një të dytën nëse vepra penale është kryer:
  - a) ndaj fëmijës së mitur nën moshën katërbëdhjetë vjeç;
  - b) ndaj subjektit përfitues me cilësi të veçanta, si aftësitë e kufizuara mendore apo fizike.
5. Në rast se personi i ngarkuar për të paguar detyrimet për jetesë sipas paragrafit të parë, i shlyen ato deri ditën e dhënies së vendimit penal përfundimtar nga ana e gjykatës, çështja pushohet nëse organi procedues krijon bindjen që ai nuk do ta kryejë më këtë veprë penale në të ardhmen.

### **Neni 735**

#### **Shmangia nga detyrimi i sigurimit të mjeteve të jetesës**

1. Mospërbushja apo shmangia nga detyrimi i sigurimit të mjeteve të jetesës nga personi i detyruar për t'u kujdesur në bazë të vendimit të gjykatës, aktit ose vendimit të organit tjetër kompetent, duke iu shmangur punësimit, duke gënjyer për punën apo të ardhurat, duke ndërruar vendin e punës, vendbanimin apo vendqëndrimin, duke tjetërsuar pasurinë, apo çdo mënyrë tjetër, me qëllimin që t'i shmanget sigurimit të mjeteve të jetesës për personin përfitues për më shumë se dy muaj, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

2. Në këtë rast ndjekja penale fillon me ankimin e viktimës dhe pushon kur ajo heq dorë prej tij.

3. Dënimi i parashikuar nga paragrafi i parë i këtij neni rritet deri me një të dytën nëse vepra penale është kryer:

a) ndaj fëmijës së mitur nën moshën katërbëdhjetë vjeç;

b) ndaj subjektit përfitues me cilësi të veçanta, si aftësitë e kufizuara mendore apo fizike.

4. Në rast se personi i ngarkuar për të paguar detyrimet për jetesë sipas paragrafit të parë, i shlyen ato deri ditën e dhënies së vendimit penal përfundimtar nga ana e gjykatës, çështja pushohet nëse organi procedues krijon bindjen që ai nuk do ta kryejë më këtë vepër penale në të ardhmen.

### **Neni 736**

#### **Kryerja e akteve seksuale me persona në gjini ose nën kujdestari**

1. Kryerja e marrëdhënieve seksuale me pëlqim të subjekteve, një pasardhës ose paraardhës, ose me një të afërm gjaku në vijë të drejtë, ose me motrën ose vëllain, dënohet me gjobë ose me burgim nga dy deri në pesë vjet.

2. Nëse vepra penale është kryer nga një person madhor me një të mitur nën gjashtëmbëdhjetë vjeç, ose duke përfituar nga autoriteti prindëror apo çdo autoritet tjetër mbizotërues në marrëdhënien midis tyre, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

3. Në kuptim të kësaj dispozite, pasardhësit, paraardhësit ose të afërmit e gjakut në vijë të drejtë përfshijnë prindin biologjik, prindin birësues, njerkun apo njerkën, gjyshin ose gjyshen, dajën, xhaxhain, tezen, hallën, fëmijën e birësuar, thjeshterin apo thjeshtërën, nipin apo mbesën, fëmijët e vëllezërve apo të motrave dhe kujdestari nëse përfiton nga autoriteti mbizotërues.

4. Vepra penale do të quhet e kryer edhe nëse marrëdhënia familjare apo e kujdestarisë ka pushuar së ekzistuari.

### **Neni 737**

#### **Birësimi në kundërshtim me ligjin**

1. Shtytja ose nxitja e prindërve ose e njërit prej prindërve për të braktisur fëmijën e tyre të lindur ose që pritet të lindë, për qëllim përfitimi, ose për marrje dhuratash, premtimesh ose nëpërmjet kanosjes apo abuzimit me detyrën, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

2. Ndërmjetësimi midis personit që dëshiron të birësojë një fëmijë dhe një prindi që dëshiron të braktisë fëmijën e tij të lindur ose që pritet të lindë, i kryer për qëllime përfitimi, dënohet me burgim nga një deri në katër vjet.

3. Kur çmohet e arsyeshme, gjykata mund të vendosë dhënien e jo më pak se sa dy dënimeve plotësuese në vend të dënimit kryesor.

### **Neni 738**

## **Kryerja e veprimeve në kundërshtim me urdhrin e gjykatës**

1. Kryerja e veprimeve në kundërshtim me vendimin e gjykatës në lidhje me ndalimet apo detyrimet e lindura nga këto vendime në marrëdhëniet familjare, përfshirë edhe dënimet apo masat plotësuese të dhëna prej saj, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

2. Kryerja e veprimeve në kundërshtim me vendimin e gjykatës, në lidhje me ndalimet apo detyrimet e sanksionuara të dhëna prej saj lidhur me mardhenijet familjare, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

3. Për qëllim të këtij kreu, urdhrat e mbrojtjes të dhëna nga gjykata civile apo urdhrat për masat paraprake të mbrojtjes të dhëna nga organet policore që lidhen me mardhenijet familjare, barazohen me dënimet plotësuese dhe masat e tjera penale.

### **Neni 739**

#### **Dënimet plotësuese**

1. Nëse veprat penale të parashikuara në këtë titull kryhen nga nëpunësi publik, atëherë gjykata, krahas dënimit kryesor cakton edhe dënimin plotësues të heqjes së të drejtës për të punuar në shërbimin publik, ose çdo dënim tjetër që çmon të arsyeshëm, në përputhje me natyrën e veprës dhe veprimeve të kryera nga i dënuari, gjithmonë nëse dispozita konkrete nuk ka parashikuar ndryshe.

2. Në çdo rast gjykata vendos masën e zëvendësimit të dëmit të shkaktuar dhe, përveç sendeve që kanë shërbyer për kryerjen e veprave penale, kur ajo është kryer nga subjektet me qëllim përfitimi material apo të premtuar, vendoset konfiskimi i të ardhurave nga vepra penale apo të premtuara.

### **Neni 740**

#### **Konkurrimi i veprave dhe bashkëpunimi**

1. Në të gjitha rastet kur, për të kryer një prej veprave penale të parashikuara në këtë titull autorit i është dashur të kryejë veprime që përbëjnë vepër penale më vete, atëherë kjo e fundit konkurren me veprën që ai ka dashur të kryejë, përveçse kur dispozita konkrete është shprehur ndryshe.

2. Nëse për kryerjen e ndonjërës prej veprave penale të parashikuara në këtë kre, autorit të posaçëm i është dashur të bashkëpunojë me ndonjë person tjetër, pavarësisht cilësive të posaçme të këtij të fundit, ata do të përgjigjen për kryerjen në bashkëpunim të veprës penale të parashikuar në këtë kre, apo çfarëdolloj vepre penale që konkurren me to.

### **Neni 741**

#### **Zbatimi i dispozitave në varësi të numrit të viktimave**

Për efekt të numrin e viktimave, çdo dispozitë e këtij titulli do të zbatohet aq herë sa është numri i tyre, pavarësisht nga lloji apo shkalla e pasojave që rezultojnë nga kryerja e veprave penale.

KREU III  
VEPRAT PENALE KUNDËR MARTESËS

**Neni 742**

**Bigamia**

1. Lidhja e dy ose më shumë martesash në të njëjtën kohë dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.
2. Nëse bigamia vazhdon pas dënimit të parë, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet.
3. Ky nen gjen zbatim edhe kur fakti është konsumuar jashtë territorit nga një shtetas shqiptar ose nga një i huaj me banim në Shqipëri ose në dëm të një shtetasi shqiptar ose të një të huaji me banim në Shqipëri, në vende apo shtetas të vendeve që e lejojnë bigaminë.

**Neni 743**

**Shtrëngimi ose pengimi për të bashkëjetuar ose për të lidhur apo zgjidhur martesën**

1. Shtrëngimi ose detyrimi i një personi tjetër për të lidhur martesë ose për të filluar bashkëjetesë apo, lidhja e martesës me personin për të cilin është në dijeni se është shtrënguar apo detyruar nga të tretë të lidhë këtë martesë ose fillojë këtë bashkëjetesë, dënohet me gjobë ose burgim nga një deri në pesë vjet. Ndjekja penale fillon me ankimin e viktimës dhe pushon kur ajo heq dorë nga ankimi.
2. Pengimi për të filluar ose vazhduar bashkëjetesën, ose shtrëngimi për të zgjidhur martesën, përbën kundërvajtje penale dhe, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit. Ndjekja penale fillon me ankimin e viktimës dhe pushon kur ajo heq dorë nga ankimi.
3. Kur vepra penale e parashikuar nga paragrafi një i këtij neni kryhet nga prindi, prindi adoptues, kujdestari apo ndonjë person tjetër që ushtron autoritet prindëror ndaj të miturit të moshës 16 deri 18 vjeç, dënohet me burgim nga dy deri në gjashtë vjet.
4. Kur vepra penale e parashikuar nga paragrafi një i këtij neni kryhet nga prindi, prindi adoptues, kujdestari apo ndonjë person tjetër që ushtron autoritet prindëror ndaj personit të moshës 14 deri 16 vjeç, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet.
5. Kur vepra penale e parashikuar nga paragrafi një i këtij neni kryhet nga prindi, prindi adoptues, kujdestari apo personi tjetër që ushtron autoritet prindëror ndaj personit nën moshën 14 vjeç, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.
6. Kur vepra penale e parashikuar nga paragrafët një deri pesë të këtij neni kryhet me qëllim të përfitimit pasuror, dënimi i parashikuar në secilin paragraf shtohet deri në një të dytën.
7. Shtytja e një personi që të lidhë martesë duke përfutuar nga kushtet e vulnerabilitetit ose të gjendjes mendore, ose të pamundësisë ekonomike, apo duke shpërdoruar marrëdhëniet familjare, shtëpiake, të punës, ose të autoritetit që lidhen me vendosjen e personit në kujdestari për arsye përkujdesjeje, arsimimi ose edukimi, mbikëqyrje ose ruajtjeje, dënimi shtohet deri në një të dytën e tij.
8. Ky nen gjen zbatim edhe kur fakti është konsumuar jashtë territorit nga një shtetas shqiptar ose nga një i huaj me banim në Shqipëri ose në dëm të një shtetasi shqiptar ose të një huaji me banim në Shqipëri.

#### **Neni 744**

### **Lejimi i lidhjes së martesës në kundërshtim me ligjin**

Lidhja e martesës nga personi i autorizuar për të lidhur martesë, që në shpërdorim të funksionit të tij dhe në dijeni për pengesat ligjore të cilat e ndalojnë martesën, e lidh atë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj.

#### **Neni 745**

### **Bashkëjetesa me të miturin nën moshën 18 vjeç**

1. Bashkëjetesa e një personi madhor me një të mitur të moshës 14 deri nën 16 vjeç, kur bëhet për qëllime të njëjta me ato të martesës apo marrëdhënies së ngjashme me të, dënohet me burgim nga katër deri në tetë vjet.

2. Nëse bashkëjetesa kryhet me një të mitur të moshës 16 deri në 18 vjeç, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

3. Prindi, prindi adoptues, kujdestari apo ndonjë person tjetër që ushtron autoritet prindëror, që e udhëzon, lejon, këshillon, ose e shtyn të miturin e moshës 14 deri 18 vjeç që të bashkëjetojë me personin madhor, sipas paragrafit të parë e të dytë të këtij neni, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.

4. Kur vepra penale e parashikuar nga paragrafët një, dy ose tre të këtij neni kryhet ndaj personit nën moshën 14 vjeç, dënohet nga tetë deri në gjashtëmbëdhjetë vjet burgim.

5. Kur vepra penale e parashikuar nga paragrafët e këtij neni kryhet me qëllim të përfitimit pasuror, dënimi i parashikuar në secilin paragraf shtohet deri në një të dytën.

## **TITULLI VIII**

### **VEPRAT PENALE KUNDËR PERSONIT**

#### **KREU I**

### **VEPRAT PENALE KUNDËR JETËS**

#### **Neni 746**

### **Vrasja me dashje**

Vrasja e kryer me dashje, dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë deri në njëzet vjet.

#### **Neni 747**

### **Vrasja me paramendim**

1. Vrasja me paramendim dënohet me burgim nga njëzet deri në tridhjetë vjet, ose me burgim të përjetshëm.

2. Në kuptim të paragrafit të parë të këtij neni, përveçse kur vrasja kryhet me përgatitje paraprake, me paramendim do të kuptojmë edhe kur autori i veprës penale, pavarësisht kohës së kaluar nga çasti i lindjes së shkakut deri në kryerjen e krimit, është në gjendje të reflektojë për rrethanat e

ngjarjes, të formojë dashjen, qëllimin dhe bindjen për të kryer vrasjen me mjetet e gjetura prej tij të përshtatshme për arritjen e qëllimit kriminal, duke shfaqur kontroll tërësor të veprimeve të tij, që çojnë në kryerjen e saj sipas vendimit të marrë.

#### **Neni 748**

#### **Vrasja me paramendim për motive**

1. Kryerja e vrasjes shtyrë nga motive të gjakmarrjes, dënohet me burgim nga njëzet e pesë deri në tridhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.

2. Vrasja e kryer për interes material, apo motive të dobëta, si xhelozia, zilia, smira, kotësia, lakmia, përtacia, epshi, zemërimi, krenaria, hakmarrja, dënohet me burgim jo më pak se njëzet e pesë vjet ose me burgim të përjetshëm.

#### **Neni 749**

#### **Vrasja e funksionarëve publikë**

Vrasja me dashje e deputetit, gjyqtarit, prokurorit, avokatit, ushtarakut, punonjësve të Policisë së Shtetit apo e funksionarëve të tjerë publikë, gjatë detyrës ose për shkak të saj, dënohet me burgim jo më pak se njëzet e shtatë vjet ose me burgim të përjetshëm.

#### **Neni 750**

#### **Vrasja në rrethana të cilësuar**

1. Vrasja me dashje e kryer:

- a) ndaj të miturit;
- b) ndaj personit në gjendje të cënueshme ngaqë është me mangësi fizike ose psikike, i pambrojtur, i sëmurë rëndë ose shtatzënë;
- c) ndaj kallëzuesit, dëshmitarit, të viktimës ose palëve të tjera ndërgjyqëse;
- ç) në mënyrë të tillë që i shkakton mundime të veçanta viktimës;
- d) ndaj grave;
- dh) në mënyrë dhe mjete të rrezikshme,

dënohet me burgim jo më pak se njëzet e pesë vjet ose, me burgim të përjetshëm.

#### **Neni 751**

#### **Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare**

Vrasja me dashje e personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, për shkak të këtyre marrëdhënieve, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm.

#### **Neni 752**

#### **Vrasja e foshnjës**

1. Vrasja e foshnjës e kryer nga nëna, gjatë ose menjëherë pas lindjes, për shkak të çrregullimeve nga lindja, dënohet me burgim deri në tre vjet.

2. Kur vrasja e foshnjës deri në një vjeç, ndodh nga nëna për shkak të çrregullimeve nga lindja që vazhdojnë të prishin ekuilibrin e saj mendor, dënohet me burgim deri në shtatë vjet.

#### **Neni 753**

#### **Vrasja me pëlqimin e viktimës**

1. Vrasja e kryer me pëlqimin apo kërkesën e viktimës, të dhënë me vullnet të plotë, serioze dhe e vërtetë, jo të shkaktuar nga ndonjë element dhune, kanosje, mashtrimi apo shtrëngimi, dënohet nga dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet burgim.

2. Nuk do të vlerësohen si pëlqim i dhënë rastet kur viktima është i mitur, i paaftë mendërisht për të vepruar, apo i ndikuar nga përdorimi i substancave që e kanë çuar në pamundësi për të vlerësuar rëndësinë e veprimeve të tij.

#### **Neni 754**

#### **Vrasja e kryer në gjendje të tronditjes së fortë psikike**

1. Vrasja me dashje e kryer në gjendje të tronditjes së fortë psikike të çastit shkaktuar nga dhuna ose fyerja e rëndë e viktimës dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet.

2. Për efekt të këtij titulli, me gjendje të tronditjes së fortë psikike të çastit do të kuptohet kur personi vepron menjëherë pas shkakut që ka sjellë tronditjen e tij, që ka prishur përkohësisht ekuilibrin apo funksionimin e rregullt mendor në mënyrë të atillë që haptazi shfaqet moskontrolli i veprimeve të kryera nën ndikimin e shkakut tronditës, por asnjëherë më vonë se sa koha e mjaftueshme që i duhet personit konkret për të reflektuar rreth veprimeve të tij dhe/apo kontrollojë ato.

#### **Neni 755**

#### **Vrasja e kryer në kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme**

Vrasja e kryer në kushtet e kapërcimit të kufijve të mbrojtjes së nevojshme dënohet me burgim nga dy deri në shtatë vjet.

#### **Neni 756**

#### **Vrasja nga pakujdesia**

Vrasja e kryer nga pakujdesia dënohet me burgim deri në shtatë vjet.

#### **Neni 757**

#### **Shkaktimi i vetëvrasjes**

1. Ndhurma, përforsimi te viktima i qëllimit për t'u vetëvrasë, përkrahja, këshillimi ose dhënia e mjeteve qe kane shkaktuar vetëvrasjen, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.

2. Shkaktimi i vetëvrasjes së një personi, si rrjedhojë e keqtrajtimit sistematik ose nga sjellje të tjera që prekin rëndë dinjitetin në mënyrë të vazhdueshme, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.

3. Nëse vepra sipas paragrafit të parë dhe të dytë të këtij neni drejtohet ndaj viktimës së mitur, dënohet me burgim nga dymbëdhjetë deri në njëzetë vjet.

4. Kur vdekja e viktimës nuk ka ardhur, pasi ka tentuar të kryejë vetëvrasjen, dënimi i parashikuar për kryerjen e veprës penale përkatëse, zbutet deri në një të dytën e dënimit të parashikuar nga dispozita përkatëse.

### **Neni 758**

#### **Ndërprerja e shtatzënisë pa pëlqimin e gruas**

1. Ndërprerja e shtatzënisë pa pëlqimin e lirë të gruas, veç rastit kur ndërprerja diktohet nga një shkak shëndetësor i justifikuar, dënohet me gjobë ose me burgim nga një deri në pesë vjet.

2. Kur kjo veprë kryhet nga personeli mjekësor, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet dhe shoqërohet me dënimin plotësues të heqjes së të drejtës për të ushtruar profesionin.

### **Neni 759**

#### **Sigurimi i kushteve për të kryer vrasje**

Bërja e planeve, sigurimi i kushteve, bashkëpunëtorëve, të dhënave apo mjeteve për të kryer një vrasje, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

### **Neni 760**

#### **Porosia për të kryer vrasje**

1. Porosia, krijimi i motivit, ofrimi i pagesës apo çdo nxitje e drejtpërdrejtë e dikujt për të kryer një vrasje, dënohet me burgim deri në katër vjet.

2. Nëse vrasja ndodh, porositësi vlerësohet si bashkëpunëtor në rolin e organizatorit nxitës në kryerjen e vrasjes.

### **Neni 761**

#### **Kryerja e veprës nga personi juridik**

1. Nëse një person juridik ka kryer ndonjëherë prej veprave penale të shënuara më poshtë, dënimi me gjobë do të jetë:

a) mbi pesëfishin e vlerës së përfitimit të paligjshëm kur janë shkelur nenet 747, paragrafi 2 dhe 759 të këtij kreu;

b) për veprat penale të parashikuara në nenet 746, 748, paragrafi i parë, 749, 750 dhe 759 të këtij kreu, gjykata cakton deri pesëfishin e vlerës së gjobës së përmendur në nenin 123 të Kodit Penal.

2. Gjukata cakton edhe dënimet plotësuese të pezullimit të veprimtarisë së personit juridik për një periudhë tërësore jo më shumë se pesë vjet dhe mbylljen e mjedisëve të punës së kompanisë.

## **Neni 762**

### **Kryerja e veprës në bashkëpunim**

Nëse për kryerjen e ndonjërës prej veprave penale të parashikuara në këtë seksion, autorit i është dashur të bashkëpunojë me një person tjetër, pavarësisht cilësive të posaçme të tij, ata do të përgjigjen për kryerjen në bashkëpunim të veprave penale të parashikuara në këtë seksion, apo çfarëdolloj vepre penale që konkurron me to.

## **Neni 763**

### **Dënimet plotësuese dhe konkurrimi**

1. Nëse veprat penale të parashikuara në këtë seksion kryhen edhe nga zyrtari publik i caktuar sipas ligjit, atëherë gjykata, krahas dënimit kryesor cakton edhe dënimin plotësues, heqjen e së drejtës për të ushtruar një funksion publik.

2. Në çdo rast gjykata vendos masën e zëvendësimit të dëmit të shkaktuar dhe, përveç sendeve që kane shërbyer për kryerjen e veprave penale, kur ajo është kryer nga subjektet me qëllim përfitimi material apo të premtuar, vendoset konfiskimi i të ardhurave nga vepra penale apo të premtuara.

3. Për efekt të këtij seksioni, nëse mënyrat e kryerjes së veprave penale të parashikuara këtu që kanë bërë të mundur kryerjen e ndonjërës prej tyre, përbëjnë vepra penale më vete, atëherë ato konkurrojnë me veprën penale të cilës i kanë shërbyer për të sjellë apo tentuar pasojën.

## **KREU II**

### **VEPRAT PENALE KUNDËR INTEGRITETIT FIZIK OSE PSIKIK TË PERSONIT**

## **Neni 764**

### **Autorizimi apo leja e paligjshme**

Per sa lidhet me dispozitat e këtij kreu, do të vleresohet te jetë e paligjshme, cdo sjellje, autorizim i kerkuar, leje per ushtrim te veprimtarive te permendura edhe kur kryhet sipas një autorizimi të lëshuar nga një autoritet kompetent i një shteti, nëse një autorizim i tillë është marrë me mashtrim ose me korrupsion, zhatje ose detyrim, ose nëse një autorizim i tillë është në shkelje të dukshme të kërkesave ligjore thelbësore përkatëse, apo ne kapercim te kushteve te atij autorizimi.

## **Neni 765**

### **Tortura**

1. Kryerja me dashje e veprave, nëpërmjet të cilave viktimës i janë shkaktuar vuajtje të rënda fizike apo mendore, nga një person që ushtron funksione publike, me qëllim:

a) për të marrë prej tij ose një tjetri informata ose pohime;

b) për ta ndëshkuar për një veprim të kryer ose që dyshohet të jetë kryer prej/ose një personi tjetër;

c) për ta frikësuar ose bërë presion mbi të ose një person tjetër;

ç) për çdo qëllim tjetër të bazuar në çfarëdolloj forme diskriminimi;

d) për çdo akt tjetër çnjerëzor apo poshtërues;

dh) për të fshehur në mënyrë të vazhdueshme informacionin për vendndodhjen e kufomës së një personi, familjarëve ose të afërmeve të tij, nga ai që ka dijeni për vendin se ku ndodhet ajo; dënohen me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.

2. Po kjo veprë, kur është kryer nga persona, me nxitjen apo miratimin, të hapur ose të heshtur, të funksionarëve publikë, dënohet me burgim nga tetë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

3. Tortura, si dhe çdo akt tjetër çnjerëzor, e kryer sipas paragrafit të parë të këtij neni, kur ka sjellë vdekjen e viktimës, dënohet edhe në konkurrim me veprën penale konkrete që kualifikohet sipas pasojës së ardhur nga ushtrimi i torturës.

### **Neni 766**

#### **Dëmtime të rënda me dashje**

Dëmtimi i shëndetit i kryer me dashje që ka sjellë si pasojë gjymtimin, shëmtimin ose çdo dëmtim tjetër të përhershëm të shëndetit, ndërprerjen e shtatzënisë, ose ka qenë e rrezikshme për jetën në çastin e shkaktimit të saj, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.

### **Neni 767**

#### **Gjymtimi i organeve gjenitale femërore**

1. Dëmtimi i rëndë i organeve gjenitale femërore, dënohet me burgim nga katër deri në dymbëdhjetë vjet.

2. Do të vlerësohen si dëmtim i rëndë i organeve gjenitale femërore sjelljet e mëposhtme të qëllimshme:

a) prerja, infibulimi ose kryerja e ndonjë gjymtimi tjetër për të tërë ose një pjesë të buzëve të mëdha, buzëve të vogla ose klitorit ;

b) shtrëngimi ose kërkesa ndaj një gruaje që t'i nënshtrohet ndonjë prej akteve të renditura në shkronjën "a";

c) provokimi, shtrëngimi ose kërkesa ndaj një vajze që t'i nënshtrohet ndonjë prej akteve të renditura në shkronjën "a".

### **Neni 768**

#### **Heqja e organeve njerëzore**

1. Heqja me qëllim e organeve njerëzore nga dhurues të gjallë apo të vdekur, kryer pa pëlqimin e lirë të vetëdijshëm të dhuruesit të gjallë, ose në rastin e dhuruesit të vdekur, pa lejimin e autorizuar sipas ligjit:

a) kur në këmbim të heqjes së organeve, dhuruesit të gjallë ose një pale të tretë i është ofruar ose ka marrë një fitim financiar ose avantazh të krahasueshëm;

b) kur në këmbim të heqjes së organeve, dhuruesit të vdekur ose një pale të tretë i është ofruar ose ka marrë një fitim financiar ose avantazh të krahasueshëm;

dënohet me burgim nga katër deri në dhjetë vjet.

2. Tregtimi, shitja, blerja ose çfarëdo mënyre tjetër e paligjshme apo titulli që autorizon, apo trajton organet ose pjesë të tyre, të marra nga një person i gjallë apo i vdekur, dënohet me burgim nga katër deri në dymbëdhjetë vjet.

3. Kur heqja e organeve njerëzore nga dhuruesit e gjallë apo të vdekur, sipas paragrafit të parë të këtij neni, kryhet jashtë sistemit të transplantimit, ose kur heqja është kryer në shkelje të parimeve themelore të ligjeve ose rregullave të transplantit, ose nga një person që ushtron një profesion shëndetësor, dënimi shtohet deri në një të tretën dhe, zbatohet dënimi plotësues të heqjes të së drejtës për të ushtruar funksione publike sipas parashikimeve të nenit 76 të këtij Kodi.

### **Neni 769**

#### **Përdorimi i organeve të hequra në mënyrë të paligjshme**

1. Përdorimi i organeve njerëzore të hequra në mënyrë të paligjshme sipas paragrafit të parë të nenit 768, për qëllime implantimi apo qëllime të tjera, dënohet me burgim nga gjashtë deri në dymbëdhjetë vjet.

2. Kur heqja e organeve njerëzore nga dhuruesit e gjallë apo të vdekur, sipas paragrafit të parë të këtij neni, kryhet jashtë sistemit të transplantimit, ose kur heqja është kryer në shkelje të parimeve themelore të ligjeve ose rregullave të transplantit, ose nga një person që ushtron një profesion shëndetësor, dënimi shtohet deri në një të tretën dhe, zbatohet dënimi plotësues, të heqjes të së drejtës për të ushtruar funksione publike sipas parashikimeve të nenit 76 të këtij Kodi.

### **Neni 770**

#### **Nxitja e paligjshme dhe rekrutimi për dhurimin e organeve**

1. Nxitja, rekrutimi i një dhuruesi të organeve apo një marrësi të tyre, për kryerjen e secilës prej krimeve të parashikuara në nenet 768 dhe 769, që synon të arrijë përfitime financiare apo avantazhi të krahasueshëm për personin e nxitur ose të rekrutuar, ose për një palë të tretë, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet.

2. Kur vepra penale sipas paragrafit të parë të këtij neni, kryhet drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga profesionistë të kujdesit shëndetësor, zyrtarëve të tij publikë ose personave që drejtojnë ose punojnë për subjektet e sektorit privat, në çfarëdo cilësie, me qëllim ofrimin ose dhënien e përfitimeve ose avantazheve të padrejta, dënimi me burgim shtohet deri në një të tretën e tij.

### **Neni 771**

#### **Ruajtja apo eksportimi i organeve njerëzore**

Ruajtja, përgatitja, transportimi, transferimi, pranimi, importimi dhe eksportimi i organeve njerëzore të hequra në mënyrë të paligjshme siç është përkrahur në nenin 768, dënohet me burgim nga dy deri në shtatë vjet.

### **Neni 772**

#### **Rrethana cilësuese**

Vlerësohen si vepra penale të kryera në rrethana të cilësuar dhe, dënohen sipas parashikimeve më poshtë, nëse çdonjëra nga krimet e parashikuara në nenet 768, 769, 770 dhe 771 është kryer:

a) ndaj një të mituri, apo ndaj një personi me cilësi specifike, si aftësitë e kufizuara mendore apo fizike, apo të tjera, dënohet me burgim nga dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

b) nga një grup i strukturuar kriminal ose organizatë kriminale, dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë deri në njëzet e pesë vjet.

c) duke shkaktuar dëme serioze në shëndetin fizik ose mendor apo ka sjellë vdekjen e viktimës madhore, dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë deri në tridhjetë vjet, ndërsa kur nga vepra penale janë shkaktuar dëme serioze në shëndetin fizik ose mendor apo ka ardhur vdekja e viktimës së mitur, dënohet me burgim jo më pak se njëzet e pesë vjet ose me burgim të përjetshëm.

### **Neni 773**

#### **Organizimi ose reklamimi i veprimtarive të trafikimit të organeve**

Organizimi, reklamimi me çfarëdo mjeti apo mënyre, duke përfshirë edhe komunikimet elektronike, i udhëtimeve apo njoftimeve me synim trafikimin e organeve ose pjesëve të organeve njerëzore, kur nuk përbën vepër penale më të rëndë, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.

### **Neni 774**

#### **Përkufizime**

Në referim të termave të përdorur në nenet 768 deri në 773 do të kuptohet:

a) “trafikim i organeve njerëzore” është çdo veprimtari e paligjshme në lidhje me organet njerëzore;

b) “organ njerëzor” është një pjesë e diferencuar në trupin e njeriut, e formuar nga inde të ndryshme që ruan strukturën e saj, vaskularizimin dhe kapacitetin për të zhvilluar funksione fiziologjike me një nivel të konsiderueshëm autonomie. Një pjesë e një organi është konsideruar të jetë një organ nëse funksioni i tij është që do të përdoret për të njëjtin qëllim si i gjithë organi në trupin e njeriut, duke ruajtur kërkesat e strukturës dhe vaskularizimit.

c) “fitim financiar apo avantazh i krahasueshëm”, nuk përfshin kompensim për humbjen e të ardhurave dhe të shpenzimeve të tjera të arsyeshme të shkaktuara nga heqja e organeve apo nga ekzaminimet përkatëse mjekësore, ose kompensimin në rast dëmtimi, i cili nuk rrjedh prej heqjes së tyre.

### **Neni 775**

#### **Dëmtime të rënda të kryera në gjendje të tronditjes së fortë psikike**

1. Dëmtimi i rëndë i shëndetit, i kryer në gjendje të tronditjes së fortë psikike të çastit, shkaktuar nga dhuna ose fyerja e rëndë nga ana e të dëmtuarit, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

2. Ndjekja penale ushtrohet vetëm mbi bazën e ankimit të viktimës ose të përfaqësuesit ligjor të saj dhe çështja pushohet me heqjen dorë nga ankimi.

### **Neni 776**

#### **Dëmtime të rënda të kryera në kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme**

1. Dëmtimi i rëndë i shëndetit, i kryer me kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose burgim deri në dy vjet.

2. Ndjekja penale ushtrohet vetëm mbi bazën e ankimit të viktimës ose të përfaqësuesit ligjor të saj dhe çështja pushohet me heqjen dorë nga ankimi.

#### **Neni 777**

#### **Dëmtime të lehta me dashje**

Dëmtimi i shëndetit i kryer me dashje, që ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se nëntë ditë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

#### **Neni 778**

#### **Dëmtime të tjera me dashje**

1. Rrahja, si dhe çdo vepër tjetër dhune, përbën kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë.
2. Po kjo vepër, kur ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë deri në nëntë ditë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj.
3. Nëse rrahja kryhet në mënyrë masive ose, me mjetë të rrezikshme, ndaj një ose disa personave, ose në mënyrë publike, pavarësisht shkallës së dëmtimeve të shkaktuara në trupin e viktimës, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

#### **Neni 779**

#### **Dëmtime të rënda nga pakujdesia**

Dëmtimi i rëndë i shëndetit i kryer nga pakujdesia përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj.

#### **Neni 780**

#### **Ndërprerja e shtatzënisë e kryer në vende dhe nga persona të paautorizuar**

1. Ndërprerja e shtatzënisë e kryer jo në mjedise spitalore publike apo klinika private të lejuara posaçërisht, ose nga një person që nuk është mjek ose, tej kohës së lejueshme për ndërprerje veç rastit kur kjo diktohet nga një shkak shëndetësor i justifikuar, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.
2. Kur nga vepra është shkaktuar dëmtimi apo rrezikimi i shëndetit ose, vdekja e viktimës, ajo konkurren me veprën penale që parashikon pasojën konkrete të ardhur.

#### **Neni 781**

#### **Dhënia e mjeteve për ndërprerjen e shtatzënisë**

1. Dhënia e mjeteve që shërbejnë për ndërprerjen e shtatzënisë një gruaje me qëllim që kjo të kryejë vetë ose me ndihmën e ndonjë tjetri ndërprerje, jashtë mjediseve spitalore, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

2. Dhënia e mjeteve që shërbejnë për ndërprerjen e shtatzënisë nga personeli mjekësor, për të kryer ndërprerjen e shtatzënisë jashtë mjediseve spitalore, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet dhe shoqërohet me dënimin plotësues të heqjes së të drejtës për të ushtruar profesionin.

#### **Neni 782**

#### **Ndërhyrjet në shtatzëninë**

1. Kryerja e një ndërhyrjeje kirurgjikale që ka për qëllim ose për pasojë ndërprerjen e aftësisë riprodhuese të një gruaje në mënyrë natyrale, pa e informuar dhe marrë paraprakisht pëlqimin e saj ose pa e kuptuar ajo procedurën e ndjekur, dënohet me burgim nga pesë deri në dymbëdhjetë vjet.

2. Praktimi i riprodhimit të asistuar të një gruaje, pa pëlqimin e saj, dënohet me burgim nga gjashtë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

#### **Neni 783**

#### **Dëmtimi i shëndetit gjatë trajtimit mjekësor**

1. Trajtimi mjekësor i të sëmurëve, nga ana e mjekut apo personelit profesionist shëndetësor që ka marrë përsipër kurimin e viktimës, i kryer me pakujdesi të vetëdijshme, jashtë standardeve të përcaktuara në protokollet përkatëse të mjekimit të miratuar nga organet kompetente, kur është shkaktuar përkeqësimi serioz i sëmundjes ose dëmtimi i rende i shëndetit të pacientit, pasoja që do të shmangeshin me probabilitet të lartë nëse trajtimi mjekësor do të ishte në mirëbesim dhe i kujdesshëm në përmbushje të protokollit mjekësor, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

2. Kur nga vepra është shkaktuar vdekja e viktimës, ajo konkurren me veprën penale që parashikon pasojën të ardhur nga pakujdesia dhe, shoqërohet me dënimin plotësues të heqjes së të drejtës së ushtrimit të profesionit për një kohë deri në pesë vjet.

#### **Neni 784**

#### **Mosdhënia e ndihmës mjekësore**

Mjeku ose çdo ofruer tjetër i shërbimeve shëndetësore, i cili nuk i jep ndihmë urgjente mjekësore pacientit ose personit që ka nevojë për një ndihmë të tillë për shkak të një rreziku të drejtpërdrejtë për jetën e tij, në rastin kur mosdhënia e ndihmës nuk është me dashje, dënohet me burgim deri në tre vjet dhe heqje të së drejtës për të ushtruar profesionin deri në pesë vjet.

#### **Neni 785**

#### **Trajtimi mjekësor i paautorizuar**

1. Trajtimi mjekësor në mjedise spitalore (ambulatorë), që i bëhet një personi, pa pëlqimin e tij të detyrueshëm sipas protokolleve të miratuara, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me heqje të së drejtës për ushtrimin e profesionit deri në dy vjet.

2. Kryerja e ndërhyrjes kirurgjikale ose e një ndërhyrjeje tjetër mjekësore në trupin e një personi pa pëlqimin e shprehur dhe të vlefshëm me shkrim të tij, dënohet me burgim deri në tre vjet dhe me heqje të së drejtës për ushtrimin e profesionit deri në tre vjet.

3. Nuk ka vepër penale sipas paragrafëve më lart, kur trajtimi i detyrueshëm mjekësor, ndërhyrja kirurgjikale ose ndonjë ndërhyrje tjetër mjekësore, duhet t'i bëhen sipas ligjit një personi i cili nuk është i vetëdijshëm ose nuk është i aftë për të arsyetuar, ose kur një anëtar i ngushtë i familjes ose përfaqësuesi ligjor nuk gjendet dhe kur shtyrja e trajtimit ose ndërhyrjes me probabilitet të lartë do të rrezikonte jetën e personit ose do të shkaktonte një përkeqësim të rëndë të shëndetit të tij.

### **Neni 786**

#### **Dhënia e shërbimit mjekësor nga joprofesionistë**

1. Trajtimi mjekësor ose ndihma mjekësore që i jepet një personi në mungesë të kualifikimeve të përcaktuara profesionale, ose zbatimi i një mënyre shërimi ose trajtimi dukshëm të papërshtatshme me elementet e kërkuar në nenin 783, dënohet me burgim nga një deri në katër vjet.

2. Kryerja e veprës për të marrë shpërblim ose përfitim pasuror, e shton dënimin deri në një të dytën e tij.

### **Neni 787**

#### **Kanosja**

1. Kanosja serioze për vrasje ose për dëmtim të rëndë të shëndetit që i bëhet një personi, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

2. Kanosja serioze për hakmarrje ose gjakmarrje, që i bëhet një personi për t'u mbyllur në shtëpi, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet.

3. Kanosja serioze për vrasje ose dëmtim të rëndë të shëndetit, që i bëhet një personi, për shkak të përkatësisë etnike, kombësisë, racës apo fesë, dënohet me gjobë ose me burgim nga dy deri në tre vjet.

4. Kur vepra penale e parashikuar në paragrafin e tretë të këtij neni, kryhet nëpërmjet sistemeve kompjuterike, dënohet nga një deri në katër vjet burgim.

5. Për qëllim të ligjit penal, me kanosje do të kuptohet çdo fjalë, thënie apo sjellje e qëllimshme që i drejtohet viktimës, që duan të sjellin vdekjen apo plagosjen e rëndë të viktimës dhe që kanë sjellë tek ai frikë e ankth për jetën, shëndetin e tij apo të të afërmeve familjarë. Vlerësohet si vepër penale edhe nëse autori nuk ka ndërmend ta kryejë veprën të cilën e shpreh në kërcënim, por që nga rrethanat në të cilat është thënë është kuptuar nga viktimja si e padyshimtë, e vërtetë dhe veçanërisht e qartë, ndaj do të realizohej siç është thënë.

6. Në kuptim të këtij neni me të afërm familjar, përmendur në paragrafin e pestë, kuptohen, bashkëshorti apo bashkëjetuesi, prindërit, fëmijët, si dhe çdo person i lidhur nga gjaku apo afërsia deri në shkallën e dytë.

### **Neni 788**

#### **Mosdhënia e ndihmës në det dhe në ujërat e brendshme**

Mosdhënia e ndihmës dhe mos marrja përsipër e shpëtimit të personave që janë në rrezik për vdekje në det ose në ujërat e brendshme, nga kapiteni i një anijeje ose zëvendësi i tij, në kundërshtim me detyrimin për të dhënë ndihmë të parashikuar me ligj, kur ndihma mund të jepej pa rrezik serioz për anijen, ekuipazhin dhe udhëtarët, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet.

#### **Neni 789**

#### **Manipulimi i gjeneve**

1. Manipulimi i gjeneve njerëzore duke ndryshuar gjenotipin, për qëllime të ndryshme nga ato të eliminimit ose pakësimit të defekteve ose sëmundjeve të rënda, dënohet me burgim nga dy deri në shtatë vjet.

2. Kryerja e kësaj veprë nga pakujdesia e vetëdijshme, dënohet me burgim jo më shumë se një e dyta e dënimit të parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni.

#### **Neni 790**

#### **Krijimi i humanëve të dallueshëm**

Zbatimi i praktikave eugenike me qëllim krijimin tërësisht apo pjesërisht, të humanëve të dallueshëm nga grupet natyrale kombëtare, etnike, racore ose fetare, që synojnë organizimin e përzgjedhjes së personave, apo krijimi i qenieve njerëzore identike me anë të klonimit ose procedurave të tjera që synojnë përzgjedhjen e racës, ose lindjen e një fëmije gjenetike identik me një tjetër person të gjallë ose të vdekur, dënohet me burgim nga pesë deri në dymbëdhjetë vjet.

#### **Neni 791**

#### **Krijimi i vezoreve**

Fekondimi i vezëve të njeriut për qëllime të tjera të ndryshme nga ai i riprodhimit njerëzor, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet.

#### **Neni 792**

#### **Krijimi i armëve**

Përdorimi i inxhinierisë gjenetike për prodhimin e armëve biologjike ose shfarosëse të qenies njerëzore, dënohet me burgim nga dhjetë deri në gjashtëmbëdhjetë vjet.

#### **Neni 793**

#### **Rrethana të cilësuar**

1. Nëse krimet e parashikuara në nenet 789, 790, 791 dhe 792 kryhen nga një organizatë kriminale ose nga ndonjë formë tjetër e bashkëpunimit të posaçëm, dënimi me burgim shtohet respektivisht deri në një të dytën e tij.

2. Nëse veprat penale të parashikuara në nenet 789, 790, 791 dhe 792 kryhen për qëllime fitimi, dënimi me burgim rritet deri në një të tretën e tij, respektivisht sipas krimit të kryer dhe zbatohet dënimi plotësues i konfiskimit të të ardhurave apo përfitimeve të premtuara apo realizuara.

## **Neni 794**

### **Kryerja e veprës nga personi juridik**

1. Nëse një person juridik ka kryer ndonjërin prej veprave penale të shënuara më poshtë, dënimi me gjobë do të jetë:

a) mbi pesëfishin e vlerës së përfitimit të paligjshëm kur janë shkelur nenet 768 dhe 770 të këtij kreu;

b) për veprat penale të parashikuara në nenet 765, 766, 767, 769, 771, 773, 774, 780, 785, 788, 789 dhe 790 të këtij kreu, gjykata cakton deri pesëfishin e vlerës së gjobës të përmendur në nenin 123 të Kodit Penal.

2. Gjkata cakton edhe dënimet plotësuese të pezullimit të veprimtarisë së personit juridik për një periudhë tërësore jo më shumë se pesë vjet dhe mbylljen e mjediseve të punës së kompanisë.

## **Neni 795**

### **Kryerja e veprës në bashkëpunim**

Nëse për kryerjen e ndonjërin prej veprave penale të parashikuara në këtë kre, autorit të posaçëm i është dashur të bashkëpunojë me ndonjë person tjetër, pavarësisht cilësive të posaçme të këtij të fundit, ata do të përgjigjen për kryerjen në bashkëpunim të veprës penale të parashikuar në këtë kre, apo çfarëdolloj vepre penale që konkurron me to.

## **Neni 796**

### **Dënimet plotësuese dhe konkurrimi**

1. Nëse veprat penale të parashikuara në këtë seksion kryhen edhe nga zyrtari publik i caktuar sipas ligjit, atëherë gjykata, krahas dënimit kryesor cakton edhe dënimin plotësues, heqjen e së drejtës për të ushtruar një funksion publik.

2. Në çdo rast gjykata vendos masën e zëvendësimit të dëmit të shkaktuar dhe, përveç sendeve që kanë shërbyer për kryerjen e veprave penale, kur ajo është kryer nga subjektet me qëllim përfitimi material apo të premtuar, vendoset konfiskimi i të ardhurave nga vepra penale apo të premtuara.

3. Për qëllim të këtij seksioni, nëse mënyrat e kryerjes së veprave penale të parashikuara këtu që kanë bërë të mundur kryerjen e ndonjërin prej tyre, përbëjnë vepra penale më vete, atëherë ato konkurrojnë me veprën penale të cilës i kanë shërbyer për të sjellë apo tentuar pasojën.

4. Për veprat penale të lehta të parashikuara në nenet 776, 777, 779, 781, 783, paragrafi i parë, 783 dhe 787, paragrafi i parë, kur çmohet e arsyeshme, gjykata mund të vendosë dhënien e jo më pak se sa dy dënimeve plotësuese në vend të dënimit kryesor.

5. Për veprat penale të parashikuara nga nenet 789, 790 dhe 792 gjykata vendos edhe masën penale të regjistrimit dhe shkëmbimit të të dhënave që përmbajnë të dhëna rreth subjektit lidhur me rastet kur vepra penale ka rëndësi për njohjen dhe parandalimin e kryerjes së krimeve me natyrë edhe ndërkombëtare.

KREU III  
VEPRAT PENALE KUNDËR INTEGRITETIT SEKSUAL

**Neni 797**  
**Përkufizime**

Për qëllime të veprave penale të këtij kapitulli shprehjet në vijim kanë këtë kuptim:

1. Shprehja “pëlqim” i personit, vlerësuar në kontekstin e rrethanave të faktit, nënkupton:

a) pranim i lirë dhe i vullnetshëm i personit që ka arritur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç për të kryer aktin seksual.

b) marrëveshja e lirë dhe e vullnetshme e dy personave që kanë arritur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç për të kryer aktin seksual në fjalë.

2. "Akt pa pëlqim" nënkupton një veprim të kryer pa pëlqimin vullnetar të personit ose duke mos qenë ajo në gjendje të shprehë vullnetin e lirë për shkak të gjendjes së saj fizike ose mendore, duke shfrytëzuar paaftësinë e saj për të shprehur vullnetin e lirë për shkak të gjendjes së pavetëdijes, dehjes, gjumit, sëmundjes, dëmtimit fizik ose paaftësisë. Pëlqimi mund të revokohet në çdo moment gjatë aktit. Mungesa e pëlqimit nuk mund të pretendohet duke pasur për bazë heshtjen e personit, mungesën e rezistencës verbale ose fizike ose sjelljes së saj seksuale në të shkuarën.

3. Nuk ekziston pëlqimi, nëse:

a) me fjalë ose me sjellje shprehet mungesë vullneti për të kryer aktin ose për ta vazhduar atë;

b) pranimi është shprehur me fjalë ose me sjelljen e një personi tjetër dhe jo të viktimës;

c) pranimi është marrë nëpërmjet shpërdorimit të besimit, gënjeshtërisë, frikësimit ose me kërcënim, nëse mënyrat e tilla nuk përfshijnë përdorimin e forcës, kanosjes serioze ose shfrytëzimin siç është parashikuar në nenin 798; ose

ç) viktima është e paaftë për të shprehur vullnetin e saj për veprimtari seksuale për shkak të aftësisë së ulët mendore apo fizike, për shkak të sëmundjes apo aftësisë së ulët mendore të shkaktuar nga përdorimi i pijeve alkoolike, lëndëve narkotike, psikotrope, stimulantëve e substancave të tjera.

4. Shprehja “akt seksual” nënkupton penetrim sado i vogël i organit seksual ose i objektit për qëllime seksuale në cilëndo pjesë të trupit të personit ose penetrim sado i vogël në zonat e trupit anus, gojë apo gjenitale të personit me ndonjë send për qëllim seksual ose me cilëndo pjesë tjetër të trupit, ose me cilëndo pjesë të kafshës, apo në çfarëdo mënyre, që synojnë kënaqësinë seksuale të personit.

5. Shprehja “dhunë seksuale” nënkupton çdo akt me përmbajtje seksuale që prek lirinë seksuale të viktimës dhe kryhet pa pëlqimin apo vullnetin e lirë të kësaj të fundit, që përfshijnë përdorimin e dhunës, frikësimit, abuzimit me një situatë epërsie ose me një situatë vulnerabiliteti të viktimës apo duke përfituar nga mungesa e vetëdijes së viktimës, nga gjendja mendore e saj apo kur vullneti i viktimës është cenuar në cilëndo mënyrë, apo përfshirjen me një person në akte të tjera të detyruara të një natyre seksuale, apo nxitjen që një person tjetër të përfshihet me një person të tretë në akte të detyruara të një natyre seksuale.

6. Shprehja “përdhunim” nënkupton penetrimin seksual të detyruar vaginal, anal ose oral, ose depërtimin e pjesëve trupore ose objekteve në trupin e një personi tjetër, kundër vullnetit të viktimës, në mungesë të pëlqimit të saj, duke iu imponuar me detyrim, kërcënuar apo vepruar në befasi të plotë ndaj saj.

7. Me shprehjen “pjesë intime” nënkuptohen gjinjte e një femre, penisi, vagjina dhe/apo anusi.

8. Shprehja “prekje” nënkupton kontakt direkt ose indirekt, pa penetrim, midis trupit të personit me cilëndo pjesë të trupit të personit tjetër apo me ndonjë send.
9. Shprehja “materiale me përmbajtje seksuale për fëmijë (pornografia)” nënkupton çfarëdo pamje vizuale apo shfaqje ose pasqyrim vizual, duke përfshirë çdo fotografi, film, video, pamje apo imazh ose fotografi e krijuar me kompjuter, edhe nëse është krijuar në mënyrë elektronike, mekanike apo me mjete të tjera, që paraqet ose pasqyron:
- a) gjenitalet (vagjina, penisi ose anusi) apo zonën e ashtit mbivetor të një fëmije, kryesisht për qëllime seksuale;
  - b) një fëmijë të vërtetë i cili është përfshirë në një sjellje të dukshme seksuale, të vërtetë apo të simuluar;
  - c) një person i cili duket të jetë fëmijë i vërtetë i përfshirë në një sjellje të qartë seksuale, të vërtetë apo të simuluar; ose
  - ç) pamje realiste të një fëmije imagjinare të përfshirë në një sjellje të dukshme seksuale, të vërtetë apo të simuluar.
10. Shprehja “qëllimi seksual” nënkupton çdo veprim të kryer për qëllimet e kënaqësisë seksuale të një personi.
11. Shprehja “joshje” nënkupton çdo veprim që synon të fitojë besimin e të miturit nëpërmjet artificave, gënjeshtreve, lajkave apo kërcënimeve, të zbatuara gjithashtu përmes përdorimit të internetit ose rrjeteve të tjera ose mjeteve të komunikimit.

## **Neni 798**

### **Aktet seksuale me të mitur**

1. Kryerja e akteve seksuale me një person të mitur të moshës deri gjashtëmbëdhjetë vjeç, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.
2. Në kuptim të këtij neni, aktet seksuale përfshijnë edhe aktet që i mituri kryen me një person të tretë ose te vetja sipas kërkesës së autorit. Nuk do të dënohet i mituri, që kryhen aktet seksuale të parashikuara nga paragrafi i parë i këtij neni, me pëlqim reciprok të të miturit që ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç, nëse diferenca në moshë midis subjekteve nuk është më shumë se dy vjet.
3. Kryerja me dhunë e akteve seksuale ndaj të miturve deri në 16 vjeç, dënohet me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.
4. Kur nga kryerja e akteve seksuale sipas paragrafit të parë të këtij neni, realizohet penetrimi pa pëlqimin e të miturit, dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë deri në njëzet vjet.
5. Kryerja e akteve seksuale me një të mitur të moshës gjashtëmbëdhjetë deri në tetëmbëdhjetë vjeç, pa pëlqimin e këtij të fundit, dënohet me burgim nga shtatë deri në dhjetë vjet.
6. Kryerja me dhunë e akteve seksuale ndaj të miturve të moshës gjashtëmbëdhjetë deri në tetëmbëdhjetë vjeç, dënohet me burgim nga dymbëdhjetë deri në njëzet vjet.
7. Kur nga kryerja e akteve seksuale sipas paragrafit të parë të këtij neni, realizohet penetrimi pa pëlqimin e të miturit të moshës gjashtëmbëdhjetë deri në tetëmbëdhjetë vjeç, dënohet me dymbëdhjetë deri në tetëmbëdhjetë vjet.
8. Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e viktimës së mitur, dënohet me burgim jo më pak se tridhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.

**Neni 799**  
**Aktet seksuale me të rritur**

1. Kryerja e akteve seksuale me një person të rritur pa pëlqimin e tij, dënohet me burgim nga dy deri në gjashtë vjet.
2. Kryerja me dhunë e akteve seksuale ndaj të personave të rritur, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.

**Neni 800**  
**Përdhunimi**

1. Cilido person që kryen një akt seksual pa pëlqimin e personit viktime, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.
2. Cilido që me përdorimin e dhunës detyron një person tjetër që të kryejë ose t'i nënshtrohet akteve seksuale, dënohet me burgim nga gjashtë deri në dymbëdhjetë vjet.
3. Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e viktimës, dënohet me burgim nga njëzet deri në tridhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.

**Neni 801**  
**Rrethanat cilësuese**

1. Kur krimet e parashikuara në nenin 800 kryhen në ndonjërin prej rrethanave të parashikuara në paragrafët më poshtë, dënimi shtohet sipas paragrafëve përkatës:
  - a) kur veprimet kryhen nga dy ose më shumë persona bashkërisht, dënimi shtohet deri në një të dytën;
  - b) kur dhuna seksuale paraprihet ose shoqërohet me dhunë veçanërisht të rëndë ose me akte të një natyre veçanërisht degraduese ose poshtëruese, dënimi shtohet deri në një të tretën;
  - c) kur viktima ka qenë bashkëshort apo ish-bashkëshort i autorit, edhe pa pasur bashkëjetesë mes tyre, dënimi shtohet deri në një të pestën;
  - ç) kur, për kryerjen e krimit, autori ka përfituar nga një situatë ose marrëdhënie bashkëjetese ose afërsie ose një marrëdhënie epërsie ndaj viktimës, dënimi shtohet deri në një të tretën;
  - d) kur autori përdor armë ose mjete të tjera po aq të rrezikshme që mund të shkaktojnë vdekjen ose një dëmtim të rëndë të shëndetit, dënimi shtohet deri në një të dytën;
  - dh) kur detyron një person për të kryer akt seksual duke e kanosur me zbulimin e një fakti që do të dëmtonte rëndë nderin ose reputacionin e këtij personi apo të personit të lidhur ngushtë me të, dënimi shtohet deri në një të tretën;
- 4) kur për kryerjen e akteve autori ka cenuar vullnetin e viktimës duke i dhënë barna, drogë ose çdo substancë tjetër kimike të përshtatshme për këtë qëllim, dënimi shtohet deri në një të dytën;
- ë) kur krimi është kryer nga një organizatë ose grup kriminal të formuar për kryerjen e veprimtarive të tilla, dënimi shtohet deri në një të dytën e dënimit që përmban vepra penale e kryer nga autori;
- f) kur kryhen nga një funksionar publik, ose person që është “maskuar” ose që simulon cilësinë e një funksionari publik ose të një personi të ngarkuar me një shërbim publik, dënimi shtohet deri në një të tretën;

g) kur vepra është kryer nga mësuesi, udhëheqësi fetar, specialisti i kujdesit shëndetësor, personi të cilit i është besuar rritja apo kujdesi për të miturin ose që në ndonjë mënyrë tjetër ka autoritet ndaj tij:

- i. duke keqpërdorur kontrollin e tij mbi gjendjen financiare, familjare, shoqërore, shëndetësore, të punësimit, shkollimit, fetare ose rrethanave të tjera të viktimës apo të personit të tretë;
  - ii. kur viktima e mitur mbahet në qendër disiplinore, në një institucion të edukimit apo institucion edukativo-korrektues, është pacient në spital, qendër të shëndetit mendor apo rehabilitimit, banor i shtëpisë së kujdesit apo strehimores, ose mbahet apo është i mbyllur në çfarëdo vendi tjetër me urdhër të gjykatës apo prokurorisë ose sipas ligjit; ose
  - iii. duke keqpërdorur pozitën ose autoritetin e tij mbi viktimën dhe e cila i është besuar për rritjen, edukimin apo kujdesin, dënimi shtohet deri në një të dytën.
2. Kur krimet e parashikuara në nenin 798 të kryera në njërën prej rrethanave cilësuese të parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni, do ta shtojnë dënimin deri në dy të tretat e tyre.
3. Kryerja e njëres prej formave të përcaktuara në këtë nen nga autori duke përfituar nga autoriteti i tij, detyra ose funksioni publik, përveç dënimit kryesor, gjykata cakton edhe dënimin plotësues të heqjes përgjithmonë të së drejtës për të ushtruar një funksion publik.
4. Nëse rrethanat cilësuese të parashikuara nga paragrafi i parë i këtij neni, janë dy ose më shumë në të njëjtën vepër penale, atëherë dënimi me burgim shtohet deri në një të dytën e tij.

## **Neni 802**

### **Tërheqja dhe ekspozimi i të miturve në akte seksuale**

1. Kryerja e akteve seksuale në prani të një të mituri të moshës katërbëdhjetë deri nën gjashtëmbëdhjetë vjeç, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.
2. Kryerja e akteve seksuale në prani të një të mituri të moshës katërbëdhjetë deri nën gjashtëmbëdhjetë vjeç, ose të ekspozohet para materialeve pornografike, me qëllim përfshirjen e tij në akte seksuale, në prani të autorit apo të një personi të tretë, dënohet me burgim nga katër deri në tetë vjet.
3. Sigurimi i pranisë së të miturit të moshës deri gjashtëmbëdhjetë të jetë dëshmitar i abuzimit seksual, edhe pa pjesëmarrjen e të miturit në këto akte seksuale, dënohet me burgim nga katër deri në tetë vjet burgim.
4. Kur vepra penale e parashikuar nga paragrafi i parë, i dytë dhe i tretë i këtij neni kryhet ndaj të miturit nën moshën katërbëdhjetë vjeç, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.
5. Dënimi penal rritet deri me një të dytën e dënimit të parashikuar në paragrafët e mësipërm, kur kjo vepër kryhet në këto rrethana cilësuese:
  - a) vepra është kryer nga disa persona që kanë vepruar në grup bashkërisht;
  - b) vepra ka dëmtuar rëndë shëndetin mendor të viktimës së mitur;
  - c) vepra është paraprirë ose është shoqëruar me përdorimin e dhunës fizike ose psikologjike;
  - ç) vepra është kryer kundër një të mituri të paafte;
  - d) vepra është kryer nga prindi, adoptuesi, kujdestari, një anëtar i familjes, një person që bashkëjeton apo ka bashkëjetuar me fëmijën, nga mësuesi i tij, ose çdo person që ka krijuar një marrëdhënie të qëndrueshme kujdesi për të.

## **Neni 803**

### **Manipulimi i fëmijës**

1. Joshja apo manipulimi me anë të mjeteve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit i bërë nga një person ndaj fëmijës që nuk ka mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç për ta takuar atë me qëllimin për të kryer një rën prej veprave penale të kryerjes së akteve seksuale me fëmijët nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç, kënaqjen e epshit seksual dhe prodhimit të materialit pornografik me fëmijë, të parashikuara nga nenet 798, 802, 805 dhe 806 të këtij Kodi kur propozimi është shoqëruar me veprime konkrete materiale që synojnë realizimin e këtij takimi, dënohet me burgim nga katër deri në tetë vjet.
2. Joshja apo manipulimi i të miturit nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç, shtytja e të miturit për të nxitur të mitur të tjerë të po kësaj moshe të përfshihen në akte seksuale, nëse fakti penal nuk përbën një krim më të rëndë të parashikuar në këtë kre, dënohet me burgim nga tre deri në gjashtë vjet.
3. Tentativa për kryerjen e njëres prej veprave penale të blerjes ose posedimit të materialit pornografik me fëmijë dhe aksesit të vetëdijshëm nëpërmjet teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në materialet pornografike me fëmijë, me anë të teknologjive të informacionit, nga një person madhor i cili josh një të mitur nën gjashtëmbëdhjetë vjeç për t'i ofruar material pornografik fëmimor që paraqet një të mitur, dënohet me burgim nga dy deri në gjashtë vjet.

#### **Neni 804** **Prostitucioni i fëmijëve**

1. Shprehja “prostitucion i fëmijëve” nënkupton përdorimin e një fëmije, ofrimin ose dhënien e shërbimeve seksuale në këmbim të vlerave monetare ose çdo formë tjetër shpërblimi apo premtimi për të paguar ose ofruar e mallrave apo shërbimeve, përfshirë shërbimet seksuale falas apo me zbritje. Nuk është me rëndësi nëse premtimi, pagesa, ose çdo formë tjetër shpërblimi i janë dhënë apo premtuar fëmijes të përfshirë në shërbime seksuale apo personit të tretë.
2. Në qoftë se fakti nuk përbën një vepër penale më të rëndë, kërkimi, pranimi, përfitimi ose kryerja e akteve seksuale me një fëmijë të moshës gjashtëmbëdhjetë deri nën tetëmbëdhjetë vjeç, në këmbim të një shpërblimi ose premtimi, duke e ditur që fëmija po prostituon, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet. Nëse viktima është fëmijë nën gjashtëmbëdhjetë vjeç, dënimi shtohet deri në një të dytën e tij.
3. Çdo veprim i kryer me qëllim përfshirjen e fëmijës së moshës nga gjashtëmbëdhjetë deri nën tetëmbëdhjetë vjeç në veprimtari prostitucioni, duke e rekrutuar ose nxitur në prostituim, ose shkaktimin e pjesëmarrjes së fëmijës në prostituim, dënohet me burgim nga tetë deri në katëmbëdhjetë vjet.
4. Kur vepra penale e parashikuar nga paragrafi i parë i këtij neni kryhet brenda perimetrit prej treqind metrash nga shkolla ose mjedisi tjetër i cili përdoret nga fëmijët, dënohet me burgim nga dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet.
5. Favorizimi, përfitimi, shfrytëzimi, administrimi, kontrollimi apo organizimi i prostitucionit të një fëmije, detyrimi të kryejë prostitucion ose realizimi i përfitimeve nga veprimtari të tilla, dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë deri në njëzet vjet.
7. Kur vepra penale e parashikuar nga paragrafët më lart të këtij neni kryhet ndaj fëmijës nën moshën katëmbëdhjetë vjeç, dënohet me burgim nga njëzet deri në njëzetë e pesë vjet.
8. Kur vepra e parashikuar nga ky nen është kryer në rrethanat cilësuese të parashikuara në nenin 801, dënohet me burgim nga njëzetë deri në tridhjetë vjet.

9. Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e të miturit dënohet me burgim të përjetshëm.

#### **Neni 805**

#### **Prodhimi i materialeve pornografikë me fëmijë**

1. Prodhimi i çdo lloj materiali me përmbajtje pornografike që përshkruan në mënyrë vizuale një fëmijë të mitur nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç, të përfshirë në një sjellje apo veprimtari reale seksuale, sjellje seksualisht të simuluar ose ekspozon çdo pamje të organeve seksuale të fëmijës për qëllime kryesore seksuale, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.

2. Dënimi rritet në masën deri në dy të tretat, kur në shfaqjet pornografike përfshihet një fëmijë i moshës nën katëmbëdhjetë vjeç apo kur materiali është i një sasi të madhe.

3. Aksesit i qëllimshëm te pornografia e fëmijëve nëpërmjet teknologjive të informacionit dhe të komunikimit, posedimi i pornografisë së fëmijëve, ofrimi ose vënia në dispozicion e pornografisë së fëmijëve, dënohet me burgim nga gjashtë deri në dymbëdhjetë vjet.

4. Nuk ka përgjegjësi penale autori i veprës kur këto imazhe shkëmbehen dhe janë në pronësi të dy subjekteve të moshës mbi gjashtëmbëdhjetë vjeç kur ata të dy janë pjesëmarrës në këtë veprim me pëlqimin e tyre dhe imazhet janë vetëm për përdorim privat.

#### **Neni 806**

#### **Shpërndarja e materialeve pornografike të fëmijët**

1. Shpërndarja me çdo mjet a formë komunikimi, përfshirë edhe atë nëpërmjet një sistemi kompjuterik, prokurimi, ofrimi, furnizimi, vënia në dispozicion, transmetimi, perhapja, përdorimi ose posedimi, reklamimi, prodhimi, importimi, shitja e botimi i materialeve pornografike në mjediset ku ka fëmijë deri në tetëmbëdhjetë vjeç, me çdo mjet ose formë, kur ata nuk kanë rënë në kontakt me to, dënohen me burgim nga gjashtë muaj, deri në katër vjet.

2. Po kjo veprë, kur ka rënë në kontakt me të miturit deri në tetëmbëdhjetë vjeç, si dhe, krijimi i aksesit në mënyrë të vetëdijshme tek ata, me çdo mjet ose formë, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.

3. Cilido që me çfarëdo mënyre, përfshirë edhe transmetimit elektronik, shpërndan, zbulon ose reklamon materialin pornografik, ose shpërndan ose shpalos informacione që synojnë joshje ose shfrytëzim seksual të fëmijëve të moshës gjashtëmbëdhjetë deri nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç, dënohet me burgim nga gjashtë deri në dymbëdhjetë vjet dhe, kur fëmija është nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç, dënimi shtohet deri në një të tretën e tij.

#### **Neni 807**

#### **Shfaqja pornografike me fëmijë**

1. Termi “shfaqje pornografike e fëmijëve” nënkupton çdo lloj shfaqje që përshkruan në mënyrë vizuale një fëmijë të përfshirë në një sjellje reale ose seksualisht të simuluar ose çdo pamje të organeve seksuale të fëmijës të përdorur për qëllime kryesore seksuale.

2. Përfshirja e një të mituri në shfaqje pornografike dënohet me burgim nga dy deri në shtatë vjet kur kryhet ndaj një fëmije të moshës gjashtëmbëdhjetë deri nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç, nëpërmjet:

- a) nxitjes ose rekrutimit të fëmijës me synimin për të marrë pjesë në shfaqje pornografike, për realizimin e ekzibicioneve apo shfaqjeve pornografike;
  - b) bërjes së mundur të pjesëmarrjes së fëmijës në shfaqje të tilla;
  - c) shtrëngimit apo dhunës ndaj fëmijës për të marrë pjesë në shfaqje pornografike ose përfituese;
  - ç) shfrytëzimit të fëmijës për qëllime të tilla;
  - d) shkuarjes me dijeni në shfaqje pornografike që përfshijnë edhe pjesëmarrjen e fëmijëve.
3. Kur vepra penale sipas paragrafit të dytë të këtij neni kryhet me fëmijë nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç, dënimi shtohet respektivisht deri në një të tretën e tij.
4. Nxitja e fëmijëve për të rekrutuar fëmijë të tjerë për të marrë pjesë në veprimtari pornografike, dënohet nga pesë deri në dhjetë vjet burg.

### **Neni 808**

#### **Transmetimi i pornografisë në kohë të papërshtatshme**

Shfaqja apo reklamimi i fotove, videove, filmave, apo çdo materiali pornografik nga televizionet, mediat audiovizive apo platformat digjitale që ushtrojnë veprimtarinë e tyre operojnë në Shqipëri përgjatë ditës në oraret apo intervalet kohore kur televizionet ndiqen nga fëmijët nën tetëmbëdhjetë vjeç dhe në kundërshtim me rregullat që zbatohen për shërbimet e medias në Republikën e Shqipërisë sipas ligjit “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.

### **Neni 809**

#### **Prodhimi i kukullave të seksit me pamje fëmije**

Prodhimi, porositja, mbajtja, ofrimi, reklamimi, tregtimi, blerja, shitja, dorëzimi ose hedhja në qarkullim e kopjes fizike të një fëmije ose një pjese të trupit të një fëmije, e cila, nga natyra e saj, synohet të përdoret për kryerjen e akteve seksuale, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet.

### **Neni 810**

#### **Pornografia virtuale me fëmijë**

1. Termi “pornografi virtuale me fëmijë” nënkupton çdo lloj materiali që pasqyron në mënyrë vizuale imazhe virtuale, të realizuara me teknikat e përpunimit grafik, duke përdorur imazhe figurative të një fëmije të përfshirë në një sjellje apo veprimtari seksuale jo reale, ose imazhe të simuluar që ekspozojnë çdo pamje të organeve seksuale të fëmijës për qëllime kryesore seksuale.

2. Prodhimi i çdo lloj materiali pornografik që pasqyron në mënyrë vizuale imazhe virtuale, të realizuara me teknikat e përpunimit grafik, duke përdorur imazhe figurative të një fëmije nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç, dënohet me burgim nga tre deri në gjashtë vjet.

3. Aksesimi i qëllimshëm te pornografia virtuale e fëmijëve nëpërmjet teknologjive të informacionit dhe të komunikimit, posedimi i pornografisë virtuale të fëmijëve, ofrimi ose vënia në dispozicion e pornografisë virtuale të fëmijëve, shpërndarja ose transmetimi i pornografisë virtuale të fëmijëve, prokurimi i pornografisë virtuale të fëmijëve për vete ose për një person tjetër, si dhe tregtimi i materialeve të pornografisë virtuale të fëmijëve, dënohet me burgim nga katër deri në tetë vjet.

## **Neni 811**

### **Turizmi seksual**

1. Organizimi apo propagandimi i udhëtimeve turistike që synojnë shfrytëzimin e prostitucionit të fëmijëve deri në tetëmbëdhjetë vjeç, pavarësisht parashikimeve ligjore përkatëse në vendin e caktuar turistik, dënohet me burgim nga dy deri në gjashtë vjet.

2. Nëse kjo veprimtari kryhet nga personi juridik, gjykata, krahas dënimeve të tjera për të, vendos edhe mbylljen e veprimtarisë së personit juridik.

## **Neni 812**

### **Ngacmimi seksual**

1. Shprehja “ngacmim seksual” nënkupton çdo formë sjellje të padëshiruar verbale, joverbale ose fizike me natyrë seksuale, apo një veprim me natyrë e qëllim seksual imponues të kryer ndaj një personi, i cili mund të jetë i përsëritur, apo propozime a sjellje me natyrë e qëllim seksual, apo seksist që për shkak të natyrës së tyre degraduese ose poshtëruese, cenojnë dinjitetin e viktimës dhe krijojnë një mjedis/situatë frikësuese, intimiduese, nënshtruese ose fyese për të, përfshirë edhe prekjen ndaj tij, apo bërja e propozimeve a sjelljeve me natyrë e qëllim seksual, ose e shtyn këtë të fundit të prekë autorin apo personin e tretë për qëllim seksual, pa pëlqimin e vetë personit.

2. Kryerja e ngacmimit seksual, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

3. Përbën ngacmim seksual edhe :

a) kur komentet ose sjelljet i imponohen të njëjtës viktimë nga disa persona, në një mënyrë të bashkërenduar ose me nxitjen e njërit prej tyre, edhe pse secili prej këtyre personave nuk ka vepruar veçmas në mënyrë të përsëritur;

b) kur këto komente ose sjellje i imponohen të njëjtës viktime, radhazi, nga disa persona që, edhe në mungesë të bashkërendimit mes tyre, e dinë që këto fjalë ose sjellje përbëjnë një përsëritje;

c) edhe fakti i përdorimit të çdo forme të presionit serioz me qëllimin e vërtetë të dukshëm të kryerjes së një akti të një natyre seksuale, edhe nëse fakti nuk përsëritet, pavarësisht nëse kërkohet në dobi të autorit ose për përfitimin e një pale të tretë.

4. Vepra penale dënohet me burgim nga dy deri në gjashtë vjet nëse kryhet në një ose më shumë prej rrethanave në vijim:

a) nga një person që abuzon me autoritetin që i është dhënë nga funksionet e tij;

b) ndaj një të mituri;

c) ndaj një personi, cilësitë e veçanta të të cilit, për shkak të moshës së tij, sëmundjes, paaftësisë fizike ose mendore ose gjendjes së shtatzënisë, janë të dukshme ose të njohura për autorin e tyre;

ç) ndaj një personi, vulnerabiliteti ose varësia e veçantë e të cilit rezultojnë nga pasiguria e situatës së tij ekonomike ose sociale, kur ajo është e dukshme ose e njohur për autorin e tyre;

d) nga disa persona që veprojnë në cilësinë e autorit ose bashkëpunëtorit;

dh) duke përdorur një shërbim të komunikimit publik në internet ose me anë të një aparature digjitale ose elektronike;

e) kur një i mitur ka qenë i pranishëm dhe ka vepruar;

ë) kur vepra kryhet nga prindi, birësuesi, njerku apo njerka, të paralindurit, gjini e afërt me personin ose kur vepra është kryer nga një person që është në marrëdhënie familjare me viktimën;

f) kur vepra është kryer nga mësuesi, udhëheqësi fetar, specialisti i kujdesit shëndetësor, personi të cilit i është besuar rritja apo kujdesi për viktimën ose që në ndonjë mënyrë tjetër ka autoritet ndaj personit;

g) kur viktima mbahet në burg, paraburgim, qendër disiplinore, në një institucion të edukimit apo institucion edukativo-korrektues, është pacient në spital, qendër të shëndetit mendor apo rehabilitimit, banor i shtëpisë së kujdesit apo strehimores, ose mbahet apo është i mbyllur në çfarëdo vendi tjetër me urdhër të gjykatës apo prokurorisë ose sipas ligjit.

### **Neni 813**

#### **Degradimi i integritetit seksual**

1. Shtyrja që i bëhet një personi, me çdo mjet ose formë, të ekspozojë pjesët intime të trupit të tij, të masturbojë ose të kryejë ndonjë akt tjetër që cenon dinjitetin e tij, duke krijuar një mjedis poshtërues apo degradues të integritetit seksual të këtij personi, pa pëlqimin e tij, dënohet me gjobë ose me burgim nga një deri në tre vjet.

2. Vepra penale dënohet me burgim nga dy deri në gjashtë vjet kur kryhet në një apo më shumë nga rrethanat në vijim:

a) me kërcënime serioze për përdorim të dhunës;

b) me kërcënim të rrezikimit të atëçastshëm të jetës ose trupit të viktimës apo të personit tjetër; ose

c) duke shfrytëzuar situatën në të cilën personi është i pambrojtur dhe ku siguria e tij është në rrezik.

ç) kur është përdorur forca;

d) kur viktimës i është shkaktuar çrregullim i rëndë i shëndetit mendor, apo viktima tenton të bëjë vetëvrasje pas veprës penale;

dh) kur ka shkaktuar me dashje dehjen e viktimës me anë të alkoolit, drogës apo substancave të tjera;

e) kur vepra është kryer nga më shumë se një person;

ë) kur shfrytëzon cilësitë e veçanta të personit, si: mosha, aftësitë e kufizuara mendore apo fizike, çrregullimet apo paaftësinë fizike apo mendore, ose shtatzëninë;

f) kur viktima është e mitur;

g) kur vepra kryhet nga prindi, birësuesi, njerku apo njerka, të paralindurit, gjini e afërt me personin ose kur vepra është kryer nga një person që është në marrëdhënie familjare me viktimën;

gj) kur vepra është kryer nga mësuesi, udhëheqësi fetar, specialisti i kujdesit shëndetësor, personi të cilit i është besuar rritja apo kujdesi për personin e tillë ose që në ndonjë mënyrë tjetër ka autoritet ndaj personit;

h) kur viktima mbahet në burg, paraburgim, qendër disiplinore, në një institucion të edukimit apo institucion edukativo-korrektues, është pacient në spital, qendër të shëndetit mendor apo rehabilitimit, banor i shtëpisë së kujdesit apo strehimores, ose mbahet apo është i mbyllur në çfarëdo vendi tjetër me urdhër të gjykatës apo prokurorisë ose sipas ligjit.

### **Neni 814**

#### **Shpërndarja telematike e akteve seksuale**

Kryerja me dashje e akteve të mëposhtme:

a) dhënia akses për pamje, pamje filmike ose materiale të tjera intime që përmbajnë akte seksuale të një personi ose pjesë intime të një personi, ndaj një numri të papërcaktuar përdoruesish, nëpërmjet teknologjive të informacionit dhe komunikimit, pa pëlqimin e personit, kur një sjellje e tij ka mundësi :

b) prodhimi ose manipulimi dhe më pas dhënia akses për pamje, pamje filmike ose materiale të tjera, në mënyrë që të besohet se një person po merr pjesë në akte seksuale, ndaj një numri të papërcaktuar përdoruesish nëpërmjet teknologjive të informacionit dhe komunikimit, pa pëlqimin e personit të interesuar,

c) kërcënimi për kryerjen e ndonjëres prej veprimeve të sipërpërmendura me qëllim që të detyrohet një person tjetër të kryejë një veprim të caktuar, të pranojë ose të heqë dorë nga kryerja e tyre,  
dënohet me burgim nga dy deri në gjashtë vjet.

### **Neni 815**

#### **Veprimet e turpshme**

1. Ngacmimi i një personi tjetër duke kryer veprime të turpshme, si ekspozimin e pjesëve intime të trupit, masturbimin ose duke kryer ndonjë akt tjetër që cenon dinjitetin e tij, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë, si dhe me dënimin plotësues të trajtimit mjekësor.

2. Vepra penale ndiqet vetëm me kërkesën e viktimës, përveç rasteve kur organi i ndjekjes penale vlerëson se ka interes të veçantë publik për ndjekjen e tij kryesisht.

### **Neni 816**

#### **Përgjegjësia për tentativën**

Tentativa për kryerjen e krimeve seksuale ndaj të miturve të parashikuara në këtë seksion dënohet me të njëjtat masa dënimi të parashikuara nga dispozitat penale përkatëse dhe nuk gjen zbatim neni 30 i këtij Kodi për lehtësimin apo zbutjen e dënimit penal për shkak se vepra ka mbetur në tentativë.

### **Neni 817**

#### **Dënimet plotësuese dhe masat e tjera penale**

1. Dënimi kryesor për krimet seksuale dhe veprat e tjera penale të këtij kreu të kryera ndaj të miturve shoqërohet detyrimisht, sipas natyrës së rastit, me dënimet plotësuese, si më poshtë:

a) me humbjen e përgjegjësisë prindërore, kur cilësia e prindit është një element përbërës cilësues ose rrethanë rënduese e krimin;

b) heqjen e së drejtës për të ushtruar funksione publike sipas parashikimeve të nenit 76 të këtij Kodi nga çdo institucion i kujdestarisë, institucion mjekësor për të miturit me aftësi të kufizuar fizike apo mendore apo/dhe institucion i përkrahjes, publike apo private;

c) me përjashtimin nga e drejta e trashëgimisë së viktimës dhe humbjen e të drejtave për të përfituar kujdesin prej saj, në rastet kur ky detyrim ekziston për shkak të ligjit apo marrëdhënies gjinore;

ç) me heqjen e përkohshme ose të përhershme të së drejtës për të ushtruar funksione publike, në varësi të rëndësisë së shkeljes;

d) me heqjen e përkohshme ose të përhershme të së drejtës së ushtrimit të një veprimtarie ose të një profesioni.

2. Dënimi për cilindo prej krimeve seksuale dhe veprave të tjera penale të këtij seksioni të kryera ndaj të miturve, në çdo rast shoqërohet detyrimisht edhe me heqjen e përhershme të autorit të veprës nga çdo pozicion në shkolla të të gjitha niveleve dhe nga çdo institucion apo shërbim në institucione ose struktura të tjera publike ose private, që përdoren kryesisht nga të miturit.

3. Dënimi kryesor për krimet seksuale dhe veprat e tjera penale të këtij seksioni të kryera ndaj të miturve, në rastet e zbatimit të rrethanave cilësuese të parashikuara në këto dispozita, shoqërohet detyrimisht me dënimet apo masat plotësuese, si më poshtë:

a) me kufizimin e lëvizjeve dhe të qarkullimit të lirë për një periudhë nga dy deri në pesë vjet;

b) me ndalimin e përhershëm për t'u afruar në vende që përdoren zakonisht nga të miturit;

c) me regjistrimin e gjeneraliteteve të autorëve në një regjistër të veçantë që mbahet nga organet vendore e qendrore të Policisë së Shtetit për efekt monitorimi e parandalimi të çdo veprimtarie të mundshme të mëtejshme kriminale ndaj integritetit seksual të të miturve;

ç) me publikimin e vendimit gjyqësor me gjeneralitetet e plota të autorit, përfshirë këtu edhe fotografinë e tij, të veprës penale të kryer dhe dënimit të dhënë, por me përmbajtje të përmbledhur të faktit penal dhe arsytimit të gjykatës penale, me qëllim arritjen e ekuilibrit dhe proporcionalitetit në mbrojtjen nga ekspozimi të të dhënave personale të viktimës së mitur dhe ekspozimin e autorit për të garantuar sigurinë publike të të miturve nga krimet që drejtohen ndaj integritetit seksual të tyre;

d) me shpërndarjen e vendimit gjyqësor dhe fotografisë së autorit në të gjitha institucionet arsimore dhe në institucionet që përdoren më së shumti nga fëmijët e mitur;

dh) me ndalimin e përhershëm të kryerjes së punës që përfshin kontakte të përhershme me të miturit;

e) me detyrimin e përhershëm për t'i mbajtur organet e policisë të informuara për vendbanimin e tyre dhe çdo lëvizje të mundshme.

4. Në çdo rast gjykata vendos masën e zëvendësimit të dëmit të shkaktuar dhe, përveç sendeve që kane shërbyer për kryerjen e veprave penale, kur ajo është kryer nga subjektet me qëllim përfitimi material apo të premtuar, vendoset konfiskimi i të ardhurave nga vepra penale apo të premtuara.

5. Shkelja e detyrimeve të vendosura nga gjykata sipas paragrafit të tretë të këtij neni, barazohet me shkeljen e çdo dënimi plotësues të dhënë dhe dënohet sipas parashikimeve të këtij Kodi.

## **Neni 818**

### **Kryerja e veprës nga personi juridik**

1. Nëse një person juridik ka kryer veprat penale të parashikuara në nenet 803, 804, 805, 806, 807, 801, 802, 803, 804 dhe 805 të këtij kreu dënimi me gjobë do të ndjekë rregullat e përcaktuara në nenin 121 të këtij Kodi.

2. Nëse ndonjëra prej veprave penale të parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni kryhet me qëllim fitimi, atëherë masa e gjobës do të jetë mbi pesëfishin e përfitimit të paligjshëm.

3. Gjykata cakton edhe dënimet plotësuese të pezullimit të veprimtarisë së personit juridik për një periudhë tërësore jo më shumë se pesë vjet dhe mbylljen e mjediseve të punës së kompanisë.

## **Neni 819**

## **Komunikimi me seksionin për të mitur të gjykatës civile**

1. Prokurori, kur fillon procedimi penal për një prej krimeve seksuale ndaj të miturve të parashikuara në këtë seksion, kërkon në seksionin për të mitur të gjykatës civile marrjen e masave të mbrojtjes dhe çdo masë tjetër të nevojshme sipas nenit 37 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” i ndryshuar, Kodit të Familjes të Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionit të zbatueshëm për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve.

2. Në rastet e parashikuara në paragrafin e parë, viktimës së mitur, bazuar në dispozitat e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur i sigurohet ndihma emocionale dhe psikologjike në çdo gjendje dhe shkallë procedimi, nga prania e prindërve ose personave të tjerë të përshtatshëm, të treguar nga i mituri, si dhe nga grupe, fondacione, shoqata ose organizata joqeveritare me përvojë të provuar në sektorin e ndihmës dhe mbështetjes për viktimat e krimeve të përmendura në paragrafin e parë dhe të regjistruara në një listë të veçantë të subjekteve të legjitimuara për këtë qëllim, me pëlqimin e të miturit, dhe të pranuar nga autoriteti gjyqësor që procedon.

### **Neni 820**

#### **Zbatimi i dispozitave në varësi të numrit të viktimave**

Për efekt të numrit të viktimave, çdo dispozitë e këtij seksioni do të zbatohet aq herë sa është numri i tyre, pavarësisht nga lloji apo shkalla e pasojave që rezultojnë nga kryerja e veprave penale.

### **Neni 821**

#### **Dënimet plotësuese dhe konkurrimi**

1. Nëse veprat penale të parashikuara në këtë seksion kryhen edhe nga nëpunësi publik i caktuar sipas ligjit, atëherë gjykata, krahas dënimit kryesor cakton edhe dënimin plotësues, heqjen e së drejtës për të punuar në shërbimin publik, ose çdo dënim tjetër plotësues që çmon të arsyeshëm, në përputhje me natyrën e veprës dhe veprimeve të kryera nga i dënuari, gjithmonë nëse dispozita konkrete nuk ka parashikuar ndryshe.

2. Në çdo rast gjykata vendos masën e zëvendësimit të dëmit të shkaktuar dhe, përveç sendeve që kanë shërbyer për kryerjen e veprave penale, kur ajo është kryer nga subjektet me qëllim përfitimi material apo të premtuar, vendoset konfiskimi i të ardhurave nga vepra penale apo të premtuara.

3. Gjkata vendos konfiskimin e mjediseve që kanë shërbyer për kryerjen e krimeve shumë të rënda të parashikuara në dispozitat e këtij kreu.

4. Për qëllim të këtij kreu, nëse mënyrat e kryerjes së veprave penale të parashikuara këtu që kanë bërë të mundur kryerjen e ndonjëres prej tyre, përbëjnë vepra penale më vete, atëherë ato konkurrojnë me veprën penale të cilës i kanë shërbyer për të sjellë apo tentuar pasojën.

5. Për veprat penale të parashikuara në dispozitat e këtij kreu, gjykata vendos edhe masën penale të regjistrimit dhe shkëmbimit të informacionit që përmbajnë të dhëna rreth subjektit lidhur me rastet kur vepra penale ka rendësi për njohjen dhe parandalimin e kryerjes së krimeve prej tij në të ardhmen ose/edhe me natyrë edhe ndërkombëtare.

### **Neni 822**

## **Kryerja e veprës në bashkëpunim**

Nëse për kryerjen e ndonjëres prej veprave penale të parashikuara në këtë kre, autorit të posaçëm i është dashur të bashkëpunojë me ndonjë person tjetër, pavarësisht cilësive të posaçme të këtij të fundit, ata do të përgjigjen për kryerjen në bashkëpunim të veprës penale të parashikuar në këtë kre, apo çfarëdolloj vepre penale që konkurron me to.

### **KREU IV**

#### **VEPRAT PENALE KUNDËR LIRIVE VETJAKE**

##### **SEKSIONI I**

#### **VEPRAT PENALE KUNDËR LIRISË PERSONALE**

### **Neni 823**

#### **Përkufizime mbi trafikimin e qenieve njerëzore**

Për qëllime të këtij ligji do të kuptohen:

a) shprehja “trafikim i personit madhor” nënkupton rekrutimin, transportimin, transferimin, pritjen, strehimin, fshehjen duke përfshirë shkëmbimin ose transferimin e kontrollit mbi këta persona, me anë të kanosjes ose të përdorimit të forcës apo me forma të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, kurthit, shpërdorimit të detyrës ose duke përfituar nga gjendja shoqërore, fizike apo psikike e personit, ose me anë të dhënies ose marrjes së pagesave apo përfitimeve për të arritur miratimin e personit që ka kontroll mbi personin tjetër, me qëllim të shfrytëzimit të tij si brenda ashtu dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

b) fjala “shfrytëzim” përfshin, por nuk kufizohet në, shfrytëzimin e prostitucionit të tjerëve, pornografisë ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, lëmshës, shërbimeve ose punës së detyruar, skllavërisë ose veprimeve të ngjashme me skllavërinë, robërisë ose heqjes së organeve apo qelizave.

c) kompromisi apo pëlqimi i viktimës së trafikimit me njerëz për qëllime shfrytëzimi nuk është i vlefshëm në lidhje me shfrytëzimin e synuar, të parashtruar në shkronjën “a” të këtij neni, në rast se, kundër viktimës, është përdorur ndonjë nga mjetet e parashtruara në këtë paragraf.

### **Neni 824**

#### **Trafikimi i personave madhorë**

1. Trafikimi i personave madhorë në një nga format e parashikuara në nenin 823 dënohet me burgim nga tetë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

2. Organizimi, drejtimi dhe financimi i veprimtarisë së trafikimit të personave madhorë dënohen me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.

3. Vepra penale e parashikuar nga paragrafi i parë i këtij neni dënohet nga pesëmbëdhjetë deri në njëzet e pesë vjet burgim nëse veprimet e parashikuara në të janë kryer:

a) duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore ose çrregullim të rëndë për shëndetin mendor apo fizik viktimës;

b) kur vepra kryhet nga gjini e afërt me viktimën ose kur vepra është kryer nga një person që është në marrëdhënie familjare me viktimën;

c) kur vepra është kryer nga mësuesi, udhëheqësi fetar, specialisti i kujdesit shëndetësor, personi të cilit i është besuar kujdesi për viktimën ose që në ndonjë mënyrë tjetër ka autoritet ndaj viktimës;

ç) kur vepra është kryer nga një person që është “maskuar” ose që simulon cilësinë e një funksionari publik ose nga një person i ngarkuar me një shërbim publik.

4. Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e viktimës, dënohet me burgim nga njëzet e pesë deri në tridhjetë e pesë vjet.

5. Tentativa për kryerjen e krimit të mësipërm ndëshkohet njëlloj si krimi i kryer.

## **Neni 825**

### **Veprime që lehtësojnë trafikimin**

1. Falsifikimi, zotërimi ose sigurimi i dokumenteve të identitetit, i pasaportave, i vizave ose i dokumenteve të tjera të udhëtimit, apo mbajtja, heqja, fshehja, dëmtimi ose shkatërrimi i tyre, që kanë shërbyer për trafikimin e personave madhorë, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

2. Kur vepra penale kryhet nga personi zyrtar në shpërdorim të funksionit të tij apo me autorizim të tij, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.

3. Kur vepra është kryer nga personi që ka për detyrë të lëshojë letërnjoftimin, pasaportën, vizën apo dokumentin e udhëtimit, dënohet me burgim nga katër deri në tetë vjet.

## **Neni 826**

### **Përfitimi ose përdorimi i shërbimeve të ofruar nga personat e trafikuar**

1. Për qëllime të këtij ligji, shprehja “viktimë e trafikimit” nënkupton personin i cili është trafikuar sipas dispozitave të këtij Kodi.

2. Për qëllime të këtij neni, nuk është e rëndësishme nëse personi e ka ditur apo jo se viktima është viktimë e trafikimit, përveç rasteve kur për arsye objektivist të justifikuara, mosnjohja ka qenë e pashmangshme.

3. Shfrytëzimi ose mundësimi i shërbimeve seksuale të viktimës së trafikimit dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

4. Kur vepra penale kryhet nga personi zyrtar në keqpërdorim të pozitës apo në bazë të autorizimeve të tij, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.

5. Nëse vepra penale e parashikuar nga paragrafi i tretë i këtij neni rezulton me vdekjen e viktimës së trafikimit, dënohet nga pesëmbëdhjetë deri në njëzet e pesë vjet burgim.

## **Neni 827**

### **Krijimi i kushteve për cenimin e paprekshmërisë seksuale**

Kur autori ka kryer heqjen e paligjshme të lirisë, ose rrëmbimin apo marrjen peng me qëllimin e cenimit të lirisë a paprekshmërisë seksuale të viktimës, ose kur ka shfaqur këtë qëllim pas kryerjes së veprimeve që kanë hequr në mënyrë të paligjshme lirinë ose me anë të të cilëve është kryer rrëmbimi apo mbajtja peng e personit, dënimit përkatës për krimin e kryer i shtohet edhe deri në një të tretën e tij.

**Neni 828**  
**Heqja e paligjshme e lirisë**

1. Heqja e paligjshme e lirisë së personit përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.
2. Vepra penale dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet nëse është kryer:
  - a) shoqëruar me dhunë fizike;
  - b) kur viktimë është i paralindur, paslindur, bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt.
  - c) nga ana e punonjësit që kryen një funksion shtetëror ose një shërbim publik gjatë ushtrimit të detyrës së tij.

**Neni 829**  
**Mbajtja në skllavëri**

Mbajtja e një personi në nënshttrim të vazhdueshëm, duke i kufizuar në mënyrë të paligjshme lirinë, duke ushtruar pushtet përmbi të, duke e trajtuar viktimën si pronë, përtej rasteve të parashikuara në nenet 824 dhe 825 të këtij Kodi, përbën mbajtje në skllavëri dhe dënohet me burgim nga tetë deri në njëzet vjet.

**Neni 830**  
**Rrëmbimi ose mbajtja në gjendje privimi të lirisë**

1. Rrëmbimi i personit dhe mbajtja e tij në privim të lirisë me qëllim për të fituar pasuri ose çdo lloj përfitimi a qëllimi tjetër, dënohet me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.
2. Vepra penale e kryer ndaj të miturit në moshën gjashtëmbëdhjetë deri në tetëmbëdhjetë vjeç dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë deri në njëzet e pesë vjet.
3. Vepra penale e kryer ndaj të miturit nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç dënohet me burgim jo më pak se njëzet e pesë vjet.
4. Dënimi i parashikuar nga paragrafi parë, i dytë dhe i tretë i këtij neni rritet deri me një të tretën nëse veprimet e parashikuara në to janë kryer:
  - a) duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore ose çrregullim të rëndë për shëndetin mendor apo fizik viktimës;
  - b) duke përdorur armë apo mjete të tjera të rrezikshme;
  - c) duke shfrytëzuar cilësitë e veçanta të personit, si aftësitë e kufizuara mendore apo fizike, çrregullimet apo paaftësinë fizike apo mendore ose shtatzëninë;
  - ç) duke u shoqëruar ose përcjellë nga tortura apo trajtim çnjerëzor;
  - d) nga gjini e afërt me viktimën ose kur vepra është kryer nga një person që është në marrëdhënie familjare me viktimën;
  - dh) nga mësuesi, udhëheqësi fetar, specialisti i kujdesit shëndetësor, personi të cilit i është besuar kujdesi për viktimën ose që në ndonjë mënyrë tjetër ka autoritet ndaj viktimës;
  - e) nga një person që është maskuar ose që simulon cilësinë e një funksionari publik ose të një personi të ngarkuar me një shërbim publik;

- ë) në bashkëpunim nga disa persona;
  - f) nga një person që bën pjesë në një organizatë kriminale me qëllimin që të lehtësojë veprimtarinë e saj;
  - g) nga punonjësi publik.
5. Kur nga vepra penale është shkaktuar vdekja e viktimës, dënohet me burgim të përjetshëm.
6. Kur personi i rrëmbyer ose i mbajtur në privim të lirisë lirohet vullnetarisht para mbarimit të shtatë ditëve nga rrëmbimi ose mbajtja peng, pa e arritur qëllimin e krimit dhe, kur ndaj personit nuk është ushtruar torturë ose dëmtime të tjera të shëndetit, dënohet me burgim nga tre deri në pesë vjet.

### **Neni 831**

#### **Shtrëngimi për kryerjen ose moskryerjen e një veprimi të caktuar**

1. Shtrëngimi apo detyrimi i një personi me përdorimin e forcës, kanosjes serioze apo çdo mënyre tjetër që përfiton nga cenueshmëria e viktimës, apo krijimi i rrethanave frikësuese në mënyrë që të detyrohet të veprojë jashtë vullnetit të tij të lirë, për të kryer ose për të mos kryer një veprim të caktuar, ose e shtrëngon atë të pajtohet kundër vullnetit të tij me një veprim të caktuar, për qëllime përfitimi të çdo lloji, përveçse pasuror, për vete ose për të tretë, dënohet me burgim nga katër deri në tetë vjet.

2. Vepra penale e parashikuar nga paragrafi i parë i këtij neni dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet kur kryhet në një apo më shumë prej rrethanave vijuese:

- a) duke kanosur viktimën me zbulimin e një fakti që do të dëmtonte rëndë nderin ose reputacionin e viktimës apo të personit të lidhur ngushtë me të;
- b) duke përdorur armë zjarri, një mjet të rrezikshëm apo çdo send tjetër që mund të shkaktojë lëndim të rëndë trupor ose dëmtim të rëndë të shëndetit të viktimës;
- c) duke shfrytëzuar cilësitë e veçanta të viktimës, si: aftësitë e kufizuara mendore apo fizike, çrregullimet apo paaftësinë fizike apo mendore të viktimës.

3. Vepra penale e parashikuar nga paragrafi i parë i këtij neni dënohet me burgim nga tetë deri në pesëmbëdhjetë vjet kur kryhet në një apo më shumë prej rrethanave vijuese:

- a) është kryer ndaj një të mituri;
- b) autori ka vepruar si anëtar i grupit të organizuar;
- c) autori ka shkaktuar dëmtim të rëndë të shëndetit të viktimës.

4. Kur nga vepra penale sipas paragrafit të parë, të dytë ose të tretë është shkaktuar vdekja e viktimës madhore dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë deri në tridhjetë vjet, ndërsa kur nga vepra penale është shkaktuar vdekja e viktimës së mitur, dënohet me burgim jo më pak se tridhjetë e pesë vjet ose me burgim të përjetshëm.

### **Neni 832**

#### **Zhdukja me forcë**

1. Zhdukja me forcë, nëpërmjet arrestimit, burgimit, rrëmbimit ose çdo forme tjetër heqjeje lirie të personit, nga funksionarët publikë apo nga persona që veprojnë me autorizimin, mbështetjen ose miratimin e tyre, shoqëruar me mospranimin e faktit të heqjes së lirisë apo me fshehjen e fatit të personit ose vendit në të cilin ai ndodhet, duke i mohuar ndihmën dhe mbrojtjen sipas ligjit, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

2. Eprori që:

a) ushtron përgjegjësinë dhe kontrollin e tij efektiv mbi veprimtaritë me të cilat lidhet zhdukja me forcë;

b) ka dijeni që vartës të vendosur nën autoritetin dhe kontrollin e tij efektiv po kryejnë ose do të kryejnë zhdukje me forcë, ose nuk merr parasysh të dhëna dhe informacione që e tregojnë qartë këtë fakt apo;

c) nuk ka marrë të gjitha masat e nevojshme dhe të arsyeshme që janë në kompetencën e tij për të penguar ose ndëshkuar personin që jep autorizimin, mbështetjen dhe miratimin e zhdukjes me forcë, ose për t'ia dërguar çështjen organeve kompetente të ndjekjes penale, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.

3. Kur kjo veprë kryhet kundër fëmijëve, grave shtatzëna ose personave që, për shkaqe të ndryshme, nuk mund të mbrohen, apo shoqërohet me vuajtje të rënda fizike, dënohet me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.

4. Kur kjo veprë ka sjellë si pasojë vdekjen e personit, dënohet me burgim jo më pak se tridhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.

5. Marrja e paligjshme e fëmijëve që janë subjekt i një zhdukjeje me forcë, ose e fëmijëve, babai, nëna ose përfaqësuesi ligjor i të cilëve është bërë subjekt i një zhdukjeje me forcë, apo e fëmijëve të lindur gjatë periudhës së zhdukjes me forcë, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.

### **Neni 833**

#### **Kryerja e veprës nga personi juridik**

1. Nëse një person juridik ka kryer veprat penale të parashikuara në nenet 824, 825, 826, 829, 830, 831 dhe 832 të këtij kreu dënimi me gjobë do të ndjeke rregullat e përcaktuara në nenin 123 të këtij Kodi.

2. Nëse ndonjëra prej veprave penale të parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni kryhet me qëllim fitimi, atëherë masa e gjobës do të jetë mbi pesëfishin e përfitimit të paligjshëm.

3. Gjykata cakton edhe dënimet plotësuese të pezullimit të veprimtarisë së personit juridik për një periudhë tërësore jo më shumë se pesë vjet dhe mbylljen e mjediseve të punës së kompanisë.

### **Neni 834**

#### **Dënimet plotësuese dhe konkurrimi**

1. Nëse veprat penale të parashikuara në këtë seksion kryhen edhe nga nëpunësi publik i caktuar sipas ligjit, atëherë gjykata, krahas dënimit kryesor cakton edhe dënimin plotësues, heqjen e së drejtës për të punuar në shërbimin publik, ose çdo dënim tjetër plotësues që çmon të arsyeshëm, në përputhje me natyrën e veprës dhe veprimeve të kryera nga i dënuari, gjithmonë nëse dispozita konkrete nuk ka parashikuar ndryshe.

2. Në çdo rast gjykata vendos masën e zëvendësimit të dëmit të shkaktuar dhe, përveç sendeve që kanë shërbyer për kryerjen e veprave penale, kur ajo është kryer nga subjektet me qëllim përfitimi material apo të premtuar, vendoset konfiskimi i të ardhurave nga vepra penale apo të premtuara.

3. Gjykata vendos konfiskimin e mjediseve që kanë shërbyer për kryerjen e krimeve shumë të rënda të parashikuara në dispozitat e këtij kreu.

4. Për qëllim të këtij seksioni, nëse mënyrat e kryerjes së veprave penale të parashikuara këtu që kanë bërë të mundur kryerjen e ndonjërës prej tyre, përbëjnë vepra penale më vete, atëherë ato konkurrojnë me veprën penale të cilës i kanë shërbyer për të sjellë apo tentuar pasojën.

5. Për veprat penale të parashikuara në dispozitat e këtij kreu, gjykata vendos edhe masën penale të regjistrimit dhe shkëmbimit të informacionit që përmbajnë të dhëna rreth subjektit lidhur me rastet kur vepra penale ka rëndësi për njohjen dhe parandalimin e kryerjes së krimeve prej tij në të ardhmen ose/edhe me natyrë edhe ndërkombëtare.

### **Neni 835**

#### **Bashkëpunimi**

Nëse për kryerjen e ndonjërës prej veprave penale të parashikuara në këtë kre, autorit të posaçëm i është dashur të bashkëpunojë me ndonjë person tjetër, pavarësisht cilësive të posaçme të këtij të fundit, ata do të përgjigjen për kryerjen në bashkëpunim të veprës penale të parashikuar në këtë kre, apo çfarëdolloj vepre penale që konkurron me to.

### **Neni 836**

#### **Zbatimi i dispozitave në varësi të numrit të viktimave**

Për efekt të numrit të viktimave, çdo dispozitë e këtij seksioni do të zbatohet aq herë sa është numri i tyre, pavarësisht nga lloji apo shkalla e pasojave që rezultojnë nga kryerja e veprave penale.

## **SEKSIONI II**

### **VEPRAT PENALE KUNDËR LIRIVE DHE TË DREJTAVE VETJAKE**

### **Neni 837**

#### **Dhunimi i banesës**

1. Hyrja ose qëndrimi në banesën e një personi apo në mjediset e tjera që njehsohen me të, kundër vullnetit apo pa pëlqimin e tij, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre muaj.

2. Kur vepra është kryer me dhunë ose nëpërmjet kërcënimit për përdorimin e armës, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

### **Neni 838**

#### **Ndërhyrje të padrejta në jetën private**

1. Cilido që për qëllime përfitimi material ose jo material, apo kur ka qëllim të dëmtojë reputacionin e një personi, pa autorizim fotografon, filmon, regjistron me video apo audio këtë person në banesën e tij personale ose në ndonjë vend tjetër ku personi gëzon ligjërisht privatësi, apo vendos aparatura që shërbejnë për fotografim, transmetim apo regjistrim të fjalëve ose të figurave, i të dhënave që ekspozojnë një aspekt të jetës private të personit, pa pëlqimin e tij, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

2. Shpërndarja, ofrimi për publikim apo publikimi me çdo mjet ose formë të komunikimit publik apo mënyrë tjetër i të dhënave të marra në mënyrën dhe qëllimin e përcaktuar në paragrafin e parë të këtij neni, dënohet me gjobe ose me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

3. Kur veprat sipas dy paragrafëve më lart të këtij neni, kryhet ndaj të miturit, dënimi me burgim shtohet respektivisht deri në një të dytën më shumë.

4. Kur veprat e përmendura në paragrafin e parë të këtij neni kryhen nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

5. Kur vepra penale e parashikuar në paragrafin e parë dhe të dytë të këtij neni është kryer nëpërmjet shtypit të shkruar ose audioviziv, dispozitat përkatëse zbatohen edhe ndaj personit juridik që ka bërë të mundur publikimin e të dhënave private.

6. Kur veprat penale të parashikuara në paragrafët e sipërpërmendur të këtij neni përfshijnë fjalë ose imazhe që paraqesin apo kanë karakter seksual, dënimet rriten deri me një të dytën.

7. Nuk ka përgjegjësi penale, nëse fotografimi, filmimi ose regjistrimi bëhet me qëllim zbulimin e veprës penale dhe të autorit të saj ose për të vërtetuar faktin penal si provë në polici, prokurori ose në gjykatë, me kushtin që fotografitë dhe regjistrimet t'u dorëzohen këtyre organeve, ose për aktivitetet të cilat eskuzivisht i shërbejnë qëllimit të kryerjes së detyrave të ligjshme zyrtare ose profesionale”

8. Paragrafi i dytë i këtij neni zbatohet edhe nëse shkelësi, i pa autorizuar për të kryer këtë veprim, zbulon sekretin e një personi tjetër pas vdekjes së personit në fjalë”.

9. Procedimi penal për këtë veprë penale, përveçse kur prokurori sheh interes të veçantë publik në iniciimin e saj, fillon me paraqitjen në gjykatë të kërkesës për gjykim nga viktima akuzuese ose nga përfaqësuesi i saj ligjor dhe pushohet nëse hiqet dorë prej saj.

### **Neni 839**

#### **Përndjekja**

1. Ndjekja, ngacmimi në mënyrë të përsëritur dhe këmbëngulëse i një personi, pa pasur një autorizim të ligjshëm, duke i ndryshuar mënyrën normale të jetesës së përditshme, nëpërmjet njërës nga sjelljet e mëposhtme:

- a) duke e mbikëqyrur, ndjekur ose duke kërkuar afërsinë fizike të viktimës;
- b) duke vendosur ose duke u përpjekur të vendosë kontakte me të nëpërmjet çdo mjeti komunikimi ose nëpërmjet personave të tretë;
- c) duke blerë produkte ose mallra nëpërmjet përdorimit të papërshtatshëm të të dhënave personale të viktimës ose kontraktin shërbime apo bën të mundur që persona të tretë të vihen në kontakt me të;
- ç) duke cenuar lirinë ose pasurinë e viktimës ose lirinë a pasurinë e një personi të afërt me të; dënohet me gjobë ose burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet.

2. Kur vepra penale e parashikuar nga paragrafi i parë kryhet nga ish-bashkëshorti, ish-bashkëjetuesi apo personi që ka pasur lidhje shpirtërore/afeksioni me viktimën, dënimi rritet deri me një të tretat e tij.

3. Dënimi i parashikuar nga paragrafët e parë dhe të dytë të këtij neni rritet me një të dytën nëse veprimet e parashikuara në to janë kryer:

- a) duke përdorur forcën;
- b) duke i shkaktuar çrregullim të rëndë për shëndetin mendor apo fizik viktimës;
- c) duke përdorur armë apo mjete të tjera të rrezikshme;

ç) duke shfrytëzuar cilësitë e veçanta të viktimës, si: aftësitë e kufizuara mendore apo fizike, çrregullimet apo paaftësinë fizike apo mendore ose shtatzëninë;

d) kur vepra është kryer nga mësuesi, udhëheqësi fetar, specialisti i kujdesit shëndetësor, personi të cilit i është besuar kujdesi për viktimën ose që në ndonjë mënyrë tjetër ka autoritet ndaj saj:

dh) nga një person që është “maskuar” ose që simulon cilësinë e një funksionari publik ose të një personi të ngarkuar me një shërbim publik.

#### **Neni 840**

##### **Përndjekja online**

Kryerja e sjelljeve të mëposhtme me dashje:

a) ndërmarrja, në mënyrë të vazhdueshme, të qëndrueshme, e sjelljeve kërcënuese ose frikësuese ndaj një personi tjetër nëpërmjet teknologjive të informacionit dhe komunikimit, të tilla që t'i bëjnë ata të kenë frikë serioze/konsiderueshme për sigurinë e tyre ose të personave që kanë në ngarkim;

b) vendosja e një personi tjetër nën mbikëqyrje të vazhdueshme duke përdorur teknologjitë e informacionit dhe komunikimit, pa pëlqimin e tij ose pa një autorizim ligjor për këtë qëllim, për të gjurmuar ose monitoruar lëvizjet dhe veprimtarinë e tij;

c) bërja i aksesueshëm për shumë përdorues fundorë, nëpërmjet teknologjive të informacionit dhe komunikimit, të materialeve që përmbajnë të dhëna personale të një personi tjetër pa pëlqimin e tij, me qëllim që t'i nxisë përdoruesit fundorë t'i shkaktojnë dëm fizik ose dëm të konsiderueshëm psikologjik këtij personi, dënohet me burgim nga dy deri në gjashtë vjet.

#### **Neni 841**

##### **Ngacmimet online**

Kryerja e sjelljeve të mëposhtme, me dashje:

a) duke sulmuar në bashkëpunim me të tretë, një person tjetër nëpërmjet bërjes së materialeve kërcënuese ose abuzive të aksesueshme për një sërë përdoruesish fundorë nëpërmjet teknologjive të informacionit dhe komunikimit, duke i shkaktuar një dëmtim të konsiderueshëm psikologjik këtij personi, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

b) duke marrë pjesë së bashku me të tretë në kryerjen e veprimeve sipas shkronjës “a”, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet.

#### **Neni 842**

##### **Përdorimi i paligjshëm i imazhit**

1. Përdorimi i imazhit të një personi për të bërë njoftime ose për të hapur profile të rreme në rrjetet sociale, faqet e kontaktit ose në çdo mjet tjetër komunikimi publik, pa pëlqimin e mbajtësit të imazhit, kur i shkakton këtij të fundit gjendje ngacmimi, përndjekjeje ose poshtërimi, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

2. Ndjekja penale për veprën penale fillon me ankim të viktimës ose përfaqësuesit ligjor të saj dhe pushon me heqjen dorë prej tij.

#### **Neni 843**

##### **Përdorimi keqdashës i thirrjeve telefonike**

1. Thirrjet telefonike keqdashëse që bëhen me qëllim për të prishur qetësinë e tjetrit, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë.

2. Ndjekja penale për veprën penale fillon me paraqitjen e ankimit të viktimës ose përfaqësuesit të saj ligjor dhe pushon me heqjen dorë prej tij.

#### **Neni 844**

#### **Zbulimi i paautorizuar i informacionit vetjak**

1. Zbulimi i informacionit vetjak të një personi pa autorizimin e tij, nga ana e mbrojtësit ligjor, mjekut, farmacistit, mësuesit apo çdo personi tjetër, për të cilin është vënë në dijeni për shkak dhe gjatë ushtrimit të profesionit të tij dhe që është ligjërisht i detyruar ta mbajë në fshehtësi, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

2. Po kjo veprë, e kryer me qëllim fitimi ose për të dëmtuar personin që i përket informacioni konfidencial apo një person tjetër, dënohet me gjobë ose me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

3. Personat e përmendur në paragrafin e parë të këtij neni nuk kanë përgjegjësi penale nëse zbulimi i informacionit konfidencial parandalon/kallëzon kryerjen e një vepre penale, në funksion të mbrojtjes së interesit publik ose/dhe të viktimës.

4. Ndjekja penale për veprën penale fillon me paraqitjen e ankimit të viktimës ose përfaqësuesit të saj ligjor dhe pushon me heqjen dorë prej tij.

#### **Neni 845**

#### **Cenimi i fshehtësisë së korrespondencës**

1. Hapja pa autorizim e letrës, telegramit, faksimilit apo çdo dokumenti tjetër të mbyllur të personit që ai drejton apo i drejtohet për komunikim ose, në ndonjë mënyrë tjetër që cenon fshehtësinë e materialeve të tilla apo kur, pa autorizim, mbahen, fshihen, asgjësohen ose i dorëzohen një personi tjetër letra, telegrami, faksimili, apo çdo dokument tjetër i mbyllur ose dërgesë të personit që i drejtohet materiali/komunikimi, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

2. Kur vepra penale sipas parashikimeve të paragrafit të parë të këtij neni kryhet me qëllim përfitimi pasuror apo për t'i shkaktuar dëm personit që i drejtohen/përkasin këto të dhëna, dënohet me gjobë ose me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

3. Kur vepra penale sipas parashikimeve të paragrafit të parë ose të dytë të këtij neni kryhet nga personi që ushtron një funksion publik apo bazuar në autorizimin e tij, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

#### **Neni 846**

#### **Ndërhyrja në të dhënat kompjuterike**

1. Hapja pa autorizim e çdo marrje, dërgese apo komunikimi elektronik të personit, duke thyer kodet mbrojtëse të sistemit privat të tij ose, në ndonjë mënyrë tjetër që cenon fshehtësinë e komunikimit apo kur, pa autorizim, mbahen, fshihen, asgjësohen ose i dorëzohen një personi tjetër

të dhënat e siguruara në postën e viktimës që i drejtohet komunikimi, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

2. Në rast se hyrja në të dhënat personale të viktimës bëhet në kapërcim të autorizimit të lëshuar apo lexohen në mënyrë rastësore, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë.

3. Kur vepra penale sipas parashikimeve të paragrafit të parë të këtij neni kryhet me qëllim përfitimi pasuror apo për t'i shkaktuar dëm personit që i drejtohen/përkasin këto të dhëna, dënohet me gjobë ose me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

4. Kur vepra penale sipas parashikimeve të paragrafit të parë ose të dytë të këtij neni kryhet nga personi që ushtron një funksion publik apo bazuar në autorizimin e tij, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

#### **Neni 847**

#### **Përgjimi i paautorizuar**

1. Përgjimi i bisedës apo komunikimit të një personi, i bërë nga kushdo pa autorizimin përkatës sipas ligjit, ose që i mundëson një personi tjetër të jetë në dijeni për bisedën apo përmbajtjen e komunikimit të përgjuar pa autorizim, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose burgim deri në dy vjet.

2. Prodhimi, importimi, posedimi, ekspozimi, ofrimi, marrja me qera ose shitja e pajisjeve teknike të afta për t'u përdorur për të kryer ndonjërin nga veprat penale të këtij seksioni, kur ofrohen me dijeninë rreth qëllimit për kryerjen e tyre, ose që dihen se do të përdoren për kapjen e të dhënave kompjuterike, kryer në mungesë të autorizimit përkatës sipas ligjit, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

3. Kur vepra penale kryhet nga personi që ushtron një funksion publik apo bazuar në autorizimin e tij dënohet me burgim nga tre deri në gjashtë vjet.

#### **Neni 848**

#### **Cenimi i të drejtës për të ushtruar mjetin juridik**

1. Pengimi i një personi, në mënyrë të paligjshme, për të shfrytëzuar të drejtën e tij për paraqitjen e lutjes, kallëzimit penal, padisë, ankesës, kundërshtimit apo të ndonjë mjeti tjetër juridik, përbën kundërvajtje penale dhe, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

2. Kur vepra penale kryhet nga personi publik në keqpërdorim të pozitës apo me autorizimin e tij, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

3. Ndjekja penale fillon me paraqitjen e ankimit të viktimës ose përfaqësuesit të saj ligjor dhe pushon me heqjen dorë prej tij.

#### **Neni 849**

#### **Cenimi i personalitetit të personit**

1. Publikimi në çdo formë, mënyrë apo mjet i një montazhi të realizuar me fjalët ose pamjen e një personi pa pëlqimin e tij, të cilat kane krijuar një kontekst të shtrëmbëruar dhe fyes për personin, që çojnë në çorientimin apo mashtrimin e publikut, kryer për qëllime përfitimi material, apo kur synon të dëmtojë padrejhtësisht reputacionin e tij, nëse nuk shfaqet dukshëm se bëhet fjalë

për një montazh ose, nuk përmendet shprehimisht që materiali është një montim, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose burgim deri në gjashtë muaj.

2. Ndjekja penale fillon me paraqitjen e ankimit të viktimës ose përfaqësuesit të saj ligjor dhe pushon me heqjen dorë prej tij.

### **Neni 850**

#### **Përvetësimi i identitetit të personit**

1. Përvetësimi i identitetit të një personi, ose përdorimi i një ose më shumë të dhënave të çdo lloji që lejojnë ta identifikojnë plotësisht atë me viktimën, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë.

2. Po kjo vepër penale e kryer në mënyrë të tillë që cenon privatësinë, paqen e viktimës ose të afërmeve të saj, ose dëmton reputacionin ose imazhin e saj, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

3. Kjo kundërvajtje penale dënohet deri në dy vjet burgim kur kryhet në një rrjet komunikimi publik nëpërmjet internetit.

4. Vepra penale si më sipër zbatohet pavarësisht rastit nëse përvetësimi i identitetit është bërë nëpërmjet falsifikimit të dokumenteve ose jo.

5. Procedimi penal për këtë vepër penale fillon me paraqitjen në gjykatë të kërkesës për gjykim të viktimës akuzuese ose përfaqësuesit të saj ligjor dhe pushon me heqjen dorë të tyre.

### **Neni 851**

#### **Vëzhgimi i paautorizuar i pjesëve intime të personit**

1. Vëzhgimi nëpërmjet përdorimit të çdo mjeti për të parë pjesët intime të një personi, i cili nuk u është ekspozuar palëve të treta, kur është kryer pa dijeninë ose pa pëlqimin e personit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

2. Po kjo kundërvajtje penale, kur kryhet në një ose më shumë nga rrethanat e mëposhtme:

- a) kur është kryer nga një person që abuzon me autoritetin që i është dhënë nga funksionet e tij;
- b) kur është kryer ndaj një të mituri;
- c) kur është kryer ndaj një personi me cilësi të veçanta të dukshme ose të njohura nga autori, si: moshë e tij, një sëmundje, një paaftësi fizike ose mendore ose një gjendje e shtatzënisë;
- ç) kur është kryer nga disa persona;
- d) kur është kryer në një automjet të caktuar për transport kolektiv të udhëtarëve ose në një vend të destinuar hyrje në një mjet të transportit kolektiv të udhëtarëve;
- dh) kur imazhet janë fiksuar, regjistruar ose transmetuar nëpërmjet pajisjeve komunikimeve elektronike apo çdo forme tjetër, dënohet nga një deri në dy vjet burgim.

3. Procedimi penal për këtë vepër penale fillon me paraqitjen në gjykatë të kërkesës për gjykim të viktimës akuzuese ose përfaqësuesit të saj ligjor dhe pushohet nëse hiqet dorë prej saj.

### **Neni 852**

#### **Shkelje e lirisë së mendimit dhe shprehjes**

1. Mohimi ose kufizimi padrejtësisht i lirisë së fjalës dhe shprehjes në publik, lirisë së shtypit apo të komunikimit me mënyra të tjera, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose burgim deri në një vit.

2. Dënimi shtohet deri në një të tretën e tij kur kundërvajtja penale sipas paragrafit të parë kryhet nga kushdo që urdhëron, detyron, kufizon apo padrejtësisht i mohon një gazetari të ushtrojë me vërtetësi vullnetin profesional të lirë për të regjistruar ose raportuar ngjarje e fakte reale, apo analiza dhe opinione të bazuara në to.

3. I njëjti dënim sipas paragrafit të dytë të këtij neni zbatohet edhe për këdo që në mënyrë të padrejtë pengon publikimin, shitjen apo shpërndarjen e librave, revistave, gazetave, apo çdo lloj shtypi tjetër, ose prodhimin, shpërndarjen e programeve radio dhe televizive, programeve të lajmeve të agjencive të shtypit, apo lëshimin e përmbajtjeve të tjera mediatike.

### **Neni 853**

#### **Shkelja e së drejtës për t'u organizuar në mënyrë kolektive**

1. Mohimi apo kufizimi i të drejtës për të formuar parti politike, organizata a bashkime tregtare apo formacione a shoqata, të drejtën për t'u bashkuar apo tërhequr nga anëtarësia, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë apo burgim deri në një vit.

2. Pengimi me dhunë i veprimtarisë së ligjshme të partive, organizatave apo shoqatave politike përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

### **Neni 854**

#### **Shkelja e lirisë së Fesë**

1. Mohimi ose kufizimi i lirisë së ndërgjegjes dhe fesë, lirisë së shpalljes publike të fesë ose besimit tjetër, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

2. I njëjti dënim zbatohet edhe për këdo që i mohon një bashkësie fetare, që vepron në pajtim me ligjin, të drejtën e barazisë me bashkësitë e tjera në Republikën e Shqipërisë, apo i mohon ose kufizon asaj bashkësie të drejtën për të kryer shërbimet e saj fetare, të drejtën për të themeluar dhe drejtuar shkolla, institucione arsimore, institucione sociale ose bamirësie.

3. Shkatërrimi ose dëmtimi me dashje i objekteve të kultit, duke shkaktuar humbjen e plotë ose të pjesshme të vlerave të tyre, me qëllim mohimin apo kufizimin e lirisë së besimit, shprehjes dhe praktikimit të tij, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

### **Neni 855**

#### **Kryerja e veprës nga personi juridik**

1. Nëse një person juridik ka kryer veprat penale të parashikuara në nenet 838, 839, 840, 841, 842, 843, 844, 845, 846, 847, 848, 849 dhe 842 të këtij kreu dënimi me gjobë do të ndjekë rregullat e përcaktuara në nenin 121 të këtij Kodi.

2. Nëse ndonjëra prej veprave penale të parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni kryhet me qëllim fitimi, atëherë masa e gjobës do të jetë mbi pesëfishin e përfitimit të paligjshëm.

3. Gjykata cakton edhe dënimet plotësuese të pezullimit të veprimtarisë së personit juridik për një periudhë tërësore jo më shumë se pesë vjet dhe mbylljen e mjediseve të punës së kompanisë.

## **Neni 856**

### **Dënimet plotësuese dhe konkurrimi**

1. Nëse veprat penale të parashikuara në këtë seksion kryhen edhe nga nëpunësi publik i caktuar sipas ligjit, atëherë gjykata, krahas dënimit kryesor cakton edhe dënimin plotësues, heqjen e së drejtës për të punuar në shërbimin publik, ose çdo dënim tjetër plotësues që çmon të arsyeshëm, në përputhje me natyrën e veprës dhe veprimeve të kryera nga i dënuari, gjithmonë nëse dispozita konkrete nuk ka parashikuar ndryshe.

2. Në çdo rast gjykata vendos masën e zëvendësimit të dëmit të shkaktuar dhe, përveç sendeve që kanë shërbyer për kryerjen e veprave penale, kur ajo është kryer nga subjektet me qëllim përfitimi material apo të premtuar, vendoset konfiskimi i të ardhurave nga vepra penale apo të premtuara.

3. Për veprat penale të parashikuara në dispozitat e këtij kreu, gjykata vendos edhe masën penale të regjistrimit dhe shkëmbimit të informacionit që përmbajnë të dhëna rreth subjektit lidhur me rastet kur vepra penale ka rëndësi për njohjen dhe parandalimin e kryerjes së krimeve prej tij në të ardhmen ose/edhe me natyrë edhe ndërkombëtare.

4. Për qëllim të këtij seksioni, nëse mënyrat e kryerjes së veprave penale të parashikuara këtu që kanë bërë të mundur kryerjen e ndonjërës prej tyre, përbëjnë vepra penale më vete, atëherë ato konkurrojnë me veprën penale të cilës i kanë shërbyer për të sjellë apo tentuar pasojën.

5. Për veprat penale të lehta të parashikuara në nenet 837, 838, paragrafi i parë dhe i dytë, 840, paragrafi i parë, 842, 833, 844, 845, paragrafi i parë dhe i dytë, 846, paragrafi i parë dhe i dytë, 847, paragrafi i parë, 848, paragrafi i parë, 849, paragrafi i parë, 850, 851, 852, 853 dhe 854, paragrafi i parë kur çmohet e arsyeshme, gjykata mund të vendosë dhënien e jo më pak sesa dy dënimeve plotësuese në vend të dënimit kryesor.

## **Neni 857**

### **Bashkëpunimi**

Nëse për kryerjen e ndonjërës prej veprave penale të parashikuara në këtë kre, autorit të posaçëm i është dashur të bashkëpunojë me ndonjë person tjetër, pavarësisht cilësive të posaçme të këtij të fundit, ata do të përgjigjen për kryerjen në bashkëpunim të veprës penale të parashikuar në këtë kre, apo çfarëdolloj vepre penale që konkurron me to.

## **KREU V**

### **VEPRAT PENALE KUNDËR MORALIT DHE NDERIT VETJAK**

## **Neni 858**

### **Shfrytëzimi i prostitucionit të personave madhorë**

1. Shtytja, ndërmjetësimi ose realizimi i përfitimeve pasurore për ushtrimin e prostitucionit nga personat madhorë dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

2. Po kjo veprë penale, kur nuk është vlerësuar si trafikim i personit, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet nëse veprimet e parashikuara në të janë kryer:

- a) duke përdorur forcën;
- b) duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore ose çrregullim të rëndë të shëndetit mendor apo fizik viktimës;
- c) duke përdorur armë apo mjete të tjera të rrezikshme;
- ç) duke e dehur me dashje viktimën me anë të alkoolit, lëndëve narkotike, psikotrope apo substancave tjera;
- d) duke shfrytëzuar cilësitë e veçanta të personit, si aftësitë e kufizuara mendore apo fizike, çrregullimet apo paaftësinë fizike apo mendore ose shtatzëninë;
- dh) duke u shoqëruar ose përcjellë nga tortura apo trajtimi çnjerëzor;
- e) nga prindi, birësuesi, njerku apo njerka, të paralindurit, gjini e afërt me viktimën ose kur vepra është kryer nga një person që është në marrëdhënie familjare me viktimën;
- ë) nga mësuesi, udhëheqësi fetar, specialisti i kujdesit shëndetësor, personi të cilit i është besuar kujdesi për viktimën ose që në ndonjë mënyrë tjetër ka autoritet ndaj viktimës:
  - i. duke keqpërdorur kontrollin e tij mbi gjendjen financiare, familjare, shoqërore, shëndetësore, të punësimit, shkollimit, fetare ose rrethanave të tjera të viktimës apo të personit të tretë;
  - ii. kur viktima mbahet në një institucion edukativo-korrektues, është pacient në spital, qëndër të shëndetit mendor apo rehabilitimit, banor i shtëpisë së kujdesit apo strehimores, ose një personi që po i nënshtrohet kufizimeve të lirisë personale me urdhër të gjykatës apo prokurorisë ose sipas ligjit;
  - iii. duke keqpërdorur pozitën ose autoritetin e tij mbi viktimën e cila i është besuar për kujdes;
  - iv. nga një person që është “maskuar” ose që simulon cilësinë e një funksionari publik ose të një personi të ngarkuar me një shërbim publik;
  - v. nëse vepra penale është kryer nga një person që bën pjesë në një organizatë kriminale me qëllimin që të lehtësojë veprimtarinë e saj.

## **Neni 859**

### **Favorizim i prostitucionit**

1. Shprehja “favorizim i prostitucionit” përfshin, por nuk kufizohet në rekrutimin, organizimin, ndihmën, kontrollimin, mbajtjen ose fshehjen e personit tjetër për qëllim të prostitucionit.

2. Kushdo që rekruton, organizon, ndihmon, mban, fsheh ose kontrollon një person me qëllimin për ta përdorur për ushtrimin e prostitucionit, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.

3. Kur vepra penale e parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni kryhet brenda perimetrit prej pesëqind metrash nga shkolla ose mjedisi tjetër i cili përdoret nga fëmijët, dënohet me burgim nga katër deri në tetë vjet.

## **Neni 860**

### **Mbajtja e mjediseve për prostitucion**

1. Mbajtja, shfrytëzimi, financimi, ofrimi me dijeni i lokaleve për ushtrimin e prostitucionit, pavarësisht nga qëllimi fillestar i tyre, qoftë nga personi si pronar i lokalit, qiradhënësi, qiramarrësi, nëndorësi ose personi përgjegjës aktiv i përfshirë në ofrimin apo krijimin e kushteve për ushtrimin e prostitucionit, dënohet me gjobë ose burgim nga një deri në pesë vjet.

2. Kur vepra penale e parashikuar nga paragrafi i parë i këtij neni kryhet brenda perimetrit prej pesëqind metrash nga shkolla ose mjedisi tjetër i cili përdoret nga fëmijët, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.

### **Neni 861**

#### **Prostitucioni**

1. Ushtrimi i prostitucionit, kur nuk janë rastet e parashikuara në paragrafin e tretë të nenit 144, paragrafi 3 të këtij Kodi, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë.

2. Dhënia e shpërblimit për përfitim personal të prostitucionit, dënohet me gjobë ose me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

3. Gjykata, kur gjendet përpara veprës penale të parashikuar nga paragrafi i parë i këtij neni dhe, kur ekzistojnë më shumë se dy rrethana lehtësuese dhe asnjë rrethanë rënduese, mund të mjaftohet me caktimin ndaj personit që ushtron prostitucion vetëm të dënimit plotësues të parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal, duke e urdhëruar atë të marrë pjesë në seanca psikologjike, terapeutike dhe edukimi.

4. Kjo dispozitë zbatohet deri në kohën e dekriminalizimit me ligj të kësaj vepre penale dhe rregullimit të ushtrimit të kësaj veprimtarie në elemente të tilla, si: subjektet që lejohen ta ushtrojnë atë, vendet e ushtrimit, regjistrimit të tyre, masave të karakterit parandalues dhe mjekësor të detyruara për t'u zbatuar, elemente të tjera të karakterit ekonomik, kufizimet e përgjithshme rreth elementeve të veçanta etj., kushte që bëjnë të mundur kontrollin dhe administrimin e plotë të fenomenit.

### **Neni 862**

#### **Kryerja e akteve seksuale në vende publike**

Kryerja e akteve seksuale në vende publike ose në mjedise të ekspozuara nga vështrimi i njerëzve, dënohet me gjobë ose me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

### **Neni 863**

#### **Fyerja**

1. Për qëllim të ligjit penal, përbën fyerje çdo veprim, fjalë ose shprehje që cenon dinjitetin e një personi tjetër, ose dëmton vetëvlerësimin e viktimës. Fyerje e rëndë do të vlerësohet të jetë veprimi, fjala apo shprehja që për shkak të natyrës, pasojave, rrethanave në të cilat është bërë apo zakoneve të mira që prek, përbëjnë shqetësim për opinionin publik.

2. Fyerja përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë.

3. Kur kundërvajtja penale është bërë në mënyrë publike, nëpërmjet çdolloj mjeti të përhapjes së informacionit, dënimi shtohet me një të tretën e tij.

4. Procedimi penal fillon me kërkesë të viktimës dhe pushon kur ajo ose përfaqësuesi i saj ligjor, heq dorë nga kërkesa.

5. Fyerja e rëndë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy muaj.

6. Fyerja e rëndë, e kryer në mënyrë publike kur është përhapur me anë të shtypit, transmetimeve radiofonike ose me çdo mjet tjetër të ngjashëm, përbën kundërvajtje penale dhe e shton dënimin deri në një të tretën e tij.

7. Personi i akuzuar për fyerje përjashtohet nga përgjegjësia në rastin kur provon të vërtetën mbi veprimet ose shprehjet e drejtuara kundër zyrtarëve publikë për fakte që kanë të bëjnë me ushtrimin e detyrës ose kryerjen e kundërvajtjeve administrative.

#### **Neni 864**

#### **Përhapja e materialeve raciste ose ksenofobike**

1. Përhapja në publik me çdo formë e trakteve, thirrjeve, fotografive, pamjeve ose çdo materiali tjetër me përmbajtje fyese, raciste ose ksenofobike, për shkak të përkatësisë etnike, kombësisë, racës apo fesë me synimin e fyerjes së viktimës, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

2. Ofrimi ose përhapja e qëllimshme në publik, nëpërmjet sistemeve kompjuterike, e materialeve me përmbajtje raciste ose ksenofobike, për shkak të përkatësisë etnike, kombësisë, racës apo fesë me synimin e fyerjes së viktimës, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

#### **Neni 865**

#### **Shpifja**

1. Përhapja e qëllimshme e deklaratave rreth një fakti specifik të rremë dhe ofendues, si dhe/apo çdo informacioni tjetër të rremë, që cenon nderin, vetëvlerësimin apo degradojnë reputacionin e personit apo institucionit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë deri në një milion e pesëqind mijë lekë dhe dënimin plotësues të përgënjeshtimit dhe faljen publike ndaj viktimës.

2. Nëse vepra penale është kryer nëpërmjet shtypit ose ndonjë mjeti tjetër komunikimi mediatik, elektronik, nëpërmjet rrjeteve sociale në internet, ose nëpërmjet një akti publik, dënimi shtohet deri në dyfishin e parashikuar në paragrafin e parë.

3. Nëse vepra penale i drejtohet një përfaqësuesi të një organi politik, administrativ ose gjyqësor, ose një anëtarit të tyre që funksionon në mënyrë kolegjiale, dënimet e parashikuara në paragrafin e parë apo të dytë shtohen deri me një të dytën.

4. Cilido që ka kryer ndonjë prej veprimeve të parashikuara në këtë nen në gjendje zemërimi nuk ka përgjegjësi penale, nëse kjo gjendje dhe këto veprime janë kryer menjëherë si pasojë e një fakti të padrejtë të tjerëve ndaj tij.

5. Procedimi penal fillon me kërkesën e viktimës apo të përfaqësuesit të saj ligjor dhe çështja pushohet kur ajo heq dorë nga ankimi.

6. Kur vepra penale e shpifjes është kryer apo përhapur nga personi juridik i tij, gjykata vendos edhe detyrimin e publikimit të vendimit gjyqësor penal nëpërmjet medias apo në komunitet dhe, përgënjeshttrimin bashkë me faljen publike të tij.

7. Procedimi penal nuk e pengon viktimën t'i drejtohet edhe gjykatës civile.

#### **Neni 866**

#### **Përdhosja e kujtimit të të vdekurit**

Përdhosja ose ndotja e kujtimit të një personi të vdekur, kur kryhet në kufijtë e pranuar në nenet 863 dhe 865, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë.

#### **Neni 867**

##### **Dhunimi i varreve**

1. Sulmi i kryer ndaj kufomës, me çfarëdo mjeti apo mënyre, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

2. Shkelja, përdhosja, dhunimi me çfarëdo mjeti apo mënyre, i varreve, varrezave ose monumenteve të ndërtuara në kujtim të të vdekurve, dënohet me gjobë ose me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

3. Kur veprimet e kryera në paragrafin e dytë të këtij neni shoqërohen me sulme mbi kufomën, me nxjerrjen e kufomës nga varri, me vjedhjen e sendeve që mund të gjenden në të apo me çdo veprim tjetër që cenon respektin ndaj të vdekurve, dënohet me gjobë ose me burgim nga një deri në pesë vjet.

4. Ndjekja penale fillon me paraqitjen e ankimit të viktimës ose përfaqësuesit të saj ligjor dhe pushon me heqjen dorë prej tij, ose kur prokurori çmon se ka interes publik.

#### **Neni 868**

##### **Përdorimi i paligjshëm i kufomës**

1. Prishja, gjymtimi ose përdorimi i një kufome njerëzore, ose i një pjese të saj, për qëllime shkencore ose didaktike, në rastet kur nuk është autorizuar apo lejuar me ligj, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj.

2. Dënimi rritet me një të dytën nëse kundërvajtja penale e parashikuar nga paragrafi i parë është kryer në kufomë, ose në një pjesë të saj, për të cilën autori ka qenë në dijeni se ishte gjymtuar, fshehur ose vjedhur nga të tjerët.

3. Ndjekja penale fillon me paraqitjen e ankimit të viktimës ose përfaqësuesit të saj ligjor dhe pushon me heqjen dorë prej tij.

#### **Neni 869**

##### **Fshehja e kufomës**

1. Për qëllime të këtij neni, me “kufomë” do të kuptojmë trupin e njeriut, pa funksione jetësore, përfshirë foshnjat me peshë deri në pesëqind gram të lindura pa jetë.

2. Fshehja e kufomës, apo pjesëve të saj, duke mos respektuar detyrimet e parashikuara në ligjin përkatës lidhur me trajtimin e tyre, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

#### **Neni 870**

##### **Kryerja e veprës nga personi juridik**

1. Nëse një person juridik ka kryer veprat penale të parashikuara në nenet 861, 862, 863 dhe 864 të këtij kreu dënimi me gjobë do të jetë deri në pesëfishin e përfitimit të paligjshëm nga kryerja e veprës penale.

2. Nëse ndonjëra prej veprave penale të parashikuara në këtë kre të Kodit Penal do të kryhet me qëllim fitimi, atëherë masa e gjobës do të jetë mbi pesëfishin e përfitimit të paligjshëm.

3. Gjykata cakton edhe dënimet plotësuese të pezullimit të veprimtarisë së personit juridik për një periudhë tërësore jo më shumë se pesë vjet dhe mbylljen e mjediseve të punës së kompanisë.

### **Neni 871**

#### **Dënimet plotësuese dhe konkurrimi**

1. Nëse veprat penale të parashikuara në këtë kre kryhen edhe nga nëpunësi publik i caktuar sipas ligjit, atëherë gjykata, krahas dënit kryesor cakton edhe dënimin plotësues, heqjen e së drejtës për të punuar në shërbimin publik, ose çdo dënim tjetër plotësues që çmon të arsyeshëm, në përputhje me natyrën e veprës dhe veprimeve të kryera nga i dënuari, gjithmonë nëse dispozita konkrete nuk ka parashikuar ndryshe.

2. Në çdo rast gjykata vendos masën e zëvendësimit të dëmit të shkaktuar dhe, përveç sendeve që kanë shërbyer për kryerjen e veprave penale, kur ajo është kryer nga subjektet me qëllim përfitimi material apo të premtuar, vendoset konfiskimi i të ardhurave nga vepra penale apo të premtuara.

3. Gjykata vendos konfiskimin e mjediseve që kanë shërbyer për kryerjen e krimeve shumë të rënda të parashikuara në dispozitat e këtij kreu.

4. Për qëllim të këtij kreu, nëse mënyrat e kryerjes së veprave penale të parashikuara këtu që kanë bërë të mundur kryerjen e ndonjërës prej tyre, përbëjnë vepra penale më vete, atëherë ato konkurrojnë me veprën penale të cilës i kanë shërbyer për të sjellë apo tentuar pasojën.

5. Për veprat penale të parashikuara në dispozitat e këtij kreu, gjykata vendos edhe masën penale të regjistrimit dhe shkëmbimit të informacionit që përmbajnë të dhëna rreth subjektit lidhur me rastet kur vepra penale ka rëndësi për njohjen dhe parandalimin e kryerjes së krimeve prej tij në të ardhmen ose/edhe me natyrë edhe ndërkombëtare.

6. Për veprat penale të lehta të parashikuara në nenet e këtij kreu, kur çmohet e arsyeshme, gjykata mund të vendosë dhënien e jo më pak sesa dy dënimeve plotësuese në vend të dënit kryesor.

### **Neni 872**

#### **Bashkëpunimi**

Nëse për kryerjen e ndonjërës prej veprave penale të parashikuara në këtë kre, autorit të posaçëm i është dashur të bashkëpunojë me ndonjë person tjetër, pavarësisht cilësive të posaçme të këtij të fundit, ata do të përgjigjen për kryerjen në bashkëpunim të veprës penale të parashikuar në këtë kre, apo çfarëdolloj veprave penale që konkurron me to.

### **Neni 873**

#### **Zbatimi i dispozitave në varësi të numrit të viktimave**

Për efekt të numrit të viktimave, çdo dispozitë e këtij kreu do të zbatohet aq herë sa është numri i tyre, pavarësisht nga lloji apo shkalla e pasojave që rezultojnë nga kryerja e veprave penale.

## TITULLI IX VEPRAT PENALE KUNDËR PASURISË

### KREU I VJEDHJA E PASURISË

#### **Neni 874 Vjedhja**

1. Përvetësimi i një sendi në pronësi apo posedim të viktimës, me qëllim për të mos e kthyer me, i kryer për përfitim material, për vete apo të tjerë, dënohet me burgim deri në tetë vjet.

2. Kur vlera e sendit është më e vogël se sa dyqind mijë leke, nëse autori i veprës zëvendëson dëmin e shkaktuar dhe viktimë kërkon të pushohet çështja dhe, palët kanë normalizuar marrëdhënien e tyre, vendoset pushimi i çështjes nëse organi procedues krijon bindjen që autori nuk do ta përsërisë më kryerjen e kësaj vepre në të ardhmen me kushtin që sendi të mos jetë pronë publike.

3. Nëse kjo vepër është kryer ndërmjet familjarëve apo të afërmeve deri në shkallë të dytë, ajo ndiqet me ankimin e tyre dhe pushohet kur kërkohet të hiqet dorë nga ankimi.

Me termin “send” do të kuptohet çdo send material i luajtshëm në përdorim të dobishëm, çdo lloj energjie, impulsi, vale, rrjeti elektronik me vlerë të konvertueshme apo çdo lëndë tjetër që përmban vlerë tregu të konvertueshme në para.

5. Nëse vjedhja e sendeve, përfshirë edhe ato të shënuara në paragrafin e katërt të këtij neni, kryhet nëpërmjet dëmtimeve të matësve të nevojshëm për regjistrimin e vlerës së sendit të përdorur, apo ndërhyrjeve fizike që kryen në matës për të manipuluar vlerën e sendit të përfituar, atëherë kjo dispozitë konkurren me veprën penale të dëmtimit të pasurisë.

6. Nuk vlerësohet si vjedhje fakti kur personi beson se ka të drejtë ligjore të marrë sendin, për vete a për një tjetër, ose kur beson se ka marrë ose do e marrë pëlqimin e viktimës për përvetësimin e sendit.

#### **Neni 875 Vjedhja e bankave dhe institucioneve financiare**

1. Vjedhja e bankave apo çdo institucioni financiar të njohur ligjërisht e që ruan vlera monetare apo sende me vlerë, e kryer në çfarëdolloj mënyre, përveçse asaj të parashikuar në nenet 261 e 262 dënohet me burgim nga tetë deri në shtatëmbëdhjetë vjet.

2. Nëse krimi sipas paragrafit të parë të këtij neni, kryhet nga punonjës të brendshëm të saj, pavarësisht detyrave apo kompetencave që kanë, dënimi shtohet me një të tretën.

3. Kjo dispozitë nuk zëvendëson ndonjë dispozitë tjetër të posaçme, nëse vjedhja e bankave apo çdo institucioni financiar të njohur ligjërisht e që ruan vlera monetare apo sende me vlerë, kryhet nëpërmjet dhunës apo përdorimit të armëve.

4. Nëse, sipas paragrafit të parë të këtij neni, vjen si pasojë vdekja e ndonjë personi, atëherë kjo dispozitë konkurren me dispozitën e posaçme të këtij Kodi për vjedhjen me pasojë vdekjen.

#### **Neni 876**

#### **Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën**

1. Vjedhja nga personi e pasurisë së luajtshme të personit juridik privat lidhur në marrëdhënie pune, apo të një personi fizik me të cilin punon, për shkak të besimit të dhënë për ta administruar pasurinë e tyre, apo duke përfituar nga natyra e detyrës që kryen, kur vlera e sendit të përvetësuar është edhe më e vogël se një milion lekë, dënohet me burgim nga një deri në katër vjet.

2. Nëse vlera e pasurisë së përvetësuar ose e drejta e pronës është më e lartë se një milion e një lekë, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.

#### **Neni 877**

#### **Vjedhja duke shmangur pagesën**

1. Shmangia e qëllimtë dhe në mënyrë të pandershme e kryerjes së pagesës nga personi prej të cilit pritet apo kërkohet të kryhet ajo për mallrat e apo shërbimet e furnizuara në favor të tij, dënohet me burgim nga një deri në katër vjet.

2. Të gjitha elementet që përmban neni 874 janë të zbatueshme edhe në këtë dispozitë.

#### **Neni 878**

#### **Grabitja**

1. Vjedhja e pasurisë e shoqëruar me përdorim dhune aty për aty, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

2. Nëse nëpërmjet dhunës personi vjedh banka apo çdo institucion financiar që ruan mjete monetare apo sende me vlerë, dënohet me burgim nga dymbëdhjetë deri në njëzet vjet.

3. Për qëllim të kësaj dispozite me fjalën “dhunë” do të kuptohet çdo përdorim force përkundrejt viktimës që, sipas dispozitave të posaçme të këtij Kodi është e dënueshme penalisht, përveç asaj që ka sjellë vdekjen e viktimës. Në kategorinë e dhunës aty për aty, do të përfshihet edhe dhuna psikike që ushtrohet përkundrejt viktimës dhe, që mund të vijë nga çfarëdolloj burimi, mjafton që të shfrytëzohet nga autori kundër viktimës.

4. Nëse ushtrimi i dhunës aty për aty, do të realizohet përmbi sendet që shërbejnë për ruajtjen e objekteve të veprës penale, atëherë kualifikimi i veprës penale do të bëhet në varësi të vlerës së sendit sipas kualifikimeve të bëra në nenin 874 të këtij Kodi, në konkurrim me dëmtimin apo, sipas rastit, shkatërrimin e pasurisë.

#### **Neni 879**

#### **Grabitja me armë**

1. Vjedhja e pasurisë, e shoqëruar me ekspozimin e armëve dhe municioneve luftarake ose me përdorimin e tyre, dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë deri në njëzet vjet.

2. Nëse nëpërmjet përdorimit apo ekspozimit të armëve, personi vjedh banka apo çdo institucion financiar që ruan mjete monetare apo sende me vlerë, dënohet me burgim nga tetëmbëdhjetë deri në njëzet e pesë vjet.

3. Për qëllim të kësaj dispozite me “ekspozim të armës luftarake” do të kuptohet çdo shfaqje e armës që personi përdor përgjatë vjedhjes, nëpërmjet të cilës kërkon të frikësojë dhe neutralizojë kundërshtimet ndaj tij dhe, lehtësimin e arritjes së qëllimit të vjedhjes. Për qëllim të kësaj dispozite, arma imituese e përdorur në kryerjen e grabitjes, që nuk ka lënë asnjë shteg a mundësi objektive për t’u perceptuar si e tillë nga viktimja, nuk do të ndryshojë kualifikimin e veprës penale të ndryshme nga grabitja me armë.

3. Me “përdorim të armës” do të kuptohet e shtëna e realizuar prej saj pa sjellë ndonjë pasojë prej atyre që dispozitat e këtij seksioni e parashikojnë si rrethanë të domosdoshme të cilësuar të ndonjë veprë penale.

4. Nëse nga shkrehja e armës do të vijë pasoja në shëndetin e viktimës, por jo vdekja e saj apo tentativa për ta vrrarë atë, atëherë personi do të përgjigjet edhe për pasojën sipas kualifikimit ligjor të varur nga lloji i fajit që shoqëron veprën e kryer.

### **Neni 880**

#### **Vjedhja me pasojë vdekjen**

1. Vjedhja e pasurisë, kur është shoqëruar me dhunime që kanë sjellë vdekjen e personit, dënohet me burgim nga njëzet deri në tridhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.

2. Vepra e parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni konkurren me vjedhjen që kryhet në banka, arka kursimi apo çdo institucion financiar që ruan mjete monetare apo sende me vlerë, të parashikuar në këtë kre të Kodit kur ka sjellë pasojë vdekjen e viktimës.

### **Neni 881**

#### **Zhvatja e pasurisë**

Zhvatja e pasurisë së personave fizikë apo juridikë, nëpërmjet frikësimit të tyre, manipulimit të nevojës së tyre për mbrojtje duke përcaktuar tarifa pagesash periodike, krijimi artificialisht i rrethanave negativë në dem të viktimës me qëllim që të detyroje atë të paguaje, dënohet me burgim nga gjashtë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

### **Neni 882**

#### **Zhvatja e pasurisë me shantazh**

1. Zhvatja e pasurisë së një personi tjetër, nëpërmjet shantazhit, frikësimit, shtrëngimit apo detyrimit të tij për t’u pajtuar kundër vullnetit të lirë me kërkesat e autorit për pasuri, që shoqërohen me materiale të çfarëdoshme që tregojnë cenueshmërinë e viktimës, krijojnë rrethana frikësuese për të, shfrytëzojnë dobësinë e saj për shkak të materialit të përdorur prej autorit, nën kërcënimin se ato do të bëhen publike dhe dëmtojnë rëndë interesat thelbësore të viktimës, nderin dhe reputacionin e saj apo të një të afërmi të saj, dënohet me burgim nga katër deri në dhjetë vjet.

2. Vepra penale e parashikuar nga paragrafi i parë i këtij neni, do të vlerësohet si grabitje, përkatësisht nenet 878 dhe 879 nëse në çastin e marrjes së pasurisë, autori do të ushtrojë dhunë.

3. Kur situata frikësuese që shkakton pajtimin e vullnetit të cenuar të viktimës me kërkesat e paligjshme për pasuri të bëra nga autori i krimit, është krijuar për shkak të kanosjes për të dëmtuar fizikisht të afërmit e viktimës, dënimi i parashikuar në paragrafin e parë shtohet deri në një të tretën e tij.

### **Neni 883**

#### **Përdorimi i paautorizuar i pasurisë së luajtshme të tjetrit**

1. Marrja dhe përdorimi në mënyrë të paligjshme dhe të përkohshme i pasurisë së luajtshme të një personi, apo sipas rastit, pa autorizimin e pronarit të sendit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim nga tre muaj deri në një vit.

2. Kur vlerësohet e arsyeshme, gjykata mund të vendosë dhënien e jo më pak se sa dy dënimeve plotësuese në vend të dënimit kryesor.

3. Procedimi fillon me paraqitjen e ankimit të viktimës dhe pushon kur ajo heq dorë prej tij.

### **Neni 884**

#### **Trafikimi i mjeteve motorike**

Importimi, eksportimi, tranzitimi dhe tregtimi në kundërshtim me ligjin, i mjeteve motorike të vjedhura, me qëllim fitimi material ose çdo përfitim tjetër, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.

### **Neni 885**

#### **Rrethana të cilësuar të kryerjes së vjedhjes**

1. Nëse ndonjëra prej veprave penale të këtij seksioni do të kryhet:

a) në banesën e viktimës, dënimi i parashikuar nga dispozitat përkatëse, do të shtohet deri në një të tretën;

b) natën në banesën e viktimës, dënimi do të shtohet deri në një të dytën e tij;

c) me anë të thyerjes, hyrjes me forcë ose duke kapërcyer pengesa të mëdha për të hyrë brenda ndërtesave, dhomave, kasafortave, gardërobave ose dhomave ose zonave të tjera të mbyllura, dënimi shtohet deri në një të tretën e tij;

ç) në një mënyrë veçanërisht të rrezikshme ose veçanërisht këmbëngulëse, dënimi shtohet deri në një të dytën e tij;

d) duke përfituar nga kushtet e shkaktuara nga zjarri, përmytja, tërmeti ose çdo fatkeqësi tjetër që ka dobësuar aftësinë mbrojtëse të viktimës ose ka lehtësuar kryerjen e krimit, dënimi shtohet deri në një të dytën e tij;

dh) duke përfituar nga pafuqia ose nga çdo situatë tjetër veçanërisht e vështirë e viktimës ose kur e vendos viktimën ose familjen e saj në një situatë të rëndë ekonomike për shkak të vlerës së sendeve të vjedhura ose sepse ato mbulojnë nevojat elementare të saj, dënimi shtohet deri në një të dytën e tij;

e) kur sendi lidhet me tubacionet, instalimet elektrike, pajisjet ose përbërës të infrastrukturës për furnizimin me energji elektrike, hidrokarbure ose shërbime transporti ose telekomunikacioni, ose sende të tjera të destinuar për ofrimin e shërbimeve të interesit të përgjithshëm, dënimi shtohet deri në një të dytën e tij;

2. Do të vlerësohet si banesë e viktimës edhe territori i oborrit të saj, nëse banesa është e rrethuar me portë të jashtme ose kur oborri qartazi shfaqet si pjesë që i shërben banesës.

#### **Neni 886**

#### **Sigurimi i mjeteve për të kryer vjedhje**

Sigurimi i kushteve materiale, sendeve të përshtatshme apo, bërja e planeve apo gjetja bashkëpunëtorëve të tjerë për të kryer vjedhjet e parashikuara nga nenet 874, 875, 876, 877, 878, 879 dhe 880 të këtij Kodi, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet.

#### **Neni 887**

#### **Kryerja e veprës nga personi juridik**

1. Nëse një person juridik ka kryer veprat penale të parashikuara në nenet 875, 878, 879, 880, 881, 882 dhe 884 të këtij kreu, dënimi me gjobë do të jetë deri në trefishin e përfitimit të paligjshëm nga kryerja e veprës penale.

2. Gjykata cakton edhe dënimet plotësuese të pezullimit të veprimtarisë së personit juridik për një periudhë tërësore jo më shumë se pesë vjet dhe mbylljen e mjediseve të punës së kompanisë.

#### **Neni 888**

#### **Dënimet plotësuese**

1. Çdo lloj pasurie që rrjedh ose fitohet drejtpërdrejtë ose tërthorazi nga kryerja e veprës penale, apo dhe i shpërblimeve, të dhëna ose të premtuara, për kryerjen e veprës penale, si dhe, sendet që kanë shërbyer për kryerjen e veprave penale, konfiskohen. Në çdo rast gjykata vendos edhe masën e zëvendësimit të dëmit të shkaktuar.

2. Nëse veprat penale të parashikuara në këtë seksion kryhen edhe nga nëpunësi publik i caktuar sipas ligjit, atëherë gjykata, krahas dënimit kryesor cakton edhe dënimin plotësues, heqjen e së drejtës për të punuar në shërbimin publik, ose çdo dënim tjetër plotësues që çmon të arsyeshëm, në përputhje me natyrën e veprës dhe veprimeve të kryera nga i dënuari, gjithmonë nëse dispozita konkrete nuk ka parashikuar ndryshe.

3. Gjykata vendos konfiskimin e mjediseve që kanë shërbyer për kryerjen e krimeve shumë të renda të parashikuara në dispozitat e këtij kreu kur ato, për nga natyra e tyre dhe e mekanizmit të kryerjes së krimeve, janë lidhur drejtpërsëdrejti me suksesin e kryerjes së tyre.

4. Për krimet e parashikuara në nenet 874, 878, 880, 881 dhe 883 të këtij kreu, gjykata vendos edhe masën penale të regjistrimit dhe shkëmbimit të informacionit që përmbajnë të dhëna rreth subjektit lidhur me rastet kur vepra penale ka rëndësi për njohjen dhe parandalimin e kryerjes së krimeve prej tij në të ardhmen ose/edhe me natyrë edhe ndërkombëtare.

#### **Neni 889**

#### **Konkurrimi i veprave dhe bashkëpunimi**

1. Në të gjitha rastet kur, për të kryer një prej veprave penale të parashikuara në këtë kre, autorit i është dashur të kryejë veprime që përbëjnë vepër penale më vete, atëherë kjo e fundit konkurren me veprën që ai ka dashur të kryejë.

2. Nëse për kryerjen e ndonjërisë prej veprave penale të parashikuara në këtë kre, autorit të posaçëm i është dashur të bashkëpunojë me ndonjë person tjetër, pavarësisht cilësive të posaçme të këtij të fundit, ata do të përgjigjen për kryerjen në bashkëpunim të veprës penale të parashikuar në këtë kre, apo çfarëdolloj veprave penale që konkurron me to.

### **Neni 890**

#### **Zbatimi i dispozitave në varësi të numrit të viktimave**

Në varësi të numrit të viktimave, çdo dispozitë e këtij kreu do të zbatohet aq herë sa është numri i tyre, pavarësisht nga lloji apo shkalla e pasojave që rezultojnë nga kryerja e veprave penale.

## **KREU II MASHTRIMET**

### **Neni 891**

#### **Mashtrimi**

1. Përvetësimi i pasurisë publike ose private të një tjetri, për vete ose në favor të personave të tjerë, nëpërmjet paraqitjes së fakteve ose ligjit në të rreme ose, duke fshehur fakte apo ligje të vërteta apo, gënjeshtërisë ose shpërdorimit të besimit, që kanë shtyrë viktimën të bindet rreth vërtetësisë së faktit dhe, drejtësisë së veprimit të saj për të dorëzuar pasurisë, vlerësohet mashtrim dhe, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet.

2. Në kuptim të kësaj dispozite me pasuri do të kuptohet edhe pasuria e paluajtshme apo sendet e lidhura me të që, nëpërmjet veprimeve të parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni, ndryshojnë gjendjen e pronësisë në favor të personit apo të të tretëve, qoftë edhe pjesërisht, nga cilido person që në mënyrën e parashikuar nga paragrafi i parë i këtij neni realizon tjetërsimin e pasurisë.

3. Gjithashtu, do të vlerësohen objekt i kësaj dispozite edhe kuotat, aksionet, interesat reale të depozituara në shoqëri tregtare, shërbimet që duhen paguar, çdolloj përfitimi të pandershëm monetar apo, letrat me vlerë që shërbejnë si dokument për të krijuar, transferuar, lëshuar çdo të drejtë për ndonjë pasuri, ose autorizim për pagesa në para për pasuri, ose që vërtetojnë krijimin, transferimin apo lëshimin e çdo të drejte mbi paratë, pasurisë apo çdo interesi real, kur realizohet me mënyrat e përcaktuara në paragrafin e parë të këtij neni.

4. Për qëllim të kësaj dispozite, paraqitja e fakteve apo ligjit në të rremë apo gënjeshtrove, nëse përmbajnë elemente të ndonjë veprave tjetër penale, mashtrimi konkurron edhe me to.

### **Neni 892**

#### **Shmangia e detyrimeve për të paguar**

Shmangia, pjesërisht apo tërësisht, e detyrimeve për të paguar të krijuara sipas ligjit, kontratës apo marrëdhënieve që lidhen me shërbime të ndryshme, që janë të ekzekutueshme dhe të pranuar për t'u paguar, kryer me çdonjërisë nga mënyrat e shënuara në paragrafin e parë të nenit 891, me qëllim për të shmangur përgjithmonë edhe pjesërisht pagimin e tyre, ose krijimi i rrethanave të gënjeshtërtë që dikush tjetër të paguajë apo shmangë detyrimet e personit, apo siguron nëpërmjet

mashtrimit përjashtime apo ulje të detyrimeve që duhen paguar, dënohet me burgim nga katër deri në tetë vjet.

### **Neni 893**

#### **Skemat mashtruese dhe piramidale**

1. Organizimi dhe vënia në funksionim e skemave mashtruese dhe piramidale të huamarrjes, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet.

2. Organizimi ose nxitja e veprimtarive mashtruese nëpërmjet dërgimit të letrave zinxhir, në të cilat një pjesëmarrës, pasi ka investuar të holla, krijon pritshmëri për të fituar vetëm nëse tërheq pjesëmarrës të tjerë në këtë veprimtari, dënohet me gjobe ose me burgim deri në tre vjet.

### **Neni 894**

#### **Manipulimi i tregut**

1. Paraqitja jo e saktë me dashje, e vlerës së një malli, shërbimi apo paraje, me qëllim çrregullimin e funksionimit të lirë dhe të drejtë të tregut, dënohet me gjobe ose me burgim nga një vit deri në pesë vjet.

2. Për qëllime të këtij ligji, manipulimi i tregut përfshin:

a) hyrjen në një transaksion, vendosjen e një urdhri për tregtim ose ndonjë sjellje tjetër që:

i. jep ose ka gjasa të japë sinjale të rreme ose mashtruese në lidhje me ofertën, kërkesën ose çmimin e një instrumenti financiar, një kontrate të lidhur për çmimin e mallit në një çast të dhënë, ose një produkti të ankanduar bazuar në lejimet e emetimeve; ose

ii. siguron, ose ka të ngjarë të sigurojë, çmimin e një ose disa instrumenteve financiare, një kontratë të lidhur për çmimin e mallit në një çast të dhënë, ose një produkti të ankanduar bazuar në lejimet e emetimeve në një nivel jonormal ose artificial;

me përjashtim të rastit kur personi që hyn në një transaksion, vendos një urdhër për të tregtuar ose përfshihet në ndonjë sjellje tjetër, vërteton se një transaksion, urdhër ose sjellje e tillë është kryer për arsye legjitime dhe është në përputhje me një praktikë të pranuar të tregut.

b) hyrja në një transaksion, dhënia e një urdhri për tregtim ose ndonjë veprimtari ose sjellje tjetër që ndikon ose ka të ngjarë të ndikojë në çmimin e një ose disa instrumenteve financiare, një kontrate të lidhur për çmimin e mallit në një çast të dhënë, ose një produkti të ankanduar bazuar në lejimet e emetimeve, të cilat përdor një mjet fiktive ose çdo formë tjetër mashtrimi ose mashtrimi;

c) shpërndarjen e informacionit nëpërmjet medias, duke përfshirë internetin, ose me çdo mjet tjetër, i cili jep, ose ka të ngjarë të japë sinjale të rreme ose mashtruese në lidhje me ofertën, kërkesën ose çmimin e një instrumenti financiar, kontrata e lidhur për çmimin e mallit në një çast të dhënë, ose një produkti të ankanduar i bazuar në lejimet e emetimeve ose siguron, ose ka të ngjarë të sigurojë, çmimin e një ose disa instrumenteve financiare, një kontrate të lidhur për çmimin e mallit në një çast të dhënë, ose një produkti të ankanduar bazuar në lejimet e emetimeve në një nivel jonormal ose artificial; duke përfshirë shpërndarjen e thashethemeve, ku personi që bëri shpërndarjen e dinte, ose duhej ta dinte, se informacioni ishte i rremë ose mashtrues;

ç) transmetimi i informacionit të rremë ose mashtrues ose ofrimi i të dhënave të rreme ose mashtruese në lidhje me një pikë referimi ku personi që bëri transmetimin ose dha informacionin

e dinte ose duhej ta dinte së ishte i rremë ose mashtrues, ose ndonjë sjellje tjetër që manipulon llogaritja e një standardi.

### **Neni 895**

#### **Ndalimi i marrëveshjeve të brendshme**

1. Përfshirja në marrëveshje të brendshme, rekomandimi apo nxitja e një personi tjetër të përfshihet në transaksione të brendshme, ose zbulimi i paligjshëm i informacionit të brendshëm, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

2. Për qëllimet e këtij ligji, do të kemi transaksionet e brendshme kur:

a) një person zotëron informacion të brendshëm dhe e përdor atë informacion duke blerë ose asgjësuar, për llogari të tij ose për llogari të një pale të tretë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, instrumente financiare me të cilat lidhet informacioni ;

b) duke anuluar ose ndryshuar një urdhër në lidhje me një instrument financiar me të cilin ka të bëjë informacioni kur porosia është vendosur përpara se personi në fjalë të zotëronte informacionin e brendshëm, gjithashtu konsiderohet si marrëveshje e brendshme;

c) gjithashtu paraqitjen, modifikimin ose tërheqjen e një oferte nga një person për llogari të tij ose për llogari të një pale të tretë në lidhje me ankandet e lejimeve të emetimeve ose produkteve të tjera të ankandeve të bazuara në to.

3. Rekomandimi që një person tjetër të angazhohet në transaksione të brendshme, ose nxitja e një personi tjetër të përfshihet në transaksione të brendshme, lind kur autori posedon informacion të brendshëm dhe:

a) rekomandon, në bazë të atij informacioni, që një person tjetër të blejë ose disponojë instrumente financiare me të cilat lidhet ai informacion, ose e shtyn atë person të bëjë një blerje ose asgjësim të tillë, ose :

b) rekomandon, në bazë të atij informacioni, që një person tjetër të anulojë ose të ndryshojë një urdhër në lidhje me një instrument financiar me të cilin lidhet ai informacion, ose ta shtyjë atë person të bëjë një anulim ose ndryshim të tillë.

4. Përdorimi i rekomandimeve ose nxitjeve të përmendura në paragrafin e tretë përbën një marrëdhënie të brendshme sipas kuptimit të këtij neni, kur personi që përdor rekomandimin ose nxitjen e di ose duhet të dijë se ai bazohet në informacione të brendshme.

5. Kjo dispozite zbatohet për çdo person që zotëron informacion të brendshëm si rezultat i:

a) të qenit anëtar i organeve administrative, drejtuese ose mbikëqyrëse të emetuesit ose pjesëmarrësit në treg të lejitimit të emetimeve;

b) zotërimit në kapitalin e emetuesit ose pjesëmarrësit të tregut të lejitimit të emetimeve;

c) aksesit në informacion nëpërmjet ushtrimit të detyrës apo profesionit; ose

ç) i veprimtarisë kriminale.

6. Ky nen zbatohet gjithashtu për çdo person që zotëron informacion të brendshëm në rrethana të ndryshme nga ato të përmendura në nënparagrafin e parë, kur ai person e di ose duhet të dijë se ai është informacion i brendshëm.

### **Neni 896**

#### **Zbulimi i paligjshëm i informacionit të brendshëm**

1. Zbulimi i paligjshëm i informacionit të brendshëm, me efekt të rëndësishëm në çmimet e instrumenteve financiare ose në çmimin e instrumenteve financiare derivative të lidhura, i kryer me dashje nga personi që e zotëron atë në favor të një personi tjetër, dënohet me gjobë ose me burgim nga dy deri në pesë vjet.

2. Për qëllimet e këtij ligji, zbulimi i paligjshëm i informacionit të brendshëm lind kur:

a) një person zotëron informacion të brendshëm dhe ia zbulon atë çdo personi tjetër, përveç rasteve kur zbulimi bëhet në ushtrimin normal të punësimit, profesionit ose detyrës.

b) kur personi që jep rekomandimin ose nxitjen e di ose duhet të dijë se ai bazohej në informacion të brendshëm.

3. Për qëllimet e këtij ligji, informacioni i brendshëm do të përmbajë llojet e mëposhtme të informacionit:

a) informacion i një natyre të saktë, i cili nuk është bërë publik, që lidhet, drejtpërdrejt ose tërthorazi, me një ose më shumë emetues ose me një ose më shumë instrumente financiare, dhe që, nëse do të bëhej publike, do të kishte të ngjarë të kishte një efekt të rëndësishëm në çmimet e këtyre instrumenteve financiare ose në çmimin e instrumenteve financiare derivative të lidhura;

b) në lidhje me derivativët e mallrave, informacion të një natyre të saktë, i cili nuk është bërë publik, që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me një ose më shumë derivativë të tillë ose që lidhet drejtpërdrejt me kontratën e lidhur me produktin spot, dhe që, nëse është bërë publik, ka të ngjarë të ketë një efekt të rëndësishëm në çmimet e derivativëve të tillë ose kontratave të lidhura me mallrat spot, dhe kur ky është informacion që pritet në mënyrë të arsyeshme të zbulohet ose kërkohet të zbulohet në përputhje me dispozitat ligjore, rregullat e tregut, kontratat, praktikat ose zakonet, në tregjet përkatëse të derivateve të mallrave ose tregjet spot;

c) në lidhje me lejimet e emetimeve ose produktet e ankandeve të bazuara në to, informacione të një natyre të saktë, që nuk është bërë publike, që lidhet, drejtpërdrejt ose tërthorazi, me një ose më shumë instrumente të tillë dhe që, nëse do të bëhej publike, do të ka të ngjarë të ketë një efekt të rëndësishëm në çmimet e këtyre instrumenteve ose në çmimet e instrumenteve financiare derivative të lidhura;

ç) për personat e ngarkuar me ekzekutimin e urdhrave në lidhje me instrumentet financiare, nënkupton gjithashtu informacionin e përcjellë nga një klient dhe në lidhje me urdhrat në pritje të klientit në instrumentet financiare, i cili është i një natyre të saktë, që lidhet, drejtpërdrejt ose tërthorazi, me një ose më shumë emetues ose për një ose më shumë instrumente financiare, dhe të cilat, nëse do të bëheshin publike, do të kishin të ngjarë të kishin një efekt të rëndësishëm në çmimet e këtyre instrumenteve financiare, çmimin e kontratave të lidhura me mallrat spot ose në çmimin e derivativit të lidhur. Instrumentet financiare.

4. Për qëllimet e kësaj dispozite, informacioni do të konsiderohet të jetë i një natyre të saktë nëse ai tregon një grup rrethanash që ekzistojnë ose që në mënyrë të arsyeshme mund të pritet të krijohen, ose një ngjarje që ka ndodhur ose që në mënyrë të arsyeshme mund të pritet të ndodhin, kur është mjaft specifik për të mundësuar nxjerrjen e një përfundimi në lidhje me efektin e mundshëm të atij grupi rrethanash ose ngjarjesh mbi çmimet e instrumenteve financiare ose instrumentit financiar derivativ të lidhur, kontratave të lidhura me mallrat spot ose produkteve të ankandeve bazuar në lejimet e shkarkimeve. Në këtë drejtim, në rastin e një procesi të zgjatur që synon të sjellë, ose që rezulton në rrethana të veçanta ose një ngjarje të caktuar, ato rrethana të ardhshme ose ajo ngjarje e ardhshme, si dhe hapat e ndërmjetëm të atij procesi që lidhen me sjelljen rreth ose që rezulton në ato rrethana të ardhshme ose në atë ngjarje të ardhshme, mund të konsiderohet si informacion i saktë.

5. Një hap i ndërmjetëm në një proces të zgjatur do të vlerësohet të jetë informacioni i brendshëm nëse, në vetvete, plotëson kriteret e informacionit të brendshëm siç referohet në këtë nen.

6. Për qëllimet e paragrafit të tretë të këtij neni, informacioni i cili, nëse do të bëhej publik, do të kishte të ngjarë të kishte një efekt të rëndësishëm në çmimet e instrumenteve financiare, instrumenteve financiare derivative, kontratave të lidhura me mallrat spot, ose produkteve të ankandeve bazuar në lejitimet e emetimeve të cilin një investitor i arsyeshëm ka të ngjarë ta përdorë si pjesë të arsyeve dhe vendimeve të tij për të investuar.

#### **Neni 897**

#### **Falsifikimi i mjeteve matëse**

1. Ndërhyrja e bëre në mjetet matëse duke i ndryshuar ato me synimin që të tregojnë më pak se sa është e vërtetë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

2. Në rastin kur autori është mbajtës i një leje, autorizimi, licence ose çdo lloj titulli tjetër që i mundëson kryerjen e veprimtarive të përmendura në paragrafin më sipër, dënimit kryesor i shtohet dhe dënimi plotësues i heqjes të së drejtës së ushtrimit të një veprimtarie ose mjeshtrie.

#### **Neni 898**

#### **Fshehja e pronësisë**

Mosdhënia me dashje tek Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare i të dhënave për pronësinë për të përmbushur detyrimet sipas ligjit për titujt, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose burgim nga tre muaj deri në dy vjet.

#### **Neni 899**

#### **Mashtrimi në subvencione**

1. Parashtrimi i rrethanave të rreme përpara një institucioni apo nëpunësi publik të ngarkuar me trajtimin e kërkesave për përfitimin në mënyrë të padrejtë të subvencioneve apo çdolloj mbështetje financiare nga shteti apo, kur autori ka synuar të përdorë subvencionin në destinacion tjetër jashtë qëllimit fillestar të dhënies së tij apo, kur përdoren për përfitim privat nga përfituesi i tyre apo familjarë të tij, dënohet me gjobë ose me burgim nga një deri në gjashtë vjet.

2. Nëse ndryshimi i destinacionit të përdorimit të subvencionit apo mbështetjes financiare, apo përdorimi i tyre në përfitim ngushtësisht privat nga përfituesi i tyre apo familjarë të tij ndodh pas marrjes së subvencionit nëpërmjet dokumenteve të rregullta, dënimi i parashikuar në paragrafët një dhe dy të këtij neni, ulet deri në një të dytën e tyre.

3. Nëse autori i kësaj vepre penale, përpara se sa të fillojë gjykimi i çështjes, arrin të kthejë plotësisht vlerën e marrë padrejtësisht nëpërmjet subvencionit apo mbështetjes financiare, apo të keqpërdorur të tij, kur janë të pranishme disa rrethana lehtësuese, gjykata mund të përjashtojë autorin nga dënimi penal.

4. Kur kjo vepër ka cenuar fonde të BE-së, të dhëna në mbështetje të zhvillimeve të fushave të posaçme të ekonomisë, dënimi shtohet deri në një të tretën e tij.

5. Për qëllim të kësaj dispozite, paraqitja e fakteve të rreme në dokumentet sipas paragrafit të parë, nëse përmbajnë elemente të ndonjë vepre tjetër penale, mashtrimi në subvencione, konkurrenca edhe me to.

#### **Neni 900**

#### **Mashtrimi në sigurime**

1. Paraqitja e rrethanave të rreme në lidhje me objektin që sigurohet, ose krijimi i rrethanave të rreme dhe paraqitja e tyre në dokumentet duke përfitur padrejtësisht sigurime, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

2. Për qëllim të kësaj dispozite, paraqitja e fakteve të rreme në dokumentet sipas paragrafit të parë, nëse përmbajnë elemente të ndonjë vepre tjetër penale, mashtrimi në sigurime, konkurrenca edhe me to.

#### **Neni 901**

#### **Mashtrimi në kredi**

1. Mashtrimi në dokumentet e paraqitura, duke përfitur padrejtësisht kredi, nëpërmjet regjistrimit në mënyrë fiktive në hipotekë objekte që nuk ekzistojnë, ose tej vlerës së tyre reale, ose në pronësi të një tjetri pa pëlqimin e dijeninës së tij, të bëra me qëllim për të mos kthyer më kredinë e marrë, dënohet me gjobë ose me burgim nga dy deri në shtatë vjet.

2. Për qëllim të kësaj dispozite, paraqitja e fakteve të rreme në dokumentet e paraqitura në paragrafin e parë, nëse përmbajnë elemente të ndonjë vepre tjetër penale, mashtrimi në kredi, konkurrenca edhe me to.

#### **Neni 902**

#### **Rrethana të cilësuar të kryerjes së mashtrimeve**

1. Për sa lidhen me natyrën e veprave penale të parashikuara në këtë kre të Kodit Penal, do të vlerësohen si rrethana cilësuese të secilës prej tyre, përherë nëse dispozita e shkëlur nuk ka parashikuar ndryshe, kur janë vërtetuar rastet më poshtë:

a) duke përfitur nga kushtet e shkaktuara nga zjarri, përmytja, tërmeti ose çdo fatkeqësi tjetër që ka dobësuar aftësinë e viktimës ose ka shtuar mundësitë për kryerjen e krimit, dënimi shtohet deri në një të dytën e tij;

b) duke përfitur nga pafuqia ose nga çdo situatë tjetër veçanërisht e vështirë e viktimës ose kur e vendos viktimën ose familjen e saj në një situatë të rëndë ekonomike për shkak të vlerës së sendeve të vjedhura ose, sepse ato mbulojnë nevojat elementare të saj, dënimi shtohet deri në një të dytën e tij;

c) kur mashtrimi lidhet me vepra apo shërbime të interesit të përgjithshëm publik, dënimi shtohet deri në një të dytën e tij;

ç) kur vepra është kryer nga persona në bashkëpunim të veçantë, dënimi shtohet deri në një të tretën e tij.

#### **Neni 903**

#### **Kryerja e veprës penale nga subjektet profesionale**

Nëse ndonjëra nga veprat penale të parashikuara në nenet 893, 894, 895, 896, 900 dhe 901 të këtij Kodi do të kryhet nga ekspertë profesionistë të lëndës, avokatë apo këshilltarë të tjerë që ushtrojnë profesionin në fushën financiare dhe të tregut, vepra penale do të vlerësohet si e kryer në rrethana të cilësuar sipas nenit 902 të këtij kreu dhe, dënimi për veprën përkatëse të kryer do të përmbajë edhe dënimin plotësues të heqjes deri në pesë vjet të së drejtës për të ushtruar profesionin.

#### **Neni 904**

##### **Kryerja e veprës nga personi juridik**

1. Nëse një person juridik ka kryer veprat penale të parashikuara në dispozitat e këtij kreu dënimi me gjobë do të jetë deri në pesëfishin e përfitimit të paligjshëm nga kryerja e veprës penale apo, sipas rastit, të vlerës së objektit të saj.

2. Gjykata cakton edhe dënimet plotësuese të pezullimit të veprimtarisë së personit juridik për një periudhë tërësore jo më shumë se pesë vjet dhe mbylljen e mjediseve të punës së kompanisë.

3. Për veprat penale të parashikuara në dispozitat e këtij kreu, gjykata vendos edhe masën penale të regjistrimit dhe shkëmbimit të informacionit që përmbajnë të dhëna rreth subjektit lidhur me rastet kur vepra penale ka rëndësi për njohjen dhe parandalimin e kryerjes së krimeve prej tij në të ardhmen ose/edhe me natyrë edhe ndërkombëtare.

#### **Neni 905**

##### **Konkurrimi i veprave dhe bashkëpunimi**

1. Në të gjitha rastet kur, për të kryer një prej veprave penale të parashikuara në këtë seksion, autorit i është dashur të kryejë veprime që përbëjnë vepër penale më vete, atëherë kjo e fundit konkurren me veprën që ai ka dashur të kryejë.

2. Nëse për kryerjen e ndonjëres prej veprave penale të parashikuara në këtë kre, autorit të posaçëm i është dashur të bashkëpunojë me ndonjë person tjetër, pavarësisht cilësive të posaçme të këtij të fundit, ata do të përgjigjen për kryerjen në bashkëpunim të veprës penale të parashikuar në këtë kre, apo çfarëdolloj veprave penale që konkurren me to.

#### **Neni 906**

##### **Zbatimi i dispozitave në varësi të numrit të viktimave**

Në varësi të numrit të viktimave, çdo dispozitë e këtij kreu do të zbatohet aq herë sa është numri i tyre, pavarësisht nga lloji apo shkalla e pasojave që rezultojnë nga kryerja e veprave penale.

#### **Neni 907**

##### **Dënimet plotësuese**

1. Nëse veprat penale të parashikuara në këtë kre kryhen nga nëpunësi publik, atëherë gjykata, krahas dënimet kryesor cakton edhe dënimin plotësues heqjen e së drejtës për të punuar në shërbimin publik, ose çdo dënim tjetër që çmon të arsyeshëm, në përputhje me natyrën e veprës dhe veprimeve të kryera nga i dënuari, gjithmonë nëse dispozita konkrete nuk ka parashikuar ndryshe.

2. Në çdo rast gjykata vendos përveç sendeve që kanë shërbyer për kryerjen e veprave penale, kur ajo është kryer nga subjektet me qëllim përfitimi material apo të premtuar, vendoset konfiskimi i të ardhurave nga vepra penale apo ato të premtuara.

3. Në çdo rast, gjykata vendos rikthimin e sendit te pronari i tij dhe, në pamundësi, zëvendësimin e dëmit të shkaktuar.

4. Për veprat penale të lehta të parashikuara në dispozitat e këtij kreu, kur çmohet e arsyeshme, gjykata mund të vendosë dhënien e jo më pak se sa dy dënimeve plotësuese në vend të dënimit kryesor.

### KREU III SHKATËRRIMI DHE DËMTIMI I PRONËS

#### **Neni 908** **Shkatërrimi i pronës**

1. Shkatërrimi apo dëmtimi me dashje i pronës së tjetrit, dënohet me burgim deri në tre vjet.
2. Nëse autori i veprës sipas paragrafit të parë zëvendëson dëmin e shkaktuar dhe viktima kërkon të pushohet çështja si dhe, palët kanë normalizuar marrëdhënien e tyre, vendoset pushimi i çështjes nëse organi procedues krijon bindjen që autori nuk do ta përsërisë më kryerjen e kësaj vepre në të ardhmen me kushtin që sendi të mos jetë pronë publike ose objekt kulti.
3. Pavarësisht vlerës së shkatërruar apo dëmtuar të pasurisë, kur kryhet me zjarr, eksploziv, përmytje apo çdo mjet a mënyrë tjetër të dhunshme e të rrezikshme për të tretët, dënohet nga pesë deri në dhjetë vjet burgim.
4. Nëse ndonjëra nga veprat penale të parashikuara në paragrafët më lart të këtij neni, do të kryhen ndaj objekteve publike apo atyre të kulteve, dënimi penal respektiv do të shtohet deri në një të tretën e tij.
5. Nëse nga shkatërrimi apo dëmtimi i kryer sipas këtij neni cenohet jeta apo shëndeti i njerëzve, atëherë kjo vepër konkurren me veprat penale kundër jetës e shëndetit të njerëzve të kualifikuara bazuar në formën e fajit të shfaqur nga autori.
6. Kur, secila nga veprat penale të parashikuara në këtë dispozitë, kryhen nga pakujdesia, dënimi penal ulet deri në dy të tretat e parashikuar nga dispozita përkatëse.

#### **Neni 909** **Shkatërrimi i rrugëve**

1. Shkatërrimi apo dëmtimi me dashje i rrugëve automobilistike, hekurudhore dhe veprave që lidhen me to, dënohet me burgim nga dy deri në shtatë vjet.
2. Kur nga veprat penale kanë ardhur pasoja të rënda materiale të vlerësuara mbi dy milionë e një lekë dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.
3. Nëse nga shkatërrimi apo dëmtimi i kryer sipas këtij neni cenohet jeta apo shëndeti i njerëzve, atëherë kjo vepër konkurren me veprat penale kundër jetës e shëndetit të njerëzve të kualifikuara bazuar në formën e fajit të shfaqur nga autori.

#### **Neni 910** **Shkatërrimi i rrjetit elektrik apo të ujësjellësit**

1. Shkatërrimi apo dëmtimi me dashje i rrjetit elektrik, telegrafik, telefonik, radiotelevizion apo të çdo rrjeti ndërlidhës apo komunikues ndërmjet subjekteve, rrjetit të kanaleve ujitëse, kulluese ose veprave që lidhen me to, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

2. Kur nga veprat penale kanë ardhur pasoja të rënda materiale të vlerësuara mbi dy milionë e një lekë dënohen me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.

### **Neni 911**

#### **Shkatërrimi i kabllave nënujore**

1. Shkatërrimi, dëmtimi, thyerja, devijimi, ose bërja e pamundur me çdo mënyrë tjetër e funksionimit të një kabllave nënujore ose një tubacioni që përdoret për të krijuar lidhje telefonike ose telegrafike në nivelin e detit ose që mundëson kalimin e ujit, gazit natyror, naftës ose energjisë elektrike ndërmjet dy ose më shumë shteteve ose ndërmjet një shteti dhe kontinenteve, dënohet me burgim nga pesë deri në dymbëdhjetë vjet.

2. Shkatërrimi, dëmtimi ose bërja e pamundur me çdo mënyrë tjetër e funksionimit të instalimeve shoqëruese, anijeve, strukturave ose pajisjeve që përdoren gjatë instalimit, riparimit ose mirëmbajtjes së kabllave nënujore ose tubacioneve, dënohet me burgim nga dy deri në gjashtë vjet.

3. Kryerja e kësaj vepre nga pakujdesia, e ul dënimin për një të dytën e parashikimit në dispozitën përkatëse.

### **Neni 912**

#### **Lidhja ose administrimi i ujit pa të drejtë**

Administrimi i ujit pa të drejtë, duke kthyer ose ndryshuar vijën e ujit, duke hapur pendat, duke ndërtuar apo mbyllur kanale kulluese apo vaditëse, vija ose vepra të tjera, për qëllime të përfitimit të çfarëdolloji, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy muaj.

### **Neni 913**

#### **Kryerja e veprës nga personi juridik**

1. Nëse një person juridik ka kryer veprat penale të parashikuara në nenet 908, paragrafi 3, 4, 5 dhe neni 909 dhe 910 të këtij kreu dënimi me gjobë do të jetë deri në pesëfishin e përfitimit të paligjshëm nga kryerja e veprës penale apo, sipas rastit, të vlerës së objektit të saj.

2. Gjykata cakton edhe dënimet plotësuese të pezullimit të veprimtarisë së personit juridik për një periudhë tërësore jo më shumë se pesë vjet.

### **Neni 914**

#### **Dënimet plotësuese**

1. Nëse veprat penale të parashikuara në këtë seksion kryhen nga nëpunësi publik, atëherë gjykata, krahas dënimit kryesor cakton edhe dënimin plotësues, heqjen e së drejtës për të punuar në shërbimin publik, ose çdo dënim tjetër që çmon të arsyeshëm, në përputhje me natyrën e veprës

dhe veprimeve të kryera nga i dënuari, gjithmonë nëse dispozita konkrete nuk ka parashikuar ndryshe.

2. Në çdo rast gjykata vendos masën e zëvendësimit të dëmit të shkaktuar dhe, përveç sendeve që kanë shërbyer për kryerjen e veprave penale, kur ajo është kryer nga subjektet me qëllim përfitimi material apo të premtuar, vendoset konfiskimi i të ardhurave nga vepra penale apo të premtuara.

3. Për veprat penale të lehta të parashikuara në dispozitat e këtij kreu, kur çmohet e arsyeshme, gjykata mund të vendosë dhënien e jo më pak se sa dy dënimeve plotësuese në vend të dënimit kryesor.

### **Neni 915**

#### **Konkurrimi i veprave dhe bashkëpunimi**

1. Në të gjitha rastet kur, për të kryer një prej veprave penale të parashikuara në këtë seksion, autorit i është dashur të kryejë veprime që përbëjnë vepër penale më vete, atëherë kjo e fundit konkurren me veprën që ai ka dashur të kryejë.

2. Nëse për kryerjen e ndonjërës prej veprave penale të parashikuara në këtë kre, autorit të posaçëm i është dashur të bashkëpunojë me ndonjë person tjetër, pavarësisht cilësive të posaçme të këtij të fundit, ata do të përgjigjen për kryerjen në bashkëpunim të veprës penale të parashikuar në këtë kre, apo çfarëdolloj vepre penale që konkurren me to.

### **KREU IV**

#### **VEPRAT PENALE KUNDËR ARTIT, KULTURËS, PRONËSISË INTELEKTUALE DHE INDUSTRIALE**

### **Neni 916**

#### **Autorizimi apo leja e paligjshme**

Per sa lidhet me dispozitat e këtij seksioni, do të vleresohet te jetë e paligjshme, cdo sjellje, autorizim i kerkuar, leje per ushtrim te veprimtarive te permendura edhe kur kryhet sipas një autorizimi të lëshuar nga një autoritet kompetent i një shteti, nëse një autorizim i tillë është marrë me mashtrim ose me korrupsion, zhvatje ose detyrim, ose nëse një autorizim i tillë është në shkelje të dukshme të kërkesave ligjore thelbësore përkatëse, apo ne kapercim te kushteve te atij autorizimi.

### **Neni 917**

#### **Vjedhja e veprave të artit dhe kulturës**

1. Vjedhja e veprave të artit e kulturës në pronësi të një personi tjetër, dënohet me gjobë ose me burgim nga dy deri në pesë vjet.

2. Vjedhja e veprave të artit e kulturës me rëndësi kombëtare, ose ato që i përkasin shtetit, ose ato të cilat gjenden, ose janë nxjerrë nga nëntoka ose nga shtrati i detit, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.

3. Kryerja e veprës penale nga personi që ka fituar lejen për të kryer kërkime në det apo nëntokë, e shton dënimin deri në një të tretën e tij.

### **Neni 918**

#### **Transferimi i veprave të artit**

1. Transferimi jashtë vendit i veprave të artit ose kulturës, sendeve me interes artistik, historik, arkeologjik, etno-antropologjik, bibliografik, dokumentar ose arkivor ose sende të tjera që i nënshtrohen dispozitave të veçanta të mbrojtjes, sipas legjislacionit për trashëgiminë kulturore, pa lejen ose autorizimin përkatës, dënohet me gjobë ose me burgim deri në katër vjet.

2. Kur vepra penale si më sipër synon çfarëdolloj tjetërsimi të paligjshëm të veprave të mbrojtura, apo ka sjellë humbjen e tyre, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.

3. Kryerja e veprave penale të parashikuara në paragrafët e këtij neni, nga personi publik, e shton dënimin respektiv deri në një të tretën e tij.

### **Neni 919**

#### **Moskthimi i veprave të artit**

Moskthimi në territorin kombëtar, pas përfundimit të afatit, i veprave të artit ose kulturës, sendeve me interes artistik, historik, arkeologjik, etno-antropologjik, bibliografik, dokumentar ose arkivor ose sendeve të tjera që i nënshtrohen dispozitave të veçanta të mbrojtjes, sipas legjislacionit për trashëgiminë kulturore, për të cilat është lejuar ose autorizuar nxjerrja ose eksportimi i përkohshëm, dënohet me burgim nga dy deri në gjashtë vjet.

### **Neni 920**

#### **Kontrabanda e vlerave kulturore**

1. Importimi, eksportimi ose kalimi transit i pasurive që përbëjnë trashëgiminë kulturore kombëtare, në kundërshtim me dispozitat ligjore në lidhje me to, apo edhe bërja e deklarimeve të rreme për të provuar pranë organit kompetent se veprat e artit dhe kulturës nuk i nënshtrohen regjimit të marrjes së lejes për t'u nxjerrë jashtë territorit kombëtar, dënohet me burgim nga katër deri në dhjetë vjet.

2. Kur vepra penale kryhet me qëllim fitimi të çfarëdolloji, dënohet me burgim nga gjashtë deri në dymbëdhjetë vjet.

2. Kur vepra penale respektive e parashikuar në dy paragrafët e parë të këtij neni, kryhet nga nëpunës publikë ose nga punonjës të doganave apo prej atyre që, për shkak të llojit të punës që kryejnë janë të lidhur me veprimtarinë kulturore apo doganore, qofshin edhe subjekte private, dënimi me burgim shtohet me një të tretën dhe, zbatohet dënimi plotësues i ndalimit të së drejtës për të ushtruar funksione publike.

3. Kur vepra penale respektive e parashikuar në dy paragrafët e parë të këtij neni, kryhet nëpërmjet bashkëpunimit të veçantë, dënimi shtohet deri në një të dytën e tij.

4. Gjykata në çdo rast, shoqëron dënimin kryesor me dënimin plotësues të konfiskimit të çdo lloji pasurie që rrjedh ose fitohet drejtpërdrejt ose tërthorazi nga kryerja e veprës penale, apo dhe i shpërblimeve, të dhëna ose të premtuara, për kryerjen e veprës penale

**Neni 921**  
**Importimi i veprave të artit**

Importimi i veprave të artit ose kulturës që rrjedhin nga një krim ose që janë gjetur pas kërkimeve të kryera pa lejen përkatëse të shtetit në territorin e të cilit është kryer kërkimi apo gërmimi, ose eksportimi nga një shtet tjetër në kundërshtim me legjislacionin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të atij shteti, kur nuk përbën vepër penale tjetër më të rëndë, dënohet me burgim nga një deri në katër vjet.

**Neni 922**  
**Fshehja e veprave të vjedhura të artit**

1. Fshehja, blerja, shitja ose marrja e veprave të artit ose kulturës që rrjedhin nga një vepër penale tjetër, ose ndërmjetësimi i kryer me atë qëllim, për t'i siguruar vetes ose tjetrit një përfitim çfarëdo, kur nuk përbën vepër penale tjetër më të rëndë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

2. Kryerja e kësaj vepre me dhunë ose kanosje, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.

3. Kjo dispozitë gjen zbatim edhe në rastet kur autori i veprës penale që ka siguruar veprën e artit ose kulturës, nuk mund të merret në përgjegjësi penale, nuk mund të dënohet ose kur mungon autorizimi për procedim.

4. Me “dhunë” sipas paragrafit të dytë të këtij neni do të pranohet dhuna që vlerësohet deri e lehtë sipas ligjit penal.

**Neni 923**  
**Përdorimi i veprave të artit**

1. Përdorimi në veprimtari ekonomike ose financiare i veprave të artit ose kulturës që rrjedhin nga një vepër penale, kur nuk përbën vepër penale tjetër më të rëndë, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

2. Zëvendësimi ose transferimi i veprave të artit dhe kulturës që rrjedhin nga një krim me dashje, ose kryerja në lidhje me to e veprimeve të tjera në mënyrë që të pengohet identifikimi i prejardhjes së tyre të paligjshme, kur nuk përbën vepër penale tjetër më të rëndë, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.

3. Kjo dispozitë gjen zbatim edhe në rastet kur autori i veprës penale që ka siguruar veprën e artit ose kulturës, nuk mund të merret në përgjegjësi penale, nuk mund të dënohet ose kur mungon autorizimi për procedim.

**Neni 924**  
**Shkelje të lehta**

Kryerja e veprimeve të mëposhtme:

a) tjetërsimi ose hedhja në treg e veprave të artit ose kulturës, pa lejen ose pa autorizimin përkatës;

b) mosdorëzimi brenda tridhjetë ditëve i aktit të kalimit të pronësisë ose të mbajtjes së veprave të artit ose kulturës, nga ai që është i detyruar për ta bërë;

c) dorëzimi i sendit në pritje të afatit gjashtëdhjetë ditor nga dita e marrjes së njoftimit për transferim nga tjetërsuesi i një pasurie kulturore që është objekt parablerjeje, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë ose me burgim deri në tre muaj.

### **Neni 925**

#### **Shkatërrimi i veprave të artit**

1. Shkatërrimi, përkeqësimi, dëmtimi ose bërja tërësisht ose pjesërisht të pavlera ose të papërdorshme të pasurisë kulturore ose pasurisë së peizazhit kulturor, private ose publike, dënohet me burgim nga dy deri në gjashtë vjet.

2. Shëmtimi ose ndotja, jashtë rasteve të përmendura në paragrafin e parë, e pasurive kulturore ose pasurive të peizazhit kulturor, private ose publike, ose destinimi i pasurisë a peizazhit kulturor për një përdorim të papajtuëshëm me natyrën e tyre historike ose artistike, ose që cenon ruajtjen ose integritetin e tyre, dënohet me burgim nga një deri në katër vjet.

3. Gjykata gjithmonë vendos masën plotësuese të rikthimit të gjendjes fillestare të vendeve ose eliminimi i pasojave të dëmshme ose të rrezikshme të veprës penale.

### **Neni 926**

#### **Plaçkitja e veprave kulturore**

1. Plaçkitja e pasurive kulturore ose pasurive të peizazhit kulturor ose instituteve dhe vendeve të kulturës, dënohet me burgim nga gjashtë deri në dhjetë vjet.

2. Për qëllim të këtij seksioni, me “plaçkitje” do të kuptohet vjedhja e dhunshme e pasurive kulturore të objekteve të përmendura në paragrafin e parë të këtij neni.

### **Neni 927**

#### **Mashtrimi në lidhje me veprat e artit dhe të kulturës**

1. Falsifikimi tërësor ose i pjesshëm i një akti shkresor privat, përdorimi ose ndryshimi, shkatërrimi, heqja apo fshehja, e plotë ose e pjesshme e një akti shkresor privat që ka lidhje me veprat e artit dhe të kulturës, me qëllim që prejardhja e tyre të duket e ligjshme apo origjinale, dënohet me burgim nga dy deri në katër vjet.

2. Për qëllim të kësaj dispozite, do të vlerësohet si mashtrim i lidhur me veprat e artit dhe kulturës, kryerja e ndonjërit prej akteve të mëposhtme me synimin për të përfituar pasuri:

a) falsifikimi, modifikimi ose riprodhimi i një vepre piktore, skulpture ose grafike ose një objekti të antikitetit ose me interes historik apo arkeologjik;

b) hedhja në treg, mbajtja për qëllime tregtimi, futja për këtë qëllim në territorin e shtetit ose shitja, vënia në qarkullim në çdo mënyrë tjetër, e kopjeve të falsifikuara, të modifikuara ose të riprodhuara të veprave të pikturës, skulpturës ose grafikës, të objekteve të antikitetit ose të objekteve me interes historik ose arkeologjik, sikur të jenë autentike, nga një person, edhe pa qenë bashkëpunëtor në falsifikimin, modifikimin ose riprodhimin e tyre;

c) vërtetimi i autenticitetit të veprave ose sendeve të përmendura në shkronjat “a” dhe “b”, të cilat janë të falsifikuara, të modifikuara ose të riprodhuara, duke pasur dijeni për falsitetin e tyre;

ç) kushdo që me deklaratatë të tjera, vlerësime, publikime, vendosje vulash ose etiketash ose me ndonjë mjet tjetër, vlerësimi ose dhënia e kontributeve për t’i bërë të besueshme si autentike, vepra

ose objekte të përmendura në pikat “a” dhe “b” të këtij neni, të cilat janë të falsifikuara, të modifikuara ose të riprodhuara, nëpërmjet deklaratave të ndryshme, ekspertimeve, publikimeve, vendosjes së vulave ose etiketave ose me çdo mjet tjetër, duke pasur dijeni për falsitetin e tyre;

d) falsifikimi tërësor ose i pjesshëm i një akti shkresor privat, përdorimi ose ndryshimi, shkatërrimi, heqja apo fshehja, e plotë ose e pjesshme e një akti shkresor privat që ka lidhje me vepra të artit dhe kulturës, me qëllim që prejardhja e tyre të duket e ligjshme apo origjinale, dhe dënohen me burgim nga katër deri në dhjetë vjet.

3. Në çdo rast, gjykata vendos konfiskimin e kopjeve të falsifikuara, të modifikuara ose të riprodhuara të veprave ose të sendeve të treguara në paragrafin e parë, përveç rasteve kur u përkasin personave që nuk kanë lidhje me veprën penale. Sendet e konfiskuara ndalohet të shiten në ankandet e mjeteve të veprës penale.

## **Neni 928**

### **Plagjiatura**

1. Plagjiatura, riprodhimi, shpërndarja, komunikimi publikisht ose në çdo mënyrë tjetër, tërësisht ose pjesërisht, i një vepre ose shfaqje letrare, artistike ose shkencore, ose transformimi, interpretimi ose ekzekutimi artistik i saj, e kryer me çdo mjet a mënyrë të komunikuarit, pa autorizimin e mbajtësit të së drejtës përkatëse të pronësisë intelektuale ose të autorizuarit prej tij, kryer me qëllimin për të marrë një përfitim ekonomik të drejtpërdrejtë ose të tërthortë dhe në dëm të një të treti, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

2. Ndhurma në mënyrë aktive, jo thjesht teknike, e aksesit ose gjetjes në internet të veprave ose shfaqjeve që i nënshtrohen pronësisë intelektuale, pa autorizimin e mbajtësve të të drejtave përkatëse ose personave të autorizuar prej tyre, duke ofruar sidomos lista të renditura dhe të klasifikuara të lidhjeve me veprat dhe përmbajtjet e tyre, edhe kur këto lidhje janë ofruar fillimisht nga marrësit e shërbimeve të tyre, kryer nga kushdo që ofron shërbime të shoqërisë së informacionit me synimin për të marrë një përfitim ekonomik të drejtpërdrejtë ose të tërthortë dhe në dëm të një të treti, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj.

3. Shpërndarja ose tregtimi ambulant ose i rastësishëm i veprave ose shfaqjeve të përmendura në paragrafin e parë të këtij neni, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë.

## **Neni 929**

### **Ruajtja e kopjeve të paligjshme**

1. Ruajtja ose eksportimi i kopjeve të veprave, prodhimeve ose shfaqjeve të mbrojtura nga normat e pronësisë intelektuale, duke përfshirë edhe kopjet digjitale të tyre, pa autorizimin e ligjshëm, me qëllimin për t'i riprodhuar, shpërndarë ose përhapur publikisht, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

2. Importimi i produkteve intelektuale pa autorizimin e ligjshëm, me qëllimin për t'i riprodhuar, shpërndarë ose përhapur publikisht, pavarësisht nëse kanë origjinë të ligjshme ose të paligjshme në vendin e tyre të origjinës, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë.

3. Importimi i produkteve intelektuale të përmendura në këtë seksion, nga një shtet anëtar i Bashkimit Evropian nuk do të dënohet kur produktet janë blerë drejtpërdrejt nga mbajtësi i të drejtave në shtetin në fjalë, ose me pëlqimin e tij.

## **Neni 930**

### **Favorizimi i shkeljeve të së drejtës së autorit**

1. Favorizimi ose lehtësimi i kryerjes së ndonjëres prej sjelljeve të përmendura në paragrafin e parë të nenit 928, duke eliminuar ose modifikuar masat mbrojtëse efektive teknologjike, që kanë për qëllim parandalimin ose kufizimin e realizimit të sjelljeve, kryer pa autorizimin e mbajtësve të të drejtave të pronësisë intelektuale ose të personave të autorizuar prej tyre, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj.

2. Shmangia ose lehtësimi i shmangies së masave efektive teknologjike të vendosura për të shmangur aksesin, për t'u siguruar palëve të treta akses në një kopje të një veprë letrare, artistike ose shkencore, ose transformimin, interpretimin ose ekzekutimin artistik të saj, me çdo mjet a mënyrë ose, për ta komunikuar me çdo mjet dhe pa autorizimin e mbajtësve të të drejtave të pronësisë intelektuale ose të personave të autorizuar prej tyre, kur kryhet me qëllimin për të marrë një përfitim ekonomik të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në katër muaj.

3. Prodhimi, importimi, vënia në qarkullim, ose posedimi për qëllime tregtimi i çdo mjeti të projektuar, prodhuar, përshtatur ose bërë kryesisht për të lehtësuar prishjen ose neutralizimin e paautorizuar të çdo pajisjeje teknike që përdoret për të mbrojtur programet kompjuterike ose ndonjë program tjetër të veprave, interpretimeve ose ekzekutimeve të tjera të përmendura në këtë seksion, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj.

## **Neni 931**

### **Përdorimi i paligjshëm i patentave**

1. Përdorimi, importimi, mbajtja, ofrimi ose hedhja në treg, pa pëlqimin e mbajtësit të një patente, marke, skice industriale a grafike, apo modeli përdorimi, në dijeni të regjistrimit të rregullt e më parë të objekteve të mbuluara nga të drejtat e regjistrimit, kryer për qëllime industriale ose tregtare, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

2. Prodhimi i paligjshëm i një objekti të regjistruar më parë sipas normave të patentave apo markave, të mbrojtura nga legjislacioni përkatës, kryer pa pëlqimin e mbajtësit të së drejtës dhe për qëllime tregtare ose industriale, dënohet me burgim nga një deri në katër vjet.

3. Përdorimi ose ofrimi për përdorim i një procedure që është objekt i një patente, ose zotërimi, ofrimi, hedhja në treg ose përdorimi i produktit të marrë drejtpërdrejt nga procesi i patentuar, në të njëjtat mënyra dhe për të njëjtat qëllime të përmendura në paragrafin e parë të këtij neni, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

## **Neni 932**

### **Shkelja e të drejtave të topografisë së qarkut të gjysmëpërçuesit**

Prodhimi, përdorimi, mbajtja për qëllim tregtimi, shitja, ofrimi për shitje, furnizimi, shpërndarja, eksportimi ose importimi për këto qëllime i produktit që shkel të drejtat e topografisë së regjistruar të qarkut, të gjysmëpërçuesit ose të qarkut të integruar, pa pëlqimin e pronarit të topografisë, të kryera me dashje, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë ose me burgim nga tre muaj deri në një vit.

**Neni 933**  
**Fabrikimi i shenjave**

1. Kryerja e veprimeve të mëposhtme, për qëllime industriale ose tregtare, në dijeni të regjistrimit të mëparshëm, kryer pa pëlqimin e mbajtësit të një të drejte të regjistruar të pronësisë industriale në përputhje me legjislacionin për markat tregtare:

a) fabrikimi, prodhimi ose importimi i produkteve që përmbajnë një shenjë dalluese që është identike ose mund të ngatërrohet me të, ose

b) ofrimi, shpërndarja ose shitja me shumicë e produkteve që përmbajnë një shenjë dalluese që është identike ose mund të ngatërrohet me të, ose ruajtja për këtë qëllim, kur bëhet fjalë për produkte, shërbime ose veprimtari të njëjta ose të ngjashme për të cilat është regjistruar e drejta e pronësisë industriale, përbën kundërvajtje penale dhe, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre muaj.

**Neni 934**  
**Shpërndarja e shenjave**

1. Shpërndarja ose tregtimi me pakicë, ose ofrimi i shërbimeve ose zhvillimi i veprimtarive, që përmbajnë një shenjë dalluese e cila është identike ose mund të ngatërrohet me të, kur bëhet fjalë për produkte, shërbime ose veprimtari të njëjta ose të ngjashme për të cilat është regjistruar e drejta e pronësisë industriale, për qëllime industriale ose tregtare, pa pëlqimin e mbajtësit të një të drejte të regjistruar të pronësisë industriale në përputhje me legjislacionin për markat tregtare dhe duke qenë në dijeni të këtij regjistrimi, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë.

2. Riprodhimi ose imitimi i një shenje dalluese identike ose që mund të ngatërrohet me të për përdorimin e saj për kryerjen e akteve të parashikuara në këtë nen, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë.

**Neni 935**  
**Prodhimi i materialit bimor**

1. Prodhimi ose riprodhimi, përgatitja e kushteve për prodhimin ose riprodhimin, ofrimi për shitje, shitja ose tregtimi në çdo mënyrë, eksportimi ose importimi, ose mbajtja për kryerjen e secilit nga këto veprime, e materialit bimor që shërben për riprodhimin ose shumëzimin e një varieteti të mbrojtur bimor në përputhje me legjislacionin e fushës ose të Bashkimit Evropian për mbrojtjen e varieteteve bimore, e kryer për qëllime bujqësore ose tregtare, pa pëlqimin e mbajtësit të titullit të seleksionuesit të bimëve dhe duke qenë në dijeni të këtij regjistrimi, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

2. Kryerja e njërit prej veprimeve të përshkruara në paragrafin e mësipërm duke përdorur, nën emërtimin e varietetit bimor të mbrojtur, material bimor riprodhues ose shumëzues që nuk i përket këtij varietetit, dënohet me gjobë ose me burgim deri në katër vjet.

3. Të njëjtat dënime të parashikuara në paragrafët më sipër do të vendosen edhe kur shkelja kryhet lidhur me hedhjen në qarkullimin civil të objekteve të emërtuara sipas origjinës ose të treguesit gjeografik të regjistruara dhe, që përfaqësojnë një cilësi të caktuar të mbrojtur ligjërisht për të dalluar produktet që mbulohen prej tyre, kur kryhet me dashje dhe pa pasur lejen ose autorizimin përkatës.

### **Neni 936**

#### **Falsifikimi i treguesve gjeografikë dhe emërtimeve të origjinës së produkteve agro-ushqimore**

1. Falsifikimi ose ndryshimi i treguesve gjeografike ose emërtimeve të origjinës së produkteve agro-ushqimore, dënohet me gjobe ose me burgim deri në tre vjet.
2. Futja në territorin e shtetit, mbajtja për shitje, ofrimi për shitje me ofertë të drejtpërdrejtë për konsumatorët ose në hedhja në qarkullim të produkteve me tregues ose emërtime të falsifikuara, me qëllim përfitimi, dënohet me gjobë ose me burgim deri në katër vjet.

### **Neni 937**

#### **Rrethanat e cilësuar**

1. Për sa lidhen me natyrën e veprave penale të parashikuara në këtë kre të Kodit Penal, do të vlerësohen si rrethana cilësuese të secilës prej tyre, kur janë vërtetuar rastet më poshtë:
  - a) shkaktimi i një dëmi me rrezikshmëri të lartë;
  - b) kryerja e veprës gjatë ushtrimit të një veprimtarie profesionale, tregtare, bankare ose financiare;
  - c) kryerja e veprës nga zyrtari publik ose personi përgjegjës i shërbimit publik përgjegjës për ruajtjen ose mbrojtjen e pasurisë kulturore të luajtshme ose të paluajtshme;
  - ç) përfitimi i marrë ose që mund të merrej ka rëndësi të veçantë ekonomike;
  - d) rrezikshmëria e veçantë e veprimeve, duke marrë parasysh vlerën e objekteve të prodhuara në mënyrë të paligjshme, numrin e veprave, ose transformimin, ekzekutimin ose interpretimin e tyre, të riprodhuara, të shpërndara, të komunikuar në mënyrë të paligjshme në publik ose të vëna në dispozicion për të, ose rëndësia e veçantë e dëmeve të shkaktuara;
  - dh) kryerja e veprës nga një grup ose organizatë, qoftë edhe të karakterit të përkohshëm, qëllimi i së cilës është të kryejë veprimtari që cenojnë të drejtat e pronësisë intelektuale;
  - e) përdorimi i të miturve nën tetëmbëdhjetë vjeç për kryerjen e këtyre veprave;dhe, shtojnë dënimin që përmban dispozita penale përkatëse deri në një të tretën më shumë në të gjitha rastet, përveçse kur dispozita e shkelur ka parashikuar ndryshe.
2. Me termin “dëm me rrezikshmëri të lartë” do të kuptohet jo vetëm dëmi material që, për aq sa është proporcionale me vlerat e objekteve kulturore, industriale apo përfitimeve prej tyre të përmendura në këtë kre, por çdo dëm tjetër i ardhshëm me probabilitet të lartë për t’u vërtetuar shkencërisht si dhe, dëmi që lidhet me cenimin e rëndë të interesave thelbësore të publikut.

### **Neni 938**

#### **Kryerja e veprës nga personi juridik**

1. Nëse një person juridik ka kryer veprat penale të parashikuara në këtë seksion dënimi me gjobë do të jetë deri në pesëfishin e përfitimit të paligjshëm nga kryerja e veprës penale apo, sipas rastit, të vlerës së objektit të saj.
2. Gjykata mund të caktojë dënimin plotësues të publikimit të vendimit të dënimit ndaj personit juridik dhe, mbylles së përkohshme të veprimtarisë së tij.

## **Neni 939**

### **Konkurrimi i veprave dhe bashkëpunimi**

1. Në të gjitha rastet kur, për të kryer një prej veprave penale të parashikuara në këtë seksion, autorit i është dashur të kryejë veprime që përbëjnë vepër penale më vete, atëherë kjo e fundit konkurren me veprën që ai ka dashur të kryejë.

2. Nëse për kryerjen e ndonjërës prej veprave penale të parashikuara në këtë seksion, autorit i është dashur të bashkëpunojë me ndonjë person tjetër, në dijeni të plotë prej këtij të fundit, pavarësisht cilësive apo rolit që kryen, ata do të përgjigjen për kryerjen e veprës penale të parashikuar në këtë seksion në bashkëpunim me njëri-tjetrin.

## **Neni 940**

### **Zbatimi i dispozitave në varësi të numrit të viktimave**

Në varësi të numrit të viktimave, çdo dispozitë e këtij kreu do të zbatohet aq herë sa është numri i tyre, pavarësisht nga lloji apo shkalla e pasojave që rezultojnë nga kryerja e veprave penale.

## **Neni 941**

### **Dënimet plotësuese**

1. Nëse veprat penale të parashikuara në këtë kre kryhen nga nëpunësi publik, atëherë gjykata, krahas dënimit kryesor cakton edhe dënimin plotësues heqjen e së drejtës për të punuar në shërbimin publik, ose çdo dënim tjetër që çmon të arsyeshëm, në përputhje me natyrën e veprës dhe veprimeve të kryera nga i dënuari, gjithmonë nëse dispozita konkrete nuk ka parashikuar ndryshe.

2. Në çdo rast gjykata vendos, përveç sendeve që kanë shërbyer për kryerjen e veprave penale, kur ajo është kryer nga subjektet me qëllim përfitimi material apo të premtuar, vendoset konfiskimi i të ardhurave nga vepra penale apo të premtuara.

3. Në çdo rast, gjykata vendos rikthimin e sendit të pronari i tij dhe, në pamundësi, zëvendësimin e dëmit të shkaktuar.

4. Gjkata, krahas dënimit kryesor apo edhe atij plotësues kur e gjen të arsyeshme, urdhëron edhe tërheqjen e veprave ose ngjarjeve që janë objekt i veprës penale. Kur, nëpërmjet një portali të aksesit në internet ose shërbimit të shoqërisë së informacionit, përmbajtja që i nënshtrohet pronës intelektuale të përmendur në seksionet e mësipërme shpërndahet ekskluzivisht ose në mënyrë mbizotëruese, do të urdhërohet ndërprerja e ofrimit të tij dhe gjykata mund të urdhërojë çdo masë parandaluese proporcionale dhe efikase, qëllimi i së cilës është mbrojtja e të drejtave të pronësisë intelektuale.

5. Gjkata vendos edhe masën penale të regjistrimit dhe shkëmbimit të të dhënave që përmbajnë të dhëna rreth subjektit lidhur me rastet kur vepra penale ka rëndësi për njohjen dhe parandalimin e kryerjes së krimeve prej subjektit, ose/edhe me natyrë edhe ndërkombëtare.

6. Për veprat penale të lehta të parashikuara në dispozitat e këtij kreu, kur çmohet e arsyeshme, gjykata mund të vendosë dhënien e jo më pak se sa dy dënimeve plotësuese në vend të dënimit kryesor.

TITULLI X  
VEPRAT PENALE KUNDËR KAFSHËVE

**Neni 942**  
**Autorizimi apo leja e paligjshme**

Per sa lidhet me dispozitat e ketij seksioni, do të vleresohet te jetë e paligjshme, cdo sjellje, autorizim i kerkuar, leje per ushtrim te veprimtarive te permendura edhe kur kryhet sipas një autorizimi të lëshuar nga një autoritet kompetent i një shteti, nëse një autorizim i tillë është marrë me mashtrim ose me korrupsion, zhvatje ose detyrim, ose nëse një autorizim i tillë është në shkelje të dukshme të kërkesave ligjore thelbësore përkatëse, apo ne kapercim te kushteve te atij autorizimi.

**Neni 943**  
**Dëmtimi i kafshëve shtëpiake**

1. Shkaktimi te një kafshe shtëpiake, të zbutur, të stërvitur apo që jeton përkohësisht apo në mënyrë të vazhdueshme nën kontrollin njerëzor, jashtë veprimtarive të rregulluara ligjërisht dhe me çdo mjet ose procedurë, të një dëmtimi të përherëshëm ose të përkohshëm, përfshi aktet me natyrë seksuale, për të cilat kërkohet trajtim veterinar për rikthimin e shëndetit të kafshës, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

2. Po kjo vepër, e kryer ndaj një kafshe vertebrorë që nuk përfshihet në kategoritë e lartpërmendura, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre muaj.

3. Kur, nga kryerja e veprës së parashikuar në paragrafin e parë shkaktohet ngordhja e një kafshe shtëpiake, të zbutur, të stërvitur ose që jeton përkohësisht ose përgjithmonë nën kontrollin e njeriut, dënimi shtohet deri në një të dytën e tij.

4. Kur, nga kryerja e veprës së parashikuar në paragrafin e parë shkaktohet ngordhja e një kafshe vertebrorë të ndryshme nga ato të përmendura në paragrafin e tretë të këtij neni, dënimi shtohet deri në një të dytën e tij.

5. Kur për dëmtimet e shkaktuara nga kryerja e kësaj vepre nuk kërkohet trajtim veterinar ose kafsha është keqtrajtuar rëndë pa i shkaktuar dëmtime, dënohet me gjobë ose me një dënim plotësues të përshtatshëm për natyrën e veprës penale të kryer.

**Neni 944**  
**Braktisja e kafshëve**

Braktisja e kafshës nga cilido që ka përgjegjësi mbi të në kushte që mund të rrezikojnë jetën ose integritetin fizik të saj, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

**Neni 945**  
**Dëmtimi i personave nga kafsha pa kontroll**

1. Kur nga moskontrollimi i kafshës së shoqërimit ose, nga mosvendosja e maskës mbrojtëse kafshës së shoqërimit, në mjedise publike ose në mjedise të hapura për publikun, kanë ardhur

pasoja në dëm të shëndetit të një personi, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose burgim deri në gjashtë muaj.

2. Kur nga vepra penale ka ardhur dëmtimi i rëndë ose vdekja e një personi, dënohet sipas dispozitës së pjesës së posaçme të këtij Kodi në varësi të formës së fajit të shfaqur nga personi që nuk kontrollon kafshën.

#### **Neni 946**

#### **Ndeshjet ndërmjet kafshëve**

1. Promovimi, organizimi ose drejtimi i ndeshjeve ndërmjet kafshëve që shkaktojnë vuajtjen ose torturimin e kafshëve, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre muaj.

2. Dhënia e kafshëve për ndeshje, rritja ose trajnimi i kafshëve me qëllim përdorimin apo shitjen për ndeshje, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj.

3. Vënia e basteve në ndeshje të zhvilluara midis kafshëve, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy muaj.

4. Në rast se nga kryerja e kësaj vepre penale ndodh dëmtimi apo vdekja e kafshës, vepra konkurren veprën penale të parashikuar në paragrafin përkatës të nenit 943.

#### **Neni 947**

#### **Rrethana e cilësuar**

1. Nëse çdonjëra nga veprat penale të parashikuara në këtë kre, do të kryhen në rrethanat e mëposhtme, dënimi përkatës i parashikuar nga dispozita e veçantë, shtohet deri në një të dytën kur:

a) përdoren armë, instrumente, objekte, mjete, metoda ose forma që mund të jenë të rrezikshme për jetën ose shëndetin e kafshës;

b) kur vepra kryhet me egërsi dhe mizori;

c) kur kafshës i është shkaktuar humbja ose paaftësia e një shqise, organi ose gjymtyre kryesore.

ç) kur vepra kryhet nga pronari i saj ose kujtdo që i është besuar kujdesi i kafshës;

d) kur vepra kryhet në prani të një të mituri ose të një personi në gjendje të veçantë vulnerabiliteti;

dh) kryerja e veprës për qëllime fitimi;

e) kur vepra kryhet për të shtrënguar, frikësuar, ngacmuar ose shkaktuar dëmtime psikologjike ndaj kujtdo që është ose ka qenë bashkëshort ose ndaj një personi që është ose ka qenë i lidhur me autorin nga një marrëdhënie e ngjashme afektive, edhe pa bashkëjetesë;

ë) kur vepra kryhet gjatë një ngjarjeje publike ose shpërndarja e pamjeve të saj nëpërmjet teknologjive të informacionit ose komunikimit;

f) kur vepra kryhet nëpërmjet përdorimit të helmeve, mjeteve shpërthyesë ose mjeteve të tjera të rrezikut të përbashkët.

#### **Neni 948**

#### **Kryerja e veprave nga personi juridik**

Nëse veprat penale të parashikuara në këtë titull kryhen nga personi juridik, gjykata, krahas dënimit kryesor me gjobe sipas nenit 123 të këtij, cakton edhe dënimin plotësues të publikimit të vendimit gjyqësor.

**Neni 949**  
**Dënimet plotësuese**

1. Nëse veprat penale të parashikuara në këtë kre kryhen nga nëpunësi publik, atëherë gjykata, krahas dënimit kryesor cakton edhe dënimin plotësues heqjen e së drejtës për të punuar në shërbimin publik, ose çdo dënim tjetër që çmon të arsyeshëm, në përputhje me natyrën e veprës dhe veprimeve të kryera nga i dënuari, gjithmonë nëse dispozita konkrete nuk ka parashikuar ndryshe.

2. Në çdo rast gjykata vendos masën e zëvendësimit të dëmit të shkaktuar dhe, përveç sendeve që kanë shërbyer për kryerjen e veprave penale, kur ajo është kryer nga subjektet me qëllim përfitimi material apo të premtuar, vendoset konfiskimi i të ardhurave nga vepra penale apo të premtuara.

3. Për veprat penale të lehta të parashikuara në dispozitat e këtij kreu, kur çmohet e arsyeshme, gjykata mund të vendosë dhënien e jo më pak se sa dy dënimeve plotësuese në vend të dënimit kryesor.

**KREU XI**  
**DISPOZITA KALIMTARE**

**Neni 950**  
**Dispozitë tranzitore**

1. Për efekt prapaveprues të ligjit më të favorshëm ose që nuk e dënon veprën penale, gjykata bazohet në përmbajtjen e dispozitës konkrete dhe jo në titullin e saj.

2. Në rast të shqyrtimit gjyqësor të kërkesave të të interesuarve, gjykata vlerëson veprimet e kryera prej tyre të konsideruara si vepër penale krahasuar me përmbajtjen e dispozitës së vjetër apo asaj të re.

3. Në rastet kur personat janë dënuar për vepra penale të përbëra, të kryera më shumë se një herë, në bashkëpunim, në mënyrë të rrezikshme për jetën apo shëndetin e personave ose me pasoja të rënda, gjykata vlerëson përmbajtjen e anës objektive të secilës vepër, referimin në veprën penale konkrete sipas këtij Kodi për të vlerësuar nëse dispozitat e vjetra penale me të cilat janë dënuar personat e interesuar, janë apo jo të parashikuara në këtë Kod.

**Neni 951**  
**Shfuqizimet**

**Neni 952**  
**Hyrja në fuqi**

Ky kod hyn në fuqi 15 ditë pas botimit ne fletoren zyrtare.

Aktet ligjore që shfuqizohen, si dhe efektet dhe mënyra e hyrjes së tij në fuqi, do të caktohet me ligj të veçantë.